

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje
të Rënda të së Drejtës Humanitare
Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-
Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T
Data: 29 nëntor 2012
Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Aktgjykim: 29 nëntor 2012

PROKURORI

k.

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

**AKTGJYKIMI PUBLIK ME SHTOJCËN
KONFIDENCIALE**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers Z.. Aditya Menon
Zj. Daniela Kravetz Zj. Priya Gopalan
Zj. Barbara Goy

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z.. Ben Emmerson QC, Z. Rodney Dixon dhe Z. Andrew Strong për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

PASQYRA E LËNDËS

I. HYRJE	1
II. FAKTORË NË VLERËSIMIN E PROVAVE.....	4
III. STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I UÇK-SË NË ZONËN E DUKAGJINIT	6
A. PARAQITJA DHE STRUKTURA E PËRGJITHSHME E UÇK-SË	6
1. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së	6
2. Numri i forcave të UÇK-së në vitin 1998	8
3. Zonat operative të UÇK-së në Kosovë	9
4. Logjistika dhe organizimi i UÇK-së	10
(a) Financimi	10
(b) Uniformat	11
(c) Armatimi	11
(d) Rekrutimi	13
(e) Stërvitja	13
(f) Disiplina	14
B. UÇK-JA NË ZONËN E DUKAGJINIT	15
1. Organizimi i mbrojtjes në fshatra	16
2. Caktimi i nënzonave dhe formimi i Shtabit Rajonal më 26 maj 1998.....	21
3. Komanda dhe kontrolli në zonën e Dukagjinit deri më 23 qershor 1998	25
4. Jabllanica.....	29
5. Krijimi i Zonës Operative të Dukagjinit	30
(a) Mbledhja e 23 qershorit 1998: krijimi i Zonës Operative të Dukagjinit dhe Shtabit Operativ të Dukagjinit	31
(b) Komanda dhe kontrolli në Zonën Operative të Dukagjinit pas 23 qershorit 1998	33
6. Krijimi i komandës së njësuar: bashkimi i forcave të UÇK-së dhe FARK-ut.....	37
7. Marrëdhëniet midis Zonës Operative të Dukagjinit dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.....	40
8. Ndërrimi i komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit	42
9. Shqiponjat e Zeza.....	44
10. Policia ushtarake e UÇK-së	49
IV. NGJARJET NË TERRITORIN E ZONËS SË DUKAGJINIT TË UÇK-SË NË PERIUdhËN MARS-SHTATOR 1998	56
A. NGJARJET NË TERRITORIN E ZONËS SË DUKAGJINIT GJATË PERIUdhËS MARS-QERSHOR 1998	56
1. Kontrolli territorial dhe operacionet e forcave serbe	56
2. Sulmet e UÇK-së kundër policisë.....	69
3. Rrëmbimi, keqtrajtimi dhe vrasja e civilëve prej UÇK-së.....	74
(a) Incidente rrëmbimesh, keqtrajtimesh dhe vrasjesh të civilëve prej UÇK-së.....	74
(i) Jah Bushati.....	74
(ii) Mijat Stojanoviqi, Dragosllav Stojanoviqi dhe Veselin Stijoviqi.....	78
(iii) Novak Stijoviqi dhe Stanisha Radosheviqi	86
(iv) Sllobodan Radosheviqi, Millosh Radunoviqi, Milica Radunoviqi dhe familja Markoviqi.....	90
(v) Dara (Darinka) Kovaçi (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq), Vukosava Markoviqi (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq), Millovan Vllahoviqi dhe Milka Vllahoviqi	97
(vi) Incidente të tjera.....	100
(vii) Përfundim	104
(b) Deklarata të përgjithshme lidhur me rrëmbimin, keqtrajtimin dhe vrasjen e civilëve nga UÇK-ja.....	104
B. NGJARJET NË TERRITORIN E ZONËS OPERATIVE TË DUKAGJINIT MIDIS KORRIKUT DHE SHTATORIT 1998.....	109

1. Marrëdhëniet midis FARK-ut dhe UÇK-së	109
(a) Dislokimi i forcave të FARK-ut në Zonën Operative të Dukagjinit	109
(b) Incidenti i 4 korrikut 1998 në Glllogjan të komunës së Deçanit.....	113
(c) Marrëdhëniet e mëpasshme midis FARK-ut dhe UÇK-së	116
2. Operacionet e forcave serbe në Zonën Operative të Dukagjinit midis korrikut dhe shtatorit 1998.....	119
3. Incidente të tjera në periudhën korrik-shtator 1998.....	126
(a) Misioni Monitorues i Bashkësisë Evropiane.....	126
(b) Sanije Balaj	130
(c) Incidente të tjera	133
4. Hetime të autoriteteve serbe në rrethinën e kanalit në afërsi të liqenit të Radoniqit, në rrugën drejt fshatrave Dashinoc dhe Ratishë e Poshtme dhe në fermën <i>Ekonomija</i>	134
(a) Konstatime të përgjithshme lidhur me ekzaminimet mjekoligjore dhe identifikimin e kufomave të gjetura	135
(b) Rrethina e kanalit të liqenit të Radoniqit.....	137
(i) Hetimet në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit	140
(ii) Kufomat në liqenin e Radoniqit dhe identifikimi i tyre i mëpasshëm	143
a. Misin Berisha.....	146
b. Zenun Gashi	147
c. Velizar Stoshiqi	150
d. Nurije Krasniqi dhe Istref Krasniqi	151
e. Malush Meha	153
f. Ilire Frrokaj	153
g. Kujtim Imeraj	156
(c) Rruga për në Ratishë të Poshtme dhe Dashinoc.....	156
(d) Ferma <i>Ekonomija</i>	158
(i) Hetimet në fermën <i>Ekonomija</i>	159
(ii) Kufomat në fermën <i>Ekonomija</i> dhe identifikimi i tyre i mëpasshëm	160
a. Mehmet Rustemaj	161
b. Tushe Tahiraj dhe Ramiz Tahiraj.....	161
V. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË NENIT 3 TË STATUTIT	164
A. LIGJI.....	164
1. Kushtet <i>Tadiq</i>	164
2. Kriteret paraprake të Nenit 3.....	165
(a) Konflikti i armatosur	165
(b) Lidhja	167
(c) Statusi i viktimave	168
B. PËRFUNDIME	168
1. Kushtet <i>Tadiq</i>	168
2. Ekzistenca e konfliktit të armatosur.....	168
(a) Ashpërsia e konfliktit	169
(b) Organizimi i UÇK-së	171
(c) Përfundim	172
3. Lidhja	173
4. Statusi i viktimave.....	173
C. PËRFUNDIM	173
VI. AKUZAT	174
A. LIGJI MBI KRIMET E AKUZUARA	174
1. Ligji mbi torturimin	174
2. Ligji mbi trajtimin mizor	175
3. Ligji mbi vrasjen	176
B. PËRFUNDIME	177

1. Shënime paraprake	177
2. Pika 1	179
(a) Akuzat në Aktakuzë	179
(b) Përfundime	179
(c) Përfundim	191
3. Pika 2	191
(a) Akuzat në Aktakuzë	191
(b) Përfundime	191
(c) Përfundim	195
4. Pika 3	195
(a) Akuzat në Aktakuzë	195
(b) Përfundime	195
(c) Përfundim	203
5. Pika 4	205
(a) Akuzat në Aktakuzë	205
(b) Përfundime	205
(c) Përfundim	210
6. Pika 5	211
(a) Akuzat në Aktakuzë	211
(b) Përfundime	213
(i) Burgimi i Pal Krasniqit, Skënder Kuqit dhe Dëshmitarit 3	213
(ii) Ngjarjet e mëpasshme	225
a. Dëshmitari 3	225
b. Skënder Kuqi	227
c. Pal Krasniqi	229
(c) Përfundim	232
7. Pika 6	234
(a) Akuzat në Aktakuzë	234
(b) Përfundime	236
(i) Rrëmbimi nga Zhabeli	236
(ii) Burgimi dhe keqtrajtimi i Naser Likës	240
(c) Përfundim	243

VII. PËRGJEGJËSIA 244

A. LIGJI	244
1. Kryerja	244
2. Kryerja nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale	245
3. Planifikimi	247
4. Nxitja	247
5. Urdhërimi	248
6. Ndihma dhe inkurajimi	249
B. PËRFUNDIME	251
1. Ndërmarrja e përbashkët kriminale	251
(a) Qëllimi i përbashkët i pretenduar	251
(i) Komunikatat e UÇK-së	251
(ii) Policia ushtarake e UÇK-së	254
(iii) “Listat e zeza të UÇK-së”	255
a. Listat e gjetura në shtëpitë e familjes Haradinaj në Gllogjan	256
b. Lista e shënimeve me shkrim dore të një mbledhjeje më 12 korrik 1998	257
c. “Listat e zeza” të Faton Mehmetajt	259
d. Përfundim	260
(iv) Incidente të keqtrajtimit dhe vrasjes së civilëve nga ushtarë të UÇK-së	261
(v) Incidente të keqtrajtimit dhe vrasjeve në objektin e UÇK-së në Jabllanicë	265
(b) Përfundim	268

2. Përgjegjësia e Ramush Haradinajt	268
3. Përgjegjësia e Idriz Balajt	268
4. Përgjegjësia e Lahi Brahimajt	269
C. PËRFUNDIM	270
VIII. VENDIM	271
IX. SHTOJCA I: HISTORIA PROCEDURALE	272
A. PROCEDURA NË PROCESIN E PARË <i>HARADINAJ DHE TË TJERË</i>	272
1. Aktakuza e parë, paraqitja e parë dhe gjykimi i parë.....	272
2. Apeli.....	272
B. NISJA E PROCEDURËS SË RIGJYKIMIT TË PJESSHËM DHE AKTAKUZA E NDRYSHUAR.....	273
C. PROCEDURA GJYQËSORE.....	277
1. Përmbledhje	277
2. Dëshmitarët	278
3. Seanca sipas Rregullës 4	278
4. Lirimi i përkohshëm i të Akuzuarve	278
X. SHTOJCA II: HARTA	281
XI. SHTOJCA III: SHPJEGUES TERMASH.....	283
XII. SHTOJCA IV: SHTOJCË KONFIDENCIALE	292

I. HYRJE

1. Të akuzuarit Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj akuzohen për krime kundër civilëve serbë, romë/egjiptianë dhe shqiptarë kosovarë, që pretendohet të jenë kryer prej tyre apo prej pjesëtarëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) në objektin e burgimit të UÇK-së në fshatin Jabllanicë, në komunën e Gjakovës, në Kosovën perëndimore, në vitin 1998. Në Aktakuzë pretendohen raste konkrete të rrëmbimit të gjithsej 16 civilëve serbë, romë dhe shqiptarë kosovarë të cilët pretendohet se u mbajtën, u torturuan dhe u trajtuan mizorisht në shtabin dhe objektin e burgimit të UÇK-së në Jabllanicë. Më tej pretendohet se tetë prej tyre u vranë gjatë kohës së mbajtjes së tyre prej UÇK-së. Këto pretendime përbëjnë bazën e gjashtë pikave për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, gjegjësisht trajtim mizor, torturim dhe vrasje, sanksionuar në Nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe akuzuar në përpputhje me Nenin 3 të Statutit.

2. Në Aktgjykim, Dhoma do t’u referohet toponimeve në shqip dhe serbisht. Toponimet e ndryshme në shqip dhe serbisht do të shkruhen në të dy versionet. Nëqoftëse toponimi është në të dy gjuhët i njëjtë, atëherë do të shkruhet vetëm një herë.

3. Ky proces është rigjykim i pjesshëm. Tre të Akuzuarit fillimisht u akuzuan më 4 mars 2005 në çështjen *Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84 (“*Haradinaj*”), për 16 pika lidhur me krime kundër njerëzimit dhe 19 pika lidhur me shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Ramush Haradinaj gjithashtu u akuzua për një pikë tjetër lidhur me krime kundër njerëzimit dhe një pikë tjetër lidhur me shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës.¹ Më 3 prill 2008, Dhoma Gjyqësore shpalli Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn të pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës. Lahi Brahimaj u shpall fajtor për dy pika të Aktakuzës dhe u dënua me gjashtë vjet burgim, e u shpall i pafajshëm lidhur me të gjitha akuzat e tjera.² Prokuroria apeloj Vendimin e Dhomës Gjyqësore duke pretenduar se Dhoma Gjyqësore, midis të tjerash, shkeli të drejtën e Prokurorisë për gjykim të drejtë duke mos i mundësuar kohë të mjaftueshme për marrjen e dëshmimeve të dy dëshmitarëve thelbësorë, dhe kërkoi rigjykim.

4. Më 21 korrik 2010, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Robinson, miratoi pjesërisht apelin e Prokurorisë dhe shfuqizoi Vendimin e Dhomës Gjyqësore për shpalljen e pafajësisë së të akuzuarve për disa prej pikave të Aktakuzës lidhur me krimet që pretendohet se ishin kryer në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë. Dhoma e Apelit urdhëroi

¹ *Shih* më poshtë, para. 686.

² *Shih* më poshtë, para. 687.

rigjykim të pjesshëm për këto pika.³ Rigjykimi i pjesshëm iu caktua kësaj Dhome më 21 korrik 2010. Procesi gjyqësor filloi më 18 gusht 2011. Dhoma mori dëshmitë e 56 dëshmitarëve, duke përfshirë dy dëshmitarët lidhur me të cilët u urdhërua rigjykimi.

5. Në Aktakuzën e ndryshuar për herë të fundit pretendohet se të Akuzuarit mbajnë përgjegjësi penale për krimet e akuzuara si pjesëtarë të NPK-së,⁴ qëllim i përbashkët i të cilës ishte konsolidimi i kontrollit të plotë të UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit, e cila përfshinte komunën e Pejës, Deçanit, Gjakovës, zonën e kanalit të Liqenit të Radoniqit dhe pjesë të komunës së Istogut dhe Klinës. Më tej pretendohet se ky konsolidim do të realizohej përmes largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë kosovarë dhe keqtrajtimit të civilëve shqiptarë dhe romë/egjiptianë kosovarë si dhe civilëve të tjerë të cilët bashkëpunonin apo mendohej se kishin bashkëpunuar me forcat serbe, apo ndryshe nuk e përkrahnin UÇK-në. Pretendohet se NPK-ja përfshinte ngritjen dhe funksionimin e objekteve të burgimit të UÇK-së dhe keqtrajtimin e të burgosurve në këto objekte, midis tyre shtabi i UÇK-së në Jabllanicë, Glllogjan dhe Irzniq.⁵ Pretendohet se NPK-ja ekzistoi duke filluar nga marsi i vitit 1998 apo rreth kësaj kohe dhe së paku deri në fund të shtatorit 1998.⁶

6. Në Aktakuzë pretendohet se Ramush Haradinaj ishte një prej drejtuesve më të lartë të UÇK-së në Kosovë. Më tej pretendohet se së paku nga 1 marsi e deri nga mesi i qershorit 1998, ai ishte *de facto* komandant në UÇK dhe se nga mesi i qershorit 1998 u emërua *de jure* komandant dhe si i tillë kishte komandë të përgjithshme mbi forcat e UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit.⁷ Ramush Haradinaj akuzohet për përgjegjësi penale individuale bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit për kryerjen e krimeve të pretenduara në gjashtë pikat e Aktakuzës në kuadër të NPK-së. Ndryshe, ai akuzohet se kreu apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të pretenduara në Pikën 1 dhe se urdhëroi, nxiti apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të pretenduara në Pikën 6.

7. Në Aktakuzë pretendohet se gjatë gjithë kohës që mbulon Aktakuza, Idriz Balaj (i njohur si “Togeri”) ishte pjesëtar i UÇK-së dhe vartës i drejtpërdrejtë i Ramush Haradinajt. Më tej pretendohet se Idriz Balaj ishte komandant i njësisë speciale për ndërhyrje të shpejtë e njohur si “Shqiponjat e Zeza” e cila pretendohet të jetë formuar në prill 1998 me miratimin e Ramush Haradinajt.⁸ Idriz Balaj akuzohet për përgjegjësi penale individuale bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit për gjashtë pikat e akuzuara në Aktakuzë lidhur me shkelje të ligjeve ose zakoneve të

³ *Shih* më poshtë, para. 689.

⁴ Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj për gjashtë pikat e Aktakuzës kurse Lahi Brahimaj për Pikat 1, 2, 4 dhe 6 të Aktakuzës.

⁵ Aktakuza, para. 24.

⁶ Aktakuza, para. 25.

⁷ Aktakuza, para. 2.

⁸ Aktakuza, para. 8-9.

luftës të kryera në kuadër të NPK-së. Ndryshe, ai akuzohet se kreu apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të pretenduara në Pikën 1 dhe se kreu, planifikoi ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të pretenduara në Pikën 6.

8. Në Aktakuzë pretendohet se gjatë gjithë kohës që mbulon Aktakuza, Lahi Brahimaj (i njohur si “Magjup”) ishte pjesëtar i UÇK-së i vendosur në Jabllanicë dhe vartës i Ramush Haradinajt.⁹ Më tej pretendohet se nga 23 qershori e deri më 5 korrik 1998, Lahi Brahimaj ishte zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe më vonë shërbeu si drejtori i financës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.¹⁰ Lahi Brahimaj akuzohet për përgjegjësi penale individuale bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit për kryerjen e krimeve të pretenduara në Pikat 1, 2, 4 dhe 6 të Aktakuzës në kuadër të NPK-së. Ndryshe, ai gjithashtu akuzohet se urdhëroi, nxiti apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të pretenduara në Pikat 1 dhe 2 dhe se kreu, planifikoi apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të pretenduara në Pikën 6.

9. Dhoma mori prova se në vitin 1998, në Kosovë u angazhuan forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë (“RFJ”), duke përfshirë forcat e Ushtrisë së Jugosllavisë (“UJ”) dhe forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë (“MPB”). Dhoma do t’u referohet forcave konkrete të përfshira në një incident konkret nëqoftëse identiteti i tyre është i njohur nga provat. Megjithatë, në rast të mungesës së provave, Dhoma do t’u referohet në përgjithësi këtyre forcave me emërtimin forcat serbe. Ky emërtim nënkupton dhe duhet të kuptohet si forcat e Serbisë, apo të RFJ-së.

⁹ Aktakuza, para. 12.

¹⁰ Aktakuza, para. 12.

II. FAKTORË NË VLERËSIMIN E PROVAVE

10. Sipas paragrafit 3 të Nenit 21 të Statutit, të akuzuarit në Tribunal konsiderohen të pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë së tyre. Një supozim i tillë ia ngarkon barrën e vërtetimit të fajësisë së një të akuzuari Prokurorisë. Në lidhje me çdo akuzë kundër secilit prej të Akuzuarve, standardi i duhur për vendim fajësues është vërtetimi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.¹¹ Rrjedhimisht, në lidhje me çdo pikë të akuzuar kundër çdo të Akuzuari, Dhoma gjykoj nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në bazë të tërësisë së provave se janë vërtetuar çdo element i krimit dhe çdo formë e përgjegjësisë të akuzuara në Aktakuzë. Në rastet kur ishte e arsyeshme të nxirrej më tepër se një konkluzion nga faktet e vërtetuara nga provat, Dhoma shqyrtoi nëse konkluzionet e lartpërmendura nuk përputheshin me fajësinë e të Akuzuarve.¹² Në raste të tilla, detyrimi dhe standardi i provës kërkojnë që për atë pikë të akuzës të shpallet pafajësi.¹³

11. Karakteristikë e rëndësishme e këtij gjykimi ishin provat e shumta të pranuar në formë të shkruar pa paraqitjen e dëshmitarëve për të dëshmuar para Dhomës, qoftë përmes marrëveshjeve konkrete midis palëve ose pasi të Akuzuarit vendosën të mos e ushtronin të drejtën e tyre për t'u bërë pyetje dëshmitarëve. Në rrethana të tilla, Dhoma pranoi si prova edhe incizimet zanore dhe filmimet e dëshmive të mëparshme të dëshmitarëve dhënë në Tribunal. Gjithsesi, duhet theksuar se jo të gjitha provat e paraqitura në gjykimin e parë *Haradinaj* u paraqitën si të tilla në këtë proces.

12. Në gjykimin e parë *Haradinaj* për shumë dëshmitarë u urdhëruan masa për mbrojtjen e identitetit të tyre të cilat ishin në fuqi edhe gjatë këtij procesi. Për hir të sigurisë personale të dëshmitarëve, shumë prej tyre në këtë Aktgjykim përmenden me numra. Në Aktgjykim nuk përmenden emrat dhe të dhënat e tjera të këtyre dëshmitarëve që rrezikojnë identifikimin e tyre. Në rastet kur Dhoma gjykoj se përmendja e pseudonimit të një dëshmitari në kontekst të një dëshmie të posaçme mund të zbulojë identitetin e dëshmitarit, Dhoma redaktoi referencat për dëshmi të tilla në versionin publik të Aktgjykimit. Referencat janë përmbledhur në Shtojcën Konfidenciale të Aktgjykimit.

13. Dhoma mori prova të shumta me shkrim që vinin nga MPB-ja e Serbisë, pjesëmarrëse në konflikt, ndër të cilat raporte me shkrim, shënime apo dokumente të tjera. Burimi i informacionit të këtyre provave me shkrim si dhe mënyra e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit nuk ishin çdo

¹¹ Rregulla 87(A) e Rregullores, në pjesën përkatëse parashtron: “Verdikti i fajësisë mund të jepet vetëm kur shumica e Dhomës Gjyqësore binden se fajësia është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.”

¹² *Shih* Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 11; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 10.

¹³ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458.

herë të njohura. Në shumë raste dokumente të tilla nuk ishin të nënshkruara. Në rastet kur dokumentet ishin të nënshkruara, autorët e tyre nuk erdhën për të dëshmuar në këtë proces. Në këto rrethana, Dhoma i vlerësoi me kujdes materiale të tilla.

14. Gjithashtu, Dhoma mori dëshmi të dëshmitarëve të cilët në kohën që mbulon Aktakuza ishin pjesëtarë të UÇK-së. Dhoma fitoi përshtypjen se ka të ngjarë që dëshmitë e tyre lidhur me organizimin e UÇK-së apo çështje të tjera të rëndësishme në lidhje me Aktakuzën, të jenë ndikuar nga besnikëria e tyre ndaj organizatës apo ndaj të Akuzuarve të cilët në atë kohë ishin pjesëtarë të rëndësishëm të UÇK-së. Dhoma e mori parasysh këtë aspekt gjatë shqyrtimit të dëshmive të tilla.

15. Pati raste kur për një fakt material të çështjes dëshmoi vetëm një dëshmitar. Dëshmia e një dëshmitari të vetëm lidhur me një fakt material, ligjërisht nuk kërkon konfirmim.¹⁴ Gjithsesi, në raste të tilla, Dhoma duhej të bindej plotësisht për besueshmërinë e dëshmisë përpara se ta përdorte.

16. Pavarësisht nga problemet e ndryshme që ndikojnë në vlerësimin e provave në këtë proces gjyqësor, pasi shqyrtoi dhe peshoi me kujdes të gjitha provat, Dhoma arriti të nxjerrë përfundimet e saj në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e çdo të Akuzuari për çdo pikë të Aktakuzës mbi bazën e fakteve të çështjes. Këto përfundime si dhe arsyetimet e hollësishme të Dhomës për pranimin apo mospranimin e provave të caktuara shtjellohen më poshtë.

¹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 62.

III. STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I UÇK-SË NË ZONËN E DUKAGJINIT

A. Paraqitja dhe struktura e përgjithshme e UÇK-së

17. “Dalja e parë publike” e UÇK-së ndodhi më 28 nëntor 1997¹⁵ gjatë varrimit të mësuesit Halit Geci, i cili pretendohet se ishte vrarë prej forcave serbe.¹⁶ U reportua se tre persona me uniforma të UÇK-së – dy prej tyre të maskuar – mbajtën një fjalim duke i bërë thirrje popullit të Kosovës t’i bashkohej “luftës”.¹⁷ Dëshmitari 17 më pas mësoi se këta tre persona ishin Daut Haradinaj, Rexhep Selimi dhe një person i njohur me nofkën Kapuçi.¹⁸ Autoritetet serbe e quanin UÇK-në grup “terrorist”.¹⁹

1. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së

18. Nga fundi i vitit 1996 dhe fillimi i vitit 1997, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së²⁰ numëronte rreth 10 anëtarë që vepronin në tri zona të ndryshme: fshehtas në Kosovë, në Shqipëri dhe në shtetet e Perëndimit, si për shembull në Zvicër, Gjermani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francë dhe anembanë Skandinavisë.²¹ Deri nga pranvera e 1998, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishin Sokol Bashota, Raif Gashi, Xhemajl Fetahu, Adem Grabovci, Xhavit Haliti, Ilir Konushevc, Jakup Krasniqi, Azem Syla (Sula), Rexhep Selimi, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Xhavit Zeka.²² Jo të gjithë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm njiheshin dhe komunikonin me njëri-tjetrin.²³

¹⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 4; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 5-8.

¹⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 4.

¹⁷ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 4; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 8.

¹⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 4.

¹⁹ Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 16, 18; Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9850-9852; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 8-10; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 6; Zoran Stijović, Prova materiale P121, para. 7; *shih* gjithashtu Dragan Zhivanović, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9316.

²⁰ Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së (“Shtabi i Përgjithshëm”) njihej edhe si Shtabi Qendror i UÇK-së, Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4966.

²¹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3306; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5025.

²² Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 15-16; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3261, 3265-3267, 3282-3283, 3389; Bislim Zyrapi, T. 651, 689, 693, 759-760; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3305-3307, 3311; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5026-5027, *shih* gjithashtu Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3821.

²³ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3821; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5024-5026, 5029.

19. Adem Jashari ishte komandant i UÇK-së deri në mars të vitit 1998.²⁴ Pas vrasjes së Adem Jasharit, komandant i përgjithshëm i UÇK-së u bë Azem Syla (Sula), kurse Sokol Bashota zëvendëskomandant i UÇK-së dhe Rexhep Selimi inspektor i përgjithshëm.²⁵ Hashim Thaçi drejtonte degën politike të UÇK-së.²⁶ Jakup Krasniqi u emërua zëdhënës i UÇK-së në Kosovë në qershor të vitit 1998.²⁷ Bislim Zyrapi u bë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dikur nga fundi i majit-fillimi i qershorit 1998.²⁸ Lahi Brahimaj u bë drejtor i degës së financave në korrik 1998.²⁹
20. Në vitin 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk kishte një bazë të vetme në Kosovë; anëtarët e tij lëviznin nga një vend në tjetrin për shkaqe sigurie, zakonisht të pavarur njëri nga tjetri.³⁰ John Crosland, atasheu i atëhershëm ushtarak britanik në Republikën e Jugosllavisë,³¹ dëshmoi se gjatë vitit 1998, UÇK-ja kishte organizim më të mirë.³²
21. John Crosland dëshmoi për Dhomën se ndonëse UÇK-ja ishte e organizuar, do të ishte e gabuar që organi në krye të saj të quhej “Shtab i Përgjithshëm”. Për mendimin e tij, Shtabi i Përgjithshëm nuk kishte kontroll efektiv mbi UÇK-në.³³ John Crosland arriti në përfundimin se nuk kishte një koordinim “të mirëfilltë” midis zonave dhe Shtabit të Përgjithshëm.³⁴

²⁴ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3306; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5024.

²⁵ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3311; në lidhje me vrasjen e Adem Jasharit, *shih* më poshtë para. 143.

²⁶ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3306; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5075.

²⁷ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3311-3313, 3429; Prova materiale P65, Shtojca 14.

²⁸ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 16; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3259, 3282, 3304; Bislim Zyrapi, T. 687, 695.

²⁹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 16; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3212-3213, 3394; Bislim Zyrapi, T. 759-760; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5075.

³⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3282-3284, 3402-3403, 3412-3413; Bislim Zyrapi, T. 689, 693-694, 775; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4990, 5029, 5074.

³¹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2925-2926.

³² John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4703-4704.

³³ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 2037-2038; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4704. Sipas Bislim Zyrapi, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk funksiononte në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 15; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 13; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3293, 3295; Bislim Zyrapi, T. 690-691, 697, 699, 733.

³⁴ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4706-4707.

22. Shtabi i Përgjithshëm hartonte deklarata politike, komunikata dhe intervista ku paraqiste strategjinë dhe qëndrimet politike të UÇK-së, si dhe zhvillimet luftarake dhe ushtarake të asaj kohe në Kosovë.³⁵

2. Numri i forcave të UÇK-së në vitin 1998

23. Dhoma mori dëshmi nga burime të UJ-së në lidhje me numrin e forcave të UÇK-së në zonat e ndryshme anembanë Kosovës nga fillimi e deri në mesin e vitit 1998. Sipas një raporti të komandës së Brigadës së Motorizuar 549 të datës 23 shkurt 1998, vlerësohej se në territorin që përfshinte Gjakovën, numri i forcave të dislokuara në atë zonë i UÇK-së arrinte deri në 200 pjesëtarë.³⁶ Sipas Branko Gajiqit, asokohe zëvendësshef i administratës së sigurimit serb,³⁷ midis janarit dhe marsit të vitit 1998 mendohej se UÇK-ja kishte “rreth 3.000 pjesëtarë të armatosur të organizuar dhe rreth 6.000 - 8.000 të tjerë që kishin armë”.³⁸ Në një urdhër dislokimi të Brigadës së Motorizuar 549 të datës 22 prill 1998, vlerësohej se UÇK-ja ishte e madhësisë së një batalioni me 500 “terroristë” të armatosur, me shumë gjasë e formuar në komunën e Prizrenit, Rahovecit, Suharekës, Gjakovës, Deçanit, Klinës dhe Pejës, e veçanërisht në zonën e përgjithshme të fshatrave Jabllanicë, Gllogjan, Junik dhe Smolicë.³⁹ Në raportin e Korpusit të Prishtinës të UJ-së të datës 8 maj 1998 përshkruhet gjendja e sigurisë në Gjakovë dhe vlerësohet se në Kosovë janë ushtarakisht të organizuar rreth 5.000 “terroristë” dhe 15.000 të tjerë të pajisur me armë.⁴⁰ Sipas Zoran Stijoviçit, shef i Degës për Analiza i RDB-së së Serbisë në Prishtinë, brenda qershorit të vitit 1998 UÇK-ja kishte rreth 1.000 pjesëtarë.⁴¹ Dragan Zhivanoviçiqi, ish-gjeneralmajor i UJ-së,⁴² dëshmoi se në maj apo qershor 1998, Aleksandar Savoviçiqi, shef i Sigurimit i Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së, e informoi se kishte të ngjarë që Haradinaj të ndodhej në zonën e Gllogjanit dhe kishte rreth 500-1.000 njerëz të armatosur dhe të stërvitur.⁴³

24. John Crosland dëshmoi se shifrat e UJ-së në lidhje me numrin e pjesëtarëve të UÇK-së janë të dyshimta. Në bazë të vizitave që u bëri pesë apo gjashtë shtabeve të UÇK-së në fshatra të

³⁵ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3320; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5010, 5022-5023, 5030.

³⁶ Prova materiale P28, para. 3.

³⁷ Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9668; Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 8.

³⁸ Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9684, 9746-9747.

³⁹ Prova materiale P32, f. 1; Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 24.

⁴⁰ Prova materiale P34; Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 29; *shih* gjithashtu Prova materiale P20, f. 1.

⁴¹ Zoran Stijoviçiq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9068-9069.

⁴² Dragan Zhivanoviçiqi ishte njëkohësisht shef i Shtabit të Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së, Dragan Zhivanoviçiq, Prova materiale P112, para. 3.

⁴³ Dragan Zhivanoviçiq, Prova materiale P112, para. 41.

ndryshme anembanë Kosovës, ai besonte se në prill të vitit 1998 ekzistonte një “bërthamë e UÇK-së” me rreth 400-500 pjesëtarë.⁴⁴ Gjithsesi, ai pranoi se nëqoftëse shifrat e UJ-së përfshinin numrin e mundshëm të pjesëtarëve të rinj të UÇK-së që stërviteshin në Shqipëri, atëherë shifra prej 3.500 deri 4.500 njerëz nuk ishte edhe “aq larg” shifrës së saktë.⁴⁵

25. Dhoma vëren se këto janë shifra të përafërta dhe me gjasë jo plotësisht të sakta. Branko Gajiqi pranoi se informacioni që mblidhnin forcat serbe nuk ishte 100 për qind i saktë, apo madje i përafërt.⁴⁶

3. Zonat operative të UÇK-së në Kosovë

26. Në fillim të 1998, në Kosovë ekzistonin disa grupime të UÇK-së.⁴⁷ Ato quheshin nënzona meqenëse Kosova në tërësi konsiderohej si një zonë.⁴⁸ Për lehtësi referimi, Dhoma do t’u referohet këtyre nënzona me zona.⁴⁹

27. Në vitin 1998, në Kosovë ishin shtatë zona:⁵⁰

1. zona e parë ishte Drenica dhe komandant i saj Sylejman Selimi;⁵¹
2. zona e dytë ishte Dukagjini dhe komandant i saj Ramush Haradinaj;⁵²
3. zona e tretë ishte Llapi dhe komandant i saj Rrustem Mustafa (“Remi”);⁵³
4. zona e katërt ishte Shala dhe komandant i saj Rrahmon Rama;⁵⁴
5. zona e pestë ishte Pashtriku dhe komandant i saj Musa Jashari;⁵⁵

⁴⁴ Prova materiale P13; John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1917-1919; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2963-2964.

⁴⁵ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1919.

⁴⁶ Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9684-9685.

⁴⁷ Prova materiale P13; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2946.

⁴⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4971.

⁴⁹ Pas nëntorit të vitit 1998, këto nënzona u emërtuan zona, Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4971, 5057.

⁵⁰ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3323.

⁵¹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3323.

⁵² Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3479.

⁵³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17; Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4217-4218; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3323.

⁵⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17.

6. zona e gjashtë ishte Nerodimja dhe komandant i saj Shukri Buja;⁵⁶ dhe

7. zona e shtatë ishte Karadaku dhe komandant i saj Ahmet Isufi.⁵⁷

28. Niveli i organizimit në shtatë zonat ndryshonte dukshëm.⁵⁸ Zona e Drenicës ishte e organizuar mirë duke qenë se luftimet midis UÇK-së dhe forcave serbe në këtë zonë kishin filluar që në nëntor të vitit 1997.⁵⁹ Luftimet në Dukagjin filluan me sulmin kundër shtëpive të familjes Haradinaj më 24 mars 1998.⁶⁰ Si pasojë e luftimeve të hershme në këto dy zona, ato ishin më të zhvilluarat dhe më të organizuarat ndër të gjitha zonat.⁶¹ Sipas Bislim Zyrapi, zona e Drenicës dhe ajo e Dukagjinit ishin dy zonat e vetme të UÇK-së në qershor dhe korrik të vitit 1998; ato ishin në fazën e zhvillimit duke u përpjekur të krijonin strukturë dhe komandë të vetme.⁶² Pas ofensivës verore të forcave serbe në vitin 1998, niveli i organizimit të zonave filloi të ndryshonte.⁶³ Komandantët e zonës së pestë, së gjashtë dhe së shtatë nuk morën postin e komandantit deri në vjeshtë të 1998 për arsye se veprimtaria e UÇK-së deri në atë kohë ishte e kufizuar.⁶⁴

4. Logjistika dhe organizimi i UÇK-së

(a) Financimi

29. Në vitin 1997 dhe 1998, UÇK financohej nga dy fonde: “Fondi Bukoshi” (i njohur gjithashtu si “Fondi i Qeverisë” ose “Fondi i trepërqindëshit”) dhe “Fondi Vendlindja Thërret”.⁶⁵ Fondi “Vendlindja Thërret” u krijua në vitin 1995 dhe kontrollohej prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.⁶⁶ Kontributet vinin kryesisht nga shqiptarë që jetonin jashtë vendit dhe përdorshin për

⁵⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17.

⁵⁶ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17.

⁵⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17.

⁵⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3414.

⁵⁹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3414.

⁶⁰ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, para. 7; *shih* më poshtë para. 144-149.

⁶¹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, para. 7; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3414; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3275, 3278, 3390-3391, 3407-3408.

⁶² Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3275-3276, 3278; Bislim Zyrapi, T. 696; *shih* gjithashtu më poshtë para. 70-77.

⁶³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3414; *shih* gjithashtu më poshtë para. 283-300.

⁶⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 17; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3278.

⁶⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3367; Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, para. 5; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 5-6; Prova materiale P153, f. 5; Prova materiale D22, f. 1-2.

⁶⁶ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, para. 5.

blerjen e armëve dhe pajisjeve në Shqipëri, për përdorim në Kosovë.⁶⁷ Dhoma nuk mori prova të tjera në lidhje me “Fondin Bukoshi”.

(b) Uniformat

30. Në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit 1998, pjesa më e madhe e ushtarëve të UÇK-së gjatë stërvitjeve mbanin rroba civile dhe disa prej tyre kishin emblemën e UÇK-së në krah.⁶⁸ Disa ushtarë të UÇK-së mbanin uniforma kamuflimi me emblemën e UÇK-së.⁶⁹ Emblema e UÇK-së kishte “shqiponjën” dhe mbishkrimin “UÇK”.⁷⁰

31. Sipas Shemsedin Çekajt, Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj mbanin uniforma me ngjyrë të gjelbër të errët me simbolet e UÇK-së dhe ishin të armatosur me “pistoleta, armë të lehta”.⁷¹ U tha se Ramush Haradinaj gjithashtu mbante uniformë ushtarake kamuflimi me çizme dhe kapelë dhe se kishte një armë automatike.⁷² Sipas dëshmimeve, ushtarët e UÇK-së në pikat e kontrollit mbanin pushkë automatike dhe pajisje të thjeshta komunikimi si “radiolidhje dore”.⁷³

32. Dhoma konkludon se ndonëse shumë pjesëtarë të UÇK-së mbanin rroba civile me simbolet e UÇK-së në krah, disa prej tyre mbanin uniforma kamuflimi që dukej se ishin me ngjyrë të gjelbër të errët. Dhoma më tej konkludon se pjesëtarët e UÇK-së dalloheshin nga të tjerët nga emblema e UÇK-së në krah. Siç shtjellohet më poshtë në Aktgjykim, Shqiponjat e Zeza dhe policia ushtarake e UÇK-së mbanin uniforma të veçanta të dallueshme nga uniformat e pjesëtarëve të thjeshtë të UÇK-së.⁷⁴

(c) Armatimi

33. Në bazë të informacionit të marrë nga MPB-ja, Dragan Zhivanoviqi vlerësoi se në fillim të vitit 1998, në Kosovë kishte rreth 80.000 - 100.000 copë armë, kurse sipas vlerësimeve jozyrtare rreth 200.000.⁷⁵ Në raportin e Korpusit të Prishtinës të UJ-së të datës 8 maj 1998 thuhej se UÇK-ja

⁶⁷ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, para. 5; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 34; Prova materiale P152; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 5.

⁶⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 33; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5830; Vesel Dizdari, Prova materiale P467, para. 15.

⁶⁹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3614; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 16.

⁷⁰ Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 8, 33; Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 987.

⁷¹ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4393.

⁷² Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3618.

⁷³ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3614-3615.

⁷⁴ *Shih* më poshtë para. 106, 124.

⁷⁵ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9294-9295.

dispononte “disa mortaja 60-milimetërshe, granatahedhës dore dhe pushkë snajper”.⁷⁶ Në një raport tjetër të Korpusit të Prishtinës të UJ-së të datës 3 qershor 1998 thuhej se UÇK-ja dispononte “mortaja 60 dhe 80-milimetërshe, topa pa dridhje 75 dhe 82-milimetërsh, granatahedhës dore dhe pajisje luftarake moderne kundër automjeteve të blinduara. Ajo gjithashtu dispononte sasi të madhe municioni dhe bombash dore”.⁷⁷ Sipas Branko Gajiqit, në gjysmën e parë të vitit 1998 “u zbuluan rreth 25.000 copë armë të kalibrave dhe të llojeve të ndryshme, 500.000 fishekë dhe predha të kalibrave të ndryshme, rreth 10.000 bomba dore, sasi të mëdha granatahedhësish dhe mortajash, kryesisht të kalibrit 60-milimetërsh dhe disa tonelata pajisjesh ushtarake”.⁷⁸ Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se në gjysmën e parë të vitit 1998, në zonën e Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së, përmes kufirit u kaluan rreth 20.000 copë armë, duke përfshirë armë të prodhimit kinez të cilat më parë i kishin qenë në armatimin e ushtrisë së Shqipërisë, pushkë gjysmëautomatike, pushkë automatike të tipit kallashnikov, mitralozë të lehtë, mitralozë, granatahedhës dore, mortaja, pajisje të tjera shtesë, karikatorë dhe municion për të gjitha llojet e armëve.⁷⁹ Dhoma nuk mori prova të tjera që konfirmonin këtë informacion.

34. Përkundrazi, sipas John Crosland-it, në periudhën janar-korrik 1998, UÇK-ja nuk dispononte “armatim të shumtë”.⁸⁰ Kjo konfirmon dëshminë e Rustem Tetajt se UÇK-ja kishte dhe filloi të përdorte granatahedhës dore kundërtanke me rreze efektive qitjeje 300-500 metra vetëm pas ardhjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (“FARK”) në Zonën Operative të Dukagjinit në fund të qershorit 1998.⁸¹ Ata kishin edhe RPG (granatahedhës dore) që mund të përdreshin kundër automjeteve të blinduara, por jo kundër tankeve.⁸²

35. Në raportin e Brigadës së Motorizuar 549 të UJ-së të datës 5 mars 1998 përshkruhen tri “rrugë kryesore” të UÇK-së për futjen e fshehtë të armëve në Kosovë: (i) Bajram Curri–Junik–në drejtim të Jabllanicës dhe Drenicës; (ii) Liqen dhe Qafa e Dobrunës në drejtim të Rogovës–Rahovecit–Malishevës dhe Drenicës; (iii) pikat kufitare Stojanoviq dhe Mandiq, dhe Lugina e

⁷⁶ Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 29; Prova materiale P34, f. 2.

⁷⁷ Prova materiale P116, para. 2.

⁷⁸ Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9699; *shih* gjithashtu Prova materiale P29; P35.

⁷⁹ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9295.

⁸⁰ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 2010.

⁸¹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3823, 3825, 3851; *shih* më poshtë, para. 258. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshminë e Jakup Krasniqit i cili iu referua intervistës së tij si zëdhënës i UÇK-së me një gazetë më 6 korrik 1998, ku ai kishte theksuar se UÇK-ja dispononte armatim të rëndë dhe ishte e gatshme të merrte kontrollin mbi Prishtinën. Ai sqaroi këtë qëndrim duke theksuar se raporte të tilla për mediat ishin pjesë e propagandës që synonte të paraqiste UÇK-në më të organizuar se sa ishte në të vërtetë dhe të fitonte besueshmëri, Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5038.

⁸² Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3823.

Plavës, në drejtim të Opolës.⁸³ Dhoma mori prova se Jabllanica dhe Gllogjani ishin dy vende strategjike në rrugën e UÇK-së për furnizim me armë dhe se UÇK-ja planifikonte dhe përpiqej të krijonte një korridor për transportin e armëve nga Shqipëria që do të lidhte Drenicën me Deçanin.⁸⁴

(d) Rekrutimi

36. Shumë njerëz ishin të gatshëm të anëtarësoheshin në UÇK. Për anëtarësim në UÇK, kandidatët duhej të paraqiteshin të shoqëruar prej dikujt që do të dëshmonte për besueshmërinë e tyre.⁸⁵ Të dhënat personale të kandidatëve regjistroheshin dhe ata pyeteshin pse donin të anëtarësoheshin në UÇK.⁸⁶ Për anëtarësim në UÇK nuk kërkohej miratim prej Shtabit të Përgjithshëm.⁸⁷ Rekrutët e rinj fillonin menjëherë stërvitjen dhe më pas bënin betimin solemn.⁸⁸ Cufë Krasniqi rrëfeu se çfarë ndodhi gjatë ceremonisë së betimit të mbajtur në Baran, në komunën e Pejës, më 20 korrik 1998, ku mori pjesë edhe ai vetë.⁸⁹ Ceremonia u kryesua nga Nazif Ramabaja dhe Ramush Haradinaj. Fjalime mbajtën edhe Rustem Tetaj dhe Tahir Zemaj.⁹⁰ Idriz Balaj nuk ishte i pranishëm.⁹¹ Ushtarët shkruan emrat në listën që ua dhanë dhe morën formulën e betimit në formë të shtypur dhe një certifikatë.⁹²

(e) Stërvitja

37. Në shkurt të vitit 1998, Metë Krasniqi i kërkoi Cufë Krasniqit që të stërviste ushtarët e rinj të UÇK-së për shkak të përvojës që kishte në përdorimin e armëve.⁹³ Nga kjo datë e deri më 28 maj

⁸³ Prova materiale P30, f. 1-2.

⁸⁴ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1897, 1945-1947; Dëshmitari 77, T. 1299-1300; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 8-10; Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4185-4191; Bislim Zyrapi, T. 682-683; Zoran Stijoviq, T. 565-569; Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9004-9005; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 25; Provat materiale P19, para. 5; P28, para. 3; P35, f 2-3.

⁸⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 32; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716-5717; Prova materiale P219.

⁸⁶ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 32.

⁸⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 13; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3260.

⁸⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 32; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716-5717.

⁸⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 66; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716, 5804; Prova materiale D148.

⁹⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 67; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716-5717.

⁹¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716.

⁹² Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 67.

⁹³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 30; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5795.

1998, Cufë Krasniqi stërviti ushtarët e UÇK-së në fshatin Vranoc i Vogël të komunës së Deçanit që ishte nën komandën e Din Krasniqit.⁹⁴ Shumica e ushtarëve që kryenin stërvitjen ishin nga fshatrat Buçan dhe Vranoc të komunës së Pejës dhe nga Vranoci i Vogël.⁹⁵ Cufë Krasniqi dëshmoi se ditën e parë të stërvitjes kishte rreth 21 ushtarë dhe se ky numër më pas arriti në 700-1.000 ushtarë.⁹⁶ Ai stërviste një grup ushtarësh për një deri në tre muaj për t'i përgatitur për luftime, operacione, taktikë luftarake dhe për përdorimin e armëve, si për shembull armët M48 dhe AK47, granatahedhësit dhe topat kundërajrorë.⁹⁷ Cufë Krasniqi dëshmoi se çdo ditë bënte një bisedë njëorëshe me ushtarët në lidhje me trajtimin e civilëve dhe robërve të luftës.⁹⁸ Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se UJ-ja dhe MPB-ja gjithashtu kishin dëgjuar për stërvitjet e UÇK-së në Pejë, Mitrovicë, Deçan dhe në fshatrat Prapaqan, Isniq, Dashinoc, Llukë e Epërme dhe Gllogjan.⁹⁹

38. Gjatë kohës së kaluar në Shqipëri nga mesi i marsit e deri më 28 maj 1998, Bislim Zyrapi dhe kolegë të tij oficerë stërvitën rreth 300 ushtarë; këtë e organizoi Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.¹⁰⁰ Ramush Haradinaj mori një raport të datës 1 korrik 1998 në të cilin Salih Veseli nga "Shtabi i Rekës" raportonte se kërkesa për stërvitje ishte plotësuar dhe se rreth 400 ushtarë po kryenin stërvitjet.¹⁰¹ Më 8 korrik 1998, Ramush Haradinaj nxori urdhrin për stërvitjen e 64 luftëtarëve të UÇK-së në qendrën e UÇK-së për stërvitjen e ushtarëve dhe oficerëve "Jusuf Gërvalla".¹⁰²

(f) Disiplina

39. Komandantët e zonave në Kosovë kishin për detyrë të informonin Shtabin e Përgjithshëm për çdo krim ose shkelje të ligjeve të luftës të kryer në zonën e tyre operative; më pas Shtabi i Përgjithshëm urdhëronte masat e nevojshme.¹⁰³ Mirëpo Shtabi i Përgjithshëm dhe UÇK-ja nuk kishin mekanizmat e duhur për marrjen e masave përveç se shkarkimin publik nga pozita e personave që kishin kryer krime apo shkelje.¹⁰⁴ Komandanti i zonës ishte i detyruar të shkarkonte

⁹⁴ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 31, 51.

⁹⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 31.

⁹⁶ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 34; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5715.

⁹⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 24, 34; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5715.

⁹⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5721.

⁹⁹ Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9318-9319.

¹⁰⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3191-3192, 3259, 3261, 3264-3265.

¹⁰¹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48; Prova materiale P205.

¹⁰² Prova materiale P239.

¹⁰³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3412-3413; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5150.

¹⁰⁴ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4970, 5150-5151.

shkelësit apo autorët e krimeve.¹⁰⁵ Jakup Krasniqi dëshmoi se Shtabi i Përgjithshëm asnjëherë nuk mori informacion se “pjesëtarë të UÇK-së ekzekutuan robër”.¹⁰⁶ Bislim Zyrapi dëshmoi se ndonëse zona e Drenicës, Shalës dhe Pashtrikut paraqitën ankesa lidhur me disiplinën ushtarake, asnjë komandant në Zonën e Dukagjinit përfshirë edhe Ramush Haradinajn, nuk iu drejtua Bislim Zyrapi për probleme të tilla.¹⁰⁷

40. Jakup Krasniqi shpjegoi se komandantët e zonave e kishin të vështirë mbajtjen e disiplinës midis ushtarëve meqenëse zonat ishin të ndara në bazë të kriterit gjeografik; nuk kishte një organizim të mirëfilltë apo komunikim të rregullt midis zonave.¹⁰⁸ Për më tepër, Jakup Krasniqi u pajtua me parashtrimin se gjatë periudhës mars-shtator 1998, UÇK-ja nuk kishte as gjykatës, e as gjykata.¹⁰⁹

41. Me përjashtim të incidentit në kazermën e Prapaqanit kur pjesëtari i FARK-ut Tahir Zemaj largoi një ushtar nga rradhët e ushtrisë, Rustem Tetaj nuk ishte në dijeni të masave të tjera disiplinore kundër ndonjë pjesëtari të UÇK-së gjatë periudhës maj-shtator 1998.¹¹⁰

B. UÇK-ja në zonën e Dukagjinit

42. Emërtimi “Zona e Dukagjinit”¹¹¹ i referohet zonës gjeografike në Kosovën perëndimore që përfshinte rreth 40-50 fshatra në komunën e Deçanit në perëndim, në komunën e Pejës në veri, në

¹⁰⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 35, 38; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3441, 3443; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5150.

¹⁰⁶ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3412-3413.

¹⁰⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 36, 38; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 47; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3432.

¹⁰⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4970.

¹⁰⁹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5088-5089. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 74; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 37; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3430-3431. Rustem Tetaj u pyet lidhur me formimin e gjykatës ushtarake të UÇK-së në qershor të vitit 1998. Dëshmitari shpjegoi se kjo ishte pjesë e propagandës për ngritjen e moralit dhe për t’i treguar popullit se UÇK-ja ishte duke krijuar një gjykatë për të parandaluar “gjërat e këqija”, Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3748-3749. Kjo gjykatë nuk u themelua kurrë, Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3826.

¹¹⁰ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3827.

¹¹¹ Zona Operative e Dukagjinit u formua pas 23 qershorit 1998, kur edhe u zgjerua dhe përfshinte një zonë më të gjerë, *shih* më poshtë, para. 72. Para kësaj date, zona e Dukagjinit njihej thjesht si “Zona e Dukagjinit” ose “Rrafshi i Dukagjinit”, *shih* Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636, 3723; *shih* gjithashtu Skënder Rexhahmetaj, T. 1052-1054. Rrjedhimisht, Dhoma do t’i referohet kësaj zone me “Zona e Dukagjinit” në lidhje me ngjarjet dhe çështjet para datës 23 qershor 1998. Për periudhën pas 23 qershorit 1998, Dhoma do t’i referohet zonës me “Zona Operative e Dukagjinit”.

komunën e Gjakovës në juglindje, dhe pjesë të komunës së Istogut në verilindje dhe të komunës së Klinës në lindje.¹¹² Pas mbledhjes së 23 qershorit 1998, Jabllanica, midis të tjerash, u përfshi në Zonën Operative të Dukagjinit.¹¹³ UÇK-ja në Kosovën perëndimore kishte tri “familje të njohura si baza mbështetëse” – Haradinajt në Glllogjan; Jasharët në Prekaz dhe Brahimajt në Jabllanicë.¹¹⁴

1. Organizimi i mbrojtjes në fshatra

43. Dhoma mori prova në lidhje me ngjarjet dhe veprimet në fshatrat Glllogjan, Irzniq, Isnig, Vranoc i Vogël dhe Llukë e Poshtme në komunën e Deçanit, në Lugun e Baranit në komunën e Pejës dhe në Grabanicë në komunën e Klinës.¹¹⁵

44. Pas luftimeve në shtëpitë e familjes Haradinaj në Glllogjan më 24 mars 1998,¹¹⁶ grupe të vogla njerëzish filluan organizimin në fshatrat e tyre. Kështu ndodhi në Vranoc të Vogël, në Isnig, në Llukë të Poshtme, në Irziniq dhe në Lugun e Baranit.¹¹⁷ Ata u mbledhën për të mbrojtur fshatrat e tyre dhe merrnin vendime në lidhje me pozicionet mbrojtëse të nevojshme.¹¹⁸

45. Roli i Ramush Haradinajt gjatë luftimeve në shtëpitë e familjes Haradinaj më 24 mars 1998 ngriti nivelin e mbështetjes së popullatës vendase për UÇK-në dhe i dha komandantit të fshatit Glllogjan, Ramush Haradinajt, popullaritet dhe respekt të madh në atë zonë.¹¹⁹ Pas kësaj ngjarjeje,

¹¹² Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 44, 90; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 25; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3480; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 47; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2945-2950; Prova materiale P10.

¹¹³ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3723, *shih* më poshtë, para. 72.

¹¹⁴ Bislim Zyrapi, T. 703-709.

¹¹⁵ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3708.

¹¹⁶ *Shih* më poshtë, para. 144-146.

¹¹⁷ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 6; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4390; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 38-39; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 5, 11; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 6-7, 11; Skënder Rexhahmetaj, T. 1031-1034; Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9749; Zoran Stijoviq, T. 566-567; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 27; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 2; Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8742; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5046-5047; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3378.

¹¹⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5046-5047; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3378.

¹¹⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 35, 40, 43, 61; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 11; Skënder Rexhahmetaj, T. 1045, 1097-1098; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(f); Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 9; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4482; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2964-2965; Dëshmitari 29, Prova materiale

shtabi i formuar në Gllogjan në komunën e Deçanit u pranua si pika qendrore e UÇK-së në zonën e Dukagjinit.¹²⁰ Personat e vendosur në shtabin e Gllogjanit, ndër të cilët edhe Ramush Haradinaj, gjithashtu konsideroheshin si persona me përvojë më të madhe për luftë dhe për furnizim me armë nga Shqipëria.¹²¹ Në Aktakuzë pretendohet se nga fillimi i prillit 1998, pjesa e komunës së Deçanit dhe Gjakovës që shtrihej rreth bazës së Ramush Haradinajt në Gllogjan ishte padyshim nën kontrollin e tij.¹²² Siç u tha më lart, organizimi i grupeve të vogla nëpër fshatra nuk bëhej në nivel qendror por me nismën e vetë fshatrave.¹²³ Një organizim i tillë njihej si mbrojtja e fshatit apo roja e fshatit.¹²⁴

46. Pjesa më e madhe e fshatrave në zonën e Dukagjinit në fillim të organizimit të tyre kishin një numër të kufizuar armësh.¹²⁵ Dhoma dëgjoi dëshmi përputhëse se me fillimin e organizimit nëpër fshatra, grupe të vogla të rinjsh dërgoheshin në Gllogjan dhe më pas në Shqipëri për t'u furnizuar me armë.¹²⁶ Ata i blenin armët në Shqipëri, si për shembull pushkë, automatikë AK47, mortaja, predha kundërtanke, pushkë snajper, municion, disa bomba dore, dhe një granatahedhës dore. Armatimi më pas sillej në fshat.¹²⁷ Në këtë mënyrë fshatrat kishin në dispozicion më shumë armë për përdorim.¹²⁸ Dhoma dëgjoi dëshmi mospërputhëse në lidhje me përfshirjen e Ramush Haradinajt në furnizimin me armë nga Shqipëria. Rustem Tetaj dëshmoi se Ramush Haradinaj nuk ishte i përfshirë në gjetjen dhe marrjen e armëve nga Shqipëria; kjo bëhej përmes kontakteve të

P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3486; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 45-46; Prova materiale P153, f. 2.

¹²⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 43; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 7-8; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 11; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(f); Skënder Rexhahmetaj, T. 1045-1046, 1086-1090; Rustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 20.

¹²¹ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 8; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 14; Skënder Rexhahmetaj, T. 1045-1046, 1086; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 9; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 19-20.

¹²² Aktakuza, para. 5.

¹²³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5047; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3708; *shih* gjithashtu Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9684.

¹²⁴ *Shih* Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3708.

¹²⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4402-4403; Bislim Zyrapi, T. 697-698; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 5-7; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 31, 34; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5715-5716, 5795-5796; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 2; Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8742.

¹²⁶ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3622-3623; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 5-7; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 3; Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8741-8742.

¹²⁷ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3622-3623; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 3.

¹²⁸ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3627.

Rrustem Tetajt në Shqipëri.¹²⁹ Sipas dëshmisë së Cufë Krasniqit, ushtarët e rinj të UÇK-së shpesh pajiseshin me armë nga shtabi i UÇK-së në Jabllanicë dhe në Gllogjan.¹³⁰ Ai gjithashtu dëshmoi se personat që zgjidheshin nga komandantët e fshatrave dërgoheshin për të takuar Ramush Haradinajn i cili më pas i udhëzonte se kë duhej të kontaktonin në Shqipëri në lidhje me armët.¹³¹ Pjetër Shala, një pjesëtar i UÇK-së, shpeshherë shkonte në Shqipëri për armë së bashku me ushtarë të tjerë.¹³² Ai dëshmoi se për udhëtime të tilla çdo herë nevojitej një fletautorizim i nënshkruar nga Ramush Haradinaj në Gllogjan.¹³³ Prokuroria pretendon se Ramush Haradinaj dhe Lahi Brahimaj bashkëpunonin me njëri-tjetrin në lidhje me furnizimin dhe shpërndarjen e armëve.¹³⁴ Provat që citon Prokuroria në lidhje me këtë pretendim, nuk mbështesin një konkluzion të tillë. Provat e kufizuara që disponon Dhoma tregojnë se ndihma u ofrohej fshatarëve vendas që kërkonin armë nga Shqipëria, duke pasur parasysh pozitën strategjike të Gllogjanit. Nuk ka prova të mjaftueshme në mbështetje të përfundimit se Ramush Haradinaj dhe Lahi Brahimaj bashkëpunuan për furnizimin dhe shpërndarjen e armëve në Zonën e Dukagjinit.

47. Fshatarët gjithashtu organizonin rojën e fshatit me ndërtime, hapnin llogore dhe ndërtonin fortifikime për mbrojtjen e fshatit.¹³⁵ Zgjidhej edhe “komandanti i fshatit”; si komandant fshati zakonisht zgjidheshin njerëz të fshatit.¹³⁶ Shumë prej fshatrave nuk kishin njerëz me përvojë ushtarake dhe rrjedhimisht komandant për mbrojtjen zgjidhej një bujk, kryeplaku ose një nga të moshuarit e fshatit.¹³⁷ Jakup Krasniqi dëshmoi se në disa fshatra apo zona të Kosovës ku UÇK-ja

¹²⁹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3624, 3713.

¹³⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 35.

¹³¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 45.

¹³² Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9980.

¹³³ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9980. *Shih* gjithashtu Zoran Stijoviq, T. 563-570; Provat materiale P74; P127.

¹³⁴ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 27, citon Pjetër Shalën, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9938-9945, 9979.

¹³⁵ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5046-5047.

¹³⁶ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Lima*), T. 3453; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5046-5047; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4402; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 4-5; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 5-8, 16; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 6-7; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(b); Skënder Rexhahmetaj, T. 1035, 1039-1040, 1042; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 31, 33, 44; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5740-5741, 5744.

¹³⁷ Bislim Zyrapi, T. 697; Skënder Rexhahmetaj, T. 1042; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 19.

ishte më mirë e organizuar, si për shembull në Drenicë, komandantin nuk e zgjidhnin fshatarët, por atë e propozonte zona dhe më pas propozimin e miratonte Shtabi i Përgjithshëm.¹³⁸

48. Ndonëse struktura ushtarake ndryshonte nga fshati në fshat varësisht nga niveli i organizimit, në parim çdo fshat kishte komandantin e përgjithshëm, zëvendëskomandantin, komandantin për operacione (përgjegjës për stërvitjen e ushtarëve), intendentin (përgjegjës për furnizimet) dhe komandantin e rojës (përgjegjës për rojet e fshatit).¹³⁹ Komandanti i operacioneve e kishte për detyrë t'u ndihmonte fshatrave të tjera të zonës së Dukagjinit në rast sulmi.¹⁴⁰ Oficerët e intendencës nën drejtimin e intendentit mblidhnin kontributet financiare për blerjen e pajisjeve dhe armëve nga fshatarët.¹⁴¹ Me organizimin e fshatrave filloi edhe ngritja e shtabeve nëpër fshatra.¹⁴²

49. Rreth 17 fshatra të Lugut të Baranit në komunën e Pejës u organizuan në mënyrë të pavarur; më shumë se gjysma e tyre nuk kishin armë.¹⁴³ Në shkurt të vitit 1998, komandant i fshatit Vranoc të komunës së Pejës ishte Din Krasniqi.¹⁴⁴ Nga mesi i prillit 1998, ai u bë komandant i gjithë Lugut të Baranit pas sulmit kundër Vranocit të Vogël.¹⁴⁵ Atë e zgjodhën fshatarët vendas dhe emërimi i tij u miratua prej Ramush Haradinajt.¹⁴⁶ Haradinaj shpalli zyrtarisht emërimin e Din Krasniqit nga mesi i prillit 1998 në mbledhjen me rreth 25 komandantë të fshatrave të asaj ane.¹⁴⁷ Në atë mbledhje, 25 komandantët e fshatrave të Lugut të Baranit diskutuan me Haradinajn lidhur me përgatitjet në rast sulmi dhe shqetësimet e tjera që kishin.¹⁴⁸ Dhoma gjithashtu mori prova se Ramush Haradinaj, ndonjëherë i shoqëruar nga Lahi Brahimaj, mori pjesë edhe në mbledhje të tjera

¹³⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5048-5049.

¹³⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 44.

¹⁴⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 44.

¹⁴¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 44.

¹⁴² Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4398-4399, 4400-4402, 4461, 4469-4470; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 5-7; Vesel Dizdari, Prova materiale P467, para. 14.

¹⁴³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 31; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5744, 5795-5796; Prova materiale P56.

¹⁴⁴ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 4-5; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 31, 33; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5740-5741, 5744; Prova materiale P56.

¹⁴⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5850-5852; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 55.

¹⁴⁶ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 4-5.

¹⁴⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5794, 5850-5851; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 55; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7658; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 4-5.

¹⁴⁸ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 5.

në Lugun e Baranit për të diskutuar taktikën dhe strategjinë, problemet me pajisjet dhe gjendjen e përgjithshme të sigurisë.¹⁴⁹

50. Në Llukë të Poshtme të komunës së Deçanit u caktuan roje nate për të vëzhguar personat e dyshimtë që hynin dhe dilnin nga fshati dhe për të verifikuar identitetin e tyre; fillimisht këta ishin vullnetarë të paarmatosur dhe pa uniforma.¹⁵⁰ Shumica e mbrojtësve të fshatit nuk kishin uniforma.¹⁵¹ Disa nga mbrojtësit e fshatit Llukë e Poshtme vendosën të mbanin pantallona dhe këmbisha të zeza për t'u identifikuar si përkrahës të UÇK-së.¹⁵² Në prill të vitit 1998, disa fshatarë gjetën uniforma ushtarake dhe emblemën e UÇK-së.¹⁵³ Komunikimi ishte i pakët duke qenë se fshatrat, si për shembull Isniqi, kishin vetëm radiolidhje të cilësisë së dobët.¹⁵⁴

51. Nga fundi i majit 1998, disa fshatra si për shembull Irzniqi, krijuan udhëheqjen dhe njësitë, organizuan stërvitjen e ushtarëve për përdorimin e armëve dhe ngritën strukturën komanduese në kuadër të komandës së fshatit.¹⁵⁵ Filloi të rritej edhe numri i anëtarëve.¹⁵⁶ Në maj dhe qershor të vitit 1998, mbrojtja e organizuar e fsharave filloi të pajisej me më shumë armë dhe në Irzniq pothuajse çdo shtëpi kishte nga një armë; në fshat UÇK-ja kishte granatahedhës dhe një “top pa dridhje”.¹⁵⁷

52. Në periudhën nga fundi i prillit e deri në fund të majit 1998, u shtua rreziku i sulmeve të forcave serbe. Në atë kohë pjesa më e madhe e fshatrave të zonës së Dukagjinit ishin të rrethuara nga forcat serbe. Me sa duket në këtë kohë shumica e fshatrave të zonës së Dukagjinit kishin filluar me organizimin e shtabeve dhe të mbrojtjes së fshatrave.¹⁵⁸ Për shkak të pranisë së forcave serbe, fshatrat e asaj zone filluan ta ndjenin gjithnjë e më shumë nevojën për koordinim midis mbrojtjeve

¹⁴⁹ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 6.

¹⁵⁰ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3626, 3706-3708.

¹⁵¹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3706; Bislim Zyrap, T. 697-698; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 6; Skënder Rexhahmetaj, T. 1035, 1038.

¹⁵² Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3802.

¹⁵³ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 2.

¹⁵⁴ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 6, 16.

¹⁵⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 8-9; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 5-7.

¹⁵⁶ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 9; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4403, 4466.

¹⁵⁷ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 10.

¹⁵⁸ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3628; Skënder Rexhahmetaj, T. 1048.

të organizuara të tyre.¹⁵⁹ Kur sulmohej një fshat, mbrojtja e organizuar e fshatrave të tjera shkonte në ndihmë të fshatit që sulmohej.¹⁶⁰

53. Për organizim më të mirë të mbrojtjes në fshatin Isniq, në prill të vitit 1998, komandanti i mbrojtjes së fshatit Skënder Rexhahmetaj së bashku me fshatarë të tjerë shkuan për të takuar Ramush Haradinajn në shtabin e Gllogjanit meqenëse ky shtab konsiderohej si pika qendrore për mbrojtjen e zonës së Dukagjinit.¹⁶¹ Skënder Rexhahmetaj u takua me Ramush Haradinajn, mirëpo Ramush Haradinaj i tha që ishte shumë herët për të filluar bashkëpunimin me Isniqin, Ramush Haradinaj e siguroi se në rast rreziku për popullatën e fshatit, ai do të përpiquej të gjente mënyrën për të ndihmuar.¹⁶² Provat tregojnë se me organizimin gjithnjë e më të mirë të fshatrave dhe nevojën për koordinim të mëtejshëm të përpjekjeve të tyre për t'u mbrojtur nga forcat serbe lindi edhe nevoja për komandë të njësuar të zonës së Dukagjinit.¹⁶³ Kjo çoi drejt mbajtjes të mbledhjes së 26 majit 1998 shtjelluar më poshtë.

2. Caktimi i nënzonave dhe formimi i Shtabit Rajonal më 26 maj 1998

54. Si pasojë e zhvillimeve në zonën e Dukagjinit dhe në përgjigje të pranisë gjithnjë e më të madhe të forcave serbe, Ramush Haradinaj dhe Faton Mehmetaj, pjesëtar i UÇK-së, organizuan një mbledhje të përfaqësuesve të fshatrave rreth Gllogjanit në komunën e Deçanit për të diskutuar masat e mëtejshme për një koordinim më të mirë të zonës së Dukagjinit.¹⁶⁴

55. Mbledhja që u mbajt rreth orës 20:00 të datës 26 maj 1998 në Gllogjan u kryesua nga Ramush Haradinaj si komandant i fshatit Gllogjan.¹⁶⁵ Të pranishëm ishin rreth 80 vetë, duke

¹⁵⁹ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 10, 15; Skënder Rexhahmetaj, T. 1043-1047, 1050.

¹⁶⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5709-5710, 5818; *shih* gjithashtu më poshtë, para. 294.

¹⁶¹ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 7-8; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 11; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(f); Skënder Rexhahmetaj, T. 1045-1046, 1086-1090.

¹⁶² Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 13; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(g); Skënder Rexhahmetaj, T. 1046-1048.

¹⁶³ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3625-3626; Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9749; Bislim Zyrapi, T. 697.

¹⁶⁴ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3628-3629, 3633-3634; Skënder Rexhahmetaj, T. 1045-1048, 1087.

¹⁶⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 12; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4432; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3630-3631; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2964-2965; Zoran Stijović, Prova materiale P121, para. 45-46; Prova materiale P153, f. 2. Sipas Skënder Rexhahmetajt, mbledhja u mbajt më 23 maj 1998. Dhoma vëren se data mund të jetë dhënë gabimisht nga dëshmitari. Dhoma gjykon se kjo nuk ndikon në

përfshirë përfaqësuesit e mbrojtjes së fshatrave të organizuar prej UÇK-së nga pothuajse gjithë fshatrat e zonës së Dukagjinit.¹⁶⁶ Për një kohë të shkurtër në mbledhje ishte i pranishëm edhe Idriz Balaj.¹⁶⁷ Lahi Brahimaj nuk ishte aty.¹⁶⁸ Kjo ishte hera e parë që përfaqësuesit e mbrojtjes së fshatrave të Kosovës perëndimore u mblodhën së bashku për të diskutuar mundësinë e organizimit të tyre të përbashkët.¹⁶⁹ Shumica e përfaqësuesve të fshatrave ishin të paarmatosur dhe me rroba civile.¹⁷⁰ Ramush Haradinaj foli për situatën në zonë dhe u kërkoi përfaqësuesve të fshatrave “t’i mbrojnë fshatrat e tyre, të kenë parasysh rrethanat, të tregojnë maturi dhe të dinë se çfarë duhet të bëjnë”.¹⁷¹ Ai gjithashtu foli për themelimin e UÇK-së dhe theksoi se kishte ardhur koha për të koordinuar të gjitha fshatrat dhe për të ngritur një strukturë që t’i përgjigjej situatës.¹⁷²

56. Rrustem Tetaj dëshmoi se në mbledhjen e 26 majit 1998 u propozua që zona e Dukagjinit të ndahej në nënzona dhe njerëzit me përvojë ushtarake të caktoheshin komandantë të nënzonave.¹⁷³ Vendimin për krijimin e nënzonave e morën vetë përfaqësuesit e fshatrave.¹⁷⁴ Nënzonat nuk përfshinin të gjitha fshatrat e gjithë zonës së Dukagjinit, por vetëm ato të cilat ishin më të rrezikuara kundrejt sulmeve dhe që me gjasë do të prekeshin nga lufta.¹⁷⁵ Gjatë mbledhjes, Ramush Haradinaj foli për situatën e atëhershme “në Gllogjan dhe vendet përreth”, duke e parë “Dukagjinin vetëm nga aspekti gjeografik”.¹⁷⁶

besueshmërinë e dëshmisë lidhur me thelbin e mbledhjes, Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 11-12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 17-18; Skënder Rexhahmetaj, T. 1049-1050.

¹⁶⁶ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 12; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4480-4481; Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3630-3631; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 11-12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 17; Skënder Rexhahmetaj, T. 1049-1050.

¹⁶⁷ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3634.

¹⁶⁸ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 11; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 17; Skënder Rexhahmetaj, T. 1052, 1087.

¹⁶⁹ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 11-12, 14; Skënder Rexhahmetaj, P298, para. 17-21; Skënder Rexhahmetaj, T. 1049-1050, 1087; Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3628, 3630-3631, 3635.

¹⁷⁰ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3631, 3709.

¹⁷¹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3635.

¹⁷² Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3635-3636.

¹⁷³ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636, *shih* gjithashtu Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 18.

¹⁷⁴ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4436-4437; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 11-12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 17-19; Skënder Rexhahmetaj, T. 1049-1050, 1054-1055, 1072.

¹⁷⁵ Skënder Rexhahmetaj, T. 1052; Rrustem Tetaj, P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3634.

¹⁷⁶ Rrustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3634.

57. Përfaqësuesit e pranishëm të fshatrave përcaktuan kufijtë e nënzoneve dhe zgjodhën komandantët e nënzoneve; këto vendime u morën me konsensus.¹⁷⁷ Disa personave Ramush Haradinaj u kërkoi por nuk i urdhëroi që të merrnin përgjegjësinë për këto zona.¹⁷⁸ Skënder Rexhahmetaj dëshmoi se meqenëse shqiptarët kosovarë duhej të organizoheshin dhe vepronin pa ndonjë pushtet ose kompetenca ligjore shtetërore apo institucionale, nuk mund të jepeshin urdhra dhe çdo vendim merrej vetëm me konsensus.¹⁷⁹ U mor vendimi që Ramush Haradinaj si komandant i nënzonës 1, të emërohej komandant i përgjithshëm, koordinator ose përfaqësues i këtyre nënzoneve.¹⁸⁰ Gjithashtu u mor vendimi që shtabi i zonës së Dukagjinit të vendosej në Gllogjan dhe të formohej shtabi rajonal. Shtabi rajonal dhe nënzonat e posapërcaktuara të zonës së Dukagjinit në prova përmenden si “Shtabi Rajonal i Gllogjanit”, “Shtabi Rajonal i Dukagjinit”, apo “Shtabi i Rajonit të Dukagjinit”.¹⁸¹ Dhoma më poshtë do t’i referohet shtabit të krijuar më 26 maj 1998 me “Shtabi Rajonal”.

58. Dhoma mori prova mospërputhëse në lidhje me numrin e nënzoneve të përcaktuara më 26 maj 1998.¹⁸² Megjithatë, në bazë të provave që disponon, Dhoma është bindur se në mbledhje u përcaktuan këto nënzona të zonës së Dukagjinit:

- a. “Nënzona 1” me bazë në Gllogjan, në komunën e Deçanit dhe e komanduar nga Ramush Haradinaj. Kjo zonë përfshinte fshatrat Gllogjan, Shaptej, Gramaqel, Dubravë, Baballoq, Prilep dhe Rastavicë;¹⁸³

¹⁷⁷ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636, 3723; Skënder Rexhahmetaj, T. 1052-1054.

¹⁷⁸ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4436-4437; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 11-12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 17-18; Skënder Rexhahmetaj, T. 1049-1052, 1054-1055, 1072.

¹⁷⁹ Skënder Rexhahmetaj, T. 1055-1056.

¹⁸⁰ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3647-3648; *shih* gjithashtu më poshtë, para. 58.

¹⁸¹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3624; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 4; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11-13; Provat materiale P174; P175; P181; P182; P183; P184; P185; P186; P187; P188; P189

¹⁸² Sipas Rustem Tetajt, më 26 maj 1998 u krijuan katër nënzona, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636. Skënder Rexhahmetaj dëshmoi se u krijuan pesë nënzona, Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 19, 20, 44; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(b); Skënder Rexhahmetaj, T. 1051-1052, 1056, 1061, 1081.

¹⁸³ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636; Prova materiale P78; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4437; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 18-20, 44; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(b); Skënder

- b. “Nënzona 2” me bazë në Irzniq, në komunën e Deçanit, dhe e komanduar nga Shemsedin Çekaj. Nënzona e Dytë përfshinte fshatrat Irzniq, Ratishë e Epërme, Ratishë e Poshtme, Beleg dhe Kodrali;¹⁸⁴
- c. “Nënzona 3” me bazë në Pozharë, në komunën e Deçanit, dhe e komanduar nga Rustem Tetaj. Ajo përfshinte fshatrat Llukë e Epërme, Llukë e Poshtme, Lumbardh, Dashinoc, Maznik dhe Vranoc;¹⁸⁵
- d. “Nënzona 4” përfshinte zonën që ndahej nga lumi Bistricë dhe fshati Isniq në komunën e Deçanit. Kjo nënzona do të komandohej nga Skënder Rexhahmetaj.¹⁸⁶ Nënzona e Katërt përfshinte fshatrat Prapaqan, Strelle i Epërm, Strelle i Poshtëm, Dubovikë, Krushefc dhe Rashiq;¹⁸⁷
- e. “Nënzona 5” komandohej nga Adem Ukëhaxhaj dhe përfshinte fshatrat Carrabreg, Voksh dhe Drenoc në komunën e Deçanit.¹⁸⁸

59. Jabllanica e komunës së Gjakovës nuk u diskutua dhe si pasojë nuk u përfshi në asnjërën prej nënzonave që u përcaktuan në mbledhje.¹⁸⁹ Rrjedhimisht, Jabllanica vazhdoi të vepronte pavarësisht nga nënzonat.¹⁹⁰ Jabllanica dhe Gllogjani bashkëpunonin sipas nevojës.¹⁹¹

Rexhahmetaj, T. 1051-1053, 1056, 1061, 1081; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 45, 47.

¹⁸⁴ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636; Prova materiale P78; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4434, 4436, 4446, 4463, 4485; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(a); Skënder Rexhahmetaj, T. 1051-1052, 1061, 1081; Prova materiale P6.

¹⁸⁵ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 19, 20, 44; Skënder Rexhahmetaj, T. 1051-1052, 1056, 1061, 1081; Prova materiale P78; P80.

¹⁸⁶ Rustem Tetaj dëshmoi se Skënder Rexhahmetaj dhe Gani Gjukaj ishin komandantë të nënzonës 4, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636. Mirëpo gjatë dëshmisë së tij, Skënder Rexhahmetaj, në veçanti lidhur me Gani Gjukajn, nuk tha që edhe ai kishte qenë komandant i nënzonës 4; ai pranoi që vetë kishte qenë komandant i nënzonës 4, Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 19-20, 44; Skënder Rexhahmetaj, T. 1051-1053, 1061, 1081.

¹⁸⁷ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3636; Prova materiale P78.

¹⁸⁸ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 19, 20, 44; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(b); Skënder Rexhahmetaj, T. 1051-1053, 1056, 1061, 1081.

¹⁸⁹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3720-3721; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 13; Skënder Rexhahmetaj, T. 1058.

¹⁹⁰ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 13; Skënder Rexhahmetaj, T. 1058.

¹⁹¹ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 18.

Përfaqësuesit e Jabllanicës nuk ishin të detyruar të merrnin pjesë në mbledhjet e komandantëve të nënzonave meqenëse Jabllanica ndodhej në vend të largët dhe të izoluar dhe nuk kërcënohej nga rrezik i menjëhershëm sulmi prej forcave serbe.¹⁹² Edhe disa fshatra të tjera, si për shembull Kosuriqi, Juniku dhe “Reka” nuk u përfshinë në nënzonat.¹⁹³

3. Komanda dhe kontrolli në zonën e Dukagjinit deri më 23 qershor 1998

60. Prokuroria pretendon se nga 26 maji 1998 kur Ramush Haradinaj u bë komandant i Shtabit Rajonal të Gllogjanit ai kishte pushtet për çështjet ushtarake dhe civile.¹⁹⁴ Prokuroria më tej pretendon se para emërimit zyrtar të tij më 23 qershor 1998, Ramush Haradinaj kishte pushtet *de facto* mbi zonën e Dukagjinit.¹⁹⁵ Prokuroria gjithashtu argumenton se pozita e fuqishme dhe pushteti i Ramush Haradinajt bazoheshin në pozitën e tij si komandantit i shtabit të Gllogjanit; në mendimin se ai ishte komandant i zonës së Dukagjinit dhe në një pozitë me pushtet; dhe në rolin e tij në organizimin e UÇK-së në zonën e Dukagjinit dhe në lidhjen e ngushtë familjare me Lahi Brahimajn.¹⁹⁶ Mbrojtja e Haradinajt argumenton se mungesa e një strukture komanduese konvencionale vë në dukje faktin se ushtria nuk kishte një hierarki vertikale, por mbështetej në konsensusin e vullnetarëve.¹⁹⁷

61. Dhoma dëgjoi rrëfime të ndryshme lidhur me emërimin dhe detyrat e komandantit të Shtabit Rajonal dhe mori parasysh parashtrimet e palëve. Sipas Skënder Rexhahmetajt, Ramush Haradinaj propozoi që nënzonat të krijoheshin nën komandën e zonës së Dukagjinit dhe të ngrihej një “strukturë vertikale” me një komandant të emëruar.¹⁹⁸ Ndonëse propozimi ishte ky, Skënder Rexhahmetaj dëshmoi se ai nuk u zbatua dhe se në mbledhje, përfaqësuesit e fshatrave arritën marrëveshje për një “komandë horizontale”. Sipas strukturës komanduese horizontale, çdo komandant nënzonë i zgjedhur nga përfaqësuesit e fshatrave të pranishëm në mbledhje do të ishte personi përgjegjës për nënzonën e tij.¹⁹⁹

62. Skënder Rexhahmetaj gjithashtu dëshmoi se në mbledhje u mor vendimi që Ramush Haradinaj të ishte përgjegjës për nënzonat, meqenëse “ishte ushtar i mirë, udhëheqës i mirë dhe

¹⁹² Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 18.

¹⁹³ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3720-3721.

¹⁹⁴ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 11.

¹⁹⁵ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 9, 37.

¹⁹⁶ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 37.

¹⁹⁷ Argumentet Përmbyllëse (26 qershor 2012), T. 2871-2872.

¹⁹⁸ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 18.

¹⁹⁹ Skënder Rexhahmetaj, T. 1052-1053, 1060-1061.

njeri që kishte aftësinë të mbliidhte njerëz rreth vetes.”²⁰⁰ Si i tillë, Ramush Haradinaj ishte përgjegjës për koordinimin e punës midis nënzoneve; ai nuk i komandonte komandantët e nënzoneve dhe nuk u jepte urdhra.²⁰¹ Asnjë urdhër si ato të një ushtrie të rregullt nuk u dha e as mund të jepej.²⁰² Shemsedin Çekaj dha dëshmi të ngjashme duke theksuar se nuk u emërua një komandant i përgjithshëm dhe se Ramush Haradinaj vetëm u përpoq që të organizonte zonën; sipas tij, komandantët e fshatrave nuk i raportnin Haradinajt.²⁰³ Dhoma mori prova se Ramush Haradinaj ushtroi vetëm pushtet *de facto* mbi zonën për shkak të reputacionit dhe respektit që gëzonte midis njerëzve; Ramush Haradinaj nuk kishte pushtet ligjor.²⁰⁴ Të gjithë komandantët e nënzoneve vazhduan të ishin të pavarur dhe të barabartë me njëri-tjetrin.²⁰⁵ Për shembull, në qershor 1998, Skënder Rexhahmetaj, pa u konsultuar me Ramush Haradinajn, dërgoi në Shqipëri disa ushtarë të nënzonës së tij për t’iu bashkuar FARK-ut; Skënder Rexhahmetaj dëshmoi se nuk ishte e nevojshme që të konsultohesh me Ramush Haradinajn meqenëse vetë ishte komandant i pavarur që vepronte në kuadër të strukturës komanduese horizontale.²⁰⁶

63. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshminë e Rustem Tetajt se në mbledhjen e 26 majit 1998 u mor vendimi që Ramush Haradinaj të bëhej komandant i përgjithshëm i zonës; që ai të bëhej përfaqësues dhe mbikëqyrës i nënzoneve dhe “drejtues i shtabit rajonal të Gillogjanit”.²⁰⁷ Rustem Tetaj dëshmoi se kjo marrëveshje ishte “një ide teorike por në praktikë [...] një gjë e tillë ishte e pamundur”.²⁰⁸ Në lidhje me këtë, ai sqaroi se të gjitha fshatrat e përfshira në një nënzonë i raportnin komandantit të nënzonës dhe se më pas, sipas mundësive, komandanti i nënzonës i raportonte Ramush Haradinajt si komandant i nënzonës së parë dhe i Shtabit Rajonal.²⁰⁹ Raportimi dhe këshillimi me Ramush Haradinajn para aksioneve varej nga rrethanat meqenëse në kohën kur u bënë këto diskutime një gjë e tillë ishte pothuajse e pamundur duke pasur parasysh numrin e pakët

²⁰⁰ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, T. 1060-1061, 1076, 1099-1101.

²⁰¹ Skënder Rexhahmetaj, T. 1060-1061.

²⁰² Skënder Rexhahmetaj, T. 1060-1061, 1076.

²⁰³ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 12; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4481-4483.

²⁰⁴ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 18; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(e); Skënder Rexhahmetaj, T. 1097, 1099.

²⁰⁵ Skënder Rexhahmetaj, T. 1060, 1076, 1081-1082.

²⁰⁶ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 22-23; Skënder Rexhahmetaj, T. 1060-1061, 1079.

²⁰⁷ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3648.

²⁰⁸ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3648.

²⁰⁹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3648-3649; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 12.

të pajisjeve për komunikim.²¹⁰ Për shkak të këtyre kufizimeve u mor vendimi që çdo nënzonë të kishte komandantin e saj në mënyrë që ato të mund të merreshin vetë me situatën.²¹¹ Për shembull, gjatë një sulmi të gjerë të forcave serbe kundër fshatit të Skënder Rexhahmetajt dhe disa fshatrave të tjera të nënzonës 4 të ndërmarrë më 29 maj 1998, fshatrat ndihmuan njëri-tjetrin në bazë vullnetare.²¹² Shemsedin Çekaj me rreth 20 të tjerë nga nënzona e dytë në Irzniq shkuan në ndihmë të fshatit Isnig në komunën e Deçanit.²¹³ Kur ndodhi sulmi i 29 majit 1998 nuk mund të vihej kontakt me Haradinajn.²¹⁴ Sipas Skënder Rexhahmetajt, gjatë periudhës 23 maj - 23 qershor 1998, Ramush Haradinaj ishte kryesisht i angazhuar në nënzonën e vet me përjashtim të mbledhjeve javore me komandantët e nënzoneve.²¹⁵

64. Mbrojtja e Haradinajt parashtron se askush, e as vetë Ramush Haradinaj nuk lëshoi urdhra; shtabi funksiononte në bazë të konsensusit dhe marrëveshjes.²¹⁶ Gjithsesi, Dhoma mori shumë dokumente si prova të nënshkruara nga Ramush Haradinaj si, “Komandant i Nënzonës 1”, “Komandant i Shtabit të Gllogjanit”,²¹⁷ Komandant i “Selisë Rajonale të Dukagjinit” apo “Shtabit Rajonal të Dukagjinit”,²¹⁸ dhe një dokument të nënshkruar pa emërtim.²¹⁹ Midis dokumenteve që mori Dhoma të nënshkruara nga Ramush Haradinaj, ka dokumente me të dhënat personale të ushtarëve të UÇK-së;²²⁰ ftesë për pjesëmarrje në një mbledhje pune në Gllogjan drejtuar përfaqësuesve të shtabeve të fshatrave të tjera;²²¹ autorizim për një mjek për të organizuar

²¹⁰ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3648-3649, 3650-3651; Skënder Rexhahmetaj, T. 1058-1059.

²¹¹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3649; Skënder Rexhahmetaj, T. 1058-1059.

²¹² Skënder Rexhahmetaj, T. 1059.

²¹³ Skënder Rexhahmetaj, T. 1059.

²¹⁴ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3664.

²¹⁵ Skënder Rexhahmetaj, T. 1058, 1060; Prova materiale P177.

²¹⁶ Dosja Përfundimtare e Haradinajt, para. 110.

²¹⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11, 12, 13; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3308-3309; Bislim Zyrapi, T. 725-726; Prova materiale P166; P169 (në origjinalet e dy dokumenteve të mëparshme nuk jepet data; mirëpo ata përmendin se u anëtarësuan në UÇK më 15 maj 1998); P170 (në dokument nuk jepet data; mirëpo përmendet 20 maji 1998 si datë e anëtarësimit në UÇK); P174 (data 25 maj 1998); P176 (data 31 maj 1998); P179 (data 13 qershor 1998); P187 (data 16 qershor 1998).

²¹⁸ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11-13; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3309; Bislim Zyrapi, T. 725-726; Prova materiale P174 (data 25 maj 1998); P175 (data 26 maj 1998); P181; P182; P183; P184; P185; P186; P187 (të gjitha të datës 16 qershor 1998); P188; P189 (të dyja të datës 19 qershor 1998).

²¹⁹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 12; Prova materiale P178 (data 9 qershor 1998).

²²⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48; Prova materiale P166; P169 (në origjinalet e dy dokumenteve të mëparshme nuk jepet data; përmendet 15 maji si datë e anëtarësimit); P170 (data 20 maj 1998).

²²¹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11; Prova materiale P174 (data 25 maj 1998).

shëndetësinë në rajon dhe për transferimin e ushtarëve të UÇK-së në spital;²²² shënime nga një mbledhje në lidhje me situatën në disa fshatra;²²³ shënime nga mbledhjet e Shtabit të Gllogjanit;²²⁴ “autorizime” për Shtabin e Përgjithshëm për furnizimin e Shtabit Rajonal të Dukagjinit me pajisje ushtarake;²²⁵ dhe caktime dhe transferime të ushtarëve të UÇK-së prej Ramush Haradinajt si komandant i Shtabit Rajonal të Dukagjinit.²²⁶ Megjithëse nënshkrimi i Ramush Haradinajt nuk është në shënimet e mbledhjeve të “Shtabit të Gllogjanit”, nga përmbajtja e shënimeve duket qartë se ato u kryesuan nga Ramush Haradinaj në cilësinë e komandantit të nënzonës 1.²²⁷

65. Prokuroria parashtron se ndonëse në atë kohë nuk kishte hierarki ushtarake të mirëfilltë, “ekzistonte pushtet i cili arrihej përmes mbrojtjes dhe respektit prej njerëzve”. Më tej ajo pretendon se “për të vërtetuar që ai kishte pushtet, mjafton të provohet se personi që jep udhëzime është i aftë të krijojë respekt në një masë të tillë sa të sigurojë zbatimin e udhëzimeve të dhëna prej tij”.²²⁸ Siç u theksua më lart, Ramush Haradinaj ishte i respektuar prej popullit.²²⁹ Dhoma nuk mendon se përmbajtja e disa prej dokumenteve të lartpërmendura, si për shembull dosjet me të dhënat personale të ushtarëve të UÇK-së apo autorizimi për vizitë të mjekut në zonë, reflektojnë një komandë të vetme apo pushtet në zonën e Dukagjinit. Për sa u përket dokumenteve të tjera, Prokuroria nuk paraqiti prova që vërtetonin se ato u zbatuan. Dhoma rikujton dëshmitë e marra të përmendura më lart se vendimet merreshin bashkërisht apo nga komandantët e nënzoneve dhe se ishte praktikisht e pamundur që Ramush Haradinaj të konsultohet për të gjitha çështjet.²³⁰ Në bazë të këtyre provave, Dhoma përfundon se si komandant i Shtabit Rajonal, Ramush Haradinaj nuk kishte pushtet mbi të gjitha çështjet ushtarake dhe civile në atë zonë. Megjithëse Ramush Haradinaj kishte përgjegjësitë e tij në zonë dhe luajti rol koordinues në përpjekjet për bashkimin e nënzoneve,

²²² Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11-12; Prova materiale P175 (data 26 maj 1998); P178 (data 9 qershor 1998).

²²³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11; Prova materiale P176 (data 31 maj 1998).

²²⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11-12; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3308-3309; Bislim Zyrapi, T. 725-726; Prova materiale P176 (data 31 maj 1998); P177 (data 8 qershor 1998); P179 (data 13 qershor 1998); P180 (data 15 qershor 1998).

²²⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 12-13; Prova materiale P181; P182; P183; P184; P185; P186; P187 (të gjitha të datës 16 qershor 1998).

²²⁶ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 13; Prova materiale P188; P189 (të dyja të datës 19 qershor 1998).

²²⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 11, 12; Prova materiale P176 (data 31 maj 1998); P177 (data 8 qershor 1998); P179 (data 13 qershor 1998).

²²⁸ Argumentet Përmbyllëse (25 qershor 2012), T. 2788.

²²⁹ *Shih* më lart, para. 45, 62. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 149.

²³⁰ *Shih* më lart, para. 63.

provat tregojnë se së paku deri më 23 qershor 1998, nënzonat në zonën e Dukagjinit vepruan në mënyrë të pavarur.²³¹

4. Jabllanica

66. Ngjarjet e akuzuara në pikat e Aktakuzës pretendohet se ndodhën në shtabin e UÇK-së në fshatin Jabllanicë.

67. Rrustem Tetaj dëshmoi se në Jabllanicë nuk kishte shumë ushtarë.²³² Sipas raportit të SPB-së së Gjakovës të datës 30 maj 1998, në Jabllanicë kishte 200 pjesëtarë të UÇK-së të stërvitur dhe të pajisur mirë. Zoran Stijoviqi shpjegoi se sipas informacionit të RDB-së, ky numër faktikisht ishte rreth 50-150 pjesëtarë.²³³ Rreth 7 shtatorit 1998, Jakup Krasniqi vizitoi Jabllanicën dhe në kohën e vizitës së tij në Jabllanicë ishin rreth 30 ushtarë dhe zona ishte e rrethuar nga forcat policore dhe ushtarake serbe.²³⁴

68. Lahi Brahimaj ishte komandanti i UÇK-së në Jabllanicë.²³⁵ Pjetër Shala, pjesëtar i UÇK-së në atë kohë, dëshmoi se kur shkante në Jabllanicë urdhrat i merrte nga Nazmi Brahimaj dhe se për mendimin e tij, komandant i shtabit dhe përgjegjës për caktimin e detyrave të ushtarëve ishte Nazmiu.²³⁶ Pjetër Shalës nuk i kujtohej nëse ndonjëherë mori urdhra nga Lahi Brahimaj,²³⁷ apo nëse Lahi Brahimaj i jepte urdhra Nazmi Brahimajt dhe anasjelltas.²³⁸ Dhoma shqyrtoi me kujdes dëshminë e Pjetër Shalës në lidhje me këtë aspekt duke pasur parasysh lidhjet e tij të ngushta me Lahi Brahimajn dhe Nazmi Brahimajn dhe rrjedhimisht interesat apo qëllimet e mundshme të tij.

²³¹ *Shih* më poshtë, para. 70-71.

²³² Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3815-3816.

²³³ Zoran Stijoviqi, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9065-9067; Prova materiale P152, f. 1.

²³⁴ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5076.

²³⁵ Bislim Zyrapit, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3387-3388; Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4193, 4196, 4264-4265; Dëshmitari 3, T. 1598-1599; Zoran Stijoviqi, Prova materiale P121, para. 23, 49; Zoran Stijoviqi, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9000-9001, 9006; Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9944-9948; Dëshmitari 75, T. 911; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 33, 35, 62; Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9850-9851; Bogdan Tomash, Prova materiale P338, para. 10; Ylber Hasanaj, Prova materiale P37, para. 6; Prova materiale P153, p. 2; P155; P193; *shih* gjithashtu Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P389, f. 4; Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4193, 4196, 4264-4265. Dhoma citon dëshminë e Bislim Zyrapit se ai kishte përshtypjen që gjatë vizitës së tij në Jabllanicë në korrik të vitit 1998, dikush i tha se komandant i njësisë në Jabllanicë ishte Driton Zeneli, Bislim Zyrapit, T. 762.

²³⁶ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9945-9947, 9953-9954.

²³⁷ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9947-9948, 9954.

²³⁸ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9944-9948.

69. Dhoma përfundon se, siç shtjellohet më poshtë, deri në formimin e Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit, me 23 qershor 1998, Jabllanica nuk vepronte nën kompetencat e Shtabit Rajonal dhe nuk u përfshi në asnjë strukturë të UÇK-së para kësaj date. Në provat lidhur me mbledhjet e Shtabit Rajonal nuk përmendet Jabllanica.²³⁹ Pas 23 qershorit 1998, siç shtjellohet më poshtë,²⁴⁰ Jabllanica u bë pjesë e Zonës Operative të Dukagjinit. Sipas Bislim Zyrapi, në korrik të vitit 1998 Jabllanica ishte nën kontrollin e Zonës Operative të Dukagjinit.²⁴¹

5. Krijimi i Zonës Operative të Dukagjinit

70. Në fillim të qershorit 1998, Skënder Rexhahmetaj i kërkoi Ramush Haradinajt që të organizonte një mbledhje me kontaktet e tij në shtabin e Jabllanicës për të përmirësuar koordinimin midis fshatrave dhe nënzonave.²⁴² Qëllimi i mbledhjes ishte zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe komunikimit midis nënzonave dhe fshatrave të tjera si Jabllanica.²⁴³

71. Sipas provave që mori Dhoma, mbledhja e parë e nënzonave të zonës së Dukagjinit dhe Jabllanicës u mbajt në Irzniq, në komunën e Deçanit, më 21 qershor 1998; në mbledhje ishin të pranishëm edhe Lahi Brahimaj dhe Nazmi Brahimaj të cilët Ramush Haradinaj i prezantoi si përfaqësues nga Jabllanica.²⁴⁴ Qëllimi i mbledhjes ishte koordinimi i veprimtarive në zonën e Dukagjinit, nxitja e bashkëpunimit dhe krijimi i një organi të vetëm pune me në krye një komandant.²⁴⁵ Siç shtjellohet më vonë në këtë kapitull, në mbledhje u diskutua edhe formimi i policisë ushtarake të UÇK-së.²⁴⁶ Gjatë mbledhjes të pranishmit u njoftuan për një “Shtab në një farë mase të vetëshpallur të Dukagjinit”, i cili duhej të përfshinte Jabllanicën dhe Glllogjanin.²⁴⁷

²³⁹ Prova materiale P177; P179.

²⁴⁰ *Shih* më poshtë, para. 72.

²⁴¹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3208-3209, 3345, 3385; Bislim Zyrapi, T. 738, 775-776.

²⁴² Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 16-17; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 38; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(c); Skënder Rexhahmetaj, T. 1062, 1068-1069, 1091-1093.

²⁴³ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 17; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 38; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(1); Skënder Rexhahmetaj, T. 1061-1062, 1091-1092.

²⁴⁴ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 15; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 38; Skënder Rexhahmetaj, T. 1082-1084; Prova materiale P190, f. 1; P191; P192. Shemsedin Çekaj theksoi se mbledhja u mbajt dikur rreth datës 24 qershor 1998 (Prova materiale P4, para. 18). Dhoma konkludon se mospërputhja e datave nuk ndikon në besueshmërinë e dëshmisë së tij në lidhje me mbledhjen.

²⁴⁵ Prova materiale P190, f. 1-2.

²⁴⁶ *Shih* më poshtë, para. 110-112.

²⁴⁷ Prova materiale P190, f. 1.

(a) Mbledhja e 23 qershorit 1998: krijimi i Zonës Operative të Dukagjinit dhe Shtabit Operativ të Dukagjinit

72. Më 23 qershor 1998, në shtëpinë e Lahi Brahimajt në Jabllanicë u mbajt një mbledhje në të cilën morën pjesë pjesëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Ramush Haradinaj, Shemsedin Çekaj, Salih Veseli, Rustem Tetaj, Skënder Rexhahmetaj, Lahi Brahimaj, Nazmi Brahimaj, Daut Haradinaj, Alush Agushi, Emrush Xhemajli, Faton Mehmetaj, Ali Gramaçeli, Agron Januzi, Mustafë Zeqa, dhe Rexhep Selimi, i cili ishte përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.²⁴⁸ Mbledhja, e cila kishte për qëllim përmirësimin e organizimit, u përqendrua në koordinimin e veprimtarive, formalizimin e një komande të njësuar, krijimin e Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe emërimin e komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit.²⁴⁹ Në mbledhje u arrit marrëveshje që nënzonat e zonës së Dukagjinit dhe Jabllanica të cilat deri atëherë kishin vepruar pa u këshilluar me njëra-tjetrën, të përiqeshin të krijonin një komandë të njësuar.²⁵⁰ Pas kësaj, Zona Operative e Dukagjinit mbulonte një territor më të gjerë se Zona e Dukagjinit.

73. Shënimet e mbledhjes së 23 qershorit 1998 evidentojnë se diskutimet u përqendruan në krijimin e një komande të njësuar, se si do të bëhej kjo dhe çfarë do të përfshinte ajo.²⁵¹ U tha se Ramush Haradinaj sugjeroi se ishte e nevojshme që përfaqësuesit e çdo nënzone të rekrutoheshin si anëtarë të Zonës Operative të Dukagjinit.²⁵² Në shënimet e tjera të mbledhjes theksohet se të pranishmit ranë dakord që “prej sot duhet të bëhemi ushtri operative” dhe në veçanti diskutuan rëndësinë gjeostrategjike të zonës së Dukagjinit dhe nevojën për riorganizimin e forcave.²⁵³ Rustem Tetaj bëri thirrje për përcaktimin e detyrave dhe drejtimin dhe koordinimin e punës.²⁵⁴

²⁴⁸ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 18, Shënime të mbledhjes së 23 qershorit 1998, f. 1, 6, Vendime të Mbledhjes së 23 qershorit 1998, f. 1; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4463; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3656, 3658-3659; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 27, 31; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3319, 3326; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 15; Prova materiale P191, f. 3-4; P192, f. 3-4; P193; P194.

²⁴⁹ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 18-19, Shënime të mbledhjes së 23 qershorit 1998, f. 1; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 17-18; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(e); Prova materiale P191, f. 1.

²⁵⁰ Skënder Rexhahmetaj, T. 1069-1070, 1072; *shih* Prova materiale P191; P192.

²⁵¹ Prova materiale P191.

²⁵² Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48; Prova materiale P191, f. 2.

²⁵³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 13; Prova materiale P192.

²⁵⁴ Prova materiale P192, f. 2.

74. Në mbledhjen e 23 qershorit 1998, Ramush Haradinaj dhe Lahi Brahimaj ishin dy kandidatët që u propozuan për postin e komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit.²⁵⁵ Pas diskutimeve, të pranishmit votuan. Ramush Haradinaj u zgjodh komandant kurse Lahi Brahimaj zëvendëskomandant.²⁵⁶ Salih Veseli u emërua shef i shtabit (apo komandant i operacioneve); Rrustem Tetaj u emërua zëvendësshef i shtabit (apo zëvendëskomandant i operacioneve); Idriz Balaj (“Togeri”) u caktua përgjegjës për operacione kundërterroriste dhe sabotim (apo ndihmës për operacione sabotimi); dhe Faton Mehmetaj u caktua përgjegjës për shërbimin e zbulimit (apo shërbimin informativ).²⁵⁷ Sipas Jakup Krasniqit, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së më pas i miratoi këto emërimet.²⁵⁸ Haradinaj propozoi që Gllogjani të ishte selia e shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit.²⁵⁹

75. Pas diskutimeve, të pranishmit morën vendim unanim për krijimin e “Shtabit Operativ të Zonës Operative të Dukagjinit” (i njohur gjithashtu si Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit).²⁶⁰ Shtabi Operativ i Zonës Operative të Dukagjinit përfshinte Ramush Haradinajn, Skënder

²⁵⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 19, Vendime të mbledhjes së 23 qershorit 1998, f. 1-2; Rrustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3660, 3741-3744, 3660; Skënder Rexhahmetaj, T. 1070-1071, 1084, 1100-1101; Prova materiale P191, f. 4; P192, f. 3.

²⁵⁶ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 19, Vendime të mbledhjes së 23 qershorit 1998, f. 1-2; Rrustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3660; Jakup Krasniqi Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5050, 5147-5148, 5149, 5156-5157; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3480; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 41, 62, 65; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5731-5732, 5738, 5802; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 18; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(e); Skënder Rexhahmetaj, T. 1070-1072; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 24; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 29; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3208-3211, 3220, 3228, 3298, 3326, 3339-3340, 3344-3345; Bislim Zyrapi, T. 649-651; Prova materiale P163; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 16-17; Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9855-9856; Prova materiale P191, f. 3-4; P192, f. 1-2; P193; P194; P195, f. 1; P198; *shih* gjithashtu Prova materiale P300.

²⁵⁷ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 18-19, Shënime të mbledhjes së 23 qershorit 1998, f. 5-6, vendime të mbledhjes së 23 qershorit 1998, f. 1-2; Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3660; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 41, 58, 65; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5738; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 42-43; Skënder Rexhahmetaj, T. 1075; Prova materiale P300; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3211-3212, 3315-3316, 3321; Prova materiale P191, f. 4; P193; P194.

²⁵⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5157-5158.

²⁵⁹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3660-3661; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 25; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 20; Prova materiale P55; P61.

²⁶⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3320-3321, 3331-3332, 3426-3427; Prova materiale P191, f. 1-3, 5. I referohet gjithashtu me “Shtabi Vendor Operativ i Rrafshit të Dukagjinit”, Prova materiale P192, f. 1-2, 4; P193; P194.

Rexhahmetajn, Rrustem Tetajn, Gani Gjukajn dhe Shemsedin Çekajn.²⁶¹ Prokuroria pretendon se personat që u caktuan anëtarë të Shtabit Operativ të Dukagjinit, ndër të cilët Lahi Brahimaj, ishin vartës të drejtpërdrejtë të Ramush Haradinajt.²⁶²

76. Pas kësaj mbledhjeje, anëtarët e Shtabit Operativ të Zonës Operative të Dukagjinit mbledheshin një apo dy herë në javë dhe ndonjëherë nga një herë në dy javë për takime pune në Irzniq, Gllogjan, Pozharë, Kodrali, Isniq ose Llukë.²⁶³ Këto mbledhje shërbyen për të diskutuar mbrojtjen dhe sigurinë e popullatës në zonat përkatëse të përgjegjësisë dhe për të analizuar gjendjen në çdo nënzonë për të mundësuar koordinimin dhe furnizimin me armë.²⁶⁴

77. Më 4 korrik 1998, Ramush Haradinaj i tërhoqi vërejtjen Lahi Brahimajt për mungesë në dy mbledhje pune.²⁶⁵ Më 4 apo 5 korrik 1998 ose rreth këtyre datave, Ramush Haradinaj zëvendësoi Lahi Brahimajn me Nazmi Brahimajn si zëvendëskomandant të tij.²⁶⁶ Shemsedin Çekaj dëshmoi se pas kësaj Lahi Brahimaj u bë drejtor i financës në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.²⁶⁷ Më 30 korrik 1998, Ramush Haradinaj emëroi Faton Mehmetajn zëvendëskomandant të shërbimit të zbulimit të UÇK-së në Shtabin Operativ të Zonës Operative të Dukagjinit dhe e autorizoi që të krijonte strukturën e shërbimit të zbulimit.²⁶⁸

(b) Komanda dhe kontrolli në Zonën Operative të Dukagjinit pas 23 qershorit 1998

78. Prokuroria pretendon se nga fundi i qershorit 1998, veç pjesëve të Deçanit dhe Gjakovës, Ramush Haradinaj e zgjeroi kontrollin e tij edhe në Pejë, Istog dhe Klinë.²⁶⁹ Sipas Prokurorisë, më 23 qershor 1998, "Haradinaj u emërua komandant i Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit, duke e formalizuar komandën e përgjithshme të tij mbi gjithë territorin e zonës së Dukagjinit, duke

²⁶¹ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4432-4433, 4437.

²⁶² Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 36.

²⁶³ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4433-4434, 4511.

²⁶⁴ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3649-3650; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 14-17; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 21; Skënder Rexhahmetaj, T. 1060-1061.

²⁶⁵ Prova materiale P211.

²⁶⁶ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3212-3213; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 23; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4512; Prova materiale P204, f. 2; P211; P218; P234.

²⁶⁷ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4512; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3212-3213, 3394; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 32.

²⁶⁸ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 19; Bislim Zyrapi, T. 686; Prova materiale P271; P272; *shih* më poshtë, para. 120-121.

²⁶⁹ Aktakuza, para. 5.

përfshirë edhe Jabllanicën.”²⁷⁰ Haradinaj argumenton se “nuk ka asnjë provë që sugjeron se ai informohej për veprimtarinë e tyre në Jabllanicë, se kishte kontroll dhe komandë efektive të plotë mbi atë vend, apo se faktikisht gëzonte pushtet urdhërdhënës”.²⁷¹ Dhoma mori prova të ndryshme mbi funksionimin në praktikë të Zonës Operative të Dukagjinit pas mbledhjes së 23 qershorit 1998. Kjo çështje analizohet më poshtë.

79. Dhoma mori prova të shumta materiale që u pranuan përmes Bismim Zyrarit, kryesisht dokumente, urdhra dhe autorizime të nënshkuara nga Ramush Haradinaj si komandant i Zonës Operative të Dukagjinit pas emërimit të tij më 23 qershor 1998. Prokuroria u mbështet në këto prova materiale për të vërtetuar pushtetin e Ramush Haradinajt mbi çështjet ushtarake dhe civile të zonës; ajo më tej pretendon se Ramush Haradinaj ishte një komandant rajonal “i fuqishëm, dinamik dhe “i shkathët” dhe kishte kontakt, pushtet dhe kontroll të drejtpërdrejtë mbi gjithë zonën dhe vartësit e tij”.²⁷² Midis këtyre dokumenteve ka urdhra dhe autorizime në lidhje me transferimin, dislokimin apo kthimin e ushtarëve të UÇK-së në fshatra si Vokshi, Smolica dhe Loxha;²⁷³ ose autorizime për pajisjen e ushtarëve të UÇK-së me armë;²⁷⁴ lista personash të pranishëm në mbledhje dhe shënime nga mbledhje pune të mbajtura në Gllogjan;²⁷⁵ autorizime për rekrutimin e forcave të reja;²⁷⁶ leje për stërvitjen e ushtarëve të UÇK-së nga 30 qershori deri më 27 korrik 1998;²⁷⁷ për transferimin e personave dhe ushtarëve të UÇK-së në spital;²⁷⁸ dhe një urdhër për ndalimin e partive politike deri në “çlirimin e plotë të vendit”;²⁷⁹ paralajmërime për ushtarët që të

²⁷⁰ Aktakuza, para. 2.

²⁷¹ Argumentet Përmbyllëse (25 qershor 2012), T. 2841, i referohet Dosjes Përfundimtare të Haradinajt, para. 100, 118.

²⁷² Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 15.

²⁷³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 14-17, 19; Prova materiale P197 (e datës 24 qershor 1998); P199 (e datës 28 qershor 1998); P201 (e datës 29 qershor 1998); P213 (e datës 4 korrik 1998); P220; P221; P222; P223; P224; P225; P226 (të gjitha të datës 7 korrik 1998); P230; P231; P232; P233; P235 (të gjitha të datës 8 korrik 1998); P241 (e datës 10 korrik 1998); P263 (e datës 26 korrik 1998).

²⁷⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 14-15; Prova materiale P200 (e datës 28 qershor 1998); P214 (e datës 4 korrik 1998).

²⁷⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 14, 21; Prova materiale P202 (e datës 30 qershor); P300 (e datës 24 qershor 1998).

²⁷⁶ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 19-20; Prova materiale P256 (e datës 19 korrik 1998); P273 (e datës 1 gusht 1998).

²⁷⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 14, 19; Prova materiale P203 (e datës qershor 1998); P256 (e datës 19 korrik 1998).

²⁷⁸ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 15; Prova materiale P207 (e datës 2 korrik 1998).

²⁷⁹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 15; Prova materiale P208 (e datës 2 korrik 1998).

mos largoheshin nga vendshërbimet përkatëse dhe të mos kontaktonin me gazetarë;²⁸⁰ ngritja e qendrës stërvitore në Prapaqan dhe emërimi i Rustem Tetajt si shef i qendrës;²⁸¹ urdhër për stërvitjen e 64 luftëtarëve të UÇK-së;²⁸² vërejtje për mungesë në mbledhje;²⁸³ leje për ardhjen e djemve të rinj në Zonën Operative të Dukagjinit për qëllime pune;²⁸⁴ dhe kërkesa për furnizime ushqimore.²⁸⁵ Siç u theksua më herët, Ramush Haradinaj zëvendësoi Lahi Brahimajn me Nazmi Brahimajn në postin e zëvendëskomandantit dhe emëroi Faton Mehmetajn zëvendëskomandant të shërbimit të zbulimit të zonës.²⁸⁶ Dhoma gjithashtu mori prova se në korrik të vitit 1998, Ramush Haradinaj nxori urdhra për emërimin e komandantëve të brigadave të posaformuara²⁸⁷ dhe se në korrik të 1998, ushtarët e UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit respektonin autoritetin e Ramush Haradinajt.²⁸⁸

80. Dhoma dëgjoi dëshmi se vendimet në lidhje me veprimet dhe masat për zbatim merreshin bashkërisht nga komandantët e nënzoneve si para mbledhjes së 23 qershorit 1998, po ashtu edhe mbas saj.²⁸⁹ Rustem Tetaj shpjegoi se megjithëse merrej parasysh mendimi i Ramush Haradinajt, vendimet i merrnin komandantët në nivel të nënzoneve.²⁹⁰ U pranua se “ndonjëherë” Ramush Haradinaj “me gjasë” konsultohej, por nuk kishte shumë mundësi për ta kontaktuar.²⁹¹ Edhe Skënder Rexhahmetaj dha dëshmi të ngjashme se asnjëherë nuk mori urdhër nga Ramush Haradinaj dhe se nuk i duhej leje prej tij për të ndërmarrë ndonjë veprim ushtarak në nënzonën e tij të përgjegjësisë apo për sjelljen e armëve nga Shqipëria. Megjithatë ai i koordinonte veprimet me Haradinajn.²⁹² Jakup Krasniqi dëshmoi se megjithëse Ramush Haradinaj si komandant i Zonës

²⁸⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 15; Prova materiale P210 (e datës 2 korrik 1998); P212 (e datës 4 korrik 1998).

²⁸¹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 17, 21; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 52; Skënder Rexhahmetaj, T. 1023-1024; Prova materiale P238 (e datës 8 (ose 6) korrik 1998); P300 (e datës 24 qershor 1998).

²⁸² Prova materiale P239. *Shih* gjithashtu më lart, para. 38.

²⁸³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 15; Prova materiale P211 (e datës 4 korrik 1998).

²⁸⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 15, 16, 18; Prova materiale P216 (e datës 5 korrik 1998); P228; P229 (të dy dokumentet mbajnë datën 8 korrik 1998); P244 (e datës 12 korrik 1998).

²⁸⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 20; Prova materiale P266; P268 (të dy dokumentet mbajnë datën 28 korrik 1998).

²⁸⁶ *Shih* më lart, para. 77.

²⁸⁷ *Shih* më poshtë, para. 87-89.

²⁸⁸ Bislim Zyrapi, T. 776. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 93.

²⁸⁹ Skënder Rexhahmetaj, T. 1056, 1061, 1076-1077, 1080; Bislim Zyrapi, T. 726-727.

²⁹⁰ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3650; *shih* gjithashtu Skënder Rexhahmetaj, T. 1078.

²⁹¹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3665.

²⁹² Skënder Rexhahmetaj, T. 1076-1078.

Operative të Dukagjinit përpiquej të merrte informacion se çfarë po ndodhte në zonën e tij të përgjegjësisë, kjo ndonjëherë ishte e vështirë.²⁹³

81. Gjatë një takimi midis UÇK-së dhe FARK-ut të mbajtur në Baran, në komunën e Pejës, më 12 korrik 1998, UÇK-ja u tregua mjaft e paorganizuar dhe pa strukturë e disiplinë; nuk respektohej hierarkia komanduese dhe kishte shumë oficerë krahasuar me numrin e vogël të ushtarëve;²⁹⁴ Cufë Krasniqi dëshmoi se sipas mundësive Ramush Haradinaj lëvizte nëpër gjithë Zonën Operative të Dukagjinit dhe kontaktonte drejtpërsëdrejti forcat e UÇK-së dhe komandantët e fshatrave, por prapëseprapë ishte e pamundur të komandohej e gjithë zona duke qenë se vija e frontit ishte rreth 50 kilometra e gjatë.²⁹⁵

82. Siç dëshmoi Skënder Rexhahmetaj, lista e emërimeve në shënimet e mbledhjes së 23 qershorit 1998 pasqyron vetëm çfarë u tha në mbledhje dhe paraqiste një plan të strukturës operative komanduese që kishte të ngjarë të formohej në të ardhmen.²⁹⁶ Bislim Zyrapi u pajtua me parashtrimin e Mbrojtjes së Haradinajt se gjatë vizitës së tij në Zonën Operative të Dukagjinit rreth 18-19 korrikut 1998, struktura e përcaktuar gjatë mbledhjes ishte ende në fazën e formimit.²⁹⁷ UÇK-ja në atë zonë ende nuk ishte formuar në “aspektin ushtarak”.²⁹⁸ Dhoma vëren se emërimi i Muhamet Berishës si përgjegjës për mbrojtjen kundër armëve biologjike dhe kimike ishte “imagjinare” meqenëse nuk ka prova për përdorimin e armëve të tilla në atë kohë.²⁹⁹

83. Bislim Zyrapi dëshmoi se në periudhën maj-shtator 1998, UÇK-ja nuk ishte një “ushtri e mirëfilltë”; ajo ishte një ushtri në fazën e zhvillimit.³⁰⁰ Nuk ekzistonte një strukturë komanduese vertikale që zbatohet në terren.³⁰¹ Dhoma dëgjoi prova se struktura komanduese e periudhës pas mbledhjes së 26 majit 1998 thjesht nuk u ndryshua dhe vazhdoi të ishte “horizontale”; Skënder Rexhahmetaj dëshmoi se asnjëherë nuk mori urdhra nga Ramush Haradinaj.³⁰² Jakup Krasniqi shpjegoi se deri nga fundi i gushtit apo fillimi i shtatorit 1998, UÇK-ja vazhdoi të vepronte si ushtri

²⁹³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5056.

²⁹⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7665-7666.

²⁹⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 66; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5810-5812.

²⁹⁶ Skënder Rexhahmetaj, T. 1071-1072, 1074-1075; Prova materiale P191, f. 4.

²⁹⁷ Bislim Zyrapi, T. 737.

²⁹⁸ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3216.

²⁹⁹ Bislim Zyrapi, T. 699-701; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3744-3746; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 42; Skënder Rexhahmetaj, T. 1075-1076; Prova materiale P191, f. 4.

³⁰⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3290, 3293-3296.

³⁰¹ Bislim Zyrapi, T. 726-727.

³⁰² Skënder Rexhahmetaj, T. 1076-1077. *Shih* gjithashtu Bislim Zyrapi, T. 726-727.

vullnetare.³⁰³ Jakup Krasniqi dëshmoi se deri dikur nga fundi i gushtit 1998, UÇK-ja kishte strukturë komanduese horizontale; ajo nuk kishte dhe as që mund të kishte një hierarki komanduese të mirëfilltë.³⁰⁴

84. Dhoma gjithashtu mori prova se struktura e UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit vazhdimisht zhvillohej dhe transformohej. Në mbledhjen e punës me komandantët e fshatrave të Zonës Operative të Dukagjinit të mbajtur në Gillogjan, në komunën e Deçanit më 27 korrik 1998, Ramush Haradinaj theksoi nevojën për përmirësimin e organizimit të brendshëm të UÇK-së dhe për shndërimin e saj nga një forcë kryengritëse në një ushtri të organizuar.³⁰⁵ Më 28 korrik 1998, Ramush Haradinaj i kërkoi edhe njëherë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të organizonte një mbledhje me komandantët e nënzonave të “çliruara” për të përmirësuar strukturimin e organizatës.³⁰⁶ Pavarësisht nga përpjekjet për përmirësimin e strukturës dhe organizimit të ushtrisë gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht 1998, sulmet e vazhdueshme të forcave serbe të cilat dispononin pajisje të shumta, penguan përpjekjet për organizim më të mirë të UÇK-së.³⁰⁷ UÇK-ja filloi ristrukturimin e radhëve dhe njësive të saj pas ofensivës serbe të kryer nga mesi i gushtit 1998.³⁰⁸ Dikur nga shtatori apo tetori i vitit 1998, UÇK-ja ishte më e organizuar dhe u bënë përpjekje më të mëdha për ngritjen e një “strukture të mirëfilltë ushtarake”.³⁰⁹ Në këtë periudhë UÇK-ja kishte kompanitë, batalionët dhe brigadat e saj dhe për pasojë u bë ushtri më e organizuar.³¹⁰ Provat tregojnë se gjatë periudhës së Aktakuzës, UÇK-ja në Zonën Operative të Dukagjinit ishte në fazën e zhvillimit.

6. Krijimi i komandës së njësuar: bashkimi i forcave të UÇK-së dhe FARK-ut

85. Siç konkludohet më poshtë në Aktgjykim, forcat e FARK-ut u dislokuan në Kosovë dikur para 25 qershorit 1998.³¹¹ Fillimisht, midis FARK-ut dhe UÇK-së pati mosmarrëveshje në lidhje me organizimin e forcave. Tahir Zemaj ishte për formimin e brigadave operative të cilat do të ndërhyjnë gjatë sulmeve të forcave serbe dhe më pas do të ktheheshin në bazë. Ramush Haradinaj

³⁰³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3450-3451.

³⁰⁴ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojca 18; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3451.

³⁰⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 20; Prova materiale P265, f. 1, 3.

³⁰⁶ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 20; Prova materiale P267.

³⁰⁷ Bislim Zyrapi, T. 727-729; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5008.

³⁰⁸ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 28; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4428, 4515; *shih* më poshtë, para. 292-295.

³⁰⁹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4710; Bislim Zyrapi, T. 701-702; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5008.

³¹⁰ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5008.

³¹¹ *Shih* më poshtë, para. 258.

ishte i mendimit se oficerët e stërvitur nuk duhej të qëndronin në bazën në Prapaqan, në komunën e Deçanit por nëpër pikat e ndryshme të mbrojtjes.³¹² Për shkak të tensionit gjithnjë e më të madh midis UÇK-së dhe FARK-ut dhe incidenteve të datës 4 dhe 10 korrik 1998 të shtjelluara më poshtë në Aktgjykim, në mbrëmjen e 10 korrikut 1998 u mbajt një mbledhje për të gjetur zgjidhje lidhur me organizimin e forcave të UÇK-së dhe FARK-ut.³¹³ Në mbledhje u mor vendimi që UÇK-ja dhe FARK-u të formonin tri brigada.³¹⁴ Pas mbledhjes, Tahir Zemaj i paraqiti Ramush Haradinajt kërkesë zyrtare për emërimet e veçanta dhe përshkrimin e detyrave në kuadër të forcave të bashkuara; planifikohej që oficerët e FARK-ut të shpërndareshin nëpër brigadat e ndryshme.³¹⁵

86. Brigada e parë drejtohej nga Tahir Zemaj dhe ishte e vendosur në Prapaqan, në komunën e Deçanit.³¹⁶ Ajo numëronte rreth 100 njerëz.³¹⁷

87. Brigada e dytë u formua me autorizimin e Ramush Haradinajt.³¹⁸ Ajo ishte e vendosur në ndërtesën e shkollës në Bardhaniq dhe/ose Zhabel, në komunën e Gjakovës.³¹⁹ Zona e përgjegjësisë

³¹² Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3753-3755.

³¹³ *Shih* më poshtë, para. 264-272, 275-279.

³¹⁴ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 25-26; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4464; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3759; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3759; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5734; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 47; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7632-7633.

³¹⁵ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 22, 25; Skënder Rexhahmetaj, T. 1078; Rustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 35; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3759-3760; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3759-3760; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 47-48; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7632-7633, *shih* Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 47; *shih* gjithashtu Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7632-7633. *Shih* gjithashtu Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3759; *shih* gjithashtu Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4463-4464.

³¹⁶ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 41, 65; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5731-5732; Prova materiale P55; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4463-4464; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3759; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 14; Dëshmitari 77, T. 1196; Sadri Selca, Prova materiale P333 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10859-10860.

³¹⁷ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26.

³¹⁸ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 18; Prova materiale P242; P252. *Shih* gjithashtu Prova materiale P248.

³¹⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 41, 65; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5731-5732; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4463-4464; Sadri Selca, Prova materiale P333 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10860; Prova materiale P55; P252; P261.

së kësaj brigade përfshinte fshatrat Lubëniq, Strellc i Epërm, Strellc i Poshtëm, Krushec, Dubovikë, Lëbushë, Isniq, Llukë e Epërme, Broliq, Dujakë dhe Prapaqan të komunës së Deçanit.³²⁰ Sipas Shemsedin Çekajt, brigada kishte rreth 80 njerëz, por në fillim vetëm 20 prej tyre kishin armë dhe uniforma.³²¹ Sipas Dëshmitarit 17, brigada e dytë nuk kishte efektiv të mjaftueshëm dhe rrjedhimisht nuk u formua asnjëherë.³²²

88. Dhoma mori prova mospërputhëse se kush dhe për sa kohë u emërua komandant i brigadës së dytë. Shemsedin Çekaj dëshmoi se nga 11 apo 12 korriku 1998, ai u hoq nga posti i komandantit të nënzonës së dytë dhe u emërua komandant i brigadës së dytë të posaformuar.³²³ Këtë dëshmi e vërteton urdhri i 11 korrikut 1998 i nënshkruar nga Ramush Haradinaj që është paraqitur si provë në këtë çështje.³²⁴ Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshminë e Cufë Krasniqit dhe Sadri Selcës se komandant i brigadës së dytë ishte Musa Gjakova.³²⁵ Edhe Dëshmitari 17 dëshmoi se komandant i brigadës së dytë në fillim ishte Kemajl Shariqi të cilin më vonë e zëvendësoi Musa Gjakova.³²⁶

89. Brigada e tretë (e njohur gjithashtu si brigada “Adrian Krasniqi” dhe më pas si brigada “Isuf Gërvalla”) ishte e vendosur në ndërtesën e shkollës fillore në Baran, në komunën e Pejës.³²⁷ Zona e përgjegjësisë e kësaj brigade përfshinte fshatrat Raushiq, Rashiq, Kotradiq, Vranoc, Baran, Kosuriq, Buçan, Llugagji, Gllogjan, Napolë, Qeskovë dhe Loxhë të komunës së Pejës.³²⁸ Më 12 korrik 1998,

³²⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 53, 54; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 18; Prova materiale P242; P248; P252; P347.

³²¹ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26.

³²² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 53.

³²³ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26-27; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4463-4464; Prova materiale P242.

³²⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 18; Prova materiale P242. Dhoma vëren se në përkthimin në anglisht të një urdhri tjetër thuhet se Shemsedin Çekaj u emërua komandant i brigadës së tretë, Prova materiale P248.

³²⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 41, 65; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5731-5732; Prova materiale P55; Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10860.

³²⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 53.

³²⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 24, 41, 63-65; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5731-5732; Prova materiale P55; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4464; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 14; Sadri Selca, Prova materiale P333 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10859-10860; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 53.

³²⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 53. Prova materiale P347 është një hartë në të cilën dëshmitari shënoi me ngjyrë zonat e përgjegjësisë. Brigada e tretë është shënuar me të portokalltë. Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit është shënuar me të verdhë, Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 53; Prova materiale P347. Dëshmitari 17 shpjegoi se në varësi të rrethanave kufijtë e zonave të përgjegjësisë ndonjëherë lëviznin, Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 54.

Ramush Haradinaj emëroi Rustem Berishën komandant të brigadës së tretë.³²⁹ Mirëpo, provat tregojnë se Rustem Berisha nuk e mori këtë detyrë dhe se detyrën e komandantit e kryente Nazif Ramabaja.³³⁰ Cufë Krasniqi dëshmoi se i raportonte Nazif Ramabajës dhe se ky i raportonte Tahir Zemajt dhe Ramush Haradinajt; për këtë shpesh duheshin javë të tëra.³³¹

90. Më 11 korrik 1998, përfaqësuesit e UÇK-së dhe FARK-ut vazhduan bisedimet në Prapaqan për të arritur marrëveshje mbi emërimin e oficerëve dhe caktimin e detyrave.³³² Pas mbledhjes, Tahir Zemaj i paraqiti “Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit” kërkesë për “emërimin dhe detyrat e oficerëve ushtarakë në brigadat operative”.³³³ Kërkesa përfshinte emrat e 20 oficerëve për emërim, pesë prej të cilëve tashmë ishin pjesëtarë të UÇK-së në zonën e Dukagjinit.³³⁴

91. Brigadat filluan të vepronin më 12 korrik 1998.³³⁵ Sipas Cufë Krasniqit, brigadat u krijuan për qëllime propagandistike në mënyrë që njerëzit të mendonin se kishin tri armata të fuqishme që vepronin në tri zona të ndryshme.³³⁶ Forcat e bashkuara nuk kishin pajisjet e nevojshme, njerëz apo uniforma për të funksionuar si një ushtri e rregullt.³³⁷

7. Marrëdhëniet midis Zonës Operative të Dukagjinit dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së

92. Në gjysmën e dytë të vitit 1998, Jakup Krasniqi si zëdhënës i UÇK-së në Kosovë dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, kishte kontakte thuajse të përditshme me ushtarë të UÇK-së, me njësitë operative të UÇK-së dhe me njësi të ndryshme që vepronin veças nga zona.³³⁸ Komunikimi mbahej kryesisht me telefona satelitorë.³³⁹ Në fillim të marsit 1998, Jakup Krasniqi nuk kishte kontakte me askënd në zonën e Dukagjinit dhe nuk dinte nëse dikush tjetër nga Shtabi i

³²⁹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 18; Prova materiale P246; P249; P346.

³³⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 24, 64; Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10859; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 14; *shih* gjithashtu Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 41, 65; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5731-5732.

³³¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 68; Cufë Krasniqi, Prova materiale P53 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5808-5809.

³³² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 48; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7633.

³³³ Dëshmitari 77, T. 1277-1278, 1316-1317, 1415; Prova materiale D147.

³³⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7638-7639; Dëshmitari 77, T. 1277-1278, 1316-1317; Prova materiale D147.

³³⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 26-27; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4464.

³³⁶ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5734.

³³⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5734-5736.

³³⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4958, 4974.

³³⁹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4974.

Përgjithshëm mbante lidhje me këtë zonë.³⁴⁰ Në qershor 1998, Jakup Krasniqi vendosi kontakt me Lahi Brahimajn në zonën e Dukagjinit për arsye se mendonte që ai ishte personi përgjegjës për atë zonë në atë kohë dhe se Lahi Brahimaj ishte njëkohësisht anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.³⁴¹ Nga fundi i qershorit ose fillimi i korrikut 1998, Jakup Krasniqi filloi kontakte me Ramush Haradinajn.³⁴²

93. Më 18 apo 19 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Bislim Zyrapi me Lahi Brahimajn dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së vizituan Zonën Operative të Dukagjinit.³⁴³ Në postëkomandën e UÇK-së në shtëpinë e Lahi Brahimajt në Jabllanicë u organizua një mbledhje.³⁴⁴ Qëllimi i mbledhjes ishte të diskutohej koordinimi midis Shtabit të Përgjithshëm, Zonës Operative të Dukagjinit dhe zonave të tjera, logjistika dhe furnizimi me armë dhe përfshirja e disa njësive vendore brenda strukturës komanduese.³⁴⁵ Bislim Zyrapi i shoqëruar nga Salih Veseli dhe Driton Zeneli, i cili sipas Zyrarit i raportonte Ramush Haradinajt, vizitoi pozicionet e njësive në zonë.³⁴⁶ Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm e kishin informuar Bislim Zyrapi që komandant i Zonës Operative të Dukagjinit ishte Ramush Haradinaj.³⁴⁷ Nga vizita e tij në Zonën Operative të Dukagjinit, Bislim Zyrapi pa se ushtarët e UÇK-së dhe fshatarët e respektonin pozitën e Ramush Haradinajt.³⁴⁸ Bislim Zyrapi theksoi se teorikisht, duke marrë parasysh formimin e komandës në atë zonë, ai do të kishte qenë komandant i Ramush Haradinajt.³⁴⁹ Duke filluar nga mesi i korrikut, Bislim Zyrapi si shef i degës operative të Shtabit të Përgjithshëm, kishte kontakte të rregullta me Zonën Operative të Dukagjinit dhe zonat e tjera operative.³⁵⁰

³⁴⁰ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5009.

³⁴¹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5009-5010, 5055-5056, 5076-5077.

³⁴² Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5010, 5034, 5051, 5054-5056.

³⁴³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3202-3203, 3207, 3208-3209, 3211-3212, 3234-3235, 3286, 3301, 3316, 3344, 3345, 3385-3386, 3388, 3414; Bislim Zyrapi, T. 657, 682, 737-738, 760-761, 768.

³⁴⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3387-3388; Bislim Zyrapi, T. 739, 760.

³⁴⁵ Bislim Zyrapi, T. 682-684.

³⁴⁶ Bislim Zyrapi, T. 685, 739, 762.

³⁴⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3209-3211, 3220, 3228; Bislim Zyrapi, T. 649-651, 685-686, 776.

³⁴⁸ Bislim Zyrapi, T. 776.

³⁴⁹ Bislim Zyrapi, T. 740.

³⁵⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 29; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3208, 3258, 3298, 3339, 3394, 3398; Bislim Zyrapi, T. 633.

94. Pas mbledhjes në Jabllanicë, Bislim Zyrapi dhe Ramush Haradinaj vizituan njësitë e UÇK-së në Glllogjan dhe pozicionet e UÇK-së në zonën përreth.³⁵¹ Gjatë dy ditëve ata gjithashtu vizituan fshatrat Irzniq (komandant i fshatit ishte Shemsedin Çekaj), Prilep (komandant i fshatit ishte Maliq Ndrecaj) dhe Shaptej në komunën e Deçanit, si dhe zonën e Rekës së Keqe, duke përfshirë fshatrat Ramoc në komunën e Gjakovës, Smolicë (komandant i fshatit ishte Naim Maloku) dhe Junik (komandant i fshatit ishte Aziz Hyseni) në komunën e Deçanit.³⁵² Bislim Zyrapi donte t'i vizitonte njësitë e këtyre fshatrave për të parë nivelin e organizimit të tyre dhe për t'i përfshirë disa prej tyre në Zonën Operative të Dukagjinit; vizitën e mundësoi Ramush Haradinaj.³⁵³ Gjatë vizitës, fshatrat Smolicë dhe Junik pranuan t'i bashkoheshin Zonës Operative të Dukagjinit.³⁵⁴ U arrit marrëveshje edhe për përfshirjen e zonës së Rekës së Keqe nën komandën e Zonës Operative të Dukagjinit.³⁵⁵

8. Ndërrimi i komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit

95. Pas ofensivës serbe³⁵⁶ më 20 gusht 1998 apo rreth kësaj date, përfaqësues të rreth 60 fshatrave të Zonës Operative të Dukagjinit u mbledhën për një takim në Prapaqan, në komunën e Deçanit, për të diskutuar riorganizimin dhe ristrukturimin e forcave në atë zonë me qëllim kryerjen e operacioneve ushtarake dhe përballjen me "armikun".³⁵⁷ Në takim morën pjesë 68 përfaqësues të shtabeve vendore të UÇK-së dhe FARK-ut, duke përfshirë Ramush Haradinajn dhe Tahir Zemajn.³⁵⁸ Ramush Haradinaj pranoi se nuk ishte më në gjendje t'i drejtonte forcat në Zonën Operative të Dukagjinit për shkak të humbjeve të pësuar kohëve të fundit në zonë, duke përfshirë Glllogjanin dhe Irzniqin në komunën e Deçanit dhe Gjakovën.³⁵⁹ Përfaqësuesit e 48 fshatrave të

³⁵¹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3213-3218, 3344; Bislim Zyrapi, T. 649.

³⁵² Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3214, 3218-3222, 3227-3229, 3231-3237, 3327, 3344, 3346, 3355; Bislim Zyrapi, T. 649; Prova materiale P172; P173.

³⁵³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3219, 3233-3235, 3280, 3330; Bislim Zyrapi, T. 714, 723-724, 726; Prova materiale P179, f. 1.

³⁵⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3235-3236.

³⁵⁵ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3236; Prova materiale P279, f. 3.

³⁵⁶ *Shih* më poshtë, para. 287-295.

³⁵⁷ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 29-31, 33; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 100; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(i), 2(j), 2(k); Skënder Rexhahmetaj, T. 1078; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7592-7593.

³⁵⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 100; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7592-7593.

³⁵⁹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 100; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7592-7593.

Zonës Operative të Dukagjinit votuan për emërimin e Tahir Zemajt komandant zone.³⁶⁰ Tahir Zemaj e zëvendësoi Ramush Haradinajn dhe u emërua komandant i Zonës Operative të Dukagjinit.³⁶¹ Ramush Haradinaj u bë zëvendëskomandant.³⁶² Parashikohej që forcat të vepronin të ndara në katër brigada dhe secila prej tyre të kishte “degët” e veta.³⁶³ Katër brigadat së bashku do të formonin korpusin.³⁶⁴

96. Më 21 gusht 1998, Ramush Haradinaj dhe Tahir Zemaj nxorrën bashkërisht dokumentin ku pasqyrohej ndërimi i komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit.³⁶⁵ Si pasojë e këtyre ndryshimeve u formua “Drejtoria Operative e Rrafshit të Dukagjinit”; kjo u bë me qëllim kontrollimin e katër brigadave nën koordinimin e Drejtorisë Operative të sapoformuar.³⁶⁶ Tahir Zemaj urdhëroi që të informohej Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në lidhje me emërimet e reja dhe të paraqiste kundërshtimet e mundshme brenda 24 orësh.³⁶⁷

97. Më 23 gusht 1998 ose rreth kësaj date, në Prapaqan erdhi një delegacion i Shtabit të Përgjithshëm, ndër të cilët edhe Lahi Brahimaj.³⁶⁸ Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kritikuan vendimin dhe e deklaruan të shfuqizuar.³⁶⁹ Bislim Zyrapi dëshmoi se vendimi për zëvendësimin e Ramush Haradinajt me Tahir Zemajn shkaktoi mosmarrëveshje të mëdha midis anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm.³⁷⁰ Më 2 shtator 1998, oficerë të FARK-ut dhe UÇK-së u mblodhën për një takim në Bardhaniq.³⁷¹ Në takim ishte i pranishëm Hashim Thaçi, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të

³⁶⁰ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 30.

³⁶¹ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 29-31, 33; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(i), 2(j), 2(k); Skënder Rexhahmetaj, T. 1078; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 100; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7592-7593.

³⁶² Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 29-31, 33; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(i), 2(j), 2(k); Skënder Rexhahmetaj, T. 1078; Dëshmitari 77, T. 1284; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 22; Prova materiale P279, f. 1; P280, f. 1.

³⁶³ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 22; Prova materiale P279, f. 3.

³⁶⁴ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 22; Prova materiale P279, f. 3.

³⁶⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 107; Dëshmitari 77, T. 1284; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 22; Prova materiale P279; P280.

³⁶⁶ Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48; Prova materiale P279; P280.

³⁶⁷ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 31; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 107; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 43; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3372.

³⁶⁸ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 31-32; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 44, 46; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 45; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3370-3372, 3374-3376; Bislim Zyrapi, T. 657, 679-680; Prova materiale P283, f. 1.

³⁶⁹ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 32.

³⁷⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 43.

³⁷¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 113.

UÇK-së dhe shef i drejtorisë politike.³⁷² Takimin e hapi Rexhep Selimi, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së i cili theksoi se Shtabi i Përgjithshëm kishte marrë vendimin që komandant i UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit të ishte Ramush Haradinaj. Pjesëtarëve të FARK-ut u thanë që nuk kishin të drejtë të bënin ndryshime në strukturën komanduese pa lejen e Shtabit të Përgjithshëm.³⁷³ Përfaqësuesit e FARK-ut kundërshtuan duke theksuar se do të vazhdonin të luftonin në zonat e tyre të përgjegjësisë dhe se nuk donin që të ndërhynte UÇK-ja.³⁷⁴ Tahir Zemaj nuk pranoi vendimin për zëvendësimin e tij prej Ramush Haradinajt meqenëse ky vendim u konsiderua orvatje për të vendosur FARK-un nën komandën e UÇK-së.³⁷⁵ FARK-u dhe UÇK-ja nuk arritën marrëveshje.³⁷⁶ Pas diskutimeve, vendimi u shfuqizua dhe Ramush Haradinaj u riemërua komandant i Zonës Operative të Dukagjinit.³⁷⁷

98. Më 3 shtator 1998, komandanti i brigadës së parë të vendosur në Prapaqan, Tahir Zemaj, njoftoi shtabet vendore në Zonën Operative të Dukagjinit për rivendosjen e strukturës së njëjtë komanduese me atë të para 20 gushtit 1998.³⁷⁸

99. Pas këtyre ngjarjeve FARK-u u tërhoq nga Kosova më 8 shtator 1998.³⁷⁹

9. Shqiponjat e Zeza

100. Në Kosovë vepronte njësi ushtarake e UÇK-së e njohur si “Shqiponjat e Zeza”. Në provat materiale Shqiponjat e Zeza përmenden edhe me emërtimet “Njësia Speciale”, “njësia për ndërhyrje të shpejtë”, dhe “njësi diversante-sabotuese”.³⁸⁰ Shemsedin Çekaj dëshmoi se njësia “Shqiponjat e

³⁷² Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3307; Zoran Stijović, Prova materiale P121, para. 48.

³⁷³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 113; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 45; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3377; Prova materiale P215, f. 2.

³⁷⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 113.

³⁷⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 115; Prova materiale P353.

³⁷⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 116.

³⁷⁷ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 32-34; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 108.

³⁷⁸ Bislim Zyrapi, T. 3377-3378; Prova materiale P281.

³⁷⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 95; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 31.

³⁸⁰ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3537-3538; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3218-3220, 3225-3226, 3382-3384; Prova materiale P162, f. 1; Bislim Zyrapi, T. 646, 649, 746-748; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 20; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 40; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4438, 4440-4442; Shemsedin Çekaj, T. 646, 649, 748; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7558; Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9970-9971.

Zeza” ekzistonte që nga fillimi i prillit 1998.³⁸¹ Mirëpo, Ylber Haskaj dëshmoi se u bë anëtar i Shqiponjave të Zeza në ditën e formimit të kësaj njësie, dikur rreth 14 majit 1998.³⁸² Dhoma është bindur se njësia “Shqiponjat e Zeza” u formua jo më vonë se më 14 maj 1998; njësia përfundimisht ndërpreu operacionet ushtarake dikur në shtator 1998.³⁸³

101. Komandant i Shqiponjave të Zeza ishte Idriz Balaj.³⁸⁴ Ai njihej gjerësisht si “Komandanti” ose “Togeri”.³⁸⁵ Balaj kishte përvojë ushtarake nga lufta në Kroaci ku kishte luftuar kundër forcave serbe.³⁸⁶ Në lidhje me caktimin e Balajt në postin e komandantit, Pjetër Shala dëshmoi se “sipas mendimit tim dhe çfarë kisha dëgjuar nga ushtarët e tjerë, mendoj se Balaj u emërua nga Ramushi”, por ai nuk ishte në gjendje të konfirmonte këtë mendim; këtë gjë thjesht e kishte dëgjuar.³⁸⁷ Gjithashtu edhe Dëshmitari 17 nuk ishte në gjendje të konfirmonte se kush e emëroi Idriz Balajn komandant të Shqiponjave të Zeza dhe kur u bë ky emërim.³⁸⁸

102. Ndonëse Dhoma vëren se Idriz Balaj u caktua formalisht në krye të “operacioneve kundërterroriste sabotuese” për Zonën Operative të Dukagjinit nga 23 qershori 1998, provat, siç u theksua më herët në Aktgjykim, tregojnë se ky vendim u mor me konsensus.³⁸⁹ Për më tepër, Shqiponjat e Zeza si njësi ishte formuar rreth një muaj më parë dhe nuk kishte asnjë provë se pas formimit të saj jo më vonë se më 14 maj 1998, Ramush Haradinaj e emëroi Idriz Balajn komandant të saj apo se ai e autorizoi Balajn që të formonte këtë njësi.

³⁸¹ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4438.

³⁸² Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 9-10.

³⁸³ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 21.

³⁸⁴ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4438, 4441-4442; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 10, 20; Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9970-9971; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7556-7557, 7558, 7743; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 16; Prova materiale P227, f. 1; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 50; Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9072; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 20; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 40; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3225; Bislim Zyrapi, T. 646.

³⁸⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4393-4394; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3620-3621; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 14; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 39; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7556-7557, 7558, 7743; Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8724-8725.

³⁸⁶ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4394; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3620-3621; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 14.

³⁸⁷ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9971-9973.

³⁸⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7556-7557.

³⁸⁹ *Shih* më lart, para. 74.

103. Shemsedin Çekaj dëshmoi se gjatë mbledhjeve të Shtabit Operativ të Dukagjinit, Balaj nuk merrte urdhra prej askujt dhe se anëtarët e shtabit thjesht diskutonin çështjet e ndryshme së bashku.³⁹⁰ Sipas Ylber Haskajt, Balaj u jepte urdhra pjesëtarëve të Shqiponjave të Zeza gojarisht përmes radiolidhjes dhe kishte në dispozicion makina të shumta gjatë gjithë kohës së konfliktit, gjë që i mundësonte atij ta komandonte njësinë duke qenë në lëvizje.³⁹¹ Dëshmitari 17 dëshmoi se Idriz Balaj ishte vartës i Haradinajt që do të thoshte se ai “kishte detyrë t’i raportonte Ramushit”.³⁹² Skënder Rexhahmetaj dëshmoi se “nëqoftëse kisha nevojë për ndihmë nga Togerit, duhej të kontaktoja Ramushin. Për çdo dislokim të njësisë së Togerit duhej autorizim prej Ramushit”.³⁹³ Ai gjithashtu dëshmoi se Ramush Haradinaj i kishte thënë që “mund ta përdorësh këtë njësi speciale në zonën tënde”, por ai “asnjëherë nuk u kërkoi ndihmë”.³⁹⁴

104. Njësia “Shqiponjat e Zeza” ishte e vendosur në Gllogjan, në komunën e Deçanit, si pjesë e shtabit rajonal të UÇK-së.³⁹⁵ Dhoma mori prova se Shqiponjat e Zeza ishin nën komandën e Zonës Operative të Dukagjinit.³⁹⁶ Dikur nga mesi apo fundi i korrikut 1998, Shqiponjat e Zeza formuan një shtab të dytë në Irzniq, në komunën e Deçanit.³⁹⁷ Njësia duhej të vepronte në të gjithë Zonën

³⁹⁰ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4442.

³⁹¹ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 18, 20.

³⁹² Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7555-7557. Zoran Stijoviqi dëshmoi se “mendohej gjerësisht” se Idriz Balaj i raportonte Ramush Haradinajt, Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 50.

³⁹³ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 21.

³⁹⁴ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 40.

³⁹⁵ Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10333-10335; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 13; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 15; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 21; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 3(f).

³⁹⁶ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3226-3227, 3357.

³⁹⁷ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3669-3670; Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10333-10335, 10348; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 13; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 15; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3357-3358; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 50; Prova materiale P254. Pjesëtarët e Shqiponjave të Zeza në Irzniq ishin të vendosur në shtëpinë e shënuar me “Shtabi i Dytë i Njësisë Shqiponjat e Zeza,” e cila ishte rreth 100-150 metra larg shkollës së fshatit, Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10342-10343; Prova materiale P41; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4440-4441 (shtëpia është shënuar me numrin 3); Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3218-3220, 3225-3226; Bislim Zyrapi, T. 649, 746-748; Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9071-9072; Prova materiale P121, para. 50. Në gusht 1998, shtabi në Irzniq ende vepronte, Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 59.

Operative të Dukagjinit dhe të ndërhynte aty ku kishte nevojë.³⁹⁸ Në praktikë, sipas Ylber Haskajt, njësia vepronte kryesisht në zonën e komunës së Deçanit dhe rreth saj.³⁹⁹

105. Njësia “Shqiponjat e Zeza” kishte rreth 30-40 pjesëtarë.⁴⁰⁰ Njësia kishte një numër të vogël ushtarësh dhe në beteja shkonin madje edhe më pak ushtarë.⁴⁰¹ Sipas Skënder Rexhahmetajt, megjithëse ishin pjesë e forcave të UÇK-së, në krahasim me njësitë e përgjithshme të UÇK-së Shqiponjat e Zeza vepronin deri diku të pavarur.⁴⁰²

106. Uniformat e pjesëtarëve të njësisë “Shqiponjat e Zeza” dalloheshin nga uniformat e ushtarëve të zakonshëm të UÇK-së.⁴⁰³ Ata vishnin rroba civile të zeza dhe ndonjëherë mbanin bereta të zeza në kokë.⁴⁰⁴ Edhe Idriz Balaj mbante uniformë të zezë.⁴⁰⁵ Pjesëtarët e Shqiponjave të Zeza mbanin emblemën e UÇK-së në anën e djathtë të uniformës dhe emblemën e njësisë “Shqiponjat e Zeza”.⁴⁰⁶

³⁹⁸ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 12; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 20; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3357-3358.

³⁹⁹ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 12-13.

⁴⁰⁰ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4438, 4502; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3670, 3846; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 50; Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9974; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 10.

⁴⁰¹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3810.

⁴⁰² Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 41.

⁴⁰³ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 19; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 16; *shih* më lart, para. 32. Shemsedin Çekaj dëshmoi se e kishte parë Ramush Haradinajn me “Togerin,” për të cilin më vonë mori vesh se ishte Idriz Balaj, rreth 20 prillit 1998, dhe se ata të dy kishin uniforma ushtarake me ngjyrë të gjelbër të errët me emblemën e UÇK-së. Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4393. Rustem Tetaj dëshmoi se “Ramushin dhe Togerin” i kishte takuar në prill 1998, dhe se të dy kishin uniforma ushtarake kamuflimi, Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3618.

⁴⁰⁴ Cufë Krasniqi, Prova materiale P53 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 20; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3669; 3807-3808; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7564; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 16, 41; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3225-3226; Bislim Zyrapi, T. 646, 649, 746-748; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 50. Pjetër Shala dëshmoi se pjesëtarët e Shqiponjave të Zeza mbanin uniforma ngjyrë kafe. Dhoma gjykon se njerëzit mund t'i ngatërrojnë lehtësisht uniformën me ngjyrë kafe me atë me ngjyrë të zezë. Rrjedhimisht, kjo nuk ndryshon përfundimin e Dhomës nga provat e tjera përputhëse se pjesëtarët e Shqiponjave të Zeza mbanin uniforma të zeza, Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9974.

⁴⁰⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 60; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3537-3539; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 16.

⁴⁰⁶ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3669-3670, 3807-3808; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 50.

107. Shqiponjat e Zeza armatoseshin dhe stërviteshin në shtabin e tyre në Gllogjan.⁴⁰⁷ Stërvitja ishte mjaft intensive dhe ndonjëherë zgjaste me ditë të tëra.⁴⁰⁸ Zoran Stijoviqi dëshmoi se pjesëtarët e Shqiponjave të Zeza ishin të pajisur mirë me pushkë automatike, bomba dore, granatahedhës dore, mitralozë të rëndë dhe të lehtë dhe me pushkë snajperë.⁴⁰⁹

108. Njësia “Shqiponjat e Zeza” u krijua që, sipas nevojës “të ndërhynte shpejt dhe të ndihmonte ushtarakisht” fshatrat që sulmoheshin nga forcat serbe.⁴¹⁰ Në operacione luftarake nuk shkonte e gjithë njësia por vetëm një numër i vogël pjesëtarësh të zgjedhur të njësisë – zakonisht tre deri në pesë pjesëtarë.⁴¹¹ Dhoma mori prova se njësia Shqiponjat e Zeza përdorej për të ndjellë frikë tek forcat serbe; Rustem Tetaj dëshmoi se në luftimet ku merrnin pjesë Shqiponjat e Zeza, aksionet e forcave serbe nuk zgjasnin shumë.⁴¹² Gjatë verës së vitit 1998, Shqiponjat e Zeza, midis të tjerash, morën pjesë në betejat në Voksh, Baballoq, Prilep, Gramaqel, Rastavicë, Junik, Carrabreg të komunës së Deçanit dhe në Loxhë të komunës së Pejës.⁴¹³ Ylber Haskaj dëshmoi se si pjesëtar i Shqiponjave të Zeza luftoi disa javë në fshatrat Voksh, Sllup dhe Drenoc të komunës së Deçanit, gjatë qershorit dhe korrikut të vitit 1998.⁴¹⁴ Shemsedin Çekaj dëshmoi se njësia “Shqiponjat e Zeza” gjithashtu lëvizte rreth zonës së rrugës së furnizimit me armë në anën perëndimore të rrugës kryesore Pejë-Gjakovë; ai shpjegoi se gjatë konfliktit Shqiponjat e Zeza mundësuan mbrojtjen strategjike të rrugëve të furnizimit me armë të UÇK-së. Shemsedin Çekaj gjithashtu dëshmoi se pas emërimit të tij komandant i nënzonës së dytë, kjo njësi për një kohë ishte e vendosur në Voksh dhe më pas u shpërngul në Irzniq.⁴¹⁵

⁴⁰⁷ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 15; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4438, 4516, 4518; Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10333-10334, 10336-10337; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 11, 13, 19.

⁴⁰⁸ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 11-12, 14.

⁴⁰⁹ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 50.

⁴¹⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 69; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3810; Bislim Zyrapi, T. 754.

⁴¹¹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (origjinal *Haradinaj*), T. 3846.

⁴¹² Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3812.

⁴¹³ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3692, 3808-3809; Prova materiale P162; Bislim Zyrapi, T. 646.

⁴¹⁴ Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10334; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 22.

⁴¹⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4497-4499, 4502-4503.

10. Policia ushtarake e UÇK-së

109. Siç shtjellohet në paragrafët e mëposhtëm, Dhoma mori prova lidhur me tri mbledhje rreth krijimit të policisë ushtarake të UÇK-së: mbledhjen e 21 qershorit 1998, 12 korrikut 1998 dhe 25 korrikut 1998. Dhoma vëren se nga provat nuk del e qartë lidhja midis këtyre tri mbledhjeve.

110. Provat tregojnë se anëtarët e Shtabit Rajonal të Dukagjinit diskutuan me hollësi formimin e policisë ushtarake të UÇK-së për herë të parë gjatë mbledhjes së 21 qershorit 1998.⁴¹⁶ Në mbledhje morën pjesë, midis të tjerëve, Ramush Haradinaj, Rrustem Tetaj, Faton Mehmetaj, Lahi Brahimaj dhe Skënder Rexhahmetaj.⁴¹⁷ Sipas shënimeve të mbledhjes, Shtabi Rajonal i Dukagjinit e parashikonte policinë ushtarake të UÇK-së si “komponent të UÇK-së”, formulim i propozuar nga Rrustem Tetaj.⁴¹⁸ Në mbledhje, Ramush Haradinaj tha se “ekziston një rregullore e Policisë Ushtarake që do të kryente detyrat e ruajtjes së rendit dhe qetësisë në rajonin e Dukagjinit”.⁴¹⁹ “Duke vepruar me nismën e vet, Fatoni [Mehmetaj] lexoi një variant alternativ të detyrave të policisë me 12 pika” kurse Ramush Haradinaj “edhe një herë lexoi pikë për pikë variantin e parë dhe të gjitha pikat u miratuan një nga një”.⁴²⁰ Dhoma konkludon se dokumenti i marrë si provë i datës 21 qershor 1998 me titull “Rregullorja e Policisë Ushtarake”, në të cilin janë paraqitur 12 “detyrat” e policisë ushtarake ku në krye të faqes është emërtimi “Shtabi Operativ i [UÇK-së] Rrafshit të Dukagjinit” dhe me “Ramush Haradinaj” të shtypur në fund të faqes, paraqet përmbledhje rregullash të miratuara gjatë mbledhjes së 21 qershorit 1998 të Shtabit Rajonal të Dukagjinit.⁴²¹

111. Shënimet e mbledhjes së 21 qershorit 1998 evidentojnë se “u theksua që për çdo nënzonë të Rajonit të caktohen 5 policë ushtarakë” por se “Skënderi propozoi variantin e caktimit në çdo fshat të një personi të policisë ushtarake me dy kolegë. Personat e emëruar në çdo nënzonë ushtarake përgjigjen para tij”, domethënë para këtij personi.⁴²² Ramush Haradinaj u përgjigj me “Si fillim, po nisim me këta pesë. Nga një për nënzonë dhe pastaj sipas nevojës do të caktohen edhe të tjerë”.⁴²³ Nga shënimet nuk është e qartë se çfarë vendimi u mor përfundimisht.

112. Në “Rregulloren e Policisë Ushtarake” të datës 21 qershor 1998, policia ushtarake përshkruhet si “organ ekzekutiv i lëndëve që kanë të bëjnë me thyerjen dhe cenimin e rregullave

⁴¹⁶ Prova materiale P190, f. 3. *Shih* më lart, para. 71.

⁴¹⁷ Prova materiale P190, f. 1.

⁴¹⁸ Prova materiale P190, f. 3.

⁴¹⁹ Prova materiale P190, f. 3.

⁴²⁰ Prova materiale P190, f. 3.

⁴²¹ Prova materiale P349. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴²² Prova materiale P190, f. 3.

⁴²³ Prova materiale P190, f. 3.

ushtarake e civile të një vendi, rajoni a lokaliteti” e cila është “pjesë përbërëse e UÇK-së”.⁴²⁴ Dymbëdhjetë “detyrat” e policisë ushtarake të UÇK-së përshijnë “hetimin dhe zbulimin me fakte bindëse të të gjithë personave të cilët në çfarëdo mënyre bashkëpunojnë me armikun” dhe “marrjen e masave ndaj të gjithë atyre që punojnë kundër UÇK-së”.⁴²⁵ Gjithashtu theksohet se “policët që shpërdorin uniformën dhe emblemën e UÇK-së përjashtohen nga të gjitha funksionet dhe ndaj tyre merren masat përkatëse”.⁴²⁶

113. Provat vënë në dukje se masa më konkrete për krijimin e një njësie operative të policisë ushtarake të UÇK-së u morën më 12 korrik 1998 në Vranoc, në komunën e Pejës, kur një komandant fshati propozoi emërimin e disa personave si pjesëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së. Konkretisht, gjatë mbledhjes së 12 korrikut 1998 të mbajtur në shtëpinë e Din Krasniqit në Vranoc, komandant i UÇK-së për Lugun e Baranit, Din Krasniqi, i dorëzoi komandantit të brigadës një listë me emrat e tetë kandidatëve për policinë ushtarake në Lugun e Baranit.⁴²⁷ Ushtarët ishin “zgjedhur nga Din Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të shtabit të UÇK-së”; Dhoma mori prova se disa prej tyre ishin “emëruar” nga Ramush Haradinaj.⁴²⁸ Gjithsesi, komandanti kishte të drejtën për të hequr njerëz nga lista.⁴²⁹ Në mesin e tetë kandidatëve ishin Hasan Gashi dhe “Ibër” apo “Ibra”,⁴³⁰ Krasniqi. Nga provat del se “Hasan Gashi” nga Barani u zgjodh komandant i policisë ushtarake të UÇK-së në Lugun e Baranit.⁴³¹

114. Lidhur me formimin e policisë ushtarake të UÇK-së në Lugun e Baranit dëshmoi edhe Cufë Krasniqi i cili u anëtarësua në UÇK në shkurt të vitit 1998 dhe stërviste ushtarët e UÇK-së.⁴³² Dëshmia e tij në përgjithësi përputhet me provat e tjera lidhur me formimin e policisë ushtarake të UÇK-së në Lugun e Baranit dhe emërimin e Hasan Gashit⁴³³ si komandant të saj, me përjashtim të

⁴²⁴ Prova materiale P349, f. 1-2.

⁴²⁵ Prova materiale P349, f. 1.

⁴²⁶ Prova materiale P349, f. 2.

⁴²⁷ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴²⁸ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴²⁹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴³⁰ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴³¹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴³² Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5795; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 30-31.

⁴³³ Cufë Krasniqi gjithashtu dëshmoi se dikur rreth gushtit 1998 Fadil Nimonaj zëvendësoi Hasan Gashin, Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 72. Dhoma vëren se kur Fadil Nimonaj u emërua komandant i policisë ushtarake në mbledhjen e “Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit” të mbajtur më 25 korrik 1998, në shënimet e mbledhjes nuk përmendet që ai zëvendësoi Hasan Gashin, Prova materiale P81.

periudhës kohore. Cufë Krasniqi jep një kohë të mëhershme me rreth dy muaj.⁴³⁴ Në bazë të tërësisë së provave⁴³⁵ Dhoma konkludon se Cufë Krasniqi ka gabuar në lidhje me kohën, mirëpo pranon aspektet e tjera të dëshmisë së tij.

115. Zona e përgjegjesisë së policisë ushtarake të UÇK-së të formuar në Lugun e Baranit mbulonte 17 fshatra.⁴³⁶ Sipas Cufë Krasniqit, “njësia e policisë ushtarake shkonte e para në fshatrat e sulmuara nga forcat serbe dhe mundësonte largimin e popullatës.”⁴³⁷ “Ajo gjithashtu mundësonte që askush të mos kryente vepra të ndëshkueshme” dhe “nëqoftëse dikush dyshohej se kishte kryer një vepër të tillë ai merrej në pyetje prej policisë ushtarake” por “të dyshuarit duhej të liroheshin për shkak të mungesës së objekteve të paraburgimit.”⁴³⁸ Për më tepër, “policia ushtarake kishte për detyrë të impononte disiplinën në UÇK”.⁴³⁹ Provat tregojnë se gjatë periudhës së Aktakuzës, UÇK-ja nuk kishte një gjykatë ushtarake që funksiononte në zonën e Dukagjinit⁴⁴⁰ dhe se nëqoftëse një gjykatë e tillë realisht u krijua, kjo u bë nga fundi i vitit 1998.⁴⁴¹

116. Pavarësisht nga policia ushtarake e Lugut të Baranit të diskutuar më lart, bisedime në lidhje me formimin e forcave të policisë ushtarake u zhvilluan në mbledhjen e “Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit” të mbajtur më 25 korrik 1998.⁴⁴² Lidhur me pyetjen nëse policia ushtarake ekzistonte në atë kohë, Rustem Tetaj i cili mori pjesë në mbledhjen e 25 korrikut 1998, ra dakort me parashtrimin e Mbrojtjes se nuk ekzistonte asnjëfarë “policie ushtarake deri më 25 korrik, megjithëse po bëheshin përpjekje për t’a krijuar.”⁴⁴³ Shemsedin Çekaj i cili gjithashtu mori pjesë në këtë mbledhje, u pajtua me parashtrimin e Prokurorisë se para 25 korrikut 1998, “në Zonën e Dukagjinit nuk vepronte asnjë njësi e policisë ushtarake.”⁴⁴⁴ Shemsedin Çekaj gjithashtu pranoi se përgjegjësitë kryesore të policisë ushtarake përfshinin “vëzhgimin e hyrje-daljeve në fshatrat në

⁴³⁴ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 24, 72; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5714-5715.

⁴³⁵ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴³⁶ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 72.

⁴³⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 72.

⁴³⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 72.

⁴³⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 73.

⁴⁴⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 74. *Shih* gjithashtu Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 46.

⁴⁴¹ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 37; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3430-3431.

⁴⁴² Prova materiale P81, f. 1; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3740-3741; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P3 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4457.

⁴⁴³ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3740-3741. *Shih* gjithashtu Prova materiale P81.

⁴⁴⁴ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P3 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4457. *Shih* gjithashtu Prova materiale P81.

zonë dhe sigurinë e fshatrave”,⁴⁴⁵ dhe se, “në atë kohë” nuk kishte rol hetues në lidhje me shkeljet e forcave të UÇK-së.⁴⁴⁶

117. Në mbledhjen e 25 korrikut 1998, u diskutua që policia ushtarake e UÇK-së të organizohej në “toga” m/e “komandantë dhe zëvendëskomandantë për zonë”.⁴⁴⁷ Më tej, “Shtabi i Përgjithshëm [i UÇK-së]-5 ” miratoi emërimin e Fadil Nimonajt apo “Tigrit”, i cili ishte i pranishëm në mbledhje, si “komandant i policisë ushtarake”.⁴⁴⁸ Në mbështetje të parashtimit mbi organizimin faktik të policisë ushtarake të UÇK-së, në një raport të datës 28 korrik 1998 që Ramush Haradinaj (pa nënshkrimin e tij) ia dërgoi Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së thuhet se Zona Operative e Dukagjinit “formoi policinë ushtarake” dhe se ajo “funksionon siç duhet”.⁴⁴⁹ Më 1 gusht 1998 Ramush Haradinaj sqaroi se shtabet vendore të UÇK-së, midis të tjerash, kishin detyrë të ndihmonin policinë ushtarake të UÇK-së.⁴⁵⁰

118. Provat që disponon Dhoma tregojnë se policia ushtarake e UÇK-së doli në periudhën midis 12 korrikut 1998 dhe fundit të korrikut 1998.

119. Prokuroria pretendon se Faton Mehmetaj, “komandanti i PU-së në zonën e Dukagjinit”, ishte “vartës dhe bashkëpunëtor i ngushtë” i Ramush Haradinajt.⁴⁵¹ Dhoma mori prova se në mbledhjen e 23 qershorit 1993, Faton Mehmetaj u emërua “përgjegjës për shërbimin e zbulimit”.⁴⁵²

120. Prova që mori Dhoma, në të cilën përshkruhen detyrat e Faton Mehmetajt, është një dokument i UÇK-së i datës 30 korrik 1998, i nënshkruar nga Ramush Haradinaj, ku Faton Mehmetaj, “oficer i Shërbimit të Zbulimit”, autorizohet të “ndërtojë strukturën e Zbulimit të UÇK-së në nënzonën e përgjegjësisë së Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit”.⁴⁵³ Në një dokument tjetër të UÇK-së të së njëjtës datë dhe të nënshkruar nga Ramush Haradinaj, Faton Mehmetaj

⁴⁴⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P3 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4457.

⁴⁴⁶ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P3 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4457-4459. Me sa duket, Dëshmitari u përpoq të sugjeronte se arsyeja pse policia ushtarake nuk kishte rol hetues ishte se pjesëtarët e saj ishin “djem të rinj”, Shemsedin Çekaj, Prova materiale P3 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4459.

⁴⁴⁷ Prova materiale P81, f. 1.

⁴⁴⁸ Prova materiale P81, f. 1; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3741; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P3 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4457.

⁴⁴⁹ Prova materiale P269, f. 2. *Shih* gjithashtu Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 20 (bën të ditur se Bislim Zyrapi njih emblemen e UÇK-së në krye të dokumentit, mirëpo vëren se atje është vetëm emri i shtypur i Ramush Haradinajt pa nënshkrimin e tij).

⁴⁵⁰ Prova materiale P275. *Shih* gjithashtu Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 20 (ku thuhet se Bislim Zyrapi njih nënshkrimin e gjatë dhe të shkurtër të Ramush Haradinajt).

⁴⁵¹ Doja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 64.

⁴⁵² *Shih* më lart, para. 74.

⁴⁵³ Prova materiale P272. *Shih* më lart, para. 77.

“emërohet zëvendëskomandant i Zbulimit [të UÇK-së] për Shtabin Operativ të Rrafshit të Dukagjinit”.⁴⁵⁴ Për më tepër, Faton Mehmetaj nuk ishte i pranishëm gjatë diskutimeve lidhur me formimin e policisë ushtarake të UÇK-së në mbledhjen e 25 korrikut 1998.⁴⁵⁵ Dhoma rikujton se gjatë mbledhjes së Shtabit Operativ të Dukagjinit të datës 25 korrik 1998, u theksua se Shtabi i Përgjithshëm kishte miratuar emërimin e Fadil Nimonajn (me pseudonimin “Tigri”) si komandant i policisë ushtarake të UÇK-së.⁴⁵⁶

121. Kur Dëshmitari 17 u pyet për marrëdhëniet midis Faton Mehmetajt dhe Ramush Haradinajt, ai u përgjigj se “fillimisht thuhej se ai ishte në krye të policisë ushtarake në shtabin e Gllogjanit dhe më pas, me formimin e Komandës së Njësuar në Rrafshin e Dukagjinit, ai u emërua përfaqësues politik i Rrafshit të Dukagjinit”.⁴⁵⁷ Dëshmitari 17 gjithashtu theksoi se “Faton Mehmeti”, i cili “i raportonte drejtpërdrejt Ramush Haradinajt” dhe “punonte në të njëjtën zyrë me të në Gllogjan” ishte “komandanti i policisë ushtarake” apo “shef i Policisë Ushtarake të UÇK-së për Gllogjanin” dhe se pas “Faton Mehmetit” shef u bë Idriz Balaj.⁴⁵⁸ Dhoma vëren se Dëshmitari 17 nuk mori pjesë në asnjë nga mbledhjet ku u diskutua formimi i policisë ushtarake, gjegjësisht në mbledhjet e 21 qershorit dhe 25 korrikut 1998,⁴⁵⁹ dhe se nuk mund të jepte dëshmi të drejtpërdrejtë në lidhje me këto ngjarje.⁴⁶⁰

122. Dhoma hedh poshtë argumentin e Prokurorisë se Faton Mehmetaj ishte “komandant i policisë ushtarake në zonën e Dukagjinit” dhe konkludon se provat nuk vërtetuan jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm nëse dhe çfarë roli luajti Faton Mehmetaj në kuadër të policisë ushtarake të UÇK-së.

123. Për sa u përket rolit dhe detyrave të policisë ushtarake të UÇK-së, Dhoma mori dëshminë e Pjetër Shalës, pjesëtar i policisë ushtarake të UÇK-së gjatë periudhës së Aktakuzës.⁴⁶¹ Pjetër Shala

⁴⁵⁴ Prova materiale P271. *Shih* më lart, para. 77.

⁴⁵⁵ Prova materiale P81, f. 1. Prova tregon se ai ishte i ftuar për mbledhje por nuk kishte ardhur, Prova materiale P81, f. 1.

⁴⁵⁶ *Shih* më lart, para. 117. *Shih* gjithashtu Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 72, 88, 91. Megjithatë, Dhoma vëren se gjatë dëshmisë së tij, Cufë Krasniqi theksoi se dikur rreth gushtit 1998 Fadil Nimonaj zëvendësoi Hasan Gashin, komandantin ushtarak të UÇK-së në Lugun e Baranit. *Shih* më lart, para. 114.

⁴⁵⁷ Dëshmitari 17, Prova materiale P343 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7808.

⁴⁵⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 62, 71.

⁴⁵⁹ Prova materiale P81, f. 1; P190, p. 1.

⁴⁶⁰ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁴⁶¹ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9956. Megjithëse Pjetër Shala deklaroi qartë se kishte qenë pjesëtar i UÇK-së, Dhoma vëren se dëshmia e tij në lidhje me anëtarësimin e tij në policinë ushtarake të UÇK-së është qëllimisht dredhuese për shkak se

pranoi se policia ushtarake e UÇK-së “nuk ishte shumë e organizuar apo moderne”⁴⁶² dhe mendonte se u emërua pjesëtar i saj nga Hashim Thaçi dhe se Lahi Brahimaj ndikoi në emërimin e tij.⁴⁶³ “Rregullorja Ndërkombëtare e Përkohshme e Policisë Ushtarake (PU) të UÇK-së”, parashtronte detyrat dhe të drejtat e policisë ushtarake të UÇK-së dhe u nënshkrua nga komandanti Gjelal Hajda (komandant i shtabit vendor të Rahovecit), Nazmi Brahimaj (komandant i shtabit vendor) dhe Pjetër Shala.⁴⁶⁴ Të drejtat dhe detyrat e paraqitura në këtë dokument, midis të tjerash, janë: “mbajtja e disiplinës ushtarake” dhe “ndërhyrja në [...] raste të shkeljes së rregullave dhe disiplinës ushtarake”.⁴⁶⁵ Pjesëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së duhej t’i raportonin komandantit të tyre ose “Komandantit të Shtabit Vendor”.⁴⁶⁶ Dhoma vëren se “Rregullorja Ndërkombëtare e Përkohshme e Policisë Ushtarake (PU) të UÇK-së” mban datën 22 janar 2005. Megjithëse sipas dëshmisë së dëshmitarit ky dokument u nënshkrua dikur në mars apo prill 1998, dëshmia e tij është e paqartë dhe nuk përcakton kohën e saktë kur u nënshkrua ose u zbatua dokumenti faktikisht.⁴⁶⁷ Rrjedhimisht, Dhoma i jep vlerë të pakët këtij dokumenti.

124. Pjesëtarët e policisë ushtarake mbanin këmisha dhe pantallona të zeza dhe kishin emblemën e UÇK-së në supin e majtë.⁴⁶⁸ Cufë Krasniqi shpjegoi se kishte edhe civilë që vishnin uniforma të zeza për shkak se “mendonin se dukeshin më interesante” dhe pranoi se kjo ishte edhe shenjë se e përkrahnin UÇK-në.⁴⁶⁹ Sipas Dëshmitarit 17, emblema e policisë ushtarake të UÇK-së dallohej nga ajo e Shqiponjave të Zeza dhe kishte mbishkrimin “Policia Ushtarake” dhe/ose “UÇK”.⁴⁷⁰ Pjetër Shala dëshmoi se ai ndonjëherë vishte uniformë kamuflimi për shkak se nuk ishin rreptësisht të detyruar të mbanin një uniformë të përcaktuar.⁴⁷¹ Dhoma konkludon se pjesëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së zakonisht mbanin uniforma të zeza dhe dalloheshin qartë nga mbishkrimi “Policia Ushtarake” në supin e majtë.

ai përshkruan një “të ashtuquajtur polici ushtarake” pjesëtar i të cilës me sa duket ishte edhe ai vetë, Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9946, 9956.

⁴⁶² Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9956.

⁴⁶³ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9961. Mirëpo në një incizim zanor të intervistës së Prokurorisë me Pjetër Shalën që u dëgjua gjatë gjykimit të parë, ai theksoi se personi që e emëroi në policinë ushtarake të UÇK-së ishte Hashim Thaçi, Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9958-9959, 9961.

⁴⁶⁴ Prova materiale P72; Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9962-9963.

⁴⁶⁵ Prova materiale P72.

⁴⁶⁶ Prova materiale P72.

⁴⁶⁷ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9963-9964.

⁴⁶⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 72; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 62. *Shih* gjithashtu Vesel Dizdari, Prova materiale P467, para. 17.

⁴⁶⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5831-5832.

⁴⁷⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 62. *Shih* më lart, para. 106.

⁴⁷¹ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9974.

IV. NGJARJET NË TERRITORIN E ZONËS SË DUKAGJINIT TË UÇK-SË NË PERIUdhËN MARS-SHTATOR 1998

A. Ngjarjet në territorin e Zonës së Dukagjinit gjatë periudhës mars-qershor 1998

1. Kontrolli territorial dhe operacionet e forcave serbe

125. Rëndësia strategjike e zonës së Dukagjinit⁴⁷² duke marrë parasysh palët e ndryshme në arenën e luftimeve në vitin 1998—forcat serbe të përbëra nga UJ-ja dhe MPB-ja nga njëra anë dhe UÇK-ja në anën tjetër—qëndronte pikërisht në faktin se ajo shtrihej në rrugën kryesore të furnizimit të UÇK-së nga Shqipëria për në Kosovë.⁴⁷³

126. Në kuadër të forcave të UJ-së asokohe në zonën e Dukagjinit vepronte Brigada e Motorizuar 125 e cila ishte në varësinë e Korpusit të Prishtinës.⁴⁷⁴ Gjatë gjithë vitit 1998, zona e përgjegjësisë e Brigadës së Motorizuar 125 mbulonte disa komuna, ndër të cilat Klinën, Istogun, Pejën dhe Deçanin.⁴⁷⁵ Për shkak të problemeve në kufirin shtetëror me Shqipërinë numri i forcave të Brigadës së 125 u rrit nga 1.400 pjesëtarë në janar të 1998 në 1.880 nga fundi i vitit.⁴⁷⁶ Në prill 1998 apo pas kësaj kohe, Brigada e Motorizuar 125 ngriti postëkomandën pararojë në Pejë për shkak të grupeve të organizuara dhe të armatosura të shqiptarëve kosovarë në gjithnjë e më shumë fshatra të cilat sulmonin pikat e kontrollit të MPB-së.⁴⁷⁷ Grupi i luftimit 2 i Brigadës së Motorizuar 125 ishte gjithashtu i vendosur në Pejë.⁴⁷⁸ Në prill dhe maj 1998, numri i forcave në postëkomandën pararojë në Pejë ishte rreth 400.⁴⁷⁹ Më 21 prill 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës ngriti një postëkomandë pararojë në Gjakovë me rreth 10-15 pjesëtarë.⁴⁸⁰ Komanda e Korpusit të Prishtinës të UJ-së me në krye gjeneral Nebojsa Pavkoviçin ishte e vendosur në Prishtinë.⁴⁸¹ Njësitë në të

⁴⁷² Për shtrirjen gjeografike të rajonit të Dukagjinit dhe të Zonës Operative të Dukagjinit, *shih* më lart, para. 42.

⁴⁷³ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2954; John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1888-1889, 1897, 1929, 1946-1947; Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 33; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9333-9334; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 61.

⁴⁷⁴ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 4.

⁴⁷⁵ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 5.

⁴⁷⁶ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9308, 9312; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 11.

⁴⁷⁷ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9316. *Shih* gjithashtu Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 46.

⁴⁷⁸ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9310.

⁴⁷⁹ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9316.

⁴⁸⁰ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9317-9318; Prova materiale D134.

⁴⁸¹ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 4.

ashtuquajturën zonë e Metohisë, e cila mbulonte Pejën, Prizrenin, Gjakovën, dhe batalionet kufitare numëronin gjithsej 3.000 deri në 4.000 pjesëtarë.⁴⁸²

127. Cufë Krasniqi, pjesëtar i UÇK-së në atë kohë, theksoi se nga marsi 1998 forcat serbe u vendosën në majën e kodrës Suka e Baballoqit gjë që u mundësoi pamje të plotë të fshatrave përreth, ndër të cilat fshati Baballoq, Gramaqel, Rastavicë, Gllogjan, Irzniq, Ratishë dhe Prilep, në komunën e Deçanit.⁴⁸³ Forcat serbe ishin të vendosura edhe në Podin e Gështenjave në komunën e Gjakovës.⁴⁸⁴ Në mars 1998, forcat serbe u vendosën edhe në Sukën e Cërmjanit në pjesën lindore të liqenit të Radoniqit⁴⁸⁵ dhe në Sukën e Biteshit, në komunën e Gjakovës.⁴⁸⁶

128. Sipas dëshmisë së Cufë Krasniqit, artileria serbe ishte e vendosur në Kërsticë, në komunën e Pejës dhe në Volljakë në komunën e Klinës.⁴⁸⁷ Pozicionet e forcave serbe ndodheshin më lart dhe që andej i granatonin fshatrat e tjera.⁴⁸⁸ Sipas Cufë Krasniqit, nga fundi i marsit 1998, nga pozicionet e artilerisë, forcat serbe granatonin vetëm fshatrat e zonës së Dukagjinit.⁴⁸⁹ Ai theksoi se forcat serbe ishin gjithashtu të vendosura në Hulaj, në komunën e Deçanit. Sipas tij, ato nuk “guxonin” të hynin në fshatrat e Lugut të Baranit në komunën e Pejës, por “vetëm” i granatonin.⁴⁹⁰ Skënder Rexhahmetaj, komandant i UÇK-së në atë zonë, theksoi se nga mesi i prillit e deri në fund të majit 1998, forcat serbe në Kosovën perëndimore posedonin shumë më tepër armë zjarri se mbrojtjet e organizuara të shqiptarëve kosovarë nëpër fshatra.⁴⁹¹ Pozicionet e forcave serbe në zonën rreth liqenit të Radoniqit dhe kontrolli mbi atë zonë shtjellohen më vonë në Aktgjykim.⁴⁹²

129. Cufë Krasniqi shënoi në një hartë disa prej pozicioneve të forcave serbe dhe disa fshatra serbe të Kosovës gjatë marsit 1998, por jo të gjitha.⁴⁹³ Edhe John Crosland-i, atasheu ushtarak

⁴⁸² Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9317-9318.

⁴⁸³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 30, 46. *Shih* gjithashtu Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 11.

⁴⁸⁴ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 11.

⁴⁸⁵ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 11; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5812-5813.

⁴⁸⁶ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 11-12; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5812-5813.

⁴⁸⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 47.

⁴⁸⁸ Bislim Zyrapi, T. 727-729; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3029; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 11; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5812-5813.

⁴⁸⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 50. *Shih* gjithashtu Skënder Rexhahmetaj, T. 1064.

⁴⁹⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 56.

⁴⁹¹ Skënder Rexhahmetaj, T. 1042, 1044.

⁴⁹² *Shih* më poshtë, para. 326-329.

⁴⁹³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5745-5747, 5750; Prova materiale P57 (shënimet me të kuqe).

britanik në Republikën e Jugosllavisë në atë kohë,⁴⁹⁴ shënoi në hartë pozicionet e forcave serbe në zonën e Dukagjinit.⁴⁹⁵

130. Provat sugjerojnë se forcat serbe kishin nën kontroll qytetet e mëdha, kurse UÇK-ja kontrollonte fshatrat. Bislim Zyrapi, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që nga qershori i vitit 1998,⁴⁹⁶ dëshmoi se në kohën e vizitës së tij në Zonën Operative të Dukagjinit në korrik të vitit 1998, forcat serbe kontrollinin qytetet e mëdha.⁴⁹⁷ John Crosland-i dëshmoi se në Pejë, Deçan dhe Gjakovë “ishin të përqëndruara forca të shumta ushtarake serbe”.⁴⁹⁸

131. Sipas provave, në vitin 1998 në zonën e Dukagjinit forcat serbe kontrollonin rrugët kryesore,⁴⁹⁹ kurse UÇK-ja fshatrat dhe rrugët dytësore në brendësi të zonës.⁵⁰⁰ Cufë Krasniqi theksoi se me përjashtim të Kërstocit në komunën e Pejës dhe Volljakës në komunën e Klinës ku ishte e vendosur artileria serbe,⁵⁰¹ fshatrat e tjera në komunën e Pejës, Deçanit dhe Klinës ishin nën kontrollin e UÇK-së.⁵⁰² Sipas John Crosland-it, në rajonin e zonës (“nga Peja në Klinë, më tej në Gjakovë e mbrapsht në Pejë”), forcat serbe dilnin jashtë rrugës për pesë apo gjashtë kilometra për të bërë kontroll dhe pastaj tërhiqeshin për shkaqe sigurie.⁵⁰³

132. Në përgjithësi kontrolli territorial ishte jashtëzakonisht i ndryshueshëm në mbarë territorin meqenëse asnjë nga palët nuk kishte kontroll të plotë mbi një territor, me përjashtim të qyteteve me

⁴⁹⁴ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2925-2926.

⁴⁹⁵ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3018; Prova materiale P14 (MPB-ja dhe UJ-ja të shënuara me të kaltër).

⁴⁹⁶ Bislim Zyrapi, T. 687, 695; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 16; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 12-13.

⁴⁹⁷ Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3420.

⁴⁹⁸ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2954.

⁴⁹⁹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3029; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5746; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 47, 90 (prill-gusht 1998); Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6687-6688, 6699-6701; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 9, 15.

⁵⁰⁰ *Shih* John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3028-3029; Prova materiale P20, f. 2; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5746; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 47, 90; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9401 (ku thuhet se njësitë e ushtrisë nuk shkuan fare në lindje të rrugës Pejë-Gjakovë në zonën e Dukagjinit deri dikur në korrik 1998); Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 37-38.

⁵⁰¹ *Shih* më lart, para. 128.

⁵⁰² Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 48.

⁵⁰³ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3029.

garnizone të cilat vazhduan të ishin nën kontrollin e forcave serbe.⁵⁰⁴ Dëshmitari 28, i cili udhëtonte nëpër Kosovë nga 7 deri në 10 ditë për çdo muaj gjatë vitit 1998,⁵⁰⁵ theksoi se gjatë “disa periudhave kohore” në vitin 1998, gjendja ushtarake ishte “e ngrirë”, do të thotë se nuk mund të flitej për një “vijë fronti”, por se forcat e UÇK-së dhe ato serbe kontrollonin territore që ishin 100 deri në 200 metra larg njëri-tjetrit.⁵⁰⁶ Sipas Bislim Zyrapi, midis marsit dhe shtatorit 1998, në zonën në anën perëndimore të rrugës kryesore në afërsi të kufirit u zhvilluan luftime të ashpra.⁵⁰⁷ John Crosland-i dëshmoi se gjatë verës së 1998, forcat serbe disa herë pushtuan fshatin Irzniq.⁵⁰⁸ Sipas John Crosland-it, edhe Prilepi ishte një territor për të cilin luftohej.⁵⁰⁹ Sipas dëshmisë së Dëshmitarit 28, përafërsisht nga 19 prilli 1998 e deri më 30 prill 1998, forcat serbe kontrollonin objektin e “Agrokombinatit”⁵¹⁰ dhe lagjen e re në Baballoq.⁵¹¹

133. John Crosland-i komentoi një telegram të asaj kohe të datës 26 mars 1998 ku thuhej se forcat serbe “nuk patrulluan jashtë” pikave të kontrollit të automjeteve të vendosura në pika të ndryshme strategjike dhe për këtë arsye thuajse “nuk kishin kontroll rreth e rrotull tyre”. Ai erdhi në përfundimin se megjithëse në atë zonë forcat serbe ishin numerikisht të shumta, “faktikisht kishin kontroll të pakët nga aspekti taktik dhe strategjik”.⁵¹²

134. Në lidhje me forcat e MPB-së në atë zonë në vitin 1998, John Crosland-i komentoi telegramin e 26 marsit 1998 se “ndoshta ishte një vlerësim i matur” që në atë kohë në Kosovë u dislokuan rreth 8.000-10.000 pjesëtarë të MPB-së, duke përfshirë edhe forcat e ndërhyrjes së shpejtë të JSO-së dhe SAJ-së.⁵¹³ Nebojsa Avramović, specialist serb i kriminalistikës,⁵¹⁴ deklaroi se SPB-ja e Gjakovës e cila përfshinte Gjakovën si kryeshtab dhe Deçanin si nënshtab, nuk u mbyll asnjëherë gjatë vitit 1998.⁵¹⁵ Kishte tre stacione policore: Juniku dhe Irzniqi në komunën e Deçanit

⁵⁰⁴ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2941-2943, 2962, 3030, 3130, 4721; John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1876, 1942; Prova materiale P14.

⁵⁰⁵ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 11, 15.

⁵⁰⁶ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10299.

⁵⁰⁷ Bislim Zyrapi, T. 713, 723.

⁵⁰⁸ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3108, 4671, 4673, 4721.

⁵⁰⁹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3108.

⁵¹⁰ Fjala “Kombinat” zakonisht i referohet shoqatës së bizneseve të disa njerëzve në strukturën socialiste të tregut).

⁵¹¹ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10179.

⁵¹² John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1876-1879, 1895-1896, 1917; Prova materiale D119, f. 2.

⁵¹³ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1876-1878; Prova materiale D119, f. 1.

⁵¹⁴ Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 7.

⁵¹⁵ Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 8, 18; Prova materiale P454. *Shih* gjithashtu Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 46.

dhe Ponosheci në komunën e Gjakovës.⁵¹⁶ Stacioni policor i Junikut dhe ai i Irzniqit u mbyllën afërsisht prej prillit deri në shtator të vitit 1998.⁵¹⁷ Sipas Nebojshta Avramoviqit, arsyeja për mbylljen e tyre ishte bllokimi i rrugës prej UÇK-së gjë që e bëri të pamundur depërtimin deri tek këto stacione policore. Për më tepër, policët u tërhoqën për shkak të sulmeve të vazhdueshme kundër tyre.⁵¹⁸

135. Në lidhje me periudhën para 24 marsit 1998, Cufë Krasniqi dëshmoi se UÇK-ja ishte thjesht një forcë guerilase e paaftë të ndalonte patrullimet e forcave serbe në zonën e Dukagjinit apo në Lugun e Baranit në komunën e Pejës.⁵¹⁹ Nebojshta Avramoviqi shënoi në hartë pjesët e “pasigurta për serbët” dhe për policinë në zonën e tij të përgjegjësisë, në atë masë sa për mendimin e tij, çdokush që hynte atje, rrezikonte jetën.⁵²⁰ Sipas dëshmisë së tij, këto zona vazhduan të ishin të “pasigurta për policinë” deri në shtator 1998 kur forcat serbe morën kontrollin mbi këto zona.⁵²¹ Branko Gajiqi theksoi se midis marsit dhe shtatorit 1998, forca të MPB-së u dislokuan në zonën në lindje të rrugës kryesore Pejë-Gjakovë” dhe kryenin “patrullime në zonat që nuk ishin nën kontrollin e tyre”.⁵²² Dëshmitari 69 dëshmoi se midis marsit dhe shtatorit 1998, në zonën e përgjegjësisë të SPB-së së Gjakovës, policia nuk mund të shkonte në Ratishë të Epërme, Ratishë të Poshtme dhe në Gillogjan në komunën e Deçanit, si dhe në Jabllanicë të komunës së Gjakovës.⁵²³

136. Në lidhje me praninë e UÇK-së në zonë, Dhoma më herët theksoi se në disa fshatra u formua mbrojtja e organizuar e fshatit.⁵²⁴ Shumë dëshmitarë e përshkruan rrugën kryesore Gjakovë-Pejë si vijë të frontit të UÇK-së.⁵²⁵ Sipas dëshmisë së Nebojshta Avramoviqit, pikat e kontrollit të

⁵¹⁶ Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 18.

⁵¹⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 48; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 41-43; Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8992; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7068; Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 18.

⁵¹⁸ Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 18.

⁵¹⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 38.

⁵²⁰ Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 9, 15; Prova materiale P455 (shënimet me të verdhë). *Shih* gjithashtu Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 28 (pas 24 marsit 1998, policia nuk kishte mundësi hyrjeje të menjëhershme në zonën përreth liqenit të Radoniqit apo në komunën e Deçanit në tërësi dhe në një pjesë të komunës së Gjakovës).

⁵²¹ Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6687-6688; Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 15; Prova materiale P455.

⁵²² Branko Gajiqi, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9721, 9725; *shih* gjithashtu Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 37-38.

⁵²³ Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9864-9865.

⁵²⁴ *Shih* më lart, para. 43-46, 49-51, 53.

⁵²⁵ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2940-2942; Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10300; Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 9, 13; Prova materiale P455 (me të portokalltë është shënuar rruga kryesore, me të kaltër vijat e frontit të UÇK-së në të dyja anët e rrugës).

UÇK-së ndodheshin në rrugët dytësore, në të dy anët e rrugës kryesore Gjakovë-Pejë. Bunkerët dhe istikamet e UÇK-së shtriheshin thuajse paralelisht me këtë rrugë.⁵²⁶ Dragan Zhivanoviqi, shefi i atëhershëm i shtabit të komandës së Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së,⁵²⁷ më 14 maj 1998 raportoi nga postëkomanda pararojë në Pejë se në Llukë të Epërme në komunën e Deçanit, UÇK-ja kishte një pikë kontrolli të ngjashme me postbllloqet policore.⁵²⁸

137. John Crosland-i shënoi në hartë zonën ku ishin të pranishme forcat e UÇK-së dhe zonën brenda zonës së Dukagjinit ku UÇK-ja kishte ndikim të madh.⁵²⁹ Cufë Krasniqi shënoi në hartë pozicionet e UÇK-së në fund të marsit 1998.⁵³⁰

138. Në lidhje me kontrollimin e rrugëve, Dragan Zhivanoviqi theksoi se përgjegjëse për kontrollimin e rrugëve në Kosovën perëndimore ishte MPB-ja. Sipas tij, në gjysmën e parë të vitit 1998, në përgjigje të veprimeve të UÇK-së, MPB-ja ngriti pika kontrolli përgjatë të gjitha rrugëve kryesore, si për shembull në rrugën Mitrovicë-Pejë-Gjakovë-Prizren dhe në rrugën Pejë- Prishtinë ku kishte vazhdimisht prani të forcave të MPB-së.⁵³¹ Forca të shumta të sigurimit serb u vendosën përgjatë rrugës Pejë-Gjakovë.⁵³² Sipas dëshmisë së Dragan Zhivanoviqit, sulmet e UÇK-së kundër këtyre pikave të kontrollit u shpeshuan “në muajt para qershorit 1998”, gjatë të cilave u vranë ose u plagosën shumë pjesëtarë të forcave të MPB-së.⁵³³

139. Kontrollimi i rrugës Pejë-Gjakovë ishte mjaft i rëndësishëm meqenëse forcat serbe nuk kishin kontroll mbi zonën malore në afërsi të kufirit me Shqipërinë. Për këtë arsye ato vendosën “një kufi të dytë” përgjatë kësaj rruge.⁵³⁴

140. Prania e UÇK-së përgjatë kësaj rruge shkaktoi probleme dhe pengesa nga më të ndryshmet gjatë periudhës mars-shtator 1998.⁵³⁵ Gjithsesi, John Crosland-i vlerësoi se “kontrollin kryesor”

⁵²⁶ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 9, 13.

⁵²⁷ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 3.

⁵²⁸ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 37-38.

⁵²⁹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3018; Prova materiale P10 (me të zezë është shënuar zona e pranisë së forcave të UÇK-së); P14 (me të kuqe është shënuar zona e ndikimit të UÇK-së).

⁵³⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5746, 5750; Prova materiale P57 (me të kaltër janë shënuar pozicionet e UÇK-së në fund të marsit 1998).

⁵³¹ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 30-31. *Shih* gjithashtu Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9712.

⁵³² John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2941-2942, 2961-2962; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5812-5813.

⁵³³ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 31.

⁵³⁴ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2940, 4712.

⁵³⁵ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2941-2943 (sulmet me snajper të UÇK-së në fillim të vitit 1998), 2951-2952 (prani grupesh të vogla prej 10-15

mbi rrugë e kishin forcat serbe dhe se në fillim të marsit 1998, në disa vende, në veçanti rreth Irzniqit dhe Prilepit në komunën e Deçanit, UÇK-ja “mund të ketë pasur pak më shumë kontroll për periudha të caktuara kohore”.⁵³⁶ Sipas tij, zhvilloheshin luftime thuajse të përditshme për rrugën nga Peja dhe Deçani për në Gjakovë dhe Prizren.⁵³⁷ Bislim Zyrapi theksoi se rruga Prizren-Gjakovë-Pejë ishte vazhdimisht nën kontrollin e forcave serbe, me përjashtim të disa periudhave të shkurtra brenda periudhës mars-shtator 1998.⁵³⁸ Sidoqoftë, rruga nuk ishte e sigurtë për forcat e UJ-së dhe MPB-së.⁵³⁹

141. Dëshmitari 28 theksoi se gjatë 10 ditëve të fundit të prillit 1998, për shkak të përlëshjeve midis forcave serbe dhe UÇK-së, shërbimi i autobusëve përgjatë rrugës Prishtinë-Gjakovë-Pejë nuk funksiononte.⁵⁴⁰ Dëshmitari theksoi se nëpër rrugët kryesore nuk kishte thuajse aspak qarkullim të automjeteve civile dhe se u shtua numri i postblloqeve policore.⁵⁴¹

142. Sipas Nebojsa Avramoviqit, në maj 1998, policia ndërmori operacion për zhbllokimin e rrugës kryesore Pejë-Gjakovë.⁵⁴² Shefi i shtabit të komandës së Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-

pjesëtarësh të UÇK-së në rrugë në periudhën mars-korrik 1998 në zonën e Irzniqit, Prilepit dhe në rrethin e Gjakovës), T. 2961-2962 (UÇK-ja ndalonte trafikun, kryente kryesisht kontrolle të makinave dhe nuk kishte ndonjë postbllok në periudhën mars-korrik 1998); Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 37 (UJ-ja nuk mund ta përdorte rrugën në maj dhe qershor të vitit 1998), para. 89 (UÇK-ja filloi me operacione sporadike përgjatë rrugës Gjakovë-Pejë); Prova materiale P116, para. 2; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 9, 16 (UÇK bllokoi disa herë rrugën); Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 29 (UÇK-ja herë pas herë bllokonte rrugën midis Gjakovës dhe Deçanit dhe e bllokoi plotësisht më 23 maj 1998 për 10 ditë me radhë); Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 29 (UÇK-ja bllokoi rrugën); Prova materiale D16, para. 2 (rruga Deçan-Pejë ende e mbyllur më 3 qershor 1998).

⁵³⁶ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2941-2943, 2948-2949, 2962.

⁵³⁷ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2940-2942, 4612-4613.

⁵³⁸ Bislim Zyrapi, T. 713-714.

⁵³⁹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4720; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9333-9334; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 29; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6687-6688; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 15; Prova materiale P455.

⁵⁴⁰ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 55.

⁵⁴¹ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10197-10198; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 63.

⁵⁴² Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 9, 16. Për mendimin e John Crosland-it, urdhri i Brigadës së Motorizuar 125 i datës 16 maj 1998 për operacion të koordinuar me MPB-në me qëllim sigurimin e rrugëve të furnizimit të njërive të UJ-së paraqiste një urdhër për sigurimin e rrugës kryesore Gjakovë-Pejë, John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4711-4712.

së dhe më pas komandant i asaj brigade në atë kohë, Dragan Zhivanoviq⁵⁴³ dëshmoi se më 28 maj 1998, koloneli Llazareviq urdhëroi Grupin e Luftimit 3 të Brigadës së Motorizuar 125 të zhbllokonte rrugën Pejë-Deçan.⁵⁴⁴ Sipas tij, urdhri nuk u zbatua në maj, por në fund të korrikut 1998.⁵⁴⁵ Në telegramet diplomatike britanike të 6 dhe 8 qershorit 1998 u raportuan deklaratat e MPB-së se operacioni kryesor në rrugën Pejë-Gjakovë ishte kryer me sukses dhe se grupet e armatosura të shqiptarëve kosovarë që u përpoqën t'a bllokoni rrugën u asgjësuan.⁵⁴⁶

143. Për sa i përket kronologjisë së ngjarjeve në zonën e Dukagjinit në periudhën përkatëse të vitit 1998, sulmet e forcave serbe kundër shtëpive të familjes Ahmeti më 28 shkurt 1998 dhe të familjes Jashari më 5 mars 1998, gjatë të cilit u vra Adem Jashari, patën ndikim të madh mbi popullatën shqiptare kosovare që jetonte përtej fshatrave Likoshan dhe Prekaz të komunës së Skënderajt ku ndodhën këto dy sulme.⁵⁴⁷ Më 28 shkurt 1998, policia sulmoi gjithashtu shtëpitë e familjeve Sejdiu dhe Nebiu në Qirez, në komunën e Skënderajt. Gjatë sulmit u vranë civilë shqiptarë kosovarë.⁵⁴⁸ Sulmet patën për pasojë shumë të vrarë, duke përfshirë pleq, gra e fëmijë.⁵⁴⁹

144. Dhoma mori prova lidhur me shkëmbim zjarri midis forcave serbe dhe UÇK-së në shtëpitë e familjes Haradinaj më 24 mars 1998. Shtëpitë e familjes Haradinaj ndodheshin përgjatë rrugës Gramaqel-Gllogjan, në kufirin midis fshatrave Gllogjan dhe Dubravë, në komunën e Deçanit.⁵⁵⁰

⁵⁴³ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 3.

⁵⁴⁴ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9406; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 84; Prova materiale D61, f. 1; *shih* gjithashtu urdhrat vijues, Prova materiale D62, f. 1; D63; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 85-86.

⁵⁴⁵ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9406-9408; Prova materiale D16, para. 2.

⁵⁴⁶ Prova materiale D19, para. 1; D20, para. 1-2.

⁵⁴⁷ Skënder Rexhahmetaj, T. 1031, 1034; Bislim Zyrapi, T. 696; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3098-3099; John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1865-1866; Prova materiale P17, para. 1-3; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 38; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3199, 3201-3206; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 11; Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10174, 10205, 10295; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 17-20; Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 619-620, 623.

⁵⁴⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 17-18.

⁵⁴⁹ Skënder Rexhahmetaj, T. 1031; Dëshmitari 80, T. 2679; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3102, 2932-2933, 2935; John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1863; Jakup Krasniqi, Prova materiale P63 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5044; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3302; Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10253-10254; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 17, 22.

⁵⁵⁰ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1845, 1847, 1850-1852, 1908-1909; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 30; Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1845, 1850-1852; Mijat Stojanoviq,

Shtëpitë e familjes Haradinaj janë rreth 150-200 metra larg shtëpive të familjes Stojanoviq.⁵⁵¹ Në vitin 1998, në fshatin Dubravë jetonin 27 familje. Familja Stojanoviq ishte e vetmja familje serbe apo malazeze;⁵⁵² të gjitha familjet e tjera ishin shqiptarë kosovarë.⁵⁵³

145. Dhoma mori prova mospërputhëse lidhur me shkëmbimin e zjarrit midis forcave të MPB-së dhe personave në shtëpitë e familjes Haradinaj që filloi më 24 mars 1998, rreth orës 10:30 në kufirin midis fshatrave Gllogjan dhe Dubravë.⁵⁵⁴ Nga provat e marra mund të konkludohet se duke filluar në orën 10:30 të datës 24 mars 1998, pati shkëmbim zjarri midis forcave serbe që shtinin nga oborri i familjes Stojanoviq dhe pjesëtarëve të UÇK-së që shtinin nga shtëpitë e familjes Haradinaj. Dikur rreth orës 11:00 apo 12:00 luftimet kaluan nga shtëpitë e familjes Haradinaj në fshatin Gllogjan.⁵⁵⁵ Luftimet vazhduan deri rreth orës 20:00 ose 21:00.⁵⁵⁶ Bazuar në provat nuk mund të konkludohet nëse shkëmbimin e zjarrit e filluan forcat e MPB-së ose personat në shtëpitë e familjes Haradinaj.

Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2025-2027, 2112-2113; Prova materiale. P411, f. 2; P412; P413, f. 2; P415.

⁵⁵¹ Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1990; Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1846-1847, 1850-1852, 1946-1949; Prova materiale. P412; P415.

⁵⁵² Dragosllav Stojanoviqi tha se ishte “serb, malazez” (Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1845), kurse nëna e tij deklaroi se ishte malazeze, Marijana Angjelković, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 594. Veselin Stijović, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2183-2184.

⁵⁵³ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1846.

⁵⁵⁴ Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10253; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 31-34; Radovan Zllatković, P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6864-6866, 6868-6872, 6876-6877, 6879, 6899-6900, 6902, 6915; Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 22-23, 27; Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1858-1859, 1968-1970; Zoran Stijović, Prova materiale P121, para. 41; Prova materiale P31, para. 1; Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 33; Marijana Angjelković, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 502, 646-647; Prova materiale P411, f. 2; P414, f. 2; P442, f. 33-35, 40; P446, f. 16-17, 37, 40; P447, f. 17-18, 20.

⁵⁵⁵ Radovan Zllatković, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6865, 6868, 7007; Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 23, 27; Prova materiale P384, f. 1, 9; Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1967-1968; Prova materiale P414, f. 2; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2006-2007.

⁵⁵⁶ Radovan Zllatković, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6865-6866; Marijana Angjelković, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 503-504; Prova materiale P411, f. 2; P442, f. 35-36; P446, f. 37, 40; P447, f. 17-18.

146. Gjatë luftimeve, komandanti i stacionit policor të Irzniqit, Miodrag Otoviqi, u qëllua dhe u vra rreth 100 metra larg shtëpive të familjes Haradinaj.⁵⁵⁷ U tha se policë të tjerë të MPB-së u plagosën.⁵⁵⁸ Ramush Haradinaj u plagos dhe u çua në shtëpinë e Lahi Brahimajt në Jabllanicë.⁵⁵⁹

147. Dhoma mori prova se gjatë hetimit që kryen autoritetet serbe, në shtëpinë e Ramush Haradinajt u gjetën bomba dore, mina kundërtanke, pushkë, një mitraloz i lehtë, sasi e madhe municioni, uniforma me emblemën e UÇK-së, çizme dhe pajisje të tjera, uniforma kamuflimi prej pëlhure liri dhe gëzhoja.⁵⁶⁰ Dëshmitarë gjithashtu dëshmuan se gjatë luftimeve, nga shtëpitë e familjes Haradinaj u hodhën predha, bomba dore dhe u hap zjarr me automatikë.⁵⁶¹ U morën gjithashtu prova se gëzhojat e plumbave që u gjetën në oborrin dhe katin e dytë të shtëpisë së Haradinajt ishin të njëjta me ato që u gjetën në vendet e krimeve në liqenin e Radoniqit.⁵⁶²

148. Zoran Stijoviqi theksoi se në vendbanimin e Haradinajt hetuesit serbë gjithashtu gjetën lista me emra të shqiptarëve kosovarë të cilët sipas autoriteteve serbe dyshohej se bashkëpunonin me pjesëtarë të forcave të sigurimit serb dhe ishin në shënjestër.⁵⁶³ Këto lista shtjellohen në hollësi më vonë në Aktgjykim.⁵⁶⁴

149. Luftimet në shtëpitë e familjes Haradinaj ngjallën frikë tek popullata shqiptare kosovare dhe e bënë atë më të vëmendshme për “represionin” serb.⁵⁶⁵ Sulmet kundër familjeve Ahmeti, Jashari dhe Haradinaj motivuan shumë njerëz që t’i bashkoheshin UÇK-së.⁵⁶⁶ Pas këtyre sulmeve,

⁵⁵⁷ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6867-6870, 6872, 6875-6876, 6879; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 22; Prova materiale P384, f. 8-9; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 32; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P450 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6723-6725; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 184, 188.

⁵⁵⁸ Prova materiale P151, f. 2; P442, f. 33-34; P446, f. 16-17; P447, f. 17; P384, f. 8.

⁵⁵⁹ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6868; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 26-28; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3272-3273; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 8; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 19, 22; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 41.

⁵⁶⁰ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6877; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 24; Prova materiale P384, f. 7-8; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 184; Prova materiale P31, para. 1.

⁵⁶¹ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6869-6870, 6879, 6902; Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1859-1860, 1969-1970, 1972-1973; Prova materiale P411, f. 2; P413, f. 2; P414, f.2; P442, f. 35-36; P446, f. 37; P447, f. 18.

⁵⁶² Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 184.

⁵⁶³ Zoran Stijoviq, T. 570, 572-573; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 41-42.

⁵⁶⁴ *Shih* më poshtë, para. 640-643.

⁵⁶⁵ Skënder Rexhahmetaj, T. 1033-1034; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 11.

⁵⁶⁶ Skënder Rexhahmetaj, T. 1027-1028, 1030-1031, 1033-1035; Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, para. 8, Shtojca 18; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 38; Bislim Zyrapi, Prova

shqiptarët kosovarë nëpër fshatra filluan të vetorganizoheshin.⁵⁶⁷ Roli i Ramush Haradinajt gjatë luftimeve në shtëpitë e familjes Haradinaj i dha atij popullaritet edhe më të madh në Kosovë.⁵⁶⁸

150. Më 25 mars 1998, nga territori i Shqipërisë, një grup i armatosur shqiptarësh kosovarë hapi zjarr me automatikë kundër pikës kufitare Mitar Voinoviq. Sulmi u zbraps.⁵⁶⁹ Incidente të tilla përgjatë kufirit rreth kësaj kohe u bënë thuajse përditshmëri.⁵⁷⁰ Qeveria jugosllave kishte ngritur vendstrehim për refugjatë në Baballoq, në komunën e Deçanit. Aty ishin strehuar refugjatë serbë dhe malazezë.⁵⁷¹ Më 18 dhe 19 prill 1998, nga drejtimi i fshatit Baballoq apo Suka e Baballoqit banuar nga shqiptarë kosovarë, UÇK-ja sulmoi vendstrehimin në Baballoq i cili ndodhej në skaj territorit që kontrollonte UÇK-ja.⁵⁷² Sipas dëshmisë së Dëshmitarit 28, forcat serbe e rimorën atë zonë më 20 prill 1998.⁵⁷³ Refugjatë shqiptarë kosovarë i thanë Dëshmitarit 28 se duke filluar nga 19 apo 20 prilli 1998, forcat policore shtinin me armë kundër tyre nga drejtimi i Sukës së Baballoqit, Sukës së Cërmjanit, vendstrehimit në Baballoq dhe Agrokombinatit që gjendej mbrapa vendstrehimit në Baballoq”.⁵⁷⁴

151. Më 21 prill 1998, në orën 07:15, ushtarë me uniforma të UÇK-së dhe civilë të armatosur shkuan me traktorë dhe kamionë në fshatin Ratishë e Epërme në komunën e Deçanit dhe shtinë me armë në ajër mbi shtëpitë e serbëve kosovarë.⁵⁷⁵ Për pasojë, shumica e banorëve serbë kosovarë i

materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3186-3188; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 5; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 6-7, 11; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(b), 2(f); Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 7.

⁵⁶⁷ Skënder Rexhahmetaj, T. 1027-1028, 1031-1032, 1034, 1038-1039, 1046; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 5, 11; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 6-7; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(b), 2(f).

⁵⁶⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 38, 40; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 11; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P299, para. 2(f).

⁵⁶⁹ Prova materiale P31, para. 4.

⁵⁷⁰ Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 21. *Shih* gjithashtu, për shembull, Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9682-9683; Prova materiale P31, para. 4; D7, para. 3; D27, para. 3.

⁵⁷¹ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 37.

⁵⁷² Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10179-10182, 10263-10264; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 38, 40-41.

⁵⁷³ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10181.

⁵⁷⁴ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10181-10182, 10239-10240, 10243-10244, 10264; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 42. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10178, 10201-10202, 10245, 10263.

⁵⁷⁵ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10229, 10235; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10229, 10235; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 49.

braktisën shtëpitë e tyre dhe më pas UÇK-ja mori kontrollin mbi këtë fshat.⁵⁷⁶ Dëshmitarë të tjerë i thanë Dëshimtarit 28 se më 21 prill 1998 serbët kosovarë ishin larguar nga fshati Dashinoc i komunës së Deçanit dhe se më pas UÇK-ja kishte marrë kontrollin mbi atë fshat.⁵⁷⁷

152. John Crosland-i, i cili asokohe ishte në terren në Kosovë, dëshmoi lidhur me luftimet që u zhvilluan rreth Baballoqit, në zonën e Deçanit, më 22 prill 1998.⁵⁷⁸ Sipas tij, më 23 prill 1998, UJ-ja kishte praninë më të madhe dhe armatimin më të rëndë në Kosovë “që nga fillimi i krizës”. Ai theksoi se këto forca ishin përqendruar në zonat kufitare dhe se prania e tyre ishte e dukshme gjithandej.⁵⁷⁹

153. Sipas një raporti diplomatik britanik, UJ-ja kishte deklaruar se kishte marrë masa për t’iu kundërvënë depërtimit në kufirin midis RFJ-së dhe Shqipërisë të një grupi prej rreth 200 shqiptarësh të armatosur në zonën e Gjakovës.⁵⁸⁰ Ky operacion gjatë të cilit u vranë 16 shqiptarë kosovarë të armatosur filloi më 22 prill 1998 dhe ishte ende në vazhdim më 24 prill 1998.⁵⁸¹ Sipas një raporti diplomatik britanik të datës 26 prill 1998, në bazë të informacionit të një agjencie vendore të pavarur lajmesh, gjatë një operacioni policor në fshatin Glllogjan ishin vrarë tetë shqiptarë kosovarë.⁵⁸²

154. Raporti diplomatik britanik i datës 29 prill 1998 përmban vlerësimin e John Crosland-it, i cili në atë kohë rregullisht vizitonte atë zonë, se numri i forcave policore në Kosovë ishte më i lartë se në çdo periudhë tjetër të krizës deri në atë kohë dhe se edhe veprimtaria e UJ-së ishte në kulmin e saj.⁵⁸³ Në telegramet diplomatike britanike të 6 dhe 8 majit 1998 raportohej për luftime të ashpra në Ponoshec të komunës së Gjakovës, në afërsi të kufirit me Shqipërinë, të cilat kishin vazhduar edhe

⁵⁷⁶ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10228; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10228; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 48-49, 51.

⁵⁷⁷ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 51.

⁵⁷⁸ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3007; Prova materiale D5.

⁵⁷⁹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3008; Prova materiale D6.

⁵⁸⁰ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3009-3010; John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1891, 1893; Prova materiale P19, para. 1-2, 5; D8, f. 1.

⁵⁸¹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3009-3011; John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1891, 1893; Prova materiale P19, para. 1-2, 5; D8, para. 1-2, 4.

⁵⁸² John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3011-3012, 3129-3130.

⁵⁸³ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3012-3013; Prova materiale D10, para. 2; *shih* gjithashtu Prova materiale D11, para. 5.

më 8 maj 1998.⁵⁸⁴ Sipas telegramit të dytë, në orët e vona të 7 majit 1998, UJ-ja pranoi humbjen e saj të parë që nga përshkallëzimi i krizës në Kosovë dy muaj më parë, gjegjësisht vrasjen e një ushtari të UJ-së gjatë sulmit të armatosur të shqiptarëve kosovarë kundër patrullës së UJ-së në kufirin midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.⁵⁸⁵

155. Më 19 maj 1998 ose rreth kësaj date, forcat serbe sulmuan fshatin Grabanicë në komunën e Klinës. Sulmi zgjati tri ditë pas të cilit forcat serbe pushtuan fshatin.⁵⁸⁶ Në një raport të rregullt luftimi të Brigadës së Motorizuar 125 të datës 20 maj 1998 theksohet se në atë kohë MPB-ja po kryente një “operacion të madh” në fshatrat Grabanicë, Dollovë, Qeskovë, dhe Këpuz të komunës së Klinës.⁵⁸⁷ Më 24 ose 25 maj 1998, Dëshmitari 28 i pa pasojat e sulmit të MPB-së kundër Dollovës në komunën e Klinës.⁵⁸⁸ Kur iu afrua fshatit, dëshmitari hasi në postblloqe të shumta të policisë dhe dëgjoi të shtëna.⁵⁸⁹ Me të mbërritur në fshat, dëshmitari pa efektiva të policisë serbe me uniforma, coftina në rrugë dhe shtëpi që po digjeshin.⁵⁹⁰

156. Dhoma mori prova nga burime të ndryshme lidhur me vrasjen prej forcave serbe të shtatë apo tetë anëtarëve të familjes Hamzaj në Lubeniq të Pejës më 25 maj 1998.⁵⁹¹ Shqiptarë kosovarë vendas më pas i thanë Dëshmitarit 28 se ky incident u krye si shpagim ndaj aksioneve të UÇK-së në Lubeniq dhe ishte “pikë kthese” që i bëri shqiptarët kosovarë në zonën përgjatë rrugës Deçan-Pejë të marrin armët në dorë dhe t’i bashkoheshin UÇK-së.⁵⁹² Një telegram diplomatik britanik i datës 27 maj 1998 u referohet lajmeve të mediave lidhur me luftime të ashpra në Deçan dhe rreth tij të cilat vazhduan me javë të tëra.⁵⁹³ John Crosland-i vlerësoi se në atë kohë Deçani u shndërrua në qendër të luftimeve të ashpra midis shqiptarëve kosovarë dhe serbëve për marrjen e kontrollit mbi qytetin. Ai raportoi se kushtet e jetesës në qytet ishin përkeqësuar gjithnjë e më shumë për banorët serbë dhe shqiptarë kosovarë që ende nuk ishin larguar nga qyteti. Sipas tij, kjo tregonte se Deçani

⁵⁸⁴ Prova materiale D11, para. 5; D38.

⁵⁸⁵ Prova materiale D11, para. 4.

⁵⁸⁶ *Shih* më poshtë, para. 444, 584.

⁵⁸⁷ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 80; Prova materiale P114, para. 5.

⁵⁸⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10206; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 65-68.

⁵⁸⁹ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 67-68.

⁵⁹⁰ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 68.

⁵⁹¹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4608-4609; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 70; Prova materiale D100, f. 4-9.

⁵⁹² Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 71, 76.

⁵⁹³ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1925, 1928; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 60; Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10272-10273; Prova materiale D15, para. 2; D16, para. 1; D17, para. 1; D19, para. 1; D40, para. 8; D41, para. 3.

ishte bërë zonë kryesore e rifurnizimit nga Shqipëria në Kosovë.⁵⁹⁴ Ndikimi i luftimeve të vazhdueshme në qytet përshkruhet në një telegram diplomatik britanik të datës 17 qershor 1998. Në telegram përshkruhen dallimet e dukshme midis situatës në Gjakovë dhe Pejë “në dukje” normale, me dyqane të furnizuara mirë, me tregje të hapura dhe me prani njerëzish kudo, dhe asaj vetëm 20 kilometra më larg në Deçan dhe rrethinë me dëme të konsiderueshme dhe pothuajse pa asnjë shenjë jetese normale dhe prani të madhe të policisë.⁵⁹⁵

157. Dhoma mori prova nga burime të ndryshme se më 29 maj 1998, forcat serbe sulmuan fshatrat Vranoc i Vogël dhe Isniq, në komunën e Deçanit.⁵⁹⁶

2. Sulmet e UÇK-së kundër policisë

158. Dhoma dëgjoi dëshmi se në periudhën 1 mars - 30 qershor 1998, UÇK-ja sulmoi forcat e MPB-së dhe rrëmbeu e vrau policë në territorin e zonës së Dukagjinit. Ekzistojnë raporte për rritjen e numrit të sulmeve të tilla nga fillimi i pranverës së vitit 1998,⁵⁹⁷ e veçanërisht pas sulmit kundër shtëpive të familjes Haradinaj më 24 mars 1998.⁵⁹⁸ Këto sulme u bënë edhe më të shpeshta në maj 1998.⁵⁹⁹ Sipas raporteve, sulmet u kryen kryesisht përgjatë rrugës Klinë-Gjakovë-Pejë.⁶⁰⁰

159. Sipas një dokumenti të asaj kohe të policisë serbe, më 1 mars 1998, rreth orës 22:15, shqiptarë kosovarë të armatosur qëlluan me granatëhedhës, bomba dhe me plumba automatiku një objekt strehimi të MPB-së në Hereç, në komunën e Gjakovës. Tomisllav Llukiqi, oficer në pension i MPB-së i cili banonte në atë objekt nuk pësoi lëndime; mirëpo ndërtesa pësoi dëmtime të konsiderueshme.⁶⁰¹ Zoran Stijoviqi theksoi se nga 2 marsi 1998, stacionet policore në Çallapek dhe

⁵⁹⁴ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1926-1929; Prova materiale D41, para. 3.

⁵⁹⁵ Prova materiale D23, para. 1, 9.

⁵⁹⁶ Skënder Rexhahmetaj, T. 1059; Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8723-8724, 8733-8734, 8741-8742; Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 3, 8; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5850-5851; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 24, 51-54.

⁵⁹⁷ Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9859-9861; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 22-23.

⁵⁹⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10200-10201; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 36, 54, 75; Radovan Zllatkoviç, Prova materiale P373, para. 28.

⁵⁹⁹ Prova materiale P20, f. 1; Dragan Zhivanoviç, Prova materiale P111, para. 48, 88; Dragan Zhivanoviç, Prova materiale P112, para. 48, 88; Prova materiale P115, para. 2, e; P116, para. 2.

⁶⁰⁰ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4670, 4720; Dragan Zhivanoviç, Prova materiale P112, para. 16; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10200; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 36, 75; Radovan Zllatkoviç, Prova materiale P373, para. 28.

⁶⁰¹ Prova materiale P149, f. 1.

Kliçinë në komunën e Pejës dhe ai në Irzniq të komunës së Deçanit ishin nën “zjarr të vazhdueshëm”, domethënë sulmoheshin thujse çdo ditë.⁶⁰²

160. Në dokumente ushtarake serbe të asaj kohe raportohet për një sulm kundër një patrulle policore të kryer në fshatin Ponoshec të komunës së Gjakovës rreth orës 10:00 të datës 3 maj 1998 gjatë të cilit u plagosën katër policë. Sipas dokumenteve, sulmet i kryen shqiptarë kosovarë të armatosur nga drejtimi i fshatrave atje afër: Smolicë, Popoc, Stubëll, Berjah, Nivokaz, Molliq, Brovinë dhe Morinë, në komunën e Gjakovës.⁶⁰³

161. Dhoma mori prova nga burime të ndryshme se rreth orës 10:30 të datës 24 maj 1998, në rrugën Deçan-Gjakovë, në afërsi të fshatrave Prilep dhe Junik, në komunën e Deçanit u rrëmbyen Nikolla Jovanoviçiq dhe Rade Popadiçiq, dy policë nga Shabaci.⁶⁰⁴ Nga mediat vendore Dëshmitari 28 mësoi se dyshohej se këtë e kishte bërë UÇK-ja.⁶⁰⁵ Thuhet se policët u panë për herë të fundit në detyrë duke shkuar nga stacioni policor në Baballoq në drejtim të Rastavicës në komunën e Deçanit.⁶⁰⁶ Sipas deklaratave të dëshmitarëve, Rade Popadiçiq ose që të dy policët u vranë më pas.⁶⁰⁷ Nuk ka fakte që mbështesin këto deklarata. Në kallëzimin penal të autoriteteve serbe në atë kohë thuhet se për shkaqe sigurie nuk u krye hetim në vendngjarje dhe se autorët e krimit ishin të panjohur, mirëpo ishin pjesëtarë “të pakicës shqiptare”.⁶⁰⁸

162. Në një raport të RDB-së të datës 6 gusht 1998 thuhet se sipas deklaratave të tetë personave që u liruan nga “i ashtuquajtur i burg” në Jabllanicë të komunës së Gjakovës, dy policët e kapur në

⁶⁰² Zoran Stijoviçiq, Prova materiale P121, para. 20(a); Zoran Stijoviçiq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8990-8992, 9058-9059. *Shih* gjithashtu Dragan Zhivanoviçiq, Prova materiale P112, para. 31; Prova materiale D46, f. 2.

⁶⁰³ Prova materiale D52, f. 2; D53, f. 1.

⁶⁰⁴ Zoran Stijoviçiq, Prova materiale P121, para. 55; Prova materiale P157, f. 1; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10198-10199; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 65; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 29; Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6884-6886; Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 8-9, 11); Prova materiale P377, f. 1-3; Nebojshta Avramoviçiq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6602, 6604; Prova materiale P383, f. 14.

⁶⁰⁵ Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10198-10199; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 65.

⁶⁰⁶ Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6884-6885; Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 9); Prova materiale P377, f. 1; Nebojshta Avramoviçiq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6604.

⁶⁰⁷ Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 29 (përmend vetëm Rade Popadiçiqin); Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 8-9, 11).

⁶⁰⁸ Prova materiale P377, f. 2-3. Raport serb bazuar në Provën materiale P377 (përmend numrin e dosjes së hetimit) ku thuhet se dy policët u rrëmbyen nga “një grup terrorist shqiptar”, Prova materiale P383, f. 14.

Deçan rreth dy muaj më parë u arrestuan dhe u torturuan për çdo ditë gjatë kohës së arrestimit të tyre dhe ua kishin “prerë krahët”.⁶⁰⁹ Askush prej tyre nuk dëshmoi në këtë çështje dhe deklaratat e tyre nuk u paraqitën si prova. Zoran Stijoviq i cili dëshmoi rreth këtij raporti theksoi se dy policët u keqtrajtuat, por nuk tha që ua kishin prerë krahët.⁶¹⁰ Dhoma nuk mori prova se si u hartua ky raport. Duke marrë parasysh këtë fakt dhe faktorët e diskutuar më lart në Aktgjykim,⁶¹¹ Dhoma konkludon se një informacion i tillë i pavërtetuar nga prova të tjera të besueshme nuk mjafton për një përfundim.⁶¹² Dhoma konkudoi në një pjesë tjetër të Aktgjykimit se kufoma e Rade Popadiqit u gjet në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit.⁶¹³ Rrjedhimisht, në mungesë të provave lidhur me rrethanat e vdekjes së dy policëve, Dhoma nuk mund të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se dy policët u mbajtën në Jabllanicë, as lidhur me rrethanat e vdekjes së tyre apo implikimin e UÇK-së në këtë çështje.

163. Sipas një raporti të MPB-së të datës 21 dhjetor 1998 që mbulon periudhën mars-dhjetor 1998, rreth orës 15:00 të datës 23 maj 1998, shqiptarë kosovarë të armatosur sulmuan me snajperë, mitralozë të lehtë, granatahedhës dore dhe topa pa dridhje kolonën e automjeteve të MPB-së që po lëvizte përgjatë rrugës Gjakovë-Pejë përmes fshatrave Pobërgjë, Voksh, Prilep, Drenoc dhe Rastavicë në komunën e Deçanit. Disa policë u plagosën, ndër të cilët Sërgjan Andrejeviq, Sllagjan Cuboviq, Dragolub Gjorgjeviq, Mlladen Tanasijeviq, Mlladen Vujoviq, Predrag Rakoviq dhe Vlladan Periq.⁶¹⁴

164. Në këtë raport përmenden edhe sulme të tjera, ndër të cilat:

- sulmi kundër një automjeti të tipit Golf i kryer më 25 maj 1998, rreth orës 06:45 në fshatin Lubeniq të komunës së Pejës prej “një grupi diversant-terrorist shqiptar”, gjatë të cilit u plagosën policët Sllobodan Vukoviq, Dimitrije Radoviq dhe Momçillo Antiq;⁶¹⁵

⁶⁰⁹ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 55; Prova materiale P157, f. 1.

⁶¹⁰ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 55.

⁶¹¹ *Shih* më lart, para. 13.

⁶¹² Në deklaratën që pretendohet ta ketë dhënë Zenel Alija përmenden dy policë të kapur në Baballoq, në komunën e Deçanit, kufomat e të cilëve u hodhën në liqenin e Radoniqit, Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 59; Prova materiale P389, f. 4, para. 4. Gjithsesi dëshmia nuk jep hollësi të mjaftueshme që t'i mundësojë Dhomës të gjykojë nëse bëhet fjalë për policët Nikolla Jovanoviq dhe Rade Popadiq. Për më tepër, Dhoma e gjykoi tejet të diskutueshme vlerën provuese të kësaj deklarate të pretenduar, *shih* më poshtë, para. 208-210.

⁶¹³ *Shih* më poshtë, para. 338.

⁶¹⁴ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 13-14.

⁶¹⁵ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 13.

- sulmi kundër kolonës së automjeteve të MPB-së që po shkonte nga Gjakova në drejtim të stacionit policor në Junik të komunës së Deçanit, i cili filloi rreth orës 08:00 dhe zgjati thuajse gjithë ditën më 25 maj 1998, i kryer prej “një grupi diversant-terrorist shqiptar” gjatë të cilit u përdorën armë të këmbësorisë dhe mortaja nga drejtimi i fshatrave Baballoq, Prilep, Gllogjan, Sllupë, Voksh dhe Drenoc të komunës së Deçanit;⁶¹⁶
- sulmi kundër një automjeti të tipit Opel Kadett, i kryer më 25 maj 1998, rreth orës 8:00, në afërsi të fshatit Rastavicë të komunës së Deçanit prej “një grupi diversant terrorist shqiptar”, gjatë të cilit u plagos rëndë komandanti i stacionit policor në Junik Milladin Novaković;⁶¹⁷ dhe
- sulmi kundër pjesëtarëve të MPB-së i kryer më 25 maj 1998, rreth orës 11:00 prej “grupit përreth Ramush Haradinajt” dhe banorëve të fshatit Strelc të komunës së Deçanit në fshatin e lartpërmendur, në rrugën Pejë-Gjakovë, gjatë të cilit u vra Dragolub Gjukiqi.⁶¹⁸

165. Në mungesë të provave të tjera konfirmuese, Dhoma nuk bindet në besueshmërinë e këtij raporti duke qenë se burimi i tij nuk dihet, veçanërisht kur këto veprime i ngarkohen “grupit përreth Ramush Haradinajt” apo “një grupi diversant-terrorist shqiptar”. Dhoma gjithashtu mori parasysh faktin që raporti u hartua më 21 dhjetor 1998 kurse në të përshkruhen incidente që pretendohet se ndodhën shumë më herët, që nga 23 maji 1998.

166. Në telegramin diplomatik britanik të 27 majit 1998 thuhet se forcat serbe të sigurimit nxirrnin raporte të shpeshta lidhur me sulmet kundër patrullave policore.⁶¹⁹ Një telegram tjetër diplomatik britanik i datës 29 maj 1998 u referohet të dhënave jozyrtare të qendrës së mediave në Prishtinë sipas të cilave nga fillimi i atij viti, gjatë 356 “sulmeve të organizuara terroriste” të kryera në atë kohë, në Kosovë ishin vrarë 14 policë dhe ishin rrëmbyer katër të tjerë.⁶²⁰

167. Në raportin e lartpërmendur të MPB-së të datës 21 dhjetor 1998, përmenden edhe sulmet e mëposhtme:

⁶¹⁶ Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 13.

⁶¹⁷ Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 14.

⁶¹⁸ Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 1-3, 5.

⁶¹⁹ Prova materiale D40, para. 8.

⁶²⁰ Prova materiale D41, para. 7.

- sulmi me snajper kundër disa policëve të MPB-së që po kryenin detyrat e tyre të zakonshme policore në qytetin e Deçanit, i kryer prej “një grupi diversant-terrorist shqiptar” më 30 maj 1998, rreth orës 18:45, gjatë të cilit polici Sllavko Tomasheviq pësoi plagë shumë të rënda;⁶²¹
- sulmi i kryer prej “grupit përreth Ramush Haradinajt” më 1 qershor 1998, rreth orës 07:00, gjatë të cilët u ngritën pengesa në disa vende dhe u shti me armë mbi policë të MPB-së që po lëviznin në kolonë automjetesh në drejtim të fshatit Junik në komunën e Deçanit;⁶²²
- sulmi kundër disa policëve që ruanin rrugën Gjakovë-Pejë, i kryer prej “grupit përreth Ramush Haradinajt” më 12 qershor 1998, rreth orës 10:00, në zonën e fshatit Prilep, në komunën e Deçanit, gjatë të cilit u plagosën rëndë Boban Velkoviqi dhe Dushan Kovaçeviqi;⁶²³
- sulmi i kryer prej “të njëjtit grup” më 14 qershor 1998, rreth orës 10:00, në fshatin Drenoc të komunës së Deçanit, gjatë të cilit u shti me armë snajper dhe automatikë mbi disa policë të MPB-së;⁶²⁴
- sulmi kundër një automjeti të tipit Ascona 18 i kryer prej “të njëjtit grup” më 14 qershor 1998, rreth orës 18:50, në fshatin Lëbushë, në komunën e Deçanit, gjatë të cilit u hap zjarr me automatikë dhe u plagosën policët Milloje Petroviq, Zdravko Ashanin dhe Tatjana Millatoviq;⁶²⁵
- sulmi i kryer prej “të njëjtit grup” më 15 qershor 1998, rreth orës 10:00, gjatë të cilit u hodh një bombë dore kundër stacionit policor në fshatin Drenoc, në komunën e Deçanit, dhe u plagos polici Vidomir Shalipur;⁶²⁶
- sulmi kundër pjesëtarëve të MPB-së i kryer prej “një grupi diversant-terrorist shqiptar” më 22 qershor 1998, rreth orës 17:00, në fshatin Prilep të komunës së Deçanit, përgjatë rrugës Gjakovë-Pejë, gjatë të cilit u plagos polici Zoltan Tot;⁶²⁷

⁶²¹ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 10.

⁶²² Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 1-3, 5.

⁶²³ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 1-3, 5.

⁶²⁴ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 1-3, 5.

⁶²⁵ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 1-3, 5.

⁶²⁶ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 1-3, 5.

⁶²⁷ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 7.

- sulmi i kryer prej “një grupi diversant-terrorist shqiptar” rreth orës 18:15 të së njëjtës ditë në fshatin Pobërgjë të komunës së Deçanit, gjatë të cilit u hap zjarr mbi pjesëtarë të MPB-së nga drejtimi i fshatit Voksh të komunës së Deçanit dhe u plagos polici Marko Shkoriq;⁶²⁸ dhe
- sulmi kundër postbllokut të policisë në fshatin Prilep të komunës së Deçanit, i kryer prej “grupit përreth Ramush Haradinajt” më 28 qershor 1998, rreth orës 04:30, gjatë të cilit u hap zjarr me automatikë dhe snajper dhe u vra polici Pero Tintor.⁶²⁹

168. Dhoma paraqiti dyshimet e saj lidhur me besueshmërinë e raportit.⁶³⁰ Rrjedhimisht, ajo konkludon se duke qenë se nuk mbështetet nga prova të tjera të besueshme, raporti nuk është i besueshëm në atë masë sa t’i mundësojë Dhomës të nxjerrë përfundim.

169. Sipas vlerësimeve të shefit të Shtabit të UJ-së, Vlladimir Llazareviqit, lidhur me ngjarjet në zonën e Drenicës dhe Metohisë, deri më 3 qershor 1998 atje ishin vranë 21 policë dhe pesë pjesëtarë të UJ-së dhe ishin plagosur mbi 50 policë dhe 10 pjesëtarë të UJ-së.⁶³¹ Kur foli për viktimat në radhët e policisë në komunën e Pejës dhe Deçanit, shefi i atëhershëm i degës për analiza në qendrën e RDB-së në Prishtinë, Zoran Stijoviq,⁶³² theksoi se nga mesi i qershorit 1998 u rrëmbye myslimani Iznet Gutiqi nga fshati Zllapek i komunës së Pejës, kurse kusherinjtë Vujsiq dhe Vukoviq u rrëmbyen nga fshatrat Raushiq dhe Lubovik të komunës së Pejës. Ai theksoi se gjatë qershorit dhe korrikut të vitit 1998, në zonën e Pejës dhe Deçanit u vranë mbi 30 policë.⁶³³

170. Nga provat e lartpërmendura, Dhoma konkludon se gjatë periudhës mars-qershor 1998, në zonën e Dukagjinit u kryen sulme të shpeshta mbi pjesëtarë të policisë. Bazuar në provat, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundim mbi identitetin e kryesve të sulmeve apo rrethanat e sakta të kryerjes së sulmeve.

3. Rrëmbimi, keqtrajtimi dhe vrasja e civilëve prej UÇK-së

(a) Incidente rrëmbimesh, keqtrajtimesh dhe vrasjesh të civilëve prej UÇK-së

(i) Jah Bushati

⁶²⁸ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 11); Prova materiale P383, f. 7.

⁶²⁹ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 9, 11); Prova materiale P379, f. 1, 3-4; P383, f. 1-3, 6.

⁶³⁰ *Shih* më lart, para. 165.

⁶³¹ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 88; Prova materiale P116, f. 1, para. 2, f. 4.

⁶³² Zoran Stijoviq, T. 537; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 2; Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinajt*), T. 8871, 9096.

⁶³³ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 54.

171. Për rrëmbimin e Jah Bushatit në pranverën e vitit 1998 dhe mbajtjen e tij të mëpasshme në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dëshmuar disa dëshmitarë, dëshmitë e të cilëve diskutohen më poshtë.

172. Dëshmitari 75 dëshmoi se në pranverën e vitit 1998, Jah Bushatin e arrestuan katër ushtarë të veshur me uniforma, me një emblemë me shqiponjë dhe me shkronjat “UÇK” në krah, në rrugën midis Zhabelit dhe Buçanit, rreth 15 apo 20 minuta në këmbë nga Jabllanica. Një muaj më pas, Dëshmitari 75 shkoi vetëm për ta vizituar në Jabllanicë, por tek porta e objektit të UÇK-së u ndalua nga një ushtar i cili i tha që të mos vinte më aty.⁶³⁴ Ky ushtar ishte me mjekër dhe më vonë dëshmitari mësoi se emri i tij ishte Naser Ibrahimaj (Brahimaj), kushëri i Lahi Brahimajt.⁶³⁵ Pas rreth një jave, Dëshmitari 75 shkoi përsëri në objektin e UÇK-së në Jabllanicë,⁶³⁶ kësaj radhe së bashku me Dëshmitarin 76.⁶³⁷ Naser Ibrahimaj (Brahimaj) u tha që Jah Bushati gjendej në objektin e UÇK-së⁶³⁸ dhe se duhej të prisnin tek trau,⁶³⁹ rreth 30 metra para portës.⁶⁴⁰ Pas pak kohe Jah Bushatin e sollën jashtë tek porta.⁶⁴¹ Nga një largësi prej rreth 30 metrash, Dëshmitari 75 mundi të shihte se Jah Bushati ishte rrahur keq. Fytyrën e kishte të mavijosur. Dy ushtarë e mbanin nga të dy anët dhe e ndihmonin të ecte.⁶⁴² Dëshmitari 75 dhe Dëshmitari 76 e panë Jah Bushatin për jo më gjatë se një minutë.⁶⁴³

173. Dëshmitari 75 më tej dëshmoi se dy apo tri javë pas kësaj vizite, atij dhe Dëshmitarit 76 u thanë se mund ta takonin Jah Bushatin për një gjysëm ore. Ushtarë e sollën Jah Bushatin tek trau. Dy ushtarë e mbanin për krahu kurse dy të tjerë qëndronin pas tij. Gjatë bisedës së lejuar prej 10-15 minutash Jah Bushati i tregoi Dëshmitarit 75 se mbahej në burg në Jabllanicë dhe se nuk e dinte arsyen.⁶⁴⁴ Jah Bushati ishte në një gjendje jashtëzakonisht të keqe: sytë i kishte të ënjtur, ishte i shfityruar, duart e ënjtura dhe rrobat e mbuluara me baltë.⁶⁴⁵ Jah Bushati i tha Dëshmitarit 75 se fillimisht e kishin mbajtur në bodrum dhe më pas e kishin çuar dhe e mbanin në një dhomë dritarja e të cilës shikonte nga një lëndinë. Çdo herë që vinin ushtarë në dhomë, e rrihnin. Personat që e

⁶³⁴ Dëshmitari 75, T. 854-855, 866-867, 871.

⁶³⁵ Dëshmitari 75, T. 855-856.

⁶³⁶ Për përshkrimin e objektit të UÇK-së në Jabllanicë *shih* më poshtë para. 429-430.

⁶³⁷ Dëshmitari 75, T. 867-868, 873.

⁶³⁸ Dëshmitari 75, T. 903.

⁶³⁹ Dëshmitari 75, T. 903-905.

⁶⁴⁰ Dëshmitari 75, T. 859-860.

⁶⁴¹ Dëshmitari 75, T. 905, 906.

⁶⁴² Dëshmitari 75, T. 906-907.

⁶⁴³ Dëshmitari 75, T. 907.

⁶⁴⁴ Dëshmitari 75, T. 907-908.

⁶⁴⁵ Dëshmitari 75, T. 908.

rrihnin ishën të maskuar kështu që ai nuk e dinte se kush po e rrihte.⁶⁴⁶ Nuk ishte larë për një kohë të gjatë. I jepnin bukë një herë në javë “sikur të ishte qen”, në kushte të llahtarshme.⁶⁴⁷ Jah Bushati ishte vetëm në dhomë. Kishte edhe dhoma të tjera nga të cilat dëgjonte zërin e të tjerëve që rriheshin.⁶⁴⁸ Kjo ishte hera e fundit që Dëshmitari 75 pa Jah Bushatin në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.⁶⁴⁹

174. Dëshmitari 75 më tej dëshmoi se rreth tre muaj pas arrestimit të Jah Bushatit, Naser Ibrahimaj (Brahimaj) erdhi në shtëpinë e Dëshmitarit 75 me Jah Bushatin dhe i tha që Jahu po mbahej në Jabllanicë për arsye se dyshohej që bashkëpunonte me serbët.⁶⁵⁰ Ata pastaj shkuan dhe e kthyen Jah Bushatin në Jabllanicë.⁶⁵¹ Dëshmitari 75 erdhi në përfundimin se Jah Bushati nuk ishte liruar.⁶⁵²

175. Dëshmitari 75 gjithashtu dëshmoi se i kishte parë Lahi Brahimajn dhe Idriz Balajn në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.⁶⁵³ Kur ata hynin ose dilnin nga objekti, ushtarët i përshëndetnin me grusht.⁶⁵⁴ Dëshmitari 75 në atë kohë nuk ia dinte emrin Idriz Balajt por mësoi më vonë se kush ishte ai dhe si quhej.⁶⁵⁵

176. Për mendimin e Dëshmitarit 75, Jah Bushati u bë anëtar i UÇK-së pas 20 majit 1998.⁶⁵⁶

177. Dëshmitari 76 dëshmoi se në “fillim të luftës” në vitin 1998, Jah Bushati u rrëmbye në rrugën e Zhabelit dhe u çua në një burg të UÇK-së në Jabllanicë.⁶⁵⁷ Dëshmitari 76 e dëgjoi këtë nga Dëshmitari 75.⁶⁵⁸ Dëshmitari theksoi se Jah Bushati u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Për mendimin e dëshmitarit, Jah Bushati u mbajt i burgosur për dy muaj dhe gjatë kësaj kohe Dëshmitari 76 dhe Dëshmitari 75 e vizitonin atë në çdo tri javë.⁶⁵⁹ Dëshmitarit 76 mori një fletautorizim për të udhëtuar në Jabllanicë nga një ushtar i UÇK-së në fshatin e tij.⁶⁶⁰ Gjatë vizitës së parë, ata u ndaluan nga një roje e UÇK-së në rrugën para se të shkohej në objektin e UÇK-së në

⁶⁴⁶ Dëshmitari 75, T. 909.

⁶⁴⁷ Dëshmitari 75, T. 909.

⁶⁴⁸ Dëshmitari 75, T. 909.

⁶⁴⁹ Dëshmitari 75, T. 910.

⁶⁵⁰ Dëshmitari 75, T. 910-911.

⁶⁵¹ Dëshmitari 75, T. 910-911.

⁶⁵² Dëshmitari 75, T. 911.

⁶⁵³ Dëshmitari 75, T. 911, 915.

⁶⁵⁴ Dëshmitari 75, T. 911, 913, 915.

⁶⁵⁵ Dëshmitari 75, T. 914-915.

⁶⁵⁶ Dëshmitari 75, T. 1765-1766; Prova materiale D195.

⁶⁵⁷ Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 5; Dëshmitari 76, T. 1370, 1378-1379, 1408, 1422.

⁶⁵⁸ Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 5; Dëshmitari 76, T. 1408.

⁶⁵⁹ Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 7, 16; Dëshmitari 76, T. 1378-1379.

⁶⁶⁰ Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 8.

Jabllanicë. Gjatë çdo vizite, Dëshmitari 76 priste jashtë objektit derisa rojet e armatosur sillnin Jah Bushatin tek porta. Përreth kishte roje të armatosur.⁶⁶¹ Çdo herë që e sillnin jashtë, fytyra e Jah Bushatit ishte e ënjtur dhe trupi i nxirë dhe dukej i rrahur “shumë keq”.⁶⁶² Rrobat i kishte të pista, me baltë, e ndonjëherë edhe të lagura.⁶⁶³ Më pas Jah Bushati i tha dëshmitarit se në objektin e UÇK-së mbaheshin edhe të burgosur të tjerë, se rojet i fushnin atë dhe të burgosurit e tjerë në ujë deri në brez dhe se ai dëgjonte britmat e burgosurve të tjerë që po rriheshin.⁶⁶⁴ Pas dy apo tre muajsh në Jabllanicë, Jah Bushati u dërgua në “vijën e frontit” për të luftuar si ushtar i UÇK-së.⁶⁶⁵

178. Dëshmitari 80 gjithashtu dëshmoi se Jah Bushati u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Për mendimin e tij, arsyeja ishte se dyshohej që Jah Bushati bashkëpunonte me Serbinë. Jah Bushati u rrah keq nga disa persona të njohur me pseudonimet Bandashi dhe Rusi. Dikur rreth 20-25 majit 1998, Dëshmitari 80 e pa një herë Jah Bushatin duke u rrahur.⁶⁶⁶ Më pas Jah Bushati u lirua dhe u bë “ushtar i mirë i UÇK-së”.⁶⁶⁷ Sipas Dëshmitarit 80, jo shumë kohë më pas, Jah Bushati e rrëmbeu atë në rrugën Kosuriq-Glllogjan dhe e çoi në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.⁶⁶⁸

179. Edhe Shefqet Kabashi dëshmoi se e kishte parë Jah Bushatin kur mbahej në Jabllanicë. Sipas dëshmisë së Kabashit në procesin *Limaj*, Jah Bushatin e solli në Jabllanicë një person me emrin Myftari.⁶⁶⁹ Shefqet Kabashi kishte dëgjuar se kjo lidhej me një incident që kishte ndodhur një apo dy ditë më parë gjatë të cilit ishte qëlluar me armë një person.⁶⁷⁰ Shefqet Kabashi ka parë Lahi Brahimajn duke rrahur Jah Bushatin.⁶⁷¹ Shefqet Kabashi nuk përmendi periudhën kohore të këtij incidenti.

180. Gjatë dëshmisë së Dëshmitarit 75 doli se para se të vinte për të dëshmuar në Tribunal, ai u kishte dhënë deklaratat nën betim autoriteteve të një shteti në lidhje me një kërkesë azili, në të cilat kishte paraqitur version të ndryshëm për fatin e Jah Bushatit. Në asnjë nga këto deklaratat, Dëshmitari nuk përmendi faktet për të cilat dëshmoi para Dhomës. Disa aspekte të dëshmisë së Dëshmitarit 75 për Dhomën nuk duken të besueshme, si për shembull dëshmia e Dëshmitarit 75 se Jah Bushati diskutonte me të identitetin e personave që e rrihnin në praninë e ushtarëve të UÇK-

⁶⁶¹ Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 9, 16; Dëshmitari 76, T. 1382.

⁶⁶² Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 9; Dëshmitari 76, T. 1371-1372, 1410.

⁶⁶³ Dëshmitari 76, T. 1372-1373.

⁶⁶⁴ Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 16; Dëshmitari 76, T. 1403-1406, 1420-1421.

⁶⁶⁵ Dëshmitari 76, Prova materiale P304, para. 14; Dëshmitari 76, T. 1380, 1382-1383, 1387.

⁶⁶⁶ Dëshmitari 80, T. 2340-2341.

⁶⁶⁷ Dëshmitari 80, T. 2341.

⁶⁶⁸ Dëshmitari 80, T. 2342.

⁶⁶⁹ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4262, 4265.

⁶⁷⁰ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4265.

⁶⁷¹ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4262.

së.⁶⁷² Më herët gjatë këtij gjykimi Dhoma shqyrtoi rrethanat e kontakteve të Dëshmitarit 75 me Zyrën e Prokurorisë lidhur me dëshminë e tij për Tribunalin dhe përfshirjen e Prokurorisë në procedurën e kërkesës së Dëshmitarit 75 për azil.⁶⁷³ Në këto rrethana, Dhoma nuk mund të përjashtojë mundësinë që vendimi i Dëshmitarit 75 për të dëshmuar në këtë proces të jetë ndikuar nga motive personale. Ndonëse në vetvete kjo nuk e bën dëshminë e tij të pabesueshme, marrë parasysh së bashku me versionet e ndryshme të ngjarjeve që Dëshmitari 75 paraqiti para autoriteteve shtetërore dhe Dhomës, dhe sjelljen e dëshmitarit në sallën e gjyqit, Dhoma nuk e konsideron bindëse dëshminë e Dëshmitarit 75. Dhoma do të mbështetet në dëshminë e tij vetëm kur ajo konfirmohet nga dëshmi të tjera të besueshme. Dëshmia e Dëshmitarit 76 pjesërisht bazohet në dëshminë e Dëshmitarit 75. Për arsyet e lartpërmendura Dhoma nuk e pranon këtë pjesë të dëshmisë së Dëshmitarit 76 si të besueshme. Gjithsesi, Dhoma konkludon se në përgjithësi, Dëshmitari 76 është i besueshëm. Ndonëse Dëshmitarit 76 nuk i kujtoheshin të gjitha hollësitë në lidhje me ngjarjet për të cilat dëshmoi, Dhoma ka parasysh faktin se nga koha e ngjarjeve e deri në dëshminë e dëshmitarit në Tribunal kanë kaluar 13 vjet. Dhoma krijoi përshtypjen se përgjigjet e Dëshmitarit 76 për pyetjet që iu bënë ishin të sinqerta dhe pranon dëshminë e tij me kushtin e lartpërmendur.

181. Gjetkë në Aktgjykim Dhoma ka paraqitur mendimin e saj në lidhje me besueshmërinë e Dëshmitarit 80.⁶⁷⁴ Dhoma e hedh poshtë këtë dëshmi si jobindëse. Në një pjesë tjetër të Aktgjykimit, Dhoma theksoi se do të pranojë dëshminë e Shefqet Kabashit dhënë në procesin *Limaj* vetëm nëse ajo konfirmohet nga dëshmi të besueshme të marra në këtë proces.⁶⁷⁵ Dëshmia e Kabashit lidhur me mbajtjen e Jah Bushatit në objektin e UÇK-së në Jabllanicë konfirmohet nga dëshmia e Dëshmitarit 76 për të cilin Dhoma konkludoi se ishte i besueshëm. Dëshmia e Kabashit se Lahi Brahimaj rrahu Jah Bushatin nuk u konfirmua nga dëshmi të tjera.

182. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se në pranverë të vitit 1998, Jah Bushati u rrëmbye dhe u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Ai u mbajt në këtë objekt për një kohë ku u rrah nga ushtarë të UÇK-së. Dëshmitë nuk përcaktuan identitetin e personave që rrahën Jah Bushatin. Në bazë të provave, Dhoma konkludon se pas një periudhe ndalimi, Jah Bushati u bë ushtar i UÇK-së.

(ii) Mijat Stojanoviqi, Dragosllav Stojanoviqi dhe Veselin Stijoviqi

⁶⁷² *Shih* më lart, para. 173.

⁶⁷³ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁶⁷⁴ *Shih* më poshtë, para. 448-452, 551-554.

⁶⁷⁵ *Shih* më poshtë, para. 473.

183. Mijat Stojanoviçiq dhe Dragosllav Stojanoviçiq u larguan nga shtëpitë e tyre në Dubravë të komunës së Deçanit pas luftimeve midis forcave të MPB-së dhe UÇK-së në shtëpitë e familjes Haradinaj më 24 mars 1998.⁶⁷⁶ Rreth orës 08:30 apo 09:00 të datës 18 prill 1998, dy anëtarët e familjes Stojanoviçiq, Mijat Stojanoviçiq dhe Dragosllav Stojanoviçiq, dhe kushëriri i tyre Veselin Stijoviçiq, që të gjithë serbë kosovarë, u kthyen në shtëpitë e familjes Stojanoviçiq për të marrë disa gjëra të tyre.⁶⁷⁷ Ndërsa Mijat Stojanoviçiq dhe Veselin Stijoviçiq po mblidhnin plaçkat, nga drejtimi i Dubravës u dëgjuan të shtëna.⁶⁷⁸ Pas të shtënave të para u dëgjuan dhe të shtëna të tjera që vinin nga drejtimi i shtëpive të familjes Haradinaj në Glllogjan.⁶⁷⁹ Mijati, Dragosllavi dhe Veselini deklaruan se nuk ishin të armatosur dhe kështu ata u strehuan në shtëpinë e Stojanoviçiqëve.⁶⁸⁰

184. Dragosllav Stojanoviçiq, Mijat Stojanoviçiq dhe Veselin Stijoviçiq mendonin se sulmi ishte drejtuar kundër vendbanimit të Stojanoviçiqëve dhe se përveç granatahedhësve të dorës u përdorën edhe automatikë dhe armë të vogla.⁶⁸¹ Të shtënat vazhduan për rreth 40 minuta dhe më pas 15 deri në 30 burra të armatosur me armë të vogla hynë në oborrin e familjes Stojanoviçiq.⁶⁸² Ata u kërkuan

⁶⁷⁶ Dragosllav Stojanoviçiq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1858-1860; Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2005, 2007, 2011; *shih* më lart, para. 144-149.

⁶⁷⁷ Stanisha Radosheviçiq, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 960; Dragosllav Stojanoviçiq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1844-1846, 1861, 1863-1865, 1867, 1904, 1950; Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2011-2012, 2019-2020; Marijana Angjelkoviçiq, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 506, 592; Novak Stijoviçiq, Prova materiale P492 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7144; Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1995, 2020; Veselin Stijoviçiq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2119, 2121, 2124-2126, 2161-2162; Prova materiale P411, f. 2; P413, f. 2-3; P414, f. 2; P425, f. 2; P426, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 9; P446, f. 23; P448, f. 5. *Shih* gjithashtu më lart, para. 144.

⁶⁷⁸ Dragosllav Stojanoviçiq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1864; Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2020-2021, 2051; Veselin Stijoviçiq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2125; Prova materiale P413, f. 3; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 9; P446, f. 23; P448, f. 5.

⁶⁷⁹ Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2021, 2051; Veselin Stijoviçiq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2126.

⁶⁸⁰ Dragosllav Stojanoviçiq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1864; Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2021-2022; Veselin Stijoviçiq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2125, 2127; *shih* gjithashtu Prova materiale P413, f. 2; P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 9; P446, f. 23; P448, f. 5.

⁶⁸¹ Dragosllav Stojanoviçiq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1864-1865; Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2021-2022; Veselin Stijoviçiq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2125-2127; Prova materiale P413, f. 3-4.

⁶⁸² Mijat Stojanoviçiq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2021-2022; Veselin Stijoviçiq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2125-2128; Prova

banorëve të shtëpisë të dorëzoheshin.⁶⁸³ Dragosllav Stojanoviçi hapi derën kryesore dhe i lejoj burrat e armatosur të hynin brenda në shtëpi.⁶⁸⁴

185. Daut Haradinaj⁶⁸⁵ dhe një shqiptar kosovar tjetër⁶⁸⁶ ishin të parët që hynë në shtëpi.⁶⁸⁷ Mijat Stojanoviçi i njohu të tjerët se ishin nga ajo zonë.⁶⁸⁸ Shumica prej tyre mbanin uniforma kamuflimi

materiale P413, f. 3; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 9; P446, f. 23; P448, f. 5.

⁶⁸³ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1865; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2021; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2126-2128; Prova materiale P413, f. 4.

⁶⁸⁴ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1865; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2021; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2126-2128; Prova materiale P413, f. 4; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23; P448, f. 5.

⁶⁸⁵ Në pyetjet e saj gjatë gjykimit të parë *Haradinaj*, Mbrojtja kundërshtoi dëshminë e Mijat Stojanoviçit mbi praninë e Daut Haradinajt më 18 prill 1998, Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2071, 2086-2089. Dhoma vëren se Mijat Stojanoviçi e njëjtte Daut Haradinajn duke qenë se të dy kishin shkuar në të njëjtën shkollë dhe rrjedhimisht gjykon se Mijati ishte në gjendje ta identifikonte Dautin, *shih* Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1987-1989. *Shih* gjithashtu Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1865; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2165-2166.

⁶⁸⁶ Gjatë dëshmisë së tij, Mijat Stojanoviçi iu referua këtij personi me “Xhavit Nimonaj” (Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2023-2024, 2064-2065. Mirëpo, në dëshminë e tij Dragosllav Stojanoviçi i referohet këtij personi me “Zeqir Nimonaj”, Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1865. “Xhavit Nimonaj” nuk përmendet më tej në dëshminë e Mijat Stojanoviçit. Në bazë të kësaj dëshmie, nuk u vërtetua identiteti i personit që hyri në shtëpinë e familjes Stojanoviçi më 18 prill 1998 i pari së bashku me Daut Haradinajn.

⁶⁸⁷ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1852, 1865; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2165-2166; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2023; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2.

⁶⁸⁸ Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2023, 2087; Marijana Angjelkoviçi, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 660-661; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2132; Prova materiale P413, f. 2; P443, f. 21; P445, f. 12; P446, f. 25; P448, f. 6; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 4.

ose të zeza; ata kishin emblemën e UÇK-së.⁶⁸⁹ Këta persona flisnin shqip me theks kosovar të asaj ane.⁶⁹⁰

186. Ushtarët e UÇK-së keqtrajuan fizikisht Mijatit, Dragosllavin dhe Veselinin. Ata i shanë se ishin serbë dhe u thanë se “Kosova është e shqiptarëve”.⁶⁹¹ Kjo vazhdoi për rreth 15 ose 20 minuta deri sa erdhi Nasim Haradinaj, kushëri i Ramush Haradinajt.⁶⁹² Nasimi me sa dukej kishte “ndikim” mbi këta persona dhe u përpoq të ndërpriste rrahjet; urdhrat e tij u respektuan për një kohë të shkurtër.⁶⁹³

187. Pas rrahjeve të mëtejshme, Mijati, Dragosllavi dhe Veselini u çuan me dhunë në Glllogjan në shtëpinë e Smajl Haradinajt i cili ishte ungji i Ramush Haradinajt dhe njëkohësisht babai i Nasim

⁶⁸⁹ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1867; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2022-2023; Prova materiale P413, f. 5; P443, f. 21; P445, f. 12; P446, f. 25; P448, f. 6; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2128.

⁶⁹⁰ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1868; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2128; Prova materiale P413, f. 4.

⁶⁹¹ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1865-1866, 1899-1900; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2024-2025; Novak Stijoviq, Prova materiale P492 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7144; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2126-2131, 2170, 2182; Prova materiale P413, f. 4; P417, f. 1; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23; P448, f. 5.

⁶⁹² Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1866; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2024-2025, 2076; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23; P448, f. 5; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2132, 2162, 2165; Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 507, 661.

⁶⁹³ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1866, 1869; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2076, 2087-2088; *shih* gjithashtu Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 507, 659; Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23; P448, f. 5; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2132, 2163-2166.

Haradinajt.⁶⁹⁴ Veselin Stijoviqi dëshmoi se personat e armatosur këtë shtëpi e quanin “Shtabi i Gllogjanit”.⁶⁹⁵ Ajo gjendej rreth 800 metra larg shtëpive të Haradinajt.⁶⁹⁶

188. Rugës për në shtëpinë e Smajl Haradinajt, tre personat e zënë rob u urdhëruan që t’i mbanin kokat poshtë dhe të mos shikonin as majtas e as djathtas.⁶⁹⁷ Mijat Stojanoviqi dëshmoi se pa Ramush Haradinajn me dy ushtarë në shtegun drejt shtëpive të Haradinajt nga rruga Dubravë-Gllogjan.⁶⁹⁸ Mijat Stojanoviqi dëshmoi se e njohu Ramush Haradinajn meqenëse e dinte shumë mirë si dukej ai për arsye se kishin shkuar në të njëjtën shkollë, i kishin shtëpitë afër dhe njiheshin me vite të tëra.⁶⁹⁹ Mirëpo, atij nuk i kujtohej se kur e kishte parë Ramush Haradinajn për herë të fundit.⁷⁰⁰ Dhoma vëren se largësia midis vendit ku Mijat Stojanoviqi dëshmoi se ishte kur pa Ramush Haradinajn, shënuar në provën materiale D28, dhe vendit ku sipas dëshmisë së tij qëndronte Ramush Haradinaj, shënuar në provën materiale D27, është rreth 71.9 metra.⁷⁰¹ Duke marrë parasysh këtë largësi si dhe faktin se Mijat Stojanoviqi u urdhërua që ta mbante kokën poshtë dhe se dy personat e tjerë të zënë rob nuk e panë Ramush Haradinajn, Dhoma nuk pranon se Mijat Stojanoviqi pa Ramush Haradinajn ndërsa po i çonin në shtëpinë e Smajl Haradinajt.

⁶⁹⁴ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 959-960; Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1866, 1868-1869; Prova materiale P413, f. 4-5; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2025, 2027; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2; Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 507; Prova materiale P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23; P448, f. 5; Novak Stijoviq, Prova materiale P492 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7144; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2126.

⁶⁹⁵ Novak Stijoviq, Prova materiale P492 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7144; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2131, 2135.

⁶⁹⁶ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1866, 1869, 1871, 1904; Prova materiale P413, f. 4; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2025-2027; *shih* gjithashtu Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 592; Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23; P448, f. 5.

⁶⁹⁷ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1866, 1869, 1915-1916; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2026, 2052, 2062-2063, 2069-2070; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2129, 2131-2134, 2166; Prova materiale P413, f. 4; P426, f. 4.

⁶⁹⁸ Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2026, 2052-2054, 2058, 2063-2064, 2066; Prova materiale P423; P424.

⁶⁹⁹ Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1988, 1992, 2045-2046, 2049-2050; Prova materiale P426, f. 4.

⁷⁰⁰ Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2067.

⁷⁰¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Parashtrimet e Përbashkëta lidhur me Pranimin e Provave dhe Fakteve të Pranuara nga Palët me Shtojcën, 24 nëntor 2011, f. 1.

189. Mijat Stojanoviqi gjithashtu dëshmoi se rrugës për në shtëpinë e Smajl Haradinajt, ai pa Zeqir Nimonajn me rreth 5-10 ushtarë të tjerë në afërsi të një llogoreje që përdorej si pikë kontrolli.⁷⁰² Përgjatë rrugës për në Gllogjan kishte shumë njerëz të armatosur, disa prej të cilëve mbanin uniformë me emblemën e UÇK-së.⁷⁰³ Rrugës për në shtëpinë e Smajl Haradinajt shumë prej tyre së bashku me arrestuesit keqtrajtuan Mijatit, Dragosllavin dhe Veselinin dhe i shanë se ishin serbë.⁷⁰⁴

190. Në shtëpinë e Smajl Haradinajt, Daut Haradinaj, Besnik Haradinaj dhe Zeqir Nimonaj i çuan tre personat e zënë rob në katin e parë.⁷⁰⁵ Në shtëpi ishin disa ushtarë të armatosur dhe me uniforma të zeza ose kamuflimi me simbolin e UÇK-së mbi supin e djathtë. Emblema e UÇK-së dukej edhe në kapelet e ushtarëve.⁷⁰⁶ Sipas Mijat Stojanoviqit, atyre që mbanin bereta të zeza të tjerët u drejtoheshin sikur të ishin eprorë. Ndër këta ishin Nasim Haradinaj dhe të gjithë anëtarët e tjerë të familjes Haradinaj.⁷⁰⁷

191. Mijatit, Dragosllavin dhe Veselinin i çuan lart dhe i vendosën bashkë në një dhomë. Brenda katër orëve të ardhshme secili prej tyre u çua në një dhomë tjetër ku u mor në pyetje dhe u rrah nga disa persona me kondakë pushke, shkopinj dhe shufra metalike.⁷⁰⁸ Midis atyre që kryen rrahjet ishin Zeqir Nimonaj, Daut Haradinaj dhe Besnik Haradinaj.⁷⁰⁹ Gjatë pyetjeve u bënë akuza të ndryshme

⁷⁰² Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2063-2066; Prova materiale P424. *Shih* gjithashtu Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1865.

⁷⁰³ Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2091; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2129, 2132-2134.

⁷⁰⁴ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1866, 1869; Prova materiale P413, f. 4; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2025, 2091; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2129, 2132-2133.

⁷⁰⁵ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1852-1853, 1871-1873, 1886, 1917; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2027-2028, 2031, 2089; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 2; P443, f. 20.

⁷⁰⁶ Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1873-1875; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2031; Prova materiale P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23; P448, f. 5; Veselin Stijoviq, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2138, 2140, 2178.

⁷⁰⁷ Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2071-2072.

⁷⁰⁸ Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2028-2034, 2071-2074, 2076, 2086-2092; Prova materiale P425, f. 3.

⁷⁰⁹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 960; Dragosllav Stojanoviq, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1871-1872, 1881-1882, 1884-1886, 1890, 1893, 1916, 1918-1919, 1927-1928; Prova materiale P413, f. 4-5; Mijat Stojanoviq, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2028-2034, 2087-2088; *shih* gjithashtu Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 507; Prova materiale P425, f. 2-3; P443, f. 20; P445, f. 10; P446, f. 23-24; P448,

dhe sharje se ishin serbë.⁷¹⁰ Pas largimit nga dhoma, Mijati, Dragosllavi dhe Veselini u rrahën përsëri.⁷¹¹

192. Më së shumti u keqtrajtua Dragosllavi; ai pësoi lëndime të rënda si rezultat i të cilave humbi vetëdijen disa herë atë ditë.⁷¹² Në një moment atë ditë, ndërsa Mijati dhe Veselini po merreshin në pyetje në një dhomë tjetër, Dragosllavi pa një ushtar të UÇK-së të cilin e trajtonin si komandant.⁷¹³ Gjatë dëshmisë së tij, Dragosllavi tha se ky komandant ishte Ramush Haradinaj.⁷¹⁴ Dragosllavi e njihte Ramush Haradinajn nga shkolla fillore, por në kohën e ngjarjeve më 18 prill 1998 ai nuk e kishte parë atë prej dhjetë vjetësh.⁷¹⁵ Personi në shtëpinë e Smajl Haradinajt për të cilin Dragosllavi mendoi se ishte Ramush Haradinaj, kishte uniformë kamuflimi dhe ushtarët e tjerë e trajtonin si epror.⁷¹⁶ Gjithsesi, Dragosllavi nuk ishte në gjendje t'i shihte mirë ushtarët e tjerë rreth këtij personi meqenëse ishte i shtrirë në tokë.⁷¹⁷ Gjatë takimit të pretenduar, personi që Dragosllav Stojanoviqi mendonte se ishte Ramushi iu drejtua atij me fqinj dhe e pyeti nëse e njihte se kush ishte; Dragosllavi iu përgjigj me jo.⁷¹⁸ Sipas Dragosllavit, kjo e bëri personin që ai besonte se ishte

f. 5; Novak Stijoviç, Prova materiale P492 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7144; Veselin Stijoviç, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2132, 2134-2135, 2137-2139, 2165.

⁷¹⁰ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1872, 1881; Prova materiale P413, f. 4-5; Mijat Stojanoviç, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2032, 2039-2040; Veselin Stijoviç, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2137, 2182.

⁷¹¹ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1891; Prova materiale P413, f. 5; P446, f. 24; Veselin Stijoviç, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2139.

⁷¹² Zoran Stijoviç, Prova materiale P121, para. 51; Stanisha Radosheviç, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 960; Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1872-1873, 1885-1886, 1889, 1893, 1898-1903, 1916, 1918-1919, 1927-1929, 1933-1934; Prova materiale P413, f. 3, 5; P417, f. 1; P418; Mijat Stojanoviç, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2033-2034, 2092-2093, 2096, 2099; *shih* gjithashtu Marijana Angjelkoviç, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 507, 509; Prova materiale P425, f. 4; P443, f. 21; P445, f. 12; P446, f. 25; P448, f. 6; Novak Stijoviç, Prova materiale P492 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7144; Veselin Stijoviç, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2135-2136, 2148.

⁷¹³ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1887-1888, 1920, 1934-1935.

⁷¹⁴ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1886, 1897, 1920.

⁷¹⁵ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1847, 1887-1888, 1915.

⁷¹⁶ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1886-1888, 1920-1921, 1934-1935.

⁷¹⁷ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1886, 1933.

⁷¹⁸ Dragosllav Stojanoviç, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1886, 1915, 1920.

Ramushi t'i bie me shkëlqim në shpinë dhe t'i thoshte se më në fund do të mësonte se kush ishte ai.⁷¹⁹ Dhoma rikujton se në kohën e takimit të pretenduar Dragosllav Stojanoviçi ishte në gjendje shumë të rëndë; ai kishte pësuar lëndime të rënda dhe kishte humbur vetëdijen disa herë atë ditë. Pavarësisht nga gjendja e tij, Dhoma vëren se Dragosllavi ishte në gjendje të shihte hollësi dhe nga kjo konkludon se aftësitë e tij njohëse nuk ishin dëmtuar plotësisht. Mirëpo Dhoma ka parasysh faktin se në atë kohë ishin bërë 10 vjet që kur Dragosllav Stojanoviçi e kishte parë Ramush Haradinajn për herë të fundit. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se kjo dëshmi nuk mjafton për të nxjerrë një përfundim jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se personi që takoi Dragosllav Stojanoviçi ishte në fakt Ramush Haradinaj.⁷²⁰

193. Rreth orës 15:00, pasi ishin ndërprerë rrahjet, Nasim Haradinaj informoi Mijatit, Dragosllavin dhe Veselinin se do të liroheshin.⁷²¹ Nasimi gjithashtu i dha Dragosllavit një qetësues kundër dhimbjeve kurse Hilmi Haradinaj (babai i Ramush Haradinajt) i solli diçka për të pirë.⁷²² Më pas Mijat Stojanoviçi shkoi me Nasim Haradinajn dhe një ushtar tjetër për të marrë njëren prej makinave që Mijati dhe shokët e tij e kishin ngarë atë mëngjes.⁷²³ Duke dalë nga shtëpia e Smajl Haradinajt, Mijat Stojanoviçi pa Ramush Haradinajn me babanë e tij në oborr.⁷²⁴ Dëshmitë nuk tregojnë nëse Mijatit e urdhëruan që ta mbante kokën poshtë dhe të mos shikonte majtas-djathas gjatë largimit sikurse e kishin urdhëruar gjatë ardhjes.⁷²⁵ Mijatit më pas e çuan tek makina e tipit Lada 1200, e cila në atë moment ishte e parkuar në shtegun e ngushtë që çonte drejt shtëpisë së Ramush Haradinajt.⁷²⁶ Meqenëse makina nuk mund të përdorej,⁷²⁷ Mijati dhe personat që e kishin zënë rob u kthyen në shtëpinë e Smajl Haradinajt për të marrë Veselinin dhe Dragosllavin.⁷²⁸

⁷¹⁹ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1886, 1920.

⁷²⁰ *Shih* Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1886-1888, 1893, 1930-1934.

⁷²¹ Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2034, 2096-2097; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 3; P443, f. 20-21; P445, f. 11; P446, f. 24; P448, f. 5.

⁷²² Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1989, 2067-2068, 2096, 2098; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2136.

⁷²³ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1893-1894; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2034; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 4; P443, f. 20-21; P445, f. 11; P446, f. 24; P448, f. 5; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2141.

⁷²⁴ Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2035-2036, 2067, 2069.

⁷²⁵ *Shih* më lart, para. 188.

⁷²⁶ Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2035; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 3.

⁷²⁷ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1894; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2035-2036; *shih*

194. Pas kthimit të Mijatit, Hilmi Haradinaj përsëri u ofroi Mijatit, Veselinit dhe Dragosllavit bukë dhe pije.⁷²⁹ Më pas Nasim Haradinaj i ktheu në shtëpinë e Stojanoviçëve në mënyrë që ai dhe njerëzit e tij të kontrollonin shtëpinë për armë.⁷³⁰ Pasi nuk gjetën armë, Mijatit, Dragosllavit dhe Veselinit ua lidhën duart dhe sytë dhe i çuan në kampin e refugjatëve në Baballoq, ku atyre iu ofrua ndihmë mjekësore.⁷³¹ I gjithë incidenti zgjati përafërisht nga ora 09:00 deri në orën 17:00.⁷³² Më pas Dragosllavi u shtrua në spital për lëndimet që kishte pësuar, së pari në Pejë e më vonë në Prishtinë. Nga lëndimet kishte pësuar çarje në stomak, në shpretkë dhe në duoden. Ai u operua në Prishtinë dhe qëndroi në shërbimin e reanimacionit për disa ditë.⁷³³

(iii) Novak Stijoviçi dhe Stanisha Radosheviçi

195. Novak Stijoviçi dëshmoi se më 22 prill 1998 së bashku me Stanisha Radosheviçin dhe nënën e Stanishës, Rosandën (“Rosa”), që të gjithë serbë kosovarë, u nisën nga Deçani për në shtëpitë e tyre: Novak Stijoviçi me një makinë të kuqe të tipit Yugo për në Pozhar, kurse Stanisha Radosheviçi dhe nëna e tij me një makinë ngjyrë hiri të tipit Lada për në Dashinoc.⁷³⁴ Rreth orës

gjithashtu Prova materiale P425, f. 3; P443, f. 20-21; P445, f. 11; P446, f. 24; P448, f. 5; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2141.

⁷²⁸ Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2036-2037; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 3; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2141.

⁷²⁹ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1894, 1935; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2037.

⁷³⁰ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1894-1895; Prova materiale P413, f. 5; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2037-2038; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 3; P443, f. 21; P445, f. 12; P446, f. 24; P448, f. 6; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2141.

⁷³¹ Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1895-1897; Prova materiale P413, f. 5; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2034, 2038, 2041-2043; *shih* gjithashtu Marijana Angjelkoviçi, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 660; Prova materiale P425, f. 3-4; P443, f. 21; P445, f. 11-12; P446, f. 24; P448, f. 5-6; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2143, 2145-2147.

⁷³² Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1900; Prova materiale P413, f. 3; P417, f. 1; P443, f. 20; P445, f. 11; P446, f. 24; P448, f. 5.

⁷³³ Zoran Stijoviçi, Prova materiale P121, para. 51; Stanisha Radosheviçi, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 960; Dragosllav Stojanoviçi, Prova materiale P409 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1873, 1889, 1898-1903; Prova materiale P413, f. 3, 5; P417, f. 1; P418; Mijat Stojanoviçi, Prova materiale P421 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2042; *shih* gjithashtu Prova materiale P425, f. 4; Marijana Angjelkoviçi, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 507, 509; Prova materiale P443, f. 21; P445, f. 12; P446, f. 25; P448, f. 6; Novak Stijoviçi, Prova materiale P492 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7144; Veselin Stijoviçi, Prova materiale P493 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2148.

⁷³⁴ Novak Stijoviçi, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7145-7146 (flet për 21 prillin); Prova materiale P445, f. 13; P446, f. 1-2; P448, f. 6 (në tre provat e fundit flitet për

10:30, në fshatin Pozhar të komunës së Deçanit, ata u ndaluan nga fshatarë të armatosur me pushkët drejt tyre.⁷³⁵ Disa prej tyre ishin të veshur me uniforma me emblemën e UÇK-së, kurse të tjerë me rroba civile.⁷³⁶ Novak Stijoviqi njohu disa prej tyre, ndër të cilët Kujtim Berishën dhe Jusufin, mbiemri i të cilit nuk i kujtohej.⁷³⁷ Ushtarët u thanë në serbisht se nuk mund të ktheheshin dhe se nuk kishin më punë në shtëpitë e tyre.⁷³⁸ Novak Stijoviqi tha se ishte Jusufi ai që urdhëroi që t'i nisnin me makinë për në Gllogjan.⁷³⁹ Që të tre u çuan në Gllogjan me makinat e tyre të shoqëruar nga ushtarë të UÇK-së.⁷⁴⁰

196. Kur arritën në Gllogjan, aty kishte rreth 30-50 ushtarë të UÇK-së shumica e të cilëve ishin të armatosur dhe të veshur me uniforma.⁷⁴¹ Ndaluan para një shtëpie private në hyrje të fshatit më të afërt me Irzniqin.⁷⁴² Me të dalë Novak Stijoviqi dhe Stanisha Radosheviqi nga makina, personat e veshur me uniforma i goditën me shkelma, grushta, shufra dhe kondakë. Sipas Novak Stijoviqit, rrahjet zgjatën rreth 20-30 minuta.⁷⁴³ Nga lëndimet e pësuar Stanisha Radosheviqit filloi t'i rridhte gjak nga pjesa e pasme e kokës dhe për mendimin e Novak Stijoviqit ai humbi vetëdijen për një kohë të shkurtër.⁷⁴⁴ Rosandën, nënën e Stanishës nuk e prekën me dorë.⁷⁴⁵ Ushtarët pyetën Novak Stijoviqin dhe Stanisha Radosheviqin se për ku ishin nisur dhe për çfarë arsye. Kur Novak Stijoviqi u përgjigj se ishin nisur për në shtëpi, një person i tha se ata më nuk mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe se duhej të shkonin në Serbi.⁷⁴⁶ Këta persona i pyetën për forcat policore, për pozicionet dhe numrin e tyre, për emrat e shefave të stacioneve policore në Deçan dhe Irzniq dhe policët

22 prillin). Meqenëse edhe Stanisha Radosheviqi i referohet 22 prillit 1998, Dhoma pajtohet se këto ngjarje ndodhën më 22 prill 1998, *shih* më poshtë, para. 199, *shih* gjithashtu më poshtë, para. 198.

⁷³⁵ Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 587-590; Prova materiale P445, f. 13-15; P446, f. 1-2; P448, f. 6-7. *Shih* gjithashtu Prova materiale P443, f. 21; P448, f. 3; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7147.

⁷³⁶ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7149, 7168.

⁷³⁷ Prova materiale P445, f. 13; P446, f. 2; P448, f. 6; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7149.

⁷³⁸ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7150, 7157.

⁷³⁹ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7188.

⁷⁴⁰ Prova materiale P445, f. 13; P446, f. 1-2; P448, f. 6; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7149-7151.

⁷⁴¹ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7151.

⁷⁴² Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7161.

⁷⁴³ Prova materiale P445, f. 13; P446, f. 2; P448, f. 3, 6; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7151, 7189.

⁷⁴⁴ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7153.

⁷⁴⁵ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7145-7146, 7153.

⁷⁴⁶ Prova materiale P445, f. 13; P446, f. 2; P448, f. 6; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7151-7153.

përgjegjës për të shtënat kundër shqiptarëve kosovarë më 24 mars 1998.⁷⁴⁷ Novak Stijoviqi dëshmoi se pas marrjes në pyetje, ai dhe Stanisha Radosheviqi u thanë personave që i zunë rob se kishin nga një karabinë në shtëpi.⁷⁴⁸ Stanisha Radosheviqin e liruan që të shkonte dhe të merrte karabinat dhe i dhanë një emblemë të UÇK-së që ta përdorte si leje kalimi.⁷⁴⁹

197. Këta persona e pyetën Novak Stijoviqin nëse kishte ndonjë të afërm në forcat policore.⁷⁵⁰ Kur i pyetën nëse ndonjë bashkëfshatar i tyre punonte në polici, Novak Stijoviqi dhe Rosa Radosheviqi u thanë se ishte vetëm një bashkëfshatar i tyre që punonte në policinë në Deçan, mbiemri i të cilit ishte Vukiçeviq; personat që i zunë rob dinin për të.⁷⁵¹ Novak Stijoviqin dhe Rosandën i kyçën me çelës në një dhomë të vogël.⁷⁵² Rreth orës 14:15 erdhi një ushtar dhe u tha ushtarëve që ishin me Novak Stijoviqin dhe Rosa Radosheviqin se Stanisha Radosheviqi kishte marrë dhe dorëzuar një karabinë në Pozhar dhe kishte shkuar në Deçan për të marrë tjetrën.⁷⁵³ Rreth orës 15:00, pas ndalimit që zgjati rreth një orë e gjysëm, Novak Stijoviqi dhe Rosa Radosheviqi u liruan.⁷⁵⁴ Atyre u thanë se mund të shkonin kudo përveçse në shtëpitë e tyre.⁷⁵⁵

198. Babai i Novak Stijoviqit, Kostadin (“Kojo”) Stijoviqi nga Pozhari⁷⁵⁶ i tha Marijana Angjelkoviqit se djali i tij ishte rrahur kur kishte shkuar për ta marrë atë më 22 prill 1998.⁷⁵⁷

199. Dëshmia e Novak Stijoviqit konfirmohet pak a shumë nga dëshmia e Stanisha Radosheviqit i cili dëshmoi se si ai, nëna e tij dhe Novak Stijoviqi u ndaluan në Pozhar më 22 prill 1998, u çuan në Gllogjan dhe u rrahën në rrugë.⁷⁵⁸ Stanisha Radosheviqi dëshmoi se më pas ai dhe Novak

⁷⁴⁷ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7152, 7174, 7192.

⁷⁴⁸ Prova materiale P445, f. 13; P446, f. 1-2; P448, f. 6; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7153.

⁷⁴⁹ Prova materiale P445, f. 14; P446, f. 2; P448, f. 6; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7154, 7156, 7158.

⁷⁵⁰ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7173, 7191-7192.

⁷⁵¹ Prova materiale P445, f. 14; P446, f. 1-2; P448, f. 6-7; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7190-7192.

⁷⁵² Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7154, 7191-7192.

⁷⁵³ Prova materiale P445, f. 14; P446, f. 1-2; P448, f. 7.

⁷⁵⁴ Prova materiale P445, f. 14; P446, f. 1-2; P448, f. 7; Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7154.

⁷⁵⁵ Novak Stijoviq, Prova materiale P491 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7154-7155.

⁷⁵⁶ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 51; Prova materiale P445, f. 15; P446, f. 3; P448, f. 7.

⁷⁵⁷ Prova materiale P445, f. 15; P446, f. 5; P448, f. 7.

⁷⁵⁸ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 960-969, 971-974, 981-982, 1020, 1027-1029, 1035-1039, 1050-1059, 1074-1075. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para 51-52; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 51.

Stijoviqi u çuan në një ndërtesë ku u morën në pyetje dhe përsëri u rrahën.⁷⁵⁹ Një person nga grupi që kishte mbërritur më parë e mori Stanisha Radosheviqin në pyetje dhe e pyeti, midis të tjerash, nëse kishte një armë të vetën dhe mbi pozicionet e policisë dhe ushtrisë.⁷⁶⁰ Sipas dëshmisë së Stanisha Radosheviqit, ai dhe Novak Stijoviqi u përgjigjën se nuk kishin armë. Stanisha Radosheviqi u tha se babai i tij kishte një pushkë dytytëshe dhe një pushkë gjuetie meqenëse më parë shkonte në gjueti.⁷⁶¹ Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, Stanisha Radosheviqi theksoi se këtyre personave u kishte thënë se baballarët e tyre, do të thotë babai i tij dhe babai i Novak Stijoviqit, kishin pushkë gjuetie.⁷⁶² Sipas dëshmisë së Stanisha Radosheviqit, personi që e mori në pyetje e dërgoi atë në Dashinoc të komunës së Deçanit për të marrë dy pushkët “për Novakun dhe për veten”, dhe i dha një lejkalim të UÇK-së për siguri gjatë udhëtimit.⁷⁶³ Ndonëse dëshmia nuk është plotësisht e qartë në lidhje me këtë pikë, Dhoma gjykon se kjo do të thotë që ai u dërgua për të marrë pushkët nga babai i Novakut dhe babai i tij (pra i Stanisha Radosheviqit).⁷⁶⁴ Personi që e mori në pyetje e kërcënoi se do të vriste Novak Stijoviqin dhe nënën e Stanisha Radosheviqit nëqoftëse ai (Stanisha Radosheviqi) nuk do t’i dorëzonte dy pushkët.⁷⁶⁵

200. Stanisha Radosheviqi shkoi në shtëpinë e familjes së tij në Dashinoc.⁷⁶⁶ Babai i tij Slllobodan Radosheviqi ishte në shtëpi.⁷⁶⁷ Ai kishte veshur një xhaketë kamuflimi.⁷⁶⁸ Stanisha Radosheviqi dëshmoi se i tregoi babait të vet se çfarë kishte ndodhur dhe më pas, babai i dha karabinën për të shpëtuar Novak Stijoviqin dhe nënën e Stanisha Radosheviqit.⁷⁶⁹ Slllobodan Radosheviqi i tha Stanisha Radosheviqit që të mos shkonte drejtpërsëdrejti për në Glllogjan, por të shkonte në Deçan për të marrë armën tjetër.⁷⁷⁰ Stanisha Radosheviqi ia la babait njëren pushkë të gjuetisë.⁷⁷¹ Ai konfirmoi se në shtëpinë e babait të tij kishte dy pushkë, por meqenëse personi që e mori në pyetje i kishte kërkoi vetëm një, ai mori vetëm njëren.⁷⁷² Babai i tij dinte ta përdorte

⁷⁵⁹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 982-983, 1051-1054.

⁷⁶⁰ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 983, 1051.

⁷⁶¹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 983.

⁷⁶² Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1059.

⁷⁶³ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 983-985, 987, 1018, 1021, 1059, 1075. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 52.

⁷⁶⁴ *Shih* Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 983, 1075.

⁷⁶⁵ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 983.

⁷⁶⁶ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 984.

⁷⁶⁷ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 984.

⁷⁶⁸ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1076.

⁷⁶⁹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 984-985.

⁷⁷⁰ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985.

⁷⁷¹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1075.

⁷⁷² Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1075.

pushkës meqenëse më parë shkonte në gjueti.⁷⁷³ Babai i tij i tha se pasi të errësohej, ai do të përpiqej të dilte dhe të shkonte në Deçan përmes pyllit.⁷⁷⁴

201. Stanisha Radosheviqi u nis nga Dashinoci për në Deçan.⁷⁷⁵ Rrugës, ai u ndal në shtëpinë e babait të Novak Stijoviqit në lagjen Bandera për të marrë armën tjetër, por atje nuk gjeti askënd.⁷⁷⁶ Në atë lagje atë e ndaluan tre persona të armatosur dhe me rroba civile.⁷⁷⁷ Njëri prej tyre quhej Çaush.⁷⁷⁸ Stanisha Radosheviqi i tregoi Çaushit se çfarë kishte ndodhur dhe se duhej të kthehej në Glllogjan dhe t'i dorëzonte dy armët për të mundësuar lirimimin e nënës dhe të Novak Stijoviqit.⁷⁷⁹ I shpjegoi se njëren armë e kishte marrë dhe se duhej të shkonte në Deçan për të marrë tjetren.⁷⁸⁰ Çaushti e shoqëroi Stanisha Radosheviqin në makinën e tij deri në Pozhar që të mundësonte kalimin e Stanisha Radosheviqit për të marrë armën tjetër.⁷⁸¹ Në Pozhar, pas një diskutimi të shkurtër, ushtarët që Stanisha Radosheviqi i kishte parë më parë, e lejuan që të vazhdonte rrugën për në Deçan.⁷⁸² Gjithsesi, përpara se të nisej, Stanisha Radosheviqi ia dorëzoi Çaushit armën që kishte.⁷⁸³

202. Stanisha Radosheviqi dëshmoi se në Deçan, një polic e mori dhe e çoi në qendrën shëndetësore që t'ia qepnin dhe lidhnin plagën.⁷⁸⁴ Më pas, rreth orës 14:00 ose 15:00, ai shkoi në stacionin policor për të bërë deklaratë dhe aty e informuan se duke u kthyer nga Deçani për në Gjakovë, një polic i kishte parë nënën e tij dhe Novak Stijoviqin duke ecur rrugës në drejtim të Deçanit, në afërsi të fshatit Prilep.⁷⁸⁵

(iv) Sllobodan Radosheviqi, Millosh Radunoviqi, Milica Radunoviqi dhe familja

Markoviq

⁷⁷³ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1075-1076.

⁷⁷⁴ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985.

⁷⁷⁵ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985, 992; Prova materiale P314.

⁷⁷⁶ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1061-1062, 1068-1069.

⁷⁷⁷ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985, 1043, 1062.

⁷⁷⁸ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985.

⁷⁷⁹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985.

⁷⁸⁰ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985.

⁷⁸¹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985-986.

⁷⁸² Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 986-987, 992, 1043-1044; Prova materiale P314.

⁷⁸³ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 985, 1021.

⁷⁸⁴ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 987.

⁷⁸⁵ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 987-988, 991; Prova materiale P314.

203. Sipas dëshmisë së dorës së dytë të Dëshmitarit 28, kur UÇK-ja mori kontrollin mbi Dashinocin në komunën e Deçanit më 21 prill 1998,⁷⁸⁶ shumica e serbëve kosovarë i braktisën shtëpitë e tyre, mirëpo Slllobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi mbetën në fshatin e tyre së bashku me fshatarë të tjerë, ndër të cilët Milica Radunoviqi dhe familja Markoviq.⁷⁸⁷ Më 22 prill 1998, djalin e Slllobodan Radosheviqit, Stanisha Radosheviqin, nuk e lejuan të kthehej në Dashinoc për të kërkuar babanë e tij.⁷⁸⁸

204. Dhoma mori dëshmi të dorës së dytë nga burime të ndryshme se personat e lartpërmendur që mbetën në Dashinoc u zhdukën.⁷⁸⁹ Nebojsa Avramoviqi, specialist serb i kriminalistikës,⁷⁹⁰ personalisht bisedoi me familjet që kallëzuan zhdukjen e Slllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit duke qenë se djemtë e tyre ishin pjesëtarë të MPB-së.⁷⁹¹ Punonjësi i RDB-së, Zoran Stijoviqi,⁷⁹² dëshmoi në bazë të informacionit të marrë nga punonjësi operativ i RDB-së në Deçan, Vllado Mirçiqi, se Slllobodan Radosheviqi, Millosh Radunoviqi dhe gruaja e të dytit ishin vvarë. Ai nuk paraqiti fakte në mbështetje të këtij pretendimi.⁷⁹³

205. Rustem Tetaj dëshmoi se kishte dëgjuar “dy rrëfime të ndryshme” në lidhje me zhdukjen e dy serbëve të Kosovës, “Milloshit” dhe “Slllobodanit”, nga fshati Dashinoc.⁷⁹⁴ Deli Lekaj, komandant i UÇK-së në fshatin Lumbardh të komunës së Deçanit, i tha Rustem Tetajt se së bashku me disa ushtarë të tjerë të UÇK-së ai (Deli Lekaj) kishte hyrë në shtëpinë e Slllobodanit në Dashinoc për ta plaçkitur, duke menduar se nuk kishte njeri në të. Pas një shkëmbimi zjarri brenda në shtëpi,

⁷⁸⁶ *Shih* më lart, para. 151.

⁷⁸⁷ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 51; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 13.

⁷⁸⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 52.

⁷⁸⁹ Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 525-526, 599, 662; Prova materiale P443, f. 6, 19; P445, f. 17; P448, f. 3, 8, 12; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6602. Në lidhje me çiftin Radunoviq, *shih* gjithashtu Prova materiale P369, f. 8-9, 16, 19; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 64.

⁷⁹⁰ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6591; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 7.

⁷⁹¹ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6602, 6605.

⁷⁹² Zoran Stijoviq T. 537; Zoran Stijoviq Prova materiale P121, para. 2; Zoran Stijoviq Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8871, 9096.

⁷⁹³ Zoran Stijoviq Prova materiale P121, para. 51.

⁷⁹⁴ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3696-3697; Rustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 31.

Sllobodani ishte vrarë.⁷⁹⁵ Rustem Tetaj më vonë e kishte parë Deli Lekajn të plagosur sikurse pretendohet nga Sllobodani.⁷⁹⁶

206. Versioni i dytë që kishte dëgjuar Rustem Tetaj⁷⁹⁷ lidhet me të njëjtët ushtarë të UÇK-së që po shkonin drejt të njëjtës shtëpi. Një serb i Kosovës me emrin Sllobodan i kishte parë këta ushtarë dhe i kishte kërkuar një serbi tjetër të Kosovës me emrin Millosh që ta shoqëronte deri në shtëpi. Sllobodani shtiu me armë dhe plagosi një ushtar të UÇK-së kurse më pas dy serbët e Kosovës u morën dhe u çuan në Glllogjan tek Haradinaj dhe Balaj.⁷⁹⁸ Me të dëgjuar për plagosjen e një ushtari të UÇK-së, Balaj e kishte qëlluar Sllobodanin në këmbë. Haradinaj kishte urdhëruar që dy personat të dërgoheshin në Prilep të komunës së Deçanit për t'u bashkuar me forcat e tyre. UÇK-ja në Prilep, nga frika e hakmarrjes për plagosjen e Sllobodanit i ktheu dy serbët në Dashinoc. Dëshmitari dëgjoi nga të tjerët se pas dy ditësh, dy serbët kosovarë ishin gjetur të vdekur para shtëpive të tyre në Dashinoc.⁷⁹⁹

207. Dhoma gjithashtu mori si provë deklaratatë të dhëna policisë serbe që i atribuohen Bekim Kalamashit, një anëtar i zënë rob i UÇK-së.⁸⁰⁰ Këto deklaratatë i referohen përfshirjes së Bekim Kalimashit në rrëmbimin prej UÇK-së të një grupi personash nga Dashinoci të cilët, sipas deklaratave, ishin serbë të Kosovës nga ajo zonë.⁸⁰¹ Në deklaratatë që i atribuohen Bekim Kalimashit thuhet se personat e rrëmbyer u çuan në Jabllanicë ku u mbajtën në burg dhe se Kalamashi kishte dëgjuar që ata u keqtrajtuar dhe u vranë.⁸⁰²

208. Gjatë përcaktimit të vlerës provuese të deklaratave të pretenduara të Bekim Kalimashit, Dhoma shqyrtoi rrethanat e marrjes së tyre. Pretendohej se këto dhe deklaratatë të tjera që iu dhanë SPB-së së Gjakovës ishin të personave nga grupi prej 10-12 shqiptarësh kosovarë që u arrestuan

⁷⁹⁵ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3697-3698, 3768; Rustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 31.

⁷⁹⁶ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3768-3769.

⁷⁹⁷ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3698-3699.

⁷⁹⁸ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3697.

⁷⁹⁹ Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3698. Rustem Tetaj u pajtua me sugjerimin se kishte thashetheme nga më të ndryshmet në lidhje me fatin e "Sllobodanit" dhe "Milloshit", Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3768.

⁸⁰⁰ Prova materiale P369, f. 18; P390; P391; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 23, 25.

⁸⁰¹ Prova materiale P369, f. 18; P390, f. 3; P391, f. 4; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 33.

⁸⁰² Prova materiale P369, f. 18; P390, f. 3-4; P391, f. 5.

nga policia në fshatin Kodrali më 3 shtator 1998.⁸⁰³ Radovan Zllatkoviqi nga SPB-ja e Gjakovës dëshmoi se me urdhrin e tij dy policë intervistuan Bekim Kalimashin dhe Zenel Alijajn në gjuhën shqipe.⁸⁰⁴ Ai më tej theksoi se ishte i pranishëm gjatë kryerjes së intervistave, të cilat zgjatën dy ose tri ditë,⁸⁰⁵ por shtoi se nuk ishte i pranishëm gjatë gjithë kohës.⁸⁰⁶ Dhoma nuk dëgjoi dëshminë e asnjërit prej personave emrat e të cilëve qëndrojnë në këto deklarata dhënë SPB-së së Gjakovës. Në kohën kur u kryen intervistat, njëri prej policëve që po merrte deklaratat, Rade Vllahoviqi, ishte i bindur se prindërit e tij ishin rrëmbyer nga UÇK-ja.⁸⁰⁷ Radovan Zllatkoviqi dëshmoi se i udhëzoi policët që t'i bënin pyetjet në shqip dhe se ai mbajti shënim përgjigjet e përkthyerat prej tyre.⁸⁰⁸ Mirëpo ai theksoi se shënimet nuk i mbajti ai vetë, se këtë e bënte personat që bënte intervistat kurse ai vetë punoi në këtë çështje në bazë të këtyre shënimeve.⁸⁰⁹ Deklaratat u shkruan në serbisht pavarësisht se intervistat ishin bërë në shqip për arsye se Bekim Kalimashi nuk e fliste serbishten kurse Zenel Alija e fliste “vetëm pak”.⁸¹⁰ Një nga deklaratat që i atribuohen Bekim Kalimashit nuk është e nënshkruar.⁸¹¹ Dhoma nuk do të shqyrtojë më tej deklaratën e panënshkruar.

209. Dhoma gjithashtu mori shënimet zyrtare nga intervista dhënë zyrtarëve të RDB-së e Zenel Alijajt dhe Lul (Luli) Musajit, të cilët ishin në grupin e personave të arrestuar më 3 shtator 1998.⁸¹² Bogdan Tomashi dëshmoi se intervistat u kryen më 7 shtator 1998.⁸¹³ Ai më tej shtoi se ai dhe kolegu i tij shfrytëzuan të drejtën e paraparë me ligj për marrje në pyetje për tri ditë, dhe rrjedhimisht i bënte intervistat më 7, 9 dhe 10 shtator 1998.⁸¹⁴ Mirëpo në shënimet zyrtare që u

⁸⁰³ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 45-46; Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7014; Nebojsa Avramoviqi, Prova materiale P451, para. 23-24; Prova materiale P387; P388; P389; P390; P391; D179, D180, D189; D190.

⁸⁰⁴ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6940-6943, 6969; Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 51.

⁸⁰⁵ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 52.

⁸⁰⁶ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6955-6956.

⁸⁰⁷ Nebojsa Avramoviqi, Prova materiale P450 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6631.

⁸⁰⁸ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 51.

⁸⁰⁹ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6942-6943.

⁸¹⁰ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6940-6943, 6969; Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 51. Bogdan Tomashi i Sigurimit Shtetëror, i cili më pas intervistoi Zenel Alijajn dhe Lul (Luli) Musajin, dëshmoi se intervistat u kryen në gjuhën shqipe për arsye se ai supozoi se të intervistuarit nuk e njihnin sa duhej gjuhën serbe, Bogdan Tomash, Prova materiale P336 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6218-6219.

⁸¹¹ Prova materiale P390, e pranuar edhe si Prova materiale D189.

⁸¹² Prova materiale P339; P340. *Shih* gjithashtu Prova materiale P341.

⁸¹³ Bogdan Tomash, Prova materiale P338, para. 22; Bogdan Tomash, Prova materiale P336 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6192.

⁸¹⁴ Bogdan Tomash, Prova materiale P336 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6189-6190.

hartuan pas intervistave përmenden vetëm intervistat me Zenel Alijajn dhe Lul (Luli) Musajn të kryera gjegjësisht më 9 dhe 10 dhe më 8 e 9 shtator 1998.⁸¹⁵

210. Çështjet e lartpërmendura ngrenë dyshime në lidhje me besueshmërinë e këtyre deklaratave dhe shënimeve zyrtare. Si prova janë marrë edhe deklaratat në vijim: një deklaratë e Lul (Luli) Musaj dhënë Komisionit për Krime Lufte në Deçan më 9 nëntor 1999, ku thuhet se më 5 shtator 1998 ai u rrah në SPB-në e Gjakovës dhe se rrahjet vazhduan për 10 ditë;⁸¹⁶ një deklaratë tjetër e Lul (Luli) Musajt dhënë në korrik 2006 e cila përmban më shumë hollësi në lidhje me të njëjtat ngjarje;⁸¹⁷ dhe një deklaratë e Zenel Alijajt dhënë në maj 2006 ku thuhet se ai dhe disa të tjerë, ndër të cilët Bekim Kalimashi, gjatë arrestimit më 3 shtator 1998 u keqtrajtuuan dhe se Zenel Alijajn e torturuan dhe e detyruan me dhunë që të nënshkruante deklaratat gjatë paraburgimit të tij të mëvonshëm në SPB-në e Gjakovës.⁸¹⁸ Këto pretendime, së bashku me shqetësimet e theksuara në paragrafin e mësipërm ngrenë dyshime të mëdha në lidhje me besueshmërinë e deklaratave të Bekim Kalimashit dhe Zenel Alijajt dhënë SPB-së së Gjakovës dhe të shënimeve zyrtare nga intervistat me Zenel Alijajn dhe Lul (Luli) Musajn. Në rrethana të tilla, Dhoma nuk do t'i japë kurrfarë vlere informacionit të dhënë në deklaratat dhe në shënimet zyrtare nga intervistat.

211. Në lidhje me incidentin e Sllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit, djali i Sllobodan Radosheviqit, Stanisha Radosheviq,⁸¹⁹ rrëfeu disa versione të mundshme të fatit të mëtejshëm të babait të tij që kishte dëgjuar. Ai dëgjoi nga një mik, emri i të cilit nuk u përmend, se ai (miku) kishte dalë nga shtëpia e tij kur pjesëtarët të UÇK-së të veshur me uniforma kaluan me dy makina në të cilat ndodheshin Sllobodan Radosheviq dhe Millosh Radunoviq.⁸²⁰ Sipas dëshmisë së Stanisha Radosheviqit, miku i tij u rrah ndërsa u përpoq t'i ndalonte pjesëtarët e UÇK-së që të mos i merrnin me vete dy personat e lartpërmendur.⁸²¹ Nga rrëfimi i mikut të Stanisha Radosheviqit, ashtu siç e rirrëfeu Stanisha Radosheviq, është e paqartë nëse miku ishte në gjendje të vërente nëse Sllobodan Radosheviq dhe Millosh Radunoviq ishin rrahur.⁸²² Sipas dëshmisë së Stanisha Radosheviqit, pjesëtarët e UÇK-së me dy personat e lartpërmendur në makinë vazhduan

⁸¹⁵ Prova materiale P339; P340.

⁸¹⁶ Prova materiale D182, f. 1-2.

⁸¹⁷ Prova materiale D183.

⁸¹⁸ Prova materiale D184, f. 1-3.

⁸¹⁹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P310, f. 1.

⁸²⁰ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1001-1003, 1006, 1082, 1086-1087; Stanisha Radosheviq, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 996-999.

⁸²¹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1002-1003, 1006; Stanisha Radosheviq, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 996-999.

⁸²² Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1005, 1081.

rrugën në drejtim të Pozharit.⁸²³ Gjithashtu, miku i tha Stanisha Radosheviqit se kishte dëgjuar që Sllobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi më pas ishin vrarë dhe se kufomat e tyre ishin hedhur në skaj të rrugës afër vëndit të njohur si “Linkin Put”.⁸²⁴ Sipas Stanisha Radosheviqit, kur miku i tij shkoi në këtë vend për ta verifikuar, atje gjeti kufomat e kalbëzuara dhe me lopatën që e kishte sjellë me vete i mbuloi me pak dhe.⁸²⁵

212. Stanisha Radosheviqi dëshmoi edhe për një rrëfim të një miku tjetër me emrin Sllavisha Markoviqi. Stanisha Radosheviqi theksoi se një ditë pas keqtrajtimit që iu bë,⁸²⁶ Sllavisha Markoviqi erdhi nga Dashinoci dhe i tha se babai i tij Sllobodan Radosheviqi “me gjasë” ishte kapur dhe ishte vrarë.⁸²⁷ Sllavisha Markoviqi i tha Stanisha Radosheviqit se rreth orës 19:00 apo 19:30, kishte pasur “shumë të shtëna”, që sipas Stanisha Radosheviqit ishte sulmi kundër shtëpisë së babait të tij.⁸²⁸ Sipas dëshmisë së Stanisha Radosheviqit, Sllavisha Markoviqi fajësoi “terroristët” e UÇK-së për sulmin.⁸²⁹ Për mendimin e Stanisha Radosheviqit, askush tjetër nuk mund ta ketë bërë këtë gjë për arsye se të vetmit që kishin liri lëvizjeje në atë zonë ishin pjesëtarët e UÇK-së.⁸³⁰

213. Stanisha Radosheviqi dëgjoi thashetheme të ndryshme lidhur me fatin e babait të tij.⁸³¹ Sipas një versioni, Sllobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi u çuan në fshatin Prilep dhe më pas u plagosën.⁸³² Sipas këtij versioni, banorët e fshatit Prilep nuk donin që ata të qëndronin në fshat nga frika se mund t’u mbetej faji për çfarë kishte ndodhur.⁸³³ Më pas ata i çuan në Gllogjan dhe ata vdiqën atje, ose në Dashinoc.⁸³⁴ Sipas një versioni tjetër, Sllobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi u morën në pyetje dhe u plagosën në Gllogjan, më pas u çuan në Prilep të komunës së Deçanit dhe më në fund në Dashinoc ku u vranë ose u lanë që të vdisnin nga plagët.⁸³⁵

⁸²³ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1001-1002, 1006, 1082, 1087-1088.

⁸²⁴ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1006.

⁸²⁵ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1006; Stanisha Radosheviq, Prova materiale P307 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 996, 998.

⁸²⁶ *Shih* më lart, para. 195-202.

⁸²⁷ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 988, 1016.

⁸²⁸ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 988.

⁸²⁹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 988-989.

⁸³⁰ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 989.

⁸³¹ *Shih* gjithashtu Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 995, 1017.

⁸³² Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1084-1085.

⁸³³ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1084.

⁸³⁴ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1084.

⁸³⁵ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1007.

Stanisha Radosheviqi përmendi edhe një version të tretë, gjegjësisht se në arrestimin dhe me gjasë vrasjen e babait të tij mori pjesë Deli Lekaj, një pjesëtar i UÇK-së në Gillogjan.⁸³⁶

214. Dhoma vë në dukje se versionet lidhur me fatin e personave të lartpërmendur të cilët për herë të fundit u panë në Dashinoc⁸³⁷ janë rrëfime të dëgjuaara prej të tjerëve, në shumicën e rasteve prej më shumë njerëzve të cilët nuk janë identifikuar, dhe rrjedhimisht nuk janë të besueshme. Disa njerëz rrëfimet e të cilëve u diskutuan më sipër, si për shembull Deli Lekaj, qëllimisht mund të kenë zvogëluar apo shtrembëruar pjesmarrjen e tyre në këto ngjarje. Prokuroria nuk paraqiti prova të drejtpërdrejta lidhur me fatin e personave të zhdukur nga momenti kur për herë të fundit u panë në Dashinoc. Dhoma më tej gjykon se versionet e diskutuara më sipër ndryshojnë dukshëm dhe madje bien ndesh me njëri-tjetrin. Provat janë të pamjaftueshme për të nxjerrë një përfundim në lidhje me rrethanat e vdekjes së këtyre personave. Lidhur me Slllobodan Radosheviqin, Dhoma gjithashtu vë në dukje dëshminë e djalit të tij, Stanisha Radosheviqit,⁸³⁸ se në ditën kur ai e pa për herë të fundit, Slllobodan Radosheviqi kishte veshur një xhaketë kamuflimi dhe kishte një pushkë gjuetie.⁸³⁹ Kjo ngre së paku dyshim të arsyeshëm nëse Slllobodan Radosheviqi merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur vdiq.

215. Sipas hetimeve të kryera nga autoritetet serbe, kufomat e gjetura në afërsi të Dashinocit në komunën e Deçanit ishin të Slllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit.⁸⁴⁰ Në raportin serb të hetimit në vendin e ngjarjes janë paraqitur hollësitë e përfundimeve nga autopsia e kufomave të gjetura në vendzhvarrimet në liqen dhe në Dashinoc. Sipas këtij raporti, të gjitha kufomat e gjetura⁸⁴¹ kishin thyerje dhe shenja të tjera keqtrajtimi dhe u konstatua se vdekja e tyre ishte shkaktuar nga të shtëna me armë zjarri.⁸⁴² Në vendzhvarrimin në Dashinoc u gjetën letërnjoftimi dhe rrobat e Millosh Radunoviqit.⁸⁴³ Kufomat, të cilat sipas hetimit serb ishin të dy individëve të lartpërmendur, përbëhen nga katër copa eshtrash të sheshta të kafkës, për të cilat “ekzaminimi

⁸³⁶ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 1004.

⁸³⁷ *Shih* më lart, para. 203.

⁸³⁸ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 957, 1075.

⁸³⁹ Stanisha Radosheviq, Prova materiale P306 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 960-961, 1075-1076.

⁸⁴⁰ Prova materiale P369, f. 5-6, 57, *shih* gjithashtu f. 67; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 83-85, 170; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 67; Prova materiale D48, f. 1. *Shih* më poshtë, para. 375.

⁸⁴¹ Ky vlerësim i raportit i referohet kufomave që u gjetën në kanal, në Dashinoc dhe në fermë, Prova materiale P369, f. 6, konkretisht përmenden kufomat që u gjetën në këto vende, të përshkruara në këtë kapitull (Ilija Antiq, Jusuf Hoxha, Slllobodan Radosheviq, Darinka Kovaç dhe Vukosava Vujosheviq), me përjashtim të Millosh Radunoviqit i cili nuk përmendet në veçanti, Prova materiale P369, f. 3-5.

⁸⁴² Prova materiale P369, f. 6-7, 50.

⁸⁴³ Për këtë dhe tjetrën në vijim, *shih* më poshtë, para. 375.

antropologjik” tregoi se ishin të së paku tre personave të ndryshëm, dhe nga eshtra apo copëza eshtrash të tjera. Në bazë të provave të paraqitura, siç shtjellohet gjetkë, Dhoma konkludon se nuk u provua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kufomat e gjetura ishin faktikisht të Slobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit.⁸⁴⁴

216. Dhoma vë në dukje se nuk mori prova të tjera lidhur me Milica Radunoviqin dhe familjen Markoviq. Rrjedhimisht, Dhoma përfundon se provat e marra janë të pamjaftueshme ose jo aq të besueshme sa të mundësojnë përcaktimin e rrethanave të vdekjes së personave të zhdukur nga Dashinoci, identitetin e keqbërësve apo implikimin e UÇK-së.

(v) Dara (Darinka) Kovaçi (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq), Vukosava Markoviqi (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq), Millovan Vllahoviqi dhe Milka Vllahoviqi

217. Dhoma mori prova dytësore se gjatë natës së 20 prillit 1998 e deri në mëngjesin e 21 prillit 1998, nga fshati Glllogjan UÇK-ja shtiu me armë zjarri në drejtim të shtëpive të serbëve të Kosovës në fshatin Ratishë e Epërme të komunës së Deçanit.⁸⁴⁵ Më 21 prill 1998, në orën 07:15, UÇK-ja dhe civilë të armatosur erdhën në fshat me traktorë e kamionë dhe filluan të shtinin me armë në ajër mbi shtëpitë e serbëve të Kosovës.⁸⁴⁶ Serbët e Kosovës i braktisën shtëpitë e tyre dhe më pas UÇK-ja mori kontrollin mbi fshatin.⁸⁴⁷ Sipas provave dytësore, Dara (Darinka) Vujosheviqi, Vukosava Vujosheviqi, si dhe prindërit e Nada Vllahoviqit, Millovan Vllahoviq dhe Millka Vllahoviq, nuk u larguan nga fshati Ratishë e Epërme i komunës së Deçanit.⁸⁴⁸ Fshatarët e asaj zone i thanë Marijana Angjelkoviqit, e cila në atë kohë punonte si hulumtuuese në një organizatë të të drejtave të njeriut,⁸⁴⁹ se Nada Vllahoviqi dhe vëllai i saj që ishin larguar nga fshati më 21 prill 1998 u përpoqën të ktheheshin në fshat për të marrë prindërit e tyre por ushtarë të UÇK-së i ndaluan dhe i kthyen

⁸⁴⁴ *Shih* më poshtë, para. 335-336, 375-376.

⁸⁴⁵ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10229, 10232-10234; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10229, 10232-10234; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 48-49. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10228-10230, 10234; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10228-10230, 10234. *Shih* gjithashtu më lart, para. 151; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 13.

⁸⁴⁶ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10229, 10235; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10229, 10235; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 49.

⁸⁴⁷ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10228; Dëshmitari 28, Prova materiale P356 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10228; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 49, 51; Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 598.

⁸⁴⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 48; Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 525-526; Prova materiale P443, f. 6; P445, f. 17; P448, f. 8.

⁸⁴⁹ Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 464, 466-468.

mbrapsht.⁸⁵⁰ Sipas rrëfimeve prej njerëzve të ndryshëm, fshatarët që mbetën në Ratishë të Epërme u zhdukën.⁸⁵¹ Zoran Stijoviqi dëshmoi se sipas informacionit të RDB-së, Millovan Vllahoviqi me bashkëshorten e tij dhe motrat Vujosheviq u vranë, por ai nuk paraqiti fakte në mbështetje të këtij pretendimi.⁸⁵²

218. Më lart u përmendën deklaratat për të cilat pretendohet se policia serbe i mori nga Bekim Kalimashi, një ushtar i UÇK-së i zënë rob.⁸⁵³ Sipas informacionit në këto deklarata që i atribuohen Bekim Kalimashit, në maj ose qershor 1998, ai mori pjesë në rrëmbimin e disa personave nga fshati Ratishë e Epërme në komunën e Deçanit me urdhrin e Jah Brahimajt,⁸⁵⁴ “komandant për fshatin Jabllanicë” të komunës së Gjakovës, i cili mori pjesë në rrëmbimet.⁸⁵⁵ Në deklaratat thuhet se njëri nga viktimat ishte një burrë i moshuar me shtatlartësi mesatare, me mustaqe dhe me një kapelë të zezë me vija të bardha.⁸⁵⁶ Sipas Nebojshta Avramoviqit, specialist i kriminalistikës,⁸⁵⁷ ky përshkrim përkon me përshkrimin e dhënë në një raport për persona të zhdukur të paraqitur nga familja e një personi të zhdukur dikur në prill 1998.⁸⁵⁸ Sipas deklaratave që i atribuohen Bekim Kalimashit, këta njerëz më vonë u mbajtën në Jabllanicë të komunës së Gjakovës, dhe sipas rrëfimeve që kishte dëgjuar ata u keqtrajtuuan dhe u vranë.⁸⁵⁹

219. Versionet rreth fatit të personave të zhdukur të lartpërmendur nga fshati Ratishë e Epërme janë rrëfime të të tjerëve, pjesërisht të paidentifikuara dhe të kaluara gojë pas goje, dhe për këto arsye, jo të besueshme. Sikurse ka shpjeguar gjetiu, Dhoma në veçanti dyshon në besueshmërinë e

⁸⁵⁰ Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 598.

⁸⁵¹ Prova materiale P369, f. 10-11, 16, 18 (çifti Vllahoviq), f. 19, 69-74 (motrat Vujosheviq); Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 525-526, 662; Prova materiale P443, f. 6, 19; P445, f. 17; P448, f. 3, 8.

⁸⁵² Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 51.

⁸⁵³ *Shih* më lart, para. 207-210; Prova materiale P369, f. 18; P390; P391; Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para 23, 25; Prova materiale D189; D190.

⁸⁵⁴ Emrat Jah Brahimaj, Lah Ibrahim, Lahi Ibrahim, Jah Ibrahim, Lahi Ibrahim që përmenden në provat materiale i referohen komandantit të Jabllanicës, Prova materiale P369, f. 18; P390, f. 3; P391, f. 5.

⁸⁵⁵ Prova materiale P369, f. 18; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 53; Prova materiale P390, f. 3; P391, f. 3-4; Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 32; Prova materiale D189, f. 3; D190, f. 4.

⁸⁵⁶ Prova materiale P390, p. 3; P391, p. 5; Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 32; Prova materiale D189, p. 3; D190, p. 5.

⁸⁵⁷ Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6591; Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 7.

⁸⁵⁸ Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 32.

⁸⁵⁹ Prova materiale P369, f. 18; P390, f. 3-4; P391, f. 5; D189, f. 3-4; D190, f. 5.

deklaratave që i atribuohen Bekim Kalimashit.⁸⁶⁰ Rrjedhimisht, Dhoma nuk do të mbështetet në asnjë nga versionet e lartpërmendura.

220. Sipas hetimeve serbe, kufomat e Darinka Kovaçit (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq), Vukosava Markoviçit (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq) dhe Milka Vllahoviçit nga fshati Ratishë e Epërme i komunës së Deçanit u gjetën në vendzhvarrimin e liqenit të Radoniçit.⁸⁶¹ Në raportin e lartpërmendur serb të hetimit në vendin e ngjarjes janë paraqitur hollësitë e përfundimeve nga autopsia e kufomave të gjetura në vendzhvarrimet në liqen dhe në Dashinoc. Sipas këtij raporti, të gjitha kufomat e gjetura⁸⁶² kishin shenja keqtrajtimi dhe thyerje dhe raporti konkludon se shkaku i vdekjes ishin të shtënat me armë zjarri.⁸⁶³ Kufoma e cila sipas raportit ishte e Vukosava Markoviçit (e shënuar me “R-10”) kishte një vrimë plumbi përmes legenit, thyerje të shumta në krahun e majtë dhe një thyerje në kofshën e djathtë.⁸⁶⁴ Autopsia e kufomës e cila sipas raportit ishte e Darinka Kovaçit (e shënuar me “R-17”) konstatoi një vrimë në ashtin e majtë të legenit të shkaktuar nga një plumb arme zjarri, thyerje të shumta në krahun e majtë dhe një thyerje në kofshën e djathtë.⁸⁶⁵ Dhoma konkludoi gjetkë se kufomat e shënuara me “R-10” dhe “R-17” ishin të Vukosava Markoviçit dhe Darinka Kovaçit.⁸⁶⁶ Dhoma më herët gjithashtu konstatoi se kufoma e shënuar me “R-35” ishte e Milka Vllahoviçit.⁸⁶⁷ Shkaku i vdekjes i kufomës së shënuar me “R-35” nuk u përcaktua.⁸⁶⁸

221. Rrjedhimisht, Dhoma përfundon se provat e marra janë të pamjaftueshme ose jo aq të besueshme sa të mundësojnë përcaktimin e rrethanave të vdekjes së personave të zhdukur nga Ratisha e Epërme, identitetin e keqbërësve apo implikimin e UÇK-së.

⁸⁶⁰ *Shih* më lart, para. 207-210.

⁸⁶¹ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 48; Prova materiale P369, f. 4-6, 57; P428, f. 2; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 170; Dushan Dunjiç, Prova materiale P470, para. 304, 593-594. Pjesët e kufomës të shënuara me “R-15” që u gjetën në liqen fillimisht u identifikuan si të Millovan Vllahoviçit por më vonë përmes analizës së ADN-së u vërtetua se i përkisnin Istref Krasniçit, Prova materiale P369, f. 57; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 170; Dushan Dunjiç, Prova materiale P470, para. 381-383. *Shih* më poshtë, para. 334-335.

⁸⁶² Ky vlerësim i raportit u referohet kufomave të gjetura në kanal, në Dashinoc dhe në fermë, Prova materiale P369, f. 6, konkretisht përmenden kufomat e gjetura në këto vende të shtjelluara në këtë kapitull (Ilija Antiqi, Jusuf Hoxha, Sillobodan Radosheviç, Darinka Kovaçi dhe Vukosava Vujosheviç), me përjashtim të Millosh Radunoviçit i cili nuk përmendet shprehimisht, Prova materiale P369, f. 3-5.

⁸⁶³ Prova materiale P369, f. 6-7, 50.

⁸⁶⁴ Dushan Dunjiç, Prova materiale P470, para. 300, 304.

⁸⁶⁵ Dushan Dunjiç, Prova materiale P470, para. 401, 408.

⁸⁶⁶ *Shih* më poshtë, para. 340.

⁸⁶⁷ *Shih* më poshtë, para. 337.

⁸⁶⁸ Dushan Dunjiç, Prova materiale P470, para. 593, 597-598.

(vi) Incidente të tjera

222. Më 2 mars 1998, në orën 16:00, gjatë sulmit mbi makinën e tij të tipit Lada të kryer në fshatin Ratishë e Poshtme të komunës së Deçanit u vra Sllobodan Prashqeviqi, polic në pension.⁸⁶⁹ Në raportin e atëhershëm të RDB-së së Gjakovës të datës 3 mars 1998 thuhet se sulmin e kryen “terroristë shqiptarë”.⁸⁷⁰ Pavarësisht nga ky raport, sipas Zoran Stijoviqit, punonjës i Sigurimit Shtetëror serb,⁸⁷¹ nga hetimet e policisë u konstatua se viktimi nuk u vra nga UÇK-ja dhe se vdekja e tij lidhej me motive personale.⁸⁷² Në bazë të kësaj dhe në mungesë të provave të tjera, ky incident nuk do të shqyrtohet më tej.

223. Më 6 mars 1998, në orën 18:00, u sulmua Stevan Masllovariqi nga fshati Plançor i komunës së Gjakovës. Provat nuk ofruan hollësi në lidhje me këtë sulm. Nebojsa Avramoviqi, specialist i kriminalistikës,⁸⁷³ dëshmoi se sipas një raporti të balistikës, gëzhojat e plumbave në këtë sulm ishin të njëjta me ato gjatë shkëmbimit të zjarrit midis UÇK-së dhe forcave serbe në shtëpitë e familjes Haradinaj,⁸⁷⁴ që, sikurse konkludoi Dhoma më parë, ndodhi më 24 mars 1998.⁸⁷⁵

224. Burime të ndryshme provash sugjerojnë se mjeku serb Mirko Peshiq dhe shoferi i tij me mbiemrin Zeçeviq u rrëmbyen dhe u morën në pyetje në afërsi të Deçanit më 13 prill 1998 ose para kësaj date, por u liruan për arsye se punonin për një organizatë shëndetësore ndërkombëtare.⁸⁷⁶ Nuk u paraqit kurrfarë informacioni lidhur me identitetin e rrëmbyesve.

225. Dhoma mori dëshmi dytësore të pakonfirmuara lidhur me sulmin kundër lagjes së refugjatëve serbë në Baballoq të komunës së Deçanit të kryer më 18 dhe 19 prill 1998. Banorë të kësaj lagjeje i thanë Dëshmitarit 28 se në mbrëmjen e 18 prillit 1998, nga drejtimi i fshatit shqiptar kosovar Baballoq apo Suka e Baballoqit, UÇK-ja sulmoi shtëpinë e Zharko Zllatiçaninit në këtë

⁸⁶⁹ Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9061-9064; Zoran Stijoviq, Prova materiale P123 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9061-9064; Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P441 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 667-668. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁸⁷⁰ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁸⁷¹ Zoran Stijoviq, T. 537; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 2; Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8871, 9096.

⁸⁷² Zoran Stijoviq, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9061-9064; Zoran Stijoviq, Prova materiale P123 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9061-9064; Marijana Angjelkoviq, Prova materiale P440 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 490, 675. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁸⁷³ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 7.

⁸⁷⁴ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6710-6711; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 187, 189. Aktekspertiza balistike nuk u paraqit si provë materiale. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 330.

⁸⁷⁵ *Shih* më lart, para. 144-149.

⁸⁷⁶ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 51; Prova materiale P448 f. 1.

lagje.⁸⁷⁷ Nuk pati të lënduar nga sulmi.⁸⁷⁸ Të njëjtët banorë i thanë Dëshmitarit 28 se UÇK-ja shtinte me armë zjarri në drejtim të shtëpive të kësaj lagjeje “ditë e natë” nga i njëjti drejtim, duke vazhduar edhe më 19 prill 1998.⁸⁷⁹

226. Dëshmitari 28 mori informacion lidhur me zhdukjen e Branko Stamatoviçit më 25 prill 1998, serb i Kosovës nga fshati Prilep i komunës së Deçanit.⁸⁸⁰

227. Më 13 maj 1998, Dragan Zhivanoviçiq nga postëkomanda pararojë e Pejës i raportoi Komandës së Korpusit të Prishtinës se ishte vrarë një shqiptar kosovar i besimit katolik nga fshati Baran i komunës së Pejës për shkak se kishte refuzuar t’i bashkohej UÇK-së.⁸⁸¹

228. Raporti i rregullt i luftimit i Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së i datës 20 maj 1998 përmban një përmbledhje incidentesh lidhur me shqiptarë kosovarë të armatosur, ndër të cilat incidenti i 19 majit 1998 kur “u hap zjarr me armë këmbësorie” mbi një autobus që po lëvizte në rrugën Prilep -Deçan. Në raport pretendohet se sulmuesit ishin të vendosur përgjatë rrugës në afërsi të urës mbi lumin “Bistrica e Lloqanit”.⁸⁸²

229. Në raportin e SPB-së së Gjakovës të datës 21 dhjetor 1998 drejtuar prokurorit të qarkut të Pejës dhe hartuar prej Radovan Zllatkoviçit⁸⁸³ përmenden disa incidente për të cilat thuhet se janë kryer prej Ramush Haradinajt dhe “grupit” rreth tij apo prej “grupeve diversante-terroriste shqiptare”.⁸⁸⁴ Në raport përmendet vrasja e Vebi Mustafës dhe plagosja e rëndë e Boshko Vllahoviçit, Misho Mijoviçit, Dragan Gjurishiçit dhe Ernand Muminoviçit më 7 maj 1998 në komunën e Deçanit;⁸⁸⁵ hapje zjarri kundër Marko Kërstoviçit dhe Kujtim Gjokës në kohën kur ata ishin në makinat e tyre më 23 maj 1998 në fshatin Prilep të komunës së Deçanit;⁸⁸⁶ dhe vrasja me armë zjarri e Vidosava Simiçit në shtëpinë e saj në fshatin Lloqan të komunës së Deçanit më 31 maj

⁸⁷⁷ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10180-10182, 10263; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 40-41.

⁸⁷⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 40.

⁸⁷⁹ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10181-10182, 10263; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 41.

⁸⁸⁰ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10196; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 53.

⁸⁸¹ Dragan Zhivanoviçiq, Prova materiale P111, para. 48; Dragan Zhivanoviçiq, Prova materiale P112, para. 48.

⁸⁸² Dragan Zhivanoviçiq, Prova materiale P112, para. 80; Prova materiale P114, para. 1.

⁸⁸³ Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6907; Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P373, para. 13 (f. 8, 11); Prova materiale P383.

⁸⁸⁴ Prova materiale P383, f. 3. Dhoma diskutoi gjetkë vlerën provuese të këtij raporti, *shih* më lart, para. 165.

⁸⁸⁵ Prova materiale P383, f. 13.

⁸⁸⁶ Prova materiale P383, f. 8.

1998.⁸⁸⁷ Sipas Radovan Zllatkoviçit, shumica e personave që u zhdukën, ishin të ashtuquajtur “shqiptarë besnikë” apo ishin njerëz që me gjasë ishin në hasmëri me të tjerë; në përgjithësi, këta njerëz nuk krijojnë probleme dhe e respektojnë ligjin.⁸⁸⁸

230. Dhoma mori deklaratën që pretendohet se Zenel Alijaj i dha policisë serbe. Sipas kësaj prove, Zenel Alijaj dëgjoi se në Dujakë të komunës së Pejës, njësia e Togerit kishte zënë një njeri nga Peja, rreth 190 centimetra i gjatë, bjond dhe me mjekër, dhe e kishte çuar atë në Gllogjan me gjasë nga fundi i majit 1998, ku ai u mbajt i burgosur. Sipas deklaratës, Zenel Alijaj dëgjoi se më vonë ai u vra.⁸⁸⁹ Dhoma përfundoi gjetkë⁸⁹⁰ se nuk mund të mbështetet në këtë provë për arsye se ajo nuk ka vlerën e mjaftueshme provuese dhe nuk mbështetet nga prova të tjera të besueshme.

231. U raportua se Jusuf Hoxha ishte zhdukur më 26 qershor 1998 në qafën e Duhlës në komunën e Suharekës, midis Prizrenit dhe Suharekës.⁸⁹¹ Sipas dëshmive të dorës së dytë që kishte dëgjuar Nebojsa Avramoviç, specialist i kriminalistikës,⁸⁹² Jusuf Hoxha kishte qenë informator i policisë për krime të vogla, vjedhje, thyerje dhe plaçkitje dyqanesh, e të tjerë.⁸⁹³ Sipas hetimeve të policisë serbe, kufoma e Jusuf Hoxhës u gjet në vendzhvarrimin e kanalit të liqenit të Radoniçit. Sikurse u shtjellua gjetkë, Dhoma nuk e pranon këtë identifikim.⁸⁹⁴ Vendi ku u raportua se ishte zhdukur Jusuf Hoxha është jashtë zonës që përfshin Aktakuza. Rrjedhimisht ky incident nuk do të shqyrtohet më tej.

232. U raportua se Ilija Antiqi u pa për herë të fundit më 28 qershor 1998.⁸⁹⁵ Sipas hetimeve të policisë serbe, kufoma e Ilija Antiqit u gjet në kanalën e liqenit të Radoniçit.⁸⁹⁶ Sipas dëshmisë së Dushan Dunjiçit, autopsia e kufomës së shënuar me “R-20”, e cila nga ekipi mjekoligjor i Beogradit u identifikua si kufoma e Ilija Antiqit,⁸⁹⁷ konstatoi thyerje të shumta, midis të tjerash, në kafkë,

⁸⁸⁷ Prova materiale P378; P383, f. 6. *Shih* gjithashtu Prova materiale P378, f. 2-3, kallëzim penal ku thuhet se për shkaqe sigurie nuk u krye hetim në vendin e ngjarjes dhe nuk u identifikuan autorët e veprës penale të terrorizmit.

⁸⁸⁸ Radovan Zllatkoviç, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7070-7071.

⁸⁸⁹ Prova materiale P389, f 1, 3-4.

⁸⁹⁰ *Shih* më lart, para. 208-210.

⁸⁹¹ Prova materiale P369, f. 60; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6592-6593; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 170.

⁸⁹² Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6591; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 7.

⁸⁹³ Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6591.

⁸⁹⁴ Prova materiale P369, f. 4-5, 57; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 170. Dhoma gjykon se provat e marra nuk vërtetojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se pjesët e kufomës që u gjetën në liqen ishin të Jusuf Hoxhës, *shih* më poshtë, para. 341.

⁸⁹⁵ Prova materiale P369, f. 75-77.

⁸⁹⁶ Prova materiale P369, f. 3, 5, 57; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 170.

⁸⁹⁷ *Shih* më poshtë, para. 334.

nofullën e poshtme, në brinjët nga ana e majtë, në dy kërcinjte, në eshtrat e krahut të majtë, të cilat nuk ishin shkaktuar nga rënia në hendek.⁸⁹⁸ Dhoma vë në dukje se identifikimi i kësaj kufome nuk u bë përmes analizës së ADN-së dhe në rrethana të tilla përfundon se provat përkatëse nuk vërtetojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kufoma e shënuar me “R-20” ishte faktikisht e Ilija Antiqit.⁸⁹⁹

233. Cufë Krasniqi, pjesëtar i UÇK-së në atë kohë,⁹⁰⁰ dëshmoi para Dhomës se dëgjoi nga të tjerë se nga fundi i qershorit 1998, UÇK-ja kishte kapur Sali Shkrelin nga fshati Kosuriq i komunës së Pejës, për të cilin dihej se punonte për RDB-në.⁹⁰¹ Sipas Cufë Krasniqit, Idriz Balaj (me pseudonimin “Togeri”) dhe Metë Krasniqi e morën në pyetje në Baran të komunës së Pejës.⁹⁰² Sipas dëshmisë së Cufë Krasniqit, Sali Shkreli tha se Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj e kishin liruar kur ai u kishte thënë që ai vetë dhe familja e tij donin t’i bashkoheshin UÇK-së.⁹⁰³

234. John Crosland-i dëshmoi se kohë pas kohe i kërkonin që të shkonte dhe të vizitonte vendet ku ishin lënë kufoma anës rrugës. Atij i kujtohej një rast në një datë të pacaktuar në rrugën Pejë-Prishtinë në afërsi të Pejës dhe një rast tjetër në Rakovinë të komunës së Gjakovës. Sipas tij, ishte shumë e vështirë të përcaktohej se kush ishte përgjegjës për këto vrasje duke marrë parasysh se në Kosovë ndodhnin krime ordinere dhe hakmarrje që përfundonin në vrasje.⁹⁰⁴

235. Disa nga provat e lartpërmendura nuk përmbajnë hollësi rreth datës, kohës apo vendit të ngjarjeve. Shumë prej dokumenteve nuk përmbajnë informacion në lidhje me burimin e informacionit, nëse informacioni ishte i drejtpërdrejtë apo i kaluar goja-gojës, dhe në shumicën e rasteve i pakonfirmuar. Rrjedhimisht, Dhoma do t’u japë peshë të vogël provues materialeve të tilla. Në këtë aspekt, Dhoma në veçanti konstaton se dokumentet në të cilat raportohen raste rrëmbimi, keqtrajtimi apo vrasje civilësh të kryera në periudhën e Aktakuzës, krimet i ngarkohen “grupeve diversante-terroriste shqiptare” dhe Ramush Haradinajt dhe grupit rreth tij pa paraqitur fakte konkrete në mbështetje të pretendimeve të tilla. Dhoma konkludon se prova të tilla lidhur me keqbërësit nuk janë aq të besueshme sa të vërtetojnë implikimin e UÇK-së apo të individëve konkretë. Për disa nga rastet e lartpërmendura Dhoma madje nuk mori asnjë provë lidhur me autorët e krimit.

⁸⁹⁸ Dushan Dunjiq, Prova materiale P470, para. 449.

⁸⁹⁹ *Shih* më poshtë, para. 341.

⁹⁰⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 30.

⁹⁰¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 80.

⁹⁰² Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 80.

⁹⁰³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5841; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 81.

⁹⁰⁴ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4701.

(vii) Përfundim

236. Bazuar në sa më sipër, Dhoma konkludon se është vërtetuar se në pranverë të vitit 1998, ushtarë të UÇK-së rrëmbyen dhe rrahën Jah Bushatin; se më 18 prill 1998, ushtarë të UÇK-së rrahën Mijat Stojanoviçin, Dragosllav Stojanoviçin dhe Veselin Stijoviçin, që të gjithë serbë të Kosovës; dhe se më 22 prill 1998, ushtarë të UÇK-së rrahën Novak Stijoviçin dhe Stanisha Radosheviçin, dy serbë të Kosovës. Dhoma përfundon se të gjitha viktimat e lartpërmendura ishin civilë.⁹⁰⁵ Ndryshe, për arsytet e shtjelluara më lart, Dhoma gjykon se nuk mund të mbështetet në materialin e mësipërm për të nxjerrë një përfundim të bazuar në fakte se UÇK-ja mori pjesë në keqtrajtimin apo vrasjen e civilëve.

(b) Deklarata të përgjithshme lidhur me rrëmbimin, keqtrajtimin dhe vrasjen e civilëve nga UÇK-ja

237. Dhoma mori një numër të madh deklaratash të përgjithshme lidhur me sulmet e UÇK-së kundër civilëve të kryera gjatë periudhës kohore dhe në zonën gjeografike që mbulon Aktakuza.

238. Dëshmitari Zoran Stijoviç paraqiti të dhëna statistikore lidhur me sulme të kryera në një zonë më të gjërë gjeografike dhe gjatë një periudhe më të gjatë kohore se ajo e pretenduar në Aktakuzë, por që gjithashtu mbulojnë sulme të kryera në zonën gjeografike dhe periudhën kohore të Aktakuzës, të shtjelluara në këtë kapitull. Zoran Stijoviç theksoi se si shef i degës për analiza të qendrës së RDB-së në Prishtinë,⁹⁰⁶ ai hartoi një pasqyrë të sulmeve “terroriste” kundër policisë dhe shqiptarëve kosovarë “të cilët nuk e përkrahnin planin e separatistëve” të kryera në vitin 1998, gjithsej 1,486 sulme të kryera gjatë periudhës 1 janar-30 nëntor 1998. Kjo shifër përfshinte vrasjen e 90 civilëve shqiptarë dhe serbë të Kosovës, plagosjen e 96 civilëve dhe rrëmbimin e 221 personave fati i të cilëve ende nuk dihet.⁹⁰⁷

239. Dëshmitari 69 theksoi se në vitin 1998, ai ishte i informuar nga zbulimi dhe shërbimi policor se një organizatë që vepronte në zonën e Dukagjinit i kërcënonte shqiptarët kosovarë në atë zonë, ushtronte presion në mënyra të ndryshme, i rrihte dhe i rrëmbente për t'i detyruar t'i bashkoheshin

⁹⁰⁵ *Shih* më poshtë, para. 176, 182-183, 195.

⁹⁰⁶ Zoran Stijoviç, T. 537; Zoran Stijoviç, Prova materiale P121, para. 2; Zoran Stijoviç, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8871, 9096-9097.

⁹⁰⁷ Zoran Stijoviç, Prova materiale P121, para. 20, 62; Zoran Stijoviç, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8933-8934, 9058. Zoran Stijoviç theksoi se këto shifra bazoheshin në informacionin e MPB-së (duke përfshirë një botim zyrtar), të RDB-së, mediave dhe të ushtrisë. Ai shpjegoi burimin e shifrave dhe hollësitë e metodologjisë së tij, duke përfshirë mënyrën e dallimit midis sulmeve “terroriste” dhe sulmeve që nuk kishin të bënin me “terrorizëm”, Zoran Stijoviç, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8933-8948, 8953-8958, 9058.

apo ta përkrahnin këtë organizatë moralisht dhe financiarisht.⁹⁰⁸ Sipas dëshmisë së Dëshmitarit 69, pjesëtarët e këtij grupi kërcënonin ose vrisnin shqiptarët kosovarë që refuzonin t'i bashkoheshin grupit. Për këtë arsye, shumë shqiptarë kosovarë iu bashkuan këtij grupi.⁹⁰⁹

240. Dëshmitari 69 dëshmoi se nga fillimi i pranverës së vitit 1998 u rrit numri i pritave dhe sulmeve kundër civilëve dhe filluan rrëmbimet e civilëve serbë, shqiptarë dhe romë të Kosovës. Sipas Dëshmitarit 69, kjo dukej qartë nga kallëzimet e qytetarëve në polici dhe nga informacioni i zbulimit dhe përputhej me kujtesën e tij nga ajo kohë.⁹¹⁰ Sipas Dëshmitarit 69, policia kishte parë vetë ose kishte “dyshim të arsyeshëm” se UÇK-ja ishte e implikuar në këto ngjarje.⁹¹¹

241. Nebojsa Avramoviqi dëshmoi se nga marsi e deri në fund të gushtit 1998, të gjithë serbët e Kosovës që kishin mbetur në zonat e kontrolluara prej UÇK-së ishin rrëmbyer.⁹¹² Ai shpjegoi se këtë informacion policia e merrte nga anëtarët e familjeve të të zhdukurve, nga “burime” që punonin për policinë, përmes kallëzimeve dhe raporteve dhe nga marrja në pyetje e ushtarëve të UÇK-së të zënë rob.⁹¹³ Ai kishte parë dokumente, raporte dhe kishte folur me kolegët e tij lidhur me personat e zhdukur. Midis të zhdukurve nga ajo zonë kishte edhe shqiptarë kosovarë të cilët ishin besnikë ndaj shtetit, domethënë nuk donin të luftonin kundër shtetit.⁹¹⁴

242. Dëshmitari 28 fitoi përfshypjen se gjatë përleshjeve midis UÇK-së dhe forcave policore në zonën e Dukagjinit në mars dhe prill të vitit 1998, UÇK-ja dhe forcat serbe sulmonin popullatën e njëra-tjetrës, gjë që shkaktoi largimin e popullatës civile, në dallim nga dhuna e “pakontrolluar” prej personave të panjohur.⁹¹⁵ Dëshmitari 28 “mësoi” se disa serbë të Kosovës ishin arrestuar dhe rrahur në shtabin e UÇK-së në Glllogjan në komunën e Deçanit.⁹¹⁶ Dëshmitari deklaroi se në mars të 1998, UÇK-ja kreu sulme në lindje të rrugës Prishtinë-Gjakovë-Pejë “brenda trekëndëshit Deçan-

⁹⁰⁸ Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9857-9858; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 11.

⁹⁰⁹ Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 11.

⁹¹⁰ Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9859-9860; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 21-23, 25.

⁹¹¹ Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9860.

⁹¹² Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6600.

⁹¹³ Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6600, 6604. Lidhur me këtë, Dhoma gjithashtu vëren se sipas dëshmitarit, inspektimi i vendit të ngjarjes gjatë hetimeve të rasteve të rrëmbimeve ishte i pamundur në atë kohë dhe në zonën e kontrolluar nga UÇK-ja dhe për këto arsye policia nuk kryente hetime, Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6603-6604.

⁹¹⁴ Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6602.

⁹¹⁵ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10178, 10182-10184, 10201.

⁹¹⁶ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10201.

Gjakovë-Klinë”, por se kushtet në vetë rrugën ishin normale.⁹¹⁷ Në raportin e Brigadës së Motorizuar 549 të UJ-së të datës 5 mars 1998 përmendet “përshkallëzimi i veprimtarisë terroriste” dhe sulme kundër popullatës serbe të Kosovës në fshatrat Bec dhe Cërmjan në komunën e Gjakovës dhe në Ratishë të komunës së Deçanit.⁹¹⁸

243. Zoran Stijoviqi, punonjës i RDB-së,⁹¹⁹ dëshmoi se në bazë të informacionit të marrë nga Vllado Mirçiqi, punonjës operativ i RDB-së së Deçanit, pas sulmit kundër shtëpive të familjes Haradinaj më 24 mars 1998, numri i keqtrajtimit dhe sulmeve prej UÇK-së u rrit.⁹²⁰ Ai më tej theksoi se në shënjestër u vunë shqiptarë dhe romë kosovarë që dyshohej se ishin bashkëpunëtor dhe se sipas patologëve që kryen autopsitë, në shumicën e kufomave të viktimave ishin të pranishme shenja të torturës.⁹²¹ Dhoma vëren se dëshmitari nuk paraqiti informacion tjetër lidhur me identitetin e viktimave të pretenduara, me vendin e vrasjes së tyre, identitetin e vrasësve dhe vendin e gjetjes së kufomave të tyre.

244. Radovan Zllatkoviqi, asokohe hetues në Gjakovë,⁹²² gjithashtu vlerësoi se pas 24 marsit 1998, aksionet e grupeve të armatosura shqiptare kosovare u shtuan në masë të konsiderueshme. Sipas tij, duke filluar nga kjo datë shqiptarë kosovarë të armatosur vepronin në zonën rreth liqenit të Radoniqit, domethënë në gjithë komunën e Deçanit dhe në një pjesë të komunës së Gjakovës. Sipas dëshmisë së tij e cila nuk ofron hollësi të tjera, ata rrëmbyen serbë të Kosovës, malazezë të Kosovës, katolikë, shqiptarë kosovarë të “pabindur” dhe romë të Kosovës në fshatrat Ratishë e Epërme, Ratishë e Poshtme dhe Lumbardh në komunën e Deçanit dhe në fshatin Plançor të komunës së Gjakovës.⁹²³

245. Dragan Zhivanoviqi, shef i shtabit të komandës së Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së,⁹²⁴ theksoi se në prill të vitit 1998, në Pejë u ngrit postëkomanda pararojë e Brigadës së Motorizuar 125 për arsye se “grupet terroriste” po shtoheshin gjithnjë e më shumë fshatra dhe sulmonin postbllloqet e MPB-së. Sipas tij, grupet e armatosura shqiptare kosovare “rrëmbejnë dhe vrisnin serbë [të

⁹¹⁷ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 56.

⁹¹⁸ Prova materiale P30, f. 1.

⁹¹⁹ Zoran Stijoviqi, T. 537; Zoran Stijoviqi, Prova materiale P121, para. 2; Zoran Stijoviqi, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8871, 9096.

⁹²⁰ Zoran Stijoviqi, Prova materiale P121, para. 51.

⁹²¹ Zoran Stijoviqi, Prova materiale P121, para. 56.

⁹²² Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 10-11. Zona e përgjegjësisë së dëshmitarit në atë kohë përfshinte, midis të tjerash, rrugën Prishtinë-Gjakovë, rrugën Gjakovë-Pejë dhe pjesë të komunës së Gjakovës dhe Deçanit, po aty, para. 11.

⁹²³ Radovan Zllatkoviqi, P373, para. 28.

⁹²⁴ Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P112, para. 3.

Kosovës], romë [të Kosovës] dhe shqiptarë [kosovarë] që ishin besnikë ndaj shtetit të Serbisë”.⁹²⁵
 Dragan Zhivanoviqi nuk paraqiti hollësi në lidhje me këto veprime.

246. Dhoma mori edhe vlerësimin e përgjithshëm të Nebojsa Avramoviqit, specialist i kriminalistikës, në lidhje me gjendjen e civilëve në periudhën rreth 21 dhe 22 prillit 1998.⁹²⁶ Ai deklaroi se serbët e Kosovës që kishin mbetur në Deçan dhe në zonën nga të dyja anët e rrugës Gjakovë-Pejë, e cila në thelb ishte vija e frontit në atë kohë, u dëbuan ose u rrëmbyen. Kjo zonë përfshinte fshatrat Pozhar, Dashinoc dhe Ratishë të komunës së Deçanit. Sipas Nebojsa Avramoviqit, UÇK-ja hapte zjarr kundër automjeteve civile dhe të policisë që lëviznin përgjatë asaj rruge.⁹²⁷

247. Nebojsa Avramoviqi deklaroi se kishte marrë pjesë në pesë ose gjashtë hetime lidhur me më shumë se dhjetë sulme kundër automjeteve civile në rrugën Gjakovë-Pejë, të kryera nga forcat e UÇK-së gjatë orëve të natës. Këto sulme u kryen në janar dhe shkurt 1998, para periudhës që mbulon Aktakuza.⁹²⁸ Nebojsa Avramoviqi dëshmoi se gjatë këtyre hetimeve ai udhëtoi përgjatë rrugës Gjakovë-Pejë. Ai theksoi se makina e tij policore, ndonëse e bardhë dhe me targa civile, “u sulmua shumë herë”, por nuk përmendi hollësi të tjera lidhur me këto sulme.⁹²⁹ Ai shtoi se nga fillimi i majit e deri në shtator 1998, sulmet kundër makinave civile u bënë më të shpeshta dhe ndodhnin si gjatë ditës, ashtu edhe gjatë natës. Shqiptarët kosovarë nuk udhëtonin më.⁹³⁰

248. Në raportin e postëkomandës pararojë të Korpusit të Prishtinës të datës 8 maj 1998 përshkruhet gjendja e sigurisë në Gjakovë dhe thuhet se grupe të armatosura shqiptare kosovare në Kosovë dhe Metohi kryen sulme, midis të tjerash, kundër popullatës serbe të Kosovës dhe shqiptarëve kosovarë besnik ndaj shtetit.⁹³¹ Në raportin e Korpusit të Prishtinës të UJ-së të datës 13 maj 1998 përmenden sulme gjithnjë e më të shpeshta, midis të tjerash, kundër “qytetarëve serbë” dhe shqiptarëve kosovarë “besnikë ndaj shtetit”.⁹³²

249. Raporti britanik për gjendjen i datës 11 maj 1998, i referohet një lajmi të Tanjugut ku paraqiteshin të dhëna për një sërë sulmesh me bomba dore kundër restoranteve dhe dyqaneve shqiptare në Pejë, të cilat i atribuoheshin UÇK-së si masë ndëshkuese për biznesmenët që

⁹²⁵ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9316.

⁹²⁶ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 7, 13.

⁹²⁷ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 13.

⁹²⁸ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6597; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 11.

⁹²⁹ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 14.

⁹³⁰ Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 11.

⁹³¹ Prova materiale P34, f. 1-2.

⁹³² Prova materiale P20, f. 1.

bashkëpunonin me administratën serbe.⁹³³ Lidhur me këto sulme, John Crosland komentoi se ato ishin të njëjta me çfarë ndodhi gjatë gjithë fushatës, “kur shqiptarë [kosovarë] që mendohej se mbanin anën e administratës serbe u eliminuan dhe bizneset e tyre u sulmuan me bomba, ose ata u vranë.”⁹³⁴

250. Në raportin e Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së të datës 22 maj 1998 thuhet se shqiptarë kosovarë të armatosur, veçanërisht gjatë dy ditëve paraardhëse, “kanë shpeshtuar ndalimet, rrëmbimet dhe sulmet kundër popullatës civile”.⁹³⁵ Provat nuk tregojnë se mbi çfarë baze u nxor ky përfundim në raport.

251. Sipas Dëshmitarit 69, në rrugën midis Gjakovës dhe Deçanit shqiptarë kosovarë të armatosur kryen sulme të shumta kundër civilëve.⁹³⁶ Kur shkoi në Pejë më 24 ose 25 maj 1998, Dëshmitari 28 u informua për disa incidente që kishin ndodhur atë ditë,⁹³⁷ ndër të cilat sulme kundër serbëve të Kosovës në rrugën Gjakovë-Pejë.⁹³⁸

252. Në urdhrin e postëkomandës pararojë të Korpusit të Prishtinës në Gjakovë të datës 3 qershor 1998 thuhej se shqiptarë kosovarë të armatosur “kanë filluar operacione gjithnjë e më të dhunshme terroriste kundër popullatës serbe dhe malazeze, [...] dhe kundër vetë popullit të tyre”.⁹³⁹ Raporti paraprak i Korpusit të Prishtinës drejtuar komandës së Armatës së Tretë, i datës 20 qershor 1998 raporton largimin e serbëve të Kosovës nga fshati Dush i Vogël i komunës së Klinës nën presionin e shqiptarëve kosovarë të armatosur.⁹⁴⁰

253. Deklaratat e përgjithshme të përmbledhura shkurtimisht më lart, nuk përmbajnë informacion konkret lidhur me ngjarje konkrete i cili do t’i mundësonte Dhomës të nxirrte një përfundim të bazuar mbi fakte. Informacioni në këto deklarata është i tërthortë dhe nga burime të paverifikuara. Rrjedhimisht, Dhoma nuk i pranon këto deklarata.

⁹³³ Prova materiale P18, para. 1, 10-11.

⁹³⁴ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1867.

⁹³⁵ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P111, para. 48; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 48; Prova materiale P115, para. 2(e).

⁹³⁶ Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 29.

⁹³⁷ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10206-10207; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 65.

⁹³⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10207; Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 65.

⁹³⁹ Prova materiale P116, para. 2.

⁹⁴⁰ John Crosland, Prova materiale P9 (transkripti *Limaj*), T. 1940-1941; Prova materiale P22.

B. Ngjarjet në territorin e Zonës Operative të Dukagjinit midis korrikut dhe shtatorit 1998

1. Marrëdhëniet midis FARK-ut dhe UÇK-së

(a) Dislokimi i forcave të FARK-ut në Zonën Operative të Dukagjinit

254. Formimi i FARK-ut lidhet me Lidhjen Demokratike të Kosovës (“LDK”). Sipas Jakup Krasniqit, LDK-ja u formua “rreth dhjetorit 1990/1991”.⁹⁴¹ Kryetar i LDK-së ishte Ibrahim Rugova kurse Bujar Bukoshi ishte Kryeministër (i LDK-së) i qeverisë në mërgim.⁹⁴² LDK-ja ishte e përkushtuar për zgjidhje paqësore të çështjes së Kosovës.⁹⁴³

255. Në fillim të vitit 1998, LDK-ja ndryshoi politikën e saj të deriatëhershme të rezistencës jo të dhunshme dhe filloi të përkrahte rezistencën e armatosur.⁹⁴⁴ Bujar Bukoshi formoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe emëroi Ahmet Krasniqin, ministër të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Agim Mehmetin zëvendës të tij. Pikërisht atëherë LDK-ja formoi FARK-un.⁹⁴⁵ Nga 22 maj deri më 24 maj 1998, në Oslo të Norvegjisë u zhvilluan bisedime mes LDK-së dhe UÇK-së lidhur me marrëdhëniet midis forcave të tyre të armatosura.⁹⁴⁶ Gjatë këtij takimi UÇK-ja “pranoi të përfshihej në Ministrinë e Mbrojtjes me kusht që forcat e reja të bashkuara të vazhdonin të njiheshin me emrin UÇK, pasi ky emër tashmë njihej gjerësisht”⁹⁴⁷ dhe “kishte domethënien e vet në mesin e popullatës”.⁹⁴⁸ Gjithashtu u arrit marrëveshje për përdorimin e emblemës së UÇK-së në uniforma.⁹⁴⁹

256. Në qershor 1998, në rajonin e Tropojës në Shqipërinë veriore, ushtarët e FARK kryen stërvitje. FARK-u kishte tri brigada: Brigadën 131 me komandant Rrustem Berishën; Brigadën 133 me komandant Kemajl Shaqirin; dhe Brigadën 134 me komandant Tahir Zemaj. Njëkohësisht

⁹⁴¹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3298.

⁹⁴² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 2; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3366.

⁹⁴³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3298-3299; Dëshmitari 3, T. 1501-1502.

⁹⁴⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 5, 7-8.

⁹⁴⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 8.

⁹⁴⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 9; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7609-7611.

⁹⁴⁷ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 9.

⁹⁴⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7610-7611.

⁹⁴⁹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 9. *Shih* gjithashtu Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 38; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 25; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5805.

Tahir Zemaj ishte oficeri me rang më të lartë i FARK-ut dhe komandant i të tri brigadave të FARK-ut.⁹⁵⁰

257. Për zonat operative dhe dislokimin e brigadave të FARK-ut në Kosovë vendosi Ahmet Krasniqi.⁹⁵¹ Dislokimi i parë i brigadave të FARK-ut në Kosovë ishte paraparë të kryhej në tri faza: së pari, brigadat do të marshonin nga Shqipëria në Jasiq të komunës së Deçanit dhe aty do të prisnin armët dhe pajisjet; së dyti, do të marshonin nga Jasiq në Isniq të komunës së Deçanit; dhe së fundi, do të “formonin kazermat ushtarake, do të bënin mobilizimin e njerëzve dhe stërvitjen e tyre si ushtarë dhe njohjen e ushtrisë në përgjithësi”.⁹⁵²

258. Dhoma dëgjoi dëshmi se rreth qershorit 1998, vetëm Brigada 134 e komanduar nga Tahir Zemaj kishte ushtarë. Brigada numëronte rreth 100-200 ushtarë dhe 23-25 oficerë.⁹⁵³ Ata hynë në Kosovë nga fundi i qershorit 1998 dhe mbërritën në Jasiq në orët e mëngjesit të datës 25 qershor 1998, ku qëndruan disa ditë.⁹⁵⁴ Më pas, brigada vazhdoi rrugën dhe mbërriti në Isniq rreth 30 qershorit 1998.⁹⁵⁵ FARK-u solli me vete automatikë dhe bomba dore.⁹⁵⁶ Dhoma dëgjoi nga Zoran Stijoviqi se “reagimi i parë i UÇK-së ndaj shfaqjes së FARK-ut ishte armiqësor”, dhe se “zëdhënësi i UÇK-së Jakup Krasniqi deklaroi publikisht se FARK-u dëmtonte kauzën shqiptare”.⁹⁵⁷

259. Më 25 qershor 1998, përfaqësues të FARK-ut u takuan në Jasiq me komandantët e UÇK-së Salih Veseli dhe Naim Maloku.⁹⁵⁸ Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në takim.⁹⁵⁹ Dëshmitë tregojnë se Ramush Haradinaj kishte dërguar komandantët e UÇK-së për ta informuar FARK-un se duhej t’i nënshtrohej komandës së UÇK-së ose ndryshe të largohej nga Kosova. Përfaqësuesit e

⁹⁵⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 10. Sipas Dëshmitarit 17, Tahir Zemaj ishte komandant i të gjitha tre brigadave të FARK-ut dhe njëkohësisht i brigadës 134.

⁹⁵¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 8, 10-11. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 77, T. 1156.

⁹⁵² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 11.

⁹⁵³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 10; Dëshmitari 77, T. 1155-1156, 1213-1214.

⁹⁵⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 11, 13; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 24; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3490-3493; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 63. Dhoma nuk mori prova lidhur me hyrjen nga Shqipëria në Kosovë të Brigadës 131 dhe 133 të FARK-ut. Gjatë dëshmisë së tij, Dëshmitari 77 theksoi se Brigada 134 e FARK-ut hyri në Kosovë “dikur në vitin 1998. Ishte fillimi i qershorit, me sa më kujtohet”, Dëshmitari 77, T. 1157, 1213-1214, 1219. Dhoma nuk e konsideron këtë informacion të besueshëm duke marrë parasysh tërësinë e provave.

⁹⁵⁵ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 24; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4463-4464; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 63.

⁹⁵⁶ Dëshmitari 77, T. 1155; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 13; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3491.

⁹⁵⁷ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 63.

⁹⁵⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 14; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7612-7613.

⁹⁵⁹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 14; Dëshmitari 77, T. 1228-1229, 1472.

FARK-ut theksuan se nuk mund t'i nënshtroheshin UÇK-së për shkak të marrëveshjes për krijimin e komandës së njësuar të arritur në Oslo në maj 1998. Komandantët e UÇK-së ose nuk dinin për marrëveshjen e Oslos, ose shtreshin se nuk dinin gjë.⁹⁶⁰

260. Më 26 qershor 1998, Ramush Haradinaj shkoi në Jasiq së bashku me ushtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Idriz Balaj, Salih Veseli, Naim Maloku dhe Hajdin Abazi.⁹⁶¹ Bisedimet gjatë takimit u përqendruan në komandën e Zonës Operative të Dukagjinit dhe hyrjen e forcave të FARK-ut në zonë.⁹⁶² Ramush Haradinaj u prezantua si komandant i “Rrafshit të Dukagjinit”.⁹⁶³ Haradinaj u tha përfaqësuesve të FARK-ut se kishin ardhur në një territor të çliruar nga UÇK-ja, se ata duhej të praninin komandën e tij ose ndryshe të ktheheshin në Shqipëri⁹⁶⁴ dhe se ai nuk e njihte marrëveshjen e Oslos.⁹⁶⁵ Ramush Haradinaj udhëzoi FARK-un që të bëhej pjesë e komandës së UÇK-së.⁹⁶⁶ Ai theksoi se oficerët e lartë të FARK-ut duhej të caktoheshin me detyrë nëpër njësitë e ndryshme operative dhe nëpër fshatra, dhe t'i kryenin detyrat e tyre në kuadër të strukturës së “Shtabit Operativ të Dukagjinit”; FARK-u nuk e pranoi këtë dhe nuk u arrit kurrfarë marrëveshje.⁹⁶⁷ FARK-u e informoi UÇK-në se do të vazhdonte me zbatimin e planeve dhe strategjive të veta ushtarake në disa faza.⁹⁶⁸

261. Më 27 qershor 1998, UÇK-ja⁹⁶⁹ ftoi komandantin e FARK-ut, Tahir Zemajn, në Junik të komunës së Deçanit për vijimin e bisedimeve lidhur me komandën e UÇK-së dhe të FARK-ut. Mirëpo, oficerët e FARK-ut e vlerësuan këtë gjë të rrezikshme dhe e këshilluan Tahir Zemajn të mos shkonte. Më 30 qershor 1998, në vend të Tahirit në Junik shkuan dy oficerë të tjerë të FARK-ut. Në mbledhjen e 30 qershorit 1998, dy përfaqësuesit e FARK-ut u takuan me Salih Veselin, i cili e prezantoi veten si “shef i Shtabit të Zonës së Dukagjinit” dhe përfaqësuesin tjetër si Hajdin

⁹⁶⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 14; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7612-7613.

⁹⁶¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 15-17; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7613-7614; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3493-3496.

⁹⁶² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 15, 17; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7613-7614; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3493-3496.

⁹⁶³ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7556-7557.

⁹⁶⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 17.

⁹⁶⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 17; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7613.

⁹⁶⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7560-7561.

⁹⁶⁷ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 17; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7560-7561, 7613-7614.

⁹⁶⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7560-7561.

⁹⁶⁹ Provat nuk tregojnë se kush prej UÇK-së e ftoi Tahir Zemajn.

Abazi.⁹⁷⁰ Oficerët e FARK-ut informuan përfaqësuesit e UÇK-së se qëndrimi i Tahir Zemajt ishte i njëjtë dhe nuk kishte ndryshuar nga dy takimet e mëparshme dhe i informuan se FARK-u “donte t’ a përfundonte fazën e dytë të dislokimit, gjegjësisht marshimin deri në Isniq” dhe se “në qoftë se dikush do t’ i pengonte”, atëherë forcat e FARK-ut “do të detyrohen të veprojnë sipas rregullave ushtarake”.⁹⁷¹ Kur përfaqësuesi i FARK-ut i tha Salih Veselit se FARK-u do të vazhdonte me dislokimin e forcave të veta, Salih Veseli iu përgjigj se UÇK-ja nuk do të garantonte sigurinë e FARK-ut.⁹⁷² UÇK-ja nuk përdori forcë ushtarake.⁹⁷³ Forcat e FARK-ut nuk ishin të gatshme të viheshin nën komandën e “UÇK-së së Dukagjinit”. Dislokimi i tyre u shty deri në natën e 30 qershorit 1998 për shkak të problemeve me UÇK-në dhe mosardhjes së kontingjentit të armëve nga Shqipëria.⁹⁷⁴

262. Më 2 korrik 1998, komandantët e brigadave të FARK-ut dhe komandantët e UÇK-së u takuan përsëri në Isniq.⁹⁷⁵ Në emër të FARK-ut, Tahir Zemaj foli për “Shtabin e Lartë të FARK-ut dhe veprimtarinë e oficerëve të lartë të tij nga viti 1991”; “themelimin zyrtar të Shtabit të Lartë më 5 mars 1998”; “formimin e brigadave më 21 qershor 1998”; dhe “marrëveshjen e arritur me udhëheqjen e UÇK-së”.⁹⁷⁶ Ai foli për formimin e “dy komponentëve të FARK-ut: UÇK-në dhe MT-në (mbrojtjen territoriale)”.⁹⁷⁷ Në emër të UÇK-së, Rrustem Tetaj theksoi se UÇK-ja nuk e njëjste Shtabin e Lartë të FARK-ut, meqenëse ai ishte i vendosur jashtë Kosovës.⁹⁷⁸ Provat tregojnë se takimi i 2 korrikut “përfundoi miqësisht”.⁹⁷⁹

263. Bisedimet vazhduan në mbledhjen e 5 korrikut 1998. Në këtë mbledhje, Rrustem Tetaj shpjegoi se UÇK-ja nuk e njëjste autoritetin e qeverisë në mërgim dhe se “Shtabi i Rrafshit të Dukagjinit” ishte “formuar më 23 maj 1998”. Ramush Haradinaj theksoi se “UÇK-ja lindi këtu në Kosovë”, dhe se mënyra më e mirë për bashkimin e forcave ishte që forcat e FARK-ut t’ i bashkoheshin UÇK-së.⁹⁸⁰ Provat tregojnë se “mbledhja përfundoi qetë”.⁹⁸¹

⁹⁷⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 18.

⁹⁷¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 18; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7616.

⁹⁷² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 18.

⁹⁷³ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7617.

⁹⁷⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 19-20; Dëshmitari 77, T. 1236-1237.

⁹⁷⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 22.

⁹⁷⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 22. Për mendimin e Dhomës, marrëveshja me udhëheqjen e UÇK-së që përmendet është marrëveshja e Oslos për krijimin e komandës së përbashkët të UÇK-së dhe FARK-ut. *Shih* më lart, para. 255.

⁹⁷⁷ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 22.

⁹⁷⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 23.

⁹⁷⁹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 24.

⁹⁸⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 33-34.

(b) Incidenti i 4 korrikut 1998 në Glllogjan të komunës së Deçanit

264. Më 4 korrik 1998, komandanti i FARK-ut Tahir Zemaj dërgoi katër ushtarë të FARK-ut nga Isniqi në Pacaj të komunës së Gjakovës për të marrë armët që do të vinin nga Shqipëria.⁹⁸² Në atë kohë, Brigada 134 e FARK-ut ishte e vendosur në fshatin Isniq.⁹⁸³ Ushtarët morën me vete fletautorizim për udhëtim nga Tahir Zemaj.⁹⁸⁴ Rrugës, ushtarët e FARK-ut ndaluan në Irzniq sepse njëri prej tyre duhej të merrte uniformën e vet ushtarake dhe një fletautorizim tjetër nga komandanti i UÇK-së në atë fshat, Maxhun Çekaj.⁹⁸⁵

265. Ndërsa dy ushtarët e tjerë të FARK-ut po prisnin në shitoren e fshatit, aty erdhën Idriz Balaj dhe Daut Haradinaj të veshur me uniforma të zeza dhe i urdhëruan ushtarët e FARK-ut që të shkonin me ta në Glllogjan.⁹⁸⁶ Kur ushtari që kishte shkuar për të marrë uniformën dhe fletautorizimin u kthye në shitore, Idriz Balaj dhe Daut Haradinaj përsëritën urdhrin dhe shtinë disa herë në ajër.⁹⁸⁷ Ushtarët e FARK-ut u treguan Idriz Balajt dhe Daut Haradinajt fletautorizimin e marrë nga komandanti i UÇK-së së atij fshati, Maxhun Çekaj.⁹⁸⁸ Daut Haradinaj e grisi dokumentin, e thirri Maxhun Çekajn dhe i tha se nuk duhej t'u kishte dhënë fletautorizim “këtyre ushtarëve të FARK-ut” sepse ata nuk e kishin vendin në Kosovë dhe se UÇK-ja duhej të “luftojë kundër tyre”.⁹⁸⁹

266. Më pas, katër ushtarët e FARK-ut u nisën me makinën e tyre për në Glllogjan, në një kolonë makinash të udhëhequr nga Daut Haradinaj me makinën e tij dhe Idriz Balaj me një makinë tjetër pas tij.⁹⁹⁰ Kur mbërritën në Glllogjan, aty panë një grup prej rreth 100-200 njerëzish, kryesisht me

⁹⁸¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 34.

⁹⁸² Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3504-3505; Prova materiale P217. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁸³ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3504-3505. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁸⁴ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁸⁵ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3509-3511. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁸⁶ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3514-3517. *Shih* Shtojca Konfidenciale; Prova materiale P217; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, p. 15.

⁹⁸⁷ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3514-3517. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁸⁸ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3514-3517.

⁹⁸⁹ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3514-3517.

⁹⁹⁰ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*) T. 3517-3518. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

rroba civile, duke pritur para ndërtesës së shtabit të UÇK-së.⁹⁹¹ Dhoma dëgjoi se ky grup njerëzish po bëhej gati për t'u nisur në Shqipëri për armë.⁹⁹²

267. Kur mbërritën në Gllogjan, njëri nga ushtarët e FARK-ut hyri në ndërtesën e shtabit të UÇK-së për të biseduar me Ramush Haradinajn.⁹⁹³ Me sa duket biseda ishte fillimisht miqësore, por kur ushtari i FARK-ut që bisedoi me Ramush Haradinajn po largohej nga ndërtesa,⁹⁹⁴ Ramush Haradinaj i shkoi pas i zemëruar. Dhoma dëgjoi dëshmi se Ramush Haradinaj iu lëshua një ushtari të FARK-ut me sharje dhe fyerje.⁹⁹⁵ Një tjetri i tha “shporru” dhe “nuk dua të të shoh më me sy”.⁹⁹⁶ Për më tepër, pati dëshmi se Ramush Haradinaj goditi një ushtar të FARK-ut me kondakun e pushkës dhe me shkelm.⁹⁹⁷ Dhoma konkludon se Ramush Haradinaj goditi një ushtar të FARK-ut.

268. Pas pak kohe, katër ushtarët e FARK-ut u rrahën dhe u goditën me shkelma nga shumë pjesëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Idriz Balaj, Daut Haradinaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së.⁹⁹⁸ Në lidhje me Ramush Haradinajn, një dëshmitar dëshmoi se nuk e dinte nëse në atë moment Ramush Haradinaj ishte ende duke goditur ushtarin e parë të FARK-ut, kurse një dëshmitar tjetër tha se pas goditjeve të para, Ramush Haradinaj vazhdoi ta rrihte këtë ushtar të FARK-ut.⁹⁹⁹ Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi se gjatë rrahjeve u dëgjuan fjalë si “vritini këta pisa të poshtër, këta spiunë,” dhe se personat që po i rrihnin ushtarët e FARK-ut kërcënuan se do t'a “zhdukjin” FARK-un dhe komandantët e tij, kurse në lidhje me një ushtar të FARK-ut Ramush Haradinaj tha se “do të të vras me dorën time”.¹⁰⁰⁰

⁹⁹¹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁹² *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁹³ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3518-3520. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁹⁴ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3520-3521. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁹⁵ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁹⁶ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3520-3521, 3524-3526, 3529-3530, 3557-3562, 3569-3570.

⁹⁹⁷ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁹⁸ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3523-3526. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

⁹⁹⁹ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3523. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰⁰⁰ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3524-3526. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3529-3531, 3557-3565, 3569-3570. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

269. Njëri nga ushtarët e FARK-ut u plagos me armë zjarri afër qafës në pjesën e prapme të shpatullës së djathtë.¹⁰⁰¹ Një dëshmitar dëshmoi se Ramush Haradinaj kërcënoi dhe shtiu personalisht kundër ushtarit të FARK-ut.¹⁰⁰² Mirëpo, ai rrëfeu dy versione të ndryshme lidhur me të shtënat. Në versionin e parë dhënë policisë së UNMIK-ut, ai deklaroi se Ramush Haradinaj shtiu disa herë me armë kurse në dëshminë e tij para Dhomës, ai theksoi se Ramush Haradinaj shtiu vetëm një herë.¹⁰⁰³ Dëshmitari shpjegoi mospërputhjen e deklaratave të tij dhe tha: “Kam thënë se ai shtiu disa herë dhe kjo është e vërtetë, por edhe të tjerë shtinë me armë. Unë nuk mund të identifikoj se kush shtiu me armë. Me rëndësi këtu është fakti se ushtarin e FARK-ut e plagosi z. Ramush”.¹⁰⁰⁴ Lidhur me këtë pikë, Dhoma konkludon se një ushtar i FARK-ut u plagos nga një e shtënë me armë zjarri dhe se Ramush Haradinaj ishte ndër personat që shtinë me armë.

270. Pas rrahjeve që nuk zgjatën shumë, ushtarë të veshur me uniforma të zeza, ndër të cilët Idriz Balaj dhe Daut Haradinaj, i kapën për flokësh tre nga katër ushtarët e FARK-ut dhe i hoqën zvarrë deri në ndërtesën e shtabit të UÇK-së. Rrahjet vazhduan edhe gjatë kohës që po hiqeshin zvarrë.¹⁰⁰⁵ Ramush Haradinaj i tha ushtarit të katërt të FARK-ut që ishte plagosur në shpatull se “ke dy minuta që të largohesh nga fshati Gllogjan”.¹⁰⁰⁶ Ushtari u kthye në komandën e FARK-ut dhe më pas u shtrua në spital në Isniq.¹⁰⁰⁷ Brenda në ndërtesën e shtabit të UÇK-së, ushtarë të veshur me uniforma të zeza i zhveshën dhe i rrahën sërish tre ushtarët e tjerë të FARK-ut; një nga ushtarët e FARK-ut humbi vetëdijen.¹⁰⁰⁸ Provat nuk tregojnë se kush urdhëroi rrahjet.

271. Më vonë atë ditë, Ramush Haradinaj urdhëroi Idriz Balajn dhe Daut Haradinajn që t’i çonin tre ushtarët e FARK-ut në Kodrali të komunës së Deçanit.¹⁰⁰⁹ Idriz Balaj dhe Daut Haradinaj detyruan ushtarët e FARK-ut që të vraponin të zhveshur për disa kilometra ndërkohë që ata shtinin

¹⁰⁰¹ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3536. Një ushtar tjetër i FARK-ut u plagos në këmbë. Mirëpo, nga dëshmitë nuk është e qartë nëse kjo ndodhi në kohën kur u plagos në qafë ushtari tjetër i FARK-ut apo gjatë incidenteve të mëpasshme. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰⁰² Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3524-3526, 3529-3530, 3557-3562, 3564, 3567-3569. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰⁰³ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3564, 3567-3569. Deklarata dhënë UNMIK-ut u lexua në sallën e gjyqit dhe Dëshmitari nuk e mohoi se i kishte dhënë deklaratë UNMIK-ut, Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3568.

¹⁰⁰⁴ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3568.

¹⁰⁰⁵ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3530-3532.

¹⁰⁰⁶ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3530-3532.

¹⁰⁰⁷ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3532, 3536. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰⁰⁸ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3530-3532. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰⁰⁹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

me armë në ajër.¹⁰¹⁰ Kur kaluan përmes fshatit Irzniq, burra “të veshur me rroba të zeza si ato të policisë ushtarake” pyetën Idriz Balajn se kush ishin ushtarët e FARK-ut. Kur Idriz Balaj u tha se këta ishin “ushtarë të Tahir Zemajt”, ata i rrahën dhe i shkelmuan.¹⁰¹¹

272. Njëri nga ushtarët e FARK-ut dëshmoi se kur kishin mbërritur në Kodrali, Idriz Balaj i kishte futur pistoletën në gojë dhe para se të largohej i kishte thënë “bëji të fala Tahir Zemajt dhe thuaju se e njëjta gjë do t’u ndodhë edhe atyre po që se kalojnë këtej”.¹⁰¹² Ushtarët e FARK-ut më në fund arritën në Isniq rreth orës 22:00; atyre iu dha menjëherë ndihmë mjekësore dhe më pas u shtruan në spitalin e Isniqit.¹⁰¹³

273. Pati prova për një takim midis komandantëve të UÇK-së dhe FARK-ut në Llukë të Poshtme më 5 korrik 1998. Gjatë bisedimeve rreth incidentit të 4 korrikut 1998 të shtjelluar më lart, Ramush Haradinaj shprehu keqardhje për atë që ndodhi me katër ushtarët e FARK-ut, dhe theksoi se kjo ishte, siç u shpreh ai “veprim i dështuar” dhe se nuk do të ndodhte më.¹⁰¹⁴ Tahir Zemaj theksoi se ky ishte incidenti i parë dhe i fundit dhe i kërkoi Ramush Haradinajt që t’i “largonte nga detyra personat përgjegjës për këtë sulm” por ai refuzoi të bënte një gjë të tillë.¹⁰¹⁵

274. Dhoma nuk mori prova për konfrontime fizike të ngjashme të mëvonshme.

(c) Marrëdhëniet e mëpasshme midis FARK-ut dhe UÇK-së

275. Dhoma dëgjoi dëshmi për një grindje midis një komandanti me uniformë të FARK-ut dhe Idriz Balajt më 7 ose 8 korrik 1998.¹⁰¹⁶ Idriz Balaj ndaloi komandantin e FARK-ut dhe e pyeti nëse kishte leje për prani apo lëvizje në atë zonë.¹⁰¹⁷ Më pas, Idriz Balaj dhe komandanti i FARK-

¹⁰¹⁰ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3537; Prova materiale P217. *Shih* Shtojca Konfidenciale. *Shih* gjithashtu Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 15.

¹⁰¹¹ Dëshmitari 29 dëshmoi se “Shqiponjat e Zeza” të komanduara nga Idriz Balaj rrahën ushtarët e FARK-ut, Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3536-3537. Mirëpo, Dhoma nuk e pranon këtë dëshmi duke marrë parasysh se ai vetë nuk ishte i pranishëm si dhe duke marrë parasysh dëshmitë e tjera të drejtpërdrejta që mori Dhoma. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰¹² *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰¹³ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3536-3537; Prova materiale P217; Bislim Zyrapi, Prova materiale P161, para. 48, f. 15. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰¹⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344 para. 33.

¹⁰¹⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 33.

¹⁰¹⁶ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁰¹⁷ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

ut shkëmbyen fjalë.¹⁰¹⁸ Megjithëse nuk është e qartë nga provat, me sa duket komandanti i FARK-ut më pas u lejua të vazhdonte rrugën për në spitalin ushtarak.

276. Pas disa ditësh, komandanti i FARK-ut e raportoi incidentin dhe sjelljen e Togerit në një mbledhje me Ramush Haradinajn të mbajtur në Llukë të Poshtme.¹⁰¹⁹ Komandanti i FARK-ut i tha Ramush Haradinajt që duhej ta shkarkonte Togerin nga detyra ose të merrte masa disiplinore kundër tij.¹⁰²⁰ Togerit ishte i pranishëm por nuk tha gjë.¹⁰²¹ Ramush Haradinaj u përgjigj se kishte dijeni për incidentin meqenëse Togerit kishte biseduar me të¹⁰²² dhe tha se do të bisedonte prapë me Togerin.¹⁰²³ Nuk ka prova nëse kundër Togerit u morën masa disiplinore lidhur me këtë incident; ai vazhdoi të ishte komandant i Shqiponjave të Zeza.¹⁰²⁴

277. Më 10 korrik 1998, në kohën kur Brigada 134 e FARK-ut ishte e vendosur në shkollën në Prapaqan të komunës së Deçanit, rreth 15-30 ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Ramush Haradinaj, Daut Haradinaj, Idriz Balaj dhe ushtarë të tjerë me uniforma të zeza erdhën tek shkolla dhe u thanë oficerëve të FARK-ut që të largoheshin menjëherë.¹⁰²⁵ Ushtarët e UÇK-së ishin të armatosur dhe Ramush Haradinaj shtiu në ajër.¹⁰²⁶ Atë ditë edhe Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj ishin të veshur me uniforma të zeza.¹⁰²⁷ Si pasojë e urdhrave të ushtarëve të UÇK-së, oficerët e FARK-ut u larguan nga kazerma dhe shkuan nëpër shtëpitë ku ishin strehuar në Prapaqan.¹⁰²⁸

278. Dhoma konkludon se më 10 korrik 1998, ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Ramush Haradinaj, Daut Haradinaj dhe Idriz Balaj, urdhëruan oficerët e FARK-ut që të largoheshin menjëherë nga kazerma në Prapaqan. Dhoma konkludon se ky incident dëshmon se kishte tension midis FARK-ut dhe UÇK-së.

¹⁰¹⁸ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

¹⁰¹⁹ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

¹⁰²⁰ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

¹⁰²¹ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

¹⁰²² *Shih Shtojca Konfidenciale.*

¹⁰²³ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

¹⁰²⁴ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

¹⁰²⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 41-42; Dëshmitari 17 Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7564-7565; Dëshmitari 77, T. 1196-1197; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3537-3539.

¹⁰²⁶ Dëshmitari 77, T. 1196-1197; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3537-3539.

¹⁰²⁷ Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3538.

¹⁰²⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 43-44, 46; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7564-7565; Dëshmitari 29, Prova materiale P359 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3537-3539; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3756; Dëshmitari 77, T. 1197.

279. Dhoma mori dëshmi lidhur me një takim midis Ramush Haradinajt dhe komandantit të FARK-ut, Tahir Zemaj, të mbajtur në Llukë të Poshtme¹⁰²⁹ në mbrëmjen e datës 10 korrik 1998, për të zgjidhur mosmarrëveshjet.¹⁰³⁰ Gjatë takimit, Ramush Haradinaj i kërkoi Tahir Zemajt falje për incidentin që kishte ndodhur më herët atë ditë në kazermën e Prapaqanit.¹⁰³¹ Dhoma mori dëshmi se Ramush Haradinaj dhe Tahir Zemaj shkuan në një dhomë tjetër për të biseduar vetëm për vetëm.¹⁰³² Kur u kthyen ata u thanë komandantëve të FARK-ut dhe komandantit të UÇK-së, Rustem Tetajt, se kishin arritur marrëveshje për formimin e tri brigadave.¹⁰³³ Oficerët e FARK-ut që ishin larguar pas urdhrave të UÇK-së, u kthyen në kazermën në Prapaqan rreth 24 orë pas largimit të tyre.¹⁰³⁴

280. Dhoma gjithashtu mori prova se më 20 korrik 1998, në Baran ose në Vranoc të komunës së Pejës u mbajt ceremonia e betimit për anëtarësimin e ushtarëve në UÇK dhe betimin e tyre për besnikëri ndaj UÇK-së.¹⁰³⁵ Dëshmia e një dëshmitari dhe filmimi i ceremonisë vërtetuan se betimin e bënë ushtarët e posaardhur të FARK-ut dhe vullnetarë të tjerë, dhe se në ceremoni morën pjesë komandantë të FARK-ut dhe të UÇK-së, ndër të cilët Tahir Zemaj dhe Ramush Haradinaj të cilët mbajtën fjalim.¹⁰³⁶

¹⁰²⁹ Dëshmitë në lidhje me vendin ku u mbajt mbledhja janë mospërputhëse. Dëshmitari 77 tha se mbledhja u mbajt në "Llukë e Poshtme". Mirëpo ai vetë nuk ishte i pranishëm në mbledhje, Dëshmitari 77, T. 1198, 1275. Në lidhje me këtë çështje, Dhoma vë në dukje dëshmitë se Ramush Haradinaj dhe Tahir Zemaj ishin takuar paraprakisht në Llukë të Poshtme më 5 korrik 1998. *Shih* më lart, para. 273.

¹⁰³⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 46-47; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7632; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3756-3759; Dëshmitari 77, T. 1198.

¹⁰³¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 46-47; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3758-3759.

¹⁰³² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 46-47; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*) T. 7632; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3758-3759.

¹⁰³³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 46-47; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*) T. 7632; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3758-3759. *Shih* më lart, para. 85-89.

¹⁰³⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 47; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3756; Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3756; Dëshmitari 77, T. 1198-1199.

¹⁰³⁵ Dëshmitari 77, T. 1281, 1308-1311; Prova materiale D148; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716-5717, 5804-5805; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 66-67; Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10862.

¹⁰³⁶ Dëshmitari 77, T. 1281, 1308-1311; Prova materiale D148; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5716-5717; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 66-67.

281. Siç u përmend më lart në Aktgjykim, më 20 gusht 1998 ose rreth kësaj date u mbajt një mbledhje për të shqyrtuar riorganizimin dhe ristrukturimin e forcave në Zonën Operative të Dukagjinit.¹⁰³⁷ Provat tregojnë se në përputhje me riorganizimin dhe ristrukturimin, Tahir Zemaj u bë komandant por menjëherë më pas, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së riemëroi Ramush Haradinajn komandant pavarësisht nga mospajtimi i Tahir Zemajt.¹⁰³⁸

282. Prokuroria argumenton se incidentet e shtjelluara më sipër, gjegjësisht reagimi i UÇK-së pas hyrjes së FARK-ut në Kosovë në fund të qershorit 1998, incidenti i 4 korrikut 1998 lidhur me katër ushtarët e FARK-ut, dhe incidenti i 10 korrikut 1998 në kazermën në Prapaqan janë dëshmi për “sulme kundër FARK-ut”.¹⁰³⁹ Dhoma konkludon se fërkime të tilla midis FARK-ut dhe UÇK-së si dhe ngjarjet e mëvonshme tregojnë qartë ekzistencën e tensioneve mes komandantëve të FARK-ut dhe të UÇK-së dhe përpjekjet e tyre për bashkimin e dy forcave.

2. Operacionet e forcave serbe në Zonën Operative të Dukagjinit midis korrikut dhe shtatorit 1998

283. Provat tregojnë se midis korrikut dhe shtatorit 1998, forcat serbe ndërmorën disa operacione në Kosovë.¹⁰⁴⁰ Zona Operative e Dukagjinit ishte “zona kryesore e rrugës së rifurnizimit [...] nga Shqipëria në Kosovë”, duke përfshirë furnizimin me armë.¹⁰⁴¹

284. Dëshmitari 17 dëshmoi se në fillim të korrikut 1998, fshati Loxhë në komunën e Pejës ishte në duart e UÇK-së¹⁰⁴² dhe se sulmi i forcave serbe filloi më 5 ose 6 korrik 1998.¹⁰⁴³ Shemsedin Çekaj dëshmoi se në mëngjesin e 8 korrikut 1998 mori informacion se forcat serbe po sulmonin Loxhën nga drejtimi i Pejës.¹⁰⁴⁴ Sipas Dëshmitarit 17, “gjatë sulmit forcat serbe e morën Loxhën

¹⁰³⁷ *Shih* më lart, para. 95.

¹⁰³⁸ *Shih* më lart, para. 95-97.

¹⁰³⁹ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 80-84.

¹⁰⁴⁰ Zoran Stijović, Prova materiale P121, para. 9, 64. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 79.

¹⁰⁴¹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2953-2954. *Shih* gjithashtu Prova materiale D105, f. 1.

¹⁰⁴² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 35.

¹⁰⁴³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 35. *Shih* gjithashtu Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 27; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5805, 5819. Në deklaratën e Dëshmitarit dhënë Prokurorisë në vitin 2007, Cufë Krasniqi thekson se sulmi serb kundër Loxhës ndodhi më 6 qershor 1998, por më vonë ai thotë se “ndoshta e kam gabim” datën, Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 77; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5819.

¹⁰⁴⁴ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 25.

nën kontrollin e tyre por forcat e FARK-ut nën komandën e Tahir Zemajt e rimorën fshatin”.¹⁰⁴⁵
Pjesëmarrja e forcave të FARK-ut vërtetohet nga prova të tjera.¹⁰⁴⁶

285. Në telegramin diplomatik britanik të datës 13 korrik 1998, situata në Kosovë përshkruhet ashtu siç e kishin vlerësuar misionet vëzhguese ndërkombëtare gjatë vizitave të tyre gjatë 9-11 korrikut 1998.¹⁰⁴⁷ Në telegram thuhet se anëtarë të misionit kishin vizituar, midis të tjerash, “zonën e Dobra Vodës”, e cila kontrollohej prej UÇK-së, dhe kishin konstatuar se “e gjithë zona ishte e qetë por e tensionuar, veçanërisht rreth Pejës pas mbarimit të operacioneve në Loxhë.”¹⁰⁴⁸ Në Pejë, ata kishin parë rreth 150 “anëtarë të JSO-së të armatosur mirë” duke shkuar me automjete drejt “zonës me gjasë të kontrolluar rreth Deçanit”.¹⁰⁴⁹ Në telegram më tej thuhet se “gjatë çdo vizite të re në zonën e Deçanit dhe Pejës shihen dëme të mëtejshme të shkaktuara nga forcat e MPB-së/JSO-së të cilat shtinë në mënyrë sporadike drejt shtëpive dhe dyqaneve dhe i plaçkisin ato”¹⁰⁵⁰ dhe vlerësohet se UÇK-ja “teknikisht kontrollon rreth 50 për qind të zonës por pozicionet e saj nuk do të mund të përballojnë një sulm serb”.¹⁰⁵¹

286. Dragan Zhivanoviçi i Brigadës së Motorizuar 125 urdhëroi përgatitjet për “angazhim në operacione aktive deri më 24 korrik 1998”¹⁰⁵² midis të tjerash në zonën e fshatrave Dolle dhe Gllarevë të komunës së Klinës dhe në atë të fshatit Junik të komunës së Deçanit.¹⁰⁵³ Në lidhje me Junikun, Grupi i Luftimit 2 duhej të “mbështesë operacionet luftarake të njëjësive PJP për eliminimin e bandave shqiptare në fshatin Junik”.¹⁰⁵⁴ Ai gjithashtu urdhëroi respektimin e plotë të “urdhrave lidhur me ndalimin e hapjes së panevojshme të zjarrit kundër civilëve të paarmatosur dhe shkatërimin e pasurisë (shtëpive dhe objekteve të tjera) nga të cilat nuk është hapur zjarr” dhe që “hapja e zjarrit të jetë përzgjedhëse sipas rëndësisë së objektivave, sidomos kur hapet zjarr me armë të rënda”.¹⁰⁵⁵ Më pas ai urdhëroi, ndër të tjerët, grupin luftarak 3 që të “marshojë përgjatë drejtimit Pejë-Deçan-fshati Rastavicë” dhe të “bllokojë fshatin Junik” në koordinim me grupin e luftimit 2

¹⁰⁴⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 35. Dhoma vëren se sulmi kundër Loxhës ndodhi para krijimit të komandës së përbashkët të FARK-ut dhe UÇK-së. *Shih* më lart, para. 85.

¹⁰⁴⁶ Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P298, para. 27. *Shih* gjithashtu Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 25.

¹⁰⁴⁷ Prova materiale D104.

¹⁰⁴⁸ Prova materiale D104, f. 2-3.

¹⁰⁴⁹ Prova materiale D104, f. 2.

¹⁰⁵⁰ Prova materiale D104, f. 3.

¹⁰⁵¹ Prova materiale D104, f. 3.

¹⁰⁵² Prova materiale D66, pika 1. Urdhri mban datën 23 korrik 1998 dhe nënshkrimin e Dragan Zhivanoviçit.

¹⁰⁵³ Prova materiale D66, pikat 2-3, 5-6.

¹⁰⁵⁴ Prova materiale D66, pika 5.

¹⁰⁵⁵ Prova materiale D66, pika 8.

dhe njësitë PJP.¹⁰⁵⁶ Në telegramin ushtarak britanik të datës 30 korrik 1998 ku janë paraqitur vëzhgimet e drejtëpërdrejta të atashut ushtarak britanik¹⁰⁵⁷ midis 28 dhe 29 korrikut 1998, lexohet: “Nga ora 13:00 e më pas, Juniku sulmohet me artileri, tanke dhe mortaja”.¹⁰⁵⁸

287. Sipas raportit të datës 7 gushtit 1998 të komandës së Brigadës së Blinduar 15 dërguar Komandës së Korpusit të Prishtinës, në periudhën 25 korrik-6 gusht 1998, njësitë e MPB-së të përbëra nga detashmentet e MPB-së, SAJ-ja dhe “njësia Brazil”, u angazhuan në zona të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë zonat brenda rajonit të Zonës Operative të Dukagjinit, përgjatë aksit “Grabanicë - Banderë [...] - Glogjan - Jabllanicë”.¹⁰⁵⁹

288. Provat tregojnë se më 1 gusht 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës kërkoi “miratim [prej postëkomandës pararojë të Armatës së Tretë] për zbatimin e fazës së tretë të Planit për luftimin e terrorizmit në Kosovë dhe Metohi”,¹⁰⁶⁰ e cila përfshinte “shkatërrimin e qendrave të forcave terroriste në [...] fshatrat Jabllanicë, Glogjan dhe Smonicë nëpërmjet operacioneve të sinkronizuara në zonën e Drenicës dhe të Jabllanicës dhe vazhdimin e bllokimit të fshatrave Junik dhe Jasiq” dhe “mbajtjen e forcave terroriste në Junik nën presion psikologjik përmes vazhdimin të bllokimit të fshatrave Junik dhe Jasiq me forcat e bllokimit dhe hapjes së zjarrit kundër objektivave të identifikuar në fshatin Jasiq”.¹⁰⁶¹ Ishte paraparë që operacioni të fillonte më 2 gusht 1998.¹⁰⁶²

289. Dëshmitari 28 dëshmoi se në gusht të vitit 1998, “forcat serbe zbrapsën UÇK-në në Glogjan dhe Jabllanicë dhe morën përsëri kontrollin mbi rajonin e Dukagjinit”.¹⁰⁶³ Dëshmitari 17 dëshmoi se Jabllanica “ra” dikur gjatë ofensivës serbe “nga 2 deri më 5 gusht”,¹⁰⁶⁴ kurse Dëshmitari 69 pranoi se “mbase” forcat e MPB-së hynë në Jabllanicë më 2 ose 3 gusht 1998.¹⁰⁶⁵ Zoran Stijoviqi theksoi se njësitë e MPB-së “u përpoqën të hynin në fshatin Jabllanicë dhe të zinin rob apo

¹⁰⁵⁶ Prova materiale D67, pika 1. Urdhri mban datën 24 korrik 1998 dhe nënshkrimin e Dragan Zhivanoviçit.

¹⁰⁵⁷ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2984-2985.

¹⁰⁵⁸ Prova materiale D106, f. 1-3. *Shih* gjithashtu Prova materiale D69.

¹⁰⁵⁹ Prova materiale D109, pika 1. Dhoma pranon se “fshati Gradanicë” i referohet Grabanicës kurse “Glogjan” është Glogjani katolik në komunën e Pejës.

¹⁰⁶⁰ Në kërkesën e nënshkruar nga Nebojsa Pavkoviç thuhet se në mbledhjen e “Komandës së përbashkët për Kosovën dhe Metohinë” të datës 31 korrik 1998 u mor vendimi për fillimin e fazës së tretë të planit, Prova materiale D108. *Shih* gjithashtu Dragan Zhivanoviç, Prova materiale P111, para. 98.

¹⁰⁶¹ Prova materiale D108.

¹⁰⁶² Prova materiale D108.

¹⁰⁶³ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 85.

¹⁰⁶⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7770-7771.

¹⁰⁶⁵ Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9905.

arrestonin grupin përreth Lahi Brahimajt” por nuk dha hollësi të mëtejshme.¹⁰⁶⁶ Dhoma konkludon se forcat serbe hynë në Jabllanicë të komunës së Gjakovës më 2 ose 3 gusht 1998, ose rreth këtyre datave.

290. Ekzistojnë prova se gjatë datave 2-4 gusht 1998, njësitë e MPB-së kryen operacione përgjatë fshatrave Meqë, Cërmjan dhe Kralan të komunës së Gjakovës.¹⁰⁶⁷ Si provë është marrë edhe vendimi i Komandës së Korpusit të Prishtinës që “të sulmohen [më 2 gusht 1998] forcat diversante-terroriste në zonën e përgjithshme të fshatit Smonicë nëpërmjet [...] angazhimit të forcave kryesore në aksin Korenicë-Nec i Poshtëm-Smonicë”.¹⁰⁶⁸ Sipas këtij vendimi, qëllimi ishte “shkatërrimi i forcave diversante-terroriste përgjatë akseve të sulmit, marrja e kontrollit në fshatrat Stubël, Nec i Poshtëm dhe në zonën e fshatit Ramoc, zhbllokimi i rrugës dhe parandalimi i sulmeve të drejtpërdrejta kundër kolonave të automjeteve në rrugën Gjakovë-Ponoshec-Batushë”.¹⁰⁶⁹ “Njësitë e atashuara [...] së bashku me njësitë e MPB-së” duhej të “parandalojnë ndërhyrjet e forcave diversante-terroriste nga zona e përgjithshme e fshatit Glllogjan në pjesën e rrugës Gjakovë-Rastavicë”.¹⁰⁷⁰

291. Në telegramin diplomatik britanik të datës 7 gusht 1998 bëhet e ditur se kishte “operacione të vazhdueshme kundër zonës së Drenicës, Junikut dhe me gjasë të Jabllanicës” midis 5 dhe 6 gusht 1998.¹⁰⁷¹ Në telegram më tej lexohet se “shumica e fshatrave në veri/jug të rrugës Pejë-Prishtinë dhe të rrugës Klinë e Epërme-Rudnik-Rakos janë shkatërruar pa shkak” dhe se “është parë një kolonë e gjatë e MPB-së duke u kthyer nga Prishtina me flamuj të mëdhenj serbë [...] forca me shami në kokë që bënin sikur po ktheheshin nga një fitore e lavdishme”.¹⁰⁷²

292. Provat tregojnë se dikur midis 8 dhe 13 gushtit 1998, forcat serbe kryen operacione midis të tjerash në fshatrat Prilep, Isniq, Baballoq, Rastavicë, Carrabreg, Kodrali, Dubravë, Irzniq, Shaptej, Gramaqel dhe Glllogjan të komunës së Deçanit.¹⁰⁷³ Si provë u mor një vendim i Komandës së

¹⁰⁶⁶ Zoran Stijoviç, Prova materiale P123 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9249-9250.

¹⁰⁶⁷ Prova materiale D140, f. 1. Ky dokument mban titullin “Analizë e operacioneve luftarake të kryera midis 18 korrikut dhe 6 gushtit 1998”, i drejtohet “Komandës së Korpusit të Prishtinës” dhe është i nënshkruar nga komandanti i Brigadës së Motorizuar 549, kolonel Bozhidar Deliqi.

¹⁰⁶⁸ Prova materiale D68, f. 1. Vendimi mban datën 1 gusht 1998 dhe nënshkrimin e Nebojshta Pavkoviçit. *Shih* gjithashtu Prova materiale D108.

¹⁰⁶⁹ Prova materiale D68, f. 1.

¹⁰⁷⁰ Prova materiale D68, f. 1.

¹⁰⁷¹ Prova materiale D107, f. 1.

¹⁰⁷² Prova materiale D107, f. 1-2.

¹⁰⁷³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 38, 93-94, 96; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7592; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P3 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4427-4428, 4487, 4515-4516; Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 28; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5709-5711,

Korpusit të Prishtinës për “shkatërrimin e bazave të forcave diversante terroriste [...] dhe vendosjen e kontrollit të përbashkët të MPB-së dhe UJ-së mbi zonën e përgjithshme të fshatrave Carrabreg-Irznik-Gllogjan-Gramaqel-Prilep”.¹⁰⁷⁴ Operacioni duhej të fillonte më 11 gusht 1998.¹⁰⁷⁵ Më 12 gusht 1998, Brigada e Motorizuar 125 vendosi, midis të tjerash, që grupi i luftimit 2 të “parandalojë tërheqjen e forcave diversante-terroriste nga fshati Junik dhe të jetë i gatshëm për çarmatimin e tyre”.¹⁰⁷⁶

293. Sipas Shemsedin Çekajt, “UÇK-ja në një farë mase i bëri rezistencë” operacionit të forcave serbe më 11 gusht 1998 kur forcat erdhën në lindje të rrugës kryesore Deçan-Gjakovë.¹⁰⁷⁷ Gjithsesi, UÇK-ja në fund “u tërhoq së bashku me popullatën civile” për arsye se “nuk kishte armë artilerie” dhe kishte “pak municion”.¹⁰⁷⁸ Shemsedin Çekaj dëshmoi se menjëherë të nesërmen UÇK-ja dhe civilët u kthyen nëpër fshatra dhe se “forcat serbe u kthyen [...] me njësitë e plaçkitjes” në pasditen e ditës së nesërme.¹⁰⁷⁹ Sipas tij, forcat serbe u larguan përsëri po atë ditë dhe “UÇK-ja u kthye në pozicionet e saj të mëparshme”.¹⁰⁸⁰

294. Dikur midis 10 dhe 12 gushtit 1998, forcat serbe sulmuan shtabin e UÇK-së në Gllogjan të komunës së Deçanit.¹⁰⁸¹ Dëshmitari 17 dëshmoi se më 11 gusht 1998 ai mbërriti në shtab dhe foli me Ramush Haradinajn, i cili i tha se “i duhej ndihmë”.¹⁰⁸² Dëshmitari më tej theksoi se shtabi i UÇK-së “ra dikur gjatë ofensivës serbe të 11 gushtit 1998”.¹⁰⁸³ Dëshmitari 17 nuk e dinte se “sa zgjati tërheqja e serbëve prej fshatrave”.¹⁰⁸⁴ Cufë Krasniqi dëshmoi se gjatë ofensivës së gushtit

5816-5818; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 93; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9469-9470, 9487; Prova materiale D110, f. 1.

¹⁰⁷⁴ Prova materiale D110, f. 1. Vendimi mban datën 10 gusht 1998 dhe nënshkrimin e Nebojshta Pavkoviqit.

¹⁰⁷⁵ Prova materiale D110, f. 1.

¹⁰⁷⁶ Prova materiale D75, f. 1. Vendimi mban datën 12 gusht 1998 dhe nënshkrimin e Dragan Zhivanoviqit.

¹⁰⁷⁷ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 28.

¹⁰⁷⁸ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 28.

¹⁰⁷⁹ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 28.

¹⁰⁸⁰ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P4, para. 28.

¹⁰⁸¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5709-5711, 5816-5818; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 93; Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9487; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7592-7593; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 38, 93-96; Prova materiale P352. Në lidhje me Cufë Krasniqin, Dhoma vëren se në deklaratën e tij si dëshmitar, Cufë Krasniqi ka gabuar në lidhje me datën e sulmit kundër Gllogjanit, Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 93; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5816-5818.

¹⁰⁸² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 95.

¹⁰⁸³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 96.

¹⁰⁸⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 93.

1998 ai ishte në zonë si përforsim.¹⁰⁸⁵ Sipas dëshmisë së tij, “Gllogjani ra gjatë ofensivës së parë”.¹⁰⁸⁶ Dhoma konkludon se forcat serbe hynë në Gllogjan më 11 gusht 1998, ose rreth kësaj date.

295. Më 14 gusht 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës mori vendimin për “shkatërrimin e forcave diversante-terroriste në zonën e fshatrave Sllup dhe Voksh” në përfundim të rrugës Deçan-Gjakovë.¹⁰⁸⁷ Në vendim përmendet dhe “bllokimi i Junikut”.¹⁰⁸⁸ Sipas Dragan Zhivanoviqit, forcat serbe hynë në Junik më 15 dhe 16 gusht 1998.¹⁰⁸⁹ Ai dëshmoi se më 15 gusht 1998 nxori urdhrin për “mbështetjen e forcave të MPB-së në çarmatimin e UÇK-së në Lloçan, Sllup dhe Voksh”¹⁰⁹⁰ dhe se më 18 gusht 1998, “gjeneral Pavkoviqi urdhëroi Korpusin e Prishtinës [...] që të kontrollojë rrugën Pejë-Deçan dhe [...] të kontrollojë Jasiqin dhe Junikut”.¹⁰⁹¹ Sipas tij, deri në fund të gushtit 1998 u lëshuan edhe urdhra të tjerë për vazhdimin e operacioneve të urdhëruara më parë.¹⁰⁹²

296. Në telegramin diplomatik britanik të datës 27 gusht 1998 lexohet se nga 26 gushti 1998, forcat serbe kontrollonin Junikun dhe zonën në jug të Junikut në komunën e Deçanit deri në Ponoshec të komunës së Gjakovës.¹⁰⁹³ Për më tepër, në një dokument të Komandës së Korpusit të Prishtinës të datës 30 gusht 1998 thuhet se forcat e Korpusit të Prishtinës morën urdhër për t’i ndihmuar forcat e MPB-së në “zhbllokimin e rrugëve dhe thyerjen e grupeve diversante-terroriste” midis të tjerash në zonat e komunës së Gjakovës dhe të Klinës.¹⁰⁹⁴ Në dokument po ashtu thuhet se “niveli i moralit i shumicës së grupeve diversante-terroriste ka rënë për shkak të humbjeve të pësuarra dhe mosardhjes së përforsimeve të pritura nga jashtë”.¹⁰⁹⁵

297. Lidhur me fillimin e shtatorit 1998, Radovan Zllatkoviqi dëshmoi se njësitë e MPB-së kryen operacione në Jabllanicë të komunës së Gjakovës.¹⁰⁹⁶ Sipas Radovan Zllatkoviqit, UÇK-ja u tërhoq

¹⁰⁸⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5709, 5817.

¹⁰⁸⁶ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5817.

¹⁰⁸⁷ Prova materiale D76, f. 1. Vendimi mban datën 14 gusht 1998 dhe nënshkrimin e Vladimir Llazareviqit. *Shih* gjithashtu Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P111, para. 118.

¹⁰⁸⁸ Prova materiale D76, f. 1.

¹⁰⁸⁹ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9456.

¹⁰⁹⁰ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P111, para. 119. *Shih* gjithashtu Prova materiale D77.

¹⁰⁹¹ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P111, para. 120. *Shih* gjithashtu Prova materiale D111, f. 1.

¹⁰⁹² Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P111, para. 121-125. *Shih* gjithashtu Prova materiale D78; D79; D80; D81; D82; D83.

¹⁰⁹³ Prova materiale D44, f. 1-2.

¹⁰⁹⁴ Prova materiale D84, f. 1. Dokumenti mban datën 30 gusht 1998 dhe nënshkrimin e Nebojshta Pavkoviqit.

¹⁰⁹⁵ Prova materiale D84, f. 2.

¹⁰⁹⁶ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 40.

në Dashinoc, në komunën e Deçanit, dhe se “më pas u tërhoqën edhe forcat e MPB-së”.¹⁰⁹⁷ Ai theksoi se nuk e dinte nëse “mbeti ndonjë njësi e MPB-së në Jabllanicë”.¹⁰⁹⁸ Radovan Zllatkoviqi gjithashtu dëshmoi se midis 4 dhe 8 shtator 1998 u kryen operacione në të cilat morën pjesë MPB-ja dhe SAJ-ja,¹⁰⁹⁹ për “rimarrjen e kontrollit” mbi rrugët “e bllokuara prej UÇK-së”, dhe se këto operacione “duhej të ishin të parat në mënyrë që MPB-ja të depërtonte në liqenin e Radoniqit”.¹¹⁰⁰ Provat tregojnë se forcat serbe depërtuan në zonën e kanalit të liqenit të Radoniqit më 8-9 shtator 1998, apo rreth këtyre datave.¹¹⁰¹

298. Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se “rreth 6-8 shtatorit 1998, MPB-ja dhe disa njësi të saj morën pjesë në një operacion tjetër kundër luftëtarëve të UÇK-së në zonën e Dukagjinit”¹¹⁰² dhe se u lëshuan urdhra të ndryshme për forcat serbe lidhur me këto operacione.¹¹⁰³ Ai theksoi se operacionet u kryen më 7 shtator 1998 apo rreth kësaj date, përgjatë disa akseve, ndër të cilët “Suka e Cërmjanit-Gërgoc-Ratishë e Poshtme” dhe “Prilep-Irznik-Dashinoc”¹¹⁰⁴ dhe se MPB-ja depërtoi në Irznik dhe më pas në zonën e kanalit të liqenit të Radoniqit¹¹⁰⁵ më 8 shtator 1998 apo rreth kësaj date.¹¹⁰⁶ Sipas telegramit diplomatik britanik të 10 shtatorit 1998 në të cilin janë përfshirë vëzhgimet e John Crosland-it,¹¹⁰⁷ kur ai shkoi i shoqëruar në zonën e kanalit të liqenit të Radoniqit më 8 ose 9 shtator, ai pa dëme të mëdha në fshatrat Prilep dhe Irznik.¹¹⁰⁸ Ai pa gjithashtu “MPB/PJP/SAJ të armatosura deri në dhëmbë të mbështetura nga UJ-ja me tanke T55 dhe Praga”

¹⁰⁹⁷ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 40.

¹⁰⁹⁸ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 40.

¹⁰⁹⁹ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6971-6972.

¹¹⁰⁰ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 39, 68; Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6971. Sipas tij, operacionet u kryen pas marrjes së informacionit nga pjesëtarë të UÇK-së që u arrestuan në Kodrali të komunës së Gjakovës më 3 shtator 1998 se tek rrethina e kanalit të liqenit të Radoniqit kishte kufoma, Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 45, 47, 53, 64; Prova materiale P385. *Shih* më poshtë, para. 330.

¹¹⁰¹ Nebojsa Avramoviqi, Prova materiale P451, para. 53; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 35. Dhoma vëren se Radovan Zllatkoviqi paraqiti më shumë data, si 5, 6, 7, 8 ose 9, në lidhje me datën kur forcat serbe arritën në zonën e kanalit të liqenit të Radoniqit, Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6970-6971, 6975; Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 65. *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 330. *Shih* gjithashtu Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P111, para. 135-136.

¹¹⁰² Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P111, para. 131.

¹¹⁰³ Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P111, para. 132-135. *Shih* gjithashtu Prova materiale D85; D86.

¹¹⁰⁴ Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P111, para. 132.

¹¹⁰⁵ Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P111, para. 136.

¹¹⁰⁶ Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P111, para. 135.

¹¹⁰⁷ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2984-2985.

¹¹⁰⁸ Prova materiale D112, f. 2. *Shih* më poshtë, para. 330.

dhe komenton se “duket qartë se forcat e përfshira në këtë operacion po kryenin edhe operacione të tjera për sigurimin e zonës”.¹¹⁰⁹

299. Më 6 shtator 1998, Brigada e Motorizuar 125 nxori “urdhër për mbështetjen e forcave të MPB-së për shpërndarjen e grupeve diversante-terroriste në rajonin më të gjerë të fshatit Ratishë” ku pritej rezistencë prej “terroristëve shqiptarë” në zonën e “fshatit Beleg, të liqenit të Radoniqit, dhe të fshatrave Ratishë, Dashinoc dhe Gërgoc”.¹¹¹⁰ Në urdhër gjithashtu përmenden “ndërrhyrje të mundshme grupesh më të fuqishme diversante-terroriste [...] të vendosura në drejtimin e fshatrave Isnqiq-Prapaqan-Broliq-Vranoc, në veri të Bistricës së Deçanit”.¹¹¹¹ Urdhri përfshinte edhe një urdhër tjetër gatishmërie për sulme më 8 shtator 1998 në rajonin e Gërgocit dhe Ratishës së Poshtme dhe ndryshe në Zhabel, Bardhaniq, Beleg, Pozhar, Kodrali, Irznqiq dhe Dashinoc.¹¹¹² Dhoma vëren se zonat e lartpërmendura përfshijnë një rajon të gjerë të komunës së Deçanit dhe Gjakovës.¹¹¹³

300. Dhoma gjithashtu mori si provë vendimet e Brigadës së Motorizuar 125 të datës 7 dhe 8 shtator 1998 të cilat bëjnë fjalë për operacione të tjera që u kryen në perëndim të rrugës Deçan-Gjakovë.¹¹¹⁴ Në vendimin e Brigadës së Motorizuar 125 të datës 7 shtator 1998 urdhërohej, midis të tjerash, që grupi i luftimit 2 të “vazhdojë ruajtjen dhe kontrollimin e zonës më të gjerë të fshatrave Jasiq dhe Junik dhe të organizojë pritë në zonën e fshatit Gjocaj”.¹¹¹⁵ Në vendimin e Brigadës së Motorizuar 125 të datës 8 shtator 1998 urdhërohej që grupet e luftimit të vijonin me mbështetjen e MPB-së gjatë operacioneve, midis të tjerash në fshatrat Jasiq, Junik dhe Gjocaj.¹¹¹⁶

3. Incidente të tjera në periudhën korrik-shtator 1998

(a) Misioni Monitorues i Bashkësisë Evropiane

301. Më 11 gusht 1998, gjatë udhëtimit me makinë nga Peja në jug në drejtim të Deçanit, anëtarë të ekipit të Misionit Monitorues të Bashkësisë Evropiane (“ECMM”) në Kosovë, ndër të cilët Achilleas Pappas, oficer i forcave ajrore greke, dëgjuan shpërthime në largësi dhe vendosën të

¹¹⁰⁹ Prova materiale D112, f. 2.

¹¹¹⁰ Prova materiale P117, f. 1. Urdhri mban datën 6 shtator 1998 dhe nënshkrimin “nënkolonel Djordjzif Kolim”. *Shih* gjithashtu Prova materiale D86, f. 2.

¹¹¹¹ Prova materiale P117, f. 1.

¹¹¹² Prova materiale P117, f. 2.

¹¹¹³ Prova materiale P352.

¹¹¹⁴ Prova materiale D85; D86. Vendimet janë të nënshkruara prej Dragan Zhivanoviqit.

¹¹¹⁵ Prova materiale D85, f. 1.

¹¹¹⁶ Prova materiale D86, f. 1.

shkonin më afër për të parë se çfarë po ndodhte.¹¹¹⁷ Ata u nisën në lindje në drejtim të “zonës me prani më të madhe të UÇK-së”.¹¹¹⁸ Ekipi arriti në Irzniq në komunën e Deçanit i cili po granatohej dhe dukej i braktisur.¹¹¹⁹ Ndërsa po largoheshin nga Irzniqi, rrugën ua bllokuan dy ushtarë me një xhip të vogël, të veshur me uniforma kamuflimi me emblemën e UÇK-së; ushtarët i pyetën se kush ishin dhe pse kishin ardhur aty.¹¹²⁰ Më pas ushtarët i shoqëruan në një shtëpi ndërkohë që granatimet po vazhdonin, dhe pastaj u thanë se ishin të lirë të shkonin; Achilleas Pappas hamendësoi se ushtarët ishin shqetësuar për sigurinë e ekipit.¹¹²¹ Ekipi po përgatitej që të nisej nga fshati kur u ndalua nga një grup tjetër ushtarësh të UÇK-së. Këta ushtarë ishin “të tërbuar” ose “të inatosur” nga granatimet dhe donin t’u tregonin anëtarëve të ekipit të ECMM-së vendet e granatuara, ndër të cilat xhamia dhe një spital “i thjeshtë” fushor.¹¹²² Ushtarët e shoqëruan ekipin nëpër vende të ndryshme për rreth 15 minuta dhe pastaj u thanë të largoheshin nga fshati.¹¹²³ Ndërsa po përgatiteshin të largoheshin për herë të tretë, anëtarët e ekipit të ECMM-së u ndaluan përsëri, këtë herë nga tre persona me një xhip të madh të zi, të veshur me uniforma të zeza me emblemën e UÇK-së.¹¹²⁴ Achilleas Pappas dëshmoi se disa prej këtyre personave ishin “shumë më agresivë” se dy grupet e mëparshme, dhe se ushtari që dukej si përgjegjës i grupit “bërtiste dhe bënte gjeste”.¹¹²⁵ Ai i urdhëroi anëtarët e ekipit të ECMM-së që të hynin në makinë dhe të shkonin pas xhipit.¹¹²⁶ Achilleas Pappas dëshmoi se meqenëse menduan se “nuk do të ishte veprim i matur të mos veprohej sipas urdhrit të tyre”, anëtarët e ekipit të ECMM-së iu bindën urdhrit dhe u nisën me makinë pas xhipit të zi në drejtim të Glllogjanit.¹¹²⁷

302. Achilleas Pappas dëshmoi se ekipi i ECMM-së u ndal në një rrugicë në Glllogjan; aty panë shumë njerëz duke hyrë dhe dalë nga një ndërtesë për të cilën menduan se ishte shtabi i UÇK-së.¹¹²⁸ Shumica e njerëzve atje mbanin uniforma kamuflimi të UÇK-së; “shumë pak prej tyre” ishin me uniforma të zeza.¹¹²⁹ Drejtuesi i personave në xhipin e zi ishte “shumë i inatosur”, “shante në

¹¹¹⁷ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4077-4079; Achilleas Pappas, Prova materiale P320, para. 6; Prova materiale P322.

¹¹¹⁸ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4078-4079.

¹¹¹⁹ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4085-4086.

¹¹²⁰ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4085-4086.

¹¹²¹ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4085-4086, 4089.

¹¹²² Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4085-4091.

¹¹²³ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4089-4090.

¹¹²⁴ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4091.

¹¹²⁵ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4090-4091.

¹¹²⁶ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4090-4092.

¹¹²⁷ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4092.

¹¹²⁸ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4092.

¹¹²⁹ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4098.

shqip” dhe “bërtiste e bënte gjeste”.¹¹³⁰ Përkthyesi shqiptar që shoqëronte ekipin e ECMM-së më pas i tregoi Achilleas Pappas-it se ky person po i akuzonte anëtarët e ECMM-së se ishin “spiunë të serbëve”.¹¹³¹ Ai hoqi emblemat “Bashkësia Evropiane” dhe “Vëzhgues” nga makina e ECMM-së dhe rrahu e shkelmoi përkthyesin shqiptar, duke bërë me dorë gjeste sikur po përpiquej të nxirrte armën dhe ta vriste.¹¹³² Ekipi i ECMM-së u urdhërua që të hynte në oborrin jashtë ndërtesës kryesore ku kishte rreth 15 vetë të veshur me uniforma.¹¹³³ Edhe atje drejtuesi i grupit nga xhipi i zi vazhdoi ta godiste përkthyesin me grushta e shkelma. Një anëtar i ekipit të ECMM-së u përpoq të shkonte afër përkthyesit shqiptar për ta mbrojtur, por ndaloi me të dëgjuar ngrehjen e çarkut të armëve.¹¹³⁴

303. Anëtarët e ECMM-së i çuan në katin e sipërm të ndërtesës kryesore dhe i urdhëruan që të prisnin Ramush Haradinajn.¹¹³⁵ Ramush Haradinaj erdhi dhe i pyeti se kush ishin dhe çfarë kërkonin aty; ai ishte “i sjellshëm”, “i qytetëruar” dhe “shumë i hapët dhe mirëkuptues” për misionin e ECMM-së.¹¹³⁶ Ai i pyeti anëtarët e ekipit nëse kishin armë me vete apo në makinë. Kur ata iu përgjigjën me jo, ai e kontrolloi shpejt makinën. Pastaj Ramush Haradinaj u tha anëtarëve të ekipit të ECMM-së se mund të shkonin dhe u tha tre personave me uniforma të zeza dhe me xhipin e zi që t’i shoqëronin; ekipi u shoqërua deri në Kodrali dhe pastaj vazhdoi rrugën vetë.¹¹³⁷ Në një vend afër Kodralisë ekipi i ECMM-së takoi grupin e UÇK-së që kishte takuar më herët dhe u shpjegoi atyre se çfarë kishte ndodhur. Komandanti i grupit “Toni” tha se i vinte “shumë keq por në radhët e UÇK-së ka grupe ekstremistësh që bëjnë si duan vetë”.¹¹³⁸

304. Më pas Achilleas Pappas e identifikoi Idriz Balajn si drejtuesi i grupit me uniforma të zeza dhe me xhip të zi nga fotografia në faqen e internetit të Tribunalit.¹¹³⁹ Ai e pa faqen e internetit të Tribunalit kur i kërkuan që të dëshmonte në gjykimin e parë *Haradinaj*.¹¹⁴⁰ Achilleas Pappas deklaroi se e njohu menjëherë Idriz Balajn si personi që rrahu përkthyesin shqiptar dhe drejtues i tre

¹¹³⁰ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4099.

¹¹³¹ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4099.

¹¹³² Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4075, 4099, 4128-4129; Prova materiale P321.

¹¹³³ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4361.

¹¹³⁴ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4128-4129.

¹¹³⁵ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4130-4131.

¹¹³⁶ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4132-4133, 4305.

¹¹³⁷ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4133-4134, 4357.

¹¹³⁸ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4134.

¹¹³⁹ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4136-4137, 4149, 4360, 4372; Prova materiale P323.

¹¹⁴⁰ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4136-4137, 4149, 4357, 4372.

personave me uniforma të zeza.¹¹⁴¹ Mirëpo përpara se të dëshmonte Achilleas Pappas-it nuk iu kërkua asnjëherë që të bënte identifikimin e Idriz Balajt në fotomontazh.¹¹⁴² Gjatë dëshmisë së tij në gjykimin e parë *Haradinaj*, Achilleas Pappas theksoi se drejtuesi i tre personave i cili rrahu përkthyesin, ishte i pranishëm në oborrin e shtabit të UÇK-së dhe shoqëroi ekipin e ECMM-së deri në Kodrali, ishte Idriz Balaj.¹¹⁴³ Megjithëse konstaton se Achilleas Pappas nuk ndoqi procedurën e rregullt për identifikimin e Idriz Balajt, Dhoma e pranon si të besueshëm identifikimin e Idriz Balajt prej tij, meqenëse ai e pa Idriz Balajn nga afër gjatë kontakteve që pati me të.

305. Kur i treguan fotografinë e Lahi Brahimajt nga faqja e internetit e Tribunalit, Achilleas Pappas e identifikoi si njëri nga personat që kishte parë në oborrin e ndërtesës së shtabit të UÇK-së në Gllogjan më 11 gusht 1998.¹¹⁴⁴ Achilleas Pappas dëshmoi se nuk e kishte përmendur Lahi Brahimajn në deklaratën e tij si dëshmitari për arsye se Lahi Brahimaj nuk luajti “rol aktiv” gjatë incidentit dhe “nuk bëri asgjë”.¹¹⁴⁵ Megjithatë, i pyetur nga Kryegjykatësi gjatë dëshmisë së tij në gjykimin e parë, Achilleas Pappas theksoi se nuk ishte i sigurt nëse personi në fotografinë në faqen e internetit të Tribunalit i identifikuar si Lahi Brahimaj ishte i njëjti person që kishte parë në oborrin e ndërtesës së shtabit të UÇK-së.¹¹⁴⁶ Dhoma konkludon se identifikimi i Lahi Brahimajt prej Achilleas Pappas-it si njëri prej personave të pranishëm gjatë incidentit nuk është i besueshëm.

306. Dhoma konkludon se më 11 gusht 1998, një ekip i ECMM-së në Kosovë shkoi në Irzniq në kohën kur fshati po granatohej. Ndërsa po bëhej gati të largohej, ekipi u ndalua disa herë nga ushtarë të UÇK-së dhe më në fund u çua në shtabin e UÇK-së në Gllogjan nga ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Idriz Balaj i cili i akuzoi se ishin spiunë. Idriz Balaj keqtrajtoi përkthyesin e ekipit të ECMM-së, Në Gllogjan ekipi takoi Ramush Haradinajn i cili u bëri disa pyetje dhe më pas i liroi që të largoheshin nga zona më të njëjtën ditë të shoqëruar nga ushtarë të UÇK-së.

¹¹⁴¹ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4136-4137, 4149, 4372.

¹¹⁴² Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4357.

¹¹⁴³ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4149, 4372-4373.

¹¹⁴⁴ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4149, 4360-4361, 4372; Prova materiale P323.

¹¹⁴⁵ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4360-4361.

¹¹⁴⁶ Achilleas Pappas, Prova materiale P317 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4366.

(b) Sanije Balaj

307. Dhoma dëgjoi dëshmi se dikur në gusht të vitit 1998, pjesëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së, ndër të cilët Metë Krasniqi, arrestuan Sanije Balajn nga fshati Strelc dhe e çuan në Baran.¹¹⁴⁷ Avni Krasniqi dhe Ibër Krasniqi, dy pjesëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së nga Vranoci,¹¹⁴⁸ shkuan te komandant Nazif Ramabaja dhe ushtari i UÇK-së Cufë Krasniqi në shkollën “e re”¹¹⁴⁹ fillore në Baran dhe u treguan se kishin arrestuar një person të dyshuar dhe se u duhej dikush që të shkonte dhe ta merrte në pyetje.¹¹⁵⁰ Ata u treguan se e kishin ndaluar Sanije Balajn rrugës duke shkuar nga fshati i saj për në Pejë për arsye se rruga që kishte marrë ajo ishte e vështirë dhe jo e drejtpërdrejtë, gjë që i kishte bërë ata të dyshonin; i kishin gjetur një fletore në të cilën ishte i shkruar një emër serb dhe kishin dyshuar se ajo punonte për të.¹¹⁵¹

308. I shoqëruar nga Avni Krasniqi dhe Ibër Krasniqi, Cufë Krasniqi shkoi në bazën e policisë ushtarake të UÇK-së në shkollën e vjetër e njohur si “shkolla e kuqe”¹¹⁵² në Baran për të marrë në pyetje Sanije Balajn.¹¹⁵³ Cufë Krasniqi i cili ishte anëtarësuar në UÇK në shkurt 1998, e gjeti Sanije Balajn të ulur duke pritur dhe një ushtar të UÇK-së i cili u prezantua si “oficer Galani” që po bënte roje.¹¹⁵⁴ Cufë Krasniqi më vonë mësoi se emri i vërtetë i oficer Galanit ishte Idriz Gashi.¹¹⁵⁵

309. Gjatë marrjes në pyetje, Sanije Balaj tha se ishte nisur për në Pejë dhe se kishte marrë rrugën më të gjatë për arsye se donte të blinte një telefon për ta instaluar në fshatin e saj për të fituar para dhe se kishte bërë plan që të takonte emtën në Kliçinë.¹¹⁵⁶ Cufë Krasniqit nuk iu duk i dyshimtë emri serb në fletoren e saj.¹¹⁵⁷ Gjatë pyetjeve, Avni Krasniqi dhe Ibër Krasniqi ndërhyjnë dhe thanë se Sanije Balaj nuk po tregonte të vërtetën. Cufë Krasniqi u tha që të shkonin; ata dolën

¹¹⁴⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5770-5772; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 76-77; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7732-7733; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 22.

¹¹⁴⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5714.

¹¹⁴⁹ Cufë Krasniqi dëshmoi se UÇK-ja përdorte tre objekte të shkollës fillore. Në mesin e këtyre objekteve ishte shkolla që quhej “e re” dhe “shkolla e kuqe”, Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5771, 5773.

¹¹⁵⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5771-5772.

¹¹⁵¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5772, 5778; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 22.

¹¹⁵² *Shih* më lart, para. 307.

¹¹⁵³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5773-5775; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 76-77; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7732, 7736-7738.

¹¹⁵⁴ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5773-5775, 5779; Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 30.

¹¹⁵⁵ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5788.

¹¹⁵⁶ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5774-5775.

¹¹⁵⁷ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5778.

jashtë por nuk shkuan larg nga dhoma.¹¹⁵⁸ Në fund Cufë Krasniqi e liroi Sanije Balajn dhe i tha që të mos shkonte në Pejë deri sa të hiqeshin dyshimet apo të merrte autorizim nga shtabi i UÇK-së në fshatin e saj.¹¹⁵⁹ Sanije Balaj refuzoi drekën që i ofroi Cufë Krasniqi por pranoi që Avni Krasniqi dhe Ibër Krasniqi ta çonin në shtëpi me makinën e tyre.¹¹⁶⁰ Cufë Krasniqi e pa Sanije Balajn në makinë për herë të fundit.¹¹⁶¹

310. Rreth dy javë më pas, vëllai i Sanije Balajt, Shaban Balaj, shkoi në Baran për të takuar Cufë Krasniqin.¹¹⁶² Shaban Balaj i tha Cufë Krasniqit se e dinte që Sanije Balaj kishte qenë në Baran dhe se ishte marrë në pyetje prej Cufë Krasniqit, dhe tani donte të dinte se ku ishte ajo. Cufë Krasniqi i rrëfeu çfarë dinte mbi ditën kur Sanije Balaj kishte qenë në Baran.¹¹⁶³ Shaban Balaj e falenderoi Cufë Krasniqin, i tha që kishte dëgjuar thashetheme për motrën dhe se “në qoftë se bashkëpunonte me serbët ai do ta vriste me dorën e vet pa pasur nevojë që dikush tjetër ta bënte këtë.”¹¹⁶⁴ Dhoma dëgjoji dëshminë e Sadri Selcës, një ushtar i FARK-ut në Baran,¹¹⁶⁵ se Shaban Balaj e takoi vetëm disa ditë pasi Sadri Selca kishte dëgjuar për “rrethimin, përdhunimin dhe vrasjen e Sanije Balajt”.¹¹⁶⁶ Sipas Sadri Selcës, Shaban Balaj pyeti për të motrën, i tha se ajo kishte pasur rreth 2.000 marka gjermane me vete dhe e pyeti “A e kam motrën të arrestuar? Mendoj se motrën time e kanë ndaluar forcat e UÇK-së”.¹¹⁶⁷ Megjithatë, më parë gjatë dëshmisë së tij, Sadri Selca tha se Shaban Balaj nuk kishte ndonjë “dyshim konkret” por vetëm se “dikush nga disa forca” kishte gisht në zhdukjen e motrës së tij.¹¹⁶⁸

311. Rrustem Tetaj dëshmoi se kishte dëgjuar që “Metë Krasniqi me disa të tjerë ndaluan dhe arrestuan [Sanije Balajn] me urdhrin e Faton Mehmetajt” dhe se ajo “u arrestua dhe u ekzekutua për shkak se dyshohej se i kalonte informacion MPB-së dhe policisë sekrete”.¹¹⁶⁹ U pretendua se kufoma e saj u gjet në fillim të gushtit 1998 në malet afër fshatit Baran.¹¹⁷⁰ Kur Rrustem Tetaj e pyeti Faton Mehmetajn se “çfarë ndodhi me Sanije Balajn”, Faton Mehmetaj iu përgjigj se “dyshohej se ishte spiune dhe se bashkëpunonte me Sigurimin shtetëror dhe MPB-në, prandaj duhej

¹¹⁵⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5775-5776.

¹¹⁵⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5776-5777.

¹¹⁶⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5777, 5779-5780.

¹¹⁶¹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5780.

¹¹⁶² Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5780-5781; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 25.

¹¹⁶³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5782-5783.

¹¹⁶⁴ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5783.

¹¹⁶⁵ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10859.

¹¹⁶⁶ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10880-10881.

¹¹⁶⁷ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10886-10887.

¹¹⁶⁸ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*) T. 10865.

¹¹⁶⁹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 26.

¹¹⁷⁰ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 26.

të eliminohej”.¹¹⁷¹ Rrustem Tetaj dëshmoi se Faton Mehmetaj i kishte thënë se “ai e kishte urdhëruar Metë Krasniqin që ta arrestonte dhe eliminonte”.¹¹⁷² Rrustem Tetaj më tej dëshmoi se më pas e kishte takuar Metë Krasniqin i cili kishte konfirmuar se e kishte “arrestuar dhe eliminuar Sanije Balajn me urdhrin e Faton Mehmetajt”.¹¹⁷³

312. Dikur në gusht 1998, Zymer Hasanaj dëgjoi nga djali i tij se rreth orës 12:00-14:00 të asaj dite, në vendin e quajtur Lugu i Sufit afër Vranocit në drejtim të Deçanit në komunën e Pejës, ai dhe shokët e tij kishin parë dy burra duke nxjerrë një grua me dhunë nga makina.¹¹⁷⁴ Dy burrat u kishin thënë që të largoheshin dhe ndërsa po largoheshin kishin dëgjuar tri të shtëna.¹¹⁷⁵ Rreth orës 19:30, djali i Zymer Hasanajt i çoi Zymer Hasanajn dhe bashkëfshatarët Ahmet Ukaj, Hysen Ukaj dhe Sokol Tolaj në vendin e ngjarjes.¹¹⁷⁶ Kur mbërritën atje dikush u tha “ndaloni”, “largoni fëmijën, ndryshe do ta vras”.¹¹⁷⁷ Zymer Hasanaj nuk e pa fytyrën e folësit. Ai me të birin dhe Hysen Ukajn dhe Sokol Tolajn u kthyen në fshatin e tyre kurse Ahmet Ukaj qëndroi në vendin e ngjarjes për rreth një orë.¹¹⁷⁸

313. Rreth një orë pas vajtjes së grupit në vendin e ngjarjes atë mbrëmje, Ahmet Ukaj dhe Hysen Ukaj shkuan në shtëpinë e Zymer Hasanajt.¹¹⁷⁹ Ahmet Ukaj i tregoi Zymer Hasanajt se në pyll kishin qenë dy njerëz: Idriz Gashi dhe Avni Krasniqi.¹¹⁸⁰ I tronditur dhe i shqetësuar, Ahmet Ukaj i tha Zymer Hasanajt se “Galani” kishte vrarë Sanije Balajn dhe e kishte kërcënuar që të mos fliste rreth vrasjes.¹¹⁸¹ Më pas, Zymer Hasanaj së bashku me Ahmet Ukajn dhe Hysen Ukajn shkuan të informonin Din Krasniqin për incidentin.¹¹⁸² Zymer Hasanaj dëshmoi se i tha Din Krasniqit që t’ia raportonte incidentin komandantit në Lugun e Baranit dhe se Din Krasniqi i tha Zymer Hasanajt se do ta hetonte rastin dhe se dikush do të mbante përgjegjësi për veprën.¹¹⁸³

¹¹⁷¹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 27.

¹¹⁷² Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 27.

¹¹⁷³ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 27.

¹¹⁷⁴ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 16; Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8738.

¹¹⁷⁵ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 16.

¹¹⁷⁶ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 16-17; Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8731.

¹¹⁷⁷ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 18.

¹¹⁷⁸ Zymer Hasanaj, Prova materiale P36 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8731.

¹¹⁷⁹ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 18.

¹¹⁸⁰ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 18, 20. *Shih gjithashtu Dëshmitari 77, Prova materiale P344, para. 78.*

¹¹⁸¹ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 18, 20.

¹¹⁸² Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 20-21.

¹¹⁸³ Zymer Hasanaj, Prova materiale P37, para. 20-21.

314. Pas zhdukjes së Sanije Balajt pjesëtarë të UÇK-së dhe FARK-ut kryen hetime; në këto hetime morën pjesë Hysen Gashi, Fadil Nimani (Nimoni, Nimonaj) dhe Sadri Selca.¹¹⁸⁴ Sipas Sadri Selcës, dikush me mbiemrin Ukaj i kishte treguar se gjatë një patrullimi me Avni Krasniqin dhe një oficer tjetër, ata kishin ndaluar një femër me mbiemrin Balaj dhe se Avni Krasniqi e kishte përdhunuar dhe vrarë dhe e kishte detyruar Ukajn që të shtinte me armë në trupin e pajetë të saj dhe të ndihmonte në varrosjen e kufomës në mënyrë që ta implikonte Ukajn në këtë vepër që të mos tregonte.¹¹⁸⁵ Shënimet e Sadri Selcës rreth hetimit të datës 26 gusht 1998 tregojnë se pas lirim të Sanije Balajt, “Galani dhe Avni Krasniqi” e morën dhe e çuan në një vend të panjohur ku e vranë.¹¹⁸⁶ Në shënimet e tij, Sadri Selca përfundon se “sipas të gjitha gjasave, Togeri më pas e ka çuar në liqenin e Radoniqit”, dhe se ajo ishte “ekzekutuar për arsye se kishte pranuar që punonte për policinë serbe”.¹¹⁸⁷ Lidhur me shënimet e hetimit, Sadri Selca dëshmoi se mbante shënim çdo informacion që merrte nga njerëzit pa pasur mundësi “ta përpunonte informacionin”; ai theksoi se “shënoja çdo informacion që merrja”.¹¹⁸⁸

315. Dhoma mori dëshmi nga Cufë Krasniqit dhe Dëshmitari 17 se kishin dëgjuar që Idriz Gashi ishte gjykuar dhe dënuar me burgim në Kosovë për vrasjen e Sanije Balajt.¹¹⁸⁹ Sadri Selca dëshmoi se pas luftës, kufoma e Sanije Balajt u gjet dhe u rivarros në fshatin e saj nga të afërmit.¹¹⁹⁰ Provat nuk tregojnë vendin ku u gjet kufoma.

316. Dhoma konstaton se Sanije Balaj nuk përmendet si viktimë në pikat e Aktakuzës. Dhoma konkludon se Sanije Balaj u vra dhe ka të ngjarë që në vrasjen e saj të jenë implikuar ushtarë të UÇK-së. Mirëpo dëshmitë e marra nuk vërtetuan jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm rrethanat e zhdukjes dhe vrasjes së saj si dhe identitetin e autorëve të vrasjes.

(c) Incidente të tjera

317. Sikurse është përmendur më parë në Aktgjykim,¹¹⁹¹ ndër provat e marra është edhe raporti i SPB-së së Gjakovës i datës 21 dhjetor 1998 në të cilin raportohen sulme të ndryshme kundër

¹¹⁸⁴ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5784; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 76.

¹¹⁸⁵ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10880-10881. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 78.

¹¹⁸⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 76-77.

¹¹⁸⁷ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10866.

¹¹⁸⁸ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10866.

¹¹⁸⁹ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5788; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 80.

¹¹⁹⁰ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10882.

¹¹⁹¹ *Shih* më lart, para. 229.

civilëve, të kryera, midis të tjerash, në periudhën korrik-shtator 1998. Në raport pasqyrohen incidentet e mëposhtme:

- a. “sulm me mortaja” kundër lagjes së refugjatëve “Pishat e Deçanit”, i kryer prej “grupit të organizuar terrorist nga fshatrat Prilep dhe Irzniq” më 6 korrik 1998, prej orës 09:50 deri në orën 20:30, gjatë të cilit u lënduan Nastadin Qullafiqi dhe Lela Batoçanini;¹¹⁹²
- b. “sulm terrorist” kundër fshatit Skivjan të komunës së Gjakovës, “i kryer prej një grupi diversant-terrorist shqiptar” më 9 shtator 1998, rreth orës 17:00, gjatë të cilit u vra Dino Çekaj.¹¹⁹³

318. Siç u theksua më herët, në mungesë të provave konfirmuese, Dhoma nuk do të mbështetet në këtë raport.¹¹⁹⁴ Nuk u paraqitën prova të tjera lidhur me këto incidente.

4. Hetime të autoriteteve serbe në rrethinën e kanalit në afërsi të liqenit të Radoniqit, në rrugën drejt fshatrave Dashinoc dhe Ratishë e Poshtme dhe në fermën *Ekonomija*

319. Provat që disponon Dhoma tregojnë se pas luftimeve të 3 shtatorit 1998 midis UÇK-së dhe MPB-së në fshatin Kodrali të komunës së Gjakovës në juglindje të liqenit të Radoniqit, MPB-ja arrestoi një grup prej 10-12 personash që dyshohej se ishin anëtarë të UÇK-së.¹¹⁹⁵ Të arrestuarit, ndër të cilët Zenel Alija, Bekim Kalimashi dhe Lul (Luli) Musaj, u çuan në SPB-në e Gjakovës për hetime.¹¹⁹⁶ Gjatë dy apo tri ditëve, ata u morën në pyetje dhe prej tyre u morën disa herë deklaratat.¹¹⁹⁷ Dhoma shqyrtoi besueshmërinë e këtyre deklaratave më herët në Aktgjykim.¹¹⁹⁸

320. Pas marrjes në pyetje, afërsisht rreth periudhës 8-16 shtator 1998, autoritetet serbe kryen hetime në tre vende të ndryshme: (i) në rrethinën e kanalit në pjesën veriperëndimore të liqenit të

¹¹⁹² Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 13 (f.11), Prova materiale P383, f. 6.

¹¹⁹³ Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 13 (f.11), Prova materiale P383, f. 15.

¹¹⁹⁴ *Shih* më lart, para. 165, 168, 235.

¹¹⁹⁵ Nebojša Avramović, Prova materiale P451, para. 23-24; Radovan Zllatković, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6954-6957, 7014; Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 45-47; Prova materiale P369, f. 16-24; P385, f. 1; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 33-34.

¹¹⁹⁶ Nebojša Avramović, Prova materiale P451, para. 25, 27-28, 31-32; Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 47-49.

¹¹⁹⁷ Radovan Zllatković, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7016-7018; Radovan Zllatković, Prova materiale P373, para. 53-55; Prova materiale P387; P388; P391 (Dhoma vëren se kjo provë materiale është e ngjashme me provën D190); Bogdan Tomash, Prova materiale P336 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6189-6190, 6192.

¹¹⁹⁸ *Shih* më lart, para. 207-210.

Radoniqit; (ii) në rrugën në drejtim të fshatrave Dashinoc dhe Ratishë e Poshtme, dhe (iii) në fermën *Ekonomija* në fshatin Irzniq. Hetimet në fermën *Ekonomija* vazhduan gjatë 23-27 shtatorit 1998. Në hetime morën pjesë MPB-ja dhe ekipi mjekoligjor nga Beogradi (“ekipi mjekoligjor i Beogradit”).

321. Sipas Radovan Zllatkoviçit, kufomat u zbuluan në bazë të informacionit të marrë nga të arrestuarit më 3 shtator 1998.¹¹⁹⁹ Dy javë më parë Radovan Zllatkoviç kishte dëgjuar rrëfime për njerëz të zhdukur dhe një prej tyre ishte se “ata ishin hedhur në liqenin e Radoniqit”.¹²⁰⁰ Zoran Stijoviç dëshmoi se RDB-ja kishte informacion lidhur me “vrasjet dhe rrëmbimet e civilëve dhe hedhjen e kufomave të tyre në kanalën e liqenit të Radoniqit para rimarrjes së asaj zone prej forcave serbe”.¹²⁰¹ Dhoma mori prova se në mbledhjen e FARK-ut dhe UÇK-së të datës 20 gusht 1998, në të cilën mori pjesë Ramush Haradinaj, një pjesëtar i FARK-ut ngriti çështjen e “shkeljeve të UÇK-së,” për shkak të së cilave “peshqit në liqenin e Radoniqit janë shëndoshur nga mishi i njerëzve”.¹²⁰² Askush nga të pranishmit në mbledhje nuk e komentoi këtë deklaratë.¹²⁰³ Zoran Stijoviç gjithashtu dëshmoi se “një numër i konsiderueshëm dokumentesh [të RDB-së] identifikojnë Idriz Balajn si përgjegjës kryesor për sulmet, vrasjet dhe incidentet e tjera në rrethinën e kanalit”,¹²⁰⁴ si për shembull raporti i RDB-së së Pejës i datës 26 qershor 1998 mbi marrjen në pyetje të një të dyshuari se “Togeri kishte vlarë dy policë serbë në Gllogjan” dhe se “kufomat e tyre u hodhën në kanalën e liqenit të Radoniqit”.¹²⁰⁵

(a) Konstatime të përgjithshme lidhur me ekzaminimet mjekoligjore dhe identifikimin e kufomave të gjetura

322. Dushan Dunjiç, drejtues i ekipit mjekoligjor të Beogradit,¹²⁰⁶ dëshmoi se gjatë hetimeve të kryera në periudhën 8-16 shtator 1998 dhe 23-27 shtator 1998, u gjetën kufomat e të paktën 39

¹¹⁹⁹ Radovan Zllatkoviç, Prova materiale P373, para. 53-55, 64.

¹²⁰⁰ Radovan Zllatkoviç, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6934-6935.

¹²⁰¹ Zoran Stijoviç, Prova materiale P121, para. 57-58; Zoran Stijoviç, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9087-9089. *Shih* gjithashtu Radovan Zllatkoviç, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6934-6935; Bogdan Tomash, Prova materiale P336 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6189.

¹²⁰² Zoran Stijoviç, Prova materiale P121, para. 58. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹²⁰³ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹²⁰⁴ Zoran Stijoviç, Prova materiale P122 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9086-9089; Zoran Stijoviç, Prova materiale P121, para. 57.

¹²⁰⁵ Zoran Stijoviç, Prova materiale P121, para. 57. Raporti nuk u paraqit si provë materiale.

¹²⁰⁶ *Shih* më poshtë, para. 331.

individëve në tre vende të ndryshme.¹²⁰⁷ Midis viktimave kishte meshkuj dhe femra nga mosha 11 deri në 70 vjeç.¹²⁰⁸

323. Ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se për shkak të shkallës së shpërbërjes së kufomave “shkaku i vdekjes” nuk mund të përcaktohej saktë vetëm nga autopsia,¹²⁰⁹ Gjithsesi ata bënë të ditur se shumica e viktimave kishin pësuar thyerje në kafkë dhe eshtra të shkaktuara nga plumbat që në disa raste u gjetën në kufomat e viktimave ose nga goditje me mjete jo të mprehta.¹²¹⁰ Bazuar në pozicionin e kufomave të gjetura në rrethinën e kanalit, dëmtimet e eshtrave që zbuloi autopsia dhe dëmtimet e murit të kanalit prej betoni të shkaktuara nga plumbat, Branimir Aleksandriqi nga ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se “kishte shumë të ngjarë” që disa nga viktimat të ishin “ekzekutuar në vend” me “armë të lehta”.¹²¹¹ Në afërsi të kufomat apo në vetë kufomat u gjetën tela me gjemba, kablla elektrike dhe “një lloj litari alpinistësh” të cilat gjatë ekzaminimit mjekoligjor u hoqën nga kufomat.¹²¹²

324. Edhe pas ekzaminimeve, ekipi mjekoligjor i Beogradit nuk ishte në gjendje të “përcaktonte saktë kohën e vdekjes”,¹²¹³ për arsye se kufomat e gjetura në kanalit të liqenit ishin “eksponuar ndaj kushteve të ndryshme, duke përfshirë kushtet atmosferike, të cilat ndikojnë në shkallën e shpërbërjes së kufomës”.¹²¹⁴ Gjithsesi ekipi mjekoligjor i Beogradit vlerësoi se personat, kufomat e të cilëve u gjetën në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit, kishin vdekur dikur midis prillit dhe

¹²⁰⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 169. Dhoma përdor fjalën “të paktën” meqenëse numri i saktë nuk është i qartë nga provat.

¹²⁰⁸ *Shih* përgjithësisht, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471.

¹²⁰⁹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 98, 196, 206, 218, 237, 248, 258, 265, 283, 293, 319, 330, 341, 351, 362, 373, 390, 400, 417, 448, 461, 474, 491, 508, 517, 530, 541, 550, 560, 567, 578, 598, 605, 618, 628, 643, 656, 668, 678; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9537; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 49.

¹²¹⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 194-196, 207-210, 219-220, 233, 244-245, 256, 266-267, 281, 291, 300, 313, 328, 330, 338, 349, 351, 359-360, 374, 391, 400-401, 418, 448-449, 461, 464, 469, 475-477, 491-492, 518, 542, 551-552, 568, 580-581, 606-607, 619-621, 629-632, 644-647, 657-658, 669-670, 679; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6776-6777, 6818-6819, 9556-9557; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 47-48, 78, 95, 105-106, 112, 171, 192.

¹²¹¹ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6776-6777, 6818-6819, 9536-9538, 9556-9558, 9560-9562; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 47-48.

¹²¹² Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 57, 72, 81-82, 87, 97, 100, 111, 119, 129, 132-133; Prova materiale P436, f. 3 (n. 15 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*, T. 6761-6762, 6769-6770; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 269, 302, 352.

¹²¹³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 97.

¹²¹⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 97.

gushtit 1998; për disa prej tyre koha e vdekjes u përcaktua më saktë se për disa të tjerë.¹²¹⁵ Koha e vdekjes për kufomat që u gjetën në fermën *Ekonomija* dhe rreth saj u përcaktua më saktë; ekspertët mjekoligjorë që bënë ekzaminimin e kufomave të gjetura në fermë konkluduan se koha e vdekjes së tyre ishte më e afërt dhe vlerësuan se këta persona kishin vdekur dikur mes korrikut dhe gushtit 1998.¹²¹⁶ Lidhur me kufomat e gjetura në rrugën për në Dashinoc dhe Ratishë të Poshtme u vlerësua se këta persona kishin vdekur dikur midis majit dhe gushtit 1998.¹²¹⁷ Në përgjithësi, u vlerësua se të gjithë personat, kufomat e të cilëve u gjetën në tre vendet e lartpërmendura, kishin vdekur brenda periudhës së Aktakuzës.

(b) Rrethina e kanalit të liqenit të Radoniqit

325. Kanali është në komunën e Deçanit, në pjesën veriperëndimore të liqenit të Radoniqit.¹²¹⁸ Dhoma vëren se Jabllanica e komunës së Gjakovës shtrihet në anën verilindore të liqenit të Radoniqit, kurse Gllogjani i komunës së Deçanit në anën veriperëndimore të liqenit të Radoniqit.¹²¹⁹ Rrethina e kanalit shtrihet rreth dy kilometra larg fshatit Irzniq të komunës së Deçanit në pjesën juglindore¹²²⁰ dhe përshkruhet si “kanal betoni për ujë shirash [...] rreth 1.8 – 2 m i thellë, projekt për mbledhjen e ujit dhe derdhjen e tij në liqen”.¹²²¹ Kanali prej betoni çon drejt një grykëderdhjeje natyrore.¹²²² Sipas Nebojshta Avramoviqit, në rrethinën e kanalit mund të

¹²¹⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7266-7268; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 192, 205, 217, 236, 247, 257, 264, 282, 292, 318, 329, 340, 350, 361, 371, 388, 398, 413, 437, 446, 458, 472, 489, 505, 514, 529, 539, 548, 558, 565, 575, 589, 596. Branimir Aleksandriqi dëshmoi se shkalla e ndryshme e shpërbërjes së kufomave tregon se kufomat te kanali kanë qenë në atë vend me kohëzgjatje të ndryshme; ai ishte i mendimit se kufomat kishin qenë në atë vend së paku tri deri në katër javë dhe më së shumti disa muaj, Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6765-6766, 9563; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 255.

¹²¹⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 604, 616, 626, 640, 654, 666, 676.

¹²¹⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 687.

¹²¹⁸ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 72-73; Prova materiale P395. *Shih* gjithashtu Prova materiale P12.

¹²¹⁹ Prova materiale P87.

¹²²⁰ Prova materiale D112, para. 1; John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4666-4667.

¹²²¹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2972.

¹²²² Nebojshta Avramoviq, Prova materiale P451, para. 71. *Shih* gjithashtu Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6803; Prova materiale P436, f. 1 (f. 12 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 151, 155-156, 212.

depërtohej vetëm përmes rrugëve të pashtuara nga drejtimi i Gllogjanit, Irzniqit dhe Ratishës së Poshtme në komunën e Deçanit.¹²²³

326. Ylber Haskaj, pjesëtar i njësisë “Shqiponjat e Zeza”,¹²²⁴ dëshmoi se me tërheqjen e forcave serbe nga fshati Irzniq dhe fshatra të tjera përreth nga mesi i prillit 1998, pjesë të mëdha të zonës së Dukagjinit, duke përfshirë edhe liqenin e Radoniqit, nuk ishin më nën kontrollin e forcave serbe deri në ofensivën e shtatorit 1998.¹²²⁵ Mirëpo, i pyetur nga Mbrojtja, ai u përgjigj se në zonën e liqenit të Radoniqit vepronin si UÇK-ja, po ashtu dhe forcat serbe, por se UÇK-ja “nuk kishte armatim të mjaftueshëm për të kontrolluar çdo pjesë, kështu që nuk mund të themi se kishim kontroll të plotë mbi një zonë”.¹²²⁶ Dëshmitari 69 theksoi se për forcat serbe “ishte e pamundur të lëviznin përgjatë liqenit prej jugut në veri, për shkak të pranisë më të madhe të UÇK-së” dhe se nga mesi i vitit 1998 deri në shtator 1998 ishte thaujse e pamundur të depërtohej në rrethinën e liqenit nëpërmjet rrugëve përmes Cërmjanit, Gllogjanit ose Ratishës për të shkuar në pjesën veriore të liqenit, pa u parë apo sulmuar nga UÇK-ja.¹²²⁷

327. Branko Gajiqi dëshmoi se në mars 1998, në anën jugore të liqenit të Radoniqit, gjegjësisht në Rakoc dhe në bazën në Sukën e Radoniqit, kishte prani të forcave serbe¹²²⁸ dhe se korpusi i njësisë të posaçme u ridislokua në zonën rreth liqenit të Radoniqit dhe në rrëzën e Sukës së Radoniqit dikur pas 13 majit.¹²²⁹ Ai dëshmoi se “UÇK-ja shpeshherë sulmonte pikën në Sukë të Radoniqit”.¹²³⁰ Kishte gjithashtu prova se forcat serbe, ndër të cilat batalioni 52 i policisë ushtarake

¹²²³ Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 53. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 69, P370, para. 30.

¹²²⁴ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 8-10.

¹²²⁵ Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 34; Prova materiale P42. *Shih* gjithashtu Radovan Zlatković, Prova materiale P373, para. 28; Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 31; Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9877-9878.

¹²²⁶ Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10329-10333.

¹²²⁷ Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para. 30, 32; Prova materiale P368. Dhoma vëren se fshati Cërmjan i komunës së Gjakovës shtrihet në anën juglindore të Liqenit të Radoniqit.

¹²²⁸ Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 22; Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9707-9709. *Shih* gjithashtu Ylber Haskaj, Prova materiale P40, para. 34; Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10329-10330 (ku thotë se forcat serbe “kontrollonin zonën në juglindje të liqenit të Radoniqit” dhe gjatë pyetjeve të Mbrojtjes pranoi se forcat serbe ishin të vendosura në bazën në Bitesh, prej nga sulmonin dhe granatonin duke filluar nga fundi i marsit apo fillimi i prillit 1998). Dhoma vëren se Rakoci dhe Suka e Radoniqit shtrihen në anën verilindore dhe juglindore të liqenit të Radoniqit

¹²²⁹ Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9743. Kur e pyetën për herë të parë nëse korpusi i njësisë të posaçme u dislokua rreth asaj zone në vitin 1998, Branko Gajiqi tha “me sa di unë, jo”. Mirëpo, ai ra ndesh me përgjigjen e vet kur iu tregua një dokument i Komandës së Korpusit të Prishtinës, Branko Gajiq, Prova materiale P25 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9710-9711, 9741-9743.

¹²³⁰ Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 22.

dhe MPB-ja, ishin të vendosura në anën jugore të liqenit të Radoniqit.¹²³¹ Në provat gjyqësore ekzistojnë dokumente të ndryshme të forcave serbe të muajit prill,¹²³² maj¹²³³ dhe qershor¹²³⁴ 1998, të cilat dëshmojnë për praninë e forcave serbe në atë zonë. Dhoma gjithashtu mori prova lidhur me shkëmbim zjarri disaorësh midis UÇK-së dhe forcave serbe në afërsi të liqenit të Radoniqit në mbrëmjen e 25 prillit 1998.¹²³⁵

328. Lidhur me kontrollin mbi rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit, Nebojsa Avramoviqi theksoi se rrethina e kanalit ishte nën kontrollin e UÇK-së, dhe se nga prilli 1998 deri më 9 shtator 1998, policia serbe nuk ishte në gjendje të depërtonte në këtë zonë.¹²³⁶ Në të kundërt, John Crosland-i gjatë dëshmisë së tij parashtroi mundësinë e depërtimit dhe veprimit të njërive të MPB-së në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit në periudhën 25 korrik-6 gusht.¹²³⁷ Për më tepër, gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, Ylber Haskaj pranoi se nga fillimi i korrikut 1998 pati luftime midis UÇK-së dhe forcave serbe në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit dhe se faktikisht asnjë palë nuk kishte kontroll të plotë të kësaj zone.¹²³⁸ Radovan Zllatkoviqi dëshmoi se gjatë operacioneve të forcave serbe në gusht 1998, forcat e MPB-së nuk depërtuan në zonën e liqenit të Radoniqit por pranoi se ishte e mundur që ato të kishin depërtuar në Sukën e Biteshit, ngjitur me bregun perëndimor të liqenit të Radoniqit.¹²³⁹ Në anën tjetër, Dragan Zhivanoviqi theksoi se gjatë

¹²³¹ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3009-3011, 4632 (në prill 1998); Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9394-9395; Dragan Zhivanoviqi, Prova materiale P112, para. 8 (i referohet një periudhe të pacaktuar kohore në vitin 1998).

¹²³² Prova materiale D120. “Raporti luftimi plotësues” i Komandës së Korpusit të Prishtinës i datës 26 prill 1998 (nuk ka nënshkrim por mban emrin e Millorad Gjorgjeviqit), ku thuhet se “terroristët” sulmuan “zonën e dislokimit të batalionit 52 të policisë ushtarake (që mbron liqenin e Radoniqit)”, Prova materiale D120.

¹²³³ Prova materiale D98. Urdhër i Brigadës së Motorizuar 125 i datës 16 maj 1998 (i nënshkruar prej Dragan Zhivanoviqit) në të cilin urdhërohet që grupi i luftimit 2 “të jetë në gjendje gatishmërie në zonën aktuale të dislokimit për operacione përgjatë akseve në vijim [...] kazermën në [liqenin e Radoniqit]”, Prova materiale D98, f. 1. *Shih* gjithashtu John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3139-3141.

¹²³⁴ Prova materiale D102. Dokument i Komandës së Korpusit të Prishtinës i datës 10 qershor 1998 (nuk ka nënshkrim por mban emrin e Nebojsa Pavkoviqit), ku përfshihet një raport se ishte vendosur kontakt me “kompaninë 25 të policisë ushtarake në zonën e liqenit të Radoniqit (në varësinë e batalionit 52 të policisë ushtarake)”, Prova materiale D102, f. 2. *Shih* gjithashtu John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4630-4632.

¹²³⁵ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3009-3011; Prova materiale D8, para. 1-2.

¹²³⁶ Nebojsa Avramoviqi, Prova materiale P451, para. 53.

¹²³⁷ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4654-4655.

¹²³⁸ Ylber Haskaj, Prova materiale P39 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10331.

¹²³⁹ Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6905-6906, 6909-6910; Radovan Zllatkoviqi, Prova materiale P373, para. 34. *Shih* gjithashtu Prova materiale D113, f. 55.

operacioneve të lartpërmendura, forcat e MPB-së depërtuan në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit.¹²⁴⁰

329. Bazuar në provat e mësipërme, Dhoma konkludon se gjatë periudhës së Aktakuzës, rrethina e kanalit të liqenit të Radoniqit ishte përgjithësisht nën kontrollin e UÇK-së, me patrullime të kohëpaskohshme të forcave serbe dhe luftime midis dy palëve në rrethinën e kanalit. Dhoma më tej konkludon se gjatë periudhës së Aktakuzës, forcat serbe kishin prani të vazhdueshme në disa pjesë përreth liqenit të Radoniqit, duke përfshirë anën jugore të liqenit.

(i) Hetimet në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit

330. Gjatë javës së parë të shtatorit 1998, para se të fillonin hetimet në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit, MPB-ja dhe UJ-ja kryen operacione të përbashkëta për pastrimin e zonës nga UÇK-ja.¹²⁴¹ Menjëherë pas operacioneve, më 8 ose 9 shtator 1998, në rrethinën e kanalit shkoi një ekip hetimor serb së bashku me disa persona që dyshohej se ishin pjesëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Zenel Alijaj, Bekim Kalimashi dhe Lul (Luli) Musaj.¹²⁴² Ekipi hetimor serb përbëhej nga zyrtarë të MPB-së dhe RDB-së.¹²⁴³ Përveç ekipit hetimor serb, në vendin e hetimit shkuan edhe zyrtarë të vendit, përfaqësues vendorë dhe të huaj, dhe gazetarë.¹²⁴⁴ Atje panë, midis të tjerash, vrima plumbash në murin e kanalit, kufoma dhe gëzhoja.¹²⁴⁵ John Crosland-i i cili ishte i pranishëm në vendin e hetimit, dëshmoi se gëzhojat ishin të prodhimit kinez dhe me simbole me gjasë kineze, dhe se në raportet e zbulimit të asaj kohe thuhej se UÇK-ja përdorte municion kinez që vinte nga

¹²⁴⁰ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P110 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9353.

¹²⁴¹ Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 68; Radovan Zllatkoviq; Prova materiale P372 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6971-6972; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6656-6657; Nebojsa Avramoviq, P451, para. 19. *Shih* më lart, para. 297.

¹²⁴² Bogdan Tomash, Prova materiale P338, para. 29, 40-41; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 41-42, 44; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6970-6973, 6975; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 64-65, 68-69, 74.

¹²⁴³ Bogdan Tomash, Prova materiale P338, para. 29-30, 34; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6641-6643; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P371 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6970-6973; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 68-69; Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9890-9891.

¹²⁴⁴ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2971-2972; Prova materiale D112; Bogdan Tomash, Prova materiale P338, para. 45; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 62.

¹²⁴⁵ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2972-2973, 2979-2980; Prova materiale P12; Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 55-59, 62, 71; Radovan Zllatkoviq, Prova materiale P373, para. 74-79, 88; Bogdan Tomash, Prova materiale P338, para. 38-39; Bogdan Tomash, Prova materiale P336 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6152-6154.

Shqipëria.¹²⁴⁶ Branimir Aleksandriqi dëshmoi se nuk e dinte nëse u morën fishekë nga terreni apo nga muri i kanalit prej betoni për t'u ekzaminuar dhe krahasuar me fishekët e gjetur gjatë autopsive.¹²⁴⁷ Gjithsesi, kishte prova se nga rrethina e kanalit u morën gëzhoja për analizë dhe se MPB-ja konkludoi se ato ishin "identike" me gëzhojat e gjetura në "vendin e ngjarjes në Plançor më 7 mars 1998" dhe "në vendin e ngjarjes në Gramaçel më 24 mars 1998".¹²⁴⁸

331. Më 9 ose 10 shtator 1998, gjykatësi Radomir Gojković i Gjykatës së Qarkut të Pejës, i cili u caktua gjykatës hetues për këtë çështje, i dërgoi Institutit Mjekoligjor të Beogradit (i njohur gjithashtu si Instituti Mjekoligjor i Fakultetit të Mjekësisë në Beograd) kërkesë për një ekip ekspertësh mjekoligjorë që do të ndihmonin hetimet në zonën e liqenit të Radoniqit.¹²⁴⁹ Në ekipin e ekspertëve mjekoligjorë të Beogradit që u caktua, midis të tjerëve ishin Dushan Dunjiqi, drejtues i ekipit, dhe Branimir Aleksandriqi.¹²⁵⁰ Në vendin e hetimit, ekipi mjekoligjor i Beogradit u ndihmua prej zhytësve të MPB-së.¹²⁵¹

332. Vonë në mëngjesin e datës 11 shtator 1998, ekipi mjekoligjor i Beogradit mbërriti në zonën e kanalit për të filluar zhvarrosjet dhe përfunduan punën më 15 ose 16 shtator 1998.¹²⁵² Ekspertët fotografuan dhe filmuan çdo kufomë dhe pjesë kufome, shënuan vendin e gjetjes, dhe çdo kufome i vunë nga një numër me parashtesën "R".¹²⁵³ Në fund të çdo dite pune, kufomat dhe pjesët e

¹²⁴⁶ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2973-2974.

¹²⁴⁷ Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9568-9570, 9606. *Shih* gjithashtu Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 123, 465-468, 502, 506.

¹²⁴⁸ Prova materiale P369, f. 7, 51-55 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹²⁴⁹ Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 106-108; Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6737; Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P439, para. 7-8, 11; Prova materiale P435, f. 1-2; P436, f. 1 (f.12 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 21-23, 26.

¹²⁵⁰ Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6737; Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P435, f. 2 në dokumentacionin gjyqësor elektronik; Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P436, f. 1 (f. 12 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P439, para. 9, 11; Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 114; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 22.

¹²⁵¹ Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 116.

¹²⁵² Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6623-6624; Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 105,108-110, 124; Prova materiale P458; P462; Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6737; Prova materiale P436, f. 1, 7 (f. 12, 18 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P439, para. 11-12, 67, 262; Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7223-7226, 7234; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 25, 27, 75; Prova materiale P473.

¹²⁵³ Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P439, para. 34-37, 39-40, 46, 124; Prova materiale P436, f. 1-3 (f. 12-14 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriqi, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6742, 6753-6755; Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 114, 117; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 43; Prova

kufomave ngarkoheshin në kamion dhe transportoheshin për autopsy në garazhin e hotel Pashtrikut në Gjakovë, meqenëse u vlerësua se për shkak të pranisë së UÇK-së në atë zonë, kryerja e autopsive në vendin e hetimit ishte tejet e rrezikshme.¹²⁵⁴ Autopsitë në hotelin Pashtrik filluan më 12 shtator 1998 dhe ato i kryen ekspertët mjekoligjorë të Beogradit.¹²⁵⁵

333. Për shkak të motit me shi, zhvarrosjet u ndërpreu më 12 shtator 1998 dhe rifilluan në pasditen e datës 15 shtator 1998.¹²⁵⁶ Autopsitë përfunduan më 16 shtator 1998.¹²⁵⁷

materiale P474; Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6831.

¹²⁵⁴ Prova materiale P436, f. 1, 2, 5-6, (f. 12-13, 16-17 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 16, 35, 41-44, 62; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 49-50, 60-62; Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6829-6831.

¹²⁵⁵ Prova materiale P436, f. 1, 3, 5-6 (f. 12, 14, 16-17 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 41-43; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 80.

¹²⁵⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 75; Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7234-7235.

¹²⁵⁷ Prova materiale P436, f. 7 (f. 18 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 262.

(ii) Kufomat në liqenin e Radoniqit dhe identifikimi i tyre i mëpasshëm

334. Provat që disponon Dhoma tregojnë se në rrethinën e kanalit u shënuan gjithsej ¹²⁵⁸ 37 ose 38 kufoma, pjesë kufomash apo sende personale;¹²⁵⁹ më vonë u konstatua se disa prej pjesëve të shënuara të kufomave i përkisnin të njëjtit individ.¹²⁶⁰ Në “procesverbalin e hartuar në objektin e hotel Pashtrikut më 19 shtator 1998, në orën 14:00”, nënshkruar nga drejtuesi i ekipit, Dushan Dunjiqi dhe gjykatësi hetues, Radomir Gojkoviqi, evidentohet se nga kufomat e gjetura në rrethinën e kanalit u identifikuan 10 individë:¹²⁶¹ Haxhi Seferaj, Velizar Stoshiq, Vukosava Markoviq (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq), Millovan Vllahoviq, Darinka Kovaç (mbiemri i vajzërisë Vujosheviq), Ilire Frrokaj, Ilija Antiq, Hajrullah Gashi, Jusuf (Isuf) Hoxha dhe Tush Frrokaj.¹²⁶²

335. Me përfundimin e ekzaminimeve, ekipi mjekoligjor i Beogradit krahasoi përshkrimet e marra prej të afërmeve të personave të zhdukur me përfundimet e nxjerra, duke përfshirë të dhënat për gjininë, shtatlartësinë, moshën dhe “karakteristikat e veçanta fizike” të viktimave. Kur të dhënat përputheshin, ekspertët mjekoligjor të Beogradit ua tregonin të afërmeve të personave të zhdukur rrobat dhe sendet personale të gjetura me kufomat, vëzhgonin reagimin e tyre dhe pastaj krahasonin “informacionin *post mortem* me atë *ante mortem*” për të bërë identifikimin.¹²⁶³ Gjithsesi, Dushan Dunjiqi theksoi se nga metodat e përdorura për identifikim ekzistonte rrezik i konsiderueshëm për identifikim të gabuar.¹²⁶⁴ Faktikisht, kufoma e shënuar me numrin R-15, e gjetur në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit, fillimisht u identifikua se ishte e Millovan Vllahoviqit kurse më pas,

¹²⁵⁸ Sipas dëshmisë së Branimir Aleksandriqit, u shënuan 37 sende, kurse sipas Dushan Dunjiqit 38. *Shih* përgjithësisht Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439; dhe Dushan Dunjiq, Prova materiale P471.

¹²⁵⁹ Ndër sendet personale ishte një këpucë e shënuar me “R-6”. Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 250. *Shih* gjithashtu Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 107, 188.

¹²⁶⁰ Për shembull, pjesët e kufomës të shënuara me “R-21” dhe “R-24” u konstatua se ishin “dy pjesë të së njëjtës kufomë,” Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 502.

¹²⁶¹ Sipas dëshmisë së Dushan Dunjiqit, pjesët e kufomës të shënuara me “R-21” dhe “R-24 u identifikuan se ishin të “Sejdo Nocit” nga vajza dhe vëllai i tij. Megjithatë, bashkëshortja e tij nuk u pajtua me këtë identifikim dhe për këtë arsye, ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se “nuk ishim në gjendje të bënim identifikimin e saktë të R-21 dhe R-24”, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471 para. 123, 465-468, 502, 506. *Shih* gjithashtu Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 188. Dhoma nuk e ka përfshirë “Sejdo Nocin” midis personave të identifikuar.

¹²⁶² Prova materiale P369, f. 57 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik). Raporti vë në dukje se nuk u identifikuan 20 kufoma apo pjesë kufomash të tjera të gjetura në rrethinën e kanalit, Prova materiale P369, f. 57 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹²⁶³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 107-117; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 262-263. Sipas Dushan Dunjiqit, kufomat nuk iu treguan anëtarëve të familjes Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 114.

¹²⁶⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7325-7326.

analiza e ADN-së nga KNPZH-ja vërtetoi se ishte e Istref Krasniqit.¹²⁶⁵ Identifikimi fillestar u bë në bazë të identifikimit të rrobave prej të afërmve, informacionit nga dosja mjekësore, duke përfshirë një “shenjë thyerjeje në eshtrën e brinjës” nga koha kur Millovan Vllahoviqi kishte thyer njërin nga brinjët e djathta, dhe karakteristikave të tjera trupore.¹²⁶⁶ Edhe në disa raste të tjera analizat e ADN-së të kryera prej KNPZH-së vërtetuan se identifikimi fillestar kishte qenë i pasaktë.¹²⁶⁷

336. Bazuar në sa më sipër, Dhoma pranon si të sakta identifikimet e bëra nga ekspertët mjekoligjorë të Beogradit vetëm kur ekzistojnë prova të mjaftueshme për identifikim. Provat për identifikim përcaktohen në bazë të rrethanave të rastit. Lidhur me identifikimin përmes analizës së ADN-së, Dhoma konkludon se kjo metodë identifikimi nuk u zbatua me të gjitha kufomat dhe se disa kufoma që nuk u identifikuan fillimisht, më pas u identifikuan nga KNPZH-ja përmes analizës së ADN-së.

337. Si provë u mor një dokument i KNPZH-së i datës 26 maj 2006 drejtuar UNMIK-ut, ku lexohet se në rrethinën e kanalit u gjetën kufomat e “Zenun (Ramadan) Gashit”, “Pal (Dedë) Krasniqit”, “Istref (Ymer) Krasniqit”, “Malush (Shefki) Mehës”, “Millka (Radovan) Vllahoviqit”, të cilat u identifikuan përmes analizës së ADN-së.¹²⁶⁸ Ndër provat materiale lidhur me Zenun Gashin është aktanaliza e ADN-së prej KNPZH-së,¹²⁶⁹ certifikata e vdekjes e lëshuar nga UNMIK-u¹²⁷⁰ dhe aktautopsia prej UNMIK-ut.¹²⁷¹ Bazuar në dokumentet e KNPZH-së, Dhoma konkludon se në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit u gjetën kufomat e Zenun Gashit, Pal Krasniqit, Istref Krasniqit, Malush Mehës dhe Millka Vllahoviqit.

338. Dushan Dunjiqi dëshmoi se kishte parë ose i kishin treguar analizën e ADN-së të KNPZH-së për Misin Berishën,¹²⁷² Kujtim Imerajn,¹²⁷³ Ilire Frrokajn,¹²⁷⁴ Nurije Krasniqin¹²⁷⁵ dhe Rade

¹²⁶⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 381, 383; Prova materiale P428.

¹²⁶⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 379-381. *Shih* gjithashtu Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T.7325-7326.

¹²⁶⁷ Dushan Dunjiqi dëshmoi se kufoma e identifikuar si e Haxhi Seferajt ishte në fakt e Misin Berishës dhe se kufoma e identifikuar si Tush Frrokaj ishte në fakt e Kujtim Imerajt, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 226, 383, 525.

¹²⁶⁸ Prova materiale P428, f. 1-2 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹²⁶⁹ Prova materiale P428, f. 3 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹²⁷⁰ Prova materiale P431, f. 4-5.

¹²⁷¹ Prova materiale P429.

¹²⁷² Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 226.

¹²⁷³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 525.

¹²⁷⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 431.

¹²⁷⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 367.

Popadiqin.¹²⁷⁶ Këto analiza nuk u paraqitën si prova.¹²⁷⁷ Gjithsesi, bazuar në dëshminë e Dushan Dunjiqit dhe në mungesë të kundërprovave, Dhoma konkludon se në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit u gjetën edhe kufomat e Misin Berishës, Kujtim Imerajt, Ilire Frrokajt, Nurije Krasniqit dhe Rade Popadiqit.

339. Kufoma e shënuar me numrin R-8 u identifikua se ishte e Velizar Stoshiqit në bazë, midis të tjerash, të rrobave të gjetura me kufomën dhe një “shufre metalike të vendosur në ijen e djathtë”.¹²⁷⁸ Kishte gjithashtu prova se të afërmit e Velizar Stoshiqit i thanë ekipit mjekoligjor të Beogradit se ai ishte nisur për në “barnatore për të blerë disa gjëra për nipin dhe ishte zhdukur duke u kthyer nga barnatorja”¹²⁷⁹ dhe se afër kufomës u gjetën “një biberon plastik, një kapak gome për shishe foshnjesh, mbathje plastike për pelena [dhe] një triko e thurur prej leshi për foshnje”.¹²⁸⁰ Bazuar në sa më sipër, Dhoma konkludon se kufoma e Velizar Stoshiqit u gjet në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit.

340. Kufomat e shënuara me R-10 dhe R-17 u identifikuan se ishin të Vukosava Markoviqit dhe motrës së saj, Darinka Kovaçit,¹²⁸¹ bazuar, midis të tjerash, në “simptomat e sëmundjes së mëparshme të eshtrave dhe sëmundjes së nyjeve të rruazave”.¹²⁸² Ekipi mjekoligjor i Beogradit konstatoi “lëndime të vjetra” në kufomën që më pas u identifikua se ishte e Vukosava Markoviqit, që përputheshin me informacionin e marrë nga një i afërm i saj se shumë vjet para vdekjes Vukosava Markoviqi kishte pësuar lëndime gjatë një aksidenti me makinë.¹²⁸³ Ekipi mjekoligjor i Beogradit gjithashtu konkludoi se kufoma e cila më vonë u identifikua se ishte e Darinka Kovaçit kishte “eshtërim të rëndë të shtyllës kurrizore që kishte shkaktuar zhvillimin e një gunge në kafazin e krahërorit”.¹²⁸⁴ Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se kufomat e gjetura në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit, të shënuara me numrat R-10 dhe R-17, u identifikuan se ishin të Vukosava Markoviqit dhe Darinka Kovaçit.

¹²⁷⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 571

¹²⁷⁷ Dushan Dunjiq gjithashtu dëshmoi se e kishte parë një raport të KNPZH-së të analizës së ADN-së për Istref Krasniqin, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 383. Dokumenti i KNPZH-së lidhur me identifikimin e kufomës së Istref Krasniqit është marrë si provë. Prova materiale, P428, f. 1 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹²⁷⁸ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 270-272.

¹²⁷⁹ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 114.

¹²⁸⁰ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 112.

¹²⁸¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 406.

¹²⁸² Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 304, 306-307, 407-408. Dhoma vëren se sëmundja nuk përmendet.

¹²⁸³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 304

¹²⁸⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 403.

341. Ekipi mjekoligjor i Beogradit bëri identifikimin e kufomave të Ilija Antiqit, Hajrullah Gashit dhe Jusuf (Isuf) Hoxhës në bazë të gjinisë, moshës, shtatlartësisë dhe karakteristikave të tjera trupore, në veçanti në bazë të identifikimit të rrobave prej të afërmeve të tyre.¹²⁸⁵ Dhoma nuk mori prova për analizë të ADN-së së këtyre kufomave. Duke marrë parasysh identifikimet e pasakta të lartpërmendura të ekipit mjekoligjor të Beogradit dhe në mungesë të provave konkrete, Dhoma gjykon se nuk ekziston bazë e mjaftueshme për pranimin e këtyre identifikimeve si të sakta.¹²⁸⁶ Dhoma gjithashtu konkludon se kufomat e Haxhi Seferajt, Millovan Vllahoviqit dhe Tush Frrokajt nuk u gjetën në kanalën e liqenit të Radoniqit duke qenë se analiza e mëpasshme e ADN-së vërtetoi se identifikimi i tyre i parë kishte qënë i pasaktë.¹²⁸⁷

342. Rrjedhimisht, Dhoma përfundon se në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit u gjetën kufomat e Misin Berishës, Zenun Gashit, Velizar Stoshiqit, Nurije Krasniqit, Istref Krasniqit, Malush Mehës, Ilire Frrokajt, Kujtim Imerajt, Rade Popadiqit, Vukosava Markoviqit, Darinka Kovaçit, Pal Krasniqit dhe Millka Vllahoviqit.

a. Misin Berisha

343. Dhoma dëgjoi dëshmi se emri i Misin Berishës ishte në listën e personave të shënuar në fletoren e Dëshmitarit 17, siç shtjellohet më vonë në Aktgjykim.¹²⁸⁸

344. Kufoma e shënuar me numrin R-3 u identifikua se ishte e Misin Berishës.¹²⁸⁹ Kufoma u gjet pranë murit të kanalit prej betoni më 11 shtator 1998.¹²⁹⁰ Pranë kufomës gjithashtu u gjet një copë shiriti i verdhë ngjites, i ngjashëm me shiritin e gjetur rreth qafës së kufomës me numrin R-4.¹²⁹¹ U vlerësua se ky person kishte vdekur dikur mes prillit dhe gushtit 1998.¹²⁹² Kufoma kishte “plagë në legen të shkaktuar nga një plumb”, e cila me gjasë kishte shkaktuar hemoragji vdekjepruese për shkak të mosmjekimit.¹²⁹³ Kufoma kishte thyerje të shumta në kafkë dhe nofullën e poshtme. Ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se thyerjet në kafkë ishin shkaktuar nga goditje me “një apo më

¹²⁸⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 452, 483, 498.

¹²⁸⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 452, 483, 498.

¹²⁸⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 226, 383, 525.

¹²⁸⁸ Prova materiale D146, f. 14; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 57. *Shih* më poshtë, para. 645.

¹²⁸⁹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 226.

¹²⁹⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 211. Dëshmia e Branimir Aleksandriqit bën të ditur se kufoma u gjet në rrëpirën drejtpërsëdrejti paralel me murin, Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9548-9550, 9552.

¹²⁹¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 212, 228.

¹²⁹² Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 215, 217.

¹²⁹³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 219; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 95

shumë mjete jo të mprehta”.¹²⁹⁴ Ekspertët mjekoligjor më tej konkluduan se “lëndimet nuk mund të ishin shkaktuar nga ndonjë rrëzim nga bregu i kanalit poshtë në vendin ku ishte gjetur kufoma”.¹²⁹⁵ Nuk u paraqitën prova të tjera lidhur me Misin Berishën.

345. Dhoma vëren se Misin Berisha nuk përmendet si viktimë në pikat e Aktakuzës. Dhoma konkludon se Misin Berisha u vra. Mirëpo, provat e lartpërmendura nuk as vërtetuan rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së tij, as implikimin e UÇK-së e as identitetin e autorëve konkretë të vrasjes.

b. Zenun Gashi

346. Në fund të qershorit apo fillim të korrikut 1998, për shkak se kishin dëgjuar se policia po largohej dhe nga frika prej UÇK-së familja e Zenun Gashit, polic rom në pension, donte të largohej nga fshati Kosuriq i komunës së Pejës.¹²⁹⁶ Zenun Gashi refuzoi të largohej, duke thënë se “Unë nuk kam bërë asnjë të keqe [...]. Prandaj nuk ka pse të largohem,” kurse familja e tij vendosi të largohej nga fshati.¹²⁹⁷ Ndërsa po largoheshin nga fshati, disa djem të rinj me rroba civile u thanë se vetëm policia serbe po largohej, kështu që ata u kthyen përsëri në shtëpi.¹²⁹⁸

347. Më vonë atë ditë, tre burra, dy prej të cilëve me uniforma të zeza dhe një me “uniformë shumëngjyrëshe”, shkuan në shtëpinë e familjes së Zenun Gashit dhe kërkuan armën e Zenun Gashit (pistoletë me leje) dhe uniformën e vjetër të tij.¹²⁹⁹ Më 30 korrik 1998, në shtëpinë e Zenun Gashit shkuan dy burra të tjerë me uniforma të zeza dhe kontrolluan shtëpinë për armë dhe uniforma.¹³⁰⁰

348. Më 1 gusht 1998, në orën 11:00, dy burrat që kishin kontrolluar shtëpinë më 30 korrik 1998 shkuan përsëri në shtëpinë e Zenun Gashit së bashku me një person të tretë; kësaj radhe, dy burrat

¹²⁹⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 220.

¹²⁹⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 220.

¹²⁹⁶ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9625-9626; Dëshmitari 52, Prova materiale P495 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9627, 9633-9634; Dëshmitari 17, Prova materiale P344 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7705; Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10872.

¹²⁹⁷ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9625-9626; Dëshmitari 52, Prova materiale P495 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9627, 9630-9631.

¹²⁹⁸ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9625-9626; Dëshmitari 52, Prova materiale P495 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9627, 9629-9631.

¹²⁹⁹ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9636; Dëshmitari 52, Prova materiale P495 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9637.

¹³⁰⁰ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9639-9640.

kishin veshur uniforma të zeza kurse i treti uniformë kamuflimi.¹³⁰¹ Njëri prej burrave me uniformë të zezë ishte Vesel Dizdari.¹³⁰²

349. Vesel Dizdari dëshmoi se me urdhrin e komandantit të policisë ushtarake të UÇK-së, Metë Krasniqi,¹³⁰³ ata kërkuan përsëri armë në shtëpinë e Zenun Gashit dhe e morën dhe e çuan Zenunin tek Metë Krasniqi në ndërtesën e shkollës në Baran.¹³⁰⁴ Vesel Dizdari dëshmoi se as ai vetë e as ushtarët e tjerë nuk përdorën dhunë dhe me sa pa ai nuk i bënë asgjë Zenun Gashit. Ai gjithashtu dëshmoi se pas luftës kishte dëgjuar se Zenun Gashi ishte vrarë ose i zhdukur.¹³⁰⁵

350. Pjesëtari i FARK-ut Sadri Selca, i cili më parë kishte punuar me Zenun Gashin në polici, për herë të fundit e pa Zenun Gashin në makinë në qendër të fshatit Baran të komunës së Pejës.¹³⁰⁶ Dëshmia nuk jep datën e kësaj ngjarjeje. Sadri Selca dëshmoi se Zenuni, i cili ishte “në gjendje shumë të keqe” dhe “i rrahur”, i kishte kërkuar ujë.¹³⁰⁷ Gjatë dëshmisë së tij në gjykimin e parë, Sadri Selca tha se nuk i njohu njerëzit në makinë dhe se nuk i kujtohej nëse ata ishin me uniforma. Kur iu lexua një pjesë e deklaratës së tij me shkrim dhënë në tetor 2002, ai pranoi se personat në makinë ishin ushtarë shqiptarë kosovarë me uniforma kamuflimi, të cilat nuk mundi t’i identifikonte.¹³⁰⁸ Sadri Selca vizitoi familjen e Zenun Gashit dhe gjatë vizitës bashkëshortja e Zenun Gashit i tregoi se Zenun Gashi ishte rrëmbyer nga shtëpia e tij prej një grupi ushtarësh në të njëjtën ditë që Sadri Selca e kishte parë në makinë.¹³⁰⁹

¹³⁰¹ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9641-9642.

¹³⁰² Vesel Dizdari, Prova materiale P467, para. 18-19; Dëshmitari 52, Prova materiale P495 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9646-9648. *Shih* gjithashtu Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 56.

¹³⁰³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5714; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 71; Rustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 27; Rustem Tetaj, Prova materiale P76 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3835-3836. Dhoma vëren se dëshmia e Sadri Selcës, pjesëtar i FARK-ut, nuk është e qartë për sa i përket pozitës së Metë Krasniqit dhe rrjedhimisht nuk e pranon në lidhje me këtë aspekt, Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10862, 10864.

¹³⁰⁴ Vesel Dizdari, Prova materiale P467, para. 18-21; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 71. *Shih* gjithashtu Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 56. Në dëshminë e tij, Vesel Dizdari deklaroi se asnjëherë nuk kishte qenë pjesëtar i UÇK-së por se kishte marrë pjesë në mbrojtjen e fshatit të tij Qellopek në komunën e Lipjanit, dhe se Metë Krasniqi i kishte thënë se do të punonte në policinë ushtarake, Vesel Dizdari, Prova materiale P467, para. 12.

¹³⁰⁵ Vesel Dizdari, Prova materiale P467, para. 20, 22.

¹³⁰⁶ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10872-10874.

¹³⁰⁷ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10873-10874.

¹³⁰⁸ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10873-10875.

¹³⁰⁹ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10884.

351. Disa ditë pas zhdukjes, familja e Zenun Gashit filloi të pyeste dhe dëgjoji për një shtab të UÇK-së të vendosur në bodrumin e një shtëpie në fshatin Kosuriq.¹³¹⁰ Të afërmit e Zenun Gashit pyetën përreth dhe shkuan në shtab. Disa burra u thanë: “Do të vijë prapë. Do të kthehet. Mos u shqetësoni”.¹³¹¹ Të afërmit e Zenun Gashit shkuan disa herë në shtab por nuk e panë më kurrë Zenun Gashin.¹³¹²

352. Nga fundi i korrikut apo fillimi i gushtit, Dëshmitari 17 u informua nga “dikush i shërbimit të sigurimit të brigadës 3/131 se oficeri i policisë ushtarake të UÇK-së Metë Krasniqi e kishte çuar një civil me emrin Zenun nga fshati Baran” në Gllogjan tek Ramush Haradinaj.¹³¹³ Dëshmitari 17 dëshmoi se kur e pyeti komandantin e Metë Krasniqit, Din Krasniqin,¹³¹⁴ rreth informacionit që kishte marrë, Dini i tha se “Faton Mehmeti” kishte urdhëruar që Zenun Gashi të çohet në Gllogjan.¹³¹⁵ Dhoma nuk mori prova nëse Ramush Haradinaj ishte i pranishëm në rast dhe në kohën kur Zenun Gashi u çua në Gllogjan. Sipas Dëshmitarit 17, në një moment të pasaktësuar pas këtyre ngjarjeve, kur Din Krasniqi i tha se Zenuni do të vritej në qoftë se i dorëzohej “policisë sekrete të UÇK-së”, Dëshmitari 17 këmbënguli që Zenuni të lirohej; Pas ndërmjetësimit të Din Krasniqit, Zenuni u lirua.¹³¹⁶ Din Krasniqi i tha Dëshmitarit 17 se në qoftë se Zenuni do të arrestohej përsëri, ai do të vritej.¹³¹⁷ Siç shtjellohet më vonë në Aktgjykim, emri i Zenun Gashit është në listën e personave të shënuar në fletoren e Dëshmitarit 17.¹³¹⁸

353. Dëshmitari 17 më pas dëgjoji se Zenuni u “arrestua përsëri nga pjesëtari i UÇK-së Zeqë Krasniqi, kushëri i Metë Krasniqit”, dhe “u çua përsëri në Shtabin Operativ të Rrafshit të Dukagjinit në Gllogjan”.¹³¹⁹ Nga dëshmia nuk është e qartë se kur ndodhi kjo dhe prej kujt e dëgjoji këtë Dëshmitari 17. Dëshmitari 17 e pyeti Din Krasniqin për Zenunin, me synimin që të ndërmjetësonte

¹³¹⁰ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9643-9644.

¹³¹¹ Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9643-9644.

¹³¹² Dëshmitari 52, Prova materiale P494 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9643-9644.

¹³¹³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 71-72; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7704.

¹³¹⁴ Din Krasniqi ishte komandant i UÇK-së në Lugun e Baranit, Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 31.

¹³¹⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 71.

¹³¹⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 71; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7704.

¹³¹⁷ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 71.

¹³¹⁸ Prova materiale D146, f. 13. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7705; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 57-58. *Shih* më poshtë, para. 645.

¹³¹⁹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 72; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7704.

përsëri lirimin e tij.¹³²⁰ Din Krasniqi iu përgjigj duke bërë me dorë një gjest të prerjes në fyt nga i cili Dëshmitari 17 kuptoi se “Zenuni ishte vrasë”.¹³²¹ Sipas Dëshmitarit 17, Din Krasniqi nuk i tha se ku ndodhej kufoma e Zenun Gashit dhe Dëshmitari 17 nuk e pyeti për këtë gjë.¹³²²

354. Sipas raportit të analizës së ADN-së të kryer prej KNPZH-së, kufoma e shënuar me numrin R-4 e gjetur në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit u identifikua se ishte e Zenun (Ramadan) Gashit.¹³²³ Kufoma u gjet pranë murit të kanalit prej betoni. Sipas raportit të ekipit mjekoligjor të Beogradit, kufoma kishte një plagë tejshpuese në kafkë e shkaktuar nga një predhë. Ata vlerësuan se vdekja kishte ndodhur dikur midis prillit dhe gushtit 1998.¹³²⁴ Kishte gjithashtu gjurmë thyerjesh “në eshtrën e krahut të majtë, brinjët në anën e majtë, eshtrën rrezore të parakrahut të majtë, llërën e majtë dhe këmbën e djathtë” “me gjasë nga plagë të shkaktuara me armë zjarri”.¹³²⁵ Rreth qafës së viktimës u gjet një copë shiriti i verdhë ngjitës, i ngjashëm me atë të gjetur pranë kufomës së shënuar me numrin R-3.¹³²⁶ Në aktautopsinë e ZPZH-së konkludohej se Zenun Gashi vdiq nga “plagë në kokë të shkaktuara nga copëza predhe”.¹³²⁷

355. Dhoma vëren se Zenun Gashi nuk përmendet si viktimë në pikat e Aktakuzës. Dhoma konkludon se Zenun Gashi u vra dhe se me gjasë në vrasjen e tij u përfshinë pjesëtarë të UÇK-së. Mirëpo, provat e lartpërmendura nuk vërtetuan rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së tij, e as identitetin e autorëve konkretë të vrasjes.

c. Velizar Stoshiqi

356. Dhoma mori prova se “më 18 korrik, pensionisti shtatëdhjetë e shtatë vjeçar Velizar Stoshiqi, baba i tre fëmijëve, u rrëmbye në rrugën Bellopojë – Loxhë”¹³²⁸ dhe se të afërmit e Velizar

¹³²⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 72

¹³²¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 72.

¹³²² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 72.

¹³²³ Prova materiale P428. Ndonëse në raportin e ekipit mjekoligjor të Beogradit thuhet se pjesët e kufomës të shënuara me “R-4” “nuk u identifikuan”, më pas identifikimin përmes ADN-së e bëri KNPZH-ja, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 238. *Shih* gjithashtu Prova materiale. P429; P430; P431.

¹³²⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 227-228, 233, 236; Prova materiale. P478; P479; P480; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 101-103.

¹³²⁵ Prova materiale P429, f. 1.

¹³²⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 212, 226, 228; Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7320-7324. “R-3” herën e parë u identifikua si kufoma e “Haxhi Seferajt” por më vonë përmes ADN-së u konstatua se pjesët e kufomës të shënuara me “R-3” ishin të “Misin Berishës”. Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 224, 226.

¹³²⁷ Prova materiale P429, f. 1. *Shih* gjithashtu Prova materiale P430; P431.

¹³²⁸ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 54.

Stoshiqit i thanë ekipit mjekoligjor të Beogradit se ai ishte nisur për në “barnatore për të blerë disa gjëra për nipin dhe ishte zhdukur duke u kthyer nga barnatorja”.¹³²⁹

357. Dushan Dunjiqi dëshmoi se kufoma e shënuar me numrin R-8 u identifikua se ishte e Velizar Stoshiqit.¹³³⁰ Kufoma e shënuar me numrin R-8 u gjet më 11 shtator 1998 pranë murit prej betoni të kanalit;¹³³¹ gjithashtu u gjet “një litar alpinistësh i lidhur ngushtë në formë laku rreth qafës”.¹³³² Ekspertët vlerësuan se vdekja kishte ndodhur dikur mes prillit dhe gushtit 1998.¹³³³ Autopsia zbuloi “vrime plumbash në të dyja anët e kokës”, lëndime mbi gjurin e këmbës së djathtë dhe “një plumb në kupën e gjurit të majtë”.¹³³⁴

358. Dhoma vëren se Velizar Stoshiqi nuk përmendet si viktimë në pikat e Aktakuzës. Dhoma konkludon se Velizar Stoshiqi u vra. Mirëpo, provat e lartpërmendura nuk vërtetuan as rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së tij, as implikimin e UÇK-së e as identitetin e autorëve konkretë të vrasjes.

d. Nurije Krasniqi dhe Istref Krasniqi

359. Sadri Selca kishte marrë shënim se “Imer (Istref) Krasniqi” nga fshati Turjakë i komunës së Pejës ishte “marrë për t’u pyetur lidhur me bashkëpunimin e tij me policinë serbe dhe për disa çështje të tjera”.¹³³⁵ Në pyetjet lidhur me Istref Krasniqin dhe Nurije Krasniqin, Sadri Selca u përgjigj se korrieri i tij Naser Kuçi i kishte thënë se “i kanë marrë... i kanë marrë këta pleq”.¹³³⁶ Sipas Sadri Selcës, Naser Kuçi e kishte dëgjuar këtë “nga njerëzit, nga disa fshatarë të Turjakës” (Turjakë e komunës së Pejës) emrat e të cilëve Sadri Selca i kishte harruar.¹³³⁷

360. Shënimi zyrtar i datës 25 gusht 1998 bën të ditur se Sadri Selca gjithashtu “u informua nga një informator se Istref Imer Krasniqi dhe gruaja e tij ishin rrëmbyer në fshatin Turjakë nga Rustem Tetaj dhe se fati i tyre nuk dihej”.¹³³⁸ Në të njëjtën kohë, Sadri Selca dëshmoi se gjatë bisedës me Naser Kuçin, “u tha se Rustem Tetaj i kishte marrë me makinë”, por Sadri Selca “nuk

¹³²⁹ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 114.

¹³³⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 272.

¹³³¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 259.

¹³³² Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 111, 119; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 269.

¹³³³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 264.

¹³³⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 266-267.

¹³³⁵ Prova materiale P335, f. 8.

¹³³⁶ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10867-10869, 10883.

¹³³⁷ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10883.

¹³³⁸ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10868; Prova materiale P334.

mori kurrfarë informacioni” se “kush e kishte kryer rrëmbimin”.¹³³⁹ Dhoma vëren se dëshmia e Rrustem Tetajt para Dhomës nuk përfshin informacion lidhur me Nurije Krasniqin dhe Istref Krasniqin.

361. Cufë Krasniqi dëshmoi se për rrëmbimin e “Nurije dhe Istref Krasniqit” kishte dëgjuar dikur para shtatorit 1998.¹³⁴⁰ Cufë Krasniqi dëshmoi se Tahir Zemaj e kishte pyetur nëse dinte se çfarë kishte ndodhur me çiftin dhe i kishte thënë se komandanti i Policisë Ushtarake të UÇK-së Fadil Nimoni (Nimani, Nimonaj)¹³⁴¹ ishte caktuar për hetimin e çështjes.¹³⁴² Më vonër Cufë Krasniqi dëgjoi thashetheme se çifti bashkëpunonte me autoritetet serbe dhe ishte vrarë, por ai nuk e dinte se kush i vrau.¹³⁴³

362. Ekipi mjekoligjor i Beogradit i gjeti kufomat e shënuara me numrat R-14 dhe R-15 afër njëra-tjetrës pranë murit të kanalit prej betoni, të mbuluara me zhavorr, më 12 shtator 1998.¹³⁴⁴ Kufomat R-14 dhe R-15 u identifikuan se ishin të Nurije Krasniqit dhe Istref Krasniqit.¹³⁴⁵ Kufoma e shënuar me numrin R-14 kishte pësuar “thyerje të shumta në kafkë” dhe “disa pjesë të kafkës mungonin”.¹³⁴⁶ Autopsia zbuloi, midis të tjerash, “thyerje të shumta në brinjë”, mungesë të një pjese të lëndës eshtërore, “thyerje në pjesën e sipërme të krahut të djathtë” dhe “pjesë të krahut të djathtë që mungonin”.¹³⁴⁷ Ekipi mjekoligjor i Beogradit nuk ishte në gjendje të konkludonte “nëse thyerjet në kafkë, pjesën e sipërme të krahut të djathtë dhe kraharor ishin shkaktuar nga plumbi apo ndonjë mjet jo i mprehtë”.¹³⁴⁸ U vlerësua se vdekja e kufomës së shënuar me numrin R-14 me gjasë kishte ndodhur në prill ose maj 1998.¹³⁴⁹ Autopsia e kufomës së shënuar me numrin R-15, e kryer prej ekipit mjekoligjor të Beogradit, zbuloi “thyerje në të dy eshtrat e parakrahëve”. Megjithëse shkaku i vdekjes “nuk mund të përcaktohej saktë” ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se thyerjet “nuk mund të ishin shkaktuar nga ndonjë rrëzim poshtë në kanal” por “ishin

¹³³⁹ Sadri Selca, Prova materiale P332 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10869; Prova materiale P334.

¹³⁴⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 88.

¹³⁴¹ *Shih* më lart, para. 117.

¹³⁴² Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 88

¹³⁴³ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 89. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹³⁴⁴ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6772-6774, 9553; Prova materiale P436, f. 3 (f. 14 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 134-135; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 354, 368.

¹³⁴⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 367, 383; Prova materiale P428.

¹³⁴⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 359.

¹³⁴⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 359. Gjithashtu mungonin kërciri i këmbës së majtë, dy shputat e këmbëve dhe dy duart, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 359.

¹³⁴⁸ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 360.

¹³⁴⁹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 361.

shkaktuar nga një forcë mekanike”.¹³⁵⁰ U vlerësua se vdekja e kufomës me numër R-15 me gjasë kishte ndodhur midis prillit apo majit dhe gushtit 1998.¹³⁵¹

363. Dhoma vëren se Nurije Krasniqi dhe Imer (Istref) Krasniqi nuk përmenden si viktimë në pikat e Aktakuzës. Dhoma konkludon se Nurije Krasniqi dhe Imer (Istref) Krasniqi u vranë. Mirëpo, provat e lartpërmendura nuk vërtetuan as rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së tyre, as implikimin e UÇK-së e as identitetin e autorëve konkretë të vrasjes.

e. Malush Meha

364. Ka prova që tregojnë se përmes analizës së ADN-së të kryer prej KNPZH-së, kufoma e shënuar me numrin R-16 u identifikua se ishte e Mahir Mehës.¹³⁵² Ekipi mjekoligjor i Beogradit nuk bëri identifikimin e kufomës R-16.¹³⁵³

365. Sipas ekipit mjekoligjor të Beogradit, kufoma u gjet më 12 shtator 1998 “pranë anës së jashtme të kanalit prej betoni” në një thellësi prej 30 centimetra, e mbuluar me një shtresë balte.¹³⁵⁴ Sipas Dushan Dunjiqit, mungesa e disa eshtrave sugjeronte se “kufoma fillimisht kishte qenë në sipërfaqe dhe më pas ishte mbuluar me dhe”.¹³⁵⁵ Kufoma kishte “thyerje në shpatullën e djathtë dhe në gjysmën e majtë të eshtrës së legenit” të cilat për mendimin e ekspertëve mjekoligjorë “nuk mund të ishin shkaktuar nga ndonjë rrëzim”.¹³⁵⁶ Nuk u paraqitën prova të tjera lidhur me Malush Mehën.

366. Dhoma vëren se Malush Meha nuk përmendet si viktimë në pikat e Aktakuzës. Në bazë të provave të marra, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundime lidhur me Malush Mehën.

f. Ilire Frrokaj

367. Në shënimet e tij, Sadri Selca shënoi: “1./?V/itor Krasniqi nga fshati Nepolë deklaroi se Tush Frrokaj nga fshati Plançor është zhdukur pa lënë gjurmë, së bashku me bashkëshorten”.¹³⁵⁷

¹³⁵⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 374.

¹³⁵¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 371.

¹³⁵² Prova materiale P428. *Shih* gjithashtu Prova materiale P431.

¹³⁵³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 393.

¹³⁵⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 384.

¹³⁵⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 391.

¹³⁵⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 391.

¹³⁵⁷ Prova materiale P335, f. 3.

Radovan Zllatkoviçiq dëshmoi se SPB-ja e Gjakovës “kishte informacion se serbë, romë e shqiptarë, si për shembull Ilire dhe Tush Frrokaj, u zhdukën pa asnjë gjurmë”.¹³⁵⁸

368. Dushan Dunjiq dëshmoi se një i afërm i Ilire Frrokajt kishte deklaruar se ajo “për herë të fundit ishte parë më 26 gusht 1998” dhe se sipas disa të afërmeve të tjerë të saj “pjesëtarë të UÇK-së” shkuan “drejt në shtëpinë e Ilire dhe Tush Frrokajt, sikur ta kishin bërë plan” dhe i rrëmbyen.¹³⁵⁹ Sipas dëshmisë së Dushan Dunjiqit, Ilire Frrokaj “në kohën e zhdukjes e kishte foshnjën në gji” dhe se “përpara marrjes së Ilires dhe Tushit nga UÇK-ja, një i afërm shkoi në shtëpinë e tyre për të marrë foshnjën”.¹³⁶⁰ Dushan Dunjiqit nuk i kujtohej nëse të afërmit i thanë se “e panë me sytë e tyre rrëmbimin” apo dëgjuan nga të tjerët.¹³⁶¹ Zoran Stijoviçiq dëshmoi lidhur me një shënim të RDB-së së Gjakovës “nga intervista me Ibrahim Majun [...] ku ai përmend rrëmbimin e çiftit Frrokaj në një fshat afër Gjakovës”.¹³⁶²

369. Kufoma e shënuar me numrin R-18 u identifikua se ishte e Ilire Frrokajt.¹³⁶³ Dhoma citon përfundimin e vet se kufoma e Tush Frrokajt nuk u gjet në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit.¹³⁶⁴ Kufoma e shënuar me numrin R-18 u gjet më 11 shtator 1998 “në hyrjen e kanalit që shpie drejt kanalit prej betoni, nën ujëvarën, në afërsi të një makine të përmbytur”.¹³⁶⁵ Autopsia “zbuloi një plagë të cekët në pjesën e poshtme të këmbës së djathtë të shkaktuar nga hyrja e plumbit” dhe “një plumb që pjesërisht kishte dalë nga këmba në të njëjtin vend”.¹³⁶⁶ Autopsia “gjithashtu zbuloi thyerje të shumta në kafkë, rruazën e qafës së mitrës, shpatullën e majtë dhe kërcirin e këmbës së majtë”.¹³⁶⁷ Gjithashtu në makinën e përmbytur afër kufomës u konstatuan vrima plumbi.¹³⁶⁸ Së fundi, autopsia “zbuloi plagë djegieje në trup dhe dëmtime nga dhëmbë kafshësh të shkaktuara *post mortem*”.¹³⁶⁹ Kufoma “ishte mjaft e shpërbërë dhe e kalbur dhe

¹³⁵⁸ Radovan Zllatkoviçiq, Prova materiale P373, para. 51.

¹³⁵⁹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 426.

¹³⁶⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 426.

¹³⁶¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 426.

¹³⁶² Zoran Stijoviçiq, Prova materiale P121, para. 56. Shënimet e intervistës së RDB-së së Gjakovës nuk janë paraqitur si provë.

¹³⁶³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 428, 431.

¹³⁶⁴ *Shih* më lart, para. 341.

¹³⁶⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 411. *Shih* gjithashtu Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6803, 9605; Prova materiale P436, f. 3 (f. 15 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Prova materiale P439, para. 151, 154-158.

¹³⁶⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 418.

¹³⁶⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 418.

¹³⁶⁸ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 419.

¹³⁶⁹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 421.

rrjedhimisht shkak i vdekjes” nuk mund “të përcaktohej vetëm nga autopsia”. U vlerësua se vdekja kishte ndodhur dikur në gusht 1998.¹³⁷⁰

370. Dhoma vëren se Ilire Frrokaj nuk përmendet si viktimë në pikat e Aktakuzës. Dhoma konkludon se Ilire Frokaj u vra. Mirëpo, provat e lartpërmendura nuk vërtetuan as rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së saj, as implikimin e UÇK-së e as identitetin e autorëve konkretë të vrasjes.

¹³⁷⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 413, 417.

g. Kujtim Imeraj

371. Kufoma e shënuar me numrin “R-26” u identifikua se ishte e Kujtim Imerajt.¹³⁷¹ Ajo u gjet rreth 660 metra nga ujëvara.¹³⁷² “Autopsia e eshtrave të gjetura të kafkës zbuloi thyerje të tëmthit nga ana e djathtë”.¹³⁷³ U vlerësua se vdekja kishte ndodhur në “korrik apo gusht 1998” dhe se “shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohet vetëm në bazë të autopsisë”.¹³⁷⁴

372. Dhoma vëren se Kujtim Imeraj nuk përmendet si viktimë në pikat e Aktakuzës. Në bazë të provave të mësipërme, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundime lidhur me Kujtim Imerajn.

(c) Rruga për në Ratishë të Poshtme dhe Dashinoc

373. Dhoma mori prova se më 11 shtator 1998, gjykatësi hetues Radomir Gojković i dha një “thes me eshtra të gjetura në Dashinoc” ekipit mjekoligjor të Beogradit që ishte në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit.¹³⁷⁵ Gjykatësi hetues dhe MPB-ja i kishin gjetur eshtrat në rrugën për në Ratishë të Poshtme dhe Dashinoc më 10 shtator 1998.¹³⁷⁶ Duket se ekipi mjekoligjor i Beogradit nuk shkoi në vendin e ngjarjes, por vetëm mori fotografitë e MPB-së të vendit ku ishin gjetur eshtrat.¹³⁷⁷

374. Në thesin e shënuar me shkronjën “D” për “Dashinoc”¹³⁷⁸ kishte eshtra, rroba, dokumente dhe gëzhoja. Thesi u çua në hotelin Pashtrik në Gjakovë.¹³⁷⁹ U konkludua se eshtrat dhe sendet në thes u përkisnin “së paku tre personave të rritur”¹³⁸⁰ ose tre meshkujve dhe një femre.¹³⁸¹ Pjesët e

¹³⁷¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 525.

¹³⁷² Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 516.

¹³⁷³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 518.

¹³⁷⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 514, 517.

¹³⁷⁵ Prova materiale P436, f. 3 (f. 14 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 252; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 63, 683-684; Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 80, 82, 87; Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6667.

¹³⁷⁶ Bogdan Tomash, Prova materiale P338, para. 50; Bogdan Tomash, Prova materiale 336 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6157; Radovan Zlatković, Prova materiale P373, para. 93-95, 97-100; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 252.

¹³⁷⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 64, 69, 128.

¹³⁷⁸ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 64, 683-687; Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6850; Prova materiale P436, f. 3 (f. 14 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 252; Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 88.

¹³⁷⁹ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 252; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 63-65, 683; Nebojsa Avramović, Prova materiale P451, para. 87; Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6667.

¹³⁸⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 683-684, 688.

¹³⁸¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6850.

kufomave u ndanë në dy grupe dhe u shënuan me D-1 dhe D-2.¹³⁸² Në grupin D-1 kishte eshtra që u përkisnin së paku tre individëve të ndryshëm, ndër të cilat pjesë të kafkës, brinjëve dhe eshtrave të këmbës; eshtrat e tre viktimave nga grupi “D-1” fillimisht u shënuan me D1a, D1b dhe D1c.¹³⁸³ Nga “shkalla e shpërbërjes së eshtrave të shënuara me D-1” u konkludua se vdekja “me gjasë kishte ndodhur midis majit dhe gushtit 1998”.¹³⁸⁴ Në grupin e shënuar me D-2 ishin grumbulluar “pjesë pjesërisht të djegura rrobash grash, të gjetura në anën tjetër të rrugës ku ishin gjetur eshtrat e shënuara me D-1”.¹³⁸⁵ Nuk u zbulua asnjëherë se të kujt ishin këto rroba grash.¹³⁸⁶

375. Ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se ndër eshtrat e shënuara me D-1 “kishte shumë të ngjarë të kishte pjesë eshtrash të të zhdukurve Slobodan Radosheviq dhe Millosh Radunoviq”.¹³⁸⁷ Ky identifikim u bë, ndër të tjera, në bazë të identifikimit të rrobave prej të afërmeve të viktimave dhe në bazë të dokumenteve të gjetura në rroba, ndër të cilat dokumentet e identifikimit të Millosh Radunoviqit.¹³⁸⁸ Provat tregojnë se nuk u bë identifikimi i këtyre kufomave përmes analizës së ADN-së. Sipas ekipit mjekoligjor të Beogradit, ishte e pamundur të përcaktohej se cila pjesë është i përkiste cilit individ, prandaj, me këmbënguljen e të afërmeve të viktimave, ata i ndanë eshtrat në tri pjesë të barabarta (domethënë dy viktimat e identifikuar dhe një e paidentifikuar) dhe i vendosën në arkivole së bashku me sendet personale.¹³⁸⁹

376. Duke marrë parasysh diskutimin rreth identifikimit parashtruar më lart në Aktgjykim, meqenëse nuk ka prova të mjaftueshme për identifikim,¹³⁹⁰ Dhoma konkludon se kufoma e Slobodan Radosheviqit dhe e Millosh Radunoviqit nuk ishin midis kufomave të gjetura në rrugë. Slobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi nuk përmenden si viktima në pikat e Aktakuzës.

¹³⁸² Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 66-67, 690.

¹³⁸³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 68.

¹³⁸⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 686-687.

¹³⁸⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 67, 689-690.

¹³⁸⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 692.

¹³⁸⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 705. *Shih* gjithashtu Prova materiale P369, f. 57 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹³⁸⁸ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 127, 704-705. Radovan Zlatkoviq dëshmoi se u gjet leja për mbajtjen e armës e Millosh Radunoviqit (Radovan Zlatkoviq, Prova materiale P373, para. 100) kurse Nebojsa Avramoviqi dëshmoi se u gjet leja për mbajtjen e armës e Slobodan Radosheviqit (Nebojsa Avramoviq, Prova materiale P451, para. 83, 85). Mirëpo, ekipi mjekoligjor i Beogradit nuk përmend gjetjen e një lejeje për mbajtje arme, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 694-709; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 252.

¹³⁸⁹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 709; Dushan Dunjiq, Prova materiale P468 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6849-6852.

¹³⁹⁰ *Shih* më lart, para. 335-336.

(d) Ferma *Ekonomija*

377. Gjatë pasdites së 11 shtatorit 1998, ekspertët e ekipit mjekoligjor të Beogradit shkuan të shoqëruar nga rrethina e kanalit në afërsi të liqenit të Radoniqit, në fermën *Ekonomija* aty pranë.¹³⁹¹ Ferma ndodhet në fshatin Irzniq, në komunën e Deçanit, rreth 300 metra larg kanalit.¹³⁹²

¹³⁹¹ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6741-6742, 9578-9579; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 12-13; Prova materiale P436, f. 1 (f. 12 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 39, 57.

¹³⁹² Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6741-6742.

(i) Hetimet në fermën *Ekonomija*

378. Në fermë, në fund të kanalit për kullimin e ujërave të zeza, ata gjetën një kufomë mashkulli me rroba civile, e shënuan me numrin RE-1, e fotografuan dhe e çuan në hotelin Pashtrik.¹³⁹³ Në fermë, brenda në stallën e bagëtive ekspertët gjithashtu gjetën shtatë kablllo elektrike të lidhura në një shufër metalike. Kabllot ishin të lidhura në formë laku në “nyje të mpleksura” ose në formë të “litarit të velit katror” (p.sh. lavare), tepër të shkurtër për t’u vënë rreth qafës së kafshëve, por duke marrë parasysh se kabllot elektrike mund t’u shkaktojnë plagë kafshëve, ekipi konkludoi se ato ishin përdorur për të lidhur njerëz, me gjasë prej qafe.¹³⁹⁴ Kabllo të ngjashme u gjetën në disa prej kufomave të gjetura në kanalën e liqenit të Radoniqit ose në afërsi të tyre.¹³⁹⁵

379. Më 23 shtator 1998, gjatë pastrimit dhe sigurimit të zonës së liqenit të Radoniqit dhe fermës *Ekonomija* para vizitës së Presidentit të atëhershëm të Serbisë, Millan Millutinoviçit, rreth 100 apo 200 metra larg fermës *Ekonomija*, policët e MPB-së gjetën edhe pesë kufoma të tjera.¹³⁹⁶ Kufomat e gjetura në afërsi të fermës *Ekonomija* u shënuan me numrat RE-2 deri në RE-7; më vonë u vërtetua se pjesët e kufomave të shënuara me numrat RE-5 dhe RE-7 i përkisnin të njëjtit person.¹³⁹⁷ Kufomat u çuan në hotelin Pashtrik. Më 24 shtator 1998, ekspertët e ekipit mjekoligjor të Beogradit shkuan në vendin ku ishin gjetur kufomat dhe më pas kryen autopsitë në hotelin Pashtrik.¹³⁹⁸ “Autopsitë dhe ekzaminimi mjekoligjor i pesë kufomave” përfunduan më 27 shtator 1998.¹³⁹⁹ Në fermë u gjetën kufomat e gjithësej gjashtë personave.

¹³⁹³ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6741; Prova materiale P436, f. 1 (f. 12 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 36, 39, 57; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 57, 62.

¹³⁹⁴ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6742-6743, 6749-6750, 9578-9579; Prova materiale P436, f. 1 (f. 12 në dokumentacionin gjyqësor elektronik); Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 55, 57; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 59.

¹³⁹⁵ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 57; Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6742-6743, 6749-6750.

¹³⁹⁶ Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 181; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6670-6671; Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 147-148. Dushan Dunjiq dëshmoi se pjesën e kufomës të shënuar me “RE-7” e gjeti kur shkoi në fermë më 26 shtator 1998. Më vonë u vërtetua se pjesët e kufomës të shënuara me “RE-5” dhe “RE-7” i takonin një individ të vetëm, Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 159-160.

¹³⁹⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 158-160, 613. *Shih* gjithashtu Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 40.

¹³⁹⁸ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 149-158; Prova materiale P477; Nebojsa Avramoviç, Prova materiale P451, para. 182.

¹³⁹⁹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 163-164; Prova materiale P477, f. 3.

(ii) Kufomat në fermën *Ekonomija* dhe identifikimi i tyre i mëpasshëm

380. Ekipi mjekoligjor i Beogradit nuk identifikoi asnjë nga gjashtë kufomat e gjetura në fermën *Ekonomija*.¹⁴⁰⁰ Mirëpo, më vonë tre prej tyre u identifikuan përmes analizës së ADN-së.

¹⁴⁰⁰ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 609, 634, 649, 660, 672, 682.

a. Mehmet Rustemaj

381. Dushan Dunjiqi dëshmoi se kishte parë raportin e KNPZH-së të analizës së ADN-së sipas të cilit kufoma e shënuar me numrin RE-1 ishte identifikuar se ishte e Mehmet Rustemajt.¹⁴⁰¹ Dhoma konkudon se kufoma e Mehmet Rustemajt u gjet në fermë.

382. Kufoma e shënuar me numrin RE-1 u gjet më 11 shtator 1998 në një “hendek të ngushtë prej betoni që përdorej për kullimin e ujërave të zeza nga stallat”.¹⁴⁰² Autopsia konstatoi “thyerje të shumta në brinjë nga të dy anët e kafazit të kraharorit, të cilat për nga karakteristikat e tyre me gjasë ishin shkaktuar nga goditje të njëpasnjëshme me mjet jo të mprehtë”.¹⁴⁰³ Gjithashtu, “në eshtrën murore të majtë, në pjesën ku ajo bashkohet me eshtrën ballore dhe me krahun e madh të eshtrës sfenoide, kishte një dëmtim me formë të parregullt ovale, i cili në pamje të parë dukej si trajektorja e depërtimit të një plumbi të shtënë nga armë e vogël”.¹⁴⁰⁴ Gjithashtu, “dëmtimi i tërthortë në eshtrën murore të djathtë kishte tehe të sheshta (pa kënde) dhe anë që përkojnë me dëmtim të shkaktuar nga goditje me mjet të mprehtë”.¹⁴⁰⁵ Së fundi, kufoma ishte “në fazë shumë të avancuar shpërbërjeje dhe rrjedhimisht ishte e pamundur të përcaktohej shkaku i vdekjes vetëm nga autopsia”.¹⁴⁰⁶ U vlerësua se viktima kishte vdekur dikur në korrik ose gusht të vitit 1998.¹⁴⁰⁷ Dhoma nuk mori prova të tjera lidhur me Mehmet Rustemajn.

383. Dhoma vëren se në Aktakuzë, Mehmet Rustemaj nuk përmendet si viktimë. Dhoma konkludon se ka të ngjarë që Mehmet Rustemaj të jetë vararë. Mirëpo, provat e lartpërmendura nuk vërtetuan as rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së tij, as implikimin e UÇK-së e as identitetin e autorëve konkretë të vrasjes.

b. Tushe Tahiraj dhe Ramiz Tahiraj

384. Provat tregojnë se analiza e ADN-së e kryer prej KNPZH-së identifikoi kufomat e shënuara me numrat RE-2 dhe RE-3 se ishin të Tushe Tahirajt dhe Ramiz Tahirajt.¹⁴⁰⁸ Dhoma konkludon se kufomat e Tushe Tahirajt dhe Ramiz Tahirajt u gjetën në fermë.

¹⁴⁰¹ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 610.

¹⁴⁰² Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 601.

¹⁴⁰³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 606.

¹⁴⁰⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 607.

¹⁴⁰⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 607.

¹⁴⁰⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 605.

¹⁴⁰⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 604.

¹⁴⁰⁸ Prova materiale P428.

385. Nebojsa Avramović u pyet nga Mbrojtja lidhur me deklaratën e Blerim Tahirajt, djali i “Tushe dhe Ramiz Tahirajt”, dhënë Prokurorisë. Në deklaratën e tij, Blerim Tahiraj theksoi se më 6 shtator 1998, prindërit e tij u nisën nga Skivjani i komunës së Gjakovës në drejtim të Pozharit të komunës së Deçanit përmes rrugës që kalonte nëpër “Novosellë” dhe se një apo dy javë më vonë, një polic serb i larguar nga puna me emrin “Moma Derllović apo Drelloviq” i kishte thënë vëllait të Blerim Tahirajt se prindërit e tyre ndodheshin në burg.¹⁴⁰⁹ Nebojsa Avramović dëshmoi se njihje një polic të larguar nga puna me emrin “Momo Dërleviq” i cili përpara largimit nga puna kishte punuar me Nebojsa Avramovićin në të njëjtën ndërtesë në Gjakovë.¹⁴¹⁰ Po në këtë deklaratë, Blerim Tahiraj theksoi se kishte dëgjuar “thashetheme se me 6 shtator 1998, në Novosellë serbët kishin kapur njerëz” dhe se më 7 shtator 1998, rrugës për në Pozhar “disa njerëz” i kishin thënë se “me 6 shtator 1998, policia dhe paraushtarakët kapën disa njerëz”.¹⁴¹¹

386. Më 23 shtator 1998, “në zabelin afër fermës”, policia serbe gjeti kufomat e Tushe Tahirajt dhe Ramiz Tahirajt afër njëra-tjetrës.¹⁴¹² Autopsia e kufomës me numër RE-2 konstatoi “çarje të lëkurës në pjesën midis shpatullave”, që ishte një “vrimë hyrjeje e shkaktuar nga një e shtënë me armë zjarri”, dhe “dëmtime të indit të butë në pjesën e çerekut të poshtëm të parakrahut të majtë”, që tregojnë një “plagë të kalbëzuar hyrje-dalje të shkaktuar nga e shtënë me armë zjarri”.¹⁴¹³ Ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se në qoftë se plaga është “shkaktuar para vdekjes, kjo tregon se vdekja ka qenë e dhunshme dhe pasojë e drejtpërdrejtë e plagëve të shkaktuara nga të shtëna me armë zjarri”.¹⁴¹⁴ Autopsia e kufomës së shënuar me numrin RE-3 “konstatoi një plagë në kafkë të shkaktuar nga të shtëna me armë zjarri”; “një plagë në gjysmën e djathtë të kafazit të kraharorit dhe në bark, e shkaktuar nga një e shtënë me armë zjarri”; dhe “një plagë në kofshën e majtë e shkaktuar nga armë zjarri”.¹⁴¹⁵ Ekipi mjekoligjor i Beogradit konkludoi se “në qoftë se plagët në kokë dhe në trup janë shkaktuar para vdekjes, atëherë ato janë dhe shkaku i drejtpërdrejtë i vdekjes”.¹⁴¹⁶ Për të dy personat u vlerësua se kishin vdekur dikur në korrik ose gusht 1998.¹⁴¹⁷

387. Dhoma vëren se në Aktakuzë, Tushe Tahiraj dhe Ramiz Tahiraj nuk përmenden si viktimat. Dhoma konkludon se ka të ngjarë që Tushe Tahiraj dhe Ramiz Tahiraj të jenë vlarë. Mirëpo, provat

¹⁴⁰⁹ Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6671-6672.

¹⁴¹⁰ Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6672-6673.

¹⁴¹¹ Nebojsa Avramović, Prova materiale P449 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6673.

¹⁴¹² Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 612-613, 623.

¹⁴¹³ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 619-620.

¹⁴¹⁴ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 621.

¹⁴¹⁵ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 629-631.

¹⁴¹⁶ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 632.

¹⁴¹⁷ Dushan Dunjiq, Prova materiale P471, para. 616-617, 626-627.

e lartpërmendura nuk vërtetuan as rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së tyre, as implikimin e UÇK-së e as identitetin e autorëve konkretë të vrasjes.

V. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË NENIT 3 TË STATUTIT

A. Ligji

388. Aktakuza i akuzon të Akuzuarit në gjashtë pika për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit të Tribunalit i cili i akordon Tribunalit kompetencë për procedimin penal të individëve që shkelin ligjet ose zakonet e luftës. Jurisprudenca ka përcaktuar edhe kushte të tjera për t'u plotësuar që Tribunali të ketë juridiksion penal mbi shkeljet brenda kuadrit të këtij neni. Më poshtë diskutohen kushtet juridiksionale dhe elementët e përgjithshëm të krimit në bazë të Nenit 3 të Statutit.

1. Kushtet Tadiq

389. Në jurisprudencën e Tribunalit është konkluduar se Neni 3 i Statutit është “klauzolë mbetëse” që i akordon Tribunalit juridiksion për të gjitha shkeljet e rënda të së drejtës humanitare jashtë kuadrit të Nenit 2, 4, ose 5 të Statutit.¹⁴¹⁸ Jurisprudenca vazhdimisht ka përcaktuar se, që Tribunali të ketë juridiksion mbi një krim të akuzuar në bazë të Nenit 3 të Statutit, duhen përmbushur katër kushte: (1) shkelja duhet të përbëjë thyerje të një rregulle të së drejtës humanitare ndërkombëtare; (2) rregulla duhet të jetë zakonore në përmbajtje, ose, në qoftë se i përket të drejtës së traktateve, duhet të plotësohen kushtet e kërkuara; (3) shkelja duhet të jetë e rëndë, domethënë, ajo duhet të jetë shkelje e një prej rregullave që mbrojnë vlera të rëndësishme dhe duhet të shkaktojë pasoja të rënda për viktimat; dhe (4) shkelja e rregullës duhet të rezultojë sipas të drejtës zakonore ose konvencionale në përgjegjësinë penale individuale të shkelësit të rregullës.¹⁴¹⁹

390. Në këtë çështje, akuzat për vrasje, trajtim mizor dhe torturim bazohen në Nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës. Tashmë ekziston jurisprudencë e provuar e Tribunalit se shkeljet e Nenit të Përbashkët 3 janë brenda juridiksionit të Nenit 3 të Statutit.¹⁴²⁰ Konkretisht, rregullat e Nenit të Përbashkët 3 janë pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare që vlejnë si në konflikt të armatosur ndërkombëtar, po ashtu edhe jondërkombëtar.¹⁴²¹ Vrasja, torturimi dhe trajtimi mizor që figurojnë në Nenin e Përbashkët 3 janë shkelje të rregullave që mbrojnë vlera të rëndësishme dhe shkaktojnë pasoja të rënda për viktimat. Shkelja e rregullave të Nenit të

¹⁴¹⁸ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para 89, 91-92; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 125; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 68.

¹⁴¹⁹ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para. 94; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 66.

¹⁴²⁰ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para. 89; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 133-134, 136; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 68.

¹⁴²¹ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para 89, 98; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 138-139, 147.

Përbashkët 3 gjithashtu rezulton në përgjegjësinë penale individuale të shkelësit të rregullës.¹⁴²²
Rrjedhimisht shkelje të tilla të Nenit të Përbashkët 3 janë brenda juridiksionit të Tribunalit.

2. Kriteret paraprake të Nenit 3

391. Pas përmbushjes së kushtit të juridiksionit, duhen përmbushur edhe disa kushte të përgjithshme para se Neni 3 i Statutit të jetë i zbatueshëm. Së pari, gjatë periudhës që mbulon Aktakuza duhet të ketë ekzistuar konflikt i armatosur, qoftë ndërkombëtar apo i brendshëm, së dyti veprimet e të Akuzuarit duhet të jenë lidhur ngushtësisht me konfliktin e armatosur, me fjalë të tjera duhet të ekzistojë një lidhje;¹⁴²³ dhe së treti, në kohën e kryerjes së krimeve viktime nuk duhet të ketë marrë pjesë në luftime në atë kohë.¹⁴²⁴

(a) Konflikti i armatosur

392. Kushti për ekzistencën e konfliktit të armatosur u shtjellua nga Dhoma e Apelit në Vendimin e Juridiksionit *Tadiq* si më poshtë:

Konflikt i armatosur ekziston sa herë që përdoret forca e armatosur midis shteteve ose dhunë e armatosur e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti.¹⁴²⁵

Ky kusht është zbatuar vazhdimisht në jurisprudencën e mëvonshme.¹⁴²⁶ Prej këtij kushti burojnë dy kritere për t'u shqyrtuar, së pari ashpërsia e konfliktit dhe së dyti organizimi i palëve në konflikt.¹⁴²⁷ Këto kritere janë qartësuar më tej prej jurisprudencës.¹⁴²⁸

393. Jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar se një konflikt i armatosur është jondërkombëtar vetëm kur ka dhunë të zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të

¹⁴²² Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para 128-129; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 153-156, 160, 162-164, 167, 170.

¹⁴²³ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para 67, 69-70; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 55; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342.

¹⁴²⁴ Neni i Përbashkët 3 (1); Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 420.

¹⁴²⁵ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para. 70. *Shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 56; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 336.

¹⁴²⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 56; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 336; Aktgjykimi *Tadiq*, para. 561; Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 183; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 51; Aktgjykimi *Naletiliq*, para. 225; Aktgjykimi *Limaj*, para. 84; Aktgjykimi *Haradinaj*, para. 37; Aktgjykimi *Deliq*, para. 40; Aktgjykimi *Millutinoviq*, Vëllimi I, para. 125; Aktgjykimi *Boshkoski*, para. 175; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1522.

¹⁴²⁷ Aktgjykimi *Tadiq*, para. 562; Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 183; Aktgjykimi *Limaj*, para. 84; Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 407.

¹⁴²⁸ *Shih* për shembull Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1522-1526 me referenca të mëtejshme.

organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti.¹⁴²⁹ Megjithëse një grup i armatosur duhet të ketë “një farë organizimi,” nuk është e domosdoshme që palët ndërluftuese të jenë po aq të organizuara sa dhe forcat e armatosura të një shteti.¹⁴³⁰ Së paku, udhëheqja e grupit duhet të ketë aftësinë për të ushtruar një farë kontrolli ndaj anëtarëve të grupit në mënyrë që të mund të përmbushen detyrimet themelore të Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës.¹⁴³¹ Elementët faktikë të lartpërmendur duhen vërtetuar në bazë të rrethanave të çështjes.¹⁴³²

394. Faktorët që merren parasysh në vlerësimin e ashpërsisë së konfliktit ndër të tjerë janë ashpërsia e sulmeve dhe fakti nëse ka patur shtim të numrit të përleshjeve të armatosura; përhapja e përleshjeve anembanë territorit dhe gjatë një periudhe të caktuar kohore, rritja e mundshme e numrit të forcave qeveritare dhe mobilizimi dhe shpërndarja e armëve midis dy palëve të përfshira në konflikt; angazhimi i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara; numri i civilëve të detyruar të largohen nga zonat e luftimeve; llojet e armëve të përdorura, veçanërisht armët e rënda dhe pajisje të tjera ushtarake, si tanke dhe automjete të tjera të rënda; bllokimi ose rrethimi i qyteteve dhe granatimi i rëndë i tyre; masa e shkatërrimit dhe numri i të vdekurve dhe plagosurve nga granatimet ose luftimet; numri i efektivave dhe njësisive të dislokuara; ekzistenca dhe ndryshimi i vijës së frontit midis palëve; pushtimi i territorit, qyteteve dhe fshatrave; dislokimi i forcave qeveritare në zonën e krizës; mbyllja e rrugëve; urdhra për armëpushim dhe marrëveshje; përpjekje të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare për arritjen dhe zbatimin e marrëveshjeve të armëpushimit; dhe ashpërsia e dhunës, përfshirë edhe kohëzgjatjen e saj që ka çuar në angazhimin e forcave të armatosura dhe në numër të madh të vrarësh dhe të plagosurish dhe masa e shkatërrimit fizik.¹⁴³³

395. Faktorët që merren parasysh në vlerësimin e organizimit të një grupi të armatosur ndahen në pesë kategori të mëdha. Ka faktorë që tregojnë ekzistencën e strukturës komanduese; faktorë që tregojnë se grupi i armatosur është në gjendje të ndërmarrë operacione në mënyrë të organizuar;

¹⁴²⁹ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para. 70.

¹⁴³⁰ Aktgjykimi *Boshkoski*, para 196-198; Aktgjykimi *Limaj*, para. 89; Aktgjykimi *Oriq*, para. 254; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1525.

¹⁴³¹ Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1525; Aktgjykimi *Boshkoski*, para. 196, citohet Shpjeguesi i KNKK-së për Konventën II të Gjenevës, f. 34 (theksohet se moszbatimi i Nenit të Përbashkët 3 prej një grupi joshtetëror, “u jep të drejtë atyre që i konsiderojnë veprimet e këtij grupi si akte thjesht anarkiste dhe banditizmi”). *Shih edhe* KNKK, “International Humanitarian Law and the Challenges of Contemporary Armed Conflicts”/E drejta ndërkombëtare dhe sfidat e konflikteve të armatosura bashkëkohore, Report prepared by the International Committee of the Red Cross, 28th International Conference of the Red Cross and Red Crescent, Geneva, 2 to 6 December 2003, at p. 19/Raport i përgatitur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Konferenca e 28-të Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në f.19 (përmenden “forca ose grupe të armatosura me njëfarë niveli organizmi, strukturë komanduese dhe rrjedhimisht të afta për zbatimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare”).

¹⁴³² Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1522.

¹⁴³³ Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1523 citohen aktgjykime të ndryshme të Tribunalit.

faktorë që tregojnë një farë niveli logjistik; faktorë që kanë të bëjnë me nivelin e disiplinës së grupit të armatosur dhe aftësisë së grupit për përmbushjen e detyrimeve themelore të Nenit të Përbashkët 3; dhe faktorë që provojnë unitetin e grupit.¹⁴³⁴

396. Konsiderohet se konflikti i armatosur ka shtrirje anembanë territorit të shteteve ndërluftuese ose në rast të një konflikti jondërkombëtar, anembanë territorit të kontrolluar prej një pale, pavarësisht nëse luftimet zhvillohen apo nuk zhvillohen atje.¹⁴³⁵ Konflikti i armatosur ndërkombëtar mbaron me arritjen e paqes së përgjithshme dhe konflikti jondërkombëtar përfundon me arritjen e një zgjidhjeje paqësore.¹⁴³⁶

(b) Lidhja

397. Në përmbushjen e kushtit të lidhjes, Prokuroria duhet të provojë ekzistencën e një lidhjeje të mjaftueshme midis sjelljes së pretenduar të të Akuzuarit dhe konfliktit të armatosur.¹⁴³⁷ Nuk është e nevojshme që krimi i pretenduar të jetë kryer në kohën dhe vendin ku është zhvilluar luftimi. Kushti i lidhjes përdoret për të bërë dallimin midis krimeve të luftës nga krimet e brendshme dhe për të shmangur cilësimin e krimeve të rastësishme ose sporadike si krime lufte.¹⁴³⁸ Nuk është e nevojshme ekzistenca e lidhjes shkakësore midis konfliktit të armatosur dhe krimin.¹⁴³⁹ Sidoqoftë, konflikti i armatosur duhet të ketë luajtur rol thelbësor në aftësinë e keqbërësit për kryerjen e krimin, në vendimin për kryerjen, në mënyrën e kryerjes ose qëllimin për të cilin u krye.¹⁴⁴⁰ Në përcaktimin e ekzistencës së lidhjes së mjaftueshme midis konfliktit të armatosur dhe krimin, mund të merren parasysh kriteret e mëposhtme: a ishte keqbërësi pjesëmarrës në luftime; a ishte viktima jopjesëmarrës në luftime apo pjesëtar i palës kundërshtare; a mund të konsiderohet se veprimi çoi në realizimin e synimit përfundimtar të operacionit ushtarak; dhe a ishte krimi i kryer nga keqbërësi pjesë e detyrave të tij zyrtare apo në kuadër të tyre.¹⁴⁴¹

¹⁴³⁴ Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1526 citohen aktgjykime të ndryshme të Tribunalit.

¹⁴³⁵ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para. 70; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para 57, 64.

¹⁴³⁶ Vendimi *Tadiq* mbi Juridiksionin, para. 70; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 57.

¹⁴³⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 57; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342.

¹⁴³⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 58.

¹⁴³⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 58; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342. *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Bagosora*, para 405-406, në të cilin Dhoma e Apelit konkludon se faktorët e shqyrtuar nga Dhoma Gjyqësore që tregonin se krimet ishin kryer për realizimin ose nën ombrellën e konfliktit të armatosur, ishin të mjaftueshëm për nxjerrjen e përfundimit se veprimet e keqbërësve ishin ngushtësisht të lidhura me konfliktin e armatosur.

¹⁴⁴⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 58; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342.

¹⁴⁴¹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 59.

(c) Statusi i viktimave

398. Së fundi, që Neni 3 i Statutit të jetë i zbatueshëm (bazuar në një shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës), lipset që viktima të mos ketë marrë pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së krimeve.¹⁴⁴² Jurisprudenca e Tribunalit e ka përkufizuar pjesëmarrjen në luftime si pjesëmarrje në veprime që natyrshëm synojnë ose kanë për qëllim që t'u shkaktojnë dëm efektivave ose pajisjeve të forcave të armatosura kundërshtarë.¹⁴⁴³ Neni i Përbashkët 3 vlen edhe për viktimat që janë anëtarë të forcave të armatosura të cilët kanë dorëzuar armët ose janë jashtë luftimit për shembull për shkak të sëmundjes, plagëve ose zënies rob.¹⁴⁴⁴ Përcaktimi i statusit duhet të bëhet rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat e viktimës konkrete në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar.¹⁴⁴⁵ Gjithashtu autori i një krimi brenda kuadrit të Nenit të Përbashkët 3 duhet të dijë ose të ketë ditur se viktimat nuk merrnin pjesë në luftime në kohën e kryerjes së krimit.¹⁴⁴⁶

B. Përfundime1. Kushtet Tadiq

399. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma bindet se kushtet *Tadiq* janë përmbushur.¹⁴⁴⁷

2. Ekzistenca e konfliktit të armatosur

400. Palët kanë rënë dakord se “gjatë gjithë periudhës që ka lidhje me Aktakuzën duke filluar nga 22 prilli 1998 e më tej, në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur”, midis (1) forcave të armatosura të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë që përbëheshin prej forcave të UJ-së dhe MPB-së, ku përfshiheshin PJP, JSO dhe SAJ (“forcat serbe”) dhe (2) UÇK-së.¹⁴⁴⁸ Mirëpo, në Aktakuzë pretendohet se gjendja e konfliktit të armatosur në Kosovë ekzistoi gjatë periudhës 1 mars - 30

¹⁴⁴² Neni i Përbashkët 3(1); Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 420, 424; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para 172, 178; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski*, para. 66.

¹⁴⁴³ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 178.

¹⁴⁴⁴ Neni i Përbashkët 3(1); Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 175.

¹⁴⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 178.

¹⁴⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski*, para. 66.

¹⁴⁴⁷ *Shih* më sipër, para. 390.

¹⁴⁴⁸ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim i Përbashkët i Prokurorisë dhe Mbrojtjes mbi Ekzistencën e një Konflikti të Armatosur në Kosovë me Shtojcën A, 19 nëntor 2010. Në parashtrim, “MUP” përkufizohet “Ministria e Punëve të Brendshme”.

shtator 1998.¹⁴⁴⁹ Për këtë arsye, Dhoma do të shqyrtojë provat për të nxjerrë përfundimin nëse ka ekzistuar konflikt i armatosur para 22 prillit 1998. Gjatë analizimit të provave Dhoma do të përqendrohet në (1) ashpërsinë e konfliktit midis forcave serbe dhe UÇK-së në Kosovë dhe (2) nivelin e organizimit të UÇK-së nga 1 marsi deri më 21 prill 1998.

401. Në lidhje me këtë çështje, provat që kanë të bëjnë me faktorët e marrë parasysh gjatë përcaktimit të ekzistencës ose mosegzistencës së konfliktit të armatosur gjatë periudhës 1 mars – 21 prill 1998, janë të kufizuara. Në këtë aspekt, Dhoma konstaton se palët nuk e trajtojnë veçazi këtë periudhë në Dosjet e tyre Gjyqësore Përfundimtare.

(a) Ashpërsia e konfliktit

402. Sikundër është diskutuar në Aktgjykim, Dhoma mori prova se dislokimi i 8.000 – 10.000 efektivave të MPB-së në Kosovë në mars 1998 si dhe i forcave të posaçme të ndërhyrjes si JSO dhe SAJ ishte “vlerësim i matur”,¹⁴⁵⁰ dhe se Brigada e Motorizuar 125 e UJ-së e cila mbulonte zona në një sërë komunash, ndër të cilat Klina, Istogu, Peja dhe Deçani, kishte 1.400 pjesëtarë në janar 1998 dhe 1.880 nga fundi i vitit.¹⁴⁵¹ Gjithashtu ndër provat është edhe një telegram diplomatik britanik me datë 24 mars 1998 që evidenton “prani të ndjeshme të policisë speciale (efektiva (100-200), autobllinda, postbllloqe)” në zonën e Drenicës dhe pozicionet e tyre “ende duke u përforcuar”.¹⁴⁵²

403. Dhoma mori prova se Brigada e Motorizuar 125 nuk u sulmua nga UÇK-ja në pjesën e parë të vitit 1998 dhe “sulmi i parë” ndodhi më 23 maj 1998 në “rrugën Gjakovë-Ponoshec-Morinë”, në komunën e Gjakovës.¹⁴⁵³ Mirëpo, meqenëse “grupe të organizuara të shqiptarëve kosovarë të armatosur” po sulmonin patrulla të MPB-së,¹⁴⁵⁴ në prill 1998 u ngrit një postëkomandë pararojë e Brigadës së Motorizuar 125 me rreth 400 pjesëtarë (nuk jepet datë) në Pejë.¹⁴⁵⁵ Grupi i luftimit 2¹⁴⁵⁶ i Brigadës së Motorizuar 125, i cili kishte 10 tanke ndër të cilët tre ishin në gatishmëri

¹⁴⁴⁹ Aktakuzë, para. 13-14. Pretendohet se konflikti i armatosur ishte midis UÇK-së dhe “forcave serbe”, që përcaktohet se ishin forcat e RFJ-së dhe të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë, Aktakuzë, para. 14.

¹⁴⁵⁰ *Shih* më sipër, para. 134.

¹⁴⁵¹ *Shih* më sipër, para. 126.

¹⁴⁵² Prova materiale D1, para. 3.

¹⁴⁵³ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 34.

¹⁴⁵⁴ Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se MPB-ja kishte detyrë që të kontrollonte rrugën në Kosovë-Metohinë perëndimore dhe njësitë e MPB-së në rrugën Pejë-Deçan-Gjakovë “sulmoheshin vazhdimisht nga UÇK-ja”. Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 16. *Shih* më sipër, para. 138.

¹⁴⁵⁵ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 18. *Shih* gjithashtu më sipër, para 126, 138.

¹⁴⁵⁶ Grupi i luftimit 1 i Brigadës së Motorizuar 125 u formua në fillim të prillit 1998 me një efektiv prej rreth 220 vetësh, ndër të cilët 12 oficerë, 12 nënoficerë dhe rreth 190 ushtarë. Ishte më i

luftarake, u formua në prill 1998 për të ndihmuar MPB-në në mbajtjen e rrugëve nën kontroll.¹⁴⁵⁷ Lidhur me rrugën Prishtinë-Gjakovë-Pejë, Dëshmitari 28 dëshmoi se në mars 1998 “kushtet” ishin “normale” megjithëse UÇK-ja ndërmori sulme ndaj fshatrave në lindje të rrugës, dhe Dëshmitari 28 tha se në prill 1998 ai filloi të shihte “postblloqe policore të përkohshme” në rrugë.¹⁴⁵⁸

404. Më herët në Aktgjykim, Dhoma shqyrtoi provat për granatimin e fshatrave të zonës së Dukagjinit prej forcave serbe nga fundi i marsit 1998,¹⁴⁵⁹ të shtënat me armë automatike nga Shqipëria prej një ‘grupi të armatosur shqiptarësh kosovarë’ kundër pikës kufitare Mitar Voinoviq më 25 mars 1998,¹⁴⁶⁰ luftime të ashpra në përfundim të rrugës kryesore Pejë-Deçan afër kufirit nga marsi deri në shtator 1998;¹⁴⁶¹ dhe sulme thuajse të përditshme të UÇK-së kundër stacioneve policor në Çallapek dhe Kliçinë, të dy në komunën e Pejës, dhe një në Irzniq në komunën e Deçanit që prej 2 marsit 1998.¹⁴⁶² Më 5 mars 1998 forcat serbe ndërmorën një sulm kundër familjes Jashari dhe sikundër është përmendur më herë në Aktgjykim më 24 mars 1998 u zhvillua një betejë midis forcave serbe dhe UÇK-së në territorin e shtëpive të familjes Haradinaj.¹⁴⁶³ Sikurse është shpjeguar, ky incident dhe incidente të tjera shërbyen si motivim për shumë njerëz që t’i bashkoheshin UÇK-së dhe pas këtyre incidenteve njerëzit në fshatra filluan me organizimin e vetëmbrojtjes.¹⁴⁶⁴

405. Krahas provave të lartpërmendura ka edhe telegrame ku përfshihen edhe komentet e atasheut ushtarak britanik i cili ishte i pranishëm në Kosovë.¹⁴⁶⁵ Një telegram diplomatik britanik me datë 24 mars 1998 përmend “incidente dhe kërcënime të herëpashershme në postblloqet policore [serbe] si dhe kërcënime nga shqiptarë të armatosur”, mirëpo nuk duket se ka “pengesa zyrtare sistematike”.¹⁴⁶⁶ Në një telegram me datë 7 prill 1998 gjendja e sigurisë në Kosovë përshkruhet “e qetë, pavarësisht nga lëvizjet e mëdha të policisë”,¹⁴⁶⁷ dhe një telegram i mëtejshëm me datë 8 prill

madh se një kompani, mirëpo më i vogël se një batalion, Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 15.

¹⁴⁵⁷ Dragan Zhivanoviq, Prova materiale P112, para. 16. *Shih* gjithashtu më sipër, para 126, 138.

¹⁴⁵⁸ Dëshmitari 28, Prova materiale P358, para. 56. *Shih* gjithashtu më sipër, para. 141.

¹⁴⁵⁹ *Shih* më sipër, para. 128.

¹⁴⁶⁰ *Shih* më sipër, para. 150.

¹⁴⁶¹ *Shih* më sipër, para. 132.

¹⁴⁶² *Shih* më sipër, para. 159.

¹⁴⁶³ *Shih më sipër*, para 143-146.

¹⁴⁶⁴ *Shih* më sipër, para. 149.

¹⁴⁶⁵ John Crosland, Prova materiale P8 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 2984-2985.

¹⁴⁶⁶ Prova materiale D1, para. 5. Duket se telegrami u dërgua para se të mësohej për incidentin në territorin e shtëpive të familjes Haradinaj më 24 mars 1998. Është edhe një telegram tjetër i mëpasshëm gjithashtu me datë 24 mars 1998 që bën fjalë për këtë incident, Prova materiale D33.

¹⁴⁶⁷ Prova materiale D34, para 1, 6.

1998 sërish e cilëson “gjendjen e sigurisë të qetë”.¹⁴⁶⁸ Në telegramin me datë 9 prill 1998 bëhet e ditur se PJP-ja u tërhoq nga “postbolloqet në Drenicë” dhe se kishin ndodhur “disa incidente të vogla në Drenicë dhe Deçan” pa “viktima të raportuara”,¹⁴⁶⁹ kurse në telegramin e datës 15 prill 1998 lexohet “nuk ka raporte për incidente të tjera që vlejné të përmenden, megjithëse shqiptarët [kosovarë] raportojnë për keqtrajtim të vazhdueshëm prej sigurimit dhe ka të dhëna të vazhdueshme për të shtëna me armë zjarri në fshatra”.¹⁴⁷⁰ Së fundi, një telegram me datë 16 prill 1998 bën të ditur se “veç disa incidenteve relativisht të vogla, gjendja është e qetë” dhe se “në postbolloqe vazhdon të jetë e pranishme policia e rregullt (MPB), jo forcat speciale (PJP)”.¹⁴⁷¹

(b) Organizimi i UÇK-së

406. Në pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi, Dhoma analizoi daljen e UÇK-së dhe strukturën e saj të përgjithshme dhe strukturën në zonën e Dukagjinit. Gjatë kësaj analize Dhoma iu referua provave se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk kishte një vendqëndrim të vetëm të përhershëm më 1998; jo çdokush njihnte gjithkënd tjetër; dhe jo të gjithë komunikonin me njëri-tjetrin.¹⁴⁷² Provat mbi madhësinë numerike të UÇK-së, financimin e saj, uniformat, armët, rekrutimin, stërvitjen dhe pajisjen gjatë periudhës përkatëse, janë të kufizuara.¹⁴⁷³

407. Në lidhje me çfarë ndodhi në terren, sikurse është përmendur më parë në Aktgjykim kishte prova që tregonin se njerëzit filluan vetorganizimin në grupe të vogla në fshatrat e tyre pasi zona e Dukagjinit filloi të granatohej, pas sulmit kundër vendbanimit të familjes Haradinaj më 24 mars 1998.¹⁴⁷⁴ Të gjithë këto grupe njerëzish nëpër fshatra, organizimi i mbrojtjes së fshatrave ose rojet në fshatra nuk u organizuan në mënyrë të centralizuar, por me nismën e fshatarëve.¹⁴⁷⁵ Sa i përket gjetjes së armëve, Dhoma ka konstatuar se njerëzit në grupe të vogla dërgoheshin në Gllogjan dhe më pas në Shqipëri për marrjen e armëve.¹⁴⁷⁶ Për më tepër në lidhje me UÇK-në në zonën e

¹⁴⁶⁸ Prova materiale, para. 1.

¹⁴⁶⁹ Prova materiale D3, para. 2. Dhoma thekson se titulli i lëndës është “9 mars”. Mirëpo, duke marrë parasysh përmbajtjen në përgjithësi, gjykon se është vetëm gabim shtypi dhe duhej të ishte “9 prill”.

¹⁴⁷⁰ Prova materiale D35, para. 2. Gjithashtu telegrami përshkruan një sulm kundër një stacioni policor më 13 prill 1998, ku një polic u plagos dhe ndërtesa pësoi dëmtime të ndjeshme, Prova materiale D35, para. 2.

¹⁴⁷¹ Prova materiale D4, para 1-2.

¹⁴⁷² *Shih* më sipër, para 18, 20.

¹⁴⁷³ *Shih* më sipër, para 18-25, 29-40.

¹⁴⁷⁴ *Shih* më sipër, para. 44.

¹⁴⁷⁵ *Shih* më sipër, para. 45.

¹⁴⁷⁶ *Shih* më sipër, para. 46.

Dukagjinit, Dhoma bëri të ditur se gjatë periudhës së Aktakuzës, UÇK-ja ishte një organizatë në zhvillim e sipër.¹⁴⁷⁷

408. Në lidhje me kontrollin territorial dhe sikurse është përmendur, provat sugjerojnë se forcat serbe kontrollonin qytetet e mëdha dhe rrugët kryesore, kurse UÇK-ja, kontrollonte fshatrat dhe rrugët dytësore.¹⁴⁷⁸ Lidhur me provat mbi postbllloqet e UÇK-së, Branko Gajiqi dëshmoi se “u shtua numri dhe prania e postbllloqeve të UÇK-së” pas incidentit më 5 mars 1998 në vendbanimin e familjes Jashari.¹⁴⁷⁹ Dëshmitari 69 dëshmoi se në fillim të pranverës 1998, UÇK-ja ngriti pika kontrolli dhe postbllloqe¹⁴⁸⁰ dhe Nebojsa Avramoviqi dëshmoi se postbllloqet e UÇK-së ndodheshin në rrugët dytësore në të dy anët e rrugës Pejë-Deçan-Gjakovë, pa saktësuar se në çfarë periudhe.¹⁴⁸¹ Shemsedin Çekaj dëshmoi se kur rreth 20 prillit 1998, ai udhëtoi nga Peja në Irzniq, nuk shkoi në rrugën kryesore sepse kishte frikë nga postbllloqet serbe, por nëpërmjet Lubeniqit, Strellcit të Poshtëm, Pozhares dhe Kodralisë.¹⁴⁸² Në disa prej fshatrave, Shemsedin Çekaj hasi në postbllloqe të UÇK-së ku kishte të rinj, disa prej të cilëve mbanin uniforma të UÇK-së.¹⁴⁸³

409. Dhoma dëgjoi dëshmi se në zonën e Dukagjinit ndihej nevoja e organizimit të mbrojtjes së fshatrave dhe se në një mbledhje më 26 maj 1998 u mbajtën diskutime mbi nevojën e një komande më të njësuar të zonës së Dukagjinit.¹⁴⁸⁴ Data e kësaj mbledhjeje është jashtë periudhës përkatëse 1 mars – 21 prill 1998. Për më tepër, Dhoma thekson se Zona Operative e Dukagjinit u krijua në qershor 1998.¹⁴⁸⁵

(c) Përfundim

410. Dhoma konkludon se provat e kufizuara janë të pamjaftueshme për të nxjerrë përfundimin se gjatë periudhës 1 mars – 21 prill 1998 konflikti midis UÇK-së dhe forcave serbe ishte i ashpër në

¹⁴⁷⁷ *Shih* më sipër, para. 84.

¹⁴⁷⁸ *Shih* më sipër, para 130-131.

¹⁴⁷⁹ Branko Gajiq, Prova materiale P27, para. 17.

¹⁴⁸⁰ Dëshmitari 69, Prova materiale P370, para 21-22; Dëshmitari 69, Prova materiale P364 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9859.

¹⁴⁸¹ *Shih* më sipër, para. 136. Sikurse u përmend më herët, Cufë Krasniqi dëshmoi se UÇK-ja nuk ishte në gjendje të ndalonte patrullimin prej forcave serbe në zonën e Dukagjinit ose në Lugun e Baranit në komunën e Pejës para 24 marsit 1998, për arsye se UÇK-ja ishte vetëm forcë guerilase, *shih* më sipër, para. 135.

¹⁴⁸² Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4390-4391, 4461-4462.

¹⁴⁸³ Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4391-4392. Atij nuk iu kërkua lejkalimi se ishte i mirënjohur në zonë, mirëpo pas asaj kohe, për të kaluar përmes postbllloqeve kërkohet lejkalim nga shtabi vendor i UÇK-së, Shemsedin Çekaj, Prova materiale P2 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4392.

¹⁴⁸⁴ *Shih* më sipër, para 53-54.

¹⁴⁸⁵ *Shih* më sipër, para. 72.

atë masë sa të cilësohet konflikt i armatosur. Faktikisht gjendja në Kosovë ishte e nderë dhe incidente si ai në vendbanimin e familjes Haradinaj më 24 mars 1998 e ashpërsuan edhe më tej gjendjen. Mirëpo, Dhoma i gjykon vetëm si incidente që përshkallëzuan tensionin i cili nuk arriti ashpërsinë e nevojshme. Gjithashtu Dhoma gjykon se nuk ka prova të mjaftueshme për të provuar se gjatë periudhës 1 mars– 21 prill 1998, UÇK-ja kishte nivelin e duhur të organizimit.

411. Dhoma nuk është bindur mbi ekzistencën e konfliktit të armatosur në Kosovë midis forcave serbe dhe UÇK-së gjatë periudhës 1 mars – 21 prill 1998. Gjithsesi Dhoma pranon faktin e pranuar prej palëve se nga 22 prilli 1998 e më tej, ekzistonte konflikt i armatosur.

3. Lidhja

412. Dhoma duhet të përcaktojë nëse ekziston lidhje midis konfliktit të armatosur që ekzistonte nga 22 prilli 1998 dhe sjelljes së pretenduar në Aktakuzë. Lidhur me këtë pikë, Dhoma u referohet përfundimeve të mëtejshme në Aktgjykim për krimet e vërtetuara në këtë Aktgjykim.¹⁴⁸⁶ Dhoma gjykon se elementi i lidhjes brenda kuadrit të Nenit 3 është vërtetuar për krimet të cilat u kryen më 22 prill 1998 ose pas kësaj date, që u provuan në Aktgjykim.

4. Statusi i viktimave

413. Së fundi, Dhoma duhet të përcaktojë nëse viktimat e krimeve që pretendohet të jenë kryer më 22 prill 1998 ose pas asaj date, nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së këtyre krimeve. Për këtë aspekt, Dhoma do të nxjerrë përfundime konkrete më tej në Aktgjykim.

C. Përfundim

414. Duke u bazuar në përfundimin e vet lidhur me ekzistencën e konfliktit të armatosur, Dhoma nuk është bindur mbi vërtetimin e elementëve të Nenit 3 të Statutit për periudhën para 22 prillit 1998. Duke marrë parasysh marrëveshjen midis palëve se konflikti i armatosur ekzistoi duke filluar nga data 22 prill 1998 dhe përfundimet e veta të mëpasshme në këtë Aktgjykim, Dhoma bindet se elementët e Nenit 3 janë vërtetuar për periudhën që fillon nga 22 prilli 1998.

¹⁴⁸⁶Shih më poshtë, para 494, 516, 579, 610.

VI. AKUZAT

A. Ligji mbi krimet e akuzuara

1. Ligji mbi torturimin

415. Në Pikën 1, 4 dhe 6, të tre të Akuzuarit akuzohen për torturim si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës e ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit. Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj akuzohen për torturim edhe në Pikën 3 dhe në Pikën 5.¹⁴⁸⁷

416. Torturimi, goftë si krim lufte, apo krim kundër njerëzimit,¹⁴⁸⁸ përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- (a) duhet të ekzistojë një veprim ose mosveprim që shkakton dhimbje ose vuajtje shumë të madhe, fizike ose mendore;
- (b) veprimi ose mosveprimi duhet të jetë i qëllimshëm; dhe
- (c) veprimi ose mosveprimi duhet të jetë kryer me një qëllim konkret, si marrja e një informacioni apo rrëfimi, apo ndëshkimi, kërcënimi ose shtrëngimi i viktimës apo një të treti ose diskriminimi për çfarëdo arsye i viktimës apo një të treti.¹⁴⁸⁹

417. Fakti nëse veprimet e akuzuara si torturë shkaktojnë dhimbje ose vuajtje shumë të madhe përcaktohet duke shqyrtuar të gjitha rrethanat e çështjes, si karakteri dhe konteksti i shkakimit të dhimbjes, paramendimi dhe institucionalizimi i keqtrajtimit, gjendja fizike e viktimës, pasoja fizike ose mendore e trajtimit mbi viktimën, gjendja shëndetësore e viktimës dhe nëse keqtrajtimi vazhdoi për një kohë të gjatë.¹⁴⁹⁰ Nuk është e nevojshme që veprimi ose mosveprimi të shkaktojë lëndim të përhershëm, dhe as të shkaktojë lëndim fizik, duke qenë se dëmtimi mendor është formë e pranuar e torturimit.¹⁴⁹¹

418. Synimi kriminal i nevojshëm është që autori i krimit synoi të vepronte në një mënyrë të tillë që në rrjedhën normale të ngjarjeve do t'u shkaktonte dhimbje ose vuajtje të madhe fizike ose

¹⁴⁸⁷ Aktakuza, para 47-65.

¹⁴⁸⁸ Aktgjykimi *Limaj*, para. 235; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 482.

¹⁴⁸⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para 142, 144; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 111; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 481; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 179; Aktgjykimi *Limaj*, para. 235; Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 513.

¹⁴⁹⁰ Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 514; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 182; Aktgjykimi *Limaj*, para. 237.

¹⁴⁹¹ Aktgjykimi *Kvoçka*, para 148-149; Aktgjykimi *Limaj*, para. 236.

mendore viktimave të tij.¹⁴⁹² Tortura dallon prej krimeve të tjera në aspektin se nëpërmjet shkakimit të dhimbjes së madhe fizike ose mendore synon të arrijë një rezultat ose qëllim konkret. Këtu përfshihen, ndër të tjerë,¹⁴⁹³ qëllimi për marrjen e informacionit ose një rrëfimi, ndëshkimi, kërcënimi ose shtrëngimi i viktimës ose një të treti, ose diskriminimi për çfarëdo arsyeje i viktimës ose një të treti.¹⁴⁹⁴ Pa këto qëllime ose objektiva, as shkaktimi i dhimbjes edhe më të rëndë nuk mund të cilësohet torturë.¹⁴⁹⁵ Sidoqoftë, nuk është e nevojshme që shkaktimi i dhimbjes apo vuajtjes së madhe të bëhet vetëm për një ose më shumë nga qëllimet e përmendura, mirëpo duhet vetëm që qëllimi ose qëllimet e tilla të jenë pjesë e motivit të sjelljes.¹⁴⁹⁶

419. Nuk është e nevojshme që autori i krimit të ketë vepruar në funksion zyrtar që veprimet në fjalë të përbëjnë torturë.¹⁴⁹⁷

2. Ligji mbi trajtimin mizor

420. Në Pikën 1, 2, 4 dhe 6, të tre të Akuzuarit akuzohen për trajtim mizor si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës e ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit. Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj akuzohen edhe në Pikën 3 dhe 5.¹⁴⁹⁸

421. Trajtimi mizor si akuzë për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, përkufizohet si veprim ose mosveprim i qëllimshëm që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose përbën sulm kundër dinjitetit njerëzor kryer kundër një personi që nuk merr pjesë aktive në luftime.¹⁴⁹⁹

422. Kushti për ekzistencën e një qëllimi të paligjshëm që është veçori e krimit të torturës, nuk është i nevojshëm për trajtimin mizor.¹⁵⁰⁰ Gjithashtu, shkalla e vuajtjes së nevojshme për vërtetimin e trajtimit mizor ose çnjerëzor nuk është aq e lartë sa në rastin e torturës.¹⁵⁰¹

¹⁴⁹² Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 153; Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 515.

¹⁴⁹³ Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 470; Aktgjykimi *Kvoçka*, para. 140; Aktgjykimi *Limaj*, para. 239; Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 515.

¹⁴⁹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 155; Aktgjykimi *Kvoçka*, para. 153; Aktgjykimi *Kërnojelac* para. 184; Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 515.

¹⁴⁹⁵ Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 180.

¹⁴⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac*, para. 155.

¹⁴⁹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 284; Aktgjykimi *Limaj*, para. 240.

¹⁴⁹⁸ Aktakuzë, para 47-65.

¹⁴⁹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 424, 426; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 595; Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj*, para. 94; Aktgjykimi i Apelit *Jelisiq*, para. 41. *Shih* gjithashtu më sipër, para. 398.

¹⁵⁰⁰ Aktgjykimi *Kvoçka*, para. 226.

¹⁵⁰¹ Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 542; Aktgjykimi *Kvoçka*, para. 161.

423. Sa i përket synimit kriminal, autori i krimit duhet të ketë vepruar me synimin e drejtpërdrejtë për kryerjen e trajtimit mizor, ose me synim të tërthortë, me fjalë të tjera, të ketë ditur se me gjasë veprimi ose mosveprimi i tij do të shkaktonte trajtim mizor.¹⁵⁰²

3. Ligji mbi vrasjen

424. Në Pikat 1, 2 dhe 4, të tretë të Akuzuarit akuzohen për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës e ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit. Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj akuzohen edhe në Pikën 5.¹⁵⁰³

425. Për vërtetimin e vrasjes nevojiten tre elementë:

- (a) vdekja e viktimës;
- (b) veprimi ose mosveprimi i një keqbërësi ose i një apo më shumë personave për të cilët ai përgjigjet penalisht shkaktoi vdekjen e viktimës; dhe
- (c) veprimi ose mosveprimi i një keqbërësi ose i një apo më shumë personave për të cilët ai përgjigjet penalisht u krye me synimin për të vrarë viktimën ose me dijeninë se kishte të ngjarë që veprimi ose mosveprimi të shkaktonin vdekje (synimi kriminal).¹⁵⁰⁴

426. Nuk është e nevojshme të vërtetohet se kufoma e të vdekurit është gjetur. Fakti i vdekjes së një viktime mund të deduktohet nga rrethanat duke u bazuar në të gjitha provat e paraqitura. Mjafton vetëm të vërtetohet se i vetmi deduksion i arsyeshëm që del nga provat është se viktima ka vdekur si pasojë e veprimit ose mosveprimit të të akuzuarit ose një apo më shumë personave për të cilët ai mban përgjegjësi penale.¹⁵⁰⁵

¹⁵⁰² Aktgjykimi *Limaj*, para. 231; Aktgjykimi *Strugar*, para. 261; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 132; Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 236; Aktgjykimi *Simiq*, para. 76; Aktgjykimi *Haradinaj*, para. 126.

¹⁵⁰³ Aktakuzë, para 47-65.

¹⁵⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 261; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 423; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 37; Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 257; Aktgjykimi *Gotovina*, para. 1725; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1708; Aktgjykimi *Mërkshiq*, para. 486.

¹⁵⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 260; Aktgjykimi *Tadiq*, para. 240; Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 37; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para 385-386; Aktgjykimi *Martiq*, para. 59; Aktgjykimi *Boshkoski*, para. 305; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para 326-327; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1708.

427. Është e mjaftueshme që sjellja e keqbërësit të ketë kontribuar ndjeshëm në vdekjen e personit, nuk është e nevojshme që sjellja në fjalë të jetë i vetmi shkak i vdekjes.¹⁵⁰⁶

B. Përfundime

1. Shënime paraprake

428. Pretendohet se veprimet ose mosveprimet e përmendura në Aktakuzë kanë ndodhur në shtabin e UÇK-së dhe në objektin e burgimit të UÇK-së në fshatin Jabllanicë, ose në lidhje me këto vende, nga 19 maji ose rreth kësaj date deri në fund të qershorit 1998.

429. Jabllanica është një fshat i vogël,¹⁵⁰⁷ që ndodhet në një zonë malore¹⁵⁰⁸ në pjesën verilindore të komunës së Gjakovës, afër kufirit me komunat e Deçanit, Pejës dhe Klinës. Ndër të tjerë, fshatrat Dollovë, Grabanicë, Gllogjan dhe Napolë ndodhen në verilindje të Jabllanicës, Kosuriqi, Barani dhe Buçani në veriperëndim, dhe Dashinoci, Zhabeli dhe Kralani në jug. UÇK-ja filloi ekzistencën e saj në Jabllanicë para periudhës së Aktakuzës dhe disa e konsideronin fshatin si baza më e vjetër e UÇK-së në Kosovën perëndimore.¹⁵⁰⁹ Mendohej se vendndodhja e saj malore e bënte të vështirë depërtimin e forcave serbe atje.¹⁵¹⁰

430. Në hyrjen jugore të Jabllanicës, objekti i parë në anën e majtë të rrugës nga Zhabeli ishte një grup ndërtesash brenda një oborri¹⁵¹¹ me porta druri,¹⁵¹² i cili ishte i rrethuar pjesërisht me mur dhe pjesërisht me një gardh,¹⁵¹³ me një mur të gjatë që shtrihej përgjatë rrugës që çon në Zhabel. Brenda

¹⁵⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 423; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 37; Aktgjykimi *Millutinoviq*, para. 137; Aktgjykimi *Oriq*, para. 347.

¹⁵⁰⁷ Cufë Krasniqi dëshmoi se Jabllanica nuk është fshat i madh dhe nuk ka shumë shtëpi dhe banorë, Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5846.

¹⁵⁰⁸ Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5846.

¹⁵⁰⁹ *Shih* Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 35; Skënder Rexhahmetaj, Prova materiale P297, para. 10.

¹⁵¹⁰ Cufë Krasniqi, Prova materiale P54, para. 35; Cufë Krasniqi dëshmoi se forcat serbe nuk mund të hynin në Jabllanicë për një kohë të gjatë, pa saktësuar kohëzgjatjen, Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5846. Në lidhje me Jabllanicën, Nebojshta Avramoviqi dëshmoi se policia kishte marrë informata se i tërë fshati ishte i armatosur dhe se ishin kryer sulme kundër policisë, Nebojshta Avramoviqi, Prova materiale P451, para. 10.

¹⁵¹¹ Dëshmitari 3, T. 1541; Dëshmitari 7, Prova materiale t P94, para. 6; Dëshmitari 16, Prova materiale P96, para. 10; Dëshmitari 75, T. 857; Dëshmitari 76, Prova materiale P305, para. 10.

¹⁵¹² Dëshmitari 3, T. 1541; Dëshmitari 76, Prova materiale P305, para. 10; Dëshmitari 80, T. 2336. Dëshmitari 3 dëshmoi se përballë në anën e djathtë të rrugës ishte “mali dhe pylli”, Dëshmitari 3, T. 1541.

¹⁵¹³ Dëshmitari 76, Prova materiale P305, para. 10; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 6. *Shih* edhe Dëshmitari 3, T. 1542-1543.

këtij oborri me ndërtesa, në të majtë të portave, ishte një ndërtesë e gjatë njëkatëshe.¹⁵¹⁴ Brenda oborrit ishte një ndërtesë tjetër njëkatëshe, në formë drejtkëndore, me tulla të kuqe. Kjo ndërtesë kishte katër dhoma dhe një bodrum.¹⁵¹⁵ Dëshmitarët e identifikuan këtë oborr me ndërtesa në fotografinë e pranuar si Prova materiale P60.¹⁵¹⁶ Provat tregojnë se ky objekt përdorej si vendndodhje e shtabit të UÇK-së¹⁵¹⁷ dhe si kazermë për UÇK-në.¹⁵¹⁸ Në ndërtesën e gjatë njëkatëshe në oborr ishte një kuzhinë për ushtarët¹⁵¹⁹ dhe një zyrë me një tavolinë.¹⁵²⁰ Dhoma do t'i referohet këtij objekti si “objekti i UÇK-së në Jabllanicë”.

431. Jo larg nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, rreth pesë ose shtatë minuta në këmbë, ndodhej shtëpia e Lahi Brahimajt.¹⁵²¹ Ushtarët e UÇK-së takoheshin dhe ndonjëherë flinin në këtë shtëpi.¹⁵²² Herë pas here në prova kjo shtëpi përmendet si shtabi i UÇK-së ose postëkomanda e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁵²³

432. Dhoma dëgjoi dëshmi nga shumë dëshmitarë lidhur me rrëmbimin e tyre ose të personave të tjerë në pranverë dhe verë të vitit 1998 nga vende të ndryshme jo larg Jabllanicës dhe mbajtjen e tyre të mëpasshme në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Këto dëshmi nuk janë gjithmonë përputhëse dhe Dhoma nuk i pranon të gjitha si të besueshme, sikurse shpjegohet më poshtë.

¹⁵¹⁴ Dëshmitari 80, T. 2336-2337. Dëshmitari 16 përshkroi një ndërtesë të gjatë që “dukej si stallë” dhe një ndërtesë dykatëshe, Dëshmitari 16, Prova materiale P96, para. 10. Duke mbajtur parasysh mundësinë e kufizuar të Dëshmitarit 16 për të vëzhguar objektin, Dhoma konkludon se ky dëshmitar gaboi në lidhje me ndërtesën dykatëshe.

¹⁵¹⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5204; Dëshmitari 75, T. 864-865.

¹⁵¹⁶ Dëshmitari 3, T. 1542; Dëshmitari 75, T. 858; Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5754.

¹⁵¹⁷ Dëshmitari 80, T. 2333-2339. Shih edhe Cufë Krasniqi, Prova materiale P53 (Transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5754.

¹⁵¹⁸ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9949-9951; Prova materiale P70; P71; P118; *shih* edhe Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4193.

¹⁵¹⁹ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9950; Cufë Krasniqi, Prova materiale P53 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5755; Prova materiale P70.

¹⁵²⁰ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9950; Prova materiale P70.

¹⁵²¹ Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9948-9949; Cufë Krasniqi qarkoi me rreth të kuq shtëpinë e Lahi Brahimajt në një fotografi të shtëpive në Jabllanicë, Cufë Krasniqi, Prova materiale P52 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5753; Prova materiale P59.

¹⁵²² Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9946-9947.

¹⁵²³ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4196; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3387-3388.

2. Pika 1(a) Akuzat në Aktakuzë

433. Në Aktakuzë pretendohet se më 19 maj 1998 ose rreth kësaj date, Ivan Zariqi, serb, dhe dy romë/egjiptianë, Agron Berisha dhe Burim Bejta, u nisën prej fshatit të tyre Dolle dhe udhëtuan për në fshatin Grabanicë ku ishte mulliri i blojës, ku u arrestuan nga ushtarë të UÇK-së, u çuan në një shtëpi të braktisur ku u rrahën keqazi.¹⁵²⁴ Pretendohet se ushtarët e UÇK-së më pas i çuan në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku u mbajtën, dhe se në prani të Ramush Haradinajt, Idriz Balaj gjymtoi Ivan Zariqin duke i prerë veshin dhe kërcënoi se do të bënte të njëjtën gjë më Agron Berishën dhe Burim Bejtën. Gjithashtu pretendohet se Idriz Balaj urdhëroi ekzekutimin e tre personave në praninë e Ramush Haradinajt.¹⁵²⁵ Më tej pretendohet se Idriz Balaj dhe një grup ushtarësh të UÇK-së të Shqiponjave të Zeza i morën tre personat dhe ata të tre u vranë gjatë mbajtjes nga UÇK-ja.¹⁵²⁶ Këto pretendime përbëjnë një pikë për vrasje, trajtim mizor dhe torturim si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit kundër çdo të Akuzuari (Pika 1) bazuar në pretendimin mbi pjesëmarrjen e tyre në një ndërmarrje të përbashkët kriminale të përmendur në Aktakuzë, dhe ndryshe mbi bazën e formave të tjera të përgjegjësisë penale sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit.

(b) Përfundime

434. Më 1998, Burim Bejta, në atë kohë 15 vjeç, banonte me familjen e tij në fshatin Dolle në komunën e Klinës.¹⁵²⁷ Agron Berisha, kushëri i Burim Bejtës, gjithashtu banonte në Dolle në atë kohë. Ai ishte 16 vjeç.¹⁵²⁸ Burim Bejta dhe Agron Berisha ishin romë. Ata nuk bënë pjesë në asnjë grup të armatosur.¹⁵²⁹ Ivan Zariqi, serb i Kosovës i cili banonte në Dolle, më 1998 ishte 22 vjeç.¹⁵³⁰ Ai kishte shërbyer më parë në ushtri mirëpo më 1998 nuk ishte pjesëtar i asnjë grupi të armatosur.¹⁵³¹

¹⁵²⁴ Aktakuza, para. 47.

¹⁵²⁵ Aktakuza, para. 47-49.

¹⁵²⁶ Aktakuza, para. 49.

¹⁵²⁷ Dëshmitari 31, Prova materiale P102 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9514; Dëshmitari 66, Prova materiale P107 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8413-8414.

¹⁵²⁸ Dëshmitari 31, Prova materiale P102 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9514; Dëshmitari 66, Prova materiale P107 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8414.

¹⁵²⁹ Dëshmitari 66, Prova materiale P107 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8413-8414.

¹⁵³⁰ Dëshmitari 31, Prova materiale P102 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9514; Dëshmitari 66, Prova materiale P107 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8414-8415.

¹⁵³¹ Dëshmitari 66, Prova materiale P107 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8415.

435. Fshati Dollc, i cili ndodhet afërsisht 3.5 kilometra në verilindje të fshatit Grabanicë, banohej kryesisht nga serbë të Kosovës. Atje jetonin edhe disa shqiptarë katolikë dhe 12 familje rome.¹⁵³²
436. Më 17 ose 18 maj 1998¹⁵³³, në 09:30 ose 10:00, Burim Bejta, Agron Berisha dhe Ivan Zariqi u nisën nga Dollci në një qerre me kuaj në drejtim të Grabanicës.¹⁵³⁴ Ata kishin një thes me misër të cilin do ta bluanin në mullirin e Grabanicës.¹⁵³⁵ Mulliri punoi deri më 21 maj 1998.¹⁵³⁶
437. Rreth asaj kohe ushtarët e UÇK-së dhe njerëzit e mbrojtjes së fshatit në Grabanicë hapnin llogore dhe bënë rojë. Një nga pjesëtarët e mbrojtjes së fshatit përshkroi se pa dy fëmijë dhe një person të kombësisë serbe që erdhën në Grabanicë me një qerre.¹⁵³⁷ Ai dha si datë të kësaj ngjarjeje “rreth 17 ose 18 maj”.¹⁵³⁸ Sipas tij, fëmijët ishin 10 ose 12 vjeç, kurse personi i tretë rreth 30 vjeç.¹⁵³⁹ Pjesëtari i mbrojtjes së fshatit i ndaloi dhe i pyeti ku po shkonin.¹⁵⁴⁰ Ata u përgjigjën se po shkonin në mulli.¹⁵⁴¹ Tre të rinjtë vazhduan më tej.¹⁵⁴² Dhoma përfundon se dy fëmijët dhe burri që u panë në qerre nga pjesëtari i mbrojtjes së fshatit ishin Burim Bejta, Agron Berisha dhe Ivan Zariqi.
438. Pasi Burim Bejta, Agron Berisha dhe Ivan Zariqi nuk u kthyen në shtëpi pas disa orësh pasi ishin nisur për në Grabanicë për të bluar misër, të afërmit e tyre filluan t’i kërkonin. Ata shkuan së pari në Klinë ku banonte e dashura e Burim Bejtës, Suzana.¹⁵⁴³ Ajo ishte serbe e Kosovës dhe në ditën kur u zhduk, Burim Bejta mbante një byzylyk me emrin e saj.¹⁵⁴⁴ Meqenëse nuk mundën të mësonin gjë për djemtë në Klinë, ata shkuan në Grabanicë.¹⁵⁴⁵

¹⁵³² Dëshmitari 66, Prova materiale P107 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8415, 8423-8424.

¹⁵³³ Për arsyet në mbështetje të përfundimit të Dhomës se ngjarjet e diskutuara këtu ndodhën më 17 ose 18 maj 1998 *shih* më poshtë, para. 444.

¹⁵³⁴ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8422-8423, 8431; Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9515-9516.

¹⁵³⁵ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9516; Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8422.

¹⁵³⁶ Mulliri punoi deri më 21 maj 1998. Atë ditë, si rezultat i granatimit të fshatit u ndërpre rryma elektrike dhe mulliri nuk punoi për njëfarë kohe, *shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵³⁷ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵³⁸ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵³⁹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵⁴⁰ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵⁴¹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵⁴² *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵⁴³ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9517-9518; Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8424.

¹⁵⁴⁴ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9521-9522.

¹⁵⁴⁵ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9517-9518; Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8424.

439. Dëshmitë mbi vizitën e të afërmve në Grabanicë kanë mospërputhje. Sipas një dëshmie, të afërmit erdhën në fshat me autobus dhe vazhduan në këmbë. Rruga kalonte përmes një pylli. Në kohën që të afërmit po kalonin përmes pyllit, nga drurët doli një grup njerëzish të armatosur dhe me uniforma të UÇK-së, të cilët i ndalën dhe i pyetën ku po shkonin.¹⁵⁴⁶ Të afërmit u thanë këtyre njerëzve se po shkonin te mulliri dhe u lejuan të shkonin.¹⁵⁴⁷ Ata arritën në mulli dhe i ranë ziles. Pas njëfarë kohe tek dera doli një burrë i cili u tha se nuk i kishte parë djemtë.¹⁵⁴⁸ Të afërmit u kthyen në shtëpi. Pak kohë më vonë, të afërmit kallëzuan zhdukjen e tre të rinjve në policinë e Klinës, mirëpo policët nuk dinin çfarë të bënin dhe i kthyen në shtëpi.¹⁵⁴⁹

440. Dëshmia e një dëshmitari tjetër është disi e ndryshme. Ky dëshmitar dëgjoi se të afërmit shkuan në Grabanicë dy herë. Hera e parë ishte dita kur ishin zhdukur djemtë. Në një vend midis shkollës dhe një varreze, ata u ndalën nga tre ose katër shqiptarë kosovarë të armatosur me armë gjysmëautomatike të cilët u kërkuan letërnjoftimet dhe i shënuan emrat e tyre në një regjistër. Këta njerëz i orientuan të afërmit për në mulli.¹⁵⁵⁰ Te mulliri nuk ndodhej askush.¹⁵⁵¹ Pastaj të afërmit shkuan në polici ku u këshilluan që vetëm gratë duhej të merrnin informacionin në Grabanicë, sepse “burrat do të mbaheshin atje”.¹⁵⁵² Ditën e nesërme, të afërmit shkuan sërish në Grabanicë. Me të mbërritur në fshat, ata u ndaluan nga 40-50 njerëz të armatosur, gjysma prej të cilëve me rroba civile dhe gjysma tjetër me uniforma.¹⁵⁵³ Të afërmve iu tha se tre të rinjtë nuk kishin qenë në Grabanicë dhe se të afërmit duhej të ktheheshin në shtëpi, ndryshe do të vriteshin.¹⁵⁵⁴

441. Kanë kaluar shumë vite nga ngjarjet e lartpërshkruara deri në dëshmitë e dhëna në Tribunal. Kujtesa e dëshmitarëve lidhur me këto ngjarje mund të mos jetë tërësisht e kthjellët ose e saktë. Gjithsesi, nga dëshmitë e analizuara më sipër, Dhoma pranon se në ditën e zhdukjes së Burim Bejtës, Agron Berishës dhe Ivan Zariqit dhe të nesërmen e asaj dite, të afërmit bënë përpjekje për t'i gjetur në fshatin Grabanicë dhe në mulli. Këto përpjekje rezultuan të pafrytshme.

¹⁵⁴⁶ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9518; Dëshmitari 31 nuk dha datë lidhur me këtë vajtje në mulli.

¹⁵⁴⁷ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9519-9520.

¹⁵⁴⁸ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9520.

¹⁵⁴⁹ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9520.

¹⁵⁵⁰ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8424-8425.

¹⁵⁵¹ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8425.

¹⁵⁵² Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8425.

¹⁵⁵³ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8426, 8428.

¹⁵⁵⁴ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8428-8429.

442. Pak ditë pas zhdukjes së tre të rinjve, qerrja me kuaj me të cilën ishin nisur për në Grabanicë, u pa në rrugën afër Klinës.¹⁵⁵⁵ Qerrja vinte nga drejtimi i fshatit Zajm dhe drejtohej nga dy fëmijë shqiptarë kosovarë.¹⁵⁵⁶ Sipas Dëshmitarit 31, thesi me misër ishte ende mbi qerre.¹⁵⁵⁷ Dy fëmijët shqiptarë kosovarë u thanë policëve se e kishin gjetur qerren pa njeri afër fshatit të tyre Përlinë në komunën e Klinës.¹⁵⁵⁸

443. Burim Bejta, Agron Berisha dhe Ivan Zariqi nuk u panë më nga të afërmit e tyre pas asaj dite kur u nisën nga fshati i tyre me një qerre.¹⁵⁵⁹

444. Dita e saktë kur tre të rinjtë u panë për herë të fundit nga dëshmitarë ka qenë subjekt debati.¹⁵⁶⁰ Dëshmitari 66 dëshmoi se një i afërm i tij i tha se kjo kishte ndodhur më 19 maj 1998.¹⁵⁶¹ Ai gjithashtu dëshmoi se ky incident ndodhi katër apo pesë ditë para granatimit të Grabanicës.¹⁵⁶² Dëshmitarit 31 nuk i kujtohej dita e zhdukjes së tre të rinjve.¹⁵⁶³ Sipas dëshmive të tjera të diskutuara në këtë pjesë, incidenti ndodhi më 17 ose 18 maj 1998.¹⁵⁶⁴ Dhoma dëgjoi dëshmi të cilat i konsideron të besueshme se më 19 maj 1998 ose rreth kësaj date, fshati Grabanicë u sulmua nga forcat serbe dhe se sulmi zgjati tri ditë.¹⁵⁶⁵ Sikundër u përmend më herët në Aktgjykim, në një raport luftimi të Brigadës së Motorizuar 125 me datë 29 maj 1998 përmendet një operacion “i madh” në vijim i forcave serbe në fshatin Grabanicë dhe gjithashtu në Dollovë, Qeskovë dhe Kpuz të komunës së Klinës,¹⁵⁶⁶ që ndodhen në jug të Grabanicës dhe fshatit Dolle prej nga u nisën tre të rinjtë. Gjetiu në këtë Aktgjykim, Dhoma konkludoi se sulmi kundër Grabanicës zgjati tri ditë.¹⁵⁶⁷ Dhoma pranon dëshmitë e diskutuara në këtë paragraf dhe konkludon se fshati Grabanicë u sulmua

¹⁵⁵⁵ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8429-8430; *shih* Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9520-9521.

¹⁵⁵⁶ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8429-8430.

¹⁵⁵⁷ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9520.

¹⁵⁵⁸ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8430-8431.

¹⁵⁵⁹ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8422-8423, 8431; Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9517. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 28, Prova materiale P355 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 12190, 10194-10195, dëshmohet se që prej gushtit 1999, vendndodhja e Burim Bejtës, Agron Berishës dhe Ivan Zariqin nuk dihej; Prova materiale P427, f 1, 2, 4, 5, 7 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹⁵⁶⁰ *Shih* Argumentet Përmbyllëse, 27 qershor 2012, T. 2960, 3060-3063.

¹⁵⁶¹ Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8423.

¹⁵⁶² Dëshmitari 66, Prova materiale P106 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8433-8434.

¹⁵⁶³ Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9515. Dëshmitari 31 dëshmoi se kjo ndodhi “më 1999 ose 1998”, Dëshmitari 31, Prova materiale P101 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9515.

¹⁵⁶⁴ *Shih* më sipër, para. 437.

¹⁵⁶⁵ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁵⁶⁶ Prova materiale P114, p. 2. *Shih* gjithashtu më sipër, para. 155.

¹⁵⁶⁷ *Shih* më poshtë, para. 584.

nga forcat serbe më 19 ose 20 maj 1998 dhe se sulmi zgjati tri ditë. Dhoma rikujton se të afërmit e tre të rinjve shkuan në Grabanicë për t'i kërkuar në ditën e zhdukjes së tyre.¹⁵⁶⁸ Ata nuk hasën në granatim apo operacione ushtarake. Prej dëshmimeve, Dhoma konkludon se tre të rinjtë u panë për herë të fundit pak ditë para operacionit të forcave serbe në Grabanicë më 19 ose 20 maj 1998, ka të ngjarë më 17 ose 18 maj 1998.

445. Dhoma dëgjoi dëshmi nga Dëshmitari 80 dhe Dëshmitari 81 lidhur me ngjarje që pretendohet të kenë ndodhur pas zhdukjes së tre të rinjve. Këto dëshmi analizohen më poshtë.

446. Dëshmitari 80 dëshmoi se i kishte parë tre të rinjtë nga Dollci që kishin shkuar në Grabanicë disa herë për të bluar misër.¹⁵⁶⁹ Ai dëshmoi se një ditë në maj 1998, para sulmit në Grabanicë,¹⁵⁷⁰ tre të rinjtë u arrestuan te mulliri në Grabanicë nga Metë Morina dhe Hazir Morina,¹⁵⁷¹ ushtarë të UÇK-së,¹⁵⁷² të cilët i çuan në shtabin e UÇK-së në Grabanicë. Dëshmitari 80 pa se në shtabin e UÇK-së në Grabanicë ata u rrahën keqazi me shkopinj druri.¹⁵⁷³

447. Dëshmitari 80 dëshmoi se tre të rinjtë i pa sërish në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Sipas tij, ata u mbajtën atje për dy ose tri ditë.¹⁵⁷⁴ Ata u nxorën jashtë bodrumit të ndërtesës drejtkëndore në atë objekt, me duar të lidhura njëri me tjetrin si një zinxhir.¹⁵⁷⁵ Në trup kishin mavijosje dhe rrobat i kishin të lagëta.¹⁵⁷⁶ Pastaj Dëshmitari 80 i pa tre të rinjtë kur u rrahën keqazi. Në rrahje morën pjesë shumë individë. Dëshmitari 80 nuk ua dinte të gjithëve emrat.¹⁵⁷⁷ Rrahja ndodhi në prani të Lahi Brahimajt, Nazmi Brahimajt dhe Idriz Balajt.¹⁵⁷⁸ Idriz Balaj mori pjesë në rrahje¹⁵⁷⁹ dhe i rrahu rëndë tre të rinjtë.¹⁵⁸⁰ Djemtë u rrahën me shkopinj derisa urinuan në teshat e tyre.¹⁵⁸¹ Në rrahje morën pjesë edhe Lahi Brahimaj dhe Nazmi Brahimaj; ata i rrahën tre të rinjtë me

¹⁵⁶⁸ *Shih* më sipër, para. 438.

¹⁵⁶⁹ Dëshmitari 80, T. 2393-2394. Dëshmitari 80 nuk ua dinte emrat tre të rinjve, mirëpo i përshkroi si vijon: (“Ishin shumë të rinj, thuajse fëmijë”, Dëshmitari 80, T. 2395; “Ishin nga fshati Dollci”, Dëshmitari 80, T. 2394; “Ata flisnin shqip, mirëpo nuk di të çfarë kombësie ishin”, Dëshmitari 80, T. 2394; “Ata erdhën me një qerre me kalë”, Dëshmitari 80, T. 2394) Dhoma pranon se tre të rinjtë e përmendur në dëshminë e Dëshmitarit 80 janë Burim Bejta, Agron Berisha dhe Ivan Zariqi.

¹⁵⁷⁰ Dëshmitari 80, T. 2390, 2392.

¹⁵⁷¹ Dëshmitari 80, T. 2395.

¹⁵⁷² Dëshmitari 80, T. 2396-2397.

¹⁵⁷³ Dëshmitari 80, T. 2395.

¹⁵⁷⁴ Dëshmitari 80, T. 2397, 2404.

¹⁵⁷⁵ Dëshmitari 80, T. 2403-2404.

¹⁵⁷⁶ Dëshmitari 80, T. 2403-2404.

¹⁵⁷⁷ Dëshmitari 80, T. 2398-2399.

¹⁵⁷⁸ Dëshmitari 80, T. 2399.

¹⁵⁷⁹ Dëshmitari 80, T. 2399-2400.

¹⁵⁸⁰ Dëshmitari 80, T. 2400.

¹⁵⁸¹ Dëshmitari 80, T. 2400.

shkopinj.¹⁵⁸² Idriz Balaj preu veshin e njërit prej djemve me një thikë shumë të mprehtë.¹⁵⁸³ Më pas Dëshmitari 80 dëgjoi Idriz Balajn kur i tha Lahi Brahimajt, Nazmi Brahimajt, Alush Agushit, Myftar Ibrahimajt (Brahimajt) dhe Naser Ibrahimajt (Brahimajt) se “duhet t’ia bëjmë gati letrat për Drenicë a diku tjetër [...]”.¹⁵⁸⁴ Edhe Lahi Brahimaj tha se duhej të bënin gati letrat për Drenicë.¹⁵⁸⁵ Dëshmitari 80 e kishte dëgjuar këtë shprehje më parë në Jabllanicë dhe mendoi se kuptimi ishte që tre të rinjtë do të vriteshin.¹⁵⁸⁶ Pas rrahjeve, ushtarët i morën me vete tre të rinjtë.¹⁵⁸⁷

448. Lidhur me besueshmërinë e Dëshmitarit 80 pati shumë kundërshtime. Kur u pyet nga Mbrojtja, dëshmitari pranoi se në një deklaratë të mëhershme ai kishte thënë se vetëm “kishte dëgjuar” për rrëmbimin e tre të rinjve në Grabanicë.¹⁵⁸⁸ Para Dhomës ai dëshmoi se tre të rinjtë “u arrestuan” te mulliri në Grabanicë.¹⁵⁸⁹ Kur u pyet kur i kishte parë për herë të parë në Grabanicë, ai tha se nuk i kujtohej.¹⁵⁹⁰ Megjithëse Dëshmitarit 80 iu bë një pyetje sugjестive se ai pa çfarë u kishte ndodhur në Grabanicë, në përgjigje Dëshmitari 80 nuk saktësoi se nga e dinte që ata ishin arrestuar në fshat.¹⁵⁹¹ Gjithsesi ai dëshmoi se i pa kur i rrahën në shtabin e UÇK-së në Grabanicë.¹⁵⁹²

449. Avokati i Balajt sugjeroi se ndonëse Dëshmitari 80 dëshmoi se i njohte tre të rinjtë nga Dollci, ai nuk mundi ta identifikonte Ivan Zariqin në fotografi e cila iu tregua gjatë një interviste me Prokurorinë.¹⁵⁹³ Konkretisht, avokati sugjeroi se kur dëshmitarit iu tregua fotografia e Ivan Zariqit më 2005, ai tha se e kishte parë atë njeri dhe ishte fytyrë e njohur, mirëpo nuk mund të saktësonte ku e kishte parë.¹⁵⁹⁴ Dëshmitarit 80 nuk i kujtohej ky episod.¹⁵⁹⁵ Para Dhomës, Dëshmitari 80 nuk

¹⁵⁸² Dëshmitari 80, T. 2407.

¹⁵⁸³ Dëshmitari 80, T. 2400-2401.

¹⁵⁸⁴ Dëshmitari 80, T. 2401-2402, 2405.

¹⁵⁸⁵ Dëshmitari 80, T. 2463.

¹⁵⁸⁶ Dëshmitari 80, T. 2405.

¹⁵⁸⁷ Dëshmitari 80, T. 2404, 2406.

¹⁵⁸⁸ Dëshmitari 80, T. 2597-2598; *shih* edhe Dosja Përfundimtare e Balajt, para. 169.

¹⁵⁸⁹ Dëshmitari 80, T. 2394-2395.

¹⁵⁹⁰ Dëshmitari 80, T. 2394.

¹⁵⁹¹ Në pjesën përkatëse të transkriptit lexohet:

“Pyetje. Ju thatë – ju na thatë se diçka u kishte ndodhur këtyre të rinjve në fshat. Çfarë – patë që u ndodhi atyre në fshat?

Përgjigje. Ata u ndaluan nga disa njerëz jo të mirë.” Dëshmitari 80, T. 2394.

¹⁵⁹² Dëshmitari 80, T. 2395.

¹⁵⁹³ Dëshmitari 80, T. 2657-2659; Dosja Përfundimtare e Balajt, para. 170.

¹⁵⁹⁴ Dëshmitari 80, T. 2658-2659.

¹⁵⁹⁵ Dëshmitari 80, T. 2659.

dëshmoi se e njihnte mirë Ivan Zariqin, mirëpo tha se i kishte parë tre të rinjtë “disa herë”, se nuk i mbante mend emrat e tyre dhe nuk kishte folur asnjëherë me ta.¹⁵⁹⁶

450. Gjithashtu gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, dëshmitarit iu tha se në një deklaratë të mëhershme, fakt të cilin ai e pranoi, ai ishte shprehur se pasi njërit prej djemve i prenë veshin, veshi ra në tokë dhe po dridhej si flutur.¹⁵⁹⁷ Avokati i Mbrojtjes gjithashtu sugjeroi se sipas një ekspertize mjekësore, ky pohim është fizikisht i pamundshëm.¹⁵⁹⁸ Aktekspertiza mjekësore e përmendur gjatë pyetjeve nga Mbrojtja nuk përfshihet në prova. Dëshmitari nuk ka arsimim mjekësor dhe sipas dëshmisë së tij, ngjarjet me tre të rinjtë për të cilat tha se i kishte parë, ndikuan emocionalisht mbi të gjatë kohës kur dha dëshmi.¹⁵⁹⁹

451. Megjithëse asnjë nga kundërshtimet e diskutuara në paragrafët e mëparshëm, po të merren veçazi, nuk e bën dëshminë e Dëshmitarit 80 të pabesueshme, Dhoma thekson se Dëshmitari 80 dha informacion mospërputhës mbi kohën e incidentit me tre të rinjtë lidhur me praninë e tij në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Fillimisht ai dëshmoi se në kohën e incidentit të prerjes së veshit ai ishte në Jabllanicë pas një incidenti në Buçan.¹⁶⁰⁰ Më herët ai kishte dëshmuar se incidenti në Buçan ndodhi *pas* ardhjes së tij me një bashkudhëtar.¹⁶⁰¹ Më tej ai tha se incidenti me tre të rinjtë ndodhi kur ai u mbajt një herë në Jabllanicë *para* ardhjes së tij me një bashkudhëtar.¹⁶⁰² Kur u pyet nëse incidenti i prerjes së veshit treguar prej tij, kishte ndodhur pas rrëmbimit të tij dhe të bashkudhëtarit të tij, dëshmitari u përgjigj: “Po. Sipas meje fëmijët u mbajtën atje për disa ditë”.¹⁶⁰³ Fillimisht ai dëshmoi se rrahjen e të rinjve në Jabllanicë e pa para sulmit në Grabanicë,¹⁶⁰⁴ mirëpo më pas dëshmoi se kishte ndodhur pas sulmit.¹⁶⁰⁵

452. Dëshmitari 80 dëshmoi se ai u çua në Jabllanicë më shumë se 10 herë.¹⁶⁰⁶ Ai dha hollësi jo gjithmonë përputhëse për disa prej këtyre incidenteve.¹⁶⁰⁷ Dëshmitari 80 dëshmoi se katër prej këtyre incidenteve ndodhën brenda një jave.¹⁶⁰⁸ Megjithëse jo i qartë për datën e incidentit të prerjes së veshit, dëshmitari ishte i qartë se tre të rinjtë u mbajtën në objektin e UÇK-së në

¹⁵⁹⁶ Dëshmitari 80, T. 2393-2394.

¹⁵⁹⁷ Dëshmitari 80, T. 2656-2657.

¹⁵⁹⁸ Dëshmitari 80, T. 2694.

¹⁵⁹⁹ Dëshmitari 80, T. 2398.

¹⁶⁰⁰ Shih Shtojca Konfidenciale.

¹⁶⁰¹ Dëshmitari 80, T. 2349, 2351.

¹⁶⁰² Dëshmitari 80, T. 2413-2414.

¹⁶⁰³ Dëshmitari 80, T. 2590.

¹⁶⁰⁴ Dëshmitari 80, T. 2414.

¹⁶⁰⁵ Dëshmitari 80, T. 2590.

¹⁶⁰⁶ Dëshmitari 80, T. 2583.

¹⁶⁰⁷ Dëshmitari 80, T. 2486, 2331-2332, 2333, 2342.

¹⁶⁰⁸ Dëshmitari 80, T. 2345, 2486, 2581-2582.

Jabllanicë për disa ditë para incidentit të prerjes së veshit, përshkruar prej tij¹⁶⁰⁹ dhe se Dëshmitari 80 e pa keqtrajtimin në një rast kur ishte në Jabllanicë pa bashkudhëtarin e tij.¹⁶¹⁰ Gjithsesi, pasi i ka analizuar këto dëshmi në tërësi duke i krahasuar me dëshmitë lidhur me çështjen për të cilën dëshmoi dëshmitari, Dhoma nuk e konsideron Dëshmitarin 80 të besueshëm.¹⁶¹¹

453. Për të provuar akuzat në Pikën 1, Prokuroria paraqiti edhe Dëshmitarin 81.

454. Në dëshminë e tij kryesore Dëshmitari 81 dëshmoi se në prill ose maj 1998, ai dhe gjashtë ushtarë të tjerë të UÇK-së, emrat e të cilëve nuk pranoi t'i tregonte, arritën në Jabllanicë. Ata u urdhëruan të shkonin atje nga komandanti i tij për arsye se duhej të ndihmonin UÇK-në në Jabllanicë.¹⁶¹² Ata shkuan në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, ku pak kohë më vonë takuan Lahi Brahimajn me pseudonimin "Magjupi".¹⁶¹³ Magjupi u tregoi bodrumin e shtëpisë në atë objekt, ku mbaheshin gjashtë apo shtatë njerëz, ndër të cilët dy romë dhe një serb, afërsisht 22-23 vjeç, dy gra rreth 45-50 vjeç dhe një ose dy burra afërsisht të së njëjtës moshë.¹⁶¹⁴ Këta persona kishin mavijosje dhe këmbët ua kishin lidhur.¹⁶¹⁵ Në bodrum kishte ujë në një lartësi 20-30 cm dhe baltë. Dëshmitari 81 pa njerëz në bodrum të cilët ishin në ujë.¹⁶¹⁶ Gjithashtu Dëshmitari 81 dëshmoi se më pas Magjupi e çoi të riun serb në një dhomë me një tavolinë ku e pyeti rreth 45 minuta mbi vendndodhjen e forcave serbe dhe postbllloqet e tyre.¹⁶¹⁷ Dëshmitari 81 dëshmoi se më pas ushtarët e atjeshëm i nxorën dy djemtë romë dhe serbin që ishte marrë në pyetje nga Magjupi, në oborrin para shtëpisë.¹⁶¹⁸

455. Në dëshminë e tij kryesore Dëshmitari 81 tha gjithashtu se rreth 10-15 minuta më vonë erdhën Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj me pseudonimin Togeri.¹⁶¹⁹ Ramush Haradinaj mori në pyetje dy romët mbi vendndodhjen e forcave serbe dhe postbllloqet e tyre.¹⁶²⁰ Dëshmitari 81 dëshmoi se dy romët iu lutën Ramush Haradinajt dhe se ai goditi një herë ose dy herë me grusht serbin.¹⁶²¹ Më pas ai deklaroi se Ramush Haradinaj po merrte në pyetje djalin serb mbi

¹⁶⁰⁹ Dëshmitari 80, T. 2404, 2590.

¹⁶¹⁰ Dëshmitari 80, T. 2413-2414, 2663.

¹⁶¹¹ *Shih* gjithashtu më poshtë, para. 552-554, 606-609.

¹⁶¹² Dëshmitari 81, T. 1882-1884, 1885-1888, 1891-1892.

¹⁶¹³ Dëshmitari 81, T. 1895-1896

¹⁶¹⁴ Dëshmitari 81, T. 1898-1901, 1953.

¹⁶¹⁵ Dëshmitari 81, T. 1900.

¹⁶¹⁶ Dëshmitari 81, T. 1898-1900.

¹⁶¹⁷ Dëshmitari 81, T. 1901-1903.

¹⁶¹⁸ Dëshmitari 81, T. 1904, 1909.

¹⁶¹⁹ Dëshmitari 81, T. 1910, 1912.

¹⁶²⁰ Dëshmitari 81, T. 1915-1916.

¹⁶²¹ Dëshmitari 81, T. 1916, 1920-1922, 1930-1931.

vendndodhjen e forcave serbe.¹⁶²² Gjatë marrjes në pyetje, Magjupi rrahu një prej romëve dhe serbin me një shkop të trashë, meqenëse ata refuzonin të flisnin.¹⁶²³ Sipas Dëshmitarit 81, më pas në keqtrajtim morën pjesë Togeri, Magjupi, Idriz Gashi dhe të tjerë.¹⁶²⁴ Togeri tha: “ja çfarë u bëjmë spiunëve dhe armiqve”, nxori një thikë dhe i preu veshin njërit prej djemve romë.¹⁶²⁵ Gjithashtu Dëshmitari 81 dëshmoi se pasi Togeri i preu veshin djalit rom, ai e shpoi me thikë disa herë në pjesën e sipërme të trupit dhe djali ra në dysheme.¹⁶²⁶ Dëshmitari 81 dëshmoi se në kohën që Togeri i preu veshin djalit rom, Magjupi po rrihte me shkop të trashë djalin tjetër rom dhe të riun serb.¹⁶²⁷ Më tej dëshmitari shtoi se Magjupi po rrihte të dy romët.¹⁶²⁸ Kur përfaqësuesi i Prokurorisë e pyeti nëse Togeri i bëri gjë tjetër djalit serb përveç goditjeve me grusht, Dëshmitari 81 u përgjigj se Togeri “bëri të njëjtën gjë me thikë” që kishte bërë edhe me një nga romët, duke qartësuar se Togeri nxori thikën, i preu veshin serbit dhe e shpoi me thikë pesë ose gjashtë herë në pjesën e përparme të trupit.¹⁶²⁹

456. Në dëshminë e tij kryesore Dëshmitari 81 gjithashtu dëshmoi se pasi tre të rinjtë kishin rënë në dysheme, Ramush Haradinaj tha: “çojini te bacë Ademi në Drenicë”, që donte të thoshte, vritini.¹⁶³⁰ Ushtarët e atjeshëm, çdo dy prej të cilëve bartnin një të burgosur, i çuan dy djemtë romë dhe të riun serb në një shtëpi në Jabllanicë, rreth 100 metra më tej, e cila sikurse dëshmitari mësoi më vonë, shërbente si spital.¹⁶³¹ Dëshmitari 81 tha se ai dhe shokët e tij u udhëzuan t’i shoqëronin ushtarët vendës që bartnin tre të rinjtë.¹⁶³² Tre të rinjtë ishin ende gjallë kur arritën në shtëpi.¹⁶³³ Gjithashtu Dëshmitari 81 dëshmoi se rreth 15 minuta më vonë, ushtarët vendës bartën tre të rinjtë me vig, të cilët nuk ishin më të gjallë.¹⁶³⁴ Tre ushtarët vendës që bartnin kufomat e tre të rinjve dhe Dëshmitari 81 dhe shokët e tij morën rrugën nga Jabllanica për në liqenin e Radoniqit dhe arritën atje rreth një orë e gjysmë deri në dy orë më vonë,¹⁶³⁵ duke iu shmangur rrugëve kryesore dhe kaluan përmes fushave dhe pyjeve dhe herë pas herë bënë pushime të shkurtra.¹⁶³⁶ Dëshmitari 81

¹⁶²² Dëshmitari 81, T. 1920-1921.

¹⁶²³ Dëshmitari 81, T. 1919-1920.

¹⁶²⁴ Dëshmitari 81, T. 1931, 1933.

¹⁶²⁵ Dëshmitari 81, T. 1919, 1923.

¹⁶²⁶ Dëshmitari 81, T. 1923.

¹⁶²⁷ Dëshmitari 81, T. 1920, 1923, 1930.

¹⁶²⁸ Dëshmitari 81, T. 1930.

¹⁶²⁹ Dëshmitari 81, T. 1934-1936.

¹⁶³⁰ Dëshmitari 81, T. 1939-1940.

¹⁶³¹ Dëshmitari 81, T. 1940-1941, 1944.

¹⁶³² Dëshmitari 81, T. 1940.

¹⁶³³ Dëshmitari 81, T. 1944.

¹⁶³⁴ Dëshmitari 81, T. 1944, 1946.

¹⁶³⁵ Dëshmitari 81, T. 1946-1947.

¹⁶³⁶ Dëshmitari 81, T. 1947-1948.

dëshmoi se grupi arriti në një kanal betoni dhe ecën përgjatë një rruge të pashtuar për në liqen dhe kur arritën në liqen, ushtarët vendës “i hodhën” kufomat “në një anë të liqenit”.¹⁶³⁷

457. Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja doli se në një intervistë të mëparshme me Prokurorinë, Dëshmitari 81 kishte deklaruar se Lahi Brahimaj me pseudonimin Magjupi, ishte personi që i preu veshin njërit prej të burgosurve romë.¹⁶³⁸ Ditën e nesërme të kësaj interviste, Dëshmitari 81 deklaroi se jo Magjupi, por Togeri i kishte prerë veshin, jo djalit rom, por të burgosurit serb.¹⁶³⁹ Në dëshminë e tij kryesore, Dëshmitari 81 dëshmoi se Togeri ishte personi që i preu veshin njërit prej djemve romë.¹⁶⁴⁰ Kur u pyet nga Prokuroria, Dëshmitari 81 shtoi se Togeri i preu veshin edhe djalit serb.¹⁶⁴¹ Del se në asnjë nga deklaratat që Dëshmitari 81 i kishte dhënë Prokurorisë, ai nuk kishte përmendur se gjatë incidentit iu pre veshi djalit rom dhe të riut serb.¹⁶⁴² Përkundrazi, në deklaratën për Prokurorinë me datë 7 dhe 8 dhjetor 2010, Dëshmitari 81 deklaroi se deklarata e tij e mëhershme për Prokurorinë se Togeri preu veshin e njërit prej djemve romë, ishte e gabuar.¹⁶⁴³

458. Gjithashtu gjatë një interviste me Prokurorinë, Dëshmitari 81 deklaroi se Lahi Brahimaj me pseudonimin Magjupi e goditi djalin serb në sy me shkop të trashë dhe pas kësaj ia nxori syrin.¹⁶⁴⁴ Më pas, Dëshmitari 81 e ndryshoi dëshminë dhe tha se Togeri ia nxori syrin djalit, jo Magjupi.¹⁶⁴⁵ Në dëshminë e tij kryesore, Dëshmitari 81 nuk përmendi që ndonjërit prej të burgosurve i nxorën syrin. Kur u pyet nga Mbrojtja, Dëshmitari 81 deklaroi se djalit serb ia nxori syrin Magjupi.¹⁶⁴⁶

459. Dëshmitari 81 e ndryshoi dëshminë e tij edhe më tej në aspekte thelbësore. Ndërsa në një intervistë me Prokurorinë, Dëshmitari 81 kishte deklaruar se pas rrahjeve, të tre të burgosurit u çuan në një vend jashtë Jabllanicës, afër një liqeni, ku u lanë të gjallë, të nesërmen e intervistës me Prokurorinë, ai deklaroi se fillimisht tre të burgosurit u çuan në spital në Jabllanicë dhe që andej kufomat e tyre u çuan në vendin e lartpërmendur afër liqenit, më vonë gjatë asaj dite.¹⁶⁴⁷ Shpjegimet e Dëshmitarit 81 mbi arsyet e ndryshimit të dëshmisë së tij në aspekte të tilla thelbësore ishin se përkthyesit nuk ishin të saktë,¹⁶⁴⁸ se ai kishte frikë,¹⁶⁴⁹ dhe se më vonë gjatë kësaj interviste

¹⁶³⁷ Dëshmitari 81, T. 1947-1949.

¹⁶³⁸ Dëshmitari 81, T. 2038-2041; Prova materiale D201, para 6-7.

¹⁶³⁹ Dëshmitari 81, T. 2038-2040, 2047-2048; Prova materiale D201, para. 8.

¹⁶⁴⁰ Dëshmitari 81, T. 1919, 1923. *Shih* gjithashtu më sipër, para. 455.

¹⁶⁴¹ Dëshmitari 81, T. 1934-1936. *Shih* gjithashtu më sipër, para. 455.

¹⁶⁴² *Shih* Prova materiale D201.

¹⁶⁴³ Prova materiale D201, para. 11.

¹⁶⁴⁴ Dëshmitari 81, T. 2042; Prova materiale D201, para. 7.

¹⁶⁴⁵ Dëshmitari 81, T. 2042, 2044-2045; Prova materiale D201, para. 12.

¹⁶⁴⁶ Dëshmitari 81, T. 2044-2045.

¹⁶⁴⁷ Dëshmitari 81, T. 2066-2068; Prova materiale D201, para 16-17.

¹⁶⁴⁸ Dëshmitari 81, T. 2033-2034.

me Prokurorinë u ndje më i lirshëm për shkak të ndryshimit të vendit dhe të personave të pranishëm gjatë intervistës.¹⁶⁵⁰ Prokuroria nxori një deklaratë ku tregojë se nuk kishte asnjë ndryshim rrethanash të sugjeruara nga Dëshmitari 81 në shpjegimin e tij të fundit.¹⁶⁵¹ Dhoma gjykon se shpjegimet e dhëna nga dëshmitari për ndryshimet në dëshminë e tij janë jobindëse dhe nuk konfirmohen nga ngjarjet para intervistës së Dëshmitarit 81 me Prokurorinë. Veçanërisht, Dhoma thekson se Dëshmitari 81 dha një sërë intervistash me personat e pranishëm gjatë intervistës së tij me Prokurorinë, dhe se deklaroi se u besonte atyre.¹⁶⁵²

460. Edhe aspekte të tjera të dëshmisë së Dëshmitarit 81 nuk duken të besueshme. Pa pretenduar se kjo përbën një analizë të plotë të mospërputhjeve në dëshminë e Dëshmitarit 81, Dhoma konstaton se ai dëshmoi se bartja e tre njerëzve në vig prej ushtarëve, nga Jabllanica në kanalin e liqenit të Radoniqit ku edhe i lanë kufomat, zgjati një orë e gjysmë deri në dy orë duke iu shmangur rrugëve kryesore dhe duke ecur përmes fushave dhe pyjeve me pushime të shkurtra të herëpashershme. Mirëpo dëshmitë e tjera para Dhomës tregojnë se largësia midis këtyre dy vendeve është afërsisht tetë ose nëntë kilometra përmes një terreni kodrinor,¹⁶⁵³ faktor që vë në dyshim saktësinë e dëshmisë së Dëshmitarit 81 në lidhje me këtë pikë.

461. Dëshmitari 81 dëshmoi se më 1998 ai ishte anëtar i UÇK-së.¹⁶⁵⁴ Ai dëshmoi se ishte anëtar i një njësie të njohur me emrin “Tigrat e Zinj”,¹⁶⁵⁵ se Idriz Balaj ishte komandant i njësisë së quajtur “Tigrat e Zinj”,¹⁶⁵⁶ mirëpo se njësia e dëshmitarit ishte e ndryshme nga njësia e komanduar prej Idriz Balajt.¹⁶⁵⁷ Dëshmitari 81 më pas dëshmoi se “kishte bërë një gabim” dhe “qartësoi” se njësia e tij quhej “Shqiponjat e Zeza” dhe se njësia e komanduar nga Idriz Balaj quhej “Tigrat e Zinj”.¹⁶⁵⁸ Gjithashtu ai e korrigjoi vetveten gjatë pyetjeve nga Mbrojtja dhe deklaroi se njësia e Idriz Balajt quhej “Shqiponjat e Zeza”, duke shpjeguar se gabimet e tij ishin rezultat i përkthimit të gabuar dhe “frikës nga prania në një ambient të madh”.¹⁶⁵⁹ Ai deklaroi se njësia e tij hynte në veprim “kudo” ku ishte e nevojshme.¹⁶⁶⁰ Kur u pyet mbi aksionet ushtarake në të cilat kishte marrë pjesë njësia e

¹⁶⁴⁹ Dëshmitari 81, T. 2057, 2067, 2069.

¹⁶⁵⁰ Dëshmitari 81, T. 2069, 2078-2080.

¹⁶⁵¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, seanca gjyqësore e 24 nëntorit 2011, T. 2099-2100.

¹⁶⁵² *Shih* Dëshmitari 81, T. 2090-2095.

¹⁶⁵³ Prova materiale P87; D202.

¹⁶⁵⁴ Dëshmitari 81, T. 1880-1881.

¹⁶⁵⁵ Dëshmitari 81, T. 1881, 1954.

¹⁶⁵⁶ Dëshmitari 81, T. 1954.

¹⁶⁵⁷ Dëshmitari 81, T. 1954-1955.

¹⁶⁵⁸ Dëshmitari 81, T. 1957.

¹⁶⁵⁹ Dëshmitari 81, T. 1995-1996.

¹⁶⁶⁰ Dëshmitari 81, T. 1991-1992, 2013.

tij gjatë 14 muajve që dëshmitari tha se kishte qenë me këtë njësi në Kosovë, Dëshmitari 81 tha “Tërstenik, Graboc dhe Vërboc” mirëpo nuk ishte në gjendje të jepte hollësi për aksione konkrete ushtarake të kësaj njësie për atë periudhë.¹⁶⁶¹ Ai nuk pranoi të jepte emrin e ndokujt që mund të konfirmonte se kishte qenë pjesëtar i kësaj njësie, sikurse tha për arsye sigurie.¹⁶⁶² Ai dëshmoi se me të udhëtonin gjashtë njerëz të pranishëm në ngjarjet që përshkroi. Dëshmitari 81 nuk pranoi të jepte emrat e këtyre personave për të konfirmuar dëshminë e tij para Dhomës, sërish, sikundër pretendoi, për arsye sigurie.¹⁶⁶³ Dëshmitari 81 mohoi të kishte dijeni për fajësime penale që implikonin atë vetë, veç “kundërvajtjeve në komunikacionin rrugor”.¹⁶⁶⁴ Provat e tjera të pranuar në këtë proces tregojnë se ai është shpallur fajtor për akuza të rreme në polici,¹⁶⁶⁵ për përdorimin e paligjshëm të një automjeti që i përkiste një individi tjetër,¹⁶⁶⁶ për pengimin e një zyrtari në ushtrimin e detyrës së tij,¹⁶⁶⁷ dhe për dhunë në shtëpi.¹⁶⁶⁸ Mohimi prej dëshmitarit ndikon vetëm në besueshmërinë e tij.

462. Gjatë argumenteve përmbyllëse, Prokuroria parashtrroi se nuk synonte të mbështetej në dëshminë e Dëshmitarit 81 dhe e ftoi Dhomën që mos ta merrte në konsideratë dhe ta trajtonte jo si pjesë të dokumentacionit të procesit gjyqësor.¹⁶⁶⁹ Pa bërë komente të tjera, Dhoma sjell në vëmendje debatet e konsiderueshme juridike dhe kohën e shpenzuar nga Dhoma në fazën paragjyqësore dhe gjyqësore të procesit lidhur me çështjen e nxjerrjes së materialit në lidhje me Dëshmitarin 81, që vijuan deri pak para fillimit të dhënies së dëshmisë nga Dëshmitari 81 më 21 nëntor 2011.¹⁶⁷⁰ Dhoma nuk e pranon kërkesën e Prokurorisë që dëshmia e tij të mos konsiderohet pjesë e dokumentacionit të procesit.

¹⁶⁶¹ Dëshmitari 81, T. 2021-2022.

¹⁶⁶² Dëshmitari 81, T. 2015-2018.

¹⁶⁶³ Dëshmitari 81, T. 1884-1892, 1912.

¹⁶⁶⁴ Dëshmitari 81, T. 2000.

¹⁶⁶⁵ Prova materiales D198; D200; Dëshmitari 81, T. 2004-2011.

¹⁶⁶⁶ Prova materiale D205.

¹⁶⁶⁷ Prova materiale D206; Dëshmitari 81, T. 2161-2170.

¹⁶⁶⁸ Prova materiales D217; D218.

¹⁶⁶⁹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Argumentet përmbyllëse, 25 qershor 2012, T. 2753.

¹⁶⁷⁰ *Shih Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Haradinajt mbi Nxjerrjen e Materialit Shfajësues në lidhje me Dëshmitarin 81, lëshuar konfidencialisht më 18 nëntor 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Kërkesën e Balajt për Seancë lidhur me Provat, lëshuar konfidencialisht më 18 nëntor 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Prokurorisë për Mosnxjerrje Materiali sipas Rregullës 66(C) dhe 68(IV), lëshuar konfidencialisht dhe *ex parte* më 18 korrik 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për Nxjerrje Materiali Sipas Rregullës 66(C) dhe 68(IV), lëshuar konfidencialisht dhe *ex parte* më 17 gusht 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda

463. Dhoma konkludon se dëshmia e Dëshmitarit 81 në tërësi nuk është e besueshme.

(c) Përfundim

464. Prokuroria nuk paraqiti dëshmi të besueshme lidhur me ngjarjet që pretendohet të kenë ndodhur pas zhdukjes së Agron Berishës, Burim Bejtës, dhe Ivan Zariqit. Për arsytet e lartpërmendura, Dhoma gjykon se ngjarjet e pretenduara në Pikën 1 nuk janë vërtetuar.

3. Pika 2

(a) Akuzat në Aktakuzë

465. Në Aktakuzë pretendohet se më 25 maj 1998 ose rreth kësaj date, ushtarët e UÇK-së rrëmbyen dy burra romë/egjiptianë, Ukë Rexhepajn dhe dhëndrin e tij, Nesret Alijaj, nga fshati Grabanicë dhe i akuzuan si bashkëpunëtorë të serbëve. Më tej pretendohet se dy burrat u çuan në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku Lahi Brahimaj urdhëroi ekzekutimin e tyre dhe se ata u vranë gjatë kohës që mbaheshin nga UÇK-ja. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, Aktakuza i ngarkon tre të Akuzuarit me një pikë për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, konkretisht vrasje dhe trajtim mizor (Pika 2), për pjesëmarrjen e tyre të pretenduar në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të pretenduar në Aktakuzë. Lahi Brahimaj akuzohet ndryshe edhe mbi bazën e formave të tjera të përgjegjësisë penale individuale sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit.¹⁶⁷¹

(b) Përfundime

466. Në maj 1998, Ukë Rexhepaj dhe familja e tij jetonin në fshatin Zajm, në komunën e Klinës.¹⁶⁷² Ata ishin ashkalinj.¹⁶⁷³ Dhoma konkludoi se më 20 maj 1998, rreth orës 10:00, Ukë Rexhepaj dhe dhëndëri i tij Nesret Alijaj,¹⁶⁷⁴ u nisën prej Zajmit për në zyrën e postës në Klinë, për

Nr. IT-04-84bis-T, Urdhër për Ndryshimin e Statusit të dy Vendimeve të Dhomës Gjyqësore dhe Dorëzimin e tyre të Akuzuarit, lëshuar konfidencialisht më 31 gusht 2011.

¹⁶⁷¹ Aktakuza, para. 50.

¹⁶⁷² Dëshmitari 79, Prova materiale P1, para 1, 3.

¹⁶⁷³ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8271; Dëshmitari 79, Prova materiale P1, f. 1; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, f. 1.

¹⁶⁷⁴ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8273. Dhoma thekson se në disa dëshmi Nesret Alijaj përmendet si “kunati” i Ukë Rexhepajt, (Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 8; Dëshmitari 79, Prova materiale P1, para. 3) mirëpo duke marrë parasysh shpjegimin e Dëshmitarit 54 në procesin e parë *Haradinaj* (Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8273), Dhoma pranon se Nesret Alijaj ishte dhëndëri i Ukë Rexhepajt.

të marrë para që një i afërm i kishte dërguar Ukë Rexhepajt.¹⁶⁷⁵ Ukë Rexhepaj kishte veshur një xhaketë me vija, pantallona me katrorë në ngjyrë kafe, këpucë në ngjyrë kafe dhe çorape të zeza.¹⁶⁷⁶ Më vonë gjatë asaj dite ata u kthyen nga posta dhe morën djalin e Ukë Rexhepajt që ishte 5 vjeç e pesë muaj, dhe u nisën drejt Dollovës në komunën e Klinës për të ushqyer bagëtinë.¹⁶⁷⁷ Ata shkuan me biçikletë.¹⁶⁷⁸ Pasi kishin bërë gjysmën e rrugëtimit, diku në rrugën midis Grabanicës dhe Dollovës, ata u ndaluan nga dy burra të armatosur me mitraloza të cilët u thanë të mos shkonin më tej ndryshe do të vriteshin.¹⁶⁷⁹ Personat ishin të veshur me rroba ushtarake kamuflimi në të gjelbër të mbyllët dhe flisnin shqip.¹⁶⁸⁰ Ukë Rexhepajn dhe Nesret Alijajn i kontrolluan dhe ua morën sendet personale dhe biçikletat.¹⁶⁸¹ Atyre ua lidhën duart dhe sytë dhe i futën në një makinë që sapo kishte arritur.¹⁶⁸² Nga pylli doli një njeri dhe dy burrat e armatosur i thanë të merrte djalin.¹⁶⁸³ Makina ku ndodheshin Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alijaj u nis.¹⁶⁸⁴ Djalin më së fundi ia kthyen familjes.¹⁶⁸⁵

467. Ukë Rexhepaj ishte mekanik automjetesh dhe nuk ishte pjesëtar i asnjë grupi të armatosur.¹⁶⁸⁶ Ditën e rrëmbimit ai kishte me vete një shumë prej 200 markash gjermane.¹⁶⁸⁷ Edhe Nesret Alijaj, në kohën që u rrëmbye, nuk ishte pjesëtar i asnjë grupi të armatosur.¹⁶⁸⁸ Një farë kohe para këtyre ngjarjeve, një prej djemve të Ukë Rexhepajt kishte hyrë në UJ për shërbimin ushtarak. Ukë Rexhepaj organizoi një gosti përcjelljeje në të cilën ishte i pranishëm edhe një anëtar

¹⁶⁷⁵ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8273-8274, 8277; Dëshmitari 79, Prova materiale P1, para. 3; Dëshmitari 79, Prova materiale P284, para. 4; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para 17-18.

¹⁶⁷⁶ Dëshmitari 79, Prova materiale P284, para. 4.

¹⁶⁷⁷ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8271, 8274-8275, 8277; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 11; Dëshmitari 78, T. 836.

¹⁶⁷⁸ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8275, 8277.

¹⁶⁷⁹ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8275-8276; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 11.

¹⁶⁸⁰ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8276; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 11.

¹⁶⁸¹ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8275.

¹⁶⁸² Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8275-8276; Dëshmitari 79, Prova materiale P1, para. 7.

¹⁶⁸³ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8275, 8277-8278.

¹⁶⁸⁴ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8276; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 12.

¹⁶⁸⁵ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*). T. 8275, 8280-8281; Dëshmitari 79, Prova materiale P1, para. 8; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para 12-13.

¹⁶⁸⁶ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8274. *Shih edhe* Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 14.

¹⁶⁸⁷ Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para 17-18.

¹⁶⁸⁸ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 8274; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 14.

i MPB-së. Askujt prej fqinjëve serbë ose shqiptarë kosovarë të Ukë Rexhepajt nuk i pëlqeu fakti që djali i tij shkoi në UJ.¹⁶⁸⁹

468. Dy ose tre muaj pas zhdukjes së Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt, një serb i Kosovës nga fshati Dollovë u tha familjarëve të Ukë Rexhepajt se kishte parë Ukë Rexhepajn dhe Nesret Alijajn në fshatin Gllogjan, duke ndjekur dhe vrarë lopë,¹⁶⁹⁰ ndërkohë që vëzhgonin fshatin me dylbi.¹⁶⁹¹ Ky rrëfim nuk konfirmohet dhe u kundërshtua nga një dëshmitar i cili mendonte se Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alijaj do të ishin kthyer po të kishin pasur mundësi, sepse të dy burrat kishin familje dhe Nesret Alijaj kishte një foshnjë të sapolindur dhe një fëmijë njëvjeçar.¹⁶⁹² Dhoma nuk e gjykon të besueshëm këtë identifikim.

469. Në një ditë të papërcaktuar pas 20 majit 1998, zhdukja e Ukë Rexhepajt iu raportua KNKK-së në Klinë.¹⁶⁹³ Në një raport të KNKK-së lëshuar më 27 shkurt 2001 konfirmohet se më 18 shkurt 1999 ishte paraqitur një kërkesë për gjetjen e Ukë Rexhepajt dhe që prej datës së nxjerrjes së raportit, KNKK-ka e konsideronte çështjen ende të hapur.¹⁶⁹⁴ Zhdukja e Ukë Rexhepajt u kallëzua edhe në policinë e Klinës.¹⁶⁹⁵ Një artikull i botuar në gazetën “Blic” më 28 korrik 1998 i përmendte Ukë Rexhepajn dhe Nesret Alijajn midis 245 personave të zhdukur në Kosovë.¹⁶⁹⁶

470. Në vitin 2003, një i afërm i Ukë Rexhepajt ishte i pranishëm në ekspozimin e sendeve personale të personave të zhdukur në Kosovë, organizuar nga KNKK-ja në Zveçan, në Kosovën veriore. Ai dëshmoi se ishte në gjendje të identifikonte se disa prej rrobave të ekspozuara ishin të Ukë Rexhepajt, për disa prej të cilave ai mendonte se ia kishte dhënë ai Ukë Rexhepajt.¹⁶⁹⁷ Ekspozimi i sendeve u organizua rreth pesë vjet pas zhdukjes së Ukë Rexhepajt dhe nuk ka prova mbi gjendjen e këtyre teshave. Si provë është një fotografi bardhezi ku shihen një palë pantallona dhe një këmishë.¹⁶⁹⁸ Në këtë fotografi nuk shihen hollësi të tjera, trajtat nuk janë të qarta, nuk shihen ngjyra apo nuanca ngjyrash. Për më tepër, nuk ka prova lidhur me vendin, kohën dhe rrethanat e gjetjes së këtyre sendeve ose kush i zbuloi. Në këto rrethana, Dhoma nuk pranon se sendet e identifikuar më 2003 janë të Ukë Rexhepajt.

¹⁶⁸⁹ Dëshmitari 79, Prova materiale P1, para. 13.

¹⁶⁹⁰ Dëshmitari 79, Prova materiale P284, para. 10; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 21-22.

¹⁶⁹¹ Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 22.

¹⁶⁹² Dëshmitari 79, Prova materiale P1, para. 11; Dëshmitari 79, Prova materiale P284, para. 11.

¹⁶⁹³ Dëshmitari 79, Prova materiale P284, para. 15; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 19.

¹⁶⁹⁴ Dëshmitari 79, Prova materiale P1, f. 13 në dokumentacionin gjyqësor elektronik.

¹⁶⁹⁵ Dëshmitari 79, Prova materiale P284, para. 15; Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 19.

¹⁶⁹⁶ Dëshmitari 79, Prova materiale P1, f. 9 (në dokumentacionin gjyqësor elektronik).

¹⁶⁹⁷ Dëshmitari 78, Prova materiale P286, para. 22-25; Dëshmitari 78, T. 840-841.

¹⁶⁹⁸ Dëshmitari 78, Prova materiale P286, f. 10.

471. Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alijaj u panë për herë të fundit nga një dëshmitar në këtë proces, më 20 maj 1998.¹⁶⁹⁹

472. Prokuroria nuk paraqiti dëshmi të drejtpërdrejta lidhur me fatin e Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt pas rrëmbimit të tyre në rrugën Grabanicë—Dollovë. Në Dosjen e vetë Përfundimtare, Prokuroria citon dëshminë e Shefqet Kabashit në procesin *Limaj*.¹⁷⁰⁰ Sipas kësaj dëshmie në mëngjesin e 21 majit 1998, Shefqet Kabashi pa dy romë që kishin lidhje dhëndër-vjehërr me njëritjetrin në Jabllanicë. Në mbrëmjen e po asaj dite ai i pa ata në “stallën” e objektit të UÇK-së në Jabllanicë, të lidhur me tel. Ai dëshmoi se dëgjoi “Lahinë, liderin tim të parë” duke i thënë një personi tjetër se do t’i dërgonte në Drenicë, që do të thoshte se do të ekzekutoheshin.¹⁷⁰¹ Veç përmendjes së një “vjuhëri” dhe “dhëndëri” rom, Kabashi nuk i përshkroi dy personat për të cilët tha se i kishte parë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.

473. Dhoma citon “Vendim mbi Mocionin e Përbashkët Gojor të Mbrojtjes sipas Rregullës 89(D)” nxjerrë më 28 shtator 2011, ku konkludoi se nuk mund t’i atribuonte ndonjëfarë vlere dëshmisë së Shefqet Kabashit në procesin *Limaj* në qoftë se nuk konfirmohej nga dëshmi të besueshme në këtë proces.¹⁷⁰² Dhoma arriti në këtë konkluzion sepse dëshmia e Shefqet Kabashit në procesin *Limaj* kishte të bënte me aspekte me rëndësi kyçe për Prokurorinë në këtë çështje dhe Shefqet Kabashi nuk u pyet nga Mbrojtja në procesin *Limaj* për asnjë aspekt që ka lidhje me procesin aktual.¹⁷⁰³ Prokuroria argumenton se dëshmia e Shefqet Kabashit diskutuar në paragrafin e mësipërm, konfirmohet nga dëshmitë e të afërmve të Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt dhe raportet e KNKK-së se të dy burrat konsiderohen ende të zhdukur.¹⁷⁰⁴ Dhoma nuk e pranon këtë argument. Shefqet Kabashi dëshmoi për ngjarje mbi një vjehërr dhe një dhëndër, identitetet e të cilëve nuk u provuan. Dëshmitë e të afërmve të Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt ofrojnë të dhëna për të vërtetuar çfarë ndodhi me Ukë Rexhepajn dhe Nesret Alijajn para se të shiheshin për herë të fundit në rrugën Grabanicë—Dollovë. Megjithëse bazuar në këto dëshmi dhe në raportet e KNKK-së Dhoma pranon se Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alijaj ende nuk janë gjetur dhe se ka të ngjarë të jenë të vdekur, dëshmia e Shefqet Kabashit edhe sikur të pranohet se bën fjalë për këta dy individë, gjë që Dhoma nuk e pranon, do të përbënte vetëm një prej shumë hamendësimeve mbi fatin e tyre. Dy

¹⁶⁹⁹ Dëshmitari 54, Prova materiale P105 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T 8277; Prova materiale P427, f. 3, 6.

¹⁷⁰⁰ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 117-118.

¹⁷⁰¹ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4252-4253.

¹⁷⁰² *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Përbashkët Gojor të Mbrojtjes sipas Rregullës 89(D) nxjerrë më 28 shtator 2011 (“Vendim i 28 shtatorit 2011”), para. 13.

¹⁷⁰³ Vendim i 28 shtatorit 2011, para. 13.

¹⁷⁰⁴ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 118.

burrat mund të jenë liruar, mund të jenë zhvendosur në një vend tjetër ose mund të jenë arratisur. Dëshmia e lartpërmendur e Shefqet Kabashit nuk konfirmohet nga dëshmi të tjera në këtë proces dhe Dhoma nuk e pranon.

(c) Përfundim

474. Dhoma arrin në përfundimin se ngjarjet e pretenduara në Pikën 2 nuk janë vërtetuar.

4. Pika 3

(a) Akuzat në Aktakuzë

475. Në Aktakuzë pretendohet se më 13 qershor 1998, ose rreth kësaj date, Dëshmitari 6, shqiptar kosovar i besimit katolik, u ndalua nga ushtarë të UÇK-së në rrugën midis Klinës dhe Gjakovës dhe u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku, me të mbërritur atje, u rrah keqazi nga ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj. Gjithashtu pretendohet se nga 13 qershori deri afërsisht më 25 qershor 1998 kur u lirua nga Nazmi Brahimaj, Dëshmitari 6 u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe u rrah sistematikisht nga Lahi Brahimaj, Nazmi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së derisa thuhet humbi ndjenjat, ndër të tjera me shkopinj të trashë.¹⁷⁰⁵ Këto pretendime përbëjnë një pikë për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, konkretisht trajtim mizor dhe torturim, (Pika 3), për të cilat Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj akuzohen mbi bazën e pretendimit për pjesëmarrjen e tyre në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të pretenduar në Aktakuzë.

476. Lahi Brahimaj nuk akuzohet në Pikën 3. Dhoma Gjyqësore në procesin e parë *Haradinaj* konkludoi se të njëjtat pretendime mbi të cilat bazoheshin Pika 27 dhe Pika 28 në aktakuzën e parë *Haradinaj* ishin vërtetuar dhe e shpalli Lahi Brahimajn fajtor në lidhje me Pikën 28.¹⁷⁰⁶ Ky përfundim u konfirmua edhe në apel.¹⁷⁰⁷

(b) Përfundime

477. Më 13 qershor 1998, rreth orës 11:30, Dëshmitari 6, bujk, së bashku me familjen e tij dolën nga shtëpia.¹⁷⁰⁸ Ata udhëtonin me automjetin Mercedes Benc të dëshmitarit.¹⁷⁰⁹ Ata morën rrugën Gjakovë—Klinë në drejtim të Klinës.¹⁷¹⁰ Diku afër Grabanicës¹⁷¹¹ ose afër Dollovës¹⁷¹² në

¹⁷⁰⁵ Aktakuza, para. 51.

¹⁷⁰⁶ Aktgjykimi *Haradinaj*, para. 395, 504.

¹⁷⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj*, para. 51, 165, 191.

¹⁷⁰⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5168-5170, 5386, 5352.

¹⁷⁰⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5170.

¹⁷¹⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5170-5171, 5188; Prova materiale P87.

komunën e Klinës, ata u ndaluan në një postbllok policor ose ushtarak serb.¹⁷¹³ Policia serbe informoi dëshmitarin se ai dhe familja e tij nuk mund të shkonin më tej.¹⁷¹⁴ Ata morën rrugën kryesore Gjakovë—Klinë dhe u kthyen në drejtim të Gjakovës.¹⁷¹⁵

478. Gjatë rrugës së kthimit, Dëshmitari 6 dhe familja e tij kaluan përmes një vendi me emrin Guri i Zi ose Volljakë në komunën e Klinës.¹⁷¹⁶ Për shkak të rrugës së keqe, makina shkonte shumë ngadalë, rreth 10 kilometra në orë. Rreth orës 13:00,¹⁷¹⁷ Dëshmitari 6 dhe familja e tij u ndaluan nga 10-15 ushtarë.¹⁷¹⁸ Dëshmitari mendonte se ishin pjesëtarë të UÇK-së.¹⁷¹⁹ Ata ishin të armatosur. Disa mbanin veshur uniforma kamuflimi, disa kishin veshje civile.¹⁷²⁰ Në veshjen e tyre nuk shiheshin emblema apo shenja.¹⁷²¹ Dëshmitari 6 nuk njohu njeri, mirëpo bashkëshortja e tij mundi të njihje një ushtar.¹⁷²² Ushtarët kontrolluan dokumentet e Dëshmitarit 6 dhe gjithashtu kontrolluan atë vetë dhe makinën e tij. Ata gjetën një pistoletë,¹⁷²³ të cilën e konfiskuan, dhe morën dokumentet e dëshmitarit.¹⁷²⁴ Gjithashtu gjetën një fotografi të Dëshmitarit 6 me një shok të tij, i cili ishte polic në pension, me uniformë.¹⁷²⁵

¹⁷¹¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5171.

¹⁷¹² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5189; Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5173; Dëshmitari 23, Prova materiale P98 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10539. Dollova është jashtë rrugës kryesore Gjakovë—Klinë, rreth tre kilometra nga Klina, Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5173, 5189; Prova materiale P87.

¹⁷¹³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5169, 5171, 5189; Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5173; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10539.

¹⁷¹⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5171; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10539.

¹⁷¹⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5171, 5173-5174, 5190-5191.

¹⁷¹⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5174, 5191, 5194; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10528; Dëshmitari 23, Prova materiale P99, f 2-3. Dhoma thekson se shprehja “Guri i Zi” në anglisht përkthehet “Black Stone”.

¹⁷¹⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5171, 5293-5294.

¹⁷¹⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5174, 5190-5194; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10528.

¹⁷¹⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5174.

¹⁷²⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5193-5194; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10539-10540.

¹⁷²¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5193-5194.

¹⁷²² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5194-5195.

¹⁷²³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5194, 5353.

¹⁷²⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5194.

¹⁷²⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5353-5355; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10540.

479. Dëshmitari 6 dhe familja e tij ndenjën brenda makinës, rreth 200 metra larg rrugës, dhe u pyetën afërsisht dy orë për pistoletën dhe fotografinë.¹⁷²⁶ Rreth orës 15:30 ose 16:00, nga rruga kryesore erdhi një Opel Kadet në ngjyrë të kaltër të çelët me targë të Gjakovës. Ndërkohë që Opel Kadeti po afrohej, u hap zjarr.¹⁷²⁷ Një nga ushtarët pyeti Dëshmitarin 6 nëse e njihte makinën dhe ai u përgjigj se nuk e njihte.¹⁷²⁸ Një nga ushtarët në Opel Kadet tha se ata vinin nga Gjakova.¹⁷²⁹ Dëshmitari 6, bashkëshortja e tij dhe një nga fëmijët e tyre si edhe një ushtar hynë në Opel Kadet. Fëmijët e tjerë të Dëshmitarit 6 ndenjën në makinën e tij.¹⁷³⁰ Në secilën prej makinave ishte nga një ushtar.¹⁷³¹ Brenda Opel Kadetit, dëshmitari 6 pa një album me fotografi të një personi të cilin e njihte që më parë. Ai ishte Nenadi, serb ose malazez i Kosovës nga fshati Binxhë afër Klinës, i cili ishte polic i komunikacionit rrugor në Gjakovë.¹⁷³²

480. Afërsisht 20 minuta pas mbërritjes së Opel Kadetit, të dy makinat u nisën drejt Gjakovës.¹⁷³³ Ata kaluan përmes fshatit Mrasor, kapërcyen një urë mbi lumin Drin dhe hynë në fshatin Kralan të komunës së Gjakovës.¹⁷³⁴ Nga Kralani ata u nisën drejt veriut, kaluan pranë fshatit Kpuz në komunën e Klinës dhe shkuan në Napolë¹⁷³⁵ ku familja e Dëshmitarit 6 u lirua.¹⁷³⁶ Dëshmitari 6 u çua drejt fshatit katolik të Gllogjanit në komunën e Pejës,¹⁷³⁷ prej ku kaluan Bistricën dhe shkuan në Jabllanicë.¹⁷³⁸ Makina e Dëshmitarit 6 që drejtohej nga ushtarë, vinte pas.¹⁷³⁹

¹⁷²⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5194-5195, 5316; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10528, 10540.

¹⁷²⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5194-5196, 5316; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10529.

¹⁷²⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5195; Dëshmitari 23, Prova materiale P99, f. 3.

¹⁷²⁹ Dëshmitari 23, Prova materiale P98 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10531.

¹⁷³⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5196; Dëshmitari 23, Prova materiale P99, p. 3; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10531, 10534-10535.

¹⁷³¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5196, 5203-5204.

¹⁷³² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5196-5197.

¹⁷³³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5196, 5203. Dëshmitari 23 dëshmoi se nga mbërritja e makinës së dytë deri te nisja e dy makinave kaluan afërsisht dy orë, Dëshmitari 23, Prova materiale P99, f. 3. Duke shqyrtuar tërë dëshminë e Dëshmitarit 6, Dhoma gjykon se përllogaritja e tij kohore është më e besueshme.

¹⁷³⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5197-5198, 5199; Prova materiale P87.

¹⁷³⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5198-5199; Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5200; Prova materiale P87.

¹⁷³⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5200-5201; Dëshmitari 23, Prova materiale P98 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10534.

¹⁷³⁷ Ky nuk është i njëjti fshat si fshati Gllogjan në komunën e Deçanit.

¹⁷³⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5201; Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5316; Prova materiale P87.

481. Më 13 qershor 1998, dikur para orës 18:00, Dëshmitari 6 arriti në Jabllanicë.¹⁷⁴⁰ Atë e futën përmes një porte në oborrin e një grupi ndërtesash dhe në mes të këtij oborri ishte një shtëpi njëkatëshe me tulla të kuqe. Më vonë Dëshmitari 6 mësoi se shtëpia njëkatëshe kishte katër dhoma dhe një bodrum.¹⁷⁴¹ Më pas ai pa se në bodrum kishte ujë.¹⁷⁴² Menjëherë në të majtë të portës ndodhej një dhomë në anë të rrugës.¹⁷⁴³ Dëshmitari 6 qëndroi afërsisht gjashtë javë në këtë objekt.¹⁷⁴⁴ Dëshmitari e identifikoi oborrin në Provën materiale P89¹⁷⁴⁵ dhe shtëpinë njëkatëshe me tulla të kuqe në Provën materiale P88.¹⁷⁴⁶ Nga këto prova, Dhoma pranon dhe rrjedhimisht konkludon se Dëshmitari 6 u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.

482. Pas mbërritjes, Dëshmitarin 6 e futën në një dhomë në anën e rrugës, majtas përbri portës nga brenda.¹⁷⁴⁷ Ai e kaloi natën e parë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë në këtë dhomë së bashku me Nenadin, policin e komunikacionit rrugor nga Gjakova, të cilin e njihte që më parë dhe fotografitë e të cilit i kishte parë më herët atë ditë në Opel Kadet. Të dy u rrahën në të njëjtën mënyrë. Gjatë natës i lidhën me litar.¹⁷⁴⁸ Dëshmitari 6 u rrah nga disa ushtarë të UÇK-së të cilët vazhdimisht ndërroheshin me njëri-tjetrin. Ata e rrahën me shkopinj të trashë, shkopinj të tjerë ose me grushte derisa u rraskapitën.¹⁷⁴⁹ Në atë kohë Dëshmitari 6 nuk i njihte këta ushtarë, por më pas mësoi se njëri prej tyre ishte Nazmi Brahimaj.¹⁷⁵⁰ Dëshmitari 6 humbi ndjenjat; ai nuk ishte në gjendje të thoshte sa kohë zgjati rrahja e tij ditën e parë.¹⁷⁵¹ Atë e shkelmuan dhe grushtuan në këmbë dhe krahë; ai pësoi thyerje dhe mavijosje në shpinë.¹⁷⁵² Askush nuk i tregoi Dëshmitarit 6

¹⁷³⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5203-5204; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10536-10537.

¹⁷⁴⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5316.

¹⁷⁴¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5204-5206; Prova materiale P88; P89. Dëshmitari 6 nuk u çua asnjëherë në bodrum dhe mësoi për të rreth dy javë para se të lirohej, Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5205-5206.

¹⁷⁴² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5271-5272.

¹⁷⁴³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5212-5214; Prova materiale P89.

¹⁷⁴⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5206.

¹⁷⁴⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5212-5214, 5216; Prova materiale P88; P89. Fotografia e pranuar si Prova materiale P89 është versioni i shënuar i fotografisë së pranuar si Prova materiale P60.

¹⁷⁴⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5205, 5213, 5215-5216; Prova materiale P88; P89.

¹⁷⁴⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5213-5214, 5216, 5316, 5324; Prova materiale P89.

¹⁷⁴⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5210-5211, 5324.

¹⁷⁴⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5207-5210, 5350-5351.

¹⁷⁵⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5207-5209.

¹⁷⁵¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5209-5210, 5350-5351.

¹⁷⁵² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5210.

arsyen e rrahjes.¹⁷⁵³ Gjithsesi ushtarët e akuzuan se rrinte me serbë¹⁷⁵⁴ dhe i thanë se ishte spiun i Serbisë.¹⁷⁵⁵ Pasditen e nesërme Dëshmitarin 6 e çuan në ndërtesën njëkatëshe me tulla të kuqe në oborrin e objektit.¹⁷⁵⁶

483. Dëshmitari 6 ndenji në një nga katër dhomat e ndërtesës njëkatëshe e cila kishte përmasa katër me katër metra.¹⁷⁵⁷ Nga ana e rrugës ishte një dritare e mbyllur me dërrasa.¹⁷⁵⁸ Atje kishte rrymë elektrike, mirëpo nuk kishte llamba.¹⁷⁵⁹ Dyshemeja ishte e drunjte dhe mbi të kishte gjak.¹⁷⁶⁰ Dëshmitari 6 u mbajt në këtë ndërtesë për gjashtë javë.¹⁷⁶¹ Gjatë katër javëve të para të mbajtjes së tij atje, ai nuk mund të dilte jashtë dhomës e cila ishte gjithmonë e kyçur.¹⁷⁶² Më pas, persona të panjohur e nxirrnin nga dhoma për në banjë.¹⁷⁶³ Në tri javët e para të mbajtjes së Dëshmitarit 6 në këtë dhomë nuk kishte “mbulesa”; vetëm dysheme.¹⁷⁶⁴ Dëshmitarit 6 i jepnin ujë, mirëpo ushqimi ishte i pamjaftueshëm.¹⁷⁶⁵ Shpesh ai ishte pa ndjenja dhe nuk ishte në gjendje as të hante, e as të pinte.¹⁷⁶⁶

484. Gjatë katër javëve të para të mbajtjes së Dëshmitarit 6 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, atë e rrahën shumë ushtarë. Lahi Brahimaj, me pseudonimin Magjupi, vëllai i tij Nazmi Brahimaj, dhe kushëriri i tij Hamza Brahimaj ishin nismëtarët e rrahjeve të tij.¹⁷⁶⁷ Lahi Brahimaj, Nazmi Brahimaj, dhe Hamza Brahimaj ishin “vazhdimisht” atje.¹⁷⁶⁸ Nuk kishte ditë që Dëshmitari 6 të mos

¹⁷⁵³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5210, 5351-5352.

¹⁷⁵⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5352.

¹⁷⁵⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5400.

¹⁷⁵⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5204-5205, 5210, 5216, 5316, 5324-5325; Prova materiale P88; P89.

¹⁷⁵⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5216, 5229, 5324.

¹⁷⁵⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5216, 5325, 5401; Prova materiale P88.

¹⁷⁵⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5401.

¹⁷⁶⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5229-5230.

¹⁷⁶¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5205-5206, 5213.

¹⁷⁶² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5217. Dhoma konstaton se gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Dëshmitari 6 deklaroi se nuk e dinte saktësisht sa kohë ndeni në dhomën e kyçur dhe sipas tij zgjati afërsisht dy javë (Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5325). Mirëpo, duke marrë parasysh pjesën tjetër të dëshmisë së Dëshmitarit 6 lidhur me mbajtjen e tij të lartpërmendur dhe dëshmi të tjera përkatëse, Dhoma pranon se ai u mbajt në dhomën e kyçur me çelës, afërsisht katër javë.

¹⁷⁶³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5326.

¹⁷⁶⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5221.

¹⁷⁶⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5327, 5329. Dëshmitari 6 dëshmoi se i dhanë bukë me marmelatë dhe më vonë bukë me grosh, Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5329.

¹⁷⁶⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5326-5327.

¹⁷⁶⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5207-5209, 5218-5220, 5372-5373.

¹⁷⁶⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5218-5219.

e shihte Lahi Brahimajn.¹⁷⁶⁹ Lahi Brahimaj ishte pjesëtar i UÇK-së dhe mbante veshur uniformë kamuflimi ose të zezë.¹⁷⁷⁰ Gjatë katër javëve të para të mbajtjes së Dëshmitarit 6, Hamza Brahimaj ishte i pranishëm thuajse çdo ditë.¹⁷⁷¹ Nazmi Brahimaj ishte gjithashtu vazhdimisht i pranishëm.¹⁷⁷² Ushtarët e tjerë i drejtoheshin me fjalën “zëvendëskomandant”.¹⁷⁷³ Gjatë katër javëve të para të mbajtjes së tij, Dëshmitari 6 i njohu Lahi Brahimajn, Nazmi Brahimajn, dhe Hamza Brahimajn nga pamja sepse ai i shihte këta njerëz në praninë e tij, thuajse çdo ditë.¹⁷⁷⁴ Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ai dëgjoi njerëz të tjerë që i përmendnin këta individë ose u drejtoheshin me emrat e lartpërmendur.¹⁷⁷⁵ Ai nuk i dinte emrat e ushtarëve të tjerë në Jabllanicë.¹⁷⁷⁶

485. Nazmi Brahimaj, Lahi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj hynin në dhomën ku mbahej Dëshmitari 6 dhe qëndronin atje për 5-10 minuta.¹⁷⁷⁷ Zakonisht ata ishin individët që e rrihnin Dëshmitarin 6, mirëpo pati raste që ai nuk rrihej prej tyre.¹⁷⁷⁸ Në rastet kur ushtarë të tjerë rrihnin Dëshmitarin 6, Nazmi Brahimaj, Lahi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj dilnin nga dhoma, mirëpo ndonjëherë Nazmi Brahimaj dhe Lahi Brahimaj qëndronin.¹⁷⁷⁹ Ata të tre nuk vinin njëkohësisht.¹⁷⁸⁰ Nazmi Brahimaj, Lahi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj e rrihnin Dëshmitarin 6 me shkopinj të trashë dhe grushte. Gjatë dy javëve të para të mbajtjes, trupi i Dëshmitarit u ënjt nga rrahjet.¹⁷⁸¹

486. Rreth katër javë pas mbajtjes së tij në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, me fjalë të tjera më 11 korrik 1998 ose rreth kësaj date,¹⁷⁸² ndaluan rrahjet e Dëshmitarit 6.¹⁷⁸³ Ai kishte më shumë liri dhe ndonëse gjatë natës ishte në të njëjtën dhomë, gjatë ditës ai mund të dilte në oborr.¹⁷⁸⁴ Ai filloi punën si pjatarës në kuzhinë.¹⁷⁸⁵ Në këtë periudhë Dëshmitari 6 kishte më shumë kontakt me Gani

¹⁷⁶⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5218.

¹⁷⁷⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5245-5246.

¹⁷⁷¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5219.

¹⁷⁷² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5219-5220.

¹⁷⁷³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5245.

¹⁷⁷⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5209.

¹⁷⁷⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5297.

¹⁷⁷⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5226.

¹⁷⁷⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5219-5220.

¹⁷⁷⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5220.

¹⁷⁷⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5220- 5221.

¹⁷⁸⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5221.

¹⁷⁸¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5220.

¹⁷⁸² Dëshmitari 6 u çua në Jabllanicë më 13 qershor 1998, *shih* më sipër, 481. Dëshmitari 6 qëndroi në objektin e UÇK-së afërsisht gjashtë javë (gjashtë javë pa dy ditë). Ai u largua nga Jabllanica më 25 korrik 1998, Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5206.

¹⁷⁸³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5243, 5259.

¹⁷⁸⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5232, 5241-5243, 5386.

¹⁷⁸⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5244, 5334.

Brahimajn i cili i sillte ushqim gjatë mbajtjes së tij.¹⁷⁸⁶ Gani Brahimaj ishte kushëri i Lahi Brahimajt dhe punonte si gjellëbërës në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁷⁸⁷ Gjatë kësaj periudhe, Dëshmitari 6 e pa Lahi Brahimajn dhe dëgjoi që njerëzit i drejtoheshin me emër ose me pseudonimin “Magjup”.¹⁷⁸⁸

487. Pas rrëmbimit të Dëshmitarit 6, të afërmit e tij filluan t’a kërkonin. Ata zbuluan se ai mbahej në Jabllanicë.¹⁷⁸⁹ Një grup të moshuarish të fshatit të tij shkuan në Jabllanicë për të kërkuar lirim e tij.¹⁷⁹⁰ Ata erdhën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe i thanë rojës te porta kryesore arsyen e ardhjes së tyre.¹⁷⁹¹ Roja u tha se duhej të flisnin me “komandant Magjupin”.¹⁷⁹² Nuk ka shpjegim të mëtjshëm mbi identitetin e “komandant Magjupit”. Pas pak kohe te porta kryesore erdhën dy burra me uniforma të zeza me emblemën e UÇK-së dhe të armatosur me pistoleta. Një nga burrat u prezantua si “komandant Magjupi; të moshuarit u pyetën për arsyen e vizitës.¹⁷⁹³ Kur pjesëtarët e grupit i shpjeguan se kishin ardhur për të kërkuar lirim e Dëshmitarit 6,¹⁷⁹⁴ “Magjupi” u tha se e kishte dënuar dhe se ai duhej ta kryente dënimin pranë UÇK-së.¹⁷⁹⁵ Grupi nuk u lejua ta takonte Dëshmitarin 6, mirëpo “Magjupi” u tha të afërmeve të tij se ata mund ta takonin pas dy javësh.¹⁷⁹⁶ Gjatë kësaj bisede “Magjupi” gjithashtu i pyeti pjesëtarët e grupit pse nuk luftonin dhe debatoi me ta mbi Presidentin e atëhershëm të Kosovës, Ibrahim Rugovën.¹⁷⁹⁷

¹⁷⁸⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5244.

¹⁷⁸⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5218-5219, 5233-5234, 5240, 5244.

¹⁷⁸⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5245.

¹⁷⁸⁹ Dëshmitari 23, Prova materiale P99, f 3-4.

¹⁷⁹⁰ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 5; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 5; Dëshmitari 16, Prova materiale P95, para. 5. Pas lirit të tij nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, Dëshmitari 6 mësoi se bashkëfshatarë të tij kishin shkuar në Jabllanicë dhe kërkuar lirim e tij, Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5252.

¹⁷⁹¹ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 7; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 7; Dëshmitari 16, Prova materiale P95, para 5-8.

¹⁷⁹² Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 7; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 7.

¹⁷⁹³ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 8; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 8.

¹⁷⁹⁴ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 10, 12; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 10, 12.

¹⁷⁹⁵ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 13; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 13. Dëshmitari 16 dha dëshmi të ngjashme, mirëpo nuk qe në gjendje të identifikonte komandantin, as me emër, as me përshkrim, Dëshmitari 17, Prova materiale P95, para 13, 19; Dëshmitari 17, Prova materiale P96, para. 13, 19.

¹⁷⁹⁶ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 14, 16; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 14, 16.

¹⁷⁹⁷ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 15; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 15; Dëshmitari 16, Prova materiale P95, para. 15-18.

488. Gjatë dy javëve vijuese një i afërm i Dëshmitarit 6 e vizitoi Jabllanicën përditë, mirëpo nuk u lejua të hynte në objekt.¹⁷⁹⁸ Kur afërsisht pas dy javësh, sikundër kishte përmendur “Magjupi”, i afërmi u përpoq sërish që të takonte Dëshmitarin 6, ai u lejua të hynte në objekt, mirëpo “Magjupi” nuk e lejoi të takonte Dëshmitarin 6.¹⁷⁹⁹ Në ditët që vijuan, i afërmi i Dëshmitarit 6 arriti të hynte në objekt, por nuk u lejua të takonte Dëshmitarin 6.¹⁸⁰⁰ Pas pak ditësh, Nazmi Brahimaj u tha të afërmve se do të lejoheshin të takonin Dëshmitarin 6. Pak më pas u bë një vizitë familjare.¹⁸⁰¹

489. Dëshmitari 6 dëshmoi se dy javë para lirimit, familja e tij e vizitoi në Jabllanicë.¹⁸⁰² Dëshmitari 6 kishte humbur peshë dhe dukej shumë i dobësuar dhe i tretur.¹⁸⁰³ Takimi zgjati afërsisht dy orë dhe u mbikëqyr nga një apo dy ushtarë të UÇK-së.¹⁸⁰⁴ Gjatë vizitës, një komandant u tha të afërmve se Dëshmitari 6 do të lirohej pas një jave.¹⁸⁰⁵

490. Lirimi ishte me kusht. Në dokument shkruhej se në rast të përsëritjes së gabimeve, Dëshmitari 6 do të përballej me akuza penale.¹⁸⁰⁶ Nazmi Brahimaj i tha Dëshmitarit 6 se kjo do të thoshte se ai duhej të qëndronte brenda shtëpisë së tij dhe të mos lëvizte rreth e rrotull.¹⁸⁰⁷ Dëshmitari 6 mori një dokument të nënshkruar nga Lahi Brahimaj ku informohej se Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit dhe konkretisht shtabi vendor në Jabllanicë, në një mbledhje të mbajtur më 24 korrik 1998, vendosi të konfiskonte Mercedesin dhe revolverin e tij të kalibrit 7.65 mm për

¹⁷⁹⁸ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 18; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 18. *Shih* gjithashtu Dëshmitari 16, Prova materiale P95, para. 18; Dëshmitari 16, Prova materiale P96, para. 18.

¹⁷⁹⁹ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 20-26; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 20-26.

¹⁸⁰⁰ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 27-30; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 27-30.

¹⁸⁰¹ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 33-36; Dëshmitari 7, Prova materiale P94, para. 33-36.

¹⁸⁰² Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5252. *Shih* edhe Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 35-36; Dëshmitari 23, Prova materiale P98 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10537-10538.

¹⁸⁰³ Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10559; Dëshmitari 23, Prova materiale P99, f. 9.

¹⁸⁰⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5252; Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5252; Dëshmitari 7, Prova materiale P93 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 33-36.

¹⁸⁰⁵ Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 37-39; Dëshmitari 23, Prova materiale P99, f. 4. Dëshmitari 7 dëshmoi se ky komandant ishte Nazmi Brahimaj, Dëshmitari 7, Prova materiale P93, para. 37. *Shih* edhe Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5252, i cili dëshmoi se gjatë asaj vizite mori një dokument ku shkruhej se do të lirohej pas një jave.

¹⁸⁰⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5255; Prova materiale P91, f. 2.

¹⁸⁰⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5255-5256.

nevoja të UÇK-së.¹⁸⁰⁸ Dëshmitari 6 i shoqëruar nga një ushtar i UÇK-së, i mori këto vendime në shtëpinë e Nazmi Brahimajt për të cilën tha se ndodhej rreth 200-250 metra larg objektit të UÇK-së në Jabllanicë.¹⁸⁰⁹ Ai u largua nga Jabllanica më 25 korrik 1998.¹⁸¹⁰

491. Pesë ditë pas lirimit të tij nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, Dëshmitari 6 shkoi në klinikën e fabrikës së tekstilit në Gjakovë. Atij iu rekomandua një ekzaminim radiografik i rrugëve urinare dhe parakrahut të majtë.¹⁸¹¹ Parakrahu i tij i majtë ishte thyer dhe ai kishte një lëndim në shpinë dhe në shpatull.¹⁸¹² Dëshmitari 6 shkoi edhe te një mjek tjetër që i dha qetësues për dhimbje.¹⁸¹³ Që nga ajo kohë Dëshmitari 6 merr mjekim dhe në kohën e dhënies së dëshmisë i ndjente ende pasojat e lëndimeve.¹⁸¹⁴

(c) Përfundim

492. Dhoma është bindur se Dëshmitari 6 u rrëmbye prej ushtarëve të UÇK-së në rrugën Gjakovë – Klinë më 13 qershor 1998 dhe u mbajt në objektin e UÇK-së afërsisht për gjashtë javë ku u rrah nga ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët, Nazmi Brahimaj, Lahi Brahimaj, dhe Hamza Brahimaj. Këto ngjarje përbëjnë akuzat për torturim dhe trajtim mizor. Dhoma mendon se në rrethanat aktuale janë vërtetuar elementët juridikë të torturimit dhe trajtimit mizor. Dhoma citon përfundimet e veta të mëparshme se pas mbërritjes së Dëshmitarit 6 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, ushtarët e UÇK-së e rrahën me shkopinj të trashë, shkopinj të tjerë ose me grushte. Ata ndërroreshin vazhdimisht me njëri-tjetrin dhe e rrahën derisa u rraskapitën. Rrahjet vazhduan derisa Dëshmitari 6 humbi ndjenjat.¹⁸¹⁵ Këto veprime i shkaktuan dhimbje dhe vuajtje shumë të madhe Dëshmitarit 6. Dhoma mendon se rrahja e Dëshmitarit 6 pas mbërritjes së tij në objektin e UÇK-së në Jabllanicë përbën veprimin e fajshëm të torturimit dhe trajtimit mizor. Duke marrë parasysh kohëzgjatjen e rrahjeve dhe mjeteve të përdorura, Dhoma është bindur se keqbërësit vepruan me synimin për t'i shkaktuar Dëshmitarit 6 dhimbje dhe vuajtje shumë të madhe fizike. Gjithashtu, duke marrë parasysh se

¹⁸⁰⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*, T. 5254; Prova materiale P91, f. 1.

¹⁸⁰⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5342-5343.

¹⁸¹⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5206.

¹⁸¹¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5261-5262, 5259; Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5259; Prova materiale P92; Dëshmitari 23, Prova materiale P99, f. 4; Dëshmitari 23, Prova materiale P98 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10552.

¹⁸¹² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5259, 5375; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10539, 10559.

¹⁸¹³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5267-5268.

¹⁸¹⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5268-5269, 5373; Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5268-5269, 5373; Dëshmitari 23, Prova materiale P97 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10538.

¹⁸¹⁵ *Shih* më sipër, para. 482.

ushtarët e akuzuan Dëshmitarin 6 se rrinte me serbë dhe spiunonte për ta, Dhoma është bindur se këto veprime u kryen me synimin e nevojshëm për torturim. Dhoma bindet se janë vërtetuar akuzat për trajtim mizor dhe torturim lidhur me rrahjen e Dëshmitarit 6 pas mbërritjes së tij në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.

493. Gjithashtu Dhoma rikujton përfundimin e vet të mëparshëm se gjatë katër javëve të para të mbajtjes së tij në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, Dëshmitari 6 u rrah nga shumë ushtarë. Lahi Brahimaj, Nazmi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj ishin “vazhdimisht” atje, ata hynin në dhomën ku mbahej ai për 5-10 minuta dhe e rrihnin.¹⁸¹⁶ Dëshmitari 6 shpesh ishte pa ndjenja dhe nuk ishte në gjendje të hante e pinte. Gjithashtu Dhoma rikujton përfundimin e vet se Dëshmitari 6 u mbajt për katër javë në një dhomë të kyçur me çelës e cila nuk kishte asgjë veç dyshemesë. Atij nuk iu dha ushqim i mjaftueshëm.¹⁸¹⁷ Dhoma bindet se këto veprime përbëjnë torturim dhe trajtim mizor. Duke marrë parasysh kohëzgjatjen e këtij trajtimi dhe shpeshësinë e rrahjeve, Dhoma bindet se këto veprime u kryen me synimin e nevojshëm. Lidhur me synimin konkret të nevojshëm për krimin e torturimit, Dhoma rikujton se të afërmeve të Dëshmitarit 6 iu tha se ai ishte “dënuar” dhe do ta kryente dënimin pranë UÇK-së.¹⁸¹⁸ Gjithashtu Dhoma rikujton se në lirin e tij, Dëshmitarit 6 iu dha një dokument ku shkruhej se Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit, gjegjësisht shtabi vendor në Jabllanicë, kishte vendosur ta lironte me kusht, me fjalë të tjera ai do të procedohej penalisht në rast se përsëriste gabimin.¹⁸¹⁹ Nga këto përfundime Dhoma konkludon se mbajtja katërjavëshe në kushtet e përshkruara më sipër dhe rrahjet gjatë kësaj periudhe u kryen me synimin për ta ndëshkuar Dëshmitarin 6.

494. Së fundi, meqenëse torturimi dhe trajtimi mizor janë akuza në formën e shkeljeve të ligjeve ose zakoneve të luftës, për plotësimin e kushteve të përgjithshme të Nenit 3 të Statutit është e nevojshme që viktima të mos ketë marrë pjesë aktive në luftime dhe të provohet ekzistenca e lidhjes midis autorëve të krimit dhe konfliktit të armatosur. Dhoma rikujton se në momentin kur u ndalua, Dëshmitari 6 po udhëtonte me familjen e vet, përfshirë edhe pesë fëmijët e tij, dhe ai dëshmoi se në kohën e ngjarjeve ishte bujk.¹⁸²⁰ Ndaj Dëshmitarit 6 u krye torturim dhe trajtim mizor gjatë kohës që ai mbahej në burgim. Ai nuk merrte pjesë aktive në luftime. Gjithashtu, duke marrë parasysh se keqbërësit ishin ushtarë të UÇK-së që merrnin pjesë në konflikt, se ata e akuzuan Dëshmitarin 6 si spiun të armiqve të tyre dhe se e mbajtën viktimën në objektin e UÇK-së, Dhoma bindet se është vërtetuar lidhja e nevojshme dhe se plotësohen kushtet e përgjithshme të Nenit 3.

¹⁸¹⁶ *Shih* më sipër, para 484-485.

¹⁸¹⁷ *Shih* më sipër, para. 483.

¹⁸¹⁸ *Shih* më sipër, para. 487.

¹⁸¹⁹ *Shih* më sipër, para. 490.

¹⁸²⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5352.

495. Për arsyet e lartpërmendura dhe duke lënë mënjanë për momentin aspektin e përgjegjësisë penale individuale të të Akuzuarve, Dhoma bindet se Pika 3 është vërtetuar.

5. Pika 4

(a) Akuzat në Aktakuzë

496. Në Aktakuzë pretendohet se më 13 qershor 1998 ose rreth kësaj date, Nenad Remishtari, polic serb, u ndalua nga ushtarë të UÇK-së në një postbllok të UÇK-së në rrugën Gjakovë – Klinë dhe u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, ku me të mbërritur atje, u rrah keqazi me shkopinj të trashë nga ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët edhe Nazmi Brahimaj.¹⁸²¹ Gjithashtu pretendohet se më 14 qershor 1998 ose rreth kësaj date, Nenad Remishtari u nxor nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë dhe u vra gjatë kohës që mbahej nga UÇK-ja.¹⁸²²

497. Gjithashtu në Aktakuzë pretendohet se midis mesit të qershorit 1998 dhe fundit të korrikut 1998, një boshnjak i paidentifikuar dhe tre malazezë të paidentifikuar u sollën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, ku u mbajtën tri ditë dhe ushtarët e UÇK-së i rrahën keqazi me shkopinj të trashë dhe i shpuan me thika. Pretendohet se ushtarët e UÇK-së i nxorën boshnjakun dhe malazezët nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë.¹⁸²³

498. Mbi këto pretendime bazohen akuzat e Pikës 4 për vrasje, trajtim mizor dhe torturim që figurojnë si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës kundër tre të Akuzuarve mbi bazën e pretendimit për pjesëmarrjen e tyre në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të pretenduar në Aktakuzë.

(b) Përfundime

499. Nenad Remishtari u lind më 4 shkurt 1969, në fshatin Binxhë të komunës së Klinës. Më 1998, ai jetonte në Binxhë.¹⁸²⁴ Ai ishte polic i komunikacionit rrugor në SPB-në e Gjakovës.¹⁸²⁵ Që prej marsit ose prillit 1998, u bë e rrezikshme që ai të bënte rrugën Gjakovë-Klinë çdo mbrëmje dhe për arsye sigurie ai shkonte në shtëpinë e tij në Binxhë pas një qëndrimi katër-pesëditor në Gjakovë.¹⁸²⁶

¹⁸²¹ Aktakuza, para. 53.

¹⁸²² Aktakuza, para. 54.

¹⁸²³ Aktakuza, para. 55.

¹⁸²⁴ Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 1; Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 1.

¹⁸²⁵ Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 3.

¹⁸²⁶ Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 3.

500. Më 13 qershor 1998, rreth orës 13:30, Nenad Remishtari doli nga shtëpia e tij në Binxhë për të nisur punën nga ora 17:00 deri në mesnatë. Ai u nis vetëm me makinën e tij, një Opel Kadet i kaltër 1300, me targë DJ-2711.¹⁸²⁷ Ishte i veshur civil, me një këmishë me mëngë të shkurtra, me katrorë në ngjyrë të kaltër, të gjelbër dhe të verdhë, pantallona bluxhins, rrip të zi lëkure, dhe këpucë lëkure me ngjyrë të zezë me lidhëse.¹⁸²⁸ Nenad Remishtari ishte afërsisht 1.68 m i gjatë, kishte flokë të shkurtër biond të errët, sy të kaltër dhe pa qime në fytyrë.¹⁸²⁹

501. Kaluan disa ditë dhe familja e Remishtarit nuk mori asnjë lajm prej tij.¹⁸³⁰ Pak ditë më vonë, kolegët e Nenad Remishtarit pyetën për të sepse ai nuk ishte paraqitur në punë prej dhjetë ditësh.¹⁸³¹ Mungesa dhjetëditore e Nenad Remishtarit në punë u konfirmua nga oficeri operativ në SPB-në e Gjakovës.¹⁸³²

502. Familjarët e Nenad Remishtarit pyetën shqiptarë kosovarë nga fshati Shtupel i komunës së Klinës, lidhur me zhdukjen e tij.¹⁸³³ Rreth 20 ditë pas zhdukjes së tij, të afërmit e tij dëgjuan se Nenad Remishtari ishte rrëmbyer afër fshatit Rakovinë në rrugën Klinë – Gjakovë së bashku me një shqiptar kosovar katolik nga Gjakova, se ata ishin burgosur në Jabllanicë dhe se shqiptari kosovar katolik u kishte treguar të tjerëve lidhur me këtë. Gjithashtu ata dëgjuan se shqiptari kosovar katolik ishte liruar 15 ditë më pas.¹⁸³⁴ Familjarët e Nenad Remishtarit gjithashtu dëgjuan se Nenadi mbrohej nga Ali Baraba, ushtar i UÇK-së i cili e njihte që më parë.¹⁸³⁵

503. Njerëzit e familjes së Nenad Remishtarit ishin të pranishëm në identifikimin e kufomave të gjetura në liqenin e Radoniqit, i cili u organizua në Gjakovë, mirëpo nuk qenë në gjendje të identifikonin ndonjë rrobë të Nenad Remishtarit.¹⁸³⁶ Njerëzit e familjes së Nenad Remishtarit ishin të pranishëm edhe në një identifikim në Prishtinë në dimrin e vitit “1998” dhe në Rudar në maj 2003, mirëpo nuk mund të identifikonin ndonjë gjë të Nenad Remishtarit.¹⁸³⁷

504. Dhoma rikujton përfundimin e vet të mëparshëm se në pasditen e 13 qershorit 1998 një Opel Kadet i kaltër me targë të Gjakovës dhe ku ndodheshin fotografi të Nenadit, polic i komunikacionit

¹⁸²⁷ Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 4.

¹⁸²⁸ Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 5.

¹⁸²⁹ Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 15.

¹⁸³⁰ Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 6-7; Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 6-7.

¹⁸³¹ Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 8; Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 8.

¹⁸³² Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 8; Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 8.

¹⁸³³ Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 9; Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 9.

¹⁸³⁴ Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 10; Dëshmitari 73, Prova materiale P108, para. 10.

¹⁸³⁵ Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 11.

¹⁸³⁶ Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 14. *Shih* gjithashtu më sipër, para. 334-335.

¹⁸³⁷ Dëshmitari 73, Prova materiale P109, para. 14.

rrugor nga fshati Binxhë i cili punonte në Gjakovë, arriti në një vend të quajtur Guri i Zi ose Volljakë i drejtuar nga ushtarë të UÇK-së.¹⁸³⁸ Dhoma thekson se përshkrimi i këtij automjeti është i njëjtë me përshkrimin e automjetit të Nenad Remishtarit, ku ai u pa për herë të fundit, se në automjet kishte fotografi të një polici të komunikacionit rrugor të quajtur Nenad nga Binxha, se u pa afër rrugës Klinë—Gjakovë, të cilën supozohej se do të bënte Nenad Remishtari në ditën e zhdukjes së tij, dhe se ky automjet u pa (pa Nenad Remishtarin) disa orë pasi Nenad Remishtari ishte parë për herë të fundit. Prej këtyre fakteve, Dhoma konkludon se Opel Kadeti i kaltër i drejtuar nga ushtarë të UÇK-së afër një vendi të quajtur Guri i Zi ose Volljakë, ishte i Nenad Remishtarit. Megjithëse nuk ka prova të drejtpërdrejta se si automjeti ra në duar të ushtarëve të UÇK-së, bazuar në rrethanat Dhoma konkludon se më 13 qershor 1998, midis orës 13:30 dhe 15:30, ushtarë të UÇK-së e nxorën Nenad Remishtarin nga makina e tij diku në rrugën Klinë-Gjakovë.

505. Dhoma rikujton përfundimin e vet të mëparshëm se në orët e mbrëmjes së 13 qershorit 1998, Nenadi, polic i komunikacionit rrugor nga fshati Binxhë, i cili punonte në Gjakovë, u pa të mbahej në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁸³⁹ Dhoma gjykon se ky person ishte Nenad Remishtari. Natën e 13-14 qershorit 1998, Nenad Remishtari së bashku me Dëshmitarin 6 u mbajtën në një dhomë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, e cila ndodhej në anë të rrugës.¹⁸⁴⁰ Ata u lidhën me litar.¹⁸⁴¹ Të dy u rrahën në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtat mjete, gjegjësisht ata u shkelmuan dhe u grushtuan në këmbë dhe krahë,¹⁸⁴² dhe u goditën me shkopinj të trashë, shkopinj të tjerë dhe grushte.¹⁸⁴³ Nenad Remishtari u rrah nga Nazmi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë që ndërroheshin me njëri-tjetrin.¹⁸⁴⁴

506. Një ditë pasi e kishin sjellë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, Dëshmitarin 6 e futën në ndërtesën njëkatëshe me tulla të kuqe në oborr.¹⁸⁴⁵ Pasditën e asaj dite hynë dy ushtarë të cilët morën Nenadin; ai nuk ishte në gjendje të ecte dhe në trup i shihej gjak dhe lëndime.¹⁸⁴⁶ Dëshmitari 6 nuk e pa më Nenad Remishtarin.¹⁸⁴⁷ Dëshmitari 6 dëshmoi se pas lirit të tij, Pavle Zuviqi, polic rezervist, i tregoi se Nenad Remishtarin e kishin vlarë në Jabllanicë dhe kufomën e kishin hedhur

¹⁸³⁸ *Shih* më sipër, para. 479.

¹⁸³⁹ *Shih* më sipër, para. 482.

¹⁸⁴⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5213-5214, 5316, 5386.

¹⁸⁴¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5210.

¹⁸⁴² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5210-5211, 5351.

¹⁸⁴³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5208, 5210, 5350-5351.

¹⁸⁴⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5211.

¹⁸⁴⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5216, 5316-5317, 5324; Prova materiale P88; P89.

¹⁸⁴⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5211, 5317.

¹⁸⁴⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5211.

diku në male.¹⁸⁴⁸ Nuk dihet se ku bazohet kjo dëshmi e dorës së dytë. Dëshmitari 6 nuk kishte asnjë dijeni të drejtpërdrejtë për këto ngjarje.

507. Prokuroria paraqiti një dëshmitar tjetër për të provuar akuzat në lidhje me Nenad Remishtarin, konkretisht Dëshmitarin 81. Më parë në Aktgjykim, Dhoma shprehu pikëpamjen lidhur me Dëshmitarin 81 dhe e konsideroi Dëshmitarin 81 jo të besueshëm. Për hir të procedurës së plotë, Dhoma do të analizojë dëshminë e tij lidhur me këtë pikë.

508. Dëshmitari 81 dëshmoi se në kohën që sipas Dhomës duhet të ketë qenë rreth fundit të qershorit ose fillimit të korrikut 1998¹⁸⁴⁹ ai vizitoi objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Magjupi e çoi në bodrum ku ishin dy të rinj serbë, njëri ishte më i gjatë se tjetri. Dëshmitari 81 mendonte se njëri prej tyre ishte biond dhe Dëshmitari 81 mendonte se ai ishte i veshur me një “uniformë të llojit ushtarak”, në një ngjyrë të gjelbër të errët kamuflimi.¹⁸⁵⁰ Dëshmitari 81 dëshmoi se ata dukeshin se ishin rrahur keqazi dhe me mavijosje, dhe se sipas Magjupit dhe një ushtari të atjeshëm, njëri prej tyre me emrin Senad ose Nenad, ishte polic.¹⁸⁵¹ Gjithashtu Dëshmitari 81 dëshmoi se Magjupi i kërkoi një ushtari ta çonte individin me uniformë në zyrën e tij, ku ai e mori në pyetje.¹⁸⁵² Sipas dëshmisë së Dëshmitarit 81, gjatë marrjes në pyetje, Magjupi e goditi personin e quajtur Senad apo Nenad me një shkop të trashë në gjithë trupin afërsisht për 15-20 minuta.¹⁸⁵³ Dhoma rikujton se në kohën e zhdukjes, Nenad Remishtari ishte pa uniformë; ai mbante një këmishë me katrorë në ngjyrë të kaltër, të gjelbër dhe të verdhë.¹⁸⁵⁴

509. Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes për Dëshmitarin 81 doli se edhe në këtë aspekt ai e kishte ndryshuar thelbësisht dëshminë e tij. Gjatë intervistës me Prokurorinë, Dëshmitari deklaroi se nuk kishte parë rrahje apo keqtrajtime të të burgosurve në vizitën e tij “të dytë” në Jabllanicë dhe se atij nuk i kujtohej ndonjë oficer i ushtrisë apo polic serb i burgosur në Jabllanicë.¹⁸⁵⁵ Mirëpo kur në të njëjtën intervistë ai u pyet nga Prokuroria nëse i kujtohej emri Nenad Remishtar, Dëshmitari 81 deklaroi se pa një polic të quajtur Nenad që ishte i burgosur në Jabllanicë bashkë me dy policë të tjerë dhe se ai pa Magjupin duke e rrahur Nenadin me një shkop të trashë gjatë marrjes në

¹⁸⁴⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5312-5313, 5322-5324, 5304-5305.

¹⁸⁴⁹ Dëshmitari 81 dëshmoi se ngjarjet e përshkruara më poshtë ndodhën rreth një muaj, një muaj e gjysmë pas vizitës së tij të dytë në Jabllanicë (Dëshmitari 81, T. 1962-1963), për të cilën ai pretendoi se ndodhi dy apo tri javë pas vizitës së tij të parë (Dëshmitari 81, T. 1958), për të cilën ai tha se ndodhi në prill ose maj 1998 (Dëshmitari 81, T. 1882-1883).

¹⁸⁵⁰ Dëshmitari 81, T. 1962-1964.

¹⁸⁵¹ Dëshmitari 81, T. 1963-1964.

¹⁸⁵² Dëshmitari 81, T. 1967-1968.

¹⁸⁵³ Dëshmitari 81, T. 1969-1970.

¹⁸⁵⁴ *Shih* më sipër, para. 500.

¹⁸⁵⁵ Dëshmitari 81, T. 2086-2088; Prova materiale D201, para. 22.

pyetje.¹⁸⁵⁶ Dhoma e konsideron jobindëse arsyen që dha Dëshmitari 81 për ndryshimin e dëshmisë së tij, se ai do të përmendte praninë e një polici në Jabllanicë vetëm në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë. Ky shpjegim gjithashtu bie ndesh me një letër të paraqitur nga Prokuroria gjatë dhënies së dëshmisë nga Dëshmitari 81.¹⁸⁵⁷ Si përfundim, Dhoma e gjykon jo të besueshme dëshminë e Dëshmitarit 81 për këtë pikë dhe rrjedhimisht nuk do t'a marrë në konsideratë.

510. Dëshmitari 6 dëshmoi se rreth dy javë¹⁸⁵⁸ pas rrëmbimit të tij, në objektin e UÇK-së në Jabllanicë sollën një boshnjak dhe tre malazezë.¹⁸⁵⁹ Ata i sollën të gjithë bashkë.¹⁸⁶⁰ Dëshmitari 6 nuk i dinte emrat e tyre.¹⁸⁶¹ Katër personat u mbajtën në të njëjtën dhomë me Dëshmitarin 6 për tri ose katër ditë.¹⁸⁶² Ata u rrahën me shkopinj të trashë dhe u shpuan me thikë në trup. Plagët ishin rreth një centimetër të thella.¹⁸⁶³ Ata kullonin dhe pështynin gjak.¹⁸⁶⁴ Dëshmitari 6 i cili i pa rrahjet, dëshmoi se Nazmi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj ishin të pranishëm në dhomë gjatë rrahjeve,¹⁸⁶⁵ mirëpo nuk ishte në gjendje të identifikonte njerëzit që rrahën dhe shpuan me thikë katër personat e lartpërmendur.¹⁸⁶⁶

511. Dëshmitari 6 dëgjoi ushtarët kur thanë se boshnjaku ishte mysliman; ai fliste pak shqip.¹⁸⁶⁷ Gjatë rrahjeve ushtarët e akuzuan për ndërprerjen e rrymës elektrike dhe gjatë rrahjeve Dëshmitari 6 mësoi se ai punonte për një ndërmarrje të quajtur Elektrokosova në Deçan.¹⁸⁶⁸ Ai kishte pantallona të holla dhe një këmishë verore të errët.¹⁸⁶⁹ Malazezët nuk flisnin shqip dhe Dëshmitari 6 nuk dinte

¹⁸⁵⁶ Dëshmitari 81, T. 2086-2088; Prova materiale D201, para 23-24.

¹⁸⁵⁷ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, seanca gjyqësore e 24 nëntorit 2011, T. 2099-2100.

¹⁸⁵⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5217, 5329. Dhoma thekson se gjatë dëshmisë së tij Dëshmitari 6 e përcaktoi kohëzgjatjen e kësaj periudhë rreth tri javë e gjysmë ose katër javë (Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227), mirëpo duke marrë parasysh se ai e përsëriti dëshminë se kjo ndodhi rreth dy javë pas rrëmbimit të tij dhe shpjegimit të tij gjatë pyetjeve nga Mbrojtja se përcaktimi i kohëzgjatjes prej tri javë e gjysmë ose katër javë ishte gabim (Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5387), Mbrojtja pranon se kjo ndodhi rreth dy javë pas rrëmbimit të tij.

¹⁸⁵⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5217, 5226-5227, 5329, 5387.

¹⁸⁶⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227.

¹⁸⁶¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227.

¹⁸⁶² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227, 5330, 5387.

¹⁸⁶³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5228, 5330-5331.

¹⁸⁶⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5228.

¹⁸⁶⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5228.

¹⁸⁶⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5330-5331.

¹⁸⁶⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227, 5329-5330.

¹⁸⁶⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227, 5329, 5397.

¹⁸⁶⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227.

asgjë për ta.¹⁸⁷⁰ Një prej malazezëve ishte më i vjetër se të tjerët, rreth 35-40 vjeç, dhe kishte të veshur një xhaketë.¹⁸⁷¹

512. Pas tri ditësh, rreth orës 22:00, boshnjaku dhe malazezët u morën dhe që atëherë Dëshmitari 6 nuk i pa më.¹⁸⁷²

(c) Përfundim

513. Dhoma është bindur se më 13 qershor 1998, Nenad Remishtari u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, ku ai u rrah keqazi nga Nazmi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së. Gjithashtu Dhoma bindet se nga fundi i qershorit 1998 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë sollën një boshnjak dhe tre malazezë ku ata u rrahën dhe u shpuan me thika nga ushtarë të UÇK-së në praninë e Nazmi Brahimajt dhe Hamza Brahimajt. Këto ngjarje përbëjnë akuza për vrasje, trajtim mizor dhe torturim. Ligji lidhur me këto krime është shtjelluar më parë në Aktgjykim.¹⁸⁷³ Lidhur me akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Nenad Remishtarit, Dhoma rikujton përfundimet e veta të mëparshme se Nenad Remishtari u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, u lidh me litar, se u shkelmua dhe u grushtua dhe u godit në krahë e në këmbë me shkopinj të trashë e shkopinj të tjerë nga Nazmi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë.¹⁸⁷⁴ Këtë veprime ishin të tilla që i shkaktuan Nenad Remishtarit dhimbje dhe vuajtje shumë të madhe dhe sipas përfundimeve të Dhomës përbëjnë veprimet kriminale të torturimit dhe trajtimit mizor. Duke marrë parasysh mënyrën e rrahjeve dhe llojin e mjeteve të përdorura, Dhoma bindet se keqbërësit vepruan me synimin për t'i shkaktuar Nenad Remishtarit dhimbje dhe vuajtje të madhe. Lidhur me kushtin e ekzistencës së synimit konkret të nevojshëm për krimin e torturimit, Dhoma thekson se Nenad Remishtari ishte serb i Kosovës dhe pjesëtar i MPB-së, që bënte pjesë në forcat serbe, një nga palët në konflikt. Nga këto fakte, Dhoma dedukton se rrahjet ndaj tij u kryen me synimin për ta ndëshkuar ose diskriminuar.

514. Prokuroria nuk paraqiti prova lidhur me vdekjen e Nenad Remishtarit ose mbi rrethanat e vrasjes së tij. Dhoma rikujton se më 14 qershor 1998, Nenad Remishtari u nxor nga dhoma ku mbahej në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Kufoma e tij nuk është gjetur. Në mungese të provave mbi ngjarjet pas nxjerrjes së tij nga dhoma në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, Dhoma nuk konkludon jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Nenad Remishtari ka vdekur ose vdiq në rrethanat e pretenduara në Aktakuzë.

¹⁸⁷⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227, 5230.

¹⁸⁷¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5227.

¹⁸⁷² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5230.

¹⁸⁷³ *Shih* më sipër, para. 416-427.

¹⁸⁷⁴ *Shih* më sipër, para. 505.

515. Lidhur me akuzat e Aktakuzës mbi një boshnjak të pidentifikuar dhe tre malazezë të pidentifikuar, Dhoma rikujton përfundimin e vet se në objektin e UÇK-së në Jabllanicë u mbajtën për tri-katër ditë një boshnjak i pidentifikuar dhe tre malazezë të pidentifikuar, dhe gjatë atyre ditëve ata u rrahën me shkopinj të trashë dhe u shpuan me thika.¹⁸⁷⁵ Dhoma bindet se këto përbëjnë veprimin kriminal të trajtimit mizor dhe torturimit dhe se u kryen me synimin e nevojshëm për trajtimin mizor. Lidhur me ekzistencën e synimit konkret të nevojshëm për torturim, Dhoma rikujton se boshnjaku u akuzua për ndërprerjen e rrymës elektrike dhe bazuar në këtë fakt konkludon se rrahjet u kryen me synimin për t'a ndëshkuar. Në mungesë të provave mbi synimin për ndëshkim ose diskriminim gjatë rrahjes së tre malazezëve, Dhoma konkludon se për ta nuk është vërtetuar akuza e torturimit.

516. Së fundi lidhur me kushtin e përgjithshëm të Nenit 3 të Statutit për mospjesëmarrje aktive të viktimave në luftime, Dhoma rikujton se në kohën e kryerjes së torturimit dhe trajtimit mizor, Nenad Remishtari, boshnjaku i pidentifikuar dhe tre malazezët e pidentifikuar ishin të arrestuar dhe rrjedhimisht nuk merrnin pjesë në luftime. Lidhur me ekzistencën e lidhjes së nevojshme, Dhoma rikujton se keqbërësit ishin ushtarë që merrnin pjesë në konflikt dhe viktimat ishin në duart e tyre. Për këto arsye, Dhoma pranon se kushtet e përgjithshme të Nenit 3 janë plotësuar.

517. Bazuar në konstatimet e mësipërme dhe duke lënë mënjane për momentin aspektin e përgjegjësisë penale individuale të të Akuzuarve, Dhoma konkludon se janë vërtetuar akuza e torturimit dhe trajtimit mizor të Nenad Remishtarit, akuza e torturimit dhe trajtimit mizor të një boshnjaku të pidentifikuar dhe akuza e trajtimit mizor të tre malazezëve të pidentifikuar, të cilat përfshihen në Pikën 4.

6. Pika 5

(a) Akuzat në Aktakuzë

518. Në Aktakuzë pretendohet se më 10 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Pal Krasniqi, shqiptar kosovar katolik, shkoi në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për të hyrë në radhët e UÇK-së. Më tej pretendohet se ai qëndroi në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për pak ditë derisa u arrestua si spiun dhe u rrah keqazi me shkopinj të trashë derisa bëri rrëfim të rremë. Pretendohet se ai u pa i gjallë për herë të fundit më 26 korrik 1998, ose rreth kësaj date, në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe u vra kur ishte në duar të UÇK-së.¹⁸⁷⁶

¹⁸⁷⁵ *Shih* më sipër, para. 510.

¹⁸⁷⁶ Aktakuza, para. 56-57.

519. Në Aktakuzë gjithashtu pretendohet se më 11 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Skënder Kuqi, shqiptar kosovar, u rrëmbye nga dyqani i tij në Zahaq prej ushtarëve të UÇK-së dhe u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku ushtarë të UÇK-së e rrahën keqazi me shkopinj dhe shufra hekuri. Pretendohet se më 16 korrik 1998, Skënder Kuqi u dërgua në qendrën shëndetësore të UÇK-së në Irzniq ku edhe vdiq. Sipas akuzave në Aktakuzë, si pasojë e rrahjeve atij i shihej veshka prej një plage të hapur. Pretendohet se kufoma e tij u varros nga ushtarët e UÇK-së në Jabllanicë dhe se më vonë me udhëzim të Ramush Haradinajt, kufoma e tij u zhvarros dhe iu dha familjes së tij.¹⁸⁷⁷

520. Gjithashtu, pretendohet se më 13 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Lahi Brahimaj i kërkoi Dëshmitarit 3, një shqiptar kosovar i cili nuk kishte pranuar të luftonte për UÇK-në, të shkonte me të në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku e mbajti “me dy burra të tjerë”.¹⁸⁷⁸ Pretendohet se midis 13 korrikut dhe 16 korrikut 1998, ushtarë të UÇK-së, përfshirë Naser Brahimajn dhe Nazmi Brahimajn, rrahën shpesh dy burrat e tjerë, dhe se të tre burrat u morën në pyetje. Gjithashtu pretendohet se më 16 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Lahi Brahimaj ftoi dy ushtarë të UÇK-së që të rrihnin Dëshmitarin 3. Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj i nxitën rrahjet dhe Idriz Balaj e akuzoi Dëshmitarin 3 si spiun. Pretendohet se më pas Dëshmitari 3 u arratis. Sipas Aktakuzës, Lahi Brahimaj e rrëmbeu sërish Dëshmitarin 3 nga fundi i korrikut 1998 dhe e çoi në shtëpinë e Lahi Brahimajt ku e rrahu. Më pas Lahi Brahimaj e çoi Dëshmitarin 3 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku e mori në pyetje dhe e rrahu. Gjithashtu pretendohet se Lahi Brahimaj e çoi Dëshmitarin 3 në shtabin e UÇK-së në Gllogjan ku u rrah nga policia ushtarake e UÇK-së dhe se më pas Ramush Haradinaj e liroi Dëshmitarin 3.¹⁸⁷⁹

521. Prokuroria pretendon se pretendimet e mësipërme janë bazë për një akuzë për vrasje, trajtim mizor dhe torturim si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës kundër Ramush Haradinajt dhe Idriz Balajt bazuar në pretendimin për pjesëmarrjen e tyre në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të pretenduar në Aktakuzë.

522. Në procesin e parë *Haradinaj*, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimaj kreu trajtim mizor dhe torturim ndaj Dëshmitarit 3 dhe për këtë arsye e shpalli Lahi Brahimajn fajtor për Pikën 32 të aktakuzës së parë e cila përfshinte pak a shumë të njëjtat akuza si Pika 5 e Aktakuzës në

¹⁸⁷⁷ Aktakuza, para. 58-59.

¹⁸⁷⁸ Aktakuza, para. 60.

¹⁸⁷⁹ Aktakuza para. 60-63.

fuqi.¹⁸⁸⁰ Ky verdikt u konfirmua në apel. Lahi Brahimaj nuk akuzohet në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës në fuqi.

(b) Përfundime

(i) Burgimi i Pal Krasniqit, Skënder Kuqit dhe Dëshmitarit 3

523. Pal Krasniqi ishte shqiptar kosovar katolik i cili në vitin 1998 jetonte me familjen e tij në qytetin e Pejës.¹⁸⁸¹ Më 1998, ai ishte afërsisht 20 vjeç.¹⁸⁸²

524. Më 10 korrik 1998, Pal Krasniqi u nis nga shtëpia e tij në Pejë me një shok, Mahir Demajn, për të hyrë në radhët e UÇK-së.¹⁸⁸³ Pal Krasniqi kishte veshur “atlete”, pantallona sportive në ngjyrë të kaltër, dhe një bluzë me mëngë të shkurtra me vija.¹⁸⁸⁴ Së pari ata morën rrugën drejt Klinës për të vizituar nënën e Pal Krasniqit.¹⁸⁸⁵ Rrugës nga Tërsteniku për në Krushevë ata u ndaluan nga një grup i armatosur civilësh serbë të Kosovës të cilët thirrën policinë serbe. Policët erdhën pas pak dhe i rrahën Pal Krasniqin dhe Mahir Demajn. Të dy personat u çuan në stacionin policor në Klinë, ku policët i morën në pyetje dhe i rrahën. Ata u pyetën për identitetin e tyre dhe se ku po shkonin.¹⁸⁸⁶ Sipas dëshmisë së Mahir Demajt, rreth mesnatës Pal Krasniqin dhe Mahir Demajn i liruan nga stacioni policor.¹⁸⁸⁷

525. Mahir Demaj dëshmoi se ata të dy u fshehën në një shtëpi, sepse mendonin se po i kërkonte policia. Së fundi policia i zbuloi dhe i futi në një makinë të policisë që shkonte në drejtim të Pejës. Mirëpo, për arsye që dëshmitari nuk mund t’i shpjegonte, automjeti policor u kthye në Klinë, ku të dy personat u liruan. Pasi u liruan, Pal Krasniqi dhe Mahir Demaj u nisën drejt kishës në drejtim të Zllakuqanit në komunën e Klinës.¹⁸⁸⁸ Ata hynë në kishë dhe pritën atje. Ata dëgjuan të shtëna sporadike të policisë. Rreth orës 04:00, Pal Krasniqi i tha Mahir Demajt se një polic i kishte

¹⁸⁸⁰ Aktgjykimi *Haradinaj*, para. 451

¹⁸⁸¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5238; Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4768.

¹⁸⁸² Ded Krasniqi, Prova materiale P51 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4794.

¹⁸⁸³ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4768-4769; Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 4.

¹⁸⁸⁴ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4787.

¹⁸⁸⁵ Ded Krasniqi, babai i Pal Krasniqit, dëshmoi se fillimisht ata duhej të shkonin në Jabllanicë, pasi të kishin marrë bashkëshorten e Pal Krasniqit dhe ta kishin çuar në Pejë, Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4769-4770. Mahir Demaj dëshmoi se ata kishin ndërmend të shkonin në Krushevë afër Klinës sepse Pal Krasniqi do ta kalonte natën në shtëpinë e nënës së tij, Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 5.

¹⁸⁸⁶ Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 5.

¹⁸⁸⁷ Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 6.

¹⁸⁸⁸ Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 6.

urdhëruar të paraqiteshin në stacionin policor në orën 08:00.¹⁸⁸⁹ Dy burrat nuk e përmbushën urdhrin për të shkuar në polici, por shkuan në zyrën e postës ku i telefonuan babait të Pal Krasniqit, Ded Krasniqi, dhe më pas shkuan drejt fshatit Jabllanicë në komunën e Gjakovës.¹⁸⁹⁰ Kjo dëshmi përputhet pjesërisht me dëshminë e Ded Krasniqit i cili dëshmoi se rreth orës 06:00, në ditën pasi Pal Krasniqi u largua, ai i telefonoi nga Klina dhe i tregoi se ai dhe Mahiri ishin arrestuar në një postbllok policor në Krushevë të Madhe dhe u çuan në Klinë.¹⁸⁹¹ Ded Krasniqi dëshmoi se gjatë bisedës telefonike në orët e mëngjesit të 11 korrikut 1998, Pal Krasniqi kërkoi ndihmë prej tij, mirëpo ai u përgjigj se nuk mund t'a ndihmonte sepse po e kërkonte policia.¹⁸⁹² Gjithashtu, Ded Krasniqi dëshmoi se gjatë asaj bisede, Pal Krasniqi i tha se po i telefononte nga kisha. Ded Krasniqi i tha Palit të shkonte dhe bashkohej me UÇK-në sikurse kishin biseduar para nisjes së tij.¹⁸⁹³

526. Dëshmitë e diskutuara në paragrafin e mëparshëm nuk përputhen tërësisht. Pasi i ka analizuar me kujdes këto dëshmi, Dhoma pranon dhe arrin në përfundimin se më 10 korrik 1998, Pal Krasniqi dhe Mahir Demaj u nisën nga Peja për t'iu bashkuar UÇK-së, se më vonë gjatë asaj dite ata u mbajtën në stacionin policor serb në Klinë ku u morën në pyetje dhe u rrahën, dhe se ditën e nesërme, më 11 korrik, ata vazhduan udhëtimin. Ata arritën në fshatin Jabllanicë më 11 korrik 1998.

527. Me të mbërritur në Jabllanicë, Pal Krasniqi dhe Mahir Demaj u çuan në një spital të improvizuar në një shtëpi dykatëshe private ku mjekoheshin ushtarët e plagosur. Mahir Demaj dhe Pal Krasniqi u treguan mjekëve dhe të tjerëve, ndër të cilët ushtarë të UÇK-së, se i kishin rrahur. Mëngjesin e nesërm Mahir Demaj shkoi me një grup burrash drejt Junikut për të marrë armë. Pal Krasniqi qëndroi në Jabllanicë.¹⁸⁹⁴

¹⁸⁸⁹ Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 7.

¹⁸⁹⁰ Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 8. Në Grabanicë, dy burrat hasën në një grup shqiptarësh kosovarë “që dukeshin si roje fshati të UÇK-së”, të armatosur dhe të veshur civilë, të cilët i treguan rrugën për në Jabllanicë, Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 8.

¹⁸⁹¹ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4770. Sipas dëshmitarit, Mahiri i tregoi më vonë se Pal Krasniqi ishte rrahur më pak se Mahiri sepse për të ishte bërë dorëzanë një oficer serb, Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4833-4834.

¹⁸⁹² Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4770, 4825-4828. Duket se ai dëshmoi për një incident të shkuar që nuk kishte lidhje.

¹⁸⁹³ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4770-4771.

¹⁸⁹⁴ Mahir Demaj, Prova materiale P24, para. 10-14.

528. Më 1998 Skënder Kuqi jetonte në fshatin Lutogllavë në komunën e Pejës me gruan dhe tre djemtë e tij. Ai kishte një dyqan për pleh kimik në fshatin fqinj Zahaq në të njëjtën komunë. Më 1998 ai ishte afërsisht 45 vjeç.¹⁸⁹⁵

529. Në një ditë të papërcaktuar në korrik 1998, në mesditë, Qerim Kuqi vizitoi Skënder Kuqin në dyqanin e tij në Zahaq. Rreth 10 minuta pas hyrjes së Qerim Kuqit në dyqan, atje mbërriti një makinë dhe në dyqan hynë dy burra. Ata kishin veshur rroba civile dhe xhaketa të llojit kamuflim.¹⁸⁹⁶ Ata kishin maska në ngjyrë kuqezi.¹⁸⁹⁷ Në rroba nuk kishin emblema apo shenja.¹⁸⁹⁸ Dy burrat ishin të armatosur me automatikë.¹⁸⁹⁹ Ata bëritën në gjuhën serbe “Duart lart!” me armë të drejtuar nga Qerim Kuqi dhe Skënder Kuqi. Pastaj ata kontrolluan xhepat e Qerim Kuqit dhe e nxorën Skënder Kuqin jashtë dhe e çuan te garazhi ku ishte parkuar makina e tij Mercedes.¹⁹⁰⁰ Pas dy-tri minutash, Qerim Kuqi pa Skënderin që ishte duke ngarë makinën e tij dhe një prej dy burrave ishte në makinë me të. Makina e ngarë nga burri tjetër me të cilën kishin ardhur ata, shkoi më pas.¹⁹⁰¹ Të dy makinat shkuan në drejtim të Klinës.¹⁹⁰²

530. Më sipër Dhoma konkludoi se Dëshmitari 6 u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë nga 13 qershori deri më 25 korrik 1998 dhe se afërsisht nga 11 korriku 1998 deri në lirimin e tij më 25 korrik 1998, atij iu dha më shumë liri lëvizjeje brenda objektit.¹⁹⁰³ Dy ose tri ditë pas ndryshimit të kushteve të mbajtjes së Dëshmitarit 6, sipas konstatimit të Dhomës, afërsisht më 13 ose 14 korrik 1998, Dëshmitari 6 pa kur në objektin e UÇK-së në Jabllanicë erdhi një Mercedes 190 në ngjyrë metalike. Nga vendbagazhi i makinës nxorën një burrë të cilin e rrahën në oborr dhe për të cilin më vonë Dëshmitari 6 mësoi se ishte shqiptar kosovar mysliman nga Zahaqi.¹⁹⁰⁴ Pas kësaj shqiptari kosovar nga Zahaqi u çua në dhomën përballë dhomës së Dëshmitarit 6 dhe u rrah atje.¹⁹⁰⁵ Nazmi

¹⁸⁹⁵ Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9990.

¹⁸⁹⁶ Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9991, 10002-10003.

¹⁸⁹⁷ Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9998.

¹⁸⁹⁸ Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10003.

¹⁸⁹⁹ Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9999.

¹⁹⁰⁰ Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9999-10001, 10005.

¹⁹⁰¹ Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10000-10001.

¹⁹⁰² Qerim Kuqi, Prova materiale P68 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 10002.

¹⁹⁰³ *Shih* më sipër, para. 486.

¹⁹⁰⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5231-5232, 5388-5389, 5391; Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5395.

¹⁹⁰⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5232, 5335; Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5395.

Brahimaj dhe Hamza Brahimaj morën pjesë në rrahje.¹⁹⁰⁶ Lahi Brahimaj ishte i pranishëm gjatë rrahjeve.¹⁹⁰⁷

531. Dhoma konkludoi se të nesërmen, afërsisht më 14 ose 15 korrik 1998, Dëshmitari 6 pa kur sollën një person në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, për të cilin më vonë mësoi se ishte Pal Krasniqi nga Peja. Pal Krasniqi e futën në të njëjtën dhomë me shqiptarin kosovar nga Zahaqi.¹⁹⁰⁸ Pal Krasniqi kishte rroba sportive, një kostum sportiv me një vijë të bardhë anash dhe disa kopsa.¹⁹⁰⁹ Ashtu sikurse ka konkluduar më parë Dhoma, Pal Krasniqi erdhi në Jabllanicë më 11 korrik 1998 me synim për t'u anëtarësuar në UÇK.¹⁹¹⁰

532. Pak orë pasi kishin sjellë Pal Krasniqin afërsisht më 14 ose 15 korrik 1998, Dëshmitari 6 pa një person të tretë të cilin e futën në të njëjtën dhomë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁹¹¹ Bazuar në përshkrimin e Dëshmitarit 6 dhe dëshmisë së Dëshmitarit 3 të diskutuar më poshtë, Dhoma konkludon se ky person ishte Dëshmitari 3.

533. Dëshmitari 3 dëshmoi se në një ditë të papërcaktuar në qershor ose korrik 1998, Lahi Brahimaj shkoi në shtëpinë ku ndodhej Dëshmitari 3 dhe e kërkoi. Lahi Brahimaj tha se ai donte që Dëshmitari 3 të bëhej ushtar i tij.¹⁹¹² Dëshmitari 3 u nis me Lahi Brahimajn. Brenda në makinën Mercedes Benc, për të cilën Dëshmitari 3 më vonë mësoi se ishte e Skënder Kuqit, Lahi Brahimaj e pyeti Dëshmitarin 3 për Kallashnikovin e tij. Pastaj ai e çoi Dëshmitarin 3 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁹¹³ Pas mbërritjes së Dëshmitarit 3, Lahi Brahimaj e shoqëroi në një dhomë brenda objektit. Pas kësaj Lahi Brahimaj u largua. Në atë dhomë mbaheshin dy burra. Dëshmitari 3 njihte njërin prej tyre që më parë, ishte Skënder Kuqi, i cili kishte qenë mësues i Dëshmitarit 3 në shkollën fillore.¹⁹¹⁴ Në atë kohë Dëshmitari 3 nuk e njohu personin tjetër, mirëpo pas luftës mësoi se ai quhej Pal Krasniqi.¹⁹¹⁵

534. Dhoma e pranon këtë dëshmi dhe konkludon se shqiptari kosovar të cilin Dëshmitari 6 e pa kur e sollën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë afërsisht më 13 ose 14 korrik 1998 në një Mercedes me ngjyrë të metaltë ishte Skënder Kuqi. Dhoma arriti në përfundimin se Skënder Kuqin e sollën

¹⁹⁰⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5232, 5337-5338.

¹⁹⁰⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5338.

¹⁹⁰⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5235-5236, 5334-5335, 5388-5389. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁹⁰⁹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5247.

¹⁹¹⁰ *Shih* më sipër, para. 526.

¹⁹¹¹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁹¹² Dëshmitari 3, T. 1538-1539.

¹⁹¹³ Dëshmitari 3, T. 1539-1543; Prova materiale P60.

¹⁹¹⁴ Dëshmitari 3, T. 1544-1545.

¹⁹¹⁵ Dëshmitari 3, T. 1550, 1558.

në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ne vendbagazhin e makinës së tij Mercedes dhe se ai u mbajt në një dhomë në ndërtesën njëkatëshe drejtkëndore me tulla të kuqe në oborrin e objektit. Me të mbërritur, ai u rrah në oborr dhe në dhomë nga ushtarët e UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj, në praninë e Lahi Brahimajt. Më tej Dhoma konkludoi se të nesërmen, me fjalë të tjera afërsisht më 14 ose 15 korrik 1998, Pal Krasniqi i cili ishte nisur nga shtëpia e tij në Pejë më 10 korrik 1998, u soll në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe u mbajt në të njëjtën dhomë me Skënder Kuqin. Pak orë më vonë, Lahi Brahimaj solli Dëshmitarin 3 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë i cili u mbajt në të njëjtën dhomë me Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin.

535. Dëshmitari 3 dëshmoi se pak pasi hyri në dhomë, katër ose pesë persona me uniformë e goditën befasisht me shkopinj të trashë. Gjatë rrahjes Dëshmitarit 3 nuk i bënë asnjë pyetje. Në përpjekje për t'u mbrojtur, Dëshmitari 3 shtyu një apo dy prej këtyre personave. Pastaj Dëshmitari 3 humbi ndjenjat. Pasi erdhi në vete, Dëshmitari 3 pa se trupin e kishte krejt të mavijosur dhe të ënjtur. Ai nuk mund të qëndronte në këmbë për të urinuar. Një nga personat në objektin e UÇK-së në Jabllanicë i tha të urinonte në brekë.¹⁹¹⁶ Pak kohë pasi Dëshmitari 3 kishte ardhur në vete, Pal Krasniqi i tha Dëshmitarit 3 të pranonte çfarë kishte bërë, ndryshe Pal Krasniqi do t'a "vriste".¹⁹¹⁷ Dëshmitari 3 mendoi se Pal Krasniqi kishte dalë mendsh.¹⁹¹⁸ Pastaj hyri Naser Brahimaj dhe e pyeti Dëshmitarin 3 çfarë kishte ndodhur. Dëshmitari 3 i shpjegoi çfarë i kishte thënë Pal Krasniqi dhe pas kësaj Naser Brahimaj e goditi Pal Krasniqin "shumë herë" me një shkop të trashë. Pal Krasniqi humbi ndjenjat sepse u godit shumë herë në kokë.¹⁹¹⁹

536. Dëshmia e Dëshmitarit 3 vihet në pikëpyetje pjesërisht nga dëshmia e Dëshmitarit 6 i cili dëshmoi se Dëshmitari 3 nuk u rrah sepse të afërmit e tij ndërhyjnë.¹⁹²⁰ Dhoma konstaton se Dëshmitari 6 nuk u mbajt në të njëjtën dhomë me Dëshmitarin 3, Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin. Ai i kaloi netët në një dhomë përballë dhomës ku u mbajtën ata, mirëpo në kohën që i prunë ata, ai kishte të drejtë të lëvizte brenda objektit dhe kalonte shumë kohë në kuzhinë.¹⁹²¹ Dëshmitari 6 kishte mundësinë të shihte kushtet e të burgosurve në dhomë kur u çonte ujë dhe bukë, mirëpo ai dëshmoi se e linte ujin brenda dhomës, afër derës dhe nuk hynte në dhomë.¹⁹²² Rrjedhimisht, Dhoma pranon se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje të shihte gjithë çfarë ndodhi në dhomën ku u mbajtën Skënder Kuqi, Pal Krasniqi dhe Dëshmitari 3. Dhoma pranon dëshminë e Dëshmitarit 3

¹⁹¹⁶ Dëshmitari 3, T. 1546-1548.

¹⁹¹⁷ Dëshmitari 3, T. 1549-1551, 1555.

¹⁹¹⁸ Dëshmitari 3, T. 1555-1556.

¹⁹¹⁹ Dëshmitari 3, T. 1549-1551, 1555.

¹⁹²⁰ *Shih* Shtojca konfidenciale.

¹⁹²¹ *Shih* më sipër, para. 486.

¹⁹²² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5336-5337.

mbi rrahjet që pësoi. Gjithashtu Dhoma thekson se Lahi Brahimaj u dënua për rolin e tij në këtë ngjarje dhe nuk do ta diskutojë atë më tej.

537. Naser Brahimaj e rrihte Skënder Kuqin pesë ose gjashtë herë në ditë.¹⁹²³ Skënder Kuqi i tha Dëshmitari 3 se atë po e trajtonin në atë mënyrë sepse kishte shumë para.¹⁹²⁴ Një natë erdhi Nazmi Brahimaj dhe shkëlmoi nga një herë secilin prej të burgosurve.¹⁹²⁵

538. Gjatë natës të tre burrave ua lidhnin duart pas shpine dhe u lidhnin edhe nyejt e këmbëve.¹⁹²⁶ Gjithsesi ata ishin në gjendje të lëviznin rrotull sepse ishte edhe një metër litar i pashtrenguar.¹⁹²⁷ Gjatë ditës burrat nuk i lidhnin.¹⁹²⁸ Atyre u jepnin fare pak ose aspak ushqim.¹⁹²⁹

539. Pal Krasniqi dhe Skënder Kuqi ishin në gjendje shumë të keqe. Dëshmitari 3 e përshkroi gjendjen e tyre si vijon: “Nuk kam parë askënd në gjendje aq të keqe. Kam parë njerëz të vdekur, të vrarë gjatë luftës, mirëpo njerëz në atë gjendje aq të keqe nuk kisha parë kurrë më parë”.¹⁹³⁰ Gjatë rrahjeve të Pal Krasniqit, Dëshmitari 3 dëgjoi një nga ushtarët e UÇK-së të thoshte se një oficer serb nga Klina e kishte dërguar Pal Krasniqin në Jabllanicë që të merrte të dhëna për municionin dhe numrin e ushtarëve.¹⁹³¹ Pal Krasniqi ishte “krejt i ënjtur”, nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë dhe binte erë e keqe. Ai i kryente nevojat fiziologjike në brekë.¹⁹³² Skënder Kuqi ishte në “gjendje më të keqe”. “Ai ishte i nxirë, gjysma e fytyrës krejt e mavijosur. [...] Frymëmarrjen e kishte shumë të rëndë. Ai ulërinte për shkak të dhimbjeve”.¹⁹³³

540. Dëshmitari 6 dha dëshmi të ngjashme. Sipas tij, Skënder Kuqi ishte në gjendje kritike, dergjej përtokë me sy të mbyllur. Trupin e kishte të ënjtur.¹⁹³⁴ Pal Krasniqi, i cili ishte vetë në gjendje të keqe e ndihmonte Skënder Kuqin të pinte ujë.¹⁹³⁵ Dëshmitari 6 e pa Pal Krasniqin të rrihej me një shkop të trashë.¹⁹³⁶

¹⁹²³ Dëshmitari 3, T. 1552.

¹⁹²⁴ Dëshmitari 3, T. 1563.

¹⁹²⁵ Dëshmitari 3, T. 1571.

¹⁹²⁶ Dëshmitari 3, T. 1553.

¹⁹²⁷ Dëshmitari 3, T. 1553-1554.

¹⁹²⁸ Dëshmitari 3, T. 1554.

¹⁹²⁹ Dëshmitari 3, T. 1563-1564.

¹⁹³⁰ Dëshmitari 3, T. 1545.

¹⁹³¹ Dëshmitari 3, T. 1553.

¹⁹³² Dëshmitari 3, T. 1551.

¹⁹³³ Dëshmitari 3, T. 1551-1552, 1564.

¹⁹³⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5237, 5337.

¹⁹³⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5235, 5336-5337.

¹⁹³⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5235.

541. Dhoma konkludoi se në ditën e tretë të mbajtjes së Dëshmitarit 3, afërsisht më 15 ose 16 korrik 1998, Dëshmitarin 3 e futën në dhomën ngjitur me dhomën ku ishte mbajtur më parë. Atje ndodheshin Lahi Brahimaj dhe dy gra e një burrë dhe të gjithë kishin uniforma të zeza. Dëshmitarit 3 nuk i kujtohej nëse gratë kishin shenja apo emblema në uniforma, kurse burri kishte mbishkrimin “PU” në krah.¹⁹³⁷ Lahi Brahimaj e pyeti Dëshmitarin 3 si hynë forcat serbe në fshatin Gjurgjevik i Madh dhe Dëshmitari 3 u përgjigj se ai nuk kishte qenë asnjëherë në këtë fshat por në Gjurgjevik të Vogël.¹⁹³⁸ Dëshmitari 3 supozoi se ushtarët e UÇK-së mendonin se dikush e kishte parë atë të hynte në fshatin Gjurgjevik i Madh mbi një tank serb.¹⁹³⁹ Më pas Lahi Brahimaj i pyeti të dy gratë nëse dëshironin të ushtroheshin ndaj Dëshmitarit 3 me shkopinj, gjë që ato e bënë për pesë ose dhjetë minuta.¹⁹⁴⁰ Gjithashtu ai i zgjati armën e tij Dëshmitarit 3 dhe i tha të vriste veten sepse Lahi Brahimaj nuk donte të ndynte duart me gjakun e Dëshmitarit 3. Personi tjetër në dhomë i tha Dëshmitarit 3 se ai dhe Lahi Brahimaj do të shkonin në Gllogjan dhe se në rast se Dëshmitari 3 nuk do të rrëfehej kur të ktheheshin, ai do t’i priste fytyrën. Pastaj Dëshmitarin 3 e futën në dhomë.¹⁹⁴¹

542. Dëshmitari 3 dëshmoi se më pas ai vendosi të arratisë sepse priste që ta vrisnin pasi Lahi Brahimaj dhe personi tjetër të ktheheshin. Ai u tha Skënder Kuqit dhe Pal Krasniqit se kishte ndërmend të arratisë dhe se ata mund të iknin me të nëse dëshironin. Dhoma kishte një dritare korniza e së cilës nuk ishte e vendosur si duhej dhe ishte e lidhur me tel. Dëshmitari 3 e hoqi dritaren, doli jashtë saj dhe ia dha vrapit drejt pyllit dhe përgjatë një përroi.¹⁹⁴² Ishte afërsisht ora 13:00.¹⁹⁴³ Ndaj Dëshmitarit 3 u hap zjarr dhe Dëshmitari 3 pa se Skënder Kuqi nuk kishte mundur të arrinte përgjatë përroit. Skënder Kuqi i cili kishte plagë më të rënda se Dëshmitari 3, nuk ishte në gjendje të vraponte apo të ecte kështu që ai ishte zvarritur.¹⁹⁴⁴ Dëshmitari 6 i cili po shikonte nga kuzhina, pa Dëshmitarin 3 kur hapi dritaren dhe ndihmoi Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin të dilnin nga dritarja.¹⁹⁴⁵ Edhe Pal Krasniqi nuk ishte në gjendje të vraponte për shkak të plagëve dhe ata të dy u kapën.¹⁹⁴⁶

543. Dëshmitari 6 pa Hamza Brahimajn dhe ushtarë të tjerë “duke rrahur dhe torturuar” Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin në lëndinë. Ata të dy i tërhoqën zvarrë në dhomën ku i mbanin dhe

¹⁹³⁷ Dëshmitari 3, T. 1564-1567; Prova materiale P407.

¹⁹³⁸ Dëshmitari 3, T. 1566-1568.

¹⁹³⁹ Dëshmitari 3, T. 1571-1572.

¹⁹⁴⁰ Dëshmitari 3, T. 1566, 1570.

¹⁹⁴¹ Dëshmitari 3, T. 1567-1568, 1570, 1707.

¹⁹⁴² Dëshmitari 3, T. 1570-1571.

¹⁹⁴³ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5237.

¹⁹⁴⁴ Dëshmitari 3, T. 1571.

¹⁹⁴⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5237-5238, 5338, 5389.

¹⁹⁴⁶ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5237-5238.

“torturat” dhe rrahjet vazhduan.¹⁹⁴⁷ Dëshmitari 6 dëgjoi se Skënder Kuqi u çua në spitalin e Glllogjanit në Deçan, ditën kur u orvat të ikte.¹⁹⁴⁸

544. Midis dëshmisë së Dëshmitarit 6 dhe asaj të Dëshmitarit 3 ka një mospërputhje lidhur me ditën e orvatjes për arratisje. Dëshmitari 3 dëshmoi se ai mendonte se kishte kaluar dy net dhe tri ditë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë¹⁹⁴⁹ para se të orvatej të arratisë, kurse Dëshmitari 6 dëshmoi se orvatja për arratisje ndodhi ditën kur sollën Pal Krasniqin dhe Dëshmitarin 3.¹⁹⁵⁰ Dhoma pranon se jo çdo hollësi në kujtesën e tyre është e qartë dhe e saktë për shkak të distancës kohore. Megjithëse Dhoma i konsideron si Dëshmitarin 6, po ashtu edhe Dëshmitarin 3, të besueshëm, ajo thekson se Dëshmitari 3 mori pjesë personalisht në ngjarjet e përshkruara dhe pranon se kujtesa e tij për hollësitë e ngjarjeve është më e qartë. Rrjedhimisht Dhoma pranon dëshminë e Dëshmitarit 3 se orvatja për arratisje ndodhi në ditën e tretë të mbajtjes së tij dhe të Pal Krasniqit në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, me fjalë të tjera më 15 ose 16 korrik 1998.

545. Edhe Shefqet Kabashi dëshmoi mbi mbajtjen e Skënder Kuqit dhe Pal Krasniqit në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Në procesin *Limaj*, ai dëshmoi se në fillim ose në mes të korrikut 1998, ai pa Pal Krasniqin, për të cilin tha se ishte nga Klina, dhe Skënder Kuqin i cili ishte nga një fshat afër fshati të tij,¹⁹⁵¹ në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁹⁵² Lahi Brahimaj e pyeti Shefqet Kabashin nëse i njihnte ata dy njerëz duke e përmendur njërin prej tyre si fqinji i Shefqet Kabashit, dhe i tha se fqinji i tij ishte “peshk i madh”, që do të thoshte spiun, dhe se ai punonte për “shërbimin sekret jugosllav”.¹⁹⁵³ Kabashi kërkoi të fliste me Pal Krasniqin sepse ishte shok i vëllait të Palit. Pal Krasniqi i tha Shefqet Kabashit se nuk dinte pse ndodhej atje, se kishte ardhur për t’u anëtarësuar në UÇK, se kishte qenë ushtar për një javë dhe se pastaj e kishin sjellë aty të dyshuar si spiun. Kabashi vuri re se ai ishte keqtrajtuar.¹⁹⁵⁴ Më pas Lahi Brahimaj u largua me një ushtar të UÇK-së të quajtur Bandash. Kabashi foli sërish me Pal Krasniqin. Pal Krasniqi i tha Shefqet Kabashit se e kishin keqtrajtuar egërsisht dhe e kishin detyruar të pranonte se një inspektor i forcave serbe të sigurimit nga Peja e kishte dërguar që të merrte të dhëna nga UÇK-ja.¹⁹⁵⁵ Më pas Kabashi u largua nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë. Kur u kthye, ai e gjeti Pal Krasniqin atje. Kabashi dëgjoi se

¹⁹⁴⁷ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5237, 5239-5240.

¹⁹⁴⁸ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5239-5240, 5341, 5388-5390.

¹⁹⁴⁹ Dëshmitari 3, T. 1547.

¹⁹⁵⁰ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5389, *shih* edhe T. 5231, 5239-5240.

¹⁹⁵¹ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁹⁵² Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4255.

¹⁹⁵³ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4255.

¹⁹⁵⁴ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4255-4256.

¹⁹⁵⁵ Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4256-4257.

Skënder Kuqi ishte orvatur të ikte bashkë me një person që sipas Kabashit quhej Naser. “Naseri” arriti të ikte, kurse Skënder Kuqin e kapën dhe e kthyen te objekti.¹⁹⁵⁶

546. Gjatë procesit *Limaj*, Shefqet Kabashi nuk u pyet nga Mbrojtja lidhur me këtë dëshmi.¹⁹⁵⁷ Gjithashtu Dhoma thekson se dëshmia e Shefqet Kabashit në procesin *Limaj* lidhur me orvatjen për arratisje është dëshmi e bazuar në thëniet e të tjerëve. Dhoma rikujton se kur Shefqet Kabashi u pyet në këtë proces për Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin, ai fillimisht tha se nuk i kishte parë këta dy persona në Jabllanicë,¹⁹⁵⁸ kurse më tej tha se nuk mund t’i përgjigjej kësaj pyetjeje.¹⁹⁵⁹ Kur dëshmoi para Dhomës, atij nuk i kujtohej ndonjë ngjarje në Jabllanicë lidhur me këta dy persona.¹⁹⁶⁰ Kur iu tregua transkripti i dëshmisë së tij në procesin *Limaj*, Shefqet Kabashi konfirmoi se në procesin *Limaj* ai kishte përmendur Pal Krasniqin dhe Skënder Kuqin. Mirëpo në gjyq ai deklaroi se nuk i kujtohej kur i kishte parë këta dy persona.¹⁹⁶¹ Kur u pyet nëse gjatë procesit *Limaj* ai i ishte përgjigjur pyetjeve të bëra me sa aq sa dinte dhe me aq sa i kujtohej, ai u përgjigj se nuk di se si ishte në atë kohë dhe si është tani dhe se nuk mund të tregonte ndryshimin midis rrethanave të atëherëshme dhe të tanishme.¹⁹⁶² Duke marrë parasysh se në procesin *Limaj*, Shefqet Kabashi nuk u pyet nga Mbrojtja lidhur me dëshminë e tij mbi Jabllanicën, se disa pjesë të rëndësishme të dëshmisë së Shefqet Kabashit bazohen në thëniet e të tretëve, dhe duke marrë parasysh gjithashtu sjelljen e Shefqet Kabashit para Dhomës, Dhoma nuk është e bindur se dëshmia e Shefqet Kabashit e shtjelluar shkurtimisht në paragrafin e mësipërm është bindëse në masë të mjaftueshme. Rrjedhimisht Dhoma nuk do ta marrë në konsideratë këtë dëshmi.

547. Një dëshmitar tjetër që dëshmoi mbi ngjarjet e lartpërmendura është Dëshmitari 80. Ai dëshmoi se një herë kur ndodhej në objektin e UÇK-së në Jabllanicë¹⁹⁶³ ai pa Lahi Brahimajn duke rrahur Dëshmitarin 3.¹⁹⁶⁴ Ai dëshmoi se Dëshmitarin 3 e prunë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me një armë.¹⁹⁶⁵ Ai dëshmoi se në rrahjen e Dëshmitarit 3 morën pjesë edhe dy femra.¹⁹⁶⁶

¹⁹⁵⁶ Shefqet Kabashi, Prova materiale P120 (transkripti *Limaj*), T. 4257-4258.

¹⁹⁵⁷ *Shih* Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4277, 4298.

¹⁹⁵⁸ Shefqet Kabashi, T. 360.

¹⁹⁵⁹ Shefqet Kabashi, T. 381.

¹⁹⁶⁰ Shefqet Kabashi, T. 381.

¹⁹⁶¹ Shefqet Kabashi, T. 388.

¹⁹⁶² Shefqet Kabashi, T. 425.

¹⁹⁶³ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

¹⁹⁶⁴ Dëshmitari 80, T. 2353.

¹⁹⁶⁵ Dëshmitari 80, T. 2353.

¹⁹⁶⁶ Dëshmitari 80, T. 2353-2354.

Lahi Brahimaj e rrahu Dëshmitarin 3 me një copë apo shkop druri dhe pastaj atë e larguan. Rrahja zgjati rreth 10-15 minuta; Dëshmitari 80 pa vetëm një herë rrahje ndaj Dëshmitarit 3.¹⁹⁶⁷

548. Gjithashtu Dëshmitari 80 dëshmoi se ai pa kur rrahën Skënder Kuqin, ish-mësuesin e tij, në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁹⁶⁸ Dëshmitari 80 dëshmoi se Skënder Kuqin e prunë në Jabllanicë pas Dëshmitarit 80.¹⁹⁶⁹ Dy persona të cilët Dëshmitari 80 nuk i njihete, e kishin rrëmbyer Skënder Kuqin nga kafeneja e tij në Zahaq dhe Dëshmitari 80 pa me sytë e vet kur Skënder Kuqin e prunë në Jabllanicë në vendbagazhin e makinës së tij. Dëshmitari 80 dëshmoi se më pas Lahi Brahimaj dhe vëllai i tij Nazmi Brahimaj e akuzuan Skënder Kuqin si bashkëpunëtor të serbëve. Dëshmitari 80 dëshmoi se ai pa se Skënder Kuqin e rrahën derisa humbi ndjenjat. Personi më aktiv në rrahje ishte Myftar Brahimaj (Ibrahimi), ku morën pjesë edhe ushtarë të tjerë. Edhe Lahi Brahimaj mori pjesë në rrahje.¹⁹⁷⁰

549. Dëshmitari 80 dëshmoi se ai e pa Skënder Kuqin pas rrahjes, i cili ishte në një gjendje të tmerrshme. Pas rrahjes, Skënder Kuqi u mbajt “për një kohë të gjatë” në burg. Më pas ai u orvat të arratisë. Dëshmitari 80 dëshmoi se ai vetë ia kishte ofruar këtë mundësi Skënder Kuqit. Mirëpo Skënder Kuqin e kapën dhe e kthyen në burg.¹⁹⁷¹ Sërish, ushtarë të rinj të saporekrutuar e rrahën Skënderin dhe Dëshmitari 80 pa kur Skënderi vdiq si pasojë e rrahjeve.¹⁹⁷² Dëshmitari 80 dëshmoi se të pranishëm gjatë rrahjes së Skënder Kuqit ishin komandant Uki, Alush Agushi, Lahi Brahimaj, Myftar Brahimaj (Ibrahimi) dhe Bandashi.¹⁹⁷³ Ai dëgjoi Myftar Brahimajn (Ibrahimin), Nazmi Brahimajn (Ibrahimin) dhe një person tjetër me mbiemër Ibrahimi të thoshin se do t’a çonin në spital.¹⁹⁷⁴ Dëshmitari 80 dëshmoi se Lahi Brahimaj (Brahimi), Nazmi Brahimaj (Brahimi) dhe Myftar Brahimaj (Ibrahimi) ishin atje dhe urdhëruan që Skënder Kuqi të çohet në spital në Irzniq.¹⁹⁷⁵ Dëshmitari 80 mendonte se ky urdhër u dha pas vdekjes së Skënderit.¹⁹⁷⁶

550. Dëshmitari 80 gjithashtu dëshmoi se trupi i Skënder Kuqit pa rroba dergjej në një vig që transportohej nga disa ushtarë të rinj të UÇK-së.¹⁹⁷⁷ Ai dëshmoi se atje ishin të pranishëm Myftar Brahimaj (Ibrahimi), Nazmi Brahimaj (Ibrahimi), dhe “disa Brahimaj të tjerë” të cilët nuk jetojnë

¹⁹⁶⁷ Dëshmitari 80, T. 2354.

¹⁹⁶⁸ Dëshmitari 80, T. 2354.

¹⁹⁶⁹ Dëshmitari 80, T. 2354.

¹⁹⁷⁰ Dëshmitari 80, T. 2355-2356.

¹⁹⁷¹ Dëshmitari 80, T. 2356.

¹⁹⁷² Dëshmitari 80, T. 2356-2357.

¹⁹⁷³ Dëshmitari 80, T. 2357.

¹⁹⁷⁴ Dëshmitari 80, T. 2366.

¹⁹⁷⁵ Dëshmitari 80, T. 2369-2370.

¹⁹⁷⁶ Dëshmitari 80, T. 2369, 2357.

¹⁹⁷⁷ Dëshmitari 80, T. 2368.

më. Trupi i Skënderit ishte krejt i mavijosur prej rrahjeve. Dëshmitari 80 tha se rrobat e tij ishin të grisura dhe gjymtyrët i kishte të thyera. Gjithashtu Dëshmitari 80 tha se ai mundi të shihte disa nga organet e brendshme të Skënderit.¹⁹⁷⁸

551. Dëshmia e Dëshmitarit 80 për këto ngjarje u kundërshtua nga Mbrojtja. Ajo veçanërisht sugjeron se nuk ka të ngjarë ose është i pamundshëm nga pikëpamja mjekësore përshkrimi që Dëshmitari 80 i bëri trupit të Skënder Kuqit në një deklaratë të tij të mëhershme të cilën e konfirmoi në gjyq,¹⁹⁷⁹ se ai pa veshkën e Skënder Kuqit prej një plage të hapur në shpinë dhe se gjuha e tij varej jashtë gojës.¹⁹⁸⁰ Ekspertiza mjekësore mbi të cilën bazohet ky sugjerim i Mbrojtjes nuk përfshihet në prova.

552. Gjithsesi bazuar në tërësinë e dëshmive, Dhoma nuk e konsideron të besueshme dëshminë e Dëshmitarit 80 mbi rrahjen e Dëshmitarit 3 dhe Skënder Kuqit. Dëshmitari 80 dëshmoi se pa Lahi Brahimajn duke rrahur Dëshmitarin 3 dhe se në rrahje morën pjesë edhe dy ushtarë femra.¹⁹⁸¹ Dëshmitari 3 dëshmoi se rrahja ndodhi në dhomën përbri dhomës ku mbahej ai më parë me praninë e Lahi Brahimajt, dy ushtarëve femra dhe një burri, të gjithë me uniforma të zeza.¹⁹⁸² Nuk është e qartë sesi mund t'i shihte rrahjet Dëshmitari 80. Dëshmitari 3 nuk e përmendi atë si të pranishëm gjatë rrahjeve. Dëshmitari 80 dëshmoi se ai nuk ishte ushtar në Jabllanicë, rrjedhimisht nuk ka të ngjarë që ai të ketë qenë ushtari me uniformë të zezë që Dëshmitari 3 pa gjatë rrahjeve. Sido që të jetë, Dëshmitari 3 e njeh Dëshmitarin 80 dhe do ta kishte identifikuar në rast se do ta kishte parë gjatë këtyre ngjarjeve apo në çdo kohë gjatë burgimit të tij. Dëshmitari 80 shpjegoi se ai ishte gjellëbërës në atë objekt gjatë periudhës në fjalë. Edhe nëse do të pranohej kjo dëshmi, është e paqartë arsyeja dhe rrethanat e pranisë së Dëshmitarit 80 si gjellëbërës gjatë marrjes në pyetje dhe rrahjeve në një dhomë të një ndërtese tjetër, relativisht larg vendit ku ai tha se punonte. Dhoma nuk pranon se Dëshmitari 80 ishte i pranishëm gjatë rrahjes së Dëshmitarit 3.

553. Gjithashtu, ndonëse Dëshmitari 80 dëshmoi se Skënder Kuqi u orvat të arratisë, dëshmitari nuk dha hollësi, kurse dëshmitarë të tjerë që e panë ngjarjen, dhanë hollësi. Dëshmitari 80 dëshmoi se Skënder Kuqi u orvat të arratisë me sugjerimin e Dëshmitarit 80. Nuk janë të qarta rrethanat dhe vendi ku Dëshmitari 80 mundi t'i jepte këtë sugjerim Skënder Kuqit. Më sipër Dhoma konkludoi se pasi e sollën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, Skënder Kuqin e mbajtën në një dhomë me Pal

¹⁹⁷⁸ Dëshmitari 80, T. 2369.

¹⁹⁷⁹ Dëshmitari 80, T. 2690-2692.

¹⁹⁸⁰ Dëshmitari 80, T. 2692-2696.

¹⁹⁸¹ *Shih* më sipër, para. 547.

¹⁹⁸² *Shih* më sipër, para. 541.

Krasniqin dhe Dëshmitarin 3.¹⁹⁸³ Skënder Kuqi nuk ishte në gjendje të dilte nga dhoma. Edhe në rast se do të pranonte dëshminë e Dëshmitarit 80 se në atë kohë ai punonte si gjellëbërës, Dhoma nuk mund të pranojë vetëm mbi këtë fakt se Dëshmitari 80 kishte mundësi të komunikonte me Skënder Kuqin mbi arratisjen e tij. Dëshmitari 6, i cili në atë kohë punonte në kuzhinë, dëshmoi se kur u çonte ujë dhe bukë tre të burgosurve, ai shkante deri te dera dhe nuk hynte në dhomë.¹⁹⁸⁴ Dëshmitari 80 gjithashtu dëshmoi se ai e pa rrahjen e Skënder Kuqit. Nuk është e qartë sesi ai mundi t'i shihte rrahjet e Skënder Kuqit që u kryen në dhomën ku mbahej. Prej dëshmimeve nuk del se Dëshmitari 80 ishte në gjendje të shihte një gjë të tillë. Në dëshminë e tij, Dëshmitari 80 nuk e përmendi Pal Krasniqin, edhe pse sikurse konstatoi Dhoma, Pal Krasniqi u mbajt në të njëjtën dhomë me Skënder Kuqin dhe gjithashtu ishte në gjendje të keqe. Po ashtu, as Dëshmitari 3, as Dëshmitari 6 për të cilët Dhoma konkludoi se ishin në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe dëshmuan mbi të njëjtat ngjarje, nuk dëshmuan se panë Dëshmitarin 80 në dhomën e Skënder Kuqit ose diku tjetër në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.

554. Si përfundim, Dhoma nuk është bindur se Dëshmitari 80 ishte i pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe se faktikisht pa rrahjen e Dëshmitarit 3 dhe të Skënder Kuqit. Rrjedhimisht, Dhoma nuk e konsideron të besueshme dëshminë e tij lidhur me këtë aspekt. Dhoma krijoi përshtypjen se ka të ngjarë që Dëshmitari 80 tregoi çfarë kishte dëgjuar nga të tjerë.¹⁹⁸⁵ Dhoma e rrëzon dëshminë e Dëshmitarit 80.

¹⁹⁸³ *Shih* më sipër, para. 534.

¹⁹⁸⁴ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5337.

¹⁹⁸⁵ *Shih* më poshtë, para 606-607.

(ii) Ngjarjet e mëpasshmea. Dëshmitari 3

555. Më sipër Dhoma konkludoi se në ditën e tretë të mbajtjes së tij në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, afërsisht më 15 ose 16 korrik 1998, Dëshmitari 3 hoqi dritaren në dhomën ku mbahej, doli nga dritarja dhe ia dha vrapit.¹⁹⁸⁶ Dëshmitari 3 vrapoi përmes pyllit këmbëzbathur. Ai shkoi te një kushëri në fshatin Buçan ku mori një palë këpucë. Atë natë ai bujti në shtëpinë e një fshatari tjetër. Fshatari tha më vonë se ai nuk mund t'a mbante më gjatë Dëshmitarin 3 sepse atë e ndiqnin. Më së fundi Dëshmitari 3 u kthye në fshatin Jabllanicë të shihte të afërmit e tij. Dëshmitari nuk dha asnjë shpjegim për këtë sjellje të pazakontë të tij. Një nga të afërmit e tij e ftoi Dëshmitarin 3 të bujtonte te shtëpia e tij dhe tha se do të fliste me Lahi Brahimajn. Më vonë ai i tha Dëshmitarit 3 se kishte bërë marrëveshje me Lahi Brahimajn që Dëshmitarit 3 t'i kthehej kallashnikovi dhe Dëshmitari 3 të ishte "njeri i lirë".¹⁹⁸⁷

556. Pas disa ditësh, Lahi Brahimaj e pa Dëshmitarin 3 në Jabllanicë dhe e shau si dhe e akuzoi si tradhtar. Lahi Brahimaj i drejtoi pistoletën Dëshmitarit 3 dhe e çoi në shtëpinë e Lahiut.¹⁹⁸⁸ Pasi shkuan atje, Lahi Brahimaj e rrahu Dëshmitarin 3 dhe e goditi me shuplakë në fytyrë. Ai e akuzoi si tradhtar dhe e shau pse ishte arratisur nga objekti i burgimit, të cilin e quajti "burgu më i madh në Kosovë".¹⁹⁸⁹ Gjithashtu Brahimaj e akuzoi Dëshmitarin 3 se Skënder Kuqi i kishte paguar 10.000 marka gjermane për ta ndihmuar të arratiset, akuzë që Dëshmitari 3 e mohoi. Gjatë këtij incidenti ishte e pranishme edhe njëra nga gratë që e kishte rrahur Dëshmitarin 3 gjatë mbajtjes së tij.¹⁹⁹⁰

557. Pastaj Lahi Brahimaj e çoi Dëshmitarin 3 në të njëjtën makinë me të cilën e kishte çuar më parë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Dëshmitari 3 u detyrua të ulej përpara kurse gruaja u ul pas tij duke ia ngjeshur armën në qafë.¹⁹⁹¹ Ata e çuan Dëshmitarin 3 në një vend rreth pesë minuta larg fshatit me makinë, ku Lahi Brahimaj e nxori Dëshmitarin 3 nga vendi i pasagjerit dhe e futi në vendbagazhin e makinës.¹⁹⁹² Pastaj makina u nis sërish. Në një moment makina ndaloi, Brahimaj çeli vendbagazhin, shau Dëshmitarin 3, nxori armën e tij, ia drejtoi Dëshmitarit 3 dhe tërhoqi këmbëzën. Nga arma doli tym dhe Dëshmitari 3 mendoi se ishte plagosur, mirëpo nuk pa t'i rridhte

¹⁹⁸⁶ *Shih* më sipër, para. 543.

¹⁹⁸⁷ Dëshmitari 3, T. 1573-1575.

¹⁹⁸⁸ Dëshmitari 3, T. 1576.

¹⁹⁸⁹ Dëshmitari 3, T. 1577.

¹⁹⁹⁰ Dëshmitari 3, T. 1578, 1705-1706.

¹⁹⁹¹ Dëshmitari 3, T. 1579.

¹⁹⁹² Dëshmitari 3, T. 1580.

gjak. Brahimaj e mbylli vendbagazhin.¹⁹⁹³ Makina u nis dhe Dëshmitari 3 mësoi se e kishin çuar me makinë në fshatin Gllogjan, në komunën e Deçanit, i cili ishte fshati i Ramush Haradinajt. Atje Dëshmitarin 3 e çuan në shtabin e UÇK-së.¹⁹⁹⁴

558. Në shtabin e UÇK-së, një mashkull biond me uniformë që kishte emblemë të UÇK-së e futi Dëshmitarin 3 në një dhomë. Në atë dhomë ishin “katër, pesë ose dhjetë persona. Biondi i tha Dëshmitarit 3 t’i vendoste duar mbi tryezë dhe e goditi Dëshmitarin 3 në trup me sa fuqi që kishte për 10-15 minuta duke e pyetur ndërkohë çfarë kishte bërë.¹⁹⁹⁵ Në dhomë nuk ishte asnjë epror i biondit.¹⁹⁹⁶ Dëshmitari 3 pa njolla gjaku në mure. Pas pak në dhomë hynë dy të rinj dhe rrahja u ndërpre. Dy të rinjtë e pyetën dëshmitarin për çfarë akuzohej dhe ai u përgjigj se nuk e dinte. Ata e penguan biondin që ta rrihte sërish Dëshmitarin 3. Ata i dhanë Dëshmitarit 3 cigare dhe shkrepëse.¹⁹⁹⁷

559. Pas kësaj, Dëshmitari 3 takoi një person për të cilin mendonte se ishte Ramush Haradinaj, sepse ushtarët e tjerë e quanin “komandanti”.¹⁹⁹⁸ Pas luftës i treguan se ishte Ramush Haradinaj. Në atë kohë ai nuk e njohte Ramush Haradinajn.¹⁹⁹⁹ Komandanti e pyeti Dëshmitarin 3 se kush e kishte çuar në atë objekt. Dëshmitari 3 u përgjigj se ishte Lahi Brahimaj.²⁰⁰⁰ Duket se komandanti u zemërua me këtë veprim të Brahimajt.²⁰⁰¹ Komandanti i dha Dëshmitarit 3 bukë dhe e nxori nga ajo dhomë.²⁰⁰² Komandanti e pyeti nëse mund të bujtonte diku në fshat.²⁰⁰³ Pasi Dëshmitari 3 i tha se nuk kishte ku të bujtonte, komandanti e çoi në një dhomë ku kishin fjetur ushtarët.²⁰⁰⁴ Komandanti e këshilloi Dëshmitarin 3 të qëndronte larg dritares për t’u mbrojtur në rast se do të kishte granatim.²⁰⁰⁵ Komandanti shtoi se në rast se askush nuk do të mund t’u merrte Dëshmitarin 3 nga objekti, komandanti do t’u kthente Dëshmitarin 3 te familja e tij.²⁰⁰⁶ Mirëpo atë natë erdhën Naser Brahimaj dhe Myftar Brahimaj të cilët e transportuan Dëshmitarin 3 me makinë në shtëpinë e një kushëriri të tij dhe komandanti i tha “je i lirë”.²⁰⁰⁷ Haradinaj i tha të qëndronte larg këtyre

¹⁹⁹³ Dëshmitari 3, T. 1581.

¹⁹⁹⁴ Dëshmitari 3, T. 1582-1583.

¹⁹⁹⁵ Dëshmitari 3, T. 1583-1585, 1672.

¹⁹⁹⁶ Dëshmitari 3, T. 1672.

¹⁹⁹⁷ Dëshmitari 3, T. 1585-1586, 1672-1675.

¹⁹⁹⁸ Dëshmitari 3, T. 1586.

¹⁹⁹⁹ Dëshmitari 3, T. 1587, 1715.

²⁰⁰⁰ Dëshmitari 3, T. 1586, 1679.

²⁰⁰¹ Dëshmitari 3, T. 1679-1680.

²⁰⁰² Dëshmitari 3, T. 1586, 1683, 1686.

²⁰⁰³ Dëshmitari 3, T. 1586.

²⁰⁰⁴ Dëshmitari 3, T. 1586, 1686.

²⁰⁰⁵ Dëshmitari 3, T. 1586-1587.

²⁰⁰⁶ Dëshmitari 3, T. 1587-1588.

²⁰⁰⁷ Dëshmitari 3, T. 1587-1588, 1723.

ngjarjeve dhe të kthehej te familja e tij.²⁰⁰⁸ Askush nuk i ra në qafë Dëshmitarit 3 “kurrë më” pas takimit të tij me komandantin.²⁰⁰⁹

b. Skënder Kuqi

560. Më sipër Dhoma konkludoi se afërsisht më 15 ose 16 korrik 1998, Skënder Kuqi u orvat të arratisesh nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, mirëpo ai u kap dhe u rrah keqazi dhe si pasojë u çua në një spital.²⁰¹⁰ Në këtë pikë Dhoma thekson se për dallim nga Dëshmitari 80, Dëshmitari 6 nuk bëri përshkrim fizik të Skënder Kuqit në atë kohë. Dëshmitari 6 nuk e pa më Skënder Kuqin pas asaj dite. Më pas Gani Brahimaj e informoi se Skënder Kuqi kishte vdekur në spital.²⁰¹¹

561. Në korrik 1998, Rrustem Tetaj, komandant në UÇK, u kontaktua nga një burrë që quhej Jusaj, shok i Skënder Kuqit, në lidhje me rrëmbimin e Skënder Kuqit. Jusaj i tha Rrustem Tetajt se Skënder Kuqi ishte rrëmbyer nga UÇK-ja dhe mbahej në Jabllanicë.²⁰¹² Rrustem Tetaj kontaktoi Faton Mehmetajn, i cili i tha Rrustem Tetajt që të fliste me Ramush Haradinajn. Ramush Haradinaj nuk kishte dijeni për këto ngjarje.²⁰¹³ Rrustem Tetaj dhe Ramush Haradinaj shkuan së bashku në shtëpinë e Nazmi Brahimajt në Jabllanicë ku sipas dëshmisë së Rrustem Tetajt ishte vendosur shtabi vendor i UÇK-së.²⁰¹⁴ Me të mbërritur atje, ata folën me Nazmi Brahimajn dhe Ramush Haradinaj i tha Nazmi Brahimajt se Skënder Kuqi duhej liruar menjëherë.²⁰¹⁵ Gjithashtu Rrustem Tetaj dëgjoi kur Ramush Haradinaj i tha Nazmi Brahimajt se “gjëra të tilla nuk duhet të ndodhin më sepse po dëmtojnë kauzën tonë”. Nazmi Brahimaj u tha se një ushtar e kishte plagosur lehtë Skënder Kuqin teksa ai ishte orvatur të arratisesh dhe se ai do të lirohej sapo të bëhej mirë.²⁰¹⁶

562. Edhe Dëshmitari 80 dëshmoi për të njëjtat ngjarje. Ai dëshmoi se Ramush Haradinaj ishte në objektin e UÇK-së në Jabllanicë kur Skënder Kuqi vdiq.²⁰¹⁷ Ramush Haradinaj nuk pa rrahjen e Skënder Kuqit, mirëpo ai pa gjendjen fizike të Skënder Kuqit.²⁰¹⁸ Dëshmitari 80 dëshmoi se pjesëtarët e familjes së Skënder Kuqit erdhën dhe ndërhyjnë.²⁰¹⁹ Ramush Haradinaj ishte shumë i

²⁰⁰⁸ Dëshmitari 3, T. 1687, 1723.

²⁰⁰⁹ Dëshmitari 3, T. 1671, 1688.

²⁰¹⁰ *Shih* më sipër, para. 542-543.

²⁰¹¹ Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5231.

²⁰¹² Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3680.

²⁰¹³ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3680-3682, 3778.

²⁰¹⁴ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3681.

²⁰¹⁵ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3681, 3778, 3852.

²⁰¹⁶ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3682.

²⁰¹⁷ Dëshmitari 80, T. 2373-2374.

²⁰¹⁸ Dëshmitari 80, T. 2379.

²⁰¹⁹ Dëshmitari 80, T. 2375.

shqetësuar mbi çfarë kishte ndodhur me Skënder Kuqin dhe midis Ramush Haradinajt dhe Lahi Brahimajt lindi problem lidhur me çfarë kishte ndodhur me Skënderin. Dëshmitari 80 dëgjoi Haradinajn të thoshte: “Pse ia bëre këtë?”²⁰²⁰ Për arsyet e shpjeguara më parë Dhoma e rrëzoi dëshminë e Dëshmitarit 80 lidhur me mbajtjen e Skënder Kuqit dhe Dëshmitarit 3. Dhoma nuk u bind se Dëshmitari 80 ishte në objektin e UÇK-së në atë kohë dhe se kishte dijeni të drejtpërdrejtë mbi ngjarjet për të cilat dëshmoi dhe se rrjedhimisht dëshmia e tij do të kishte qenë e besueshme. Për të njëjtat arsye Dhoma e rrëzon dëshminë e Dëshmitarit 80 diskutuar në këtë paragraf.

563. Tri ose katër ditë pasi Ramush Haradinaj i kishte thënë Nazmi Brahimajt që të lironte Skënder Kuqin, Ramiz Berisha, i afërm i Skënder Kuqit, i tha Rrustem Tetajt se Skënder Kuqi ende nuk ishte liruar. Rrustem Tetaj, Ramush Haradinaj dhe Ramiz Berisha shkuan në Jabllanicë. Atje Nazmi Brahimaj u tha se Skënder Kuqi ishte dërguar në spitalin e improvizuar në Irzniq, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve, nuk kishin mundur t’ia shpëtonin jetën.²⁰²¹ Ai ishte varrosur në një pyll afër Jabllanicës.²⁰²² Rrustem Tetaj dhe Ramiz Berisha informuan familjen e Skënder Kuqit.²⁰²³ Ramiz Berisha kërkoi që kufoma të rivarrosej në varrezën e fshatit Dubovik, në komunën e Deçanit; Nazmi Brahimaj pranoi.²⁰²⁴

564. Ndër provat është edhe një deklaratë për UNMIK-un e mjekut që u kujdes për Skënder Kuqin në spitalin ushtarak në Irzniq.²⁰²⁵ Sipas kësaj dëshmie, Skënder Kuqin e sollën në spital një person që thirrej “Çergashi” (që do të thotë “jveg”) dhe dy persona të tjerë me uniformë ushtarake të cilët e lanë para derës së spitalit ushtarak dhe u larguan. Skënder Kuqi ishte i çorientuar dhe në kllapi. Ai nuk kishte plagë “të dukshme” në trup, mirëpo kishte shenja të azotemisë dhe trupi i tij ishte i mavijosur dhe paksa i ënjtur gjë që sipas deklaratës kishte të ngjarë të ishte shkaktuar nga “qëndrimi në një vend të papërshtatshëm, në lagështi, në kushte të papërshtatshme”. Të dhënat laboratorike treguan se ai kishte pësuar bllokim të plotë të veshkave që shkaktoi vdekjen. Mjekut nuk i kujtohej kush e kishte marrë kufomën e Skënder Kuqit nga spitali.²⁰²⁶

²⁰²⁰ Dëshmitari 80, T. 2380.

²⁰²¹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3682-3683, 3779-3780.

²⁰²² Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3683, 3780, 3853.

²⁰²³ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3684.

²⁰²⁴ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3853.

²⁰²⁵ Prova materiale P82.

²⁰²⁶ Prova materiale P82; Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3780-3781.

565. Kufoma e Skënder Kuqit ishte varrosur në hyrje të Jabllanicës, afër xhamisë.²⁰²⁷ Në një datë të paidentifikuar, gjatë natës, ushtarë të UÇK-së e zhvarrosën kufomën e Skënder Kuqit.²⁰²⁸ Sipas Rrustem Tetajt, kufoma e Skënder Kuqit ishte e mbuluar me dhe, e nuk kishte shenja të dukshme plagësh të hapura.²⁰²⁹ Për kufomën ishte bërë arkivol dhe kufoma u fut në të.²⁰³⁰ Nazmi Brahimaj u dha Rrustem Tetajt dhe Ramiz Berishës sendet personale të Skënder Kuqit të cilat ata ia dhanë familjes së Skënder Kuqit.²⁰³¹ Makina e Skënder Kuqit nuk u kthye; nga provat del se u përdor në operacione ushtarake.²⁰³²

566. Më 9 mars 2004, me urdhër të gjykatës së Qarkut të Pejës, zyrtarë të ZPZHML-së zhvarrosën kufomën e Skënder Kuqit nga varreza e Dubovikut në prani të familjes së tij dhe një hetuesi të Prokurorisë së Tribunalit.²⁰³³ Aktautopsia e kryer më 12 prill 2004 dhe më pas e konfirmuar nga ZPZHML-ja e UNMIK-ut konkludonte se shkak i vdekjes ishte i papërcaktuar. Gjithsesi në aktautopsi shënohej se lloji dhe vendi i thyerjeve në dërrasën e kraharorit dhe në brinjën e tretë, “në rast se ishin shkaktuar në periudhën para vdekjes, [...] tregonin shtypje të përparme të kraharorit shkaktuar nga një goditje, shkelje të forta me këmbë ose forcë të ngjashme”.²⁰³⁴

567. Bazuar në konstatimet e mësipërme dhe provat shkresore të diskutuara, Dhoma konkludon se Skënder Kuqi vdiq në mes të korrikut 1998, pas orvatjes së tij për t’u arratisur nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë si rezultat i rrahjeve ndaj tij në kohën që u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.

c. Pal Krasniqi

568. Pas orvatjes për arratisje, afërsisht më 15 ose 16 korrik 1998, Pal Krasniqi mbeti në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Ai ishte në gjendje të rëndë. Trupin e kishte krejt të nxirë dhe të mavijosur nga rrahjet, të ënjtur dhe të mbuluar me gjak, gjithashtu ai pështynte gjak.²⁰³⁵ Më 25 korrik 1998 kur Dëshmitari 6 u lirua nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, Pal Krasniqi ishte ende në

²⁰²⁷ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3686; Prova materiale P79.

²⁰²⁸ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3684.

²⁰²⁹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3782.

²⁰³⁰ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3845.

²⁰³¹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3853-3854.

²⁰³² Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3854.

²⁰³³ Harjit Sandhu, Prova materiale P490, para 5-13; Prova materiale P489, f. 2.

²⁰³⁴ Prova materiale P488, f. 4-5.

²⁰³⁵ Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5240.

atë objekt.²⁰³⁶ Nga dëshmitë që disponon Dhoma del se kjo ishte hera e fundit që Pal Krasniqi u pa i gjallë.

569. Ded Krasniqi dëshmoi se nipi i tij Deda, i cili ishte shok i Pal Krasniqit, e informoi se në mes të gushtit 1998, Pal Krasniqi i telefonoi. Sipas Dedës, Pal Krasniqi i tha se ishte në Jabllanicë dhe se kishte shumë para me vete.²⁰³⁷ Gjatë kësaj bisede telefonike, Pali ra dakord që të takohej me Dedën në Gjakovë, mirëpo ai nuk erdhi në takim. Deda nuk dëgjoi më asgjë nga Pal Krasniqi.²⁰³⁸

570. Në një datë të papërcaktuar midis 10 korrikut 1998 dhe fundit të qershorit 1999,²⁰³⁹ Ded Krasniqi dhe vëllai i tij Hila shkuan në Jabllanicë për të pyetur për Pal Krasniqin. Disa ushtarëve në Jabllanicë u kishin thënë se atë e kishin çuar nga Jabllanica në Pejë ose në Klinë.²⁰⁴⁰ Ded Krasniqi mendonte se shprehja “me shku në Pejë” do të thoshte se personi nuk do të kthehej,²⁰⁴¹ mirëpo Dhoma nuk disponon prova që konfirmojnë këtë pretendim.

571. Në shtator ose tetor 2000, në një përpjekje për të gjetur Pal Krasniqin, Ded Krasniqi shkoi në Jabllanicë ku foli me Hamëz Ukshinin, anëtar i UÇK-së të cilin Ded Krasniqi e njihte që më parë.²⁰⁴² Hamëz Ukshini mbante një listë me emrat e anëtarëve të UÇK-së që kishin ardhur dhe ishin nisur nga Jabllanica dhe ai i tha Ded Krasniqit se do të kërkonte për emrin e Palit. Pak kohë më vonë ai i tha Ded Krasniqit se Pal Krasniqi nuk kishte qenë asnjëherë në Jabllanicë.²⁰⁴³

572. Në vijim Ded Krasniqi kontaktoi Alush Agushin, komandant në UÇK, dhe e takoi në Klinë.²⁰⁴⁴ Alush Agushi i tha Ded Krasniqit se Pal Krasniqi kishte qenë me UÇK-në deri në ofensivën serbe në shtator 1998. Në atë kohë UÇK-ja ishte rrethuar nga ushtria serbe dhe Alush Agushi u kishte thënë ushtarëve të tij të shkonin ku të dëshironin.²⁰⁴⁵ Alush Agushi i tha Ded Krasniqit se do t'a kontaktonte pas disa javësh, mirëpo ai nuk e kontaktoi më. Ded Krasniqi zbuloi

²⁰³⁶ *Shih* më sipër, para. 490; Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5239.

²⁰³⁷ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4818-4821.

²⁰³⁸ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4820.

²⁰³⁹ Dëshmitari e lidhi këtë ngjarje me kohën kur forcat serbe granatuan fshatin e tij. Koha e kësaj ngjarjeje nuk është përcaktuar nga provat, mirëpo Dhoma thekson se konflikti i armatosur në Kosovë përfundoi në qershor 1999 dhe pranon se kjo duhet të ketë ndodhur para qershorit të vitit 1999.

²⁰⁴⁰ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4822-4823, 4825.

²⁰⁴¹ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4823-4825.

²⁰⁴² Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4775-4778, 4801-4802;

Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4794-4795.

²⁰⁴³ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4777-4778.

²⁰⁴⁴ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4779-4780.

²⁰⁴⁵ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4783-4784.

se Alush Agushi ishte transferuar në Prishtinë dhe shkoi atje për ta takuar. Gjithsesi ai nuk u lejua të takonte Alush Agushin.²⁰⁴⁶

573. Në tetor ose nëntor 2000, Dëshmitari 6 vizitoi Ded Krasniqin në fshatin e tij.²⁰⁴⁷ Sipas dëshmisë së Ded Krasniqit, Dëshmitari 6 i tha se ishte burgosur së bashku me Pal Krasniqin dhe se Pali ishte keqtrajtuar dhe e kishin larguar nga Jabllanica.²⁰⁴⁸ Dëshmia se Dëshmitari 6 i tha Ded Krasniqit se Pal Krasniqin e kishin larguar nga Jabllanica është dëshmi e dorës së dytë dhe bie në kundërshtim me dëshminë e drejtpërdrejtë të Dëshmitarit 6 në Tribunal. Dhoma e konsideroi Dëshmitarin 6 të besueshëm dhe nuk e pranon dëshminë e Ded Krasniqit lidhur me këtë aspekt.

574. Ded Krasniqi i dha KNKK-së në Krushë të Madhe një deklaratë për zhdukjen e Pal Krasniqit.²⁰⁴⁹ Ded Krasniqit iu tha se një dokument i ZPZHML-së së UNMIK-ut me datë 3 dhjetor 2001 evidenton se Pal Krasniqi u pa për herë të fundit në shtator 1998 në Napolë të komunës së Pejës. Ky dokument nuk përfshihet në prova dhe burimi i këtij informacioni është i paidentifikuar.²⁰⁵⁰

575. Gjetiu Dhoma ka konstatuar se në mes të shtatorit 1998 në liqenin e Radoniqit u gjetën kufoma.²⁰⁵¹ Një nga kufomat, fillimisht me etiketën “R-9”, më pas u identifikua nëpërmjet analizës së ADN-së si kufoma e Pal Krasniqit.²⁰⁵² Kufoma pjesërisht e mbuluar me baltë u gjet më 11 shtator 1998 në kanal in prej betoni që derdhet në liqenin e Radoniqit.²⁰⁵³ Megjithëse duket se fillimisht pati mosmarrëveshje midis ekspertëve mjeko-ligjorë nëse eshtrat ishin dëmtuar nga armë zjarri,²⁰⁵⁴ në aktautopsinë e 13 shtatorit 1998, nënshkruar nga të dy ekspertët mjeko-ligjorë u konstatua “një plagë hyrëse-dalëse shkaktuar nga një predhë prej një arme zjarri të vogël; vrima e

²⁰⁴⁶ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4781.

²⁰⁴⁷ Ded Krasniqi, Prova materiale P51 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4790, 4793, 4795; Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5250-5251, 5357-5358.

²⁰⁴⁸ Ded Krasniqi, Prova materiale P51 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4794.

²⁰⁴⁹ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4815.

²⁰⁵⁰ Ded Krasniqi, Prova materiale P50 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4815-4818.

²⁰⁵¹ *Shih* më sipër, para. 330, 332.

²⁰⁵² Prova materiale P428; *shih* Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 12, 35-36, 40; *shih* gjithashtu më sipër, para. 342. *Shih* gjithashtu *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Parashtrim i Përbashkët i Prokurorisë dhe Mbrojtjes mbi Fakte të Pranuara dhe Shtojcë, 2 nëntor 2011.

²⁰⁵³ Branimir Aleksandriq, Prova materiale P439, para. 62, 121; Dushan Dunjiq, Prova materiale P470, para. 285.

²⁰⁵⁴ Branimir Aleksandriq dëshmoi se nga të gjitha kufomat me etiketat R-1 deri R-10, kufoma R-9 ishte e vetmja ku eshtrat nuk ishin dëmtuar nga armë zjarri, Branimir Aleksandriq, Prova materiale P432 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 6776-6777. Në lidhje me kufomën R-9, Dushan Dunjiq dëshmoi se në kokë kishte një vrimë hyrjeje dhe një vrimë daljeje, se në gjymtyrë kishte thyerje që nuk ishin shkaktuar nga plumbat, Dushan Dunjiq, Prova materiale P470, para. 291.

hyrjes është poshtë qoshes së poshtme të nofullës së majtë dhe vrima e daljes në zonën e eshtrës murore të djathtë”.²⁰⁵⁵ Aktautopsia konkludonte se shkak i vdekjes nuk mund të përcaktohej vetëm prej autopsisë për shkak se kufoma ishte në fazë të avancuar shpërbërjeje.²⁰⁵⁶ Palët pranuan faktin se më 5 dhjetor 2003, Dr. Gasior kreu një autopsi tjetër në kufomën e Pal Krasniqit në morgun e Rahovecit ku konstatoi “kufomë të skeletizuar dhe të çnyjzuar dhe pak a shumë të plotë. Në thesin e kufomës, nuk kishte as veshje, as sende personale. Fluoroskopia zbuloi një bërthamë plumbi në kufomë. Në kokë, trung dhe gjymtyrët e sipërme u gjetën plagë prej armëve të zjarrit”.²⁰⁵⁷ Bazuar në këto prova, Dhoma konkludon se kufoma e Pal Krasniqit u gjet në kanalën prej betoni që derdhet në liqenin e Radoniqit më 11 shtator 1998, me plagë prej armëve të zjarrit në kokë, trung, dhe gjymtyrët e sipërme.²⁰⁵⁸

(c) Përfundim

576. Ngjarjet e vërtetuara më lart përbëjnë akuza për vrasje, trajtim mizor dhe torturim si krim luftime në bazë të Nenit 3 të Statutit. Dhoma është bindur se rrahjet e provuara në këtë pjesë u shkaktuan dhimbje dhe vuajtje të mëdha Skënder Kuqit, Pal Krasniqit dhe Dëshmitarit 3 dhe se rrjedhimisht rrahjet përbëjnë veprimin kriminal të trajtimit mizor dhe torturimit. Duke marrë parasysh shpeshësinë e rrahjeve dhe mjetet e përdorura, Dhoma është bindur se rrahësit vepruan me paramendim. Gjithashtu Dhoma rikujton se gjatë një prej rrahjeve, Dëshmitari 3 u mor në pyetje nga Lahi Brahimaj mbi pjesëmarrjen e tij të pretenduar në një sulm të forcave serbe kundër një fshati²⁰⁵⁹ dhe konkludon se janë vërtetuar elementët e torturimit në lidhje me Dëshmitarin 3. Pas kapjes së Dëshmitarit 3 pasi ai ishte arratisur nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, Lahi Brahimaj e shau, e rrahu sërish dhe shtiu me armë zjarri kundër tij.²⁰⁶⁰ Dhoma gjykon se ky ishte ndëshkim për arratisjen e tij nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë dhe përpjekjen e tij për të ndihmuar të burgosurit e tjerë që të arratiseshin. Dhoma rikujton dëshmitë e analizuar më parë se Skënder Kuqi u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë sepse mendohej se kishte shumë para, dhe pranon se kjo ishte arsyeja e keqtrajtimit të tij. Në këtë mënyrë është vërtetuar synimi konkret për torturimin. Në lidhje me Pal Krasniqin, Dhoma rikujton se ai u akuzua si bashkëpunëtor i forcave serbe dhe për këtë arsye konkludon se përsa i përket rrahjes së Pal Krasniqit është vërtetuar synimi konkret i torturimit.

²⁰⁵⁵ Prova materiale P484, f 5-6.

²⁰⁵⁶ Prova materiale P484, f. 5.

²⁰⁵⁷ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Parashtrim i Përbashkët i Prokurorisë dhe Mbrojtjes mbi Fakte të Pranuara dhe Shtojcë, 2 nëntor 2011.

²⁰⁵⁸ *Shih* më sipër, para. 342.

²⁰⁵⁹ *Shih* më sipër, para. 541.

²⁰⁶⁰ *Shih* më sipër, para. 556-557.

577. Më parë Dhoma konkludoi se Skënder Kuqi pësoi rrahje të shpeshta të rënda në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe se më pas atë e sollën në një spital në Irzniq ku ai vdiq. Në aktautopsinë e autopsisë së kryer vite më vonë pas ngjarjes konkludohej se shkak i vdekjes nuk mund të përcaktohej mirëpo konstatohej se lloji dhe vendi i thyerjeve në kufomë, në rast se ishin shkaktuar para vdekjes tregonin lëndime të shkaktuara nga goditje, shkelje të forta me këmbë ose një forcë e ngjashme.²⁰⁶¹ Bazuar në këto konstatime, Dhoma bindet se vdekja e Skënder Kuqit është vërtetuar dhe se bazuar në provat u shkaktua nga (ndërlikimet) e lëndimeve që iu shkaktuan gjatë rrahjeve në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Duke marrë parasysh se rrahësit ishin të vetëdijshëm mbi gjendjen e përgjithshme fizike të Skënder Kuqit dhe të gjendjes së shkaktuar prej rrahjeve dhe gjithsesi vijuan me rrahjet, Dhoma është bindur se keqbërësit vepruan me dijeninë e gjasës së vdekjes si pasojë e rrahjeve. Dhoma konkludon se akuza e vrasjes së Skënder Kuqit është vërtetuar.

578. Dhoma rikujton se Pal Krasniqi u rrah shpesh dhe keqazi në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.²⁰⁶² Gjithashtu Dhoma rikujton se kufoma e Pal Krasniqit u zbulua në shtator 1998 në liqenin e Radoniqit. Megjithëse aktautopsia nuk mundi të përcaktonte shkakun e vdekjes, ekzaminimi mjeko-ligjor zbuloi plagë prej armëve të zjarrit në kokë, trung dhe gjymtyrët e sipërme.²⁰⁶³ Dhoma nuk mori prova mbi fatin e mëtejshëm të Pal Krasniqit pasi ai u pa për herë të fundit i gjallë nga Dëshmitari 6 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë më 25 korrik 1998. Prokuroria nuk paraqiti prova që të ndriçonin arsyen e gjetjes së kufomës së Pal Krasniqit në liqenin e Radoniqit. Megjithëse ka të ngjarë që Pal Krasniqi të jetë vrarë kur ishte në duar të UÇK-së, kjo është vetëm hamendje. Dhoma nuk mund të përjashtojë opsione të tjera, sidomos duke marrë parasysh se këto ngjarje ndodhën gjatë një konflikti të armatosur dhe se fshati Jabllanicë u prek nga ky konflikt.²⁰⁶⁴ Rrjedhimisht, akuza e vrasjes së Pal Krasniqit nuk është vërtetuar.

579. Lidhur me kushtet e përgjithshme të Nenit 3, Dhoma rikujton se në kohën kur u rrahën, Skënder Kuqi, Pal Krasniqi dhe Dëshmitari 3 ishin të burgosur dhe si pasojë nuk ishin pjesëmarrës aktivë në luftime. Rrahësit, ndër të cilët Nazmi Brahimaj i cili rrahu Skënder Kuqin dhe shkëlmoi Pal Krasniqin dhe Dëshmitarin 3,²⁰⁶⁵ Hamza Brahimaj dhe Naser Brahimaj të cilët rrahën Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin,²⁰⁶⁶ dhe Lahi Brahimaj i cili keqtrajtoi Dëshmitarin 3 dhe ishte i pranishëm

²⁰⁶¹ *Shih* më sipër, para. 566.

²⁰⁶² *Shih* më sipër, para. 539-540.

²⁰⁶³ *Shih* më sipër, para. 575.

²⁰⁶⁴ *Shih* më sipër, para. 287, 289, 291.

²⁰⁶⁵ *Shih* më sipër, para. 534, 537.

²⁰⁶⁶ *Shih* më sipër, para. 530, 534, 537, 543.

gjatë rrahjeve të Skënder Kuqit,²⁰⁶⁷ ishin ushtarë të UÇK-së. Keqbërësit ishin ushtarë të UÇK-së që ishte palë në konfliktin e armatosur dhe viktimat mbaheshin prej tyre në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Bazuar në sa më sipër, Dhoma konkludon se është provuar lidhja dhe si rrjedhojë janë përmbushur kushtet e përgjithshme të Nenit 3 të Statutit.

580. Bazuar në konstatimet e mësipërme dhe duke lënë mënjane për momentin aspektin e përgjegjësisë penale individuale të të Akuzuarve, Dhoma konkludon se janë vërtetuar akuzat e mëposhtme që përbëjnë Pikën 5: akuza e trajtimit mizor dhe torturimit të Skënder Kuqit, Pal Krasniqit dhe Dëshmitarit 3; dhe akuza e vrasjes së Skënder Kuqit.

7. Pika 6

(a) Akuzat në Aktakuzë

581. Në Aktakuzë pretendohet se më 23 maj 1998 ose rreth kësaj date, Naser Lika dhe Fadil Fazlija (Fazliu), shqiptarë kosovarë nga Grabanica, u rrëmbyen në fshatin Zhabel nga ushtarë të UÇK-së të cilët i çuan në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Atje Lahi Brahimaj, Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së kërcënuan Naser Likën dhe Fadil Fazlinë (Fazliun) dhe rreth 20 burra nga fshati Grabanicë. Naser Lika dhe Fadil Fazlija (Fazliu) akuzoheshin si tradhtarë me pretendimin se ishin përkrahës të LDK-së. UÇK-ja i liroi të dy burrat pasi një pjesëtar i familjes ndërhyri dhe kërcënoi me gjakmarrje.²⁰⁶⁸

582. Gjithashtu në Aktakuzë pretendohet se në korrik 1998, Lahi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së e rrëmbyen sërisht Naser Likën në shtëpinë e tij në Grabanicë dhe e prunë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë para Ramush Haradinajt dhe Idriz Balajt. Një ushtar i UÇK-së që thirrej Bandashi e rrahu Naser Likën me një shkop të trashë dhe ushtarë të UÇK-së e goditën në testikuj kur ai dergjej përtokë. Pretendohet se Ramush Haradinaj në mënyrë përsëritëse urdhëroi ndërprerjen dhe rifillimin e rrahjeve dhe e pështyu Naser Likën në fytyrë gjatë rrahjeve. Po ashtu pretendohet se Idriz Balaj kërcënoi se do t'a vriste Naser Likën. Më tej Aktakuza parashton se më pas Naser Lika u burgos për tri ditë në bodrumin e mbushur me ujë të ndërtesës së dytë të objektit dhe u rrah keqazi sërisht. Pretendohet se pas tri ditësh burgimi, Naser Lika u detyrua të punonte në kuzhinën e objektit të UÇK-së në Jabllanicë dhe se afërsisht pas tri javësh, arriti të arratisëj.²⁰⁶⁹

²⁰⁶⁷ *Shih* më sipër, para. 534-535, 541.

²⁰⁶⁸ Aktakuza, para. 64.

²⁰⁶⁹ Aktakuza, para. 65.

583. Prokuroria parashtron se këto akuza përbëjnë një pikë për trajtim mizor dhe torturim, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, kundër tre të Akuzuarve mbi bazën e pretendimit për pjesëmarrjen e tyre në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të pretenduar në Aktakuzë dhe ndryshe mbi bazën e formave të tjera të përgjegjësisë penale individuale sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit.

(b) Përfundime(i) Rrëmbimi nga Zhabeli

584. Më sipër Dhoma arriti në përfundimin se më 19 maj 1998 ose rreth kësaj date, forcat serbe sulmuan fshatin Grabanicë.²⁰⁷⁰ Shumica e meshkujve të fshatit u angazhuan në mbrojtjen e fshatit.²⁰⁷¹ Në mbrojtjen e fshatit ndihmuan edhe ushtarët e UÇK-së.²⁰⁷² Forcat serbe e granatuan rregullisht fshatin Grabanicë.²⁰⁷³ Sulmi zgjati tri ditë.²⁰⁷⁴

585. Ndaj provave të paraqitura në mbështetje të akuzave të Pikës 6 janë ngritur pikëpyetje të mëdha. Për këtë arsye, më poshtë Dhoma do të shtjellojë këto prova para se të nxjerrë përfundimet e veta faktike.

586. Dëshmitari 80 dëshmoi se në ditën e tretë të sulmit kundër Grabanicës në maj 1998, banorët e fshatit që ishin disa qindra nisën të ecnin drejt Jabllanicës.²⁰⁷⁵ Së pari arritën në Bokshiq dhe më tej shkuan në Gllogjanin katolik, në komunën e Pejës.²⁰⁷⁶ Disa nga fshatarët ndenjën në Gllogjan, të tjerët vazhduan drejt Jabllanicës.²⁰⁷⁷ Naser Lika dhe Fadil Fazliu ishin ndër fshatarët që shkuan drejt Jabllanicës.²⁰⁷⁸ Ata kaluan fshatin Gllogjan dhe vazhduan drejt Jabllanicës.²⁰⁷⁹ Në Grykën e Gllogjanit, ata u ndaluan nga Lahi Brahimaj dhe Alush Agushi.²⁰⁸⁰ Lahi Brahimaj akuzoi Naser Likën dhe Fadil Fazliun si tradhtarë dhe ishte shumë i zemëruar dhe agresiv.²⁰⁸¹ Naser Lika dhe Fadil Fazliu vazhduan për në Jabllanicë ku ata u ndaluan sërish nga Alush Agushi, Shaqir Krasniqi dhe Lahi Brahimaj.²⁰⁸² Alush Agushi u mori armët Naser Likës dhe Fadil Fazliut dhe u tha se armët duheshin për mbrojtjen e fshatit Qeskovë.²⁰⁸³

²⁰⁷⁰ *Shih* më sipër, para 155, 444. *Shih* gjithashtu Shtojca Konfidenciale.

²⁰⁷¹ *Shih* Shtojca Konfidenciale. *Shih* Dëshmitari 80, T. 2323, 2474-2475.

²⁰⁷² *Shih* Shtojca Konfidenciale. *Shih* gjithashtu Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4198-4200. Konkretisht, Shefqet Kabashi dëshmoi se më 19 maj 1998, ose rreth kësaj date, ai dhe fshatarë të tjerë shkuan në fshatrat Kpuz, Bokshiq, Qeskovë dhe Grabanicë ku kishte vijë fronti, për t'u angazhuar në luftime.

²⁰⁷³ Dëshmitari 80, T. 2607-2608.

²⁰⁷⁴ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

²⁰⁷⁵ Dëshmitari 80, T. 2347, 2477-2478.

²⁰⁷⁶ Dëshmitari 80, T. 2478. Dhoma thekson se ky është fshat tjetër nga fshati Gllogjan në komunën e Deçanit.

²⁰⁷⁷ Dëshmitari 80, T. 2626.

²⁰⁷⁸ Dëshmitari 80, T. 2347.

²⁰⁷⁹ Dëshmitari 80, T. 2626.

²⁰⁸⁰ Dëshmitari 80, T. 2478.

²⁰⁸¹ Dëshmitari 80, T. 2703-2704.

²⁰⁸² *Shih* Shtojca Konfidenciale.

²⁰⁸³ *Shih* Shtojca Konfidenciale.

587. Dëshmi të tjera tregojnë se pas rënies së Grabanicës, banorët e fshatit vendosën të tërhiqeshin në fshatin Bokshiq. Një dëshmitar pa Lahi Brahimajn bashkë me Malos /si në origjinal/ Agushin në mes të rrugëtimit nga Bokshiqi për në Gllogjanin katolik. Brahimaj ishte i zemëruar për shkak të tërheqjes dhe po shante fshatarët. Lahi Brahimaj i akuzoi si tradhtarë dhe dezertorë.²⁰⁸⁴ Pastaj fshatarët arritën në Gllogjanin katolik, afër Jabllanicës, mirëpo panë se nuk ishin të mirëpritur. U tha se shkak ishte se banorët e Gllogjanit i konsideronin tradhtarë dhe dezertorë dhe “ndoshta njerëzit e Lahi [Brahimajt] u kishin thënë të mos i ndihmonin”.²⁰⁸⁵

588. Dëshmitari 80 dëshmoi se Naser Lika dhe Fadil Fazliu vazhduan udhëtimin e tyre dhe më së fundi arritën në Zhabel vonë në mbrëmje.²⁰⁸⁶ Fadil Fazliu, Naser Lika dhe një person i tretë me familjen e tij qëndruan në një shtëpi në Zhabel për dy ditë.²⁰⁸⁷ Naser Lika dhe Fadil Fazliu qëndruan në odën, dhoma ku burrat pinë dhe kuvendojnë, e asaj shtëpie që nga momenti i mbërritjes e deri kur u larguan nga Zhabeli.²⁰⁸⁸

589. Sipas Dëshmitarit 80, ditën e dytë të qëndrimit të Naser Likës dhe Fadil Fazliut në Zhabel, në atë shtëpi në Zhabel erdhën dy persona nga Jabllanica, Arbnor Zeneli dhe një komandant që thirrej “Ujku” ose “Pjetër Uka”.²⁰⁸⁹ Pjetër “Ujku” ose “Uka” kishte uniformë të zezë dhe mbante një shpatë.²⁰⁹⁰ Naser Likën dhe Fadil Fazliun i thirrën të dilnin jashtë. Atje, Fadil Fazliu i tha Ujku se ai do të shkonte me Ujkun vetëm po t’u urdhëronte Ibrahim Rugova. Ujku nxori pistoletën e vet dhe ia mbështeti në gjoks Fadil Fazliut. Kur Naser Lika u orvat të ndërhynte, Arbnor Zeneli u afrua dhe i mbështeti pistoletën Naser Likës në shpinë ose në gjoks.²⁰⁹¹ Atje erdhën edhe persona të tjerë dhe Naser Likën e Fadil Fazliun i çuan në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.²⁰⁹²

590. Dëshmitari 3 dëshmoi për ngjarje të ngjashme. Ai dëshmoi se gjatë kohës që ishte në Zhabel në shtëpinë e lartpërmendur, ai pa kur erdhën dy burra. Një prej tyre ishte “Ujku”, i afërm i Lahi Brahimajt, i cili kishte uniformë të zezë me emblemën e policisë ushtarake të UÇK-së, dhe tjetri ishte Tahir Qorri, i cili kishte veshur “uniformë ushtarake të zakonshme”.²⁰⁹³ Dëshmitari 3 i pa këta dy persona duke keqtrajtuar Naser Likën dhe Fadil Fazliun në korridorin e shtëpisë. Ujku dhe Qorri

²⁰⁸⁴ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

²⁰⁸⁵ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

²⁰⁸⁶ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

²⁰⁸⁷ *Shih Shtojca Konfidenciale.*

²⁰⁸⁸ Dëshmitari 80, T. 2641.

²⁰⁸⁹ Dëshmitari 80, T. 2347-2348.

²⁰⁹⁰ Dëshmitari 80, T. 2643.

²⁰⁹¹ Dëshmitari 80, T. 2707, 2645. *Shih gjithashtu Dëshmitari 80, T. 2348.*

²⁰⁹² Dëshmitari 80, T. 2707.

²⁰⁹³ Dëshmitari 3, T. 1532-1534.

i quajtën tradhtarë. Incidenti zgjati disa sekonda.²⁰⁹⁴ Përshkrimi prej Dëshmitarit 3 i keqtrajtimit është si vijon: “I pashë në korridor, kur morën Naserin dhe Fadilin duke i rrahur dhe shkelmuar teksa i nxorën jashtë. [...] Të parin pashë Fadilin kur e nxorën. Me të po merrej Qorri. Ai e shtyu Fadilin jashtë derës dhe e shkelmoi. Ujku mori Naser Likën; ai e tërhoqi duke e kapur pas koke dhe gjithashtu e shkelmoi [...], duke zbritur shkallët”.²⁰⁹⁵ Pastaj Dëshmitari 3 pa kur Ujku dhe Qorri i morën me vete. Pas disa javësh, Dëshmitari 3 e takoi Naser Likën në një fshat tjetër. Naser Lika i tregoi se pas incidentit, e kishin çuan në “shtabin e Jabllanicës” dhe e kishin rrahur atje.²⁰⁹⁶

591. Dëshmitari 80 dëshmoi se kur Fadil Fazliu dhe Naser Lika erdhën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, atje ndodheshin rreth 20-30 banorë të Grabanicës të cilët i kishin sjellë atje me forcë. Atyre u thanë të ktheheshin në fshatin e tyre dhe të luftonin kundër forcave serbe.²⁰⁹⁷ Naser Likës i ofruan diçka për të ngrënë, mirëpo ai refuzoi dhe Lahi Brahimaj i tha një ushtari të UÇK-së të quajtur Bandash që të fliste me të. Bandashi, i cili mbante një shkop të trashë, iu afrua Naser Likës dhe e kërcënoi.²⁰⁹⁸ Një person i quajtur Gani i ftoi Naser Likën dhe Fadil Fazliun të shkonin në kuzhinë dhe të hanin.²⁰⁹⁹ Gjatë kohës në Jabllanicë Fadil Fazliu e rrahën, kurse Naser Likën jo.²¹⁰⁰

592. Dëshmitari 80 dëshmoi se Ramush Haradinaj ishte i pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë gjatë këtyre ngjarjeve dhe se i dëgjoi kërcënimet që Lahi Brahimaj, vëllai i Lahut, Nazmiu dhe të tjerë nga shtabi i UÇK-së u bënë fshatarëve.²¹⁰¹ Ramush Haradinaj nuk foli me fshatarët në këtë incident.²¹⁰²

593. Naser Lika dhe Fadil Fazliu ishin në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për disa orë deri kur disa nga të afërmit dhe shokët e tyre ndërhyrën dhe i morën Naser Likën dhe Fadil Fazliun.²¹⁰³ Ata bënë të ditur se në rast se Naser Lika dhe Fadil Fazliu nuk liroheshin, do të kishte luftë midis familjeve.²¹⁰⁴ Banorët e Grabanicës u larguan në drejtime të ndryshme.²¹⁰⁵

594. Gjatë marrjes në pyetje të Dëshmitarit 80, Mbrojtja e ballafaqoi dëshmitarin me faktin se Fadil Fazliu, dëshmitar në gjykimin e parë *Haradinaj*, dha një dëshmi të ndryshme të këtyre

²⁰⁹⁴ Dëshmitari 3, T. 1532-1535.

²⁰⁹⁵ Dëshmitari 3, T. 1534-1535.

²⁰⁹⁶ Dëshmitari 3, T. 1536.

²⁰⁹⁷ Dëshmitari 80, T. 2348-2349, 2577-2578.

²⁰⁹⁸ Dëshmitari 80, T. 2348-2349.

²⁰⁹⁹ Dëshmitari 80, T. 2647-2648.

²¹⁰⁰ Dëshmitari 80, T. 2661, 2666.

²¹⁰¹ Dëshmitari 80, T. 2382.

²¹⁰² Dëshmitari 80, T. 2386.

²¹⁰³ Dëshmitari 80, T. 2349, 2578-2579.

²¹⁰⁴ Dëshmitari 80, T. 2654-2655.

²¹⁰⁵ Dëshmitari 80, T. 2655.

ngjarjeve.²¹⁰⁶ Dëshmia e Dëshmitarit 80 para Dhomës ndryshon në aspekte thelbësore nga dëshmia e Fadil Fazliut në gjykimin e parë *Haradinaj* e cila u lexua në gjykatë nga avokati i Mbrojtjes në këtë proces. Mirëpo, Fadil Fazliu nuk është dëshmitar në këtë proces dhe dëshmia e tij në gjykimin e parë *Haradinaj* nuk u pranua në këtë proces.

595. Dëshmia e diskutuar më lart e Dëshmitarit 80 ngre disa probleme. Dëshmitari 80 dëshmoi se gjatë rrugëtimit për në Zhabel, Naser Lika dhe Fadil Fazliu u ndaluan dy herë nga Lahi Brahimaj dhe Alush Agushi, dhe se herën e dytë ua morën armët.²¹⁰⁷ Gjithashtu dëshmia e Dëshmitarit 80 për Dhomën se Naser Lika nuk u rrah në objektin e UÇK-së në Jabllanicë²¹⁰⁸ duket se bie në kundërshtim me rrëfimin që Naser Lika i bëri Dëshmitarit 3 pak kohë pas ngjarjeve, konkretisht se atë e kishin rrahur në Jabllanicë.²¹⁰⁹ Më parë Dhoma shprehu dyshimet e veta serioze mbi besueshmërinë e Dëshmitarit 80.²¹¹⁰ Dhoma nuk është bindur se dëshmia e lartpërmendur e Dëshmitarit 80 është e besueshme dhe nuk e pranon atë.

596. Dëshmitari 3 dëshmoi mbi largimin me dhunë të Fadil Fazliut dhe Naser Likës nga Zhabeli.²¹¹¹ Kur gjatë pyetjeve të veta Mbrojtja i tregoi Dëshmitarit 3 dëshminë e Fadil Fazliut në gjykimin e parë *Haradinaj*, dëshmitari deklaroi pa mëdyshje se dëshmia e Fadil Fazliut nuk ishte e vërtetë.²¹¹² Përgjithësisht Dhoma e konsideron të besueshëm Dëshmitarin 3 dhe e pranon dëshminë e tij lidhur me këto ngjarje. Dëshmitari 3 i identifikoi personat që morën Fadil Fazliun dhe Naser Likën nga Zhabeli si “Ujku” dhe Tahir Qorri.²¹¹³ Bazuar në dëshminë e Dëshmitarit 3, Dhoma konkludon se ushtarë të UÇK-së larguan me dhunë nga Zhabeli Naser Likën dhe Fadil Fazliun dhe se ushtarët e UÇK rrahën dhe shkelmuan Naser Likën dhe Fadil Fazliun në Zhabel. Dhoma gjykon se dëshmia nuk përcakton identitetin e këtyre ushtarëve të UÇK-së.

597. Të vetmet dëshmi të paraqitura nga Prokuroria në mbështetje të pretendimeve në Aktakuzë mbi këto ngjarjet në objektin e UÇK-së në Jabllanicë pas largimit me dhunë nga Zhabeli të Naser

²¹⁰⁶ *Shih* Dëshmitari 80, T. 2632-2633, 2704-2705, 2642, 2644-2645, 2652-2653, 2647-2649, 2650-2652.

²¹⁰⁷ *Shih* më sipër, para. 586.

²¹⁰⁸ *Shih* më sipër, para. 591.

²¹⁰⁹ *Shih* më sipër, para. 590.

²¹¹⁰ *Shih* më sipër, para. 552-554.

²¹¹¹ *Shih* më sipër, para. 590.

²¹¹² Dëshmitari 3, T. 1639-1640.

²¹¹³ Pjetër Shala me pseudonimin “Ujku” (Pjetër Shala, Prova materiale P69 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 9938; Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 41), dëshmitar në këtë proces, nuk përmend ndonjë ngjarje të tillë në dëshminë e tij. Dëshmitari 80, të cilin Dhoma nuk e konsideron të besueshëm, jep një dëshmi të ndryshme. Megjithëse Dhoma e konsideron Dëshmitarin 3 të besueshëm, duke marrë parasysh rrethanat dhe veçanërisht mundësinë e kufizuar që kishte Dëshmitari 3 për t'i parë këta dy persona, Dhoma gjykon se dëshmia e Dëshmitarit 3 është e pamjaftueshme për përcaktimin e identitetit të ushtarëve të UÇK-së.

Likës dhe Fadil Fazliut janë dëshmia e Dëshmitarit 80 dhe dëshmia e dorës së dytë e Dëshmitarit 3 se Naser Lika i tregoi që e kishin rrahur në Jabllanicë. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma nuk i pranon këto dëshmi. Pretendimet në Aktakuzë mbi këto ngjarje nuk janë vërtetuar.

(ii) Burgimi dhe keqtrajtimi i Naser Likës

598. Prokuroria paraqiti vetëm një dëshmitar në mbështetje të pretendimeve të Aktakuzës mbi burgimin e mëpasshëm të Naser Likës në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, Dëshmitarin 80. Dhoma i ka shprehur që më parë dyshimet e veta serioze mbi besueshmërinë e këtij dëshmitari. Më poshtë Dhoma do të shtjellojë shkurtimisht pjesën përkatëse të dëshmisë së Dëshmitarit 80.

599. Dëshmitari 80 dëshmoi se Hajdar Dula, ushtar apo komandant, e çoi Naser Likën nga fshati Buçan në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Shokët e Naser Likës ndërhyjnë sërish dhe pas disa ditësh ai u lirua.²¹¹⁴ Dëshmitari 80 dëshmoi se gjatë këtyre ditëve Naser Likën e rrahën.²¹¹⁵ Ai gjithashtu dëshmoi se në rrahjen e Naser Likës morën pjesë rekrutët e rinj, mirëpo kryesorët ishin Bandashi dhe Pjetër “Ujku”.²¹¹⁶

600. Gjithashtu Dëshmitari 80 dëshmoi se Naser Lika u rrah dhe u mbajt në bodrum bashkë me persona të tjerë të cilët Dëshmitari 80 nuk i njohte. Ai dëshmoi se në bodrum kishte ujë, tel me gjemba dhe kripë. Dëshmitari 80 dëshmoi se Naser Lika u mbajt në burg për tri ditë rresht. Herë pas herë atë e nxirrnin jashtë për t’u rrahur dhe pastaj e kthenin prapë brenda.²¹¹⁷ I pari që e rrahu Naser Likën në Jabllanicë ishte Lahi Brahimaj, bashkë me një person të thirrur “Bandashi” i cili ishte shtatmadh.²¹¹⁸ Ata thanë se Naser Lika ishte i një partie që ata nuk e pëlqenin dhe se dikush u kishte treguar se ai kishte marrë pjesë në sulmin kundër fshatit Qeskovë dhe e kishin parë mbi një tank të forcave serbe.²¹¹⁹

601. Dëshmitari 80 dëshmoi se Lahi Brahimaj e rrihte Naser Likën me sende të forta, për shembull me shkopinj të posaçëm, dhe gjithashtu “sende gome të përdorura më parë prej serbëve”.²¹²⁰ Në rrahje morën pjesë edhe ushtarë të rinj. Alush Agushi, Nazmi Brahimaj, Myftar

²¹¹⁴ Dëshmitari 80, T. 2349.

²¹¹⁵ Dëshmitari 80, T. 2351.

²¹¹⁶ Dëshmitari 80, T. 2351.

²¹¹⁷ Dëshmitari 80, T. 2415.

²¹¹⁸ Dëshmitari 80, T. 2415-2416.

²¹¹⁹ Dëshmitari 80, T. 2416.

²¹²⁰ Dëshmitari 80, T. 2416-2417.

Ibrahimi (Brahimaj) dhe Naser Ibrahimaj (Brahimaj) ishin të pranishëm gjatë rrahjeve. Naser Lika u rrah disa herë gjatë burgimit të tij.²¹²¹

602. Sipas Dëshmitarit 80, Idriz Balaj ishte i pranishëm gjatë rrahjeve të Naser Likës. Balaj ishte shumë “euforik” dhe tha: “Jam këtu vetëm për të vrarë njerëz”.²¹²² Ai e bëri këtë deklaratë kur Lahi Brahimaj dhe Bandashi e rrahën Naser Likën me shkopinj.²¹²³

603. Dëshmitari 80 dëshmoi se pasi u rrah nga Bandashi dhe Lahi Brahimaj, Naser Likën e futën në bodrum për tri ditë. Atë e rrahën disa herë të njëjtët persona dhe ushtarë të rinj.²¹²⁴ Dëshmitari 80 dëshmoi se Gani Ibrahimaj (Brahimaj), personi përgjegjës për kuzhinën, dhe Lahi Brahimaj urdhëruan që Naser Lika të punonte në kuzhinë.²¹²⁵

604. Dëshmitari 80 dëshmoi se Naser Lika u largua nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë pasi kishte qëndruar afërsisht tri javë atje, “në fund të majit, fillim të qershorit, ose dikur në qershor 1998” kur forcat serbe ndërmorën një sulm kundër të gjithë zonës. Ai u arratis.²¹²⁶ Më parë Dhoma konkludoi në këtë Aktgjykim se forcat serbe sulmuan Jabllanicën më 2 ose 3 gusht 1998, ose rreth këtyre datave.²¹²⁷

605. Dëshmia e Dëshmitarit 80 për këto ngjarje u kundërshtua. U tha se dëshmia e Dëshmitarit 80 lidhur me arsyen e mbajtjes së Naser Likës në Jabllanicë²¹²⁸ është e njëjtë me përgjigjet e dhëna nga Dëshmitari 3 për të njëjtat pyetje.²¹²⁹ Gjithashtu u tha se Dëshmitari 80 i kishte diskutuar këto ngjarje me Dëshmitarin 3 dhe kishte përvetësuar elementë të dëshmisë së Dëshmitarit 3.²¹³⁰

606. Megjithëse Dhoma nuk është në dijeni të ndonjë bisede të mundshme të Dëshmitarit 3 me Dëshmitarin 80, Dhoma nuk mund të mos konstatojë ngjashmëri të theksuar në dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve. Dëshmitari 3 dëshmoi se teksa e rrihnin, Lahi Brahimaj e pyeti si kishin hyrë forcat serbe në fshatin Gjurgjevik i Madh dhe se dikush e kishte parë të hynte në fshat mbi një tank

²¹²¹ Dëshmitari 80, T. 2417.

²¹²² Dëshmitari 80, T. 2418.

²¹²³ Dëshmitari 80, T. 2418-2419, 2423.

²¹²⁴ Dëshmitari 80, T. 2423.

²¹²⁵ Dëshmitari 80, T. 2351.

²¹²⁶ Dëshmitari 80, T. 2424.

²¹²⁷ *Shih* më sipër, para. 289.

²¹²⁸ Konkretisht, se “ata” nuk e pëlqenin “partinë e tij”, se ai akuzohej se kishte marrë pjesë në një sulm kundër një fshati dhe se dikush e kishte parë mbi një tank të forcave serbe, *shih* më sipër, para. 600.

²¹²⁹ Dëshmitari 80, T. 2697-2700, përmend Dëshmitarin 3, T. 1571, dëshmon se pretendohet se atë e kishin parë mbi një tank të forcave serbe dhe se ndihmoi serbët të hynin në fshatin Gjurgjevik.

²¹³⁰ Dëshmitari 80, T. 2699-2700.

serb.²¹³¹ Lidhur me arsyen e rrahjes së Naser Likës, Dëshmitari 80 dëshmoi se dikush u kishte thënë ushtarëve të UÇK-së se Naser Lika kishte marrë pjesë në sulmin kundër fshatit Qeskovë dhe e kishin parë mbi një tank të forcave serbe.²¹³² Dëshmitari 80 dha një përshkrim të hollësishëm të rrahjes së Dëshmitarit 3 nga Lahi Brahimaj dhe nga dy ushtarë, kurse në dëshminë e Dëshmitarit 3 dhe të gjitha dëshmitë e tjera nuk përmendet prania e Dëshmitarit 80 gjatë rrahjeve dhe është e paqartë se si mundi t'i shihte këto ngjarje.²¹³³ Dëshmitari 3 dëshmoi se ai u tha Skënder Kuqit dhe Pal Krasniqit se kishte ndërmend të arratisej dhe se ata mund të iknin me të nëse dëshironin.²¹³⁴ Sipas Dëshmitarit 80 ishte ai vetë që i ofroi Skënder Kuqit mundësinë e arratisjes.²¹³⁵ Dëshmitari 3 dëshmoi se Skënder Kuqi kishte qenë mësuesi i tij në shkollën fillore.²¹³⁶ Dëshmitari 80 gjithashtu dëshmoi se Skënder Kuqi ishte mësuesi i tij,²¹³⁷ ndonëse Dhoma thekson se Skënder Kuqi ishte vetëm pak vjet më i vjetër se Dëshmitari 80. Gjithashtu Dhoma thekson se kur Dëshmitari 80 u pyet për herë të parë nëse kishte kontaktuar me Dëshmitarin 3, ai e mohoi.²¹³⁸ Mirëpo më pas, Dëshmitari 80 pranoi se kishte kontaktuar me Dëshmitarin 3.²¹³⁹

607. Ka edhe probleme të tjera lidhur me besueshmërinë e Dëshmitarit 80. Ai dëshmoi se një nga burrat që punonin në kuzhinë kishte të njëjtin emër me Dëshmitarin 6. Gjatë një interviste të mëhershme me Prokurorinë, Dëshmitari 80 e kishte identifikuar Dëshmitarin 6 në fotografi si personi që punonte në kuzhinë.²¹⁴⁰ Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja u tha se Dëshmitari 6 kishte dëshmuar se nuk e njohte Dëshmitarin 80.²¹⁴¹ Dhoma rikujton dëshminë e Dëshmitarit 6 se ai nuk e njohte Dëshmitarin 80, se nuk e kishte parë kurrë në Jabllanicë dhe se ai nuk ishte në Jabllanicë, në kohën kur Dëshmitari 6 ndodhej atje.²¹⁴² Më parë Dhoma konstatoi se Dëshmitari 6 u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë nga 13 qershori 1998 deri më 25 korrik 1998.²¹⁴³ Megjithëse nga dëshmia e Dëshmitarit 80 nuk është e qartë se në çfarë periudhe Dëshmitari 80 thotë se ishte i pranishëm në Jabllanicë, Dhoma rikujton se Dëshmitari 80 dëshmoi për ngjarje që kishin të bënin me Skënder Kuqin dhe Dëshmitarin 3 dhe për këtë arsye konkludon se dëshmia e Dëshmitarit 80

²¹³¹ *Shih* më sipër, para. 541.

²¹³² *Shih* më sipër, para. 600.

²¹³³ *Shih* më sipër, para 541, 547.

²¹³⁴ *Shih* më sipër, para. 542.

²¹³⁵ *Shih* më sipër, para. 549.

²¹³⁶ *Shih* më sipër, para. 533.

²¹³⁷ *Shih* më sipër, para. 548.

²¹³⁸ Dëshmitari 80, T. 2522.

²¹³⁹ Dëshmitari 80, T. 2527.

²¹⁴⁰ Dëshmitari 80, T. 2680-2684, 2686; Prova materiale D212.

²¹⁴¹ Dëshmitari 80, T. 2685-2686.

²¹⁴² Dëshmitari 6, Prova materiale P84 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5381-5382; Dëshmitari 6, Prova materiale P85 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5381-5382.

²¹⁴³ *Shih* më sipër, para. 481, 490.

synonte të mbulonte së paku një pjesë të periudhës që Dëshmitari 6 kaloi në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Dhoma e konsideroi të besueshëm Dëshmitarin 6 dhe pranon se Dëshmitari 6 nuk e pa Dëshmitarin 80 në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.

608. Duke marrë parasysh këto probleme si edhe shqetësimet e shprehura më parë nga Dhoma në Aktgjykim, dhe përfundimet e veta të mëparshme mbi besueshmërinë e Dëshmitarit 80,²¹⁴⁴ Dhoma nuk pranon asnjë pjesë të dëshmisë së Dëshmitarit 80 si të besueshme dhe rrjedhimisht e rrëzon krejt dëshminë e Dëshmitarit 80.

609. Prokuroria nuk ka paraqitur prova të tjera lidhur me akuzat për burgimin dhe rrahjen e Naser Likës në objektin e UÇK-së në Jabllanicë që përfshihen në Pikën 6. Rrjedhimisht këto akuza nuk janë vërtetuar.

(c) Përfundim

610. Më sipër Dhoma konkludoi se ushtarë të UÇK-së larguan me dhunë nga Zhabeli Naser Likën dhe Fadil Fazliun dhe se ushtarët e UÇK-së rrahën dhe shkelmuan Naser Likën dhe Fadil Fazliun në Zhabel. Dhoma bindet se këto veprime të ushtarëve të UÇK-së përbëjnë veprimin kriminal të trajtimit mizor dhe torturimit dhe se ushtarët e UÇK-së vepruan me paramendimin e duhur. Gjithashtu Dhoma rikujton se gjatë incidentit ushtarët e UÇK-së i quajtën Fadil Fazliun dhe Naser Likën “tradhtarë” dhe për arsyet e lartpërmendura konkludon se është vërtetuar synimi i nevojshëm konkret për torturim. Duke marrë parasysh se keqbërësit ishin ushtarë të UÇK-së dhe viktimat u quajtën “tradhtarë”, Dhoma bindet mbi ekzistencën e lidhjes. Gjithashtu mbi bazën e provave që disponon, Dhoma është bindur se Naser Lika dhe Fadil Fazliu nuk merrnin pjesë aktive në luftime dhe se rrjedhimisht janë përmbushur kushtet e përgjithshme të Nenit 3. Duke lënë mënjane për momentin aspektin e përgjegjësisë penale individuale të të Akuzuarve, Dhoma është bindur se janë vërtetuar akuza e trajtimit mizor dhe akuza e torturimit lidhur me largimin e dhunshëm të Naser Likës dhe Fadil Fazliut nga Zhabeli.

611. Nuk është vërtetuar asnjë prej akuzave të tjera të ngritura nga Prokuroria në kuadrin e Pikës 6.

²¹⁴⁴ *Shih* më sipër, para 552-554.

VII. PËRGJEGJËSIA

612. Të tre të Akuzuarit akuzohen në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit. Në Aktakuzë pretendohet se Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj janë penalisht përgjegjës për krimet që përfshihen në çdo pikë të Aktakuzës si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (“NPK”). Më tej pretendohet se Lahi Brahimaj mban përgjegjësi penale individuale nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK, për krimet e përfshira në Pikën 1, 2, 4, dhe 6.

613. Ndryshe, Ramush Haradinaj akuzohet për kryerje ose ndihmë dhe inkurajim të krimeve të Pikës 1 dhe urdhërim, nxitje, ose ndihmë dhe inkurajim të krimeve të Pikës 6. Idriz Balaj akuzohet ndryshe për kryerje ose ndihmë dhe inkurajim të krimeve të Pikës 1 dhe për kryerje, planifikim ose ndihmë dhe inkurajim të krimeve të Pikës 6. Lahi Brahimaj akuzohet ndryshe për urdhërim, nxitje ose ndihmë dhe inkurajim të krimeve të Pikës 1 dhe 2 dhe për kryerje, planifikim ose ndihmë dhe inkurajim të krimeve të Pikës 6 të Aktakuzës.

A. Ligji

614. Në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit lexohet:

Një person që ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose ndryshe që ka ndihmuar dhe inkurajuar, planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e një krimi të përmendur në Nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti, është individualisht përgjegjës për krimin.

1. Kryerja

615. “Kryerja” e një krimi është “kryerja fizike nga vetë shkelësi, ose moskryerja e fajshme e një veprimi të detyrueshëm prej një rregulle të së drejtës penale”.²¹⁴⁵ Veprimi i nevojshëm kriminal i kryerjes konsiston në faktin se i akuzuari mori pjesë fizikisht ose ndryshe drejtpërsëdrejti në elementët materialë të përcaktuar prej Statutit, përmes veprimeve ose mosveprimeve, qoftë vetëm apo së bashku me të tjerë.²¹⁴⁶ Synimi i nevojshëm kriminal është se i akuzuari veproi duke synuar të kryente krimin ose i vetëdijshëm për gjasën thelbësore të kryerjes së një krimi si pasojë e sjelljes së tij.²¹⁴⁷

²¹⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 188; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, para. 60; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 478; Aktgjykimi i Apelit *Seromba*, para. 161; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 218-219.

²¹⁴⁶ Aktgjykimi *Limaj*, para. 509.

²¹⁴⁷ Aktgjykimi *Limaj*, para. 509.

2. Kryerja nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale

616. Në bazë të doktrinës së NPK-së, një person i cili ka kontribuar në realizimin e një qëllimi të përbashkët kriminal nga një grup personash, mban përgjegjësi penale për krimet që rezultojnë prej kësaj varësisht prej kushteve të përshkruara më poshtë.²¹⁴⁸ Jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar tri kategori të NPK-së. Veprimi kriminal i një pjesëmarrësi në NPK është i përbashkët për të tri kategoritë.

617. Së pari është e nevojshme ekzistenca e një bashkësie individësh.²¹⁴⁹ Nuk është e nevojshme që pjesëmarrësit në një ndërmarrje të përbashkët kriminale të jenë të organizuar në një strukturë ushtarake, politike apo administrative.²¹⁵⁰ Mirëpo, Dhoma Gjyqësore duhet të identifikojë bashkësinë e individëve pjesëmarrës në NPK konkretisht dhe sa më saktësisht.²¹⁵¹ Nuk është i domosdoshëm identifikimi me emër i secilit pjesëmarrës. Varësisht nga rrethanat e çështjes, identifikimi i kategorive apo grupeve të individëve mund të jetë i mjaftueshëm.²¹⁵²

618. Së dyti, duhet provuar ekzistenca e një plani, projekti apo qëllimi të përbashkët që rezulton në kryerjen e një krimi të përcaktuar në Statut ose përfshin kryerjen e atij krimi.²¹⁵³ Nuk kërkohet që anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të kenë rënë dakord mbi objektivin e përbashkët kriminal paraprakisht dhe shprehimisht; ai mund të jetësohet spontanisht dhe ekzistenca e tij mund të deduktohet prej fakteve.²¹⁵⁴ Dhoma Gjyqësore duhet të përkufizojë qëllimin e përbashkët kriminal duke përcaktuar objektivin e paramenduar kriminal dhe kuadrin e tij, për shembull kufijtë gjeografikë dhe kohorë të këtij objekti dhe identitetet e përgjithshme të viktimave të paramenduara.²¹⁵⁵ Dhoma Gjyqësore duhet të provojë se krimi i paramenduar në mënyrë të përbashkët ose për fajësinë sipas kategorisë së tretë të NPK, *shih* më poshtë, krimi i parashikueshëm, ka ndodhur faktikisht.²¹⁵⁶ Që të vërtetohet ekzistenca e NPK-së, krimi në fjalë

²¹⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 190.

²¹⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100.

²¹⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 96; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 64.

²¹⁵¹ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 156-157; Aktgjykimi i Apelit *Limaj*, para. 99; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 116.

²¹⁵² Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 156; Aktgjykimi i Apelit *Limaj*, para. 104; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100. *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 69.

²¹⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 31; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq* para. 100. Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 81, 96; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 73; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 704.

²¹⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227. *Shih* gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 109; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 96, 115-119; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 418.

²¹⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

²¹⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

duhet të jetë pjesë e qëllimit të përbashkët. Rrjedhimisht, në rastet kur keqbërësi kryesor nuk bën pjesë në NPK, Dhoma Gjyqësore duhet të bindet se Prokuroria ka provuar se krimi mund t'i ngarkohet së paku një anëtari të NPK-së dhe se ky anëtar kur përdori keqbërësin kryesor, veproi në përputhje me planin e përbashkët.²¹⁵⁷ Ekzistenca e një lidhjeje të tillë midis një anëtari të përbashkët të NPK-së dhe autorit kryesor të krimit vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit.²¹⁵⁸

619. Së treti, i akuzuari duhet të ketë marrë pjesë në projektin e përbashkët,²¹⁵⁹ ose nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në kryerjen e krimit të paramenduar, ose duke ndihmuar apo kontribuar në zbatimin e qëllimit të përbashkët.²¹⁶⁰ Nuk është e nevojshme që kontributi i të akuzuarit në realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal të jetë thelbësor.²¹⁶¹ Gjithsesi, kontributi i të akuzuarit në planin e përbashkët duhet të jetë të paktën i konsiderueshëm.²¹⁶² Megjithëse një kontribut i tillë mund të arrihet nëpërmjet kryerjes prej të akuzuarit si autor kryesor i një krimi që bën pjesë në objektivin e përbashkët, edhe sjellja e cila e marrë veçazi nuk është kriminale, mund ta provojë këtë element nëse kjo sjellje konsiston në mundësimin apo dhënien e ndihmës për zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal.²¹⁶³ Mosveprimi sjell përgjegjësi penale sipas paragrafit 1 të Nenit 7, kur ekziston detyrim ligjor për të vepruar.²¹⁶⁴ Nuk është e nevojshme që pjesëmarrësi i NPK-së të jetë i pranishëm në kohën e kryerjes së krimit nga autori i drejtpërdrejtë i krimit.²¹⁶⁵

620. Lidhur me synimin kriminal, kushtet e tri kategorive të NPK-së ndryshojnë.²¹⁶⁶ Në kategorinë e parë bazë të NPK-së, i akuzuari ka synimin të kryejë krim dhe ky synim është i përbashkët për të gjithë bashkëfajtorët.²¹⁶⁷ Në rrethana të caktuara, synimi mund të deduktohet prej dijenisë si edhe vijimësisë së pjesëmarrjes të marra së bashku.²¹⁶⁸

621. Kategoria e tretë ka të bëjë me çështje në të cilat një nga pjesëmarrësit kryen një krim jashtë planit të përbashkët. Në raste të tilla synimi kriminal është dyplanësh. Së pari, i akuzuari duhet të

²¹⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, 430; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225-226, 235.

²¹⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 169.

²¹⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227.

²¹⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227.

²¹⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 98.

²¹⁶² Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 675.

²¹⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 31, 81; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 96, 99; Aktgjykimi i Apelit *Babiq*, para. 38; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 215, 218, 695; Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 466.

²¹⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 175.

²¹⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81.

²¹⁶⁶ Dhoma konstaton se në Aktakuzë pretendohen vetëm NPK 1 dhe NPK 3.

²¹⁶⁷ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220, 228.

²¹⁶⁸ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 697.

ketë pasur synim për pjesëmarrje dhe kontribut në qëllimin e përbashkët kriminal. Së dyti, që të mbajë përgjegjësi për krimet të cilat nuk ishin pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal, por gjithsesi ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e tyre, i akuzuari duhet të jetë i vetëdijshëm për gjasën e kryerjes së një krimi të tillë nga një anëtar i grupit ose një person i përdorur nga një anëtar i grupit dhe ta marrë vullnetarisht përsipër rrezikun përkatës duke marrë pjesë në atë ndërmarrje ose duke vijuar pjesëmarrjen në të.²¹⁶⁹ Problemi nëse krimet e kryera jashtë qëllimit të përbashkët të NPK-së ishin “pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e tyre” duhet analizuar duke marrë parasysh dijeninë e të akuzuarit konkret, me fjalë të tjera Prokuroria duhet të provojë se i akuzuari kishte dijeni të mjaftueshme se krimet e tjera ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme.²¹⁷⁰

3. Planifikimi

622. Përgjegjësia penale lind kur një ose më shumë persona planifikojnë kryerjen e një krimi si në fazën përgatitore, po ashtu edhe në zbatim. Veprimi kriminal i planifikimit është se një ose më shumë persona planifikojnë ose projektojnë sjelljen kriminale që konsiston në një ose më shumë krime të përkufizuara prej Statutit të cilat kryhen më vonë.²¹⁷¹ Mjafton të provohet se planifikimi ishte faktor me ndikim thelbësor në sjelljen kriminale.²¹⁷² Lidhur me synimin kriminal, i akuzuari duhet të ketë vepruar me synimin që krimi të kryhet ose i vetëdijshëm për gjasën thelbësore se në zbatimin e planit do të kryhet krim.²¹⁷³ Fajësia në lidhje me planifikimin nuk dikton që i akuzuari të ketë pozitë eprore.²¹⁷⁴

4. Nxitja

623. “Nxitja” është përkufizuar si “shtyj dikë tjetër në kryerjen e një vepre penale”.²¹⁷⁵ Më tej duhet të ndodhë kryerja e një vepre penale.²¹⁷⁶ Si veprimet, po ashtu edhe mosveprimet mund të

²¹⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 204; 227-228; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 83. *Shih gjithashtu Prokurori k. Radovan Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5/18-AR72.4, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë që Apelon Vendimin e Dhomës Gjyqësore mbi Parashikueshmërinë për NPK III, 25 qershor 2009, para. 18.

²¹⁷⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 86.

²¹⁷¹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 479; Aktgjykimi i Apelit *Milloseviq*, para. 268; Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 601; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 443; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 268.

²¹⁷² Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 479; Aktgjykimi i Apelit *Milloseviq*, para. 268.

²¹⁷³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 29, 31; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 479; Aktgjykimi i Apelit *Milloseviq*, para. 268.

²¹⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kanyarukiga*, para. 258.

²¹⁷⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 27; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 280; Aktgjykimi *Limaj*, para. 514; Aktgjykimi *Popoviq*, para. 1007; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1870; Aktgjykimi *Gotovina*, Vëllimi II, para. 1958.

jenë nxitje, si e shprehur po ashtu edhe e nënkuptuar.²¹⁷⁷ Shtytja që përbën nxitje jo domosdoshmërisht është e drejtpërdrejtë apo publike.²¹⁷⁸ Duhet provuar se midis nxitjes dhe kryerjes së krimit ekziston një lidhje në atë masë sa nxitja të ketë kontribuar thelbësisht në kryerjen e krimit.²¹⁷⁹ Gjithsesi nuk është e nevojshme të provohet se krimi nuk do të ishte kryer pa implikimin e të akuzuarit.²¹⁸⁰ Lidhur me synimin kriminal, i akuzuari duhet të ketë synimin që krimi të kryhet ose të jetë i vetëdijshëm për gjasën thelbësore të kryerjes së krimit si pasojë e nxitjes.²¹⁸¹ Nxitja nuk kushtëzon praninë e të akuzuarit në vendin e krimit, ndonëse mund të jetë ndër faktorët që merren parasysh për të provuar synimin kriminal të nxitësit.²¹⁸²

5. Urdhërimi

624. Veprimi kriminal i urdhërimit është se një person në pozitë pushteti *de jure* ose *de facto* udhëzon një person tjetër që të kryejë një vepër penale.²¹⁸³ Kjo formë përgjegjësie kushtëzon që i akuzuari të ketë pushtet, qoftë *de jure* apo *de facto*, për të urdhëruar kryerjen e krimit.²¹⁸⁴ Ndryshe nga nxitja, urdhërimi konkretizohet nëpërmjet veprimit dhe nuk mund të realizohet nëpërmjet mosveprimit.²¹⁸⁵ Pushteti mund të jetë *de jure* ose *de facto*, dhe gjithashtu mund të jetë i nënkuptuar; me fjalë të tjera, nuk është e nevojshme që të jetë lidhje “zyrtare epror-vartës”.²¹⁸⁶ Nuk është e nevojshme që i akuzuari t’i japë drejtpërsëdrejti urdhër personit që kryen veprën penale, mirëpo urdhri mund të përcillet përmes hierarkisë komanduese ku çdo person në rast se vepron me synimin e duhur kriminal, mund të mbajë përgjegjësi penale për urdhërimin.²¹⁸⁷ Nuk është e nevojshme që urdhri të jetë me shkrim apo në ndonjë formë të veçantë.²¹⁸⁸ Ai mund të jetë i

²¹⁷⁶ Aktgjykimi *Galiq*, para. 168.

²¹⁷⁷ Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 280; Aktgjykimi *Limaj*, para. 514; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1870.

²¹⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit *Akayesu*, para. 483.

²¹⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 27; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 269; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1870.

²¹⁸⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 27.

²¹⁸¹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 32; Aktgjykimi *Gotovina*, para. 1958.

²¹⁸² Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski*, para. 132.

²¹⁸³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 28; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 213; Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 601; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1871.

²¹⁸⁴ Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1870; Aktgjykimi *Limaj*, para. 515; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 270.

²¹⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 176; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1871.

²¹⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 361; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 211; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 176; Aktgjykimi *Kordiq*, para. 388; Aktgjykimi *Popoviq*, para. 1012.

²¹⁸⁷ Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 282; Aktgjykimi *Millutinoviq*, Vëllimi I, para. 87; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 270; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1871.

²¹⁸⁸ Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski*, para. 160; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 281; Aktgjykimi *Limaj*, para. 515; Aktgjykimi *Popoviq*, para. 1012.

shprehur ose i pashprehur.²¹⁸⁹ Për të provuar ekzistencën e urdhrin mund të shfrytëzohen provat rrethore në rast se ekzistenca e një urdhrin të tillë është i vetmi deduksion i arsyeshëm.²¹⁹⁰ Nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë se veprimi nuk do të kishte ndodhur pa urdhrin e të akuzuarit, mirëpo urdhri duhet të ketë pasur “ndikim të drejtpërdrejtë dhe thelbësor në kryerjen e veprimit të paligjshëm”.²¹⁹¹ Synimi i nevojshëm kriminal është që gjatë zbatimit të urdhrin, i akuzuari duhet të synojë kryerjen e veprës penale ose të jetë i vetëdijshëm për gjasën thelbësore të kryerjes së krimit si pasojë e zbatimit ose realizimit të urdhrin.²¹⁹² Urdhërimi nuk kushtëzon praninë e të akuzuarit në vendin e krimit, ndonëse mund të jetë ndër faktorët që merren parasysh për të provuar synimin kriminal të urdhëruesit.²¹⁹³

6. Ndihma dhe inkurajimi

625. Ndihma dhe inkurajimi janë përkufizuar si veprime ose mosveprime që ndihmojnë, inkurajojnë ose i japin mbështetje morale autorit të një krimi konkret dhe që kanë ndikim thelbësor në kryerjen e krimit.²¹⁹⁴ Ashtu si edhe për të gjitha format e tjera të përgjegjësisë penale dytësore, që i akuzuari të shpallet fajtor për ndihmë dhe inkurajim, krimi në fjalë duhet të jetë kryer faktikisht.²¹⁹⁵ Lidhur me veprimin kriminal, nuk është e nevojshme të provohet ekzistenca e lidhjes shkak-pasojë midis sjelljes së individit që ndihmon dhe inkurajon dhe kryerjes së krimit.²¹⁹⁶ Gjithsesi ndihma e dhënë nga ndihmuesi dhe inkurajuesi duhet të ushtrojë ndikim thelbësor në kryerjen e krimit.²¹⁹⁷ Ndihma dhe inkurajimi mund të jepen para, gjatë ose pas kryerjes së krimit

²¹⁸⁹ Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 281.

²¹⁹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski*, para. 160; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 281; Aktgjykimi *Kordiq*, para. 388; Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1871; Aktgjykimi i Apelit *Hategekimana*, para. 67.

²¹⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, para. 76; Aktgjykimi i Apelit *Hategekimana*, para. 67.

²¹⁹² Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 42; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 30; Aktgjykimi *Limaj*, para. 515; Aktgjykimi *Boshkoski*, para. 400; Aktgjykimi *Popoviq*, para. 1010; Aktgjykimi *Gotovina*, para. 1959.

²¹⁹³ Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski*, para. 132.

²¹⁹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 229; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 352; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 45-46, 48; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 89; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 85; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 127; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 482; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 43; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 321; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 49, 81, 146, 159; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 74, 86; Aktgjykimi i Apelit *Ntawukulilyayo*, para. 214; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 162, citon Aktgjykimin *Furunxhija*, para. 249.

²¹⁹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 85; *shih* gjithashtu Aktgjykimi *Gotovina*, para. 1956.

²¹⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 81; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 48; Aktgjykimi *Limaj*, para. 517.

²¹⁹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 48, Aktgjykimi *Boshkoski*, para. 402; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 249; Aktgjykimi *Kunarac*, para. 391; Aktgjykimi *Limaj*, para. 517.

kryesor.²¹⁹⁸ Miratimi dhe inkurajimi i heshtur, bazuar në pushtetin dhe praninë e të akuzuarit në vendin e krimit që kontribuojnë thelbësisht në kryerjen e krimit gjithashtu përbëjnë veprimin kriminal të ndihmës dhe inkurajimit.²¹⁹⁹

626. Mosveprimi mund të përbëjë krimin e ndihmës dhe inkurajimit kur vërtetohet se mospërbushja e një detyrimi ligjor ndihmoi, inkurajoi ose i dha mbështetje morale autorit të krimit dhe pati ndikim thelbësor në realizimin e krimit.²²⁰⁰ Ndhurma dhe inkurajimi nëpërmjet mosveprimit kushtëzojnë që i akuzuari të ketë pasur aftësinë për të vepruar në kuptimin që dispononte mundësinë për përbushjen e detyrimit për të vepruar.²²⁰¹

627. Synimi kriminal i ndihmës dhe inkurajimit konkretizohet nëpërmjet dijenisë së ndihmuesit dhe inkurajuesit se nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të tij, ai ndihmon autorin kryesor të krimit në kryerjen e krimit.²²⁰² Nuk është e nevojshme që ndihmuesi dhe inkurajuesi të kenë të njëjtin synim kriminal si autori kryesor i krimit, mirëpo ai ose ajo duhet të jetë i/e vetëdijshëm/vetëdijshme për synimin kriminal të autorit kryesor të krimit.²²⁰³ Këtu përfshihet synimi konkret i autorit kryesor të krimit, në qoftë se krimi kërkon një synim të tillë.²²⁰⁴ Gjithsesi nuk është e nevojshme që ndihmuesi dhe inkurajuesi të jetë në dijeni të synimit konkret të krimit,

²¹⁹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 48; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 85; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 127, 134; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 482; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 81, 200.

²¹⁹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 273, 277; Aktgjykimi *Boshkoski*, para. 402; Aktgjykimi *Limaj*, para. 517.

²²⁰⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 663; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 175; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 274; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 41, 43; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 49, 81, 134, 156, 200.

²²⁰¹ Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 49, 82, 154.

²²⁰² Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 45-46; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 484, 488; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 127; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 482; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 43; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 321; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 49, 146, 159; Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj*, para. 57-58; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Ntawukulilyayo*, para. 222.

²²⁰³ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 162; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 484, 487-488; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 482; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 43; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 49, 146, 159; Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj*, para. 57-58.

²²⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 52; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 140; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 127; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Ntawukulilyayo*, para. 222.

ose të krimit që faktikisht është kryer; mjafton që ai ose ajo të jetë i/e vetëdijshëm/vetëdijshme se ka të ngjarë të kryhen një numër krimesh dhe se një nga këto krime faktikisht është kryer.²²⁰⁵

B. Përfundime

1. Ndërmarrja e përbashkët kriminale

(a) Qëllimi i përbashkët i pretenduar

628. Më parë në Aktgjykim, Dhoma konkludoi se janë provuar krimet e përfshira në Pikën 3, 4, 5 dhe incidenti në Zhabel i përmendur në Pikën 6. Prokuroria nuk ka paraqitur asnjë provë të drejtpërdrejtë se këto krime u kryen në kuadrin e një NPK-je në të cilën morën pjesë të Akuzuarit. Rrjedhimisht Dhoma duhet të marrë parasysh provat rrethore të paraqitura nga Prokuroria gjatë rigjyimit.

(i) Komunikatat e UÇK-së

629. Dhoma mori si prova komunikata të UÇK-së të pasqyruara në media të cilat përmbajnë informacion për sulme ose “masa” të ndërmarra nga UÇK-ja kundër bashkëpunëtorëve të autoriteteve serbe.²²⁰⁶

630. Komunikatat përpiloheshin bazuar në informacion të marrë nga burime brenda Kosovës.²²⁰⁷ Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nxori shumicën e komunikatave, ndonëse disa komandantë në UÇK lëshonin komunikata vetë në emër të UÇK-së, pa dijeninë e Shtabit të Përgjithshëm.²²⁰⁸ Jakup Krasniqi, anëtarë i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që nga fundi i vitit 1996 ose fillimi i vitit 1997 dhe zëdhënës i UÇK-së nga 11 qershori 1998 brenda Kosovës, shpjegoi se komunikatat ose deklaratat për median ndonjëherë ishin të tepruara dhe përdorshin kryesisht në kuadrin e

²²⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 50; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 482; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 321; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 49, 159; Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj*, para. 57-58.

²²⁰⁶ Prokuroria ka paraqitur një numër komunikatash ku bëhet fjalë për vrasjen ose plagosjen e bashkëpunëtorëve nga UÇK-ja, që gjithsesi kanë të bëjnë me një periudhë para asaj të përfshirë në Aktakuzë, *shih* Prova materiale P131; P136; P137; P139; P142; P143; P145; P146; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4951-4953, 4972-4973, 4975, 5118, 5120-5122; Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojcat 1-2, 4-5; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3319-3326. Meqenëse këto komunikata nuk kanë të bëjnë me periudhën e Aktakuzës, Dhoma nuk do t'i shqyrtojë më tej.

²²⁰⁷ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4953-4954, 4993.

²²⁰⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3314-3315.

propagandës së UÇK-së.²²⁰⁹ Gjithashtu ato bëheshin për të ngritur moralin e ushtarëve të UÇK-së dhe qytetarëve të Kosovës, për të inkurajuar mobilizimin në UÇK dhe për të fituar mbështetjen e qytetarëve të Kosovës, Shqipërisë dhe të bashkësisë ndërkombëtare.²²¹⁰ Megjithëse Jakup Krasniqi pranoi se ngjarjet e përmendura në komunikata shpesh ndodhën në realitet, ai shpjegoi se duke marrë parasysh nivelin e organizimit të Shtabit të Përgjithshëm, qëllimi i komunikatave ishte t'u jepnin përshtypje qytetarëve në Kosovë se UÇK-ja ishte një ushtri e organizuar më së miri dhe të nxirrnin në pah sukseset.²²¹¹ Kishte raste kur sukseset e UÇK-së dhe humbjet e palës kundërshtare fryheshin, kurse humbjet dhe viktimat nga ana e UÇK-së zvogëloheshin.²²¹²

631. Në komunikatën nr. 42 të botuar në gazetën e Prishtinës “Bujku” më 28 shkurt 1998, shkruhet se në janar dhe shkurt, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm u ndërmorën sulme kundër policisë serbe “dhe bashkëpunëtorëve të tyre”, ndër të cilët edhe kundër “kriminelit” Desimir Vasiq “bashkëpunëtor i ngushtë i Arkanit” më 23 janar 1998, dhe kundër “bashkëpunëtorit” Mustafa Kurti më 13 shkurt 1998, i cili u vra.²²¹³ Sipas komunikatës së UÇK-së nr. 47 botuar në gazetën e Prishtinës “Koha Ditore” më 13 maj 1998, nga marsi deri në mes të majit 1998 “ u ndërmorën operacione [...] kundër bashkëpunëtorëve shqiptarë, të cilët me gjithë paralajmërimet që u ishin bërë më parë, nuk hoqën dorë nga veprimet e tyre antikombëtare”.²²¹⁴ Komunikata nuk jep hollësi mbi identitetin e këtyre “bashkëpunëtorëve”, llojin e aksioneve që u ndërmorën kundër tyre, vendin e aksioneve dhe identitetin e sulmuesve. Komunikata e UÇK-së nr. 49, e botuar në gazetën “Koha Ditore” më 13 korrik 1998, bën të ditur se ishin marrë masa “kundër disa bashkëpunëtorëve të

²²⁰⁹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3305, 3311, 3346, 3353-3354, 3377, 3419-3420; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4953-4954, 4968, 5011, 5034-5035, 5044, 5060.

²²¹⁰ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3377, 3420; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4953, 5011, 5039, 5035.

²²¹¹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3420; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4967-4968, 5036-5037. Jakup Krasniqi përmendi një shembull lidhur me një sulm që u raportua në nëntor 1997 nga një njësi speciale e UÇK-së në aerodromin e Goleshit ku një aeroplan u godit dhe u rrëzua (Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4978; Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojca 5; Prova materiale P145, f. 1). Ai nuk kundërshtoi se kjo kishte ndodhur, mirëpo nuk dihej nëse ishte sulm i UÇK-së sepse Jakup Krasniqi nuk besonte se UÇK-ja kishte armë që mund të rrëzonin aeroplanë (Jakup, Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4978). U shpjegua se kjo ishte në përputhje me propagandën e UÇK-së (Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4980).

²²¹² Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5011.

²²¹³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojca 7; Prova materiale P148, f. 1.

²²¹⁴ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojca 13. Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3340.

betuar, të cilët ende punojnë kundër interesave tona kombëtare”.²²¹⁵ Nuk jepen masa se ku, kundër kujt dhe prej kujt u morën këto masa. Jakup Krasniqi konfirmoi se deri më 13 korrik 1998, UÇK-ja ende merrte “masa kundër të gjithë operativëve të dhunshëm të regjimit të Millosheviqi [...] në Kosovë”, përfshirë edhe bashkëpunëtorët.²²¹⁶ Ai nuk saktësoi se ku, prej kujt dhe kundër kujt u morën këto masa ose se çfarë masash u morën.

632. Gjatë dëshmisë së tij në procesin *Limaj*, Jakup Krasniqi iu tregua komunikata nr. 53 e Shtabit të Përgjithshëm e 19 shtatorit 1998. Në këtë komunikatë që u botua në gazetën “Koha Ditore” thuhej se masa ndëshkuese “të llojeve të ndryshme po merreshin edhe kundër elementëve kolaboracionistë të cilët ende i shërbejnë pushtuesit”.²²¹⁷ Jakup Krasniqi konfirmoi se “natyrisht ishin marrë masa kundër të gjithë atyre që dëmtojnë aksionet politike dhe ushtarake të UÇK-së”, ndër të cilët bashkëpunëtorët, pa saktësuar prej kujt, kundër kujt ishin marrë këto masa ose ku dhe çfarë masash ishin marrë.²²¹⁸

633. Komunikata e Shtabit të Përgjithshëm nr. 43 e 4 marsit 1998, botuar në gazetën “Bujku”, jepte një parullë të përgjithshme “vdekje armiqve dhe tradhtarëve!”²²¹⁹ Jakup Krasniqi deklaroi se fjala “tradhtarë” ishte për “bashkëpunëtorët”.²²²⁰ Megjithëse sipas këtij dëshmitari, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së asnjëherë nuk përcaktoi publikisht se cilët persona konsideronte “bashkëpunëtorë” më 1998,²²²¹ ata konsideronin “bashkëpunëtorë” shqiptarët kosovarë që ishin rekrutuar në ushtrinë, policinë apo sigurimin serb, jo ata që ishin kundër luftës.²²²² Dhoma thekson se në procesin *Limaj*, Jakup Krasniqi gjithashtu cilësoi bashkëpunëtorë edhe persona që u përcillnin informacion autoriteteve serbe, për shembull lidhur me lëvizjet e UÇK-së.²²²³

²²¹⁵ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojca 16; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3345-3346.

²²¹⁶ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3350.

²²¹⁷ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3354.

²²¹⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3354.

²²¹⁹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojca 8; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3335-3336; *shih* gjithashtu Prova materiale P145, f. 2.

²²²⁰ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3335-3336.

²²²¹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5088.

²²²² Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5061-5062, 5064-5065, 5115, 5152-5153; *shih* gjithashtu Shefqet Kabashi, Prova materiale P119 (transkripti *Limaj*), T. 4194-4195.

²²²³ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3324-3325, 3329.

634. Sipas dëshmisë së Jakup Krasniqit, UÇK-ja nuk kishte për praktikë të sulmonte civilë, por policinë dhe ushtrinë serbe në zonën e Dukagjinit si dhe në zona të tjera.²²²⁴ Deklarata nr 2. e UÇK-së e datës 27 prill 1998, mbi politikën e vet, në një frymë të ngjashme bënte të ditur se UÇK-ja “dënon terrorizimin dhe forma të tjera dhune kundër popullatës civile dhe robërve”, dhe se “pranon e respekton [...] konventat mbi luftën”.²²²⁵ Jakup Krasniqi dëshmoi se ai nuk kishte dijeni që UÇK-ja të kishte ekzekutuar bashkëpunëtorë të kapur, mirëpo se ai kishte dëgjuar përmes komunikatave se faktikisht UÇK-ja ekzekutonte bashkëpunëtorë jo të kapur.²²²⁶

635. Sikurse u diskutua më lart, komunikatat e UÇK-së ishin pjesë e “fushatës propagandistike” të UÇK-së. Dhoma rikujton dëshminë e Jakup Krasniqit se refreni i përsëritur i hakmarrjes kundër bashkëpunëtorëve në shumë komunikata të UÇK-së duhet interpretuar në kontekstin e “fushatës propagandistike” të UÇK-së e cila synonte të pengonte civilët që ata të mos i shërbenin “regjimit serb”.²²²⁷ Informacioni i komunikatave të UÇK-së mund të jetë fryrë ose ndryshuar për qëllime të kësaj fushate. Për më tepër, Dhoma thekson se informacioni në komunikata mbi incidentet lidhur me “bashkëpunëtorë” është shpesh i mjegullt dhe nuk jep hollësi për kohën dhe vendin e incidentit, identitetin e personit që shkaktoi incidentin dhe identitetin e viktimave, apo nëse viktimat ishin civilë apo ushtarakë. Gjithashtu është veçanërisht i paqartë nëse masat që pretendohet të jenë marrë kundër “bashkëpunëtorëve” u zbatuan në zonën e Dukagjinit dhe nëse u ndërmorën nga ndonjë prej personave që në Aktakuzë akuzohen si anëtarë të NPK-së. Duke marrë parasysh këta faktorë, Dhoma nuk mund të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se provat e lartpërmendura tregojnë ekzistencën e një plani me pjesëmarrjen e të Akuzuarve dhe/ose anëtarëve të tjerë në NPK-në e pretenduar në Aktakuzë “për konsolidimin e kontrollit tërësor të UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit nëpërmjet [ndër të tjera] keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë dhe romë/egjiptianë kosovarë, dhe civilëve të tjerë të cilët ishin ose mendohej se kishin qenë bashkëpunëtorë të forcave serbe ose ndryshe mospërkrahës të UÇK-së”, sikurse pretendohet në Aktakuzë.

(ii) Policia ushtarake e UÇK-së

²²²⁴ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 4959-4961; Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, Shtojca 18, f. 4; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3388-3389.

²²²⁵ Jakup Krasniqi, Prova materiale P65, para. 6, 10 (p. 6), Shtojca 12, f 1-3, *shih* gjithashtu Shtojca 18, f. 4; Shtojca 19, f. 2; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3363. *Shih* gjithashtu Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3359-3360, 3363-3364.

²²²⁶ Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5066, 5114, 5117-5118.

²²²⁷ *Shih* gjithashtu para. 630.

636. Në Dosjen e vetë Përfundimtare, Prokuroria argumenton se pjesëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së kryen keqtrajtimin e individëve që konsideroheshin kundërshtarë të UÇK-së, duke iu referuar “Rregullores së Policisë Ushtarake” numrat 3-4.²²²⁸ Dhoma e analizoi përmbajtjen e kësaj rregulloreje në një pjesë tjetër të Aktgjykimit.²²²⁹ Dhoma rikujton se në pjesët përkatëse të rregullores përcaktohet se policia ushtarake kishte për detyrë “të hetojë dhe të zbulojë nëpërmjet fakteve bindëse të gjithë ata persona që në një mënyrë ose në një tjetër bashkëpunojnë me armikun” dhe “të marrë masa kundër cilitdo që vepron kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”. Mirëpo, provat nuk tregojnë sesi kuptoheshin këto rregulla, a gjenin zbatim dhe nëse po, në çfarë mënyre. Gjithashtu Dhoma rikujton se mori prova që tregojnë se objektivat e policisë ushtarake të UÇK-së ishin që të mundësohej evakuimi i popullatës nga fshatrat; të vëzhgoheshin hyrje-daljet e kujtdo në fshatra; të parandaloheshin veprimet e ndaluara; dhe të zbatoheshin disiplina brenda UÇK-së.²²³⁰ Sikurse diskutohet më në hollësi në një pjesë tjetër të Aktgjykimit, Dhoma konkludoi se faktikisht pjesëtarë të policisë ushtarake u përfshinë në hetimet e incidenteve të zhdukjes së civilëve shqiptarë kosovarë për të cilët thuhej se ishin zhdukur kur kishin qenë në duar të UÇK-së.²²³¹

637. Provat mbi veprimet faktike të policisë ushtarake të UÇK-së në terren nuk e konfirmojnë pretendimin e Prokurorisë se UÇK-ja keqtrajtonte bashkëpunëtorët ose individët që i konsideronte kundërshtarë nëpërmjet policisë ushtarake. Ka prova se një nga viktimat, ndërsa merrej në pyetje dhe rrihej në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, pa një person me uniformë të zeze me mbishkrimin “PU” në krah.²²³² Dhoma mendon se ky rast i vetëm nuk përbën arsye për të konkluduar se në një farë mënyre policia ushtarake e UÇK-së përdorej për realizimin e planit të përbashkët kriminal të pretenduar në Aktakuzë. Nuk ka prova që tregojnë se pati më shumë incidente të tilla të ngjashme.

(iii) “Listat e zeza të UÇK-së”

638. Dhoma mori prova lidhur me lista të ndryshme me emra. Prokuroria argumenton se këto janë “lista të zeza të UÇK-së për individët e dyshuar si mospërkrahës të UÇK-së, simpatizantë të LDK-së kundërshtarë, ose që kishin punuar për autoritetet serbe”.²²³³ Sipas Prokurorisë, këto lista “iu shpërndanë rojeve të UÇK-së në fshatra në mënyrë që ata të pengonin hyrjen e këtyre njerëzve

²²²⁸ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 62-63.

²²²⁹ *Shih* më sipër, para. 112.

²²³⁰ Gjithashtu Dhoma mori prova se policia ushtarake e UÇK-së nuk kishte asnjë rol hetues në shkëljet e forcave të UÇK-së, *shih* më sipër, para. 115-116.

²²³¹ *Shih* më sipër, para. 314, 361.

²²³² *Shih* më sipër, para. 541.

²²³³ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 58.

në fshatra” me “objektivin [...] për të komprometuar ose diskredituar individët e përfshirë në listat e zeza”.²²³⁴

639. Provat përmendin (i) disa lista të gjetura në shtëpitë e familjes Haradinaj në Gllogjan në mars 1998;²²³⁵ (ii) një listë dhënë Dëshmitarit 17 më 12 korrik 1998;²²³⁶ dhe (iii) disa lista të njerëzve “të përfshirë në lista të zeza nga Faton Mehmetaj²²³⁷ dhe Fitnete Ramosaj “për mosbesnikëri ndaj [UÇK-së], për përkrahje të LDK-së, ose se kishin punuar për MPB-në ose [organe] të tjera”.²²³⁸

a. Listat e gjetura në shtëpitë e familjes Haradinaj në Gllogjan

640. Zoran Stijoviqi dëshmoi se më 24 mars 1998, pas incidentit në Gllogjan në komunën e Deçanit, MPB-ja ose RDB-ja kreu një kontroll dhe gjeti disa lista në shtëpitë e familjes Haradinaj. Sipas Zoran Stijoviqit, ndër këto lista përfshiheshin, “lista të anëtarëve të UÇK-së ... ndër të cilët njerëz që ishin në... postëroje”; “lista të policëve në detyrë dhe të mëparshëm të MPB-së”; dhe “lista të shqiptarëve që dyshoheshin për bashkëpunim me forcat e sigurimit serb”.²²³⁹ Zoran Stijoviqi dëshmoi se pas krahasimit të emrave që ishin në listat e gjetura me “regjistrat” e RDB-së serbe për “rrjetin e informatorëve”, MPB-ja dhe RDB-ja arritën në përfundimin se disa nga listat e gjetura në shtëpitë e familjes Haradinaj përmendnin persona që “do të sulmoheshin”.²²⁴⁰ Listat që pretendohet se u gjetën në shtëpitë e familjes Haradinaj nuk u paraqitën si prova.

641. Sipas Zoran Stijoviqit, një nga emrat në listë ishte Murat Haxhocaj, të cilin më pas “një operativ i [RDB-së]” e paralajmëroi se “emri i tij ishte në një listë të gjetur gjatë kontrollit të shtëpisë së familjes Haradinaj”;²²⁴¹ Murat Haxhocajt “iu tha të ishte shumë i kujdesshëm ku shkonte dhe të informonte [RDB-në për lëvizjet e tij]”.²²⁴² Zoran Stijoviqi dëshmoi se një anëtar i familjes së Murat Haxhocajt informoi RDB-në se ai ishte vrrarë nga anëtarë të UÇK-së nga fundi i vitit 1998,

²²³⁴ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 58. *Shih* gjithashtu Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 59-61.

²²³⁵ Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 41-42; Zoran Stijoviq, T. 570.

²²³⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 57-58; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7583-7584; Prova materiale D146, f. 13-14.

²²³⁷ *Shih* më sipër, para. 119-122.

²²³⁸ Rustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 29. Sipas Rustem Tetajt, Fitnete Ramosaj ishte një grua nga Carrabregu, e cila punonte me Faton Mehmetajn, dhe mbulonte median, Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*) T. 3630.

²²³⁹ Zoran Stijoviq, T. 570; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 41.

²²⁴⁰ Zoran Stijoviq, T. 572-573; Zoran Stijoviq, Prova materiale P121, para. 41.

²²⁴¹ Zoran Stijoviq, T. 573-575.

²²⁴² Zoran Stijoviq, T. 575.

ndoshta në tetor ose nëntor 1998.²²⁴³ Dhoma thekson se nga dëshmia nuk del qartë nëse Zoran Stijoviqi pa emrin e Murat Haxhocajt në listë²²⁴⁴ apo mori informacion se ishte në listë, dhe në rast se ishte kështu, prej kujt e mori këtë informacion. Për më tepër, ndonëse nuk ishte Zoran Stijoviqi ai që paralajmëroi Murat Haxhocajn që të ishte i kujdesshëm, ai nuk bën të ditur se prej kujt e mori informacionin se Murat Haxhocaj u paralajmërua.

642. Ndër provat është një raport i SPB-së së Gjakovës ku thuhet se “më 13 nëntor 1998 [...] në fshatin Prekollukë të komunës së Deçanit, një grup terrorist shqiptar kreu një sulm terrorist kundër shtëpisë së Murat Haxhocajt nga ky fshat”.²²⁴⁵ Raporti bën të ditur se Murati dhe i biri “u nxorën nga shtëpia” dhe se “terroristët vranë Muratin dhe djali i tij [...] pësoi një plagë të lehtë – një gërvishtje”.²²⁴⁶ Raporti nuk jep hollësi të tjera. Dhoma gjithashtu thekson se ky incident është jashtë periudhës kohore që mbulon Aktakuza.

643. Gjithashtu Zoran Stijoviqi dëshmoi për Dhomën se dy gra nga familjet “Zukaj” dhe “Coraj” sipas tij mblidhnin të dhëna mbi veprimtaritë e UÇK-së për llogari të forcave të sigurimit serb.²²⁴⁷ Mirëpo, nga dëshmia nuk del nëse emrat e këtyre grave ishin apo nuk ishin në listat e gjetura në shtëpitë e familjes Haradinaj.²²⁴⁸ Dhoma nuk mori prova të tjera lidhur me këto dy gra.

b. Lista e shënimeve me shkrim dore të një mbledhjeje më 12 korrik 1998

644. Dëshmitari 17 dëshmoi se ai mori pjesë në një mbledhje në shtëpinë e Din Krasniqit (komandant në UÇK në Lugun e Baranit), në Vranoc, në komunën e Pejës, më 12 korrik 1998.²²⁴⁹ Në mbledhje ishin të pranishëm edhe përfaqësues të tjerë të UÇK-së, si dhe komandantë të UÇK-së në fshatrat e Lugut të Baranit.²²⁵⁰ Dëshmitari 17 dëshmoi se mbledhja u mbajt për të dhënë informacion mbi ardhjen e brigadës së FARK-ut dhe faktin se oficerët e FARK-ut përfaqësonin qeverinë e Kosovës, dhe për të diskutuar, midis të tjerash, gjendjen në terren, financimin, krijimin e

²²⁴³ Zoran Stijoviq, T. 574-575.

²²⁴⁴ Megjithëse përfaqësuesi i Prokurorisë në pyetje sugjeroi se Zoran Stijoviqi pa lista, në përgjigjen e tij dëshmitari as nuk konfirmoi, as nuk mohoi të kishte parë lista vetë, Zoran Stijoviq, T. 571.

²²⁴⁵ Prova materiale P383, f. 11.

²²⁴⁶ Prova materiale P383, f. 11.

²²⁴⁷ Zoran Stijoviq, T. 571-573.

²²⁴⁸ Nga dëshmia e Zoran Stijoviqit del se një nga dy gratë mund të ketë qenë në listën e gjetur në shtëpitë e familjes Haradinaj, mirëpo nuk është e qartë se për cilën grua flet dëshmitari, Zoran Stijoviq, T. 573.

²²⁴⁹ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7583-7584; Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 56-58.

²²⁵⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 56; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7583-7586.

policisë ushtarake, përdorimin e automjeteve të rënda dhe mobilizimin e forcave.²²⁵¹ Gjatë mbledhjes, Dëshmitari 17 mbajti shënime me shkrim dore.²²⁵²

645. Në këtë mbledhje ose ditën e nesërme, Dëshmitarit 17 “iu dha një listë e personave të kërkuar nga UÇK-ja” dhe ai i shkroi emrat në shënimet e tij.²²⁵³ Në shënimet e tij me shkrim dore përfshihen këto 10 pika nën titullin: “Persona të kërkuar/ose të zhdukur?” (theksi i shtuar): 1. “Zenel”; 2. “Ali”; 3. “Mehmet Alia”; 4. “Tahir Zhukri”; 5. “Zenun Gashi bashkë me të birin”; 6. “Zenel Mehmeti”; 7. “Shekrelet Sadiku bashkë me familjen e vetë”; 8. “Dy gra bashkëpunëtore Turjakë-Kosuriq”; 9. “Misin Berisha - rom, Gllogjan”; dhe 10. “Skënder Sali Kuqi - Lutogllavë”.²²⁵⁴ Dëshmitari 17 dëshmoi se ai nuk i tregoi asnjëherë Ramush Haradinajt për këtë listë.²²⁵⁵

646. Dëshmia lidhur me burimin e kësaj liste është e paqartë. Dëshmitari 17 nuk mbante mend kush ia kishte dhënë listën.²²⁵⁶ Mirëpo, ai përmendi se kishte të ngjarë që listën t’u kishte marrë nga mbajtësi i procesverbalit të mbledhjes apo nga “Din Krasniqi ose dikush tjetër”, por nuk i kujtohej nëse listën e kishte marrë me shkrim apo gojarisht.²²⁵⁷ Dëshmitari 17 gjithashtu dëshmoi se në kohën që bëri shënimet, ai nuk njihte asnjë prej personave të shënuar në fletoren e tij.²²⁵⁸

647. Me gjithë titullin “Persona të kërkuar/ose të zhdukur?” (theksi i shtuar), dëshmia nuk ishte e qartë lidhur me qëllimin e listës. Dëshmitari 17 dëshmoi se “personat e kërkuar kërkoheshin nga UÇK-ja dhe Din Krasniqi”.²²⁵⁹ Në të njëjtën kohë, Dëshmitari 17 pranoi se lista kishte emrat e personave të cilët kërkoheshin prej policëve nën komandën e tij, dhe se ai mendonte se nuk kishte asgjë të parregullt lidhur me listën dhe se ajo nuk ishte provë e ndonjë plani për të kryer krime.²²⁶⁰

648. Dhoma thekson se mori edhe dëshmi të tjera në lidhje me Zenun Gashin, Misin Berishën dhe Skënder Kuqin, tre nga personat që përfshiheshin në lista.²²⁶¹ Lidhur me Zenun Gashin, Dhoma

²²⁵¹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 56.

²²⁵² Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 56; Prova materiale D146, f. 12-13.

²²⁵³ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 57; Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7583-7584; Prova materiale D146, f. 13-14.

²²⁵⁴ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 57; Prova materiale D146, f. 13-14.

²²⁵⁵ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7700.

²²⁵⁶ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 57; Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7584, 7699.

²²⁵⁷ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7584, 7694.

²²⁵⁸ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 58.

²²⁵⁹ Dëshmitari 17, Prova materiale P344, para. 58. *Shih* Shtojca Konfidenciale.

²²⁶⁰ Dëshmitari 17, Prova materiale P342 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 7695, 7700.

²²⁶¹ *Shih* më sipër, para. 343-344, 346-354.

konkludoi se ai ishte vrarë dhe se kishte të ngjarë të ishin implikuar pjesëtarë të UÇK-së.²²⁶² Mirëpo, dëshmitë nuk provuan se arrestimi dhe vdekja e tij erdhën si pasojë e përfshirjes së emrit të tij në listë. Përkundrazi, Dëshmitari 17, i cili e kishte shkruar listën në shënimet e tij, dëshmoi se ai ndërhyri dy herë për të mundësuar lirim të Zenun Gashit.²²⁶³ Lidhur me Misin Berishën, Dhoma konkludoi se ai ishte vrarë, mirëpo për shkak të mungesës së provave nuk nxori përfundime të tjera.²²⁶⁴

649. Dhoma thekson se emri i Skënder Kuqit, i përmendur në Pikën 5 të Aktakuzës, është gjithashtu midis emrave të listës.²²⁶⁵ Dhoma konkludoi se Skënder Kuqin e sollën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë afërsisht më 13 ose 14 korrik 1998 dhe se në lidhje me ngjarjet në objekt u vërtetuan akuzat e trajtimit mizor, torturimit dhe vrasjes së Skënder Kuqit.²²⁶⁶ Dhoma pranoi se ai u mbajt në objekt dhe u keqtrajtua sepse mendohej se kishte shumë para.²²⁶⁷ Dëshmitë nuk provojnë se ai u ndalua, u keqtrajtua dhe së fundi u vra për shkak se emri i tij ishte në listën e 12 ose 13 korrikut 1998. Ndonëse Dhoma mori parasysh afërsinë e datës së përpilimit të listës me atë të prurjes së Skënder Kuqit në objekt, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura, Dhoma nuk e konsideron këtë listë si “listë të zeza”, sidomos për shkak të mungesës së provave mbi burimin dhe qëllimin e listës.

c. “Listat e zeza” të Faton Mehmetajt

650. Dhoma dëgjoi dëshminë e Rrustem Tetajt se “listat e zeza” të Faton Mehmetajt dhe Fitnete Ramosajt “iu shpërndanë rojeve të fshatrave [të UÇK-së], konkretisht në fshatrat që përkrahnin [UÇK-në]”.²²⁶⁸ Sipas Rrustem Tetajt, “rojet duhej të verifikonin identitetet e personave që kalonin përmes fshatrave të tyre dhe t’u ndalonin hyrjen personave emrat e të cilëve ishte në lista”.²²⁶⁹ Ai dëshmoi se për mendimin e tij listat u përpiluan “për të komprometuar personat e listës [të cilët ishin me] parti politike të tjera”, dhe “kundërshtarët që nuk pëlqeheshin”; “qëllimi i kësaj procedure ishte që të komprometoheshin dhe diskreditoreshin njerëzit e lartpërmendur”.²²⁷⁰ Vetë listat nuk u paraqitën si prova.

²²⁶² *Shih* më sipër, para. 355.

²²⁶³ *Shih* më sipër, para. 352-353.

²²⁶⁴ *Shih* më sipër, para. 345.

²²⁶⁵ Aktakuza, para 58-59.

²²⁶⁶ *Shih* më sipër, para. 534, 580.

²²⁶⁷ *Shih* më sipër, para. 576.

²²⁶⁸ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 29.

²²⁶⁹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 29.

²²⁷⁰ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 29; Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3858-3859, 3863.

651. Sipas Rrustem Tetajt, ai vetë ishte përfshirë në një listë të tillë dhe në maj 1998 u mor në pyetje nga Faton Mehmetaj dhe një person i thirrur “Ujku” në fshatin Pozhar, në komunën e Deçanit.²²⁷¹ Gjatë marrjes në pyetje, ai u akuzua se “i jepte informata lidhur me UÇK-në MPB-së në [Pejë]”, me arsyetimin se kishte qenë oficer i APJ-së.²²⁷² Rrustem Tetaj dëshmoi se ai u pyet për dy orë në një atmosferë kërcënuese, mirëpo nuk e keqtrajtoi dhe më pas e lejuan të shkonte.²²⁷³

d. Përfundim

652. Për mendimin e Dhomës, provat e paraqitura në lidhje me listat e lartpërmendura nuk vërtetojnë ekzistencën e qëllimit të përbashkët kriminal të NPK-së pretenduar në Aktakuzë.

²²⁷¹ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 30.

²²⁷² Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 30.

²²⁷³ Rrustem Tetaj, Prova materiale P77, para. 30.

(iv) Incidente të keqtrajtimit dhe vrasjes së civilëve nga ushtarë të UÇK-së

653. Fillimisht Dhoma vëren se Prokuroria paraqiti shumë dëshmi të cilat Dhoma në shumicën e rasteve i gjykoi të pamjaftueshme për vërtetimin e incidenteve konkrete.²²⁷⁴ Arsyeja ishte se shpesh këto dëshmi ishin rrëfime të dëgjuaara prej të tretëve e më tej dhe nuk dihej burimi i tyre. Gjithashtu Dhoma shprehu shqetësimin që kishte mbi besueshmërinë e dëshmive që vinin nga një palë e konfliktit të armatosur, sidomos për shkak të mosidentifikimit të burimit të informacionit dhe mënyrës së përpunimit të tij. Në analizën e mëposhtme nuk trajtohen incidentet midis UÇK-së dhe FARK-ut²²⁷⁵ për arsye se ushtarët e FARK-ut nuk ishin civilë dhe rrjedhimisht incidentet në lidhje me ta nuk kanë ndikim mbi vërtetimin e ekzistencës së qëllimit të përbashkët kriminal të pretenduar në Aktakuzë.

654. Gjithashtu provat e paraqitura për vërtetimin e sulmeve të UÇK-së shpesh ishin fragmentare dhe të paplota. Për shembull, Prokuroria paraqiti prova mbi zbulimin e kufomave në liqenin e Radoniqit, mirëpo paraqiti shumë pak ose aspak prova për vërtetimin e rrethanave të vdekjes së këtyre individëve. Më parë Dhoma konkludoi se kufomat e Misin Berishës, Zenun Gashit, Velizar Stoshiqit, Nurije Krasniqit, Istref Krasniqit, Malush Mehës, Ilire Frrokajt, Kujtim Imerajt, Rade Popadiqit, Vukosava Markoviqit, Darinka Kovaçit, Pal Krasniqit dhe Millka Vllahoviqit u gjetën në kanalën e liqenit të Radoniqit, dhe se kufomat e Mehmet Rustemajt, Tushe Tahirajt dhe Ramiz Tahirajt u gjetën në fermën *Ekonomija*.²²⁷⁶ Dhoma konkludoi se provat e paraqitura nga Prokuroria nuk vërtetuan rrethanat e vdekjes së këtyre personave.²²⁷⁷ Rrjedhimisht, Dhoma nuk do t'i analizojë këto vdekje në lidhje me vërtetimin e ekzistencës së NPK-së pretenduar në Aktakuzë. Për të njëjtat arsye, Dhoma nuk do të analizojë provat mbi kufomat e pidentifikuara.²²⁷⁸

655. Më parë Dhoma konkludoi se janë vërtetuar disa incidente të keqtrajtimit ose vrasjes së civilëve nga ushtarë të UÇK-së në territorin e zonës së Dukagjinit.

656. Konkretisht, Dhoma arriti në përfundimin se më 18 prill 1998, vendbanimi i familjes Stojanoviç u sulmua nga ushtarë të UÇK-së dhe se ushtarët e UÇK-së çuan me dhunë në shtëpinë e Smajl Haradinajt në Gllogjan Mijat Stojanoviçin, Dragosllav Stojanoviçin dhe Veselin Stijoviçin të cilët i keqtrajtuuan gjatë rrugës.²²⁷⁹ Me të mbërritur në shtëpi, ata u keqtrajtuuan sërish.²²⁸⁰ Ndër

²²⁷⁴ *Shih* më sipër, para. 203-235, 238-253, 307-318, 343-372, 381-387.

²²⁷⁵ *Shih* më sipër, para. 264-278.

²²⁷⁶ *Shih* më sipër, para. 342, 381, 384.

²²⁷⁷ *Shih* më sipër, para. 221, 345, 355, 358, 363, 366, 370, 372, 578.

²²⁷⁸ *Shih* më sipër, para. 341, 376, 380.

²²⁷⁹ *Shih* më sipër, para. 183-184, 186-187, 189.

²²⁸⁰ *Shih* më sipër, para. 191-192.

ushtarët e UÇK-së që kryen këto veprime ishin Zeqir Nimonaj, Daut Haradinaj dhe Besnik Haradinaj.²²⁸¹ Dhoma thekson se më 24 mars 1998 u zhvillua luftim midis pjesëtarëve të UÇK-së që ndodheshin në territorin brenda vendbanimit të familjes Haradinaj dhe efektivave të MPB-së që ndodheshin në territorin brenda vendbanimit të familjes Stojanoviq, dhe se atë ditë familja Stojanoviq u largua nga shtëpia e tyre dhe pjesëtarë të familjes Stojanoviq u kthyen për herë të parë më 18 prill 1998 kur edhe u sulmuan.²²⁸² Në këto rrethana, Dhoma nuk mund të përjashtojë mundësinë se sulmi kundër vendbanimit të familjes Stojanoviq më 18 prill 1998 dhe keqtrajtimi i mëpasshëm i Mijat Stojanoviqit, Dragosllav Stojanoviqit dhe Veselin Stijoviqit u kryen si hakmarrje për rolin konkret që mendohej se ata luajtën në luftimin e 24 marsit 1998 midis forcave të MPB-së të pozicionuara në vendbanimin e familjes Stojanoviq dhe forcave të UÇK-së të pozicionuara në vendbanimin e familjes Haradinaj, dhe jo si një incident që ishte pjesë e një plani për keqtrajtimin e serbëve të Kosovës dhe civilëve të tjerë që konsideroheshin bashkëpunëtorë. Gjithashtu Dhoma thekson se në pasditen e 18 prillit 1998, Nasim Haradinaj informoi të tre burrat se do të liroheshin, se ai i dha një qetësues për dhimbje Dragosllav Stojanoviqit, se Hilmi Haradinaj u dha ushqim dhe ujë tre burrave, dhe se së fundi tre burrat u çuan në një kamp refugjatësh në Baballoq ku ata u liruan dhe iu dha ndihmë mjekësore. Megjithëse ky incident i vetëm përbën keqtrajtim të civilëve serbe të Kosovës, duke marrë parasysh kontekstin e këtij incidenti dhe sjelljen e lartpërmendur të Nasim Haradinajt dhe Hilmi Haradinajt, Dhoma rrëzon pretendimin se ky incident tregon ekzistencën e një plani të përbashkët që përfshinte largimin e paligjshëm dhe keqtrajtimin e civilëve serb dhe civilëve të tjerë në Kosovë që konsideroheshin bashkëpunëtorë.

657. Më parë Dhoma konkludoi se në orët e mëngjesit më 22 prill 1998, ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Kujtim Berisha dhe Jusufi të cilit nuk i dihet mbiemri, ndaluan Novak Stijoviqin, Stanisha Radosheviqin dhe nënën e tij Rosanda Radosheviqin në Pozhar.²²⁸³ Ushtarët atyre u thanë se nuk mund të ktheheshin në shtëpi dhe se nuk kishin punë atje.²²⁸⁴ Ushtarët çuan me dhunë në Gllogjan, në komunën e Deçanit, Novak Stijoviqin, Stanisha Radosheviqin dhe Rosanda Radosheviqin, ku rreth 30-50 ushtarë të UÇK-së shkellmuan, grushtuan dhe goditën me shufra dhe me kondakë pushke të dy burrat për 20-30 minuta.²²⁸⁵ Atyre u thanë sërish që nuk mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe duhej të shkonin në Serbi.²²⁸⁶ Pastaj Stanisha Radosheviqin e liruan që të shkonte e të sillte dy karabina; Novak Stijoviqi dhe Rosanda Radosheviqi u liruan rreth orës 3

²²⁸¹ *Shih* më sipër, para. 191.

²²⁸² *Shih* më sipër, para. 145-146, 183.

²²⁸³ *Shih* më sipër, para. 195, 199.

²²⁸⁴ *Shih* më sipër, para. 195.

²²⁸⁵ *Shih* më sipër, para. 195-196, 199.

²²⁸⁶ *Shih* më sipër, para. 196, 202

pasdite, pasi një ushtar i UÇK-së solli lajmin se Stanisha Radosheviqi i kishte dorëzuar një armë UÇK-së.²²⁸⁷

658. Dhoma thekson se gjatë këtij incidenti ushtarë të UÇK-së i thanë Novak Stijoviçit, Stanisha Radosheviçit dhe Rosanda Radosheviçit, të cilët ishin civilë serbë të Kosovës, se ata nuk mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe se duhej të shkonin në Serbi. Mirëpo, Dhoma thekson se Stanisha Radosheviçin e dërguan të merrte dy pushkë dhe të tre ata u liruan pasi Stanisha Radosheviqi i dorëzoi një armë një ushtari të UÇK-së më vonë gjatë asaj dite. Rosanda Radosheviqi nuk u rrah gjatë incidentit. Megjithëse Dhoma pranon se incidenti me Novak Stijoviçin, Stanisha Radosheviçin dhe Rosanda Radosheviçin përbën keqtrajtim të civilëve serbë të Kosovës, bazuar në faktin se Stanisha Radosheviçin e dërguan të sillte dy armë dhe se pak orë më vonë, u liruan që të tre, Dhoma e rrëzon pretendimin se incidenti është tregues i ekzistencës së një plani të përbashkët për largim të paligjshëm dhe keqtrajtim të civilëve serbë dhe civilëve të tjerë në Kosovë sikurse pretendon Aktakuza.

659. Më parë Dhoma konkludoi se më 11 gusht 1998, Idriz Balaj dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së ndaluan një ekip të ECMM-së, i urdhëruan të shkonin në Gllogjan dhe i akuzuan se spiunonin për forcat serbe. Në Gllogjan, Idriz Balaj keqtrajtoi përkthyesin shqiptar.²²⁸⁸ Dhoma gjithashtu konkludoi se Ramush Haradinaj i mori në pyetje anëtarët e ekipit në mënyrë “të sjellshme” dhe se më pas liroi ekipin e ECMM-së dhe përkthyesin e tyre me një ekip shoqërues për të garantuar sigurinë e tyre.²²⁸⁹ Një ushtar tjetër i UÇK-së që quhej Toni, të cilin anëtarët e ekipit të ECMM-së e hasën pas lirimt të tyre, tha se “i vinte shumë keq mirëpo brenda UÇK-së ka grupe ekstremiste që veprojnë sipas mënyrës së tyre”.²²⁹⁰ Duke marrë parasysh incidentin brenda një konteksti më të gjerë, sjelljen e Ramush Haradinajt, lirimt e ekipit të ECMM-së dhe ndjesën e ushtarit të UÇK-së “Tonit”, i cili ia ngarkoi këtë incident grupeve ekstremiste të pakontrollueshme brenda UÇK-së, Dhoma nuk pranon se ky incident është tregues i ekzistencës së një qëllimi të përbashkët kriminal të NPK-së sikurse pretendon Aktakuza.

660. Gjithashtu, Dhoma konkludoi se Fadil Fazliu dhe Naser Lika u morën me dhunë nga Zhabeli prej ushtarëve të UÇK-së. Ushtarët e UÇK-së i quajtën tradhtarë Fadil Fazliun dhe Naser Likën.²²⁹¹ Prokuroria nuk paraqiti prova që do të vërtetonin se ky krim ishte pjesë e një plani ose prova për incidente të tjera që vërtetojnë një praktikë dhune kundër civilëve sikurse pretendon Aktakuza.

²²⁸⁷ *Shih* më sipër, para. 196-197, 199, 201.

²²⁸⁸ *Shih* më sipër, para. 301-302, 304, 306.

²²⁸⁹ *Shih* më sipër, para. 303.

²²⁹⁰ *Shih* më sipër, para. 303.

²²⁹¹ *Shih* më sipër, para. 590, 596, 610.

(v) Incidente të keqtrajtimit dhe vrasjeve në objektin e UÇK-së në Jabllanicë

661. Më herët Dhoma konkludoi se në pranverë të vitit 1998, Jah Bushati u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, ku e rrahën. Gjithashtu, Dhoma konkludoi se pas njëfarë kohe Jah Bushati hyri në radhët e UÇK-së.²²⁹² Në këto rrethana, Dhoma nuk pranon se mbajtja e Jah Bushatit në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ishte pjesë e një plani të përbashkët për konsolidimin e kontrollit të UÇK-së mbi zonën e Dukagjinit nëpërmjet largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve.

662. Më parë Dhoma konkludoi se më 13 qershor 1998, Dëshmitari 6 u rrëmbye prej ushtarëve të UÇK-së nga rruga Gjakovë—Klinë dhe u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë afërsisht për gjashtë javë, ku atë e rrahën ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj, Lahi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj.²²⁹³ Dëshmitari 6 u akuzua se rrinte me serbë dhe spiunonte për ta.²²⁹⁴ Në ditën kur Dëshmitari 6 u lirua, Nazmi Brahimaj i dha një dokument me emrin dhe nënshkrimin e Nazmi Brahimajt dhe mbishkrimin “Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit, shtabi vendor i Jabllanicës”, ku shkruhej se Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit kishte vendosur ta lironte Dëshmitarin 6 dhe në rast se ai përsëriste gabimet, do të përballej me akuza penale.²²⁹⁵ Gjithashtu, Nazmi Brahimaj i dha Dëshmitarit 6 një dokument të ngjashëm ku shkruhej se Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit kishte vendosur të konfiskonte automjetin dhe revolen e tij për nevoja të ushtrisë.

663. Dhoma gjithashtu konkludoi se afërsisht më 13 qershor 1998, Nenad Remishtari, polic serb i Kosovës, u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku u rrah keqazi nga Nazmi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së. Ai u pa për herë të fundit në objektin e UÇK-së në Jabllanicë më 14 qershor 1998.²²⁹⁶ Dhoma konkludoi se një boshnjak i paidentifikuar i akuzuar për ndërprerje të rrymës elektrike dhe tre malazezë të paidentifikuar u mbajtën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për tri-katër ditë gjatë të cilave u rrahën me shkopiinj të trashë dhe u shpuan me thikë nga ushtarë të UÇK-së në praninë e Nazmi Brahimajt dhe Hamza Brahimajt.²²⁹⁷

664. Dhoma u bind se Skënder Kuqi u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë nga 13 ose 14 korrik 1998 deri më 15 ose 16 korrik 1998, ku ai u rrah keqazi. Atë e çuan në spital afërsisht më 15 ose 16 korrik 1998, në ditën e orvatjes së tij të pasuksesshme për t’u arratisur, ku ai vdiq për shkak të (problemeve fizike të shkaktuara nga) rrahjet.²²⁹⁸ Gjithashtu u vërtetua se edhe Pal Krasniqi u

²²⁹² *Shih* më sipër, para. 182.

²²⁹³ *Shih* më sipër, para. 477-486, 490.

²²⁹⁴ *Shih* më sipër, para. 482.

²²⁹⁵ *Shih* më sipër, para. 490.

²²⁹⁶ *Shih* më sipër, para. 499-500, 505-506.

²²⁹⁷ *Shih* më sipër, para. 510-511.

²²⁹⁸ *Shih* më sipër, para. 530, 533-534, 537, 539-540, 542-543, 564, 566-567.

mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë nga 14 ose 15 korrik 1998 deri së paku më 25 korrik 1998, ku u rrah keqazi. Po ashtu Dhoma u bind se më 14 ose 15 korrik 1998, Dëshmitarin 3 e sollën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, ku ai u mbajt deri më 15 ose 16 korrik kur mundi të arratisej. Gjatë burgimit, atë e rrahën me paramendimin për ta ndëshkuar sepse mendohej se kishte marrë pjesë në një sulm me forcat serbe dhe më vonë për ta ndëshkuar për arratisjen e tij.²²⁹⁹ Ndër individët që rrahën tre burrat ishin Nazmi Brahimaj i cili rrahu Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin dhe shkemoi Dëshmitarin 3;²³⁰⁰ Hamza Brahimaj²³⁰¹ dhe Naser Brahimaj,²³⁰² të cilët rrahën Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin; Lahi Brahimaj i cili keqtrajtoi Dëshmitarin 3 dhe ishte i pranishëm gjatë rrahjeve të Skënder Kuqit,²³⁰³ dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së, të pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë.

665. Dëshmitari 6, Nenad Remishtari, boshnjaku i paidentifikuar, tre malazezët e paidentifikuar, Skënder Kuqi, Pal Krasniqi dhe Dëshmitari 3 u mbajtën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe u rrahën keqazi. Provat tregojnë se para mbajtjes së tyre atë kishin qenë të gjithë civilë, me përjashtim të Nenad Remishtarit. Gjithsesi, në kohën e keqtrajtimit askush prej tyre nuk merrte pjesë aktive në luftime. Dhoma konkludoi se me përjashtim të tre malazezëve, rrahjet kundër tyre u kryen me synim ndëshkues ose diskriminues. Nazmi Brahimaj mori pjesë në keqtrajtimin e Dëshmitarit 6, Nenad Remishtarit, Skënder Kuqit, Pal Krasniqit dhe Dëshmitarit 3; ai ishte i pranishëm gjatë rrahjes së boshnjakut të paidentifikuar dhe tre malazezëve të paidentifikuar.²³⁰⁴ Ai konsiderohej komandant në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe nënshkroi dokumentet për lirimin e Dëshmitarit 6.²³⁰⁵ Hamza Brahimaj mori pjesë në rrahjen e Dëshmitarit 6, Skënder Kuqit dhe Pal Krasniqit; ai ishte i pranishëm gjatë rrahjes së boshnjakut dhe tre malazezëve.²³⁰⁶ Naser Brahimaj rrahu Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin.²³⁰⁷ Lahi Brahimaj mori pjesë në keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitarit 3; ai ishte i pranishëm gjatë rrahjes së Skënder Kuqit.²³⁰⁸

666. Përfundimet e lartpërmendura lënë të kuptohet se ka të ngjarë të ketë ekzistuar një plan i përbashkët ndërmjet Nazmi Brahimajt, Hamza Brahimajt, Naser Brahimajt, Lahi Brahimajt dhe ushtarëve të tjerë të UÇK-së të pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për mbajtjen dhe

²²⁹⁹ *Shih* më sipër, para. 533-535, 539-543.

²³⁰⁰ *Shih* më sipër, para. 530-531, 537.

²³⁰¹ *Shih* më sipër, para. 530, 534, 543.

²³⁰² *Shih* më sipër, para. 534-535, 537.

²³⁰³ *Shih* më sipër, para. 530, 534, 541, 556-557.

²³⁰⁴ *Shih* më sipër, para. 482, 484-485, 505, 510, 530, 534, 537.

²³⁰⁵ *Shih* më sipër, para. 484, 490.

²³⁰⁶ *Shih* më sipër, para. 484-485, 510, 530, 543.

²³⁰⁷ *Shih* më sipër, para. 535, 537.

²³⁰⁸ *Shih* më sipër, para. 484-485, 530, 541, 556-557.

keqtrajtimin e individëve për të cilët ata mendonin se bashkëpunonin me forcat serbe ose nuk përkrahnin UÇK-në. Aktakuza nuk e trajton një plan të tillë të përbashkët dhe kjo çështje del jashtë kuadrit të këtij procesi. Gjithsesi, Dhoma thekson se edhe sikur të vërtetohet ekzistenca e një plani të tillë të përbashkët, për të cilën Dhoma mendon të kundërtën, asnjë provë nuk tregon se Ramush Haradinaj ose Idriz Balaj mund të kenë marrë pjesë në këtë plan të përbashkët. Përkundrazi, më parë Dhoma konkludoi se kur Ramush Haradinaj mësoi për mbajtjen dhe keqtrajtimin e Skënder Kuçi, ai shkoi në Jabllanicë dhe foli me Nazmi Brahimajn lidhur me lirin e Skënder Kuçit, mirëpo përpjekja e tij ishte e pasuksesshme.²³⁰⁹ Veçanërisht Dhoma rikujton se një dëshmitar i pranishëm gjatë bisedës së lartpërmendur dëgjoi Ramush Haradinajn t'i thoshte Nazmi Brahimajt se “nuk duhet të ndodhë më një gjë e tillë sepse dëmton kauzën tonë”.²³¹⁰ Kur Dëshmitarin 3 e çuan te Ramush Haradinaj pas arratisjes së tij nga Jabllanica dhe kapjes së tij të mëpasshme nga Lahi Brahimaj, Haradinaj i dha bukë dhe strehim Dëshmitarit 3 dhe i propozoi që t'a kthente te familja e tij.²³¹¹ Ramush Haradinaj u zemërua kur mësoi se Lahi Brahimaj e kishte çuar Dëshmitarin 3 në Gllogjan.²³¹² Veç këtyre dy incidenteve, Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë që së paku vërtetonte se Ramush Haradinaj ishte në dijeni të kryerjes së krimeve në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Në provat e pranura nga Dhoma nuk përmendet prania e Idriz Balajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë apo dijenia e tij për këto krime.

667. Në Aktakuzë pretendohet se ekzistonte një NPK, qëllimi i përbashkët i së cilës ishte konsolidimi i kontrollit tërësor të UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit nëpërmjet largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë, shqiptarë kosovarë dhe civilëve të tjerë të cilët bashkëpunonin ose mendohej se kishin bashkëpunuar me forcat serbe, ose ndryshe nuk përkrahnin UÇK-në, plan në të cilin pretendohet të kenë marrë pjesë të tre të Akuzuarit. Krimet në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për të cilat Dhoma në Aktgjykim konkludoi se janë vërtetuar, megjithëse zbulojnë një praktikë dhe me gjasë një plan për kryerjen e krimeve të lartpërmendura në të cilat u implikuan disa individë në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, nuk provojnë ekzistencën e planit të përbashkët të pretenduar në Aktakuzë. Krimet e vërtetuara në këtë Aktgjykim kanë të bëjnë me një numër të kufizuar individësh, konkretisht Nazmi Brahimaj, Hamza Brahimaj, Naser Brahimaj, Lahi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së, të pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, dhe provat nuk vërtetojnë se pjesëtarë të tjerë të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit jashtë Jabllanicës u implikuan ose kishin dijeni për këto ngjarje.

²³⁰⁹ *Shih* më sipër, para. 561, 563.

²³¹⁰ Rrustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3681-3682.

²³¹¹ *Shih* më sipër, para. 559.

²³¹² Dëshmitari 3, T. 1679.

(b) Përfundim

668. Pasi ka shqyrtuar të gjitha provat rrethanore e paraqitura për vërtetimin e ekzistencës së NPK-së së pretenduar në Aktakuzë, Dhoma konkludon se nuk është vërtetuar qëllimi i përbashkët i NPK-së së pretenduar. Nuk është vërtetuar as ekzistenca e NPK-së së pretenduar në Aktakuzë.

2. Përgjegjësia e Ramush Haradinajt

669. Aktakuza e ngarkon Ramush Haradinajn me përgjegjësi penale individuale në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit për krimet e përfshira në Pikat 1-6, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK-në e pretenduar në Aktakuzë. Dhoma konkludoi se Pika 1 dhe Pika 2 nuk janë vërtetuar dhe për rrjedhojë nuk do të analizojë përgjegjësinë penale të të Akuzuarit në lidhje me këto pika.

670. Më sipër Dhoma konkludoi se ekzistenca e NPK-së nuk është vërtetuar. Rrjedhimisht, Ramush Haradinaj nuk mban përgjegjësi penale për pjesëmarrje në një NPK në lidhje me krimet e Pikave 3-6 të Aktakuzës.

671. Ndryshe, Ramush Haradinaj akuzohet për urdhërim, nxitje ose ndihmë dhe inkurajim të krimeve të përfshira në Pikën 6. Dhoma konkludoi se krimet e pretenduara në këtë pikë nuk janë vërtetuar, me përjashtim të largimit të dhunshëm të Naser Likës dhe Fadil Fazliut nga Zhabeli prej ushtarëve të UÇK-së.²³¹³

672. Provat e paraqitura në lidhje me këtë krim²³¹⁴ nuk tregojnë praninë e Ramush Haradinajt në vendin e ngjarjes. Dhoma nuk disponon asnjë provë që sugjeron, e aq më shumë që provon jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, se Ramush Haradinaj shtyu ose udhëzoi ushtarët e UÇK-së që larguan me dhunë nga Zhabeli Naser Likën dhe Fadil Fazliun për kryerjen e këtyre veprimeve. Nuk ka asnjë provë për ndonjë veprim ose mosveprim të Ramush Haradinaj që mund të ketë ndikuar thelbësisht në kryerjen e këtyre veprimeve. Provat që disponon Dhoma nuk vërtetojnë as synim të Ramush Haradinajt për këto veprime apo se ai ishte i vetëdijshëm se kishte plotësisht të ngjarë që këto veprime të kryheshin si pasojë. Rrjedhimisht, Ramush Haradinaj nuk mban përgjegjësi penale në asnjë aspekt për krimet e përfshira në Pikën 6, përfshirë edhe format alternative të përgjegjësisë.

3. Përgjegjësia e Idriz Balajt

673. Aktakuza e ngarkon Idriz Balajn me përgjegjësi penale individuale në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit për krimet e përfshira në Pikat 1-6, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK-në e

²³¹³ *Shih* më sipër, para. 590, 596, 610.

²³¹⁴ *Shih* më sipër, para. 590.

pretenduar në Aktakuzë. Dhoma konkludoi se Pika 1 dhe Pika 2 nuk janë vërtetuar dhe për rrjedhojë nuk do të analizojë përgjegjësinë penale të të Akuzuarit në lidhje me këto pika.

674. Më sipër Dhoma konkludoi se ekzistenca e NPK-së nuk është vërtetuar. Rrjedhimisht, Idriz Balaj nuk mban përgjegjësi penale për pjesëmarrje në një NPK në lidhje me krimet e Pikave 3, 4, 5 dhe 6 të Aktakuzës.

675. Ndryshe, Idriz Balaj ngarkohet me përgjegjësi penale individuale në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit për kryerje ose planifikim apo ndihmë dhe inkurajim të krimeve të përfshira në Pikën 6. Dhoma konkludoi se krimet e pretenduara në këtë pikë nuk janë vërtetuar, me përjashtim të largimit të dhunshëm të Naser Likës dhe Fadil Fazliut nga Zhabeli prej ushtarëve të UÇK-së.²³¹⁵

676. Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë që tregon se Idriz Balaj kreu, planifikoi ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e këtij krimi. Rrjedhimisht, Idriz Balaj nuk mban përgjegjësi penale në asnjë aspekt për krimet e përfshira në Pikën 6, përfshirë edhe format alternative të përgjegjësisë.

4. Përgjegjësia e Lahi Brahimajt

677. Aktakuza e ngarkon Lahi Brahimajn me përgjegjësi penale individuale në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit për krimet e përfshira në Pikat 1, 2, 4 dhe 6, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK-në e pretenduar në Aktakuzë. Dhoma konkludoi se Pika 1 dhe Pika 2 nuk janë vërtetuar dhe për rrjedhojë nuk do të analizojë përgjegjësinë penale të të Akuzuarit në lidhje me këto pika.

678. Më sipër Dhoma konkludoi se ekzistenca e NPK-së nuk është vërtetuar. Rrjedhimisht, Lahi Brahimaj nuk mban përgjegjësi penale për pjesëmarrje në një NPK në lidhje me krimet e përfshira në Pikën 4 dhe Pikën 6 të Aktakuzës.

679. Ndryshe, Lahi Brahimaj ngarkohet me përgjegjësi penalet për kryerje ose planifikim apo ndihmë dhe inkurajim të krimeve të përfshira në Pikën 6. Dhoma konkludoi se krimet e pretenduara në këtë pikë nuk janë vërtetuar, me përjashtim të largimit të dhunshëm të Naser Likës dhe Fadil Fazliut nga Zhabeli prej ushtarëve të UÇK-së.²³¹⁶

680. Prokuroria nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të akuzës se Lahi Brahimaj kreu ose planifikoi apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e këtij krimi. Ka dëshmi se diku midis Bokshiqit dhe Grykës së Gllogjanit, Lahi Brahimaj hasi në fshatarë nga Grabanica, ndër të cilët edhe Naser Lika dhe Fadil Fazliu, dhe i akuzoi si tradhtarë para mbërritjes së Naser Likës dhe Fadil Fazliut në

²³¹⁵ *Shih* më sipër, para. 590, 596, 610.

²³¹⁶ *Shih* më sipër, para. 590, 596, 610.

Zhabel.²³¹⁷ Mirëpo, nuk ka prova të mjaftueshme se këto akuza iu drejtuan pikërisht Naser Likës dhe Fadil Fazliut. Për më tepër, provat nuk zbulojnë asnjë lidhje midis Lahi Brahimajt dhe ngjarjeve në Zhabel. Rrjedhimisht, Lahi Brahimaj nuk mban përgjegjësi penale në asnjë aspekt për krimet e përfshira në Pikën 6, përfshirë edhe format alternative të përgjegjësisë.

C. Përfundim

681. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma konkludon se nuk është vërtetuar përgjegjësia penale individuale e Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt.

²³¹⁷ *Shih* më sipër, para. 586-587.

VIII. VENDIM

682. Për arsyet e lartpërmendura, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat dhe parashtrimet e palëve, Dhoma vendos si vijon:

683. Dhoma e shpall të Akuzuarin Ramush Haradinaj **TË PAFAJSHËM** në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës. Në bazë të Rregullës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirim të Ramush Haradinajt nga Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara, në qoftë se nuk mbahet në paraburgim në bazë të ndonjë urdhri tjetër në fuqi për paraburgim.

684. Dhoma e shpall të Akuzuarin Idriz Balaj **TË PAFAJSHËM** në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës. Në bazë të Rregullës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirim të Idriz Balajt nga Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara, në qoftë se nuk mbahet në paraburgim në bazë të ndonjë urdhri tjetër në fuqi për paraburgim.

685. Dhoma e shpall të Akuzuarin Lahi Brahimaj **TË PAFAJSHËM** në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës. Në bazë të Rregullës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirim të Lahi Brahimajt nga Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara, në qoftë se nuk mbahet në paraburgim në bazë të ndonjë urdhri tjetër në fuqi për paraburgim.

Bërë në anglisht dhe frëngjisht, teksti në anglisht ka përparësi.

Sot më njëzet e nëntë nëntor 2012
Në Hagë
Holandë

Gjykatësi Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Gjykatësi Burton Hall

Gjykatësi Guy Delvoie

[Vula e Tribunalit]

IX. SHTOJCA I: HISTORIA PROCEDURALE

A. Procedura në procesin e parë Haradinaj dhe të tjerë

1. Aktakuza e parë, paraqitja e parë dhe gjykimi i parë

686. Aktakuza e parë kundër tre të Akuzuarve, Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, u konfirmua më 4 mars 2005.²³¹⁸ Kjo aktakuzë i ngarkoi të Akuzuarit me përgjegjësi penale në 16 pika për krime kundër njerëzimit dhe në 19 pika për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës;²³¹⁹ gjithashtu Ramush Haradinaj u ngarkua me përgjegjësi penale në një pikë shtesë për krime kundër njerëzimit dhe në një pikë shtesë për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës.²³²⁰ Më 14 mars 2005, secili prej të Akuzuarve vetëdeklaroi pafajësinë në lidhje me të gjithë pikat kundër tyre.²³²¹

687. Gjykimi i parë filloi më 5 mars 2007; argumentet përmbyllëse u dëgjuan më 21-23 janar 2008, dhe Dhoma Gjyqësore e shpalli vendimin më 3 prill 2008. Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj u shpallën të pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat.²³²² Lahi Brahimaj u shpall fajtor në lidhje me Pikën 28 (torturim si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës) dhe Pikën 32 (torturim dhe trajtim mizor si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës), dhe u dënua me gjashtë vjet burgim; ai u shpall i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat e tjera.²³²³

2. Apeli

688. Prokuroria dhe Lahi Brahimaj e apelian vendimin e Dhomës Gjyqësore. Konkretisht, në Njoftimin për Apel të Prokurorisë të paraqitur më 2 maj 2008, apelohej verdikti i pafajësisë së Dhomës Gjyqësore për të tre të Akuzuarit në gjashtë pika lidhur me pretendimin për pjesëmarrjen e tyre në një NPK, për kryerjen e krimeve në shtabin e UÇK-së dhe në objektin e burgimit në

²³¹⁸ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-I, Vendim mbi Shqyrtimin e Aktakuzës, 4 mars 2005. Aktakuza e parë u ndryshua më pas dhe aktakuza në fuqi gjatë procesit të parë ishte Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt e 16 tetorit 2007.

²³¹⁹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-I, Aktakuza (Rishikuar për herë të dytë), 4 mars 2005.

²³²⁰ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-I, Aktakuza (Rishikuar për herë të dytë), 4 mars 2005.

²³²¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-I, Transkripti Publik i Seancës, 14 mars 2005; *shih gjithashtu Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-PT, Transkripti Publik i Seancës, 1 mars 2007, T. 265-266.

²³²² Aktgjykimi *Haradinaj*, para. 502-503.

²³²³ Aktgjykimi *Haradinaj*, para. 504-505.

Jabllanicë.²³²⁴ Njoftimi për Apel i Lahi Brahimajt i paraqitur më 5 maj 2008, parashtronte 19 pika për apel, duke përfshirë edhe kërkesën për shfuqizimin e fajësisë së tij lidhur me Pikën 28 dhe Pikën 32.²³²⁵

689. Më 28 tetor 2009, Dhoma e Apelit dëgjoi parashtrime gojore nga palët lidhur me të dy apelet dhe shqiptoi vendimin më 21 korrik 2010. Me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Robinson (kryegjykatës), Dhoma e Apelit miratoi pikën e parë të apelit të Prokurorisë, duke konkluduar se Dhoma Gjyqësorë gaboi kur refuzoi kërkesën e Prokurorisë për kohë shtesë në shfrytëzimin e të gjitha masave të arsyeshme, për të siguruar dëshmitë e dy dëshmitarëve kyç para se të mbyllej paraqitja e provave të Prokurorisë. Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykim të pjesshëm në lidhje me gjashtë pika që u cenuan nga pamundësia e marrjes së dëshmive të dy dëshmitarëve në fjalë, konkretisht Pikat 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të aktakuzës së parë. U rrëzuan 18 pika të apelit të Lahi Brahimajt; pika e nëntëmbëdhjetë e apelit të tij lidhur me fajësinë për torturim sipas Pikës 32 u miratua pjesërisht. Gjithsesi, vendimi i Dhomës së Apelit nuk ndryshoi verdiktin e fajësisë apo dënimin e dhënë.

B. Nisja e procedurës së rigjyimit të pjesshëm dhe aktakuza e ndryshuar

690. Më 21 korrik 2010, Kryetari i Tribunalit, gjykatësi Patrick Robinson, nxori një urdhër që caktoi këtë Dhomë për rigjykimin e pjesshëm, në përbërje të së cilës u emëruan gjykatësi Bakone Justice Moloto (kryegjykatës), gjykatësi Burton Hall dhe gjykatësi Guy Delvoie.²³²⁶

691. Më 15 shtator 2010, Dhoma urdhëroi që aktakuza në fuqi për rigjykimin e pjesshëm të mbetej aktakuza në fuqi për procesin e parë dhe që vetëdeklarimet e pafajësisë prej të Akuzuarve në lidhje me të gjitha akuzat të mbeteshin në fuqi.²³²⁷

692. Më 23 shtator 2010 u mbajt një konferencë për gjendjen, për të organizuar shkëmbimet midis palëve, në mënyrë që të mundësohej përgatitje e shpejtë për procesin gjyqësor. Në konferencën për gjendjen, gjykatësi paragjyqësor urdhëroi që brenda datës 28 tetor 2010, palët të paraqisnin bashkërisht një formë të shkurtuar të aktakuzës në fuqi që do të përkonte me kuadrin e

²³²⁴ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Njoftimi për Apel i Prokurorisë, 2 maj 2008, para. 2-7.

²³²⁵ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Njoftimi për Apel i të Akuzuarit të Tretë, Lahi Brahimaj, 5 maj 2008, para. 27.3.

²³²⁶ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Urdhër për Caktimin e Gjykatësve në një Çështje para një Dhome Gjyqësore, 21 korrik 2010.

²³²⁷ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Urdhër lidhur me Aktakuzën në Fuqi dhe Vetëdeklarimet, 15 shtator 2010.

rigjykimit të pjesshëm.²³²⁸ Gjithashtu gjykatësi paragjyqësor urdhëroi që palët të paraqisnin një deklaratë të përbashkët të fakteve të pranuar nga palët brenda datës 18 nëntor 2010, para dorëzimit prej Prokurorisë të dosjes së vetë paragjyqësore, përfshirë edhe një listë të plotë të dëshmitarëve dhe provave materiale,²³²⁹ dhe që të Akuzuarit të dorëzonin dosjet e tyre paragjyqësore brenda datës 14 dhjetor 2010.²³³⁰ Në një konferencë të mëvonshme për gjendjen mbajtur më 26 tetor 2010, gjykatësi paragjyqësor ndryshoi urdhrin e tij të 23 shtatorit 2010, ku kërkoi që aktakuza të paraqitej vetëm nga Prokuroria.²³³¹

693. Më 28 tetor 2010, Prokuroria dorëzoi Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar;²³³² dhe, më 9 nëntor 2010 u dorëzuan versioni i “shënuar” dhe “i pastër”(“ Versioni i Ri i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar”).²³³³

694. Më 23 nëntor 2010, secili prej të Akuzuarve dorëzoi parashtrim në përgjigje të Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, ku argumentoj se ky version përmbante akuza jashtë kuadrit të rigjykimit sipas urdhrin të Dhomës së Apelit dhe sipas parashtrimit të Prokurorisë në apel.²³³⁴ Konkretisht, të Akuzuarit argumentuan se akuzat e bëra në paragrafin 24 të Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, i cili ndryshoi paragrafin 26 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt²³³⁵ lidhur me NPK-në, pjesëmarrjen e të Akuzuarve në NPK dhe deklaratën e fakteve që shtriheshin jashtë Jabllanicës dhe incidente konkrete që pretendohet se ndodhën atje,²³³⁶ duheshin rishikuar dhe/ose hequr nga Versioni i Ri i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar. Gjithashtu parashtroj se

²³²⁸ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Transkripti Publik i Seancës, 23 shtator 2010, T. 5.

²³²⁹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Transkripti Publik i Seancës, 23 shtator 2010, T. 6-20.

²³³⁰ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Transkripti Publik i Seancës, 23 shtator 2010, T. 23-24.

²³³¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Transkripti Publik i Seancës, 26 tetor 2010, T. 23, 45-46.

²³³² *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 28 tetor 2010.

²³³³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim i Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 9 nëntor 2010, Shtojca A dhe B.

²³³⁴ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim në Emër të Ramush Haradinajt mbi Versionin e Ri të Aktakuzës për Rigjykimin e Pjesshëm, 23 dhjetor 2010; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Përgjigje ndaj Mocionit të Prokurorisë mbi Aktakuzën në Emër të Lahi Brahimajt, 23 nëntor 2010; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Mocion i Idriz Balajt Kundër Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 23 nëntor 2010.

²³³⁵ *Shih* më sipër, para. 686.

²³³⁶ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim i Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 9 nëntor 2010, Shtojca A, para. 24.

urdhri i Dhomës së Apelit e kufizonte rigjykimin e pjeshëm në shqyrtimin e krimeve të përmendura në Pikën 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të aktakuzës së parë, krime që pretendohesh se ishin kryer vetëm në shtabin e UÇK-së dhe objektin e burgimit në Jabllanicë.

695. Pas parashtrimeve prej tre të Akuzuarve, më 14 janar 2011, Dhoma urdhëroi që Prokuroria të ndryshonte sërish Versionin e Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar dhe të paraqiste sërish versionin “e shënuar” dhe atë “të pastër” të aktakuzës për rigjykimin e pjeshëm.²³³⁷ Këto versione u dorëzuan më 21 janar 2011.²³³⁸ Versioni “i pastër” i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të katërt të Rishikuar është aktakuza në fuqi në këtë proces.

696. Ndryshimet e urdhëruara nga Dhoma më 14 janar 2011 kishin të bënin me mospërputhje datash; me heqjen e akuzës në aktakuzë për kryerjen prej Lahi Brahimajt të krimeve të përfshira në Pikën 3 ose Pikën 5; dhe zëvendësimin e paragrafit 26 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar me paragrafin 24 të Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar.²³³⁹ Lidhur me ndryshimin e fundit të urdhëruar, Dhoma citoi vendimin e vet të 3 nëntorit 2010, ku theksonte se Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt ishte aktakuza në fuqi dhe se nuk e ftoi Prokurorinë të bënte ndryshim, dhe as Prokuroria nuk kërkoi të bënte ndryshim në atë aktakuzë në fuqi.²³⁴⁰ Dhoma konkludoi se “Dhoma e Apelit kishte ravijëzuar një pjesëmarrje *më të kufizuar* të të Akuzuarve në NPK, jo një NPK më të kufizuar. Rrjedhimisht NPK-ja është ajo që përkufizohet në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt, por krimet për të cilat do të rigjykohen të Akuzuarit kanë lidhje vetëm me pjesëmarrjen e tyre, në rast se ka pasur, në kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë”.²³⁴¹ Për rrjedhojë, ky urdhër garantoj që kuadri i NPK-së së pretenduar në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt të mbetet i pandryshuar në aktakuzën në fuqi të këtij procesi.

697. Ramush Haradinaj kërkoi leje për apelimin e vendimit të Dhomës të 14 janarit 2011 që rrëzoi pjesërisht argumentet e tij lidhur me Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt të

²³³⁷ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 14 janar 2011, Vendim, para. 42(3).

²³³⁸ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 21 janar 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt e Rishikuar, 21 janar 2011.

²³³⁹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 14 janar 2011, Vendim, para. 42(2)(a) to (e).

²³⁴⁰ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 14 janar 2011, Vendim, para. 29.

²³⁴¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 14 janar 2011, Vendim, para. 30.

Rishikuar;²³⁴² kërkesa u miratua më 3 shkurt 2011.²³⁴³ Gjithashtu edhe Idriz Balaj së bashku me Lahi Brahimajn paraqitën kërkesë për leje për apelimin e vendimit të Dhomës të 8 shkurtit 2011 i cili kishte rrëzuar kërkesat e tyre për qartësim të vendimit të 14 janarit 2011;²³⁴⁴ kërkesa për apelim u miratua më 24 shkurt 2011.²³⁴⁵ Më 31 maj 2011, Dhoma e Apelit e rrëzoi apelin e Ramush Haradinajt konkretisht me arsyetimin se Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt e Rishikuar nuk e ballafaqonte të Akuzuarin me rrezik të dyfishtë të mundshëm ose cenonte të drejtat dhe interesat e tij themelore, dhe se, meqenëse Dhoma Gjyqësore mund të nxirrte përfundime vetëm në lidhje me Pikat 1-6, përfshirja e pretendimeve të përgjithshme në “Paraqitje e Fakteve” në Aktakuzë nuk e ballafaqonte Ramush Haradinajn me akuza shtesë, as nuk e bënte rigjykimin në vetvete të padrejtë.²³⁴⁶ Më të njëjtën ditë, Dhoma e Apelit rrëzoi edhe apelin e Idriz Balajt dhe apelin e Lahi Brahimajt me arsyetimin se vendimi i vet i mëparshëm lidhur me apelin e Ramush Haradinajt i bënte të panevojshme çështje e ngritura dhe mjetin ligjor ndreqës kërkuar nga Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj.²³⁴⁷

698. Më 3 dhjetor 2010, Prokuroria dorëzoi Dosjen e vetë Paragjyqësore së bashku me listën e dëshmitarëve dhe provave materiale që kishte ndërmend të përdorte, në përputhje me Rregullën

²³⁴² *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kërkesë në Emër të Ramush Haradinajt për Leje për Apelim Sipas Rregullës 73(B), 18 janar 2011.

²³⁴³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Kërkesën në Emër të Ramush Haradinajt për Leje për Apelim Sipas Rregullës 73(B), 3 shkurt 2011.

²³⁴⁴ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kërkesë e Idriz Balajt për Leje për Apelim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 8 shkurtit 2011 Sipas Rregullës 73(B) të Rregullores, 15 shkurt 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kërkesë e Lahi Brahimajt për Bashkim me “Kërkesë e Idriz Balajt për Leje për Apelim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 8 shkurtit 2011 Sipas Rregullës 73(B) të Rregullores”, 15 shkurt 2011. *Shih gjithashtu Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kërkesë e Idriz Balajt për Qartësim të Vendimit të 14 janarit 2011 Lidhur me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar dhe për një Urdhër për Prokurorinë për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar, 26 janar 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kërkesë e Lahi Brahimajt për Bashkim me “Kërkesë e Idriz Balajt për Qartësim të Vendimit të 14 janarit 2011 Lidhur me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar dhe për një Urdhër për Prokurorinë për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar”, 26 janar 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt për Qartësim të Vendimit të 14 janarit 2011 Lidhur me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar, 8 shkurt 2011.

²³⁴⁵ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt për Apelimin e vendimit të Dhomës Gjyqësore të 8 shkurtit 2011 Sipas Rregullës 73(B), 24 shkurt 2011.

²³⁴⁶ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR73.1, Vendim mbi Apelin e Haradinajt Lidhur me Kuadrin e Rigjykimit të Pjesshëm, 31 maj 2011.

²³⁴⁷ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR73.2, Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për Qartësim të Aktakuzës në Fuqi, 31 maj 2011.

65ter(E) të Rregullores.²³⁴⁸ Më 20 qershor 2011, Prokuroria dorëzoi Dosjen e ndryshuar Paragjyqësore.²³⁴⁹ Më 11 korrik 2011 u dorëzuan Dosjet Paragjyqësore për secilin prej të Akuzuarve.²³⁵⁰

C. Procedura gjyqësore

1. Përmbledhje

699. Prokuroria filloi me paraqitjen e provave të veta më 18 gusht 2011 dhe përfundoi më 20 prill 2012. Më 27 prill 2012, Ramush Haradinaj dhe Lahi Brahimaj paraqitën njoftime të veçanta ku bënë të ditur se asnjë prej të Akuzuarve nuk do të bënte parashtrim sipas Rregullës 98bis, ose të paraqisnin prova në mbrojtje të vetvetes.²³⁵¹ Më të njëjtën ditë, Idriz Balaj dorëzoi një njoftim ku bënte të ditur se as ai nuk do të bënte parashtrim të Rregullës 98bis ose të paraqiste prova në mbrojtje të vetvetes në varësi të një marrëveshjeje për disa prova mjekësore.²³⁵² Më 7 maj 2012, Dhoma u njoftua se Idriz Balaj nuk do të paraqiste dëshmi gojore.²³⁵³ Më 4 maj 2012, avokati i Idriz Balajt dorëzoi një mocion për pranimin e provave në sallën gjyqësore. Mocioni u rrëzua prej një vendimi konfidencial të 25 majit 2012.

700. Më 11 qershor 2012, Prokuroria dhe secili prej të Akuzuarve dorëzuan Dosjet Gjyqësore Përfundimtare.²³⁵⁴ Argumentet përmbyllëse u dëgjuan më 25-27 qershor 2012.

²³⁴⁸ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim i Prokurorisë Sipas Rregullës 65ter (E) me Shtojcat Konfidenciale I, II dhe III, 3 dhjetor 2010.

²³⁴⁹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Njoftim i Prokurorisë për Dorëzimin e Dosjes Paragjyqësore të Ndryshuar me Shtojcën A dhe B, 20 qershor 2011.

²³⁵⁰ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Dosja Paragjyqësore në Emër të Ramush Haradinajt për Rigjykimin e Pjesshëm, 11 korrik 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Dosja Paragjyqësore e Idriz Balajt, 11 korrik 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Dosja Paragjyqësore në Emër të Lahi Brahimajt, 11 korrik 2011.

²³⁵¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Njoftim i Mbrojtjes së Ramush Haradinajt mbi Kërkesën e Rregullës 98bis dhe Paraqitjen e Provave prej Mbrojtjes, 27 prill 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Parashtrim në Emër të Lahi Brahimajt Sipas Urdhrit për Caktim Date, 27 prill 2012.

²³⁵² *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Parashtrim i Idriz Balajt në Përgjigje të Urdhrit për Caktim Date prej Dhomës Gjyqësore të 23 prillit 2012, 27 prill 2012.

²³⁵³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Njoftim, 7 maj 2012.

²³⁵⁴ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Parashtrim i Dosjes Përfundimtare të Prokurorisë, 11 qershor 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Dosja Përfundimtare në Emër të Ramush Haradinajt për Rigjykimin e Pjesshëm, 11 qershor 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Dosja Përfundimtare në Emër të Lahi Brahimajt, 11 qershor 2012.; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Dosja përfundimtare e Idriz Balajt, 11 qershor 2012.

2. Dëshmitarët

701. Dhoma mori dëshmi nga 56 dëshmitarë të Prokurorisë; në lidhje me tre prej këtyre dëshmitarëve, Dhoma nxori urdhërparaqitje. Mbrojtja nuk paraqiti dëshmitarë. Gjashtë dëshmitarë dhanë dëshmi tërësisht gojore; me marrëveshje midis palëve u pranuan dëshmi me shkrim nga 25 dëshmitarë; dëshmitë e pesë dëshmitarëve u paraqitën në përputhje me Rregullën 92*ter*; 11 dëshmitarë dëshmuan në përputhje me Rregullën 92*bis* pa u marrë në pyetje nga Mbrojtja; një dëshmitar dëshmoi në përputhje me Rregullën 92*bis* i cili u pyet nga Mbrojtja; dhe tetë dëshmitarë dëshmuan në përputhje me Rregullën 89(F).

702. Për 21 nga 56 dëshmitarë që dëshmuan u morën masa mbrojtëse. Për 15 nga këta dëshmitarë, masat mbrojtëse ishin të njëjta me masat e marra gjatë procesit të parë.

3. Seanca sipas Rregullës 4

703. Më 14 shkurt 2012, Dhoma nxori një vendim konfidencial ku i kërkonte Kryetarit të Tribunalit që të autorizonte mbajtjen e një seance në një vend të largët për marrjen e dëshmisë së një dëshmitari në përputhje me Rregullën 4. Më 17 shkurt 2012, ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Tribunalit nxori një urdhër që autorizonte Dhomën të mbante një seancë në një vend të largët. Seanca u zhvillua nga 16 deri më 20 prill 2012.

4. Lirimi i përkohshëm i të Akuzuarve

704. Gjatë fazës paragjyqësore dhe gjykimit, të Akuzuarit paraqitën disa kërkesa për lirim të përkohshëm.

705. Më 10 shtator 2010, Dhoma rrëzoi mocionet e paraqitura nga Ramush Haradinaj dhe Lahi Brahimaj për lirim të përkohshëm gjatë fazës paragjyqësore të procesit.²³⁵⁵

706. Më 8 dhjetor 2010, Dhoma përkatësisht miratoi dhe rrëzoi mocione për lirim të përkohshëm gjatë pushimeve dimërore 2010/2011, të paraqitura nga Ramush Haradinaj dhe Lahi Brahimaj.²³⁵⁶

²³⁵⁵ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-PT, Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 10 shtator 2010; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-PT, Vendim mbi Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 10 shtator 2010. *Shih gjithashtu Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-PT, Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 26 korrik 2010; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-PT, Kërkesë për Lirim të Përkohshëm me Kusht paraqitur nga i Akuzuari Lahi Brahimaj, 27 korrik 2010.

²³⁵⁶ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-PT, Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 8 dhjetor 2010; *Prokurori k.*

Të dy vendimet u apeluar dhe Dhoma e Apelit prapësoi vendimin që miratonte lirim të përkohshëm të Ramush Haradinajt dhe la në fuqi vendimin që refuzonte lirim të përkohshëm të Lahi Brahimajt.²³⁵⁷

707. Në vigjilje të pushimeve dimërore 2011/2012, Ramush Haradinaj dhe Lahi Brahimaj sërish paraqitën mocione për lirim të përkohshëm gjatë kësaj periudhe.²³⁵⁸ Dhoma i miratoi të dy mocionet më 12 dhjetor 2011,²³⁵⁹ që më pas u rrëzuan prej Dhomës së Apelit.²³⁶⁰

708. Pas përfundimit të paraqitjes së provave, të tre të Akuzuarit paraqitën mocione për lirim të përkohshëm deri në seancën e argumenteve përmbyllëse.²³⁶¹ Dhoma i miratoi të tre mocionet.²³⁶²

Vendimet e Dhomës nuk u apeluar.

Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm me Kusht paraqitur nga i Akuzuari Lahi Brahimaj, 8 dhjetor 2010. *Shih gjithashtu Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 25 nëntor 2010; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kërkesë për Lirim të Përkohshëm me Kusht paraqitur nga i Akuzuari Lahi Brahimaj, 26 nëntor 2010.

²³⁵⁷ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR65.1, Vendim mbi Apelimin prej Prokurorisë të Vendimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 16 dhjetor 2010; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR65.2, Vendim mbi Apelimin prej Lahi Brahimajt të “Vendim mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm me Kusht paraqitur nga i Akuzuari Lahi Brahimaj” të Dhomës Gjyqësore, 21 dhjetor 2010.

²³⁵⁸ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 28 nëntor 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 30 nëntor 2011.

²³⁵⁹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 12 dhjetor 2010; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 12 dhjetor 2011.

²³⁶⁰ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR65.3, Vendim mbi Apelimin prej Prokurorisë të Vendimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Mocionin në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 22 dhjetor 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR65.4, Vendim mbi Apelimin prej Prokurorisë të Vendimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 22 dhjetor 2011.

²³⁶¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Mocion i Mbrojtjes së Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 20 prill 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht deri në Argumentet Përmbyllëse, 2 maj 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë për Lirim të Përkohshëm me Kusht në Emër të Idriz Balajt, 14 maj 2012.

709. Pas përfundimit të argumenteve përmbyllëse, të tre të Akuzuarit paraqitën mocione për lirim të përkohshëm deri në shqiptimin e vendimit.²³⁶³ Sërish, Dhoma i miratoi të tre mocionet e të Akuzuarve.²³⁶⁴ Këto vendime nuk u apeluan.

710. Së fundi, më 3 dhe 5 tetor 2012, Dhoma miratoi mocionet e paraqitura nga tre të Akuzuarit për zgjatjen e periudhës së lirimit të tyre të përkohshëm.²³⁶⁵ Për të tre të Akuzuarit, lirimi i përkohshëm i tyre u zgjat me tre muaj ose deri në një urdhër tjetër.


²³⁶² *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 8 maj 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht deri në Argumentet Përmbyllëse, 15 maj 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 25 maj 2012.

²³⁶³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Mocion i Mbrojtjes së Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 2 korrik 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë në Emër të Idriz Balajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 5 korrik 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 11 korrik 2012.

²³⁶⁴ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 13 korrik 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Kërkesën në Emër të Idriz Balajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 17 korrik 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 17 korrik 2012.

²³⁶⁵ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Ramush Haradinajt për Zgjatjen e Periudhës së Lirimit të Përkohshëm me Kusht, 3 tetor 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Zgjatjen e Periudhës së Lirimit të Përkohshëm me Kusht, 3 tetor 2012; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin në Emër të Idriz Balajt për Zgjatjen e Lirimit të Përkohshëm me Kusht, 5 tetor 2012.

X. SHTOJCA II: HARTA



XI. SHTOJCA III: SHPJEGUES TERMASH

Aktakuza	<i>Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 21 janar 2011
Aktgjykimi <i>Bërgjanin</i>	<i>Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit</i> , Lënda Nr. IT-99-36-T, Aktgjykim, 1 shtator 2004
Aktgjykimi <i>Bllashkiq</i>	<i>Prokurori k. Tihomir Bllashkiqit</i> , Lënda Nr. IT-95-14-T, Aktgjykim, 3 mars 2000
Aktgjykimi <i>Boshkoski</i>	<i>Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçullovskit</i> , Lënda Nr. IT-04-82-T, Aktgjykim, 8 korrik 2008
Aktgjykimi <i>Çelebiqi</i>	<i>Prokurori k. Zejnil Delaliqit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-96-21-T, Aktgjykim, 16 nëntor 1998
Aktgjykimi <i>Deliq</i>	<i>Prokurori k. Rasim Deliqit</i> , Lënda Nr. IT-04-83-T, Aktgjykimi, 15 shtator 2008
Aktgjykimi <i>Furunxhija</i>	<i>Prokurori k. Anto Furunxhisë</i> , Lënda Nr. IT-95-17/1-T, Aktgjykim, 10 dhjetor 1998
Aktgjykimi <i>Galiq</i>	<i>Prokurori k. Stanisllav Galiqit</i> , Lënda Nr. IT-98-29-T, Aktgjykim dhe Mendim, 5 dhjetor 2003
Aktgjykimi <i>Gjorgjeviq</i>	<i>Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit</i> , Lënda Nr. IT-05-87/1-T, Aktgjykim, 23 shkurt 2011
Aktgjykimi <i>Gotovina</i>	<i>Prokurori k. Ante Gotovinës dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-06-90-T, Aktgjykim, 15 prill 2011
Aktgjykimi <i>Haliloviq</i>	<i>Prokurori k. Sefer Haliloviqit</i> , Lënda Nr. IT-01-48-T, Aktgjykim, 16 nëntor 2005
Aktgjykimi <i>Haradinaj</i>	<i>Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve</i> , Lënda nr. IT-04-84, Aktgjykim, 3 prill 2008
Aktgjykimi i Apelit <i>Akayesu</i>	<i>Prokurori k. Jean-Paul Akayesu-s</i> , Lënda nr. ICTR-96-4-A, Aktgjykim, 1 qershor 2001

Aktgjykimi i Apelit <i>Aleksovski</i>	<i>Prokurori k. Zllatko Aleksovskit</i> , Lënda Nr. IT-95-14/1-A, Aktgjykim, 24 mars 2000
Aktgjykimi i Apelit <i>Babiq</i>	<i>Prokurori k. Millan Babiqit</i> , Lënda Nr. IT-03-72-A, Aktgjykimi i Apelit për Dënimin, 18 korrik 2005
Aktgjykimi i Apelit <i>Bagosora</i>	<i>Théoneste Bagosora dhe Anatole Nsengiyumva k. Prokurorit</i> , Lënda nr. ICTR-98-41-A, Aktgjykim, 14 dhjetor 2011
Aktgjykimi i Apelit <i>Bërgjanin</i>	<i>Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit</i> , Lënda Nr. IT-99-36-A, Aktgjykim, 3 prill 2007
Aktgjykimi i Apelit <i>Bllagojeviq</i>	<i>Prokurori k. Vidoje Bllagojeviqit dhe Dragan Jokiqit</i> , Lënda Nr. IT-02-60-A, Aktgjykim, 9 maj 2007
Aktgjykimi i Apelit <i>Bllashkiq</i>	<i>Prokurori k. Tihomir Bllashkiqit</i> , Lënda Nr. IT-95-14-A, Aktgjykim, 29 korrik 2004
Aktgjykimi i Apelit <i>Boshkoski</i>	<i>Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçullovskit</i> , Lënda Nr. IT-04-82-A, Aktgjykim, 19 maj 2010
Aktgjykimi i Apelit <i>Çelebiqi</i>	<i>Prokurori k. Zejnil Delaliqit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-96-21-A, Aktgjykim, 20 shkurt 2001
Aktgjykimi i Apelit <i>Furunxhija</i>	<i>Prokurori k. Anto Furunxhisë</i> , Lënda Nr. IT-95-17/1-A, Aktgjykim, 21 korrik 2000
Aktgjykimi i Apelit <i>Gacumbitsi</i>	<i>Sylvestre Gacumbitsi k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-2001-64-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006
Aktgjykimi i Apelit <i>Galiq</i>	<i>Prokurori k. Stanislav Galiqit</i> , Lënda Nr. IT-98-29-A, Aktgjykim, 30 nëntor 2006
Aktgjykimi i Apelit <i>Haradinaj</i>	<i>Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve</i> , Lënda nr. IT-04-84, Aktgjykim, 19 korrik 2010
Aktgjykimi i Apelit <i>Hategekimana</i>	<i>Ildephonse Hategekimana k. Prokurorit</i> , Lënda nr. ICTR-00-55B-A, Aktgjykim, 8 maj 2012
Aktgjykimi i Apelit <i>Jelisiq</i>	<i>Prokurori k. Goran Jelisiqit</i> , Lënda Nr. IT-95-10-A,

Aktgjykim, 5 korrik 2001

Aktgjykimi i Apelit <i>Kalimanzira</i>	<i>Callixte Kalimanzira k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-05-88-A, Aktgjykim, 20 tetor 2010
Aktgjykimi i Apelit <i>Kamuhanda</i>	<i>Jean de Dieu Kamuhanda k. Prokurorit</i> , Lënda Nr ICTR-99-54A-A, Aktgjykim, 19 shtator 2005
Aktgjykimi i Apelit <i>Kanyarukiga</i>	<i>Gaspard Kanyarukiga k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-02-78-A, Aktgjykim, 8 maj 2012
Aktgjykimi i Apelit <i>Karera</i>	<i>François Karera k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-01-74-A, Aktgjykim, 2 shkurt 2009
Aktgjykimi i Apelit <i>Kërnojelac</i>	<i>Prokurori k. Millorad Kërnojelacit</i> , Lënda Nr. IT-97-25-A, Aktgjykim, 17 shtator 2003
Aktgjykimi i Apelit <i>Kërstiq</i>	<i>Prokurori k. Radisllav Kërstiqit</i> , Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykim, 19 prill 2004
Aktgjykimi i Apelit <i>Kordiq</i>	<i>Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit</i> , Lënda Nr. IT-95-14/2-A, Aktgjykim, 17 dhjetor 2004
Aktgjykimi i Apelit <i>Krajishnik</i>	<i>Prokurori k. Momçillo Krajishnikut</i> , Lënda Nr. IT-00-39-A, Aktgjykim, 17 mars 2009
Aktgjykimi i Apelit <i>Kunarac</i>	<i>Prokurori k. Dragolub Kunaracit dhe të tjerëve</i> , Lënda nr. IT-96-23&23/1-A, Aktgjykim, 12 qershor 2002
Aktgjykimi i Apelit <i>Kvoçka</i>	<i>Prokurori k. Miroslav Kvoçkës dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005
Aktgjykimi i Apelit <i>Limaj</i>	<i>Prokurori kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-03-66-A, Aktgjykim, 27 shtator 2007
Aktgjykimi i Apelit <i>Martiq</i>	<i>Prokurori k. Millan Martiqit</i> , Lënda Nr. IT-95-11-A, Aktgjykim, 8 tetor 2008
Aktgjykimi i Apelit <i>Mërkshiq</i>	<i>Prokurori k. Mile Mërkshiqit dhe Veselin Shlivançaninit</i> , Lënda Nr. IT-95-13/1-A, Aktgjykim, 5 maj 2009

Aktgjykimi i Apelit <i>Millosheviq</i>	<i>Prokurori k. Dragomir Millosheviqit</i> , Lënda Nr. IT-98-29/1-A, Aktgjykim, 12 nëntor 2009
Aktgjykimi i Apelit <i>Nahimana</i>	<i>Ferdinand Nahimana dhe të tjerë k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-99-52-A, Aktgjykim, 28 nëntor 2007
Aktgjykimi i Apelit <i>Ntakirutimana</i>	<i>Prokurori k. Elizaphan Ntakirutimana-s dhe Gérard Ntakirutimana-s</i> , Lëndët Nr. ICTR-96-10-A dhe ICTR-96-17-A , Aktgjykim, 13 dhjetor 2004
Aktgjykimi i Apelit <i>Ntawukulilyayo</i>	<i>Dominique Ntawukulilyayo k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-05-82-A , Aktgjykim, 14 dhjetor 2011
Aktgjykimi i Apelit <i>Oriq</i>	<i>Prokurori k. Naser Oriqit</i> , Lënda Nr. IT-03-68-A, Aktgjykim, 3 korrik 2008
Aktgjykimi i Apelit <i>Semanza</i>	<i>Laurent Semanza k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-97-20-A, Aktgjykim, 20 maj 2005
Aktgjykimi i Apelit <i>Seromba</i>	<i>Prokurori k. Athanase Seromba-s</i> , Lënda Nr. ICTR-2001-66-A, Aktgjykim, 12 mars 2008
Aktgjykimi i Apelit <i>Setako</i>	<i>Ephrem Setako k. Prokurorit</i> , Lënda Nr. ICTR-04-81-A, Aktgjykim, 28 shtator 2011
Aktgjykimi i Apelit <i>Simiq</i>	<i>Prokurori k. Bllagoje Simiqit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-95-9-A, Aktgjykim, 28 nëntor 2006
Aktgjykimi i Apelit <i>Stakiq</i>	<i>Prokurori k. Millomir Stakiqit</i> , Lënda Nr. IT-97-24-A, Aktgjykim, 22 mars 2006
Aktgjykimi i Apelit <i>Strugar</i>	<i>Prokurori k. Pavle Strugarit</i> , Lënda Nr. IT-01-42-A, Aktgjykim, 17 korrik 2008
Aktgjykimi i Apelit <i>Tadiq</i>	<i>Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur edhe si “Dule”</i> , Lënda Nr. IT-94-1-A, Aktgjykim, 15 korrik 1999
Aktgjykimi i Apelit <i>Vasileviq</i>	<i>Prokurori k. Mitar Vasileviqit</i> , Lënda Nr. IT-98-32-A, Aktgjykim, 25 shkurt 2004
Aktgjykimi <i>Kërnojelac</i>	<i>Prokurori k. Millorad Kërnojelacit</i> , Lënda Nr. IT-97-

25-T, Aktgjykim, 15 mars 2002

Aktgjykimi <i>Kërstiq</i>	<i>Prokurori k. Radisllav Kërstiqit</i> , Lënda Nr. IT-98-33-T, Aktgjykim, 2 gusht 2001
Aktgjykimi <i>Kordiq</i>	<i>Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit</i> , Lënda Nr. IT-95-14/2-T, Aktgjykim, 26 shkurt 2001
Aktgjykimi <i>Kunarac</i>	<i>Prokurori k. Dragolub Kunaracit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-96-23/1-T, Aktgjykim, 22 shkurt 2001
Aktgjykimi <i>Kvoçka</i>	<i>Prokurori k. Miroslav Kvoçkës dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-98-30-T, Aktgjykim, 2 nëntor 2001
Aktgjykimi <i>Limaj</i>	<i>Prokurori kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-03-66-T, Aktgjykim, 30 nëntor 2005
Aktgjykimi <i>Martiq</i>	<i>Prokurori k. Millan Martiqit</i> , Lënda Nr. IT-95-11-T, Aktgjykim, 12 qershor 2007
Aktgjykimi <i>Mërkshiq</i>	<i>Prokurori k. Mile Mërkshiqit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-95-13/1, Aktgjykim, 27 shtator 2007
Aktgjykimi <i>Millutinoviq</i>	<i>Prokurori k. Millan Millutinoviqit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-05-87-T, Aktgjykim, 26 shkurt 2009
Aktgjykimi <i>Naletiliq</i>	<i>Prokurori k. Mlladen Naletiliqit dhe Vinko Martinoviqit</i> , Lënda Nr. IT-98-34-T, Aktgjykim, 31 mars 2003
Aktgjykimi <i>Oriq</i>	<i>Prokurori k. Naser Oriqit</i> , Lënda Nr. IT-03-68-T, Aktgjykim, 30 qershor 2006
Aktgjykimi <i>Popoviq</i>	<i>Prokurori k. Vujadin Popoviqit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-05-88-T, Aktgjykim, 10 qershor 2010
Aktgjykimi <i>Simiq</i>	<i>Prokurori k. Bllagoje Simiqit dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-95-9-T, Aktgjykim, 17 tetor 2003
Aktgjykimi <i>Stakiq</i>	<i>Prokurori k. Millomir Stakiqit</i> , Lënda Nr. IT-97-24-T, Aktgjykim, 31 korrik 2003

Aktgjykimi <i>Strugar</i>	<i>Prokurori k. Pavle Strugarit</i> , Lënda Nr. IT-01-42-T, Aktgjykim, 31 janar 2005
Aktgjykimi <i>Tadiq</i>	<i>Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur edhe si “Dule”</i> , Lënda Nr. IT-94-1-T, Mendim dhe Aktgjykim, 7 maj 1997
Aktgjykimi <i>Vasileviq</i>	<i>Prokurori k. Mitar Vasileviqit</i> , Lënda Nr. IT-98-32-T, Aktgjykim, 29 nëntor 2002
APJ	Armata Popullore e Jugosllavisë
Dhoma	Trupi Gjykes II i Dhomës Gjyqësore II të Tribunalit
Dosja Përfundimtare e Prokurorisë	<i>Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve</i> , Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Parashtrim Konfidencial i Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Prokurorisë, 11 qershor 2012.
FARK	Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës
JSO	Njësia për Operacione të Posaçme. BKS: <i>jedinica za specijalne operacije</i>
KB	Kombet e Bashkuara
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
KNPZH	Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur
Konventa e Gjenevës II	Konventa e Gjenevës II për Përmirësimin e Gjendjes së Të Plagosurve, Të Sëmurëve dhe Të Fundosurve në Forcat e Armatosura në Det e 12 gushtit 1949
Konventat e Gjenevës	Konventat e Gjenevës I - IV të 12 gushtit 1949
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë (në BKS <i>Ministarstvo Unutrašnjih Poslova</i>)

Neni i Përbashkët 3	Neni 3 i Konventave të Gjenevës I - IV
NPK	Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale
Periudha e Aktakuzës	1 mars 1998 - 30 shtator 1998
PJP	Njësi të posaçme policore të MPB-së. BKS: <i>Posebne jedinice policije</i>
Praga	Armë kundërajrore vetështytëse
Prokuroria	Zyra e Prokurorit të TPNJ-së
PU	Policia Ushtarake (e UÇK-së)
RDB	Drejtoria e Sigurimit Publik (BKS: <i>Resor Državne Bezbednosti</i>)
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
RPG (në anglisht)	Granatahedhës, armë kundërtanke e mbajtur në sup
Rregullorja	Rregullorja e Procedurës dhe Provave e Tribunalit
SAJ	Njësia e posaçme kundërterroriste e MPB-së. (BKS: <i>Specijalna Antiteroristička Jedinica</i>)
Shpjegues i KNKK-së për Konventën e Dytë të Gjenevës	J. Pictet, ed., <i>The Geneva Conventions of 12 August 1949: Commentary, Part II Geneva Convention for the Amelioration of the Condition of Wounded, Sick and Shipwrecked Members of Armed Forces at Sea</i> , International Committee of the Red Cross, Geneva, 1987/ <i>Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949; Shpjegues, Pjesa II Konventa e Gjenevës për Përmirësimin e Gjendjes së Të Plagosurve, Të Sëmurëve dhe Të Fundosurve në Forcat e Armatosura në Det</i> , Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Gjenevë, 1987
SPB	Sekretariati për Punë të Brendshme (në BKS <i>Sekretarijat Unutrašnjih Poslova</i>)

Statuti	Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, themeluar me Rezolutën 827 të Këshillit të Sigurimit
T.	Transkripti i seancave në këtë çështje. Të gjitha faqet e transkriptit të cituara në Aktgjykim janë marrë nga versioni i pakorrigjuar i transkriptit. Rrjedhimisht mund të ketë ndryshime të vogla midis faqesjes së këtushme dhe asaj të transkriptit përfundimtar për publikun
T55	Një lloj tanku mësymës
Tanjug	Agjencia telegrafike e Jugosllavisë së Re (në BKS: <i>Telegrafska Agencija Nove Jugoslavije</i>)
TPNJ	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991.
TPNR	Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe të Shtetasve Ruandezë përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Ngjashme të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinje nga 1 janari 1994 deri më 31 dhjetor 1994.
Tribunali	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UJ	Ushtria e Jugosllavisë (në BKS: <i>Vojska Jugoslavije</i>)
UNMIK (në anglisht)	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
Vendimi <i>Tadiq</i> mbi Juridiksionin	<i>Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur edhe si “Dule”, Lënda Nr. IT-94-1-AR72, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Apel të Ndërkohshëm lidhur me</i>

Juridksionin, 2 tetor 1995

ZPT

Zyra e Prokurorit të TPNJ-së

ZPZHML

Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore

XII. SHTOJCA IV: SHTOJCË KONFIDENCIALE